

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË



S T U D I M E

H I S T O R I K E

1

REDAKSIA

KRYEREDAKTOR

Prof. dr. Hamit KABA

SEKRETAR SHKENCOR

Prof. asoc. dr. Sali KADRIA

BORDI I REVISTËS

Prof. dr. Afrim KRASNIQI (Shqipëri)	Prof. dr. Noel MALCOLM (Britani e Madhe)
Prof. dr. Beqir META (Shqipëri)	Prof. dr. Oliver Jens SCHMITT (Austri)
Prof. dr. Marenglen VERLI (Shqipëri)	Prof. dr. Nathalie CLAYER (Francë)
Prof. dr. Pëllumb XHUFI (Shqipëri)	Prof. dr. Abdülhamit KIRMIZI (Turqi)
Prof. dr. Frashër DEMAJ (Kosovë)	Prof. dr. Fehari RAMADANI (Maqedoni e Veriut)
Prof. dr. Ledia DUSHKU (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Elidor MËHILLI (SHBA)
Prof. dr. Romeo GURAKUQI (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Anton PANCHEV (Bullgari)
Prof. dr. Sabit SYLA (Kosovë)	Prof. asoc. dr. Elias G. SKOULIDAS (Greqi)
Prof. dr. Gjon BERISHA (Kosovë)	Prof. asoc. dr. Gjon BORIÇI (Shqipëri)
Prof. dr. Teuta SHALA-PELI (Kosovë)	Prof. asoc. dr. Marenglen KASMI (Shqipëri)
Prof. dr. Valentina DUKA (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Hasan BELLO (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Edmond MALAJ (Shqipëri)	Dr. Eduart CAKA (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Sonila BOÇI (Shqipëri)	

Redaktore gjuhësore: Mimoza KONOMI

*Korrektimi teknik për njësimin e citimeve
e të bibliografisë & Arti grafik:* Mirela MIHALI

ISSN: 3005-8481 (E printuar)

ISSN: 0563-5799 (Online)

Del çdo gjashtë muaj

© Copyright:

Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Adresa e redaksisë: Rruga “Naim Frashëri”, nr.7, Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

faqe

ARTIKUJ SHKENCORË

Edmond MALAJ	Dyndjet e popujve “barbarë” në Iliri gjatë shek. IV-VII	5
Pëllumb XHUFI	Armanët e Shasit (shek. XV-XVI)	39
Eduart CAKA	Islamizimi në sanxhakun e Elbasanit gjatë gjysmës së parë të shek. XVI	71
Alvin SARAÇI	Origjina shqiptare, jeta dhe vepra e Karl Gegës	93
Romeo GURAKUQI	Lindja dhe zhvillimi i nacionalizmit shqiptar (shek. XIX deri në vitet 1920)	119
Hasan BELLO	Konflikti i shqiptarëve me xhonturqit për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe (shtator 1909 – dhjetor 1910)	151
Ledia DUSHKU	Regjimet e pushtimit dhe shoqëritë lokale: Një qasje sociopolitike mbi krahinën autonome të Korçës	175
Erind MERKURI	Komisioni ligj-përgatitës dhe veprimtaria “tjetër” e tij në periudhën 1926-1929	205
Gentiana KERA	Zhvillimi demografik në Shqipëri në gjysmën e parë të shek. XX	231
Afrim KRASNIQI	Dosja e arit shqiptar: Nga konflikti ideologjik te zgjidhja në periudhën e tranzicionit	257
Sonila BOÇI	Reforma pa transformim: Dinamika të pushtetit politik në Shqipërinë e viteve 1953-1956	295

NEKROLOGJI

Marenglen VERLI Muhamet SHATRI	Dy fjalë për prof. dr. Ramiz Abdylin (10 nëntor 1944 – 22 shkurt 2026).....	321
-----------------------------------	---	-----

TABLE OF CONTENT

page

SCIENTIFIC ARTICLES

Edmond MALAJ	“Migration Of “Barbarian” Peoples In Illyria During The 4th-7th Centuries”	5
Pëllumb XHUFİ	The Armani Family Of Shas (XV-XVI)	39
Eduart CAKA	Islamization In The Sanjak Of Elbasan During The First Half Of The 16th Century ..	71
Alvin SARAÇI	Karl Gega’s Origin, Life And Works	93
Romeo GURAKUQI	The Birth And Development Of Albanian Nationalism (19th Century To The 1920s)	119
Hasan BELLO	The Conflict Of Albanians With The Young Turks On The Issue Of The Albanian Alphabet (September 1909 – December 1910)	151
Ledia DUSHKU	Occupation Regimes and Local Societies: French Occupation and Socio-political Change in the Autonomous Province of Korçë (1916-1918)	175
Erind MERKURI	The Legislative Drafting Commission and Its ‘Other’ Activities 1926–1929.....	205
Gentiana KERA	Demographic Development In Albania In The First Half Of The 20th Century	231
Afrim KRASNIQI	The Albanian Monetary Gold Case: From Ideological Conflict To Resolution In The Transitional Period	257
Sonila BOÇI	Reform Without Transformation: Political Power Dynamics In Albania 1953-1956	295

NECROLOGY

Marenglen VERLI Muhamet SHATRI	In Memoriam: Professor Ramiz Abdylı (10 November 1944 – 22 February 2026). His Life and Scholarly Legacy.....	321
-----------------------------------	---	-----

PROF. ASOC. DR. EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edmondmalaj@yahoo.de

**DYNDJET E POPUJVE “BARBARË” NË ILIRI
GJATË SHEK. IV-VII****Abstrakt:**

Ky studim trajton dyndjet e popujve të ashtuquajtur “barbarë” në hapësirën e Ilirisë gjatë shek. IV-VII, një periudhë që shënon transformime të thella politike, demografike dhe kulturore në Ballkan. Analiza përqendrohet te lëvizjet e gotëve, hunëve, avarëve, bullgarëve të hershëm dhe, veçanërisht, të sllavëve, duke shqyrtuar ndikimin e tyre mbi strukturat e provincave ballkanike të Perandorisë Romake të Lindjes. Studimi mbështetet në burime narrative bizantine dhe latine, në historiografinë moderne, si dhe në dëshmi arkeologjike, të cilat ndihmojnë në rindërtimin sa më të plotë dhe të saktë të këtyre proceseve historike. Në artikull argumentohet se inkursionet e hershme kishin kryesisht karakter grabitës dhe destabilizues, ndërsa, duke filluar nga shek. VI, ato u shoqëruan me procese të qëndrueshme kolonizimi, veçanërisht në rastin e sllavëve. Si pasojë, rajoni përjetoi ndryshime të thella në strukturën etnike dhe shoqërore. Studimi thekson se dyndjet e këtyre popujve nuk përfaqësojnë vetëm një fazë shkatërrimi, por edhe një faktor vendimtar në transformimin e Ballkanit nga Antikiteti i Vonë në Mesjetë.

Fjalë kyçe:

Dyndjet e popujve, Iliria në Antikitetin e Vonë, gotët, hunët dhe avarët, sllavët në Ballkan, Bizanti.

Hyrje

Dyndjet e popujve të ashtuquajtur “barbarë” në hapësirat ballkanike të Perandorisë Romake përbëjnë një nga proceset më të rëndësishme

historike të Antikitetit të Vonë.¹ Sipas historianit gjerman Johann Wilhelm Zinkeisen, lëvizjet e para të popujve nga veriu drejt kufijve të perandorisë mund të vërehen që në shekujt e parë të erës sonë.² Këto dyndje vinin nga rajone që nuk kishin rënë nën kontrollin e plotë të Romës dhe përfshinin popullsi të ndryshme, shpesh pak të njohura për burimet e kohës. Shkaqet e tyre mbeten në një masë të madhe të paqarta; sipas Zinkeisenit, ato mund të rindërtohen vetëm pjesërisht mbi bazën e të dhënave fragmentare dhe të traditave legjendare të ruajtura në burimet e hershme.

Faza më intensive e këtyre lëvizjeve ndodhi ndërmjet shek. IV dhe VII të erës sonë, kur kufijtë veriorë dhe lindorë të Perandorisë Romake të Lindjes u përballën me valë të njëpasnjëshme popujsh: fise gjermanike, hunë, avarë, sllavë, si edhe grupe turanike dhe protobullgare. Fillimisht, këto lëvizje kishin shpesh karakter relativisht paqësor dhe përfundonin me vendosjen e popullsisë të reja si federatë brenda territorit perandorak; me kalimin e kohës, megjithatë, ato morën gjithnjë e më shumë formën e inkursioneve dhe pushtimeve të dhunshme.

Ndër të parët që depërtuan në hapësirat ballkanike ishin gotët. Të organizuar në dy formacione “politike” – vizigotët në zonën e Danubit të Poshtëm dhe ostrogotët në rajonin e Dnjeprit të Poshtëm – ata kaluan Danubin dhe u vendosën në territoret përtej tij si federatë e perandorisë. Në fund të shek. IV, vizigotët, të udhëhequr më vonë nga Alariku, shtrinë veprimtarinë e tyre ushtarake në Traki, Maqedoni dhe në provincat ilirike, duke arritur deri në brigjet e Adriatikut.

Perandori Theodosius pranoi vendosjen e tyre në disa rajone të Ballkanit, veçanërisht në Panoni (Moesi) dhe Traki (Dacia), duke marrë në shërbim ushtarak edhe 40 000 gotë.³ Megjithatë, pakënaqësia ndaj marrëveshjeve me autoritetet perandorake çoi në një kryengritje të vizigotëve, të cilët u përhapën në një hapësirë të gjerë nga Trakia deri në Ilirik. Marrëveshja e vitit 398⁴ u njohu atyre të drejtën e vendosjes në pjesën jugperëndimore të gadishullit, ndërsa Alariku u emërua

¹ Johann Wilhelm Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands vom Anfange geschichtlicher Kunde bis auf unsere Tage*. Ersther Theil. (Leipzig: Johan Ambrosius Barth, 1832), 665 (më tej: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1).

² *Po aty*.

³ T. H. Neomario, *Geschichte der Stadt Rom*. Erster Band. Unveränderter Nachdruck der Originalausgabe von 1931 (Frankfurt: Outlook Verlag 2025), 540.

⁴ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 644.

komandant i ushtrive perandorake në Ilirik. Pak më vonë, ai u drejtua me ushtrinë e tij drejt Italisë dhe, në vitin 410, pushtoi dhe plaçkiti Romën.⁵

Në mesin e shek. V, në skenën historike u shfaqën hunët. Një pjesë e tyre depërtoi përmes Kaukazit në Azinë e Vogël, ndërsa pjesa tjetër, nën drejtimin e Atilës, kaloi Danubin dhe ndërmori fushata shkatërrimtare në Ballkan. Vetëm pas vdekjes së Atilës, në vitin 453, u dobësua rreziku hun për perandorinë. Pas tyre, në territorin bizantin depërtuan ostrogotët, të cilët, nën udhëheqjen e Teodorikut, arritën deri në qytetin e Durrësit dhe e pushtuan atë. Synimi i tyre ishte të vendoseshin në bregdetin e ngrohtë të Shqipërisë së sotme,⁶ por ky plan nuk u realizua. Pas luftërash të gjata, Perandori Zeno u lejoi atyre vendbanime në Dacia Ripensis dhe në Misinë e Poshtme (Moesia Inferior), ku Teodoriku i Madh, si mbret i gotëve dhe komandant romak, vendosi selinë e tij në Novae (Svištov) në vitin 483.⁷

Nga fundi i shek. V kufijtë e Perandorisë Bizantine u kapërcyen gjithashtu nga grupe me origjinë turaniko-bullgare, ndërsa në fillim të shek. VI fiset sllave – të njohura në burime si skllavenë dhe antë – kaluan Danubin dhe përshkuan provincat e Ilirikut dhe të Trakës. Gjatë sundimit të Perandorit Justiniani I (527-565), këto inkursione u bënë veçanërisht të shpeshta dhe të dhunshme. Burimet bashkëkohore, veçanërisht historiani Prokopi i Cezaresë, përshkruajnë një periudhë të gjatë trazirash, në të cilën Iliriku, Trakia dhe Helada u goditën pothuajse çdo vit nga ekspeditat plaçkitëse të hunëve, sllavëve dhe antëve.⁸ Sipas tij, hapësirat që shtriheshin nga Gjiri Jon deri pranë Kostandinopojës u shkatërruan vazhdimisht, duke sjellë pasoja të rënda për popullsitë vendase.

Megjithatë, këto sulme nuk mbetën gjithmonë pa kundërpërgjigje. Në shumë raste, forcat perandorake arritën të zmbropsnin një pjesë të madhe të forcave pushtuese, veçanërisht gjatë rrethimeve dhe betejave fatkeqe, ku shumë prej tyre gjetën shkatërrimin; sepse jo vetëm romakët,

⁵ Më pas ai u nis në drejtim të Italisë së Jugut, me qëllim që përmes Sicilisë të kalonte në Afrikë, por gjatë rrugës vdiq dhe u varros në Cozencë (Busento), Karl Ploetz, *Auszug aus der Alten Mitlerer und Neueren Geschichte*. 12. Verbesserte Auflage (Berlin: A. G. Ploetz, 1898), 158.

⁶ Constantin Jireček, *Geschichte der Serben. Erster Band*. (Bis 1371). (Gotha: 1911), 51.

⁷ Po aty.

⁸ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 665.

por pothuajse të gjithë barbarët duhej ta ndienin etjen për gjak të Justinianit.⁹

Justiniani ndërmoi gjithashtu një politikë të fortë ushtarake dhe diplomatike për të mbrojtur kufijtë dhe për të frenuar depërtimin e vazhdueshëm të këtyre popujve.

Në vitin 548, bullgarët rifilluan inkursionet në drejtim të Ilirikut dhe të Greqisë, duke arritur deri në Durrës dhe në Korinth. Në mesin e shek. VI, edhe ostrogotët, nën drejtimin e Totilës, kryen plaçkitje të mëdha në Epirin e Vjetër, në hapësirën që shtrihej nga Saranda deri në Nikopojë. Që nga vitet gjashtëdhjetë të këtij shekulli, dyndjet sllave u bënë më të organizuara dhe më të shpeshta, duke u përhapur gradualisht në pothuajse të gjithë Ballkanin. Sllavët u shtrinë nga brigjet e Adriatikut në perëndim deri në rajonet e Detit të Zi në lindje, ndërsa në jug arritën deri në Thesali dhe në Peloponez.

Sulmet e ashpra të viteve 610-626 sollën shkretimin e shumë krahinave, veçanërisht të Epirit dhe të një pjese të madhe të Ilirikut. Në dekadat pasuese, rreth viteve 630-640, në Ballkanin Verior u vendosën edhe serbët dhe kroatët, duke shënuar fillimin e formimit të organizimeve të para shtetërore sllave në rajon.¹⁰ Sllavët u vendosën gjithashtu në Dalmaci që në vitin 614, ndërsa protobullgarët, në vitet shtatëdhjetë të shek. VII, u vendosën në hapësirën midis Danubit dhe maleve të Ballkanit, ku hodhën themelet e shtetit bullgar.¹¹

Si pasojë e këtyre lëvizjeve të mëdha demografike dhe politike, përbërja etnike e Ballkanit pësoi ndryshime të thella. Në shumë rajone të gadishullit, popullsitë e vjetra trake dhe ilire u zëvendësuan ose u asimiluan gradualisht nga popullsia sllave. Kolonizimi sllav ishte veçanërisht i thellë në territoret e sotme të Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës, Serbisë, Maqedonisë dhe Dalmacisë. Në viset jugore të Ilirisë, megjithatë – në Dardani, Prevalitani, Epirin e Ri dhe Epirin e Vjetër – popullsia autoktone arriti, në një masë të konsiderueshme, të ruante vazhdimësinë e saj etnike, duke i bërë ballë presionit të vazhdueshëm të inkursioneve dhe kolonizimit sllav.

Në artikullin që paraqesim synohet të ofrohet një pasqyrë më e gjerë e dyndjeve të popujve në hapësirën ballkanike gjatë Antikitetit të

⁹ *Po aty*; shih edhe: Procop Historia Arcana C 18, edt Paris, 54.

¹⁰ Petrika Thëngjilli, “Dyndjet e mëdha (barbare) të popujve,” në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I: A-Gj (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 563.

¹¹ *Po aty*.

Vonë. Nga pikëpamja metodologjike, ky studim vë në dukje edhe një çështje tjetër me rëndësi: historiografia shqiptare nuk e ka trajtuar gjithmonë me thellësinë e duhur këtë periudhë.¹² Shpesh, dyndjet përmenden si një sfond i përgjithshëm për të shpjeguar kalimin nga Antikiteti në Mesjetë, por jo si një objekt më vete analize, me kronologjinë, dallimet tipologjike dhe pasojat e veçanta që mbart secila valë dyndjeje. Pikërisht për këtë arsye, është e nevojshme që kjo periudhë të rishqyrtohet jo vetëm në bazë të burimeve narrative bizantine dhe latine, por edhe përmes një dialogu më të ngushtë me topografinë historike, historinë kishtarë, studimet mbi etnogjenezën dhe arkeologjinë.

Inkursionet e gotëve (ostrogotëve dhe vizigotëve)

Qysh gjatë sundimit të Perandorit romak Marcus Aurelius Antoninus Caracalla (195-217), burimet përmendin një nga dyndjet e para të rëndësishme të gotëve në hapësirat e Danubit. Në vitin 215, grupe gotësh, të përziera me fise të tjera gjermanike, sulmuan fillimisht provincën e Dakisë. Pas disa përplasjesh të suksesshme me forcat romake, ata depërtuan më tej drejt jugut, duke plaçkitur terriore të gjera dhe duke dobësuar çdo përpjekje rezistence nga administrata perandorake.¹³

Këto sulme nuk mbetën të izoluara. Në vitet pasuese, gotët i përsëritën inkursionet kundër Dakisë dhe provincave të tjera romake, nën drejtimin e një figure që burimet e përmendin si Mbretëresha Ostrogotha. Sulme të ngjashme u shfaqën edhe gjatë viteve të fundit të sundimit të Perandorit Decius, kur terriore të gjera të Trakisë, Misisë dhe rajoneve të tjera ballkanike u shkatërruan nga ekspedita plaçkitëse.¹⁴ Në këtë kontekst përmendet edhe një ushtri e madhe prej rreth 70 000 luftëtarësh, e përbërë nga popuj të ndryshëm gjermanikë dhe sarmatë, e udhëhequr nga prijësi got Kniva, e cila ndërmori një ofensivë të gjerë kundër Trakisë dhe krahinave përreth.¹⁵ Për të ndalur përparimin e tyre, Perandori Decius

¹² Shih: Kreu XII: “Dyndjet e popujve,” në Neritan Ceka, *Ilirët* (Tiranë: Ilar, 2001), 271-278.

¹³ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 578.

¹⁴ *Po aty*, 579.

¹⁵ Në lidhje me sarmatët, atdheu i të cilëve duhet të kërkohet diku ndërmjet lumenjve Don dhe Vollgë, nuk dihet se çfarë gjuhe flisnin. Ata ishin një popull plaçkitës, i

urdhëroi prokonsullin e Akajës, Mesalla, dhe tribunin Klaudius të mbronin Termopilet dhe Peloponezin me një ushtri të konsiderueshme. Në këtë forcë ushtarake bënte pjesë edhe një njësi prej rreth dyqind ushtarësh nga Dardania.¹⁶ Megjithatë, lufta kundër gotëve rezultoi fatale për vetë perandorin: Decius u vra në betejën e Abritusit, në Misinë e Poshtme, duke u bërë kështu perandori i parë romak që humbi jetën në një përballje të drejtpërdrejtë me gotët.¹⁷

Gjatë sundimit të Perandorit Gallus (deri në vitin 253), një valë tjetër dyndjesh goditi Ballkanin. Krahinat e Ilirisë, Misisë dhe Trakisë u plaçkitën nga grupe të ndryshme barbarësh, të cilët burimet romake i përmendin shpesh me emërtimin kolektiv “Skytë”; megjithatë, në këtë emërtim përfshiheshin popuj të ndryshëm si gotët, boranët, karpët dhe herulët.¹⁸ Sulmet e këtyre grupeve ndaj territoreve ilire, maqedonase dhe rajoneve të tjera të gadishullit vazhduan pothuajse çdo vit gjatë gjysmës së dytë të shek. III.¹⁹

Një valë tjetër inkursionesh ndodhi pas luftës së Perandorit Valerian kundër Mbretit pers Shapur I, gjatë së cilës Valeriani u kap rob. Ndërkohë që Gallienusi, i cili qeveriste i vetëm, ishte i angazhuar në luftimet kundër gjermanëve në kufirin e Rinit, fise të ndryshme skyte u bashkuan dhe filluan një sërë sulmesh kundër provincave romake, si në lindje ashtu edhe në perëndim. Një ushtri e madhe u drejtua në Itali, ndërsa një tjetër marshoi drejt Ilirisë dhe disa provincave të Azisë së Vogël.²⁰

Sulmet gotike vazhduan edhe në dekadat pasuese. Rreth vitit 270 dokumentohen inkursione në Epir, nga ku gotët u përhapën në Beoti, Akarnani dhe Thesali. Për t’i përballuar këto kërcënime, Perandori Gallienus hyri në Iliri me një ushtri të fuqishme dhe arriti të shkatërronte

kishin fytyrat me tatuazhe dhe u shkaktonin romakëve vazhdimisht shqetësime. Jireček, *Geschichte der Serben*, I, 32.

¹⁶ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 580.

¹⁷ Jireček, *Geschichte der Serben* I, 47.

¹⁸ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 581.

¹⁹ Zosimus, *Historia Nova*, I, 31. 1, cituar sipas: *po aty*, 583. Historiani grek, Zosimus (Ζώσιμος), i identifikon këta popuj si boranë, gotë, karpënë, urugundë, por mjaftohet edhe me shprehjen e përgjithshme: “τῶν δὲ ταῦτα περὶ τὸν Ἰστρον οἰκούντα,” [tón de taýta peri ton Ístron oikóunta] d.m.th., “ata që banojnë rreth Istrit (Danubit)”.

²⁰ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 581.

një pjesë të madhe të forcave grabitëse, duke i detyruar ato të tërhiqeshin përmes Ilirisë dhe Trakisë drejt territoreve të tyre veriore.²¹

Luftimet kundër barbarëve vazhduan edhe pasi Gallienusi u detyrua të kthehej në Romë për shkak të rebelimit të komandantit të kalorësisë romake, Aureolus. Komanda e ushtrisë romake në Iliri iu besua Marcianusit, i cili vazhdoi luftën kundër skytëve dhe arriti të çlironte një pjesë të provincave romake nga këto inkursione, duke ndërmarrë madje edhe sulme kundër gotëve në territoret e tyre.²²

Në vitin 267, gotët ndërmorën një tjetër sulm të madh kundër Selanikut dhe, me flotat e tyre detare, plaçkitën qytetet e Greqisë, pasuritë e mëdha të cilave ushtronin një tërheqje të veçantë për popujt e Veriut. Kjo ofensivë u ndal vetëm kur Perandori Claudius II u shkaktoi një humbje të rëndë pranë Naissusit (Nishit) në vitin 269.²³

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e provincave ballkanike luajti edhe Aureliani, i cili fillimisht si komandant i ushtrive romake në Iliri dhe Traki, e më pas si perandor, arriti t'i zmbrapste gotët dhe t'i dëbonte ata përtej lumit Ister (Danubit).²⁴

Sipas historianit Johann Wilhelm Zinkeisen, një fazë e re e lëvizjeve të popujve “barbarë” filloi në vitin 376, kur në Europë u shfaqën për herë të parë hunët. Të shtyrë nga presioni i tyre, gotët u përzier, në rrethana të ndryshme, me alanët²⁵ dhe me grupe të tjera barbare, duke ndërmarrë një sërë sulmesh plaçkitëse kundër provincave romake të Ballkanit.²⁶

Fundi i shek. IV solli ndryshime të thella në ekuilibrin e rajonit. Nën presionin e hunëve, gotët kërkuan strehim brenda perandorisë dhe u vendosën në jug të Danubit në bazë të një marrëveshjeje me autoritetet romake. Megjithatë, shkelja e këtyre marrëveshjeve dhe keqmenaxhimi i furnizimeve romake çuan në një konflikt të hapur që kulmoi me betejën e Adrianopojës trake (ose Hadrianopolit) në vitin 378, një nga disfatat më

²¹ Trebellius Pollio Flavius Vopiscus, *Historiae Augustae Gallieni duo*. vol. III, 13, p. 44: “Gallienus interea, vix excitatus publicis malis, Gothis vagantibus per Illyricum occurrit; et fortuito plurimos interemit, quo comperto, Scythae facta carragine per montem Gessacem fugere sunt conati.” cituar sipas: po aty, 589.

²² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 590.

²³ Jireček, *Geschichte der Serben* I, 47.

²⁴ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 596.

²⁵ Alanët ishin një popull nomad, të cilët në rasishten e vjetër quheshin *jasi* dhe sipas Jireček-ut janë paraardhësit e osëtëve të sotëm. Jireček, *Geschichte der Serben* I, 32.

²⁶ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 627-628.

të rënda të ushtrisë romake.²⁷ Panonia, së bashku me pothuajse të gjithë Ilirinë e Veriut, u bë pre e sulmeve të hordhive barbare. Shën Hieronimi, me origjinë nga Stridoni ilir në Dalmaci, dëshmonte në vitin 380 se atdheu i tij ishte shkatërruar.²⁸ Pikërisht në këtë kontekst, Skodra duket se mori një peshë të veçantë, edhe për shkak të pozicionit të saj të mbrojtur nga natyra, çka mund të ketë ndikuar në zgjedhjen e këtij qyteti si seli kryepeshkvnore. Kryepeshkvi i saj, Bassius,²⁹ përmendet në vitin 377 në një letër të Papës Siricius drejtuar ipeshkvijve të Ilirikut.



Fig. 1: Dyndjet e ostrogotëve (gotëve lindorë) gjatë shek. V pas Kr. Burimi: M. Knaut/ D. Quast, *Die Völkerwanderung*, 39.

Heladën dhe Peloponezin. Alariku ushtroi autoritetin e tij në këtë rajon për disa vjet, duke e shfrytëzuar atë si bazë për fushatat e mëvonshme drejt Perëndimit. Para se të marshonte drejt Italisë dhe Romës, ai e rëndoi më tej provincën e stërmunduar të Ilirisë me tribute të rënda dhe plaçkitje të vazhdueshme. Një përshkrim të gjallë të këtyre ngjarjeve jep edhe poeti dhe historiani romak Klaudian,³¹ i cili në veprën e tij *De Bello Gothico* [Mbi luftën gotike] përshkruan veprimtarinë e Alarikut dhe

Në këtë periudhë, gotët filluan të fitonin edhe pushtet politik brenda hapësirës së Ilirisë. Një shembull domethënës është Alariku, i cili, pas inkursioneve shkatërruese në Epir, arriti të emërohej komandant i përgjithshëm i provincës së Ilirikut nga Perandori Arcadius në vitin 398.³⁰ Në atë kohë, provinca e Ilirikut (gubernia Illyricum) përfshinte edhe

²⁷ Matthias Knaut & Dieter Quast, *Die Völkerwanderung. Europa zwischen Antike und Mittelalter*. Herausgegeben von Mathias Knaut, und Dieter Quast (Stuttgart: Theiss, 2005) 38.

²⁸ Ceka, *Ilirët*, 256.

²⁹ *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 6, f.1 (Cituar si: AAlb I. nr.)

³⁰ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 644.

³¹ *Po aty*, 645.

shkatërrimet që ushtria e tij shkakttoi në provincat e Ilirisë, me këto vargje:

“Por tani ilirët, pasi m’u dorëzuan të drejtat e pushtetit dhe më bënë prijësin e tyre, aq shumë heshta, aq shumë shpata, aq shumë përkrenare, me djersë të bollshme të thrakasve, u përgatitën dhe taksën e hekurit e kthyen për përdorimin tim; qytetet romake i detyrova, me urdhër të ligjshëm. Kështu më përkrahin fatet: ata vetë, të cilët çdo vit i shkatërroja, tani janë caktuar të më shërbejnë dhe, duke u ankuar, do të më japin armë që do t’u sjellin dëm atyre vetë.”³²

Gjatë kësaj periudhe duket se u shkatërrua nga gotët, më saktësisht nga vizigotët, edhe qyteti i Dokleas, i cili më parë kishte qenë qendra administrative e provincës Prevalitana. Disa studiues mendojnë se shkatërrimi i tij mund të lidhet drejtpërdrejt me inkursionet e Alarikut, megjithëse qyteti duket se u rigjallërua më vonë, sidomos gjatë reformave dhe rindërtimeve të ndërmarra në kohën e Perandorit Justinian.³³

Në të njëjtën kohë, në provincat e Trakisë, Maqedonisë, Misisë, Ilirisë dhe Epirit Verior filloi të formohej një realitet i ri shoqëror dhe demografik. Pas shkatërrimeve të shkaktuara nga inkursionet e barbarëve, një pjesë e territoreve u ripopullua nga kolonë të rinj me prejardhje barbare, të cilët u vendosën në këto hapësira.³⁴ Popullsia vendase, së bashku me mbetjet e banorëve të vjetër, u përqendrua kryesisht në zonat bregdetare dhe në qytetet portuale, ndërsa shumë vendbanime në brendësi të vendit kishin mbetur të braktisura. Ndër krahinat më të prekura nga këto zhvillime ishte Akaia. Si dëshmi e rënies së ndjeshme të popullsisë dhe e dobësimit të kapaciteteve prodhuese në këtë provincë, Zinkeiseni përmend dy urdhëresa të Perandorit Theodosius II. Njëra prej tyre flet për numrin e madh të pronave të braktisura në Akaia, ndërsa tjetra

³² Claud, de bell. Get. 535-543: “*At nun Illyrici postquam mihi tradita jura, Meque suum fecere ducem, tot tela, tot enses, Tot galeas, multo Thracum sudore parari Inque meos usus vectigal vertere ferri Oppida legitimo jussu Romana coegi. Sic me fata foveant, ipsi, quos omnibus annis Vastabam, servire dati, nocitura gementes Arma dabunt.*” Cituar sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 646.

³³ *On the Roman Town of Doclea in Montenegro* (Westminster: Nichols and Sons, 1896), 19.

³⁴ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 647.

parashikonte një lehtësim fiskal për banorët e kësaj province, duke u falur dy të tretat e tributit që ishte caktuar për Ilirikun Lindor.³⁵




Fig. 2: Dyndjet e vizigotëve (gotëve perëndimorë) gjatë shek. IV-V pas Kr. Burimi: M. Knaut/ D. Quast, *Die Völkerwanderung*, 38.

Në fillim të shek. V, gjatë sundimit të Perandorit Honorius (393-423), përmendet edhe një konflikt ndërmjet gotëve dhe fisit ilir të taulantëve, të cilët në këtë rast shfaqen për herë të fundit në burimet historike. Bëhet fjalë për një kryengritje të taulantëve kundër autoritetit perandorak, e cila u shtyp me ndihmën e trupave mercenare gotike.³⁶

Në dekadat që pasuan, zgjerimi i pushtetit hunik e shndërroi rajonin e Danubit në një zonë trazirash të vazhdueshme. Pas rënies së “Perandorisë Hune” në vitin 454, gepidët dhe grupe të ndryshme gotike arritën të forconin pozitën e tyre, si në veri të kufijve romakë, ashtu edhe brenda territoreve të perandorisë.³⁷

Në këtë kontekst, gotët krijuan edhe koloni të qëndrueshme në disa zona të Ballkanit. Sipas Zinkeisenit, një koloni e tillë mund të ketë ekzistuar edhe në Durrës. Ai përmend një dëshmi sipas së cilës, gjatë tërheqjes së Alarikut, në Epir mbetën koloni gotike të vendosura në mënyrë të përhershme, sidomos në pjesën veriore të tij, në rrethinat e Dyrrahut. Kjo prani vërtetohet edhe nga zhvillimet e mëvonshme të lidhura me veprimtarinë e ostrogotëve kundër Perandorisë Bizantine.

³⁵ Codex Theodosianus, lib. X, tit. VIII, *De bonis vacantibus*, ligji 5, viti 435; *po aty*, lib. XI, tit. I, *De annonis et tributis*, ligji 53. Pasi prefektit pretorian të Ilirikut iu urdhërua të mblidhte nga provincat e tij shumën e tributit që ato kishin premtuar, në dokument thuhet: “Akaiasitt (Achivi), të cilët kanë deklaruar se nuk mund të kontribuojnë më shumë se një të tretën, le të paguajnë atë shumë për të cilën ata vetë pohojnë pa dyshim se janë në gjendje ta përballojnë.” (“*Achivi, qui protestati sunt nihil a se ultra tertiam partem posse conferri, illud exsolvant, ad quod se indubitanter fore idoneos pollicentur.*”), *po aty*, ref. 1.

³⁶ Neritan Ceka, “Taulantët,” në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III: N-ZH (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009), 2663.

³⁷ Knaut, Quast, *Die Völkerwanderung*, 38.

Një episod domethënës lidhet me veprimtarinë e Teoderikut të Madh. Sipas historianit Malchus, kur Teoderiku, nën sundimin e Perandorit Zenon, në vitin 479 kërkoi të merrte në zotërim Epidamnin dhe Epirin, ai u lidh me një person të fisit të tij, të quajtur Sidimund, i cili banonte në Epir, pranë Epidamnit, zotëronte një pronë të pasur dhe përfitonte subvencione nga perandori.³⁸ Para se të vendosej në Durrës për të kaluar dimrin, Teoderiku kishte ndërmarrë një fushatë shkatërruese në Ballkan, duke rrënuar qytete si Stobi, Heraklea (në afërsi të Manastirit të sotëm) dhe shumë lokalitete të tjera, duke arritur deri pranë Selanikut. Përparimi i tij drejt Greqisë u ndal nga gjenerali perandorak Sabinianus, i cili arriti ta pengonte më tepër përmes manovrave diplomatike dhe strategjike sesa me forcën e armëve.³⁹ Pas vdekjes së Sabinianusit, Perandori Zenon u detyrua të bënte një marrëveshje me Teoderikun, duke u dhënë ostrogotëve një pjesë të provincës së Dakisë, gjë që i siguroi përkohësisht perandorisë një stabilitet të brishtë në rajon.⁴⁰

Në lidhje me këto fushata të ostrogotëve në territoret ilire, Zinkeiseni, duke u mbështetur te historiani romak lindor (me origjinë gotë) i shek. VI, Jordanes*, sjell edhe të dhëna për sulmet kundër Nishit⁴¹ dhe disa lokaliteteve të tjera të Ilirikut, të cilat më parë konsideroheshin të pakalueshme, por që në këtë periudhë u depërtuan për herë të parë nga ushtritë gotike. Një element që ka shkaktuar shpesh konfuzion në historiografi është fakti se edhe prijësi i këtyre gotëve quhej Teoderik, gjë që ka sjellë ngatërime si tek autorët e vjetër, ashtu edhe te studiuesit e mëvonshëm.⁴²

Përballë këtij kërcënimi të vazhdueshëm, autoritetet perandorake ndërmorën edhe ndërtimin e një sistemi të ri fortifikimesh në Iliri. Ndër

³⁸ *Corpus Scriptorum Historiae Byzantinae*, vol. I, 248: “ἐκ τῆς κατ’ Ἐπίδαμνον Ἡπειρου χώραν τε νεμόμενον καὶ εὐδαίμονα κλήρον, καὶ παρὰ βασιλέως δεχόμενον συντάξεις,” [ek tīs kat Epídamnon Ípeírou chóran te nemómenon kai eudaímona klíron, kai para vasiléōs dechómenon syntáxeis] sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 651.

³⁹ *Po aty*, 653-654.

⁴⁰ *Po aty*, 655.

* *Jornandes* ose *Jordanes* filloi të shkruante një histori të gotëve në vitin 551.

⁴¹ Jordanes, “Origin and the Deeds of the Goths,” në *The Gothic History of Jordanes*, in English Version with an Introduction and a Commentary, by Charles Christopher Mierow (Princeton: Princeton University Press, 1915), 134.

⁴² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 652, duke u referuar te Jornandes, i cili shkruan: “nonnullaque loca Illyrici inaccessabilia sibi tunc primum pervia faciunt”.

kështjellat që lidhen me këtë periudhë përmenden Anagustum (Onogošti ose Nikshiqi i sotëm) dhe një fortifikim i njohur në traditën lokale si “Muri i Vukës së Marrë” (Žit Vuka Magnitoga) në territorin e sotëm të Malit të Zi.⁴³ Në vitin 535, Perandori Justinian arriti të dëbonte ostrogotët nga territoret ilire.⁴⁴ Ata u detyruan të linin Prevalin dhe Shkodrën, kryeqytetin e kësaj province, e cila, sipas arkeologut N. Ceka, duhet të ketë rënë më herët në duart e gotëve. Qyteti u rifortifikua, dhe për këtë dëshmon edhe prania e një periudhe të dytë ndërtimi në murin rrethues të Shkodrës.⁴⁵ Në vijim të kësaj politike ushtarake, gjatë luftërave gotike u ndërmor edhe një ekspeditë për të rimarrë Salonën, e cila ishte pushtuar nga gotët nën drejtimin e Grippës. Kjo fushatë u organizua nga gjenerali Konstancian, i cili mbërriti në Durrës (Epidamnus) për të përgatitur operacionin ushtarak. Pasi qëndroi për një kohë në qytet dhe organizoi trupat, ai u drejtua drejt Salonës, duke zbarkuar në Epidaurum. Qyteti u rimor nga forcat perandorake në vitin 537, një ngjarje që përshkruhet edhe nga Prokopi i Cezaresë.⁴⁶

Megjithatë, konfliktet nuk përfunduan me kaq. Në vitet 551-552, ostrogotët ndërmorën sulme të reja kundër territoreve të Epirit. Mbreti i tyre, Totila, kishte përgatitur një flotë të madhe prej rreth 300 anijesh, të cilat i dërgoi drejt brigjeve perëndimore të Akajës me urdhrin për të shkatërruar çdo vendbanim që do të hasnin.⁴⁷ Kjo flotë shkatërroi Sarandën (Santi Quaranta)⁴⁸ dhe më pas plaçkiti rajonin përreth Dodonës, si edhe qytetet Nikopojë dhe Anhizos, duke lënë pas një gjurmë të re shkatërrimi në këto hapësira.⁴⁹

⁴³ Milan Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët*, përktheu nga kroatishtja Hasan Çipuri (Tiranë: Toena, 2004), 9.

⁴⁴ Fulvio Cordignano, *In Albania* (Roma: Società Nazionale di Dante Aleghieri, 1940), 73.

⁴⁵ Ceka, *Ilirët*, 256.

⁴⁶ “Delle Istorie di Procopio di Cesarea,” Seconda Tetrare. La Guerra Gotica. Libro 1, 7, në *Fonti per la storia d'Italia. Pubblicate dall'Istituto Storico Italiano. Scrittori – Secoli VI* (Roma: Istituto di Storia 1895), 51.

⁴⁷ Procopius, *De Bello Gothico* IV, 25, sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 676.

⁴⁸ Cordignano, *In Albania*, 73.

⁴⁹ Procop, *De Bello Gothico* IV, 25, sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 676.

Inkursionet e vandalëve

Me sa duket, territoret ilire u prekën gjithashtu nga inkursionet e vandalëve. Ky popull barbar me prejardhje gjermanike ndërmori një sërë ekspeditash plaçkitëse nën udhëheqjen e Mbretit të tyre, Genserik. Burimet i përshkruajnë vandalët edhe si detarë dhe piratë të aftë, të cilët shfrytëzonin me mjeshtëri hapësirat detare për ndërmarrje grabitëse.

Ata ndërmorën sulme kundër Perandorisë Bizantine rreth vitit 466, përpara se në Ballkan të fillonin inkursionet e ostrogotëve nën udhëheqjen e Teodomirit dhe më pas të Teoderikut. Fushatat e këtyre të fundit zgjatën afro dy dekada, nga mësymjet e Teodomirit në Misi në vitin 473, deri te pushtimi i Italisë nga Teoderiku në vitin 493.⁵⁰ Teoderiku vdiq gjatë udhëtimit që po bënte për t’u kthyer sërish në Iliri. Sipas kronistit romak me origjinë ilire, Marcellinus Comes, ai gjeti vdekjen ndërsa përparonte mes qerreve të lëvizshme të njerëzve të tij, pasi “u shpua aksidentalisht për vdekje nga maja e një heshte të shtrirë mbi një karrocë, si pasojë e shtytjes së kalit të tij të trembur, dhe kështu vdiq”.⁵¹

Vandalët ishin ndër popujt e parë barbarë që, duke u larguar nga hapësira europiane dhe në aleancë me alanët, u drejtuan nga jugu dhe depërtuan në Afrikën e Veriut, ku themeluan edhe një mbretëri të tyre. Në vitin 475, Genseriku ndërmori një tjetër fushatë në Ballkan, duke sulmuar Epirin e Jugut (Epirus Vetus) dhe duke pushtuar qytetin e Nikopojës (Nikopolis).⁵²

Megjithatë, dominimi vandal nuk do të zgjaste gjatë. Në mesin e shek. VI, Perandori Justiniani I arriti, përmes fushatave të gjeneralëve të tij, të shkatërronte mbretërinë vandale në Afrikën e Veriut. Në vijim të kësaj politike restauruese, Perandoria Bizantine arriti gjithashtu të nënshtronte me radhë mbretërinë ostrogote në Itali dhe atë vizigote në

⁵⁰ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 655.

⁵¹ Marcellini V. C., *Chronicon: Placidi solius IIII (481), 1*: “*Porro in Illyricum properans dum inter suorum mouentia plaustra progreditur, iacentis super carpentum teli acumine et pauescentis equi sui impulsione fixus transuerberatusque interiit,*” sipas Theodor Mommsen, *Chronica minora saec. IV. V. VI. VII.* Editit Theodor Mommsen. Volumen II. Accedunt Tabulae duae. (Berolini Apud Weidmannos MDCCCXCIV), 92.

⁵² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 658.

Spanjë, si dhe të rimerrte Dalmacinë, e cila ishte pushtuar më parë nga gotët.⁵³

Inkursionet e të ashtuquajturve bullgarë (apo skytë)

Në fund të shek. V, gjatë sundimit të Perandorit Anastasius (491-518), i lindur rreth vitit 430 në Dyrrachium, në territoret e Perandorisë Bizantine u shfaq një tjetër popull barbar që vinte nga hapësirat veriore përtej Danubit. Ky popull njihej me emrin Bulga (Βούλγα në burimet bizantine), një emërtim që lidhej me vendin e prejardhjes së tyre, nga rajonet e Vollgës, midis Donit dhe maleve Urale. Sipas traditave të përhapura në burimet mesjetare, ata konsideroheshin pjesë e popujve skytë, ndërsa Zinkeiseni i përcakton si bullgarë. Këto grupe depërtuan në territoret perandorake së bashku me familjet e tyre, me gra dhe fëmijë, duke u vendosur në fushat pjellore të Jugut.⁵⁴ Burimet e përshkruajnë si një popull të egër, luftarak dhe të papërpunuar, që jetesën e siguronte kryesisht përmes plaçkitjeve dhe grabitjeve në territoret ku depërtonte.

Fillimisht Kostandinopoja nuk reagoi me shqetësim të madh ndaj ardhjes së tyre dhe autoritetet perandorake i toleruan për një kohë inkursionet e tyre grabitëse. Vetëm kur bullgarët depërtuan thellë në territorin e perandorisë, u futën në Iliri dhe filluan të afroheshin edhe drejt kryeqytetit, administrata perandorake vendosi të ndërmerre masa ushtarake. Në këtë kontekst, kryekomandanti i forcave perandorake Aristos mbledhi në Ilirik një ushtri prej rreth 15 000 ushtarësh, me synimin për të ndalur marshimin e mëtejshëm të bullgarëve. Sipas kronikës së Marcellinusit, kjo ushtri përbëhej kryesisht nga trupa të rekrutuara në provincat ilire. Forcat romake u drejtuan drejt Trakisë, ku barbarët ishin vendosur ndërkohë.⁵⁵

Megjithatë, sipas kronistit, marshimi i ushtrisë romake u zhvillua me një ngadalësi të madhe dhe pa disiplinën e nevojshme. Pas tyre

⁵³ Jireček, *Geschichte der Serben I*, 52.

⁵⁴ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands I*, 658.

⁵⁵ Marcellini V. C., *Chronicon*: (499) VII. Ioannis Gibbi solius 1: *Aristus Illyricianae ductor militiae cum quindecim milibus armatorum et cum quingentis uiginti plaustreis armis ad proeliandum necessariis oneratis contra Bulgares Thraciam deuastantes profectus est. Bellum iuxta Tzurtam fluium consertum, ubi plus quam quattuor millia nostrorum aut in fuga aut in praecipitio ripae fluminis interempta sunt. Ibique Illyriciana uirtus militum periit, Nicostrato, Innocentio, Tanco et Aquilino comitibus interfectis*. Cituar sipas Mommsen, *Chronica minora*, II, 95.

ndiqeshin rreth 520 karroca të ngarkuara me armatime, gjë që e bënte edhe më të ngadaltë lëvizjen e trupave. Përpara se të ndodhte një përplasje e mirëfilltë ndërmjet dy ushtrive, bullgarët ndërmorën një sulm të befasishtë kundër kohortave romake, të cilat nuk ishin të përgatitura për betejë.

Përplasia ndodhi pranë brigjeve të rrëpira të një lumi të vogël në Traki, të cilin Marcellinusi e përmend me emrin Zurta. Në sulmin e parë të barbarëve, trupat romake u shpërndanë dhe u tërhoqën në panik. Pjesa më e madhe mundi të shpëtonte; megjithatë, mbi 4 000 prej tyre u vranë gjatë tërheqjes ose ranë nga brigjet e thepisura të lumit dhe u mbytën në ujë. Për humbjet e barbarëve nuk jepen të dhëna të sakta. Kronisti e përshkruan ngjarjen me ton ironik, duke shkruar se “këtu pra perëndoi edhe trimëria e luftëtarëve ilirë”, ndërsa tre prej komandantëve më të njohur – Nikostrati, Inoncenci dhe Aquilini – humbën jetën në këtë katastrofë.

Sipas Zinkeisenit, kjo ishte përpjekja e vetme serioze e autoriteteve perandorake për t’i zmbrazur bullgarët me forcën e armëve. Në vend që të organizohej një kundërofensivë e re, në Kostandinopojë filluan të shkruheshin lloj-lloj historish për këtë disfatë të turpshme, shkaku i së cilës, sipas këtyre rrëfimeve, u atribuohet *aftësive të barbarëve për të bërë magji*; sikur gjatë kësaj ngjarjeje paskësh pasur edhe gjithfarëlloj shenjash ogurzeza që paralajmëronin përfundimin e kobshëm: shfaqja e kometave dhe britmat e çjerra të korbave që kishin shoqëruar vazhdimisht ushtrinë, si dhe boritë e luftës, të cilat nuk jepnin tingullin e zakonshëm, por një zhurmë të shurdhët.⁵⁶

Pas kësaj disfate, Trakia dhe Maqedonia u përfshinë nga inkursionet e vazhdueshme të këtyre barbarëve, të cilët plaçkitën zonat fushore deri në afërsi të portave të Kostandinopojës. Përballë këtij kërcënimi, Perandori Anastasius u përpoq të siguronte mbrojtjen e kryeqytetit duke ndërtuar një mur të fuqishëm mbrojtës midis Derkonit dhe Pontus Euxinus (Detit të Zi), si dhe duke vendosur aty garnizone të forta ushtarake.⁵⁷

Megjithatë, bullgarët nuk e panë të nevojshme të përballeshin drejtpërdrejt me këtë sistem mbrojtës. Ata preferuan të sulmonin provincat më pak të mbrojtura në perëndim dhe në jug, të cilat ofronin

⁵⁶ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 660.

⁵⁷ *Po aty*, 661.

mundësi më të lehta për plaçkitje. Inkursionet e tyre arritën edhe në Epirin e Ri, në territoret e sotme shqiptare, ku që nga koha e Teoderikut kishin ekzistuar edhe disa koloni gotike. Këto sulme grabitëse të bullgarëve kulmuan në vitin 517, që ishte edhe viti i fundit i sundimit të Perandorit Anastasius⁵⁸ (†518), me origjinë nga Durrësi. Në krahinat e Ilirisë, barbarët plaçkitën dhe shkatërruan shumë vendbanime dhe morën një numër të madh skllevërish, por shpesh nuk i vrisnin banorët vendas, sepse i konsideronin si një burim të ardhurash përmes shpërblimeve dhe tregtisë së robërve. Për të shpëtuar një pjesë të popullsisë së zënë rob, Perandori Anastasius i dërgoi prefektit të Ilirikut një shumë të madhe parash – rreth një mijë libra floriri – me qëllim që të bliheshin sa më shumë pengje, qytetarë të perandorisë. Sipas Marcellinusit, ata që nuk u blenë u tërhoqën zvarrë nga kasollet dhe banesat e tyre ku mbaheshin të mbyllur dhe u therën e u copëtuan pa mëshirë para mureve të qyteteve.⁵⁹

Në këtë periudhë, Iliria duket se kishte mbetur pothuajse pa mbrojtje ushtarake. Nuk përmendet më prania e legjioneve që mund të ndalonin përparimin e barbarëve. Edhe gjatë sundimit të Perandorit Justin I (518-527), me origjinë ilire (i lindur në Bedariana të Nishit) – të cilin Zinkeiseni e konsideron me prejardhje barbare⁶⁰ – perandoria vazhdoi të përballej me inkursione të vazhdueshme. Sikur të mos mjaftonin këto trazira, rajoni u godit edhe nga tërmete të fuqishme, të cilat shkaktuan shkatërrime të mëdha në provincën e Dardanisë. Sipas burimeve, rreth 24 lokalitete, përfshirë edhe Shkupin, kryeqendrën e provincës, u rrënuan nga këto katastrofa natyrore. Në atë kohë, qyteti ishte i braktisur për shkak të sulmeve të vazhdueshme barbare.⁶¹ Një tjetër tërmet i fuqishëm shkatërroi edhe Durrësin (Dyrrachium), vendlindjen e Perandorit

⁵⁸ Po aty, 662.

⁵⁹ Marcellini V. C., *Chronicon*., X. Anastasii et Agapiti 517: “Olla illa, quae in Hieremia vate ab aquilone adversum nos nostraque delicta saepe succenditur, tela ignita fabricavit maximamque partem Illyrici iisdem iaculis vulneravit. duae tunc Macedoniae Tliessaliaque vastatae et usque Thermopylas veteremque Epirum Getae equites depraedati sunt. mille tunc librarum auri denarios per Paulum Anastasius imperator pro redimendis Romanorum oaptivis Iohanni praefecto Illyrici misit: deficiente pretio vel inclusi suis cum domunculis captivi Roniani incensi sunt vel pro muris clausarum urbium trucidati,” sipas botimit të Mommsen-it, *Chronica minora*, II, 99-100.

⁶⁰ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 663.

⁶¹ Jireček, *Geschichte der Serben* I, 54.

Anastasius, i cili u dëmtua rëndë, ashtu si edhe qyteti i Korintit,⁶² duke e përkeqësuar edhe më tej gjendjen e rëndë të provincave ballkanike në këtë periudhë trazirash. Si një rast të mëtejshëm për sulmet e skytëve ndaj trojeve ilire, mund të përmendim edhe sulmin që ata i bënë qytetit të Nishit në Dardani. Sipas Priskut, skytët e rrethuan Naisin, qytet ilir pranë Danubit, dhe meqenëse qyteti ishte i madh dhe i fortifikuar mirë, barbarët përdorën çdo mjet për ta pushtuar. Ndërsa mbrojtësit nuk guxonin të dilnin jashtë mureve, rrethuesit ndërtuan një urë në jug të lumit për të lehtësuar kalimin e ushtrisë dhe afruan pranë mureve makinat luftarake, sidomos kullat prej druri mbi rrota. Nga këto kulla, ushtarët lëshonin shigjeta mbi mbrojtësit në mure, ndërsa të tjerë i shtynin kullat në pozicione sa më të favorshme për të goditur me saktësi.⁶³

Në lidhje me dyndjet e mëvonshme të bullgarëve, do të mjaftohemi të përmendim pushtimet dhe ekspansionin e tyre në shek. IX, kur pushtuan territore të Kosovës, pasi më parë kishin pushtuar territore të Maqedonisë dhe kishin avancuar deri në Serbinë Lindore.⁶⁴ Sa u përket pushtimeve të tyre në Arbërinë Qendrore,⁶⁵ duke arritur madje deri në Durrës, nuk do të zgjerohemi më tej, pasi ato i përkasin shek. XI dhe dalin jashtë kornizës kohore të punimit tonë.

Dyndjet e hunëve

Pas tërheqjes së gotëve dhe dobësimit të fuqisë së tyre shkatërruese, në skenën e Ballkanit dhe të Perandorisë Romake të Lindjes u shfaq një armik i ri: hunët. Ata ishin një popull kalorësish nomadë me prejardhje nga stepat aziatike dhe zakonisht konsiderohen si një nga nxitësit kryesorë të epokës së dyndjeve të mëdha të popujve.⁶⁶ Rreth vitit 375, hunët u shfaqën papritur në hapësirat e Europës Lindore dhe shkatërruan mbretërinë e fuqishme ostrogote të Ermanarikut në territoret e Ukrainës

⁶² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 664.

⁶³ Priscus, *Historia Gothica*, Fragmenta, vol. IV, I b, 25. sipas: *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, përgatitur nga Selim Islami, Frano Prendi, Hasan Ceka, Skënder Anamali (Tiranë: Toena, 2002), 392. Shih edhe: Emine Hajdari & Arben Hajdari, *Dardania dhe dardanët*. Një histori rrëfyer nga autorët antikë (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri,” 2025), 281-282.

⁶⁴ Noel Malcolm, *Kosovo - A short History* (London: Macmillan, 1998), 27.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Knaut, Quast, *Die Völkerwanderung*, 26.

së sotme. Megjithëse origjina e tyre lindore është tashmë e njohur, proceset që çuan në formimin dhe shfaqjen e këtyre bashkësive të fuqishme nomade në Europë mbeten ende të paqarta.⁶⁷

Pak para vitit 370, disa grupe hunësh kishin arritur të formonin koalicionë më të mëdha dhe të depërtunin deri në Vllahinë e Madhe, ndonëse fillimisht vepronin të ndara dhe me synime të ndryshme. Vetëm bashkimi i tyre nën udhëheqjen e Uldinit, e më pas të Atilës, e shndërroi këtë fuqi në një kërcënim real për Perandorinë Romake, veçanërisht pasi shumë fise gjermanike u përfshinë gradualisht në strukturën politike të asaj që burimet e quajnë “Perandoria Hune”.⁶⁸

Gjatë tri dekadave të para të shek. V, hunët u mbajtën disi nën kontroll nga Perandoria Bizantine, herë përmes pagesës së një tributi të rëndë financiar nga oborri i Kostandinopojës dhe herë të tjera përmes përdorimit të trupave barbare në shërbim të perandorisë, të vendosura në rajonet përtej Danubit. Megjithatë, situata ndryshoi rrënjësisht me ardhjen e Atilës në krye të hunëve në vitin 434. Marrëdhëniet me Perandorinë e Lindjes morën një karakter të hapur armiqësor. Atila kërkoi me këmbëngulje nga Perandori Theodosius II rritjen e tributit që perandoria i paguante popullit të tij,⁶⁹ dhe sa më shumë që qeveria perandorake, e dobët, tregonte gatishmëri për t’iu nënshtruar kërkesave të tij, aq më të mëdha dhe më kërcënuese bëheshin pretendimet e tij në ambasadat e dërguara çdo vit në Kostandinopojë.

Kur të ardhurat e mbledhura nga provincat, të rraskapitura nga grabitjet dhe nga taksat e rënda, nuk mjaftonin më për të kënaqur kërkesat e hunëve, ata filluan një sërë fushatash shkatërrimtare në territorin e perandorisë. Kështu, hunët depërtuan në provincat lindore, shkatërruan fortesat e dobëta përgjatë bregut jugor të Danubit dhe, gjatë inkursioneve të përsëritura në Moesi, Traki dhe Maqedoni, rrënuan një numër të madh qytetesh që sapo kishin filluar të rimëkëmbeshin. Tërheqja e tyre u arrit vetëm kur Theodosius II, pak para vdekjes së tij, u

⁶⁷ Dëshmitë arkeologjike për hunët europianë përbëhen kryesisht nga materiale krahasuese të stepave euroaziatike, por mungesa e datimit të saktë dhe përmasat e vogla të nekropoleve e vështirësojnë nxjerrjen e përfundimeve mbi përbërjen e tyre.

Po aty.

⁶⁸ *Po aty.*

⁶⁹ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 649.

detyrua të blinte pagën duke paguar gjashtë mijë libra ari (λίτρων) dhe duke premtuar një tribut vjetor prej dy mijë librash.⁷⁰

Nga këto fushata plaçkitëse nuk shpëtuan as qytetet ilire. Si shembull përmendet Drishti (Drivastum),⁷¹ i cili duket se u shkatërrua nga hunët gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë vandalët shkaktuan dëme të mëdha në rajonet e Mesdheut, duke filluar nga Italia e Jugut dhe duke vazhduar drejt Ilirisë, Greqisë, Peloponezit dhe ishujve përreth, ku u shkatërruan shumë qytete bregdetare. Të dhëna të tilla Zinkeiseni i sjell duke u mbështetur në dëshmitë e historianit bizantin Prokopi i Cezaresë (500-560).⁷² Fushatat e shkatërrimeve të Atilës dhe të vëllait të tij Bledës në Iliri dhe Traki, si dhe shpopullimi i qyteteve⁷³ si pasojë e këtyre dyndjeve, përmenden edhe nga kronisti romak me origjinë ilire Marcellinus, i cili vë theksin te shkatërrimi i Nishit, Singidunumit etj.⁷⁴

Sulmet e këtyre barbarëve u shtrinë nga brigjet e Adriatikut deri në Peloponez. Sipas disa burimeve, një nga përballjet më të rëndësishme ndodhi pranë qytetit bregdetar Tenaron (Kaenopolis), në rajonin e sotëm të Manit, ku hunët pësuan një disfatë nga popullsia lokale.⁷⁵ Sipas traditës, këta mbrojtës u identifikuan me spartanët, të cilët më pas u vendosën në zonat malore të Peloponezit; gjurmë të pasardhësve të tyre mendohet se mund të ruhen edhe sot⁷⁶ në këtë rajon. Këto ngjarje mund të kenë ndodhur rreth vitit 465.⁷⁷

Një tjetër valë e fuqishme inkursionesh barbare goditi Ilirinë dhe provincat e tjera të perandorisë në vitin 540, gjatë sundimit të Perandorit Justinian. Edhe këtë episod Prokopi i Cezaresë e përshkruan si një sulm

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Theodor Ippen, “Denkmäler verschiedener Altersstufen in Albanien,” në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegovina*. Herausgegeben von Bosnisch-Herzegowinischen Landesmuseum in Sarajevo. Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. *Zehnter Band*. (Wien: Adolf Holzhausen, 1907), 9.

⁷² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 656.

⁷³ Marcellini V. C., *Chronicon*: (442) X. 2. Eudoxii et Dioscori: “*Bleda et Attila fratres multarumque gentium reges Illyricum Thraciamque depopulati sunt*,” sipas botimit të Mommsen-it, *Chronica minora*, II, 80.

⁷⁴ Marcellini V. C. *Chronicon*: Cyri solius, (441) VIII. 3: “*Hunnorum reges numerosis suorum cum milibus Illyricum irruerunt; Naisum, Singidunum aliasque ciuitates oppidaque Illyrici plurima exciderunt*” Sipas botimit të Mommsen-it, *Chronica minora*, II, 80.

⁷⁵ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 656.

⁷⁶ Po aty, 657.

⁷⁷ Po aty, 658.

të hunëve, të cilët shkatërruan territore të gjera nga Gjiri i Jonit deri në afërsi të mureve të Kostandinopojës.⁷⁸

Për t'u përballur me këto kërcënime të vazhdueshme, Justiniani I ndërmori një program të gjerë fortifikimesh në Ballkan. Ai organizoi disa linja mbrojtëse të përbëra nga kështjella dhe fortesa të shumta. Linja e parë veriore shtrihej përgjatë dy brigjeve të Danubit, duke përfshirë qytete si Singidunum (Beogradi i sotëm), Viminacium dhe Ratiaria. Linja e dytë kryesore kalonte nëpër Dardani dhe Misi (Moesia), përgjatë vargmalit të Hemusit, duke lidhur një sërë qytetesh të fortifikuara si Ulpiana, Tauresium (Justiniana Prima), Germana dhe Sardica. Më në jug, nga Epiri i Ri, shtrihej edhe një brez i tretë fortesash që kalonte përmes Maqedonisë dhe Trakisë deri në qytetin e Kersonit.⁷⁹

Sipas burimeve, numri i përgjithshëm i fortifikimeve të rindërtuara ose të ndërtuara rishtazi në këto rajone arrinte në 382, duke përfshirë Dardaninë, Maqedoninë, territorin e brendshëm të Ilirisë, si dhe të dy Epiret dhe Thesalinë.⁸⁰ Ndër fortesat e ndërtuara në territoret ilire të sotme të Shqipërisë përmenden kështjella Stefanoakon (kështjella e Koxhaxhikut⁸¹), që mendohet të ketë qenë në krahinën e Peshkopisë, Tyrkanos, të cilin Milan Šufflay e vendos në afërsi të Tiranës, si dhe Argyas, një fortesë e ngritur mbi lumin Janicë.⁸² Këto fortifikime ishin pjesë e sistemit mbrojtës të ndërtuar nga Justiniani për të përballuar kërcënimin e vazhdueshëm të popujve “barbarë” në Ballkan.

Gjurmë nga dyndjet e avarëve

Avarët u përkisnin popujve nomadë të stepave euroaziatike. Sa i përket origjinës së tyre, studiuesit mendojnë se ata nuk përbënin një popullsi me prejardhje të njëtrajtshme etnike, por një bashkësi të formuar nga grupe të ndryshme që vinin nga hapësira të Azisë Qendrore dhe të

⁷⁸ Procopius, *De Bello Persico II*, 4, cituar sipas: *po aty*, 667.

⁷⁹ Procopius, *De Aedificiis*. IV, 10, cituar sipas: *po aty*, 668.

⁸⁰ Prokopi i Cezaresë i përmend me emër të gjitha këto kështjella, duke i renditur në lista. Shih: Procopius, *De Aedificiis*. IV, 4, 11, cituar sipas: *po aty*, 670.

⁸¹ Adem Bunguri, “Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër),” në *Studime historike*, 1-2 (2009): 37, ref. 45.

⁸² Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 8, 75.

Azisë së Brendshme. Kjo duket të ketë qenë veçanërisht e vërtetë për avarët që u shfaqën në Europë gjatë shek. VI.⁸³

Prania e tyre në hapësirat ballkanike dëshmohej edhe nga disa gjetje arkeologjike, ndër të cilat veçohen thesaret e zbuluara në Ersekë⁸⁴ dhe në Vrap,⁸⁵ pranë Tiranës. Thesari i Vrapit, i gjetur në vitin 1901 nga një fshatar që punonte tokën e tij,⁸⁶ përbëhej nga 41 objekte të ndryshme, disa prej ari me peshë rreth 5,554 kg, ndërsa të tjerat prej argjendi me peshë 1,438 kg.⁸⁷ Midis objekteve të zbuluara dallohen edhe disa togëza dhe elemente dekorative të veshura me ar, të punuara sipas motiveve karakteristike të kulturës së vonë avare, të përdorura zakonisht në zbukurimin e objekteve prej bronzit.

Pjesa më e madhe e këtyre objekteve duket se është me origjinë bizantine, gjë që sugjeron se ato mund të jenë marrë si plaçkë gjatë inkursioneve në qytete të ndryshme të perandorisë. Sipas një hipoteze të përhapur në literaturë, thesari mund të ketë qenë në zotërim të Kuberit (ose Kuverit), të birit të Kubratit, i cili kishte qenë khagan i avarëve. Mendohet se këto objekte mund të jenë sjellë në territorin e sotëm shqiptar në rrethana të lidhura me një rebelim ose me lëvizjet e grupeve të tij drejt Ballkanit. Megjithatë, mënyra se si ky thesar përfundoi i fshehur në zonat malore të Shqipërisë mbetet ende një enigmë.⁸⁸ Sipas hipotezës së historianit Joachim Werner, Kuberi dhe ndjekësit e tij mund

⁸³ Walter Pohl, *Die Avaren. Ein Steppenvolk in Mitteleuropa 567-822 n. Chr.* (München: C. H. Beck 1988), 37.

⁸⁴ *Po aty*, 281.

⁸⁵ Matthias Hardt, *Gold und Herrschaft: Die Schätze europäischer Könige und Fürsten im ersten Jahrtausend* (Berlin: Akademie Verlag, 2004), 183.

⁸⁶ Fshatari, emrin e të cilit studimet nuk e japin, gjatë punimit të arës hasi në një kazan dhe nuk u mor shumë me përmbajtjen e tij, por ua shiti kazanin për disa *mesxhide* tre shqiptarëve të tjerë, të cilët, me sa duket, filluan të ziheshin për shkak të tij. Kjo grindje u mor vesh në Tiranë nga autoritetet osmane të kohës. Mytesarifi Mehmet Hysni Beu u gjeti atyre një kupë ari (pokal), të cilën ua konfiskoi dhe e dërgoi për ekzaminim në Stamboll. Një pjesë tjetër përfundoi e shitur në Paris, ndërsa 39 pjesë të këtij thesari (me përjashtim të dy pjesëve, asaj të dërguar në Stamboll dhe një tjetre në Paris) u blenë më vonë nga J. Pierpont Morgan († 1913) dhe, pas vdekjes së tij, u ruajtën në Nju Jork nga i biri. Shih më tepër: Josef Strzygowski, *Altai-Iran und Völkerwanderung. Ziergeschichtliche Untersuchungen über den Eintritt der Wanderer - und Nordvölker in die Treibhäuser Geistigen Lebens. Anknüpfend an einen Schatzfund in Albanien* (Leipzig: J. C. Hinrichs'sche Buchhandlung 1917), 1.

⁸⁷ Hardt, *Gold und Herrschaft*, 184.

⁸⁸ *Po aty*.

ta kenë marrë këtë thesar gjatë një grabitjeje dhe më pas të jenë tërhequr drejt Maqedonisë e më tej në territorin shqiptar.⁸⁹

Inkursionet e avarëve dhe të aleatëve të tyre nuk lanë pa prekur edhe disa qendra të rëndësishme urbane të rajonit. Si shembull përmendet shkatërrimi i qytetit të Balcit (Balesium),⁹⁰ 15 km në afërsi të Shkodrës. Po ashtu, vërshimet shkatërrimtare duket se goditën edhe qytetin e Sardës, pranë brigjeve të Drinit. Gjatë gjurmimeve arkeologjike, në një kullë me planimetri në formë U-je brenda qytetit janë zbuluar skelete njerëzish,⁹¹ të cilat interpretohen si dëshmi e një masakre të lidhur me sulmet e sllavëve dhe avarëve në shek. VI. Në këtë periudhë, inkursionet e tyre çuan edhe në pushtimin e Lezhës dhe në shkatërrimin e kështjellës së Sardës,⁹² duke shënuar një tjetër episod të rëndë në historinë e këtyre qendrave mesjetare. Kaq mund të themi, hëpërhë, në lidhje me dyndjet e avarëve.

Dyndjet e sllavëve dhe ngulmimi i tyre në Ballkan

Në kohën kur filluan të shfaqeshin në kufijtë e Perandorisë Bizantine, sllavët ishin pothuajse të panjohur për botën romake. Vetëm pas përplasjes së ushtrive perandorake me grupe të ndryshme të kësaj popullsie, u bë e qartë se ata banonin në hapësirat e gjera përtej Danubit (Istrit). Historiani bizantin Prokopi i Cezaresë ofron një përshkrim të hollësishëm të mënyrës së jetesës së tyre: sipas tij, ata nuk jetonin në qytete apo në fshatra të qëndrueshme, por në kasolle të ulëta dhe të shpërndara, duke i ndryshuar shpesh vendbanimet sipas nevojës. Sllavët nuk i nënshtroheshin pushtetit të një sundimtari të vetëm, por i rregullonin çështjet e tyre në mënyrë kolektive, duke marrë së bashku vendime për fatin e mirë dhe të keq të bashkësisë.⁹³

Prokopi vëren gjithashtu se ata nderonin disa hyjni përmes flijimeve, por nuk besonin se fati kishte pushtet mbi jetën e tyre. Në luftë

⁸⁹ Pohl, *Die Avaren*, 281.

⁹⁰ Ippen, "Denkmäler," 6.

⁹¹ Hëna Spahiu, Damjan Komata, "Shurdhahu - Sarda qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar (Rezultatet e gjurmimeve të viteve 1967-1970)," në *Iliria* 3 (1974): 269-270.

⁹² Gjerark Karaickaj, "Qyteti shqiptar i Sardës. Origjina dhe zhvillimi i qytetit mesjetar në Shqipërinë e Veriut," në *Monumente*, nr. 15-16 (1978): 75-76.

⁹³ Procop, *De Bello Gothico III*, 14, cituar sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 665-666.

zakonisht merrnin pjesë në këmbë, pa parzmore, të armatosur vetëm me shtiza të shkurtra dhe mburoja të vogla. Ai përmend edhe dy grupet kryesore të kësaj popullsie, sllavët dhe antët, të cilët i konsideron të ngjashëm për nga pamja fizike, mënyra e jetesës dhe gjuha.⁹⁴ Megjithatë, edhe pse Prokopi i përfshin në të njëjtin kompleks etnik, nuk është plotësisht e sigurt nëse antët kishin një origjinë tërësisht sllave.⁹⁵ Territori i formimit të tyre si bashkësi etnike vendoset zakonisht në Ukrainën Veriperëndimore, ndërsa procesi i konsolidimit të tyre si popull i veçantë daton në gjysmëmijëvjeçarin e parë pas Krishtit.⁹⁶

Dyndjet e sllavëve në territoret e Perandorisë Bizantine filluan të intensifikoheshin rreth vitit 533, pas vrasjes së komandantit bizantin Chibuldios, i cili për vite me radhë kishte arritur t’i mbante nën kontroll sulmet e tyre përgjatë kufirit danubian. Pas rënies së tij në një betejë përtej Danubit, kufiri verior i perandorisë mbeti i pambrojtur dhe territori u hap për depërtimin e tyre drejt jugut.⁹⁷ Në këtë periudhë filloi edhe zgjerimi gradual i sllavëve drejt Ballkanit.⁹⁸ Ata depërtuan në territoret ilire dhe në vitin 590 pushtuan Lezhën, të cilën e mbajtën për disa vjet nën kontroll. Si pasojë, ipeshkvi i Lezhës u detyrua të largohej dhe të kërkonte strehim në Itali, ku, sipas burimeve, nuk u prit me ndonjë dashamirësi të madhe.⁹⁹ Pak vjet më vonë, në vitet 593 ose 595, sllavët plaçkitën Shkupin¹⁰⁰ dhe rajonet përreth. Një grup prej rreth 600 luftëtarësh sllavë, gjatë kthimit nga këto ekspedita grabitëse, u kap dhe u shkatërrua nga ushtria perandorake e komanduar nga gjenerali Pjetër, vëllai i Perandorit Mauricius.

⁹⁴ *Po aty*, 666.

⁹⁵ Bartłomiej Szymon Szmoniewski, “The Antes. Eastern “Brothers” of the Slaves?” në Florin Curta (ed.), *Neglected Barbarians* (Turnhout: Brepols, 2010), 82.

⁹⁶ Mathias Knut, “Die frühen Slawen,” në M. Knut & Q. Dieter, *Die Völkerwanderung*, 80.

⁹⁷ Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 667.

⁹⁸ Knut, “Die frühen Slawen,” 80.

⁹⁹ W. Pohl, *Die Awaren*, 123. Sipas një letre nr. 26 të qershorit 592 (Greg. Reg. I, 2, 37, f. 132), tensione të ngjashme u shfaqën pak më vonë edhe në Istrië. Ndërsa për sulmet e barbarëve bëhet fjalë edhe në letrat 1, 2, 3 (f. 120), drejtuar prefektit ilirik Jobinus në mars të vitit 592, si edhe në letrën 2, 10 (f. 249), dërguar peshkopit të Salonës në korrik të vitit 600. Shih *po aty*, ref. 26, f. 377.

¹⁰⁰ Cordignano, *In Albania*, 73.

Në fazën e parë, sllavët nuk depërtuan në Ballkan si një popullsi e bashkuar dhe kompakte, por në grupe të vogla luftëtarësh, të cilat shpesh shoqëroheshin edhe nga elementë të tjerë etnikë, si gjermanikë ose avarë, që më pas u asimiluan brenda komuniteteve sllave.¹⁰¹ Fillimisht, ata dërgonin pararoja ushtarake, të cilat sulmonin në mënyrë të papritur, digjin dhe plaçkitnin vendbanimet, duke detyruar popullsinë vendase të tërhiqej në zonat malore për të shpëtuar. Pas këtyre sulmeve vinin grupe më të mëdha kolonësh, të cilët vendoseshin në territoret e braktisura dhe krijonin ngulmime të reja. Përmes kësaj taktike të shkatërrimit (taktika e tokës së djegur) dhe kolonizimit, sllavët arritën të ndryshonin thellësisht strukturën etnike të shumë rajoneve të Ballkanit. Kjo periudhë konsiderohet ndër më të errëtat jo vetëm për historinë shqiptare, por edhe për gjithë Europën Juglindore. Edhe kronistët bizantinë japin të dhëna shumë të kufizuara për zhvillimet e shek. VII-X. Sipas Prokopit, inkursionet e sllavëve dhe të popujve të tjerë barbarë në Iliri dhe në provincat fqinje përsëriteshin pothuajse çdo vit, veçanërisht gjatë sundimit të Perandorit Justinian.¹⁰²

Burimet përmendin disa inkursione të rëndësishme në territoret ilire. Një nga më të rëndësishmet ndodhi në vitin 548, kur një ekspeditë sllave përshkoi të gjithë Ilirinë, duke shkaktuar shkatërrime të mëdha. Ata kaluan nga Nishi dhe, duke kaluar nga Skodra, arritën deri pranë mureve të Epidamnosit.¹⁰³ Autoritetet perandorake arritën të grumbullonin rreth 15 000 ushtarë, por këta nuk guxuan të përballeshin drejtpërdrejt me sulmuesit dhe i ndoqën vetëm nga larg.¹⁰⁴ Gjatë këtyre ngjarjeve u shkatërrua edhe qyteti i lulëzuar i Bylisit, së bashku me katedralen e tij.¹⁰⁵

Një tjetër inkursion ndodhi në vitin 550, kur rreth 3 000 luftëtarë sllavë kaluan Danubin dhe u ndanë në dy grupe. Ata arritën të mposhtnin disa njësi perandorake dhe plaçkitën territoret e Ilirisë dhe Trakisë, duke shkatërruar çdo fortesë të vogël që u dilte përpara. Fillimisht, ata vrisnin

¹⁰¹ Biermann, "Von Kiew an der Elbe," 82-83.

¹⁰² Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 665.

¹⁰³ *Die Heerstrasse von Belgrad nach Constantinopel und die Balkanpässe*. Eine historisch-Geographische Studie. Von Dr. Constantin Jos. Jireček (Prag: F. Tempsky 1877), 64 (më tej: Jireček, *Die Heerstrasse*)

¹⁰⁴ Procop, *De Bello Gothico* III, 13, p. 495, sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands* 1, 674.

¹⁰⁵ Aleksandër Meksi, "Të dhëna për historinë e hershme mesjetare të Shqipërisë (fundi i shek. VI – fillimi i shek. XI)," *Iliria*, 1 (1989): 112.

vetëm burrat e rritur dhe merrnin robër gra e fëmijë, por më pas, për shkak të pamundësisë për t'i ruajtur robërit, i masakruan pa dallim moshe apo gjinie.¹⁰⁶ Prokopi përshkruan se Iliria dhe Trakia ishin të mbushura me kufoma të pavarrosura, viktima të këtyre sulmeve.

Në vitin 552, sllavët, të ndihmuar nga gepidët,¹⁰⁷ ndërmorën një tjetër ekspeditë të madhe drejt jugut. Ata kaluan përmes territoreve të gepidëve dhe, me mbështetjen e tyre, plaçkitën Dardaninë, Epirin dhe rajonet e tjera të Ilirisë, duke depërtuar deri në Hellas.¹⁰⁸ Në këtë kohë, ata bashkëpunuan edhe me Mbretin ostrogot Totila, i cili kishte sulmuar me flotën e tij brigjet perëndimore të Akajas. Për kalimin e Danubit, sllavët u paguanin gepidëve nga një *stater* për person, një pagesë që Zinkeiseni mendon se mund të ketë qenë financuar nga ostrogotët.¹⁰⁹

Shkatërime dhe pushtime të tjera që i hapën rrugën e mëtejshme sllavizimit të Ballkanit Jugor, dhe së bashku me të edhe të trojeve të shqiptarëve, janë edhe pushtimi dhe shkatërrimi i kështjellës Sirmium në vitin 582, të cilën ata e morën me ndihmën e avarëve, si dhe, dhjetëvjeçarë më vonë, më saktë në vitin 615, edhe pushtimi i Nishit, gjë që i hapi rrugën një ngulmimi sllavësh në territoret e Dardanisë (Kosovës së sotme) dhe të Prevalit (Shqipëria Veriore dhe Mali i Zi), me kryeqendër Shkodrën, të cilët u vendosën kryesisht nëpër disa zona rurale, por jo në qytete.¹¹⁰ Sipas Noel Malcolm-it, gjatë kësaj periudhe (vitet 610-620) – që përkon me sundimin e Perandorit bizantin Heraklios (610-641) – perandori bizantin i asaj kohe i ftoi kroatët që të vinin nga Europa Qendrore dhe të merreshin me kërcënimin avar. Ai u vuri këtyre sllavëve territore në dispozicion në vitin 626.¹¹¹ Ata erdhën duke marrë

¹⁰⁶ Procop, *De Bello Gothico III*, 38-40, cituar sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands 1*, 675.

¹⁰⁷ Gepidët ishin një popull që shfaqet për herë të parë në gjysmën e dytë të shek. IV pas Krishtit dhe ishin të vendosur në krahinat e Danubit, ndërmjet zonës verilindore hungareze dhe asaj veriperëndimore rumune. Studiues të ndryshëm janë përpjekur të krijojnë një lidhje ndërmjet gotëve dhe gepidëve, por sipas Michael Schmauder-it, gepidët nuk mund të identifikohen si gotë, pasi përfaqësonin një popull tjetër gjermanik. Michael Schmauder, “Im Brennpunkt des Geschehens: Germanische Völker an der Donau,” në Knut & Dieter, *Die Völkerwanderung*, 40-41.

¹⁰⁸ Procop, *De Bello Gothico IV*, 25, sipas: Zinkeisen, *Geschichte Griechenlands 1*, 676.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ Malcolm, *Kosovo*, 24.

¹¹¹ Jusuf Buxhovi, *Kosova*, vol. 1: Darania in Ancient and Medieval Times (Houston: Jalifat Publishing 2013), 333.

me vete edhe komshinjtë e tyre, serbët. Të dyja këto popullsi u vendosën në territoret e zbrazura nga avarët: kroatët në Kroacinë Moderne, Bosnjën Perëndimore dhe në krahinën e Malit të Zi (të sotëm).¹¹² Gjatë kësaj kohe duhet të jetë shkatërruar për herë të tretë edhe qyteti i Docleas nga sllavët, të cilët e pushtuan këtë territor rreth vitit 639,¹¹³ pasi më parë ishte shkatërruar një herë nga Alariku dhe vizigotët, e më pas nga një tërmet i vitit 518.¹¹⁴ Përsa i përket rastit të asaj pjese të Dardanisë që është Kosova e sotme, ekspansioni serb filloi në shek. XII, pasi ky territor kishte kaluar më përpara, në shek. IX, edhe një pushtim nga bullgarët.¹¹⁵

Në brendësi të Dalmacisë, situata ishte më e vështirë. Në vitin 599, trupat romake u detyruan të kufizoheshin në ndjekjen e ushtrisë së Kaganit dhe në sulme ndaj karvanit të tij, ndërsa avarët arritën të shkatërronin rreth dyzet kështjella — një shkallë shkatërrimi që sllavët nuk e kishin arritur më parë. Po atë vit, një ushtri romake u përball me një grup prej rreth 600 sllavësh, të cilët, pas pushtimit të tri qyteteve të vogla, po transportonin plaçkën dhe robërit. Nga dëshmitë e të burgosurve u bë e qartë se, pas pushtimit të Shkupit, *Getët* sllavë kishin vazhduar depërtimin drejt jugut.¹¹⁶

Burim i rëndësishëm për këtë periudhë është edhe *Miracula Sancti Demetrii*, një vepër e shek. VII që përshkruan depërtimin e sllavëve në provincat e Illyricum-it dhe Epirit. Sipas saj, në vitin 617 një numër i madh sllavësh pushtoi pjesë të mëdha të këtyre territoreve dhe u vendos aty së bashku me familjet dhe pasuritë e tyre, duke çuar në braktisjen e shumë qyteteve dhe në shkatërrimin e ekonomisë lokale.¹¹⁷ Sipas Jireček-ut, sllavët u shfaqën para mureve të këtyre qyteteve jo vetëm me makineritë e tyre të rrethimit, por edhe me familjet e tyre, të cilat prisnin të vendoseshin në qytete sapo ato të pushtoheshin.¹¹⁸ Pushtimi i këtyre qyteteve nuk ishte aspak i vështirë, pasi një pjesë e madhe e banorëve ishte larguar në kohën e dhur dhe ishte strehuar në qytetet bregdetare.

¹¹² Malcolm, *Kosovo*, 24.

¹¹³ *On the Roman town of Doclea*, 19.

¹¹⁴ *Po aty*, 11.

¹¹⁵ Malcolm, *Kosovo*, 26, 27.

¹¹⁶ Pohl, *Die Awaren*, 125.

¹¹⁷ Stefanaq Pollo & Arben Puto, *The history of Albania from its origins to the present day*. With the collaborations of Kristo Frashëri and Skënder Anamali. English translation by Carol Wiseman and Ginnie Hole (London/Boston/Henley: Routledge & Kegan Paul [o. J]), 27.

¹¹⁸ Jireček, *Die Heerstrasse*, 68.

Për shembull, në vitin 678 në Selanik ndodheshin refugjatë nga Nishi, Serdika, qytetet danubiane të Dakisë, si dhe nga Dardania e Panonia (Sirmium).¹¹⁹

Në disa raste, sllavët morën pjesë edhe në fushatat e avarëve, si në rrethimin e Kostandinopojës në vitin 626, i cili përfundoi me disfatë për sulmuesit.¹²⁰ Pas fushatave të tyre plaçkitëse dhe veprimeve luftarake, shpesh pasonte procesi i kolonizimit, ndërsa shtrirja e tyre në Ballkan ishte jashtëzakonisht e gjerë: nga veriperëndimi i Ballkanit, në kufi me Austrinë, duke vazhduar deri në Alpet juglindore dhe Rumani, ndërsa në jug shtrihej deri në Peloponez.¹²¹ Sulmet e sllavëve u bënë më intensive pikërisht pas disfatës së lartpërmendur të avarëve kundër Bizantit (626).

Megjithatë, edhe pse sundimi roman pas viteve '30 të shek. VII u përmbys, duke mundur të rezistonte vetëm në disa kështjella bregdetare të arritshme, marrëdhëniet me Bizantin nuk u shkatërruan. Në shek. VIII-IX, duke u bazuar në listat e pjesëmarrësve në sinodet kishtarë, në vulat e zyrtarëve, si edhe në të dhëna arkeologjike, shohim një ripërtëritje të ndikimit dhe të pushtetit të Bizantit.

Si shembull kryesor mund të përmendim qytetin e Durrësit, i cili i ruajti të pandërprera lidhjet detare me Kostandinopojën dhe madje kishte edhe një flotë detare në Qefaloni, e cila mbështeste dhe mbronte këtë lidhje detare. Shkaqet e këtyre invazioneve të stërmëdha duhet t'i kërkojmë, ndër të tjera, edhe te qeverisja e dobët e Bazileus Fokas-it gjatë viteve 602-610, sepse gjatë kësaj periudhe pati distabilitet dhe trazira të mëdha në provincat bizantine, duke u hapur kështu portat këtyre invazorëve.

Kjo gjendje vazhdoi edhe gjatë periudhës së sundimit të Perandorit Heraklios (610-49), i cili ishte i përfshirë në një luftë të vështirë 20-vjeçare kundër persëve dhe, si rrjedhojë, nuk mund t'u kushtonte vëmendje të plotë provincave ballkanike. Dyndjet sllave u shoqëruan edhe me një fenomen të ri, atë të kolonizimit të vendit, dhe si pasojë, mjaft treva si Dakia, Maqedonia Trakia apo Peloponezi pësuan ndryshime të mëdha në strukturën e tyre etnike. Sllavët depërtuan në masë të madhe edhe në Ilirinë Veriore, duke shkaktuar tkurrje të ndjeshme të popullsisë vendase.

¹¹⁹ *Po aty.*

¹²⁰ Felix Biermann, “Von Kiew an der Elbe,” në Knut & Dieter, *Die Völkerwanderung*, 82.

¹²¹ *Po aty.*

Pas këtij invazioni sllav dhe depërtimit të tij në trevat e Prevalit, Dardanisë, Epirit të Ri dhe Epirit të Vjetër, shqiptarët kaluan për pothuaj një gjysmë mijëvjeçari një jetë “pa histori”, gjatë së cilës disponohen shumë pak të dhëna mbi zhvillimet dhe fatet e popullsisë me etni shqiptare. Këto popullsi u detyruan të braktisnin krahinat fushore dhe bregdetare dhe, për t’u vetëmbrojtur e mbijetuar, u përqendruan në zonat e thella malore, duke bërë një jetë pothuajse nomade si barinj endacakë. Një mënyrë jetese të ngjashme bënë edhe fiset rumune dhe vllahe, të cilat u prekën njësoj nga këto dyndje.¹²²

Përsa u përket ngulmimeve të tyre, vendosja e popullsive sllave nuk duket se ka ndjekur shpërndarjen ekzistuese të hapësirave të banuara që ata gjetën në territoret e perandorisë. Po ashtu, nuk ka gjasa që ata të kenë pushtuar fillimisht zonat kufitare dhe vetëm më pas rajonet e brendshme. Nga të dhënat e burimeve të shkruara dhe nga gjetjet arkeologjike ende relativisht të kufizuara, del se në fazën e parë ata u përqendruan kryesisht në krahinat malore të brendshme të Ilirikut, veçanërisht në Bosnjë, Maqedoni, Shqipëri dhe në zonat e Greqisë përtej brezit bregdetar.¹²³ Faktor përcaktues për këtë duket se ka qenë prania e pabarabartë ushtarake e bizantinëve. Deri në vitin 602, Perandoria Bizantine ishte në gjendje të organizonte operacione ushtarake të përsëritura në Traki dhe përgjatë kufirit danubian. Qendrat bregdetare përfitonin nga mundësia e përforsimeve detare; qytete si Selaniku dhe Salona dispononin garnizone që mund të ndërmerren edhe veprime sulmuese, megjithëse kjo i ekspozonte vetë këto qendra ndaj rrezikut.¹²⁴

Vetëm pas vitit 602 këto grupe arritën të vendoseshin në mënyrë të qëndrueshme në territoret e Ballkanit, duke u shfaqur jo vetëm si kolonë, por edhe si pushtues. Rreth vitit 615, gjatë rrethimit të Selanikut, sllavët sollën me vete familjet dhe pasurinë shtëpiake, gjë që tregon se synonin një vendosje të përhershme në qytet.¹²⁵

Shek. VII shënoi periudhën e vendosjes së tyre përfundimtare në Ballkan. Antët, ose sllavët e Detit të Zi, gjatë sundimit të Perandorit bizantin Heraklios (625-641), u vendosën në Ilirik, më tepër të toleruar

¹²² Georg Stadtmüller, “Die albanisch-rumänische Wanderungsbewegung (11. – 13. Jahrhundert),” në Georg Stadtmüller, *Geschichte Südosteuropas mit 23 Karten und einem Anfang* (München: R. Oldenburg, 1950), 202.

¹²³ Pohl, *Die Awaren*, 124.

¹²⁴ *Po aty*, 125.

¹²⁵ *Po aty*.

sesa të ftuar nga perandori.¹²⁶ Në Shqipërinë e Veriut, serbët përmenden për herë të parë nga historianët në vitin 822¹²⁷ (Jir., *Ist. Srba*, II, 86) dhe qëndruan aty, me ndërprerje, deri rreth vitit 1360.¹²⁸ Historia e tyre, deri në disfatën në Betejën e Kosovës nga turqit më 1389, ishte në thelb një përpjekje e vazhdueshme për të zotëruar të gjithë Ballkanin; nën dinastinë e Nemanjicëve ata arritën madje pranë realizimit të synimit për të marrë kurorën e Perandorisë së Lindjes.

Ky instinkt për zgjerim u ripërtëri vazhdimisht. Në vitin 746 ata arritën të depërtonin edhe në Greqi. Pas kësaj vijon një periudhë shumë e errët, derisa në shek. X në skenë shfaqen bullgarët, një popull që u ndikua aq thellë nga sllavët sa që përvetësoi edhe gjuhën e tyre.

Përfundime

Shqyrtimi i dyndjeve të popujve të ashtuquajtur “barbarë” në Iliri gjatë shek. IV-VII tregon qartë se këto lëvizje nuk përbënin thjesht një varg inkursionesh të shkëputura ushtarake, por një proces të gjatë dhe të shumëanshëm transformimi historik. Nëpërmjet tyre u tronditën themelet politike, ushtarake, ekonomike dhe demografike të provincave ballkanike të Perandorisë Romake të Lindjes, duke përgatitur kështu kalimin e ngadaltë, por vendimtar, nga Antikiteti në Mesjetë.

Nga analiza e të dhënave të përdorura në këtë studim del se valët e para të goditjeve – sidomos ato të gotëve – kishin së pari karakter ushtarak dhe grabitës. Ato synonin plaçkën, dobësimin e kufijve dhe imponimin e marrëveshjeve të favorshme me pushtetin perandorak. Megjithëse shkaktuan shkatërrime të rënda, rrënim qytetesh dhe destabilizim të administratës romake në Ballkan, këto dyndje nuk sollën menjëherë një zëvendësim të qëndrueshëm etnik në të gjitha hapësirat e prekura. Në këtë fazë kemi të bëjmë më tepër me një cikël të gjatë rrënimi, pasigurie dhe ripërshtatjeje të strukturave perandorake sesa me një kolonizim të plotë e të menjëhershëm.

Ndryshe paraqitet tabloja me hunët, avarët dhe sidomos me sllavët. Hunët ushtruan një presion të madh ushtarak mbi kufijtë danubianë dhe mbi provincat e Ballkanit, duke përshpejtuar lëvizjen e popujve të tjerë

¹²⁶ Cordignano, *In Albania*, 73.

¹²⁷ Jireček, *Geschichte der Serben I*, 120.

¹²⁸ Jireček, *Geschichte der Serben II*, 110.

dhe duke e vënë perandorinë përballë një forme të re lufte – të shpejtë, të lëvizshme dhe të vështirë për t’u përballuar me mjetet tradicionale mbrojtëse. Avarët, nga ana tjetër, ndonëse shfaqen kryesisht përmes gjurmëve arkeologjike dhe disa episodeve shkatërruese, dëshmojnë se Iliria nuk mbeti jashtë rrjeteve të mëdha të dhunës, plaçkitjes dhe lëvizjes së njerëzve që përshkuan Ballkanin në shek. VI.

Megjithatë, faktori më përcaktues për ndryshimin afatgjatë të peizazhit historik të Ballkanit ishte pa dyshim depërtimi dhe ngulmimet sllave. Pikërisht këtu qëndron edhe dallimi themelor midis dyndjeve të mëparshme dhe asaj që ndodhi nga fundi i shek. VI dhe, sidomos, gjatë shek. VII. Sulmet sllave nuk mbetën vetëm bastisje të përkohshme, por u shoqëruan me vendosjen e qëndrueshme të popullsive të reja, me braktisjen e qendrave të vjetra, me kolonizimin e territoreve të dëmtuara dhe të zbrazura, si dhe me ndryshime të thella në strukturën etnike të shumë krahinave të Ballkanit. Në këtë kuptim, sllavët nuk ishin thjesht plaçkitës të radhës, por bartës të një realiteti të ri demografik dhe historik.

Në hapësirat ilire, pasojat e këtij procesi qenë të rënda dhe afatgjata. Burimet dhe dëshmitë arkeologjike tregojnë për shkatërrimin ose dobësimin e një sërë qendrash urbane e kishtare, si Doclea, Bylisi, Sarda, Baleci, Lezha, Drishti e lokalitete të tjera. Rrjeti qytetar i trashëguar nga Antikiteti u dëmtua rëndë; një pjesë e popullsisë u tërhoq në zonat malore, ndërsa qendrat bregdetare dhe disa pika strategjike ruajtën më gjatë vazhdimësinë e jetës administrative e kishtare, falë lidhjeve detare me Bizantin. Kjo tërheqje e popullsisë autoktone drejt brendësisë dhe drejt relievit mbrojtës së vendit (malësive) duket se përbën një nga mekanizmat kryesorë të mbijetesës së elementit vendas në Ilirinë Jugore.

Në këtë aspekt, një nga përfundimet më të rëndësishme të artikullit tonë është se procesi i sllavizimit nuk ishte i njëtrajtshëm në gjithë Ballkanin. Në shumë rajone të gadishullit, kolonizimi sllav u bë i thellë dhe përcaktues, si për shembull në Dalmaci¹²⁹ dhe në rajone të tjera të ish-Jugosllavisë etj., ku romanizimi kishte avancuar. Sipas Jireček-ut, ishin pikërisht krahinat romane dhe të romanizuara të Ilirikut (Illyrianici) që u prekën më tepër nga kjo përmbysje.¹³⁰ Në viset jugore të Ilirisë – veçanërisht në Dardani, Preval, Epirin e Ri dhe Epirin e Vjetër –

¹²⁹ Malcolm, *Kosovo*, 24.

¹³⁰ Jireček, *Die Heerstrasse*, 68.

popullsia autoktone duket se ruajti në një masë të konsiderueshme vazhdimësinë e saj. Kjo nuk do të thotë mungesë e ndikimit sllav, por tregon se procesi i transformimit etnik ishte më i ndërlikuar, më i pabarabartë dhe i kushtëzuar nga faktorë gjeografikë, ushtarakë, ekonomikë dhe politikë. Fati i banorëve të vjetër të vendeve ballkanike ishte, pra, ishte i ndryshëm. Fshatarët dhe barinjët ilirë, trakë dhe romakë, që përbënin popullsinë vendase, nuk i braktisën vendbanimet e tyre; madje, ka gjasa që, ashtu si në rastin e gotëve, ata iu bashkuan sllavëve me dëshirë, për t’iu shmangur barrës së rëndë të taksave. Nga ana tjetër, këta vendas ushtruan ndikimin e tyre mbi kolonët sllavë, si në gjuhë, ashtu edhe në mënyrën e jetesës.¹³¹

Po aq i rëndësishëm është edhe roli i Perandorisë Bizantine. Edhe pse shpesh e lodhur, e goditur nga krizat e brendshme, luftërat e jashtme dhe paaftësia e disa perandorëve, ajo nuk u zhduk menjëherë nga këto hapësira. Përkundrazi, reagimet ushtarake, diplomatike dhe fortifikuese – sidomos në kohën e Justinianit – dëshmojnë për një përpjekje të qëndrueshme për të ruajtur kontrollin mbi Ballkanin. Sistemi i ri i fortesave, rindërtimi i disa qyteteve dhe mbijetesë e qendrave si Durrësi tregojnë se Bizanti vijoi të mbetej një faktor vendimtar, edhe në kushtet e një shpërbërjeje të dukshme të rendit të vjetër të provincave.

Në përfundim, mund të thuhet se dyndjet e popujve “barbarë” në Iliri gjatë shek. IV-VII nuk përfaqësojnë vetëm një epokë dhune dhe rrënimi, por edhe një moment kyç të riformësimit historik të hapësirës ilire dhe të asaj ballkanike. Nëpërmjet tyre u shembën shumë nga strukturat e vjetra të botës romake, por njëkohësisht u krijuan kushtet për lindjen e realiteteve të reja etnike, politike dhe kulturore që do të karakterizonin Mesjetën e Hershme. Pikërisht në këtë nyjë historike duhet kërkuar një pjesë e rëndësishme e shpjegimit për transformimin e Ilirisë së vonë, për mbijetesën e elementit autokton shqiptar në jug dhe për formësimin e botës ballkanike mesjetare.

¹³¹ *Po aty.*

Bibliografi:

- CEKA, Neritan. *Ilirët*. Tiranë: Ilar, 2001.
- CEKA, Neritan. “Taulantët”. Në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*. Botim i ri, vëll. III: N–Zh. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009.
- BUNGURI, Adem. “Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)”. Në *Studime historike*, nr. 1-2 (2009): 27-56.
- BUXHOVI, Jusuf. *Kosova*. Volume 1: *Dardania in Ancient and Medieval Times*. Houston: Jalifat Publishing, 2013.
- CORDIGNANO, Fulvio. In *Albania*. Roma: Società Nazionale “Dante Alighieri”, 1940.
- Fonti per la Storia d’Italia*. Pubblicate dall’Istituto Storico Italiano. Scrittori – Secoli VI. Roma: Istituto di Storia, 1895.
- HAJDARI, Emine & HAJDARI, Arben. *Dardania dhe dardanët: Një histori rrëfyer nga autorët antikë*. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
- HARDT, Matthias. *Gold und Herrschaft: Die Schätze europäischer Könige und Fürsten im ersten Jahrtausend*. Berlin: Akademie Verlag, 2004.
- ISLAMI, Selim & PRENDI, Frano & CEKA, Hasan & ANAMALI, Skënder (përg.). *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*. Tiranë: Toena, 2002.
- IPPEN, Theodor. “Denkmäler verschiedener Altersstufen in Albanien.” Në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Herzegowina*. Herausgegeben von dem Bosnisch-Herzegowinischen Landesmuseum in Sarajevo. Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. Zehnter Band. Mit 11 Tafeln, 214 Abbildungen im Texte und 5 Stammtafeln. Wien: Adolf Holzhausen, 1907.
- JIREČEK, Constantin. *Die Heerstrasse von Belgrad nach Constantinopel und die Balkanpässe: Eine historisch-geographische Studie*. Prag: F. Tempsky, 1877.
- JIREČEK, Constantin. *Geschichte der Serben*. Erster Band (bis 1371). Gotha, 1911.
- JIREČEK, Constantin. *Geschichte der Serben*. Zweiter Band, erste Hälfte (1371-1573). Gotha, 1918.
- STRZYGOWSKI, Josef. *Altai-Iran und Völkerwanderung: Ziergeschichtliche Untersuchungen über den Eintritt der Wanderer- und Nordvölker in die Treibhäuser geistigen Lebens, anknüpfend an einen Schatzfund in Albanien*. Leipzig: J. C. Hinrichs’sche Buchhandlung, 1917.

- KNAUT, Matthias & QUAST, Dieter (ed.). *Die Völkerwanderung: Europa zwischen Antike und Mittelalter*. Stuttgart: Theiss, 2005.
- MALCOLM, Noel. *Kosovo: A Short History*. London: Macmillan, 1998.
- MEKSI, Aleksandër. “Të dhëna për historinë e hershme mesjetare të Shqipërisë (fundi i shek. VI - fillimi i shek. XI)”. *Iliria*, nr. 1 (1989): 109-136.
- MOMMSEN, Theodor (ed.). *Chronica minora saec. IV, V, VI, VII*. Volumen II. *Accedunt tabulae duae*. Berolini: Apud Weidmannos, 1894.
- MIEROW, Charles Christopher (ed.). *The Gothic History of Jordanes*. In English version with an introduction and a commentary by Charles Christopher Mierow. Princeton: Princeton University Press, 1915.
- MÜHLE, Eduard. *Die Slawen im Mittelalter zwischen Idee und Wirklichkeit*. Wien; Köln; Weimar: Böhlau, 2020.
- NEOMARIO, T. H. *Geschichte der Stadt Rom*. Erster Band. Unveränderter Nachdruck der Originalausgabe von 1931. Frankfurt: Outlook Verlag, 2025.
- PLOETZ, Karl. *Auszug aus der alten, mittleren und neueren Geschichte*. 12., verbesserte Auflage. Berlin: A. G. Ploetz, 1898.
- POHL, Walter. *Die Avaren: Ein Steppenvolk in Mitteleuropa 567-822 n. Chr.* München: C. H. Beck, 1988.
- POLLO, Stefanaq & PUTO, Arben. *The History of Albania from Its Origins to the Present Day*. With the collaboration of Kristo Frashëri and Skënder Anamali. English translation by Carol Wiseman and Ginnie Hole. London; Boston; Henley: Routledge & Kegan Paul, [s.a.].
- STADTMÜLLER, Georg. *Geschichte Südosteuropas mit 23 Karten und einem Anhang*. München: R. Oldenbourg, 1950.
- SPAHIU, Hëna & DAMJAN, Komata. “Shurdhahu – Sarda qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar (Rezultatet e gërmimeve të viteve 1967-1970)”. *Në Iliria*, nr. 3 (1974).
- STRZYGOWSKI, Josef. *Altai-Iran und Völkerwanderung*. Ziergeschichtliche Untersuchungen über den Eintritt der Wanderer- und Nordvölker in die Treibhäuser geistigen Lebens, anknüpfend an einen Schatzfund in Albanien. Leipzig: J. C. Hinrichs'sche Buchhandlung, 1917.
- SZMONIEWSKI, Bartłomiej Szymon. “The Antes: Eastern ‘Brothers’ of the Slavenes?” *Në Florin Curta* (Hrsg.), *Neglected Barbarians*. Turnhout: Brepols, 2010.
- ŠUFLAJ, Milan. *Serbët dhe Shqiptarët*. Përktheu nga kroatishtja Hasan Çipuri. Tiranë: Toena, 2004.

- EVANS, Arthur J. *On the Roman Town of Doclea in Montenegro*. Westminster: Nichols and Sons, 1896, 19.
- THËNGJILLI, Petrika. “Dyndjet e mëdha (barbare) të popujve”. Në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*. Botim i ri, vëll. I: A–Gj. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008, 562-563.
- ZINKEISEN, Johann Wilhelm. *Geschichte Griechenlands vom Anfange geschichtlicher Kunde bis auf unsere Tage*. Erster Theil. Leipzig: Johann Ambrosius Barth, 1832.

ASSOC. PROF. DR. EDMOND MALAJ

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edmondmalaj@yahoo.de

S u m m a r y

“MIGRATION OF “BARBARIAN” PEOPLES IN ILLYRIA
DURING THE 4TH-7TH CENTURIES”

This study examines the incursions of the so-called “barbarian” peoples into Illyricum between the fourth and seventh centuries, a period marked by profound political, demographic, and cultural transformations in the Balkans. The analysis focuses on the movements of the Goths, Huns, Avars, early Bulgars, and particularly the Slavs, and their impact on the provincial structures of the Eastern Roman Empire. The research is based on Byzantine and Latin narrative sources, modern historiography, and available archaeological evidence that helps reconstruct these historical processes. It argues that the earliest incursions were largely predatory and destabilizing, while from the sixth century onward they increasingly involved patterns of permanent settlement, especially in the case of the Slavs. These developments led to major changes in the ethnic and social composition of the region. The study concludes that the migrations were not merely episodes of destruction, but a decisive factor in the transformation of the Balkans from Late Antiquity to the medieval world.

Keywords: Migration period, Illyricum in Late Antiquity, goths, huns, avars, slavic migrations in the Balkans, Byzantium.

AKAD. PROF. DR. PËLLUMB XHUFİ

Akademia e Shkencave e Shqipërisë
pxhufi@gmail.com

**ARMANËT E SHASIT
(SHEK. XV-XVI)****Abstrakt:**

Historia e familjes Armani, nga bashkësia territoriale e Pamaliotëve pranë qytetit të Shasit, mishëron fatet e bujarisë së vogël shqiptare në vitet e sundimit të Balshëve të fundit, kur qytetet e territoret e principatës së tyre rrekeshin t'i merrnin Republika e Venedikut, despoti serb Stefan Lazareviç e, në fund, edhe turqit osmanë. Konstatimi i parë që bëhet pas njohjes me dokumentacionin është se, në të njëjtën periudhë kohore, tre nga krerët kryesorë të Pamaliotëve – Dukë Leti, Nikë Armani dhe Pjetër Nika – mbështesnin përkatësisht Balshën III, Republikën e Venedikut dhe despotin serb Stefan Lazareviçin. Ky fakt mbështet të dhënat dokumentare, të cilat i paraqesin Pamaliotët si një bashkësi të pakonsoliduar, e krijuar vonë mbi bazën e mbledhjes në të njëjtin territor të fiseve dhe familjeve të ardhura nga vise të ndryshme. Pas ekzekutimit të Dukë Letit nga venecianët, të cilët e akuzonin atë si mbështetës të Balshës III dhe si shkaktar të kryengritjeve kundër sundimit venecian, si dhe pas vdekjes së Balshës, vojvoda i ri i Pamaliotëve, Nikë Armani, dëshmohej si përkrahës i Republikës kundër despotit serb Stefan Lazareviç. Nika, familja dhe të besuarit e tij u vendosën në zotërimet veneciane, fillimisht në Shkodër, ku dëshmohen si kalorës në shërbim të kont-kapitenit venecian. Pas pushtimit të saj nga turqit osmanë, më 1479, ata u vendosën në Ulqin, ku u bënë pjesë e patriciatit të qytetit. Pushtimi i Ulqinit nga osmanët në vitin 1571 shkaktoi një valë të re migrimi të Armanëve drejt Venecies dhe zotërimeve të saj në Istrië. Burimet e shek. XVI-XVIII evidentojnë pinjollë të Armanëve që vijonin të jetonin në Shkodër, Ulqin e rrethinat e Shasit. Kjo familje ka lënë kujtimin e saj edhe në emrin e lagjes “Rmajë” të organizuar rreth kishës së Shën Kollit. Kjo lagje përmendet në shek. XVII-XVIII me emrin ende të pakontraktuar Armani (Ermani, Ermanji).

Fjalë kyçe:

Mal, bashkësi, kont-kapiten, vitet 1421, 1479, 1571, vojvodë, despot, koncesion, kalorës, Senat, pronjë, detyrim, sekuestrim, patric, abat, ipeshkëv, emigrim.

Në burimet e shek. XV-XVII flitet shpesh për bashkësinë shqiptare të Pamaliotëve, e vendosur në Tejbunë, në rrethinat e qytetit të Shasit.¹ Sipas Šufflay-t, emri *Pamaliot* është i prejardhur nga fjala *mal*, prej së cilës janë formuar edhe mbiemrat *malok*, *malësor*, të dëshmuara në burimet e shek. XIV-XV.² Në vitin 1376 shënohet prania e një noteri nga Ulqini, i quajtur *Lazarus Malliocus*, ndërsa në vitin 1416, administrata e kadastrës veneciane regjistronte në fshatin Grizhë të Malësisë së Madhe dy pronarë me emrat *Petro dhe Teodor Malisori*.³ Mbi këtë bazë, Šufflay ka ndërtuar antinominë *pa-malok*, *ne-malok*.⁴ Gjithsesi, në rastin e fjalës së prejardhur *pamaliot*, duket më e ngjashme antinomia *pamaliot – memaliot* (ata pa mal - ata me mal) e cila pasqyron kundërvënien mes një shoqërie bujqësore të fushës dhe asaj blegtorale të malësisë. Këtyre të fundit, mali, me pyjet e kullotat e tij, u ofronte lëndë drusore, gjah dhe, mbi të gjitha, kullota të pasura për bagëtinë në stinën e verës, kur blegtorët mblidhnin frytet e punës së një viti të tërë: qumështin, leshin e mishin e bagëtisë. Ky do të ishte rasti i banorëve të *Anamalit*, një terren fushor që shtrihet pikërisht *anës malit*, mes rrjedhës së mesme të Bunës dhe pikës ku shkrihen e kthehen në fushë dy sisteme kodrinoro-malore paralele, me shtrirje veriperëndim-juglindje: ai i Shalësit dhe ai i Krajës, i pari përgjatë bregdetit Adriatik, i dyti përgjatë bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës. Ndryshe nga Kraja, vargu i lartësive të Shalësit zbret

¹ Një përshkrim të zonës në vitin 1711 e jep ipeshkvi i Shkodrës, Antonio Babbi: Peter Bartl, *Albania Sacra: Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 5: Diözese Skutari* (Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2021), 290, 315.

² M. Šufflay, *Historia e shqiptarëve të Veriut. Serbët dhe shqiptarët* (Prishtinë: Rilindja, 1968), 31-32.

³ *Po aty*, 31; I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417* (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1977), 296.

⁴ Šufflay, *Historia e shqiptarëve të Veriut*, 31.

dhe shkrihet në fushë shumë përpara se t'i afrohet bregut të Bunës në rrjedhjen e saj të poshtme. Kështu, Shasi dhe rrethinat e tij, ku shtrihej vendbanimi i Pamaliotëve, ndodheshin në një terren krejtësisht fushor. Banorët e tij, të *pamalët*, pra *pamaliotët*, konsideroheshin të pafat në krahasim me ata që ishin *me mal*, pra me ata që banonin në malësi ose anë saj (Anamal), të cilët i siguronin mjetet e jetesës kryesisht nga blegtoria. Në këtë kuptim, do ta konsideronim si antonim të saktë të emrit *pamaliot* emrin *memaliot*, siç quhen banorët e Memaliajt afër Tepelenës, lokalitet në këmbë të malit të Shëndëllisë, i dëgjuar për kullotat e tij verore. Me gjasë, nga sintagma *me mal* rrjedh edhe emri i fshatit *Mámël*, në hinterlandin malor të Tiranës, e gjithashtu toponimi *Mamël* në hyrje të Gjirit të Kotorrit,⁵ në një brez me prani të dendur shqiptare gjatë Mesjetës, që shtrihej prej aty deri në Kotorr dhe Perast.⁶ Raguzanët, tregtarë dhe njohës të pashoq të këtyre hapësirave, e quanin në vitin 1403 këtë brez jugor të Gjirit të Kotorrit “brezi i Arbërve” (*banda de Albanexi*), ndërsa bregun verior të atij gjiri e quanin “brezi i Sllavëve” (*banda di Sclavi*).⁷

⁵ G. Modrić, *La Dalmazia Romana. Note e ricordi di viaggio* (Roma: L. Roux, 1892), 335.

⁶ P. Xhufi, *Voskopoja e bota përreth* (Tiranë: Dituria, 2025), 218-219. Në Perast ndeshet edhe më 1732 një person i quajtur Nicolò Mamoli: *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASVe), *Cinque Savi alla Mercanzia. Lettere Consoli: Durazzo*, b. 662: 27 tetor 1732.

⁷ G. Gelcich, L. Thalloczy, *Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae cum Regno Hungariae* (Budapest: M. Tud. Akadémia, 1887): 11 dhjetor 1403, 148. Atë vit, raguzanët u përpoqën të hynin në tratativa “me shqiptarët e Lusticës” (*tractar cum li Albanexi de Lustiza*), në mënyrë që me ndihmën e tyre të mbyllnin hyrjen e “anijeve armike” në Gjirin e Kotorrit (*po aty*, 146). Lustica, me portin e saj Porto Rosa, ishte kepi që, nga ana jugore e Gjirit të Kotorrit, së bashku me kepin e Kanalit (Chelm) në anën veriore të tij, asokohe nën kontrollin e Raguzës, bllokonte hyrjen në atë gji. Në vitin 1420, pasi morën Kotorrin, venecianët ngritën një stacion të dytë ushtarak në vendin e quajtur *Scoglio de li Stradiotti*, afër Kotorrit, që përfaqësonte mburojën e fundit përpara se anijet apo trupat armike t'i afroheshin qytetit, përkatësisht nga deti ose nga rruga tokësore që i qasej Kotorrit pasi përshkonte krahinën e Zhupës së Gërballit. Ky është pikërisht kufiri që përcaktonte, qysh në shek. X, Perandori bizantin Kostantin Porfyrogeneti, dhe që ndante sllavët tërbunjtë, zaklumë e kanalitë të vendosur në veri të Gjirit të Kotorrit që në shek. VII, nga popullsia autoktone e Dioklesë, në jug të tij (Const. Porphyrogeniti, *De administrando imperio*, Greek Text: G. Moravcsik, Engl. Translation: R. J. Jenkins (Budapest: Egyetemi Görög Filológiai, 1949), 144, 162; Constantin Jireček, *Geschichte der Serben* (Gotha: Friedrich Andreas Perthes, 1911), 117-119; B. Ferjančić, “Dolazak hrvata i srba na balkansko

Si të gjitha bashkësitë, që nga fundi i shek. XIV dëshmohen në fashën mes Gjirit të Kotorrit, në veri, dhe derdhjes së Bunës, në jug, me Gërballët e Zhupës, Poborët, Mainët, Pastrovikët, Mërkoet, Pobratët, Krutat (Krythat), Burrëmirët, edhe Pamalioët përfaqësonin një bashkësi territoriale të krijuar nga fise, grupe familjare, fshatra e katunde të zbritura nga viset e brendshme malore.⁸ Në vitet e invazionit osman, edhe Pamalioët u shpërndanë sa në drejtim të Shkodrës aq edhe në atë të Ulqinit e, përfundimisht, në drejtim të Istries. Por vatra e tyre ndodhej në rrethinat e Shasit, në fshatrat *Calesena* (sot: Klezna) dhe *Bria*.⁹ Në shek. XVII, hartografi P. M. Coronelli, në hartën Corso delli fiumi Drino e Boiana, e shënon emrin e këtij fshati të fundit edhe në përkthimin italisht: Bria ose Corni (*Bria ò Corni*).

Në vitet e konfliktit të gjatë, 1404-1421, mes Balshës III dhe Republikës së Venedikut, e cila synonte t'i rrëmbente atij zotërimet historike të familjes, përkatësisht Shkodrën, Drishtin, Lezhën, Ulqinin,

poluostrovo,” ZRVI, 35 (1996): 139; Neven Budak, “Die südslawische Ethnogenesen an der östlichen Adriaküste im frühen Mittelalter,” në *Typen der Ethnogenese unter besonderer Berücksichtigung der Bayern*. Berichte des Symposions der Kommission für Frühmittelalterforschung, 27. bis 30. Oktober 1986, vol. I (Wien: Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 1990), 131 e vijim; M. Eggers, “Das De administrando Imperio des Kaisers Konstantinos VII Porphyrogenetos und die historisch-politische Situation Südosteuropas im 9. und 10. Jahrhundert,” *Ostkirchliche Studien* nr. 56 (2007): 40; Marin Tadin, “Les Arbanitai des chroniques byzantines, XI^e –XII^e s.,” *Actes du XVe Congrès International d'Études Byzantines*, IV: Histoire (Athènes: [na] 1980), 327-330).

⁸ Në rastin e Pamalioëve, bashkësisë më të madhe dhe më heterogjene, me shtrirje mes Tivarit e Budvës, Senati i Venedikut shprehet qartë në vitin 1435: “Na përkasin neve të gjithë Pastrovikët e Rezevikët, të cilët kanë zbritur nga malet e Cërnegorës, dhe bashkë me Pastrovikët e Rezevikët edhe katundet e Lastuas, si dhe të tjera fshatra, të cilët formojnë bashkësinë e Pastrovikëve” (*habere debemus omnes Pastrovichios et Resevichios, qui descenderunt de monte Zarnagore, unde descenderunt omnes Pastrovichii, Resevichii et Catuni de la Stua* (Lastua - P. Xh.) *et alie ville, que ad suorum Pastrovichiorum se congregant*), Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV* (më tej: AAV), pars II, tomus 15 (München: Rudolf Trofenik, 1972), nr. 3669: 28 maj 1435; Nicolae Jorga, “Notes et extraits pour servir à l’histoire des Croisades au XVe siècle,” *Revue de l’Orient Latin*, VI (1898): 137.

⁹ Giuseppe Valentini, “L’elemento vlah nella zona scutarina nel sec. XV,” në *Südosteuropa unter dem Halbmond* (München: Trofenik, 1975), 270; Bartl, *Albania Sacra*, 290, 315.

Tivarin e Budvën, Pamaliothët kishin mbështetur princin shqiptar.¹⁰ Ndërkohë, Durrësi i ishte dhënë Venedikut në vitin 1392 nga zoti i qytetit, Gjergj Topia, i cili veproi nën presionin e patriciatit të qytetit, të përfaqësuar nga Andrea Muzaka, Progon Skura, Andrea Nesha dhe vëllai i tij, Dhimitër Nesha, ipeshkëv i Arbrit etj.¹¹ Lezha, gjithashtu, iu dorëzua venecianëve nga Dukagjinët, të cilët në atë kohë ishin zotërit e saj.¹² Më 1405, Republika ia rrëmbeu Balshës III Shkodrën, Drishtin, Ulqinin e Tivarin falë ndihmës së krerëve Dukagjinë, Zaharia e Jonima.¹³ Në rastin e Drishtit, venecianëve u dhanë një ndihmë të çmuar ipeshkvi i qytetit dhe abati i manastirit të Shën Gjonit, ndaj të cilëve Balsha III u hakmor duke u hedhur prangat.¹⁴ Kurse, për shtënien në dorë të Tivarit e të Ulqinit, evidentohet mbështetja që i dhanë Republikës së Venedikut familjet patrice Boriçi¹⁵ e gjithashtu Izari¹⁶ të Tivarit, e njëherësh bashkësia e Pobratëve në Tejbunë. Këtu, vëllezërit Aleks e Pjetër Pobrat, kishin ngritur krye kundër Balshës III dhe bashkë me burrat e bashkësisë iu betuan për besnikëri Republikës. Venecianët mendonin se shembulli i Pobratëve, të cilët ishin ngritur të parët kundër Balshës, do të tërhiqte edhe bashkësitë e tjera të asaj ane, duke qenë se ata “përfaqësoheshin nga gjini të shumta”.¹⁷ Atëkohë, në verën e vitit 1407, Senati i Venedikut

¹⁰ “Cum occasione novitatis noviter attentate per Ypamaliothi... contra honores et statum nostrum,” Valentini, AAV, tom 6, nr. 1546, f. 42: 5 maj 1410.

¹¹ *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), (ed.) L. Thalloczy, C. Jireček, M. Šufflay, vol. II (Vindobonae: Adolf Holzhausen, 1918), nr. 496.

¹² *Po aty*, 501.

¹³ Valentini, AAV, pars I, tom 3, nr. 759; Injac Zamputi, Luan Malltezi (përg.), *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, vëll. I (1400-1405)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1987), nr. 260, f. 336-338.

¹⁴ Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades au XV siècle*, I^{re} série (Paris: Ernest Leroux, 1899), 310.

¹⁵ “el venerabel miss. Pater Mathio Boris, zentilhomio di questa terra...per optimi sui comportamenti et di suo progenitori, i qual anno dato el castello de Antivari in man dilla Ill.ma Sig.”, ASVe, *Capi Cons. Dieci: Lettere di Rettori e di altre cariche*, busta 274: Tivar, 24 qershor 1503; ASVe, *Senato Mar*, reg. 17, c. 86v: 12 mars 1510.

¹⁶ “miei maggiori quali diedero nelli passati aquisti Dolcegno et Antivari, mie infelici patrie, nel poter di questo Ser.o Dnio”, ASVe, *Senato Mar*, filza 51: in Pregadi, 10 mars 1572.

¹⁷ “ipsi conduxerunt omnes homines dicte contrate de Proprat ad obedienciam dominationis nostre, qui fuerunt gentes multe”, Valentini, AAV, pars II, tom 5, nr. 1273: 9 gusht 1407.

deklaronte se Balshës III vijonin t'i qëndronin besnikë vetëm vëllezërit Llesh e Gjergj Gjurashi (më vonë: Cërnojeviç), zotër të Zetës së Epërme.¹⁸

Në gusht 1407 flitet për herë të parë për kreun e Pamalioëve, *Dukë Letin*, i cili ishte lidhur me venecianët dhe ishte vendosur në Shkodër (*moratur in Scutaro*).¹⁹ Me siguri, ai ishte integruar në sistemin venecian të *pronjës*, i cili konsistonte në dhënien në përdorim të fondeve të caktuara të tokës kundrejt detyrimit të përfituesit për të kryer shërbim ushtarak në favor të Republikës. Në fakt, më 22 qershor të atij viti, mbi anijen e tij në lumin Buna, në vendin e quajtur Shën Teodor, Dukë Leti kishte nënshkruar me kapitenin e flotës së Adriatikut, Marin Caravello një marrëveshje, sipas së cilës, kreut të Pamalioëve i njiheshin të gjitha pronat që zotëronte deri atëherë, si dhe i jepeshin si pronjë fshatrat Muriqan e *Betigaret*, të cilat do t'i shfrytëzonte për sa kohë do t'i qëndronte besnik dhe do t'i shërbente Republikës së Venedikut".²⁰ Gjithashtu, ai do të merrte një pagë prej 25 dukatësh në muaj. Në këmbim, Dukë Leti do t'i dorëzonte Sinjorisë të dhjetat e korrijeve dhe të të ardhurave nga pronjat në fjalë, si dhe në kohë lufte duhej të mbante në gatishmëri një trupë prej 10 kalorësish, që do të luftonin për llogari të Republikës.²¹

Me Dukë Letin e Pamalioëve, në krahun e Venedikut kishte kaluar edhe kreu i Pobratëve, Pjetri. Vëllai i këtij të fundit, Aleks Pobrati, e pagoi rëndë tradhtinë ndaj Balshës III. Gjatë një beteje, Aleksi u zu rob dhe u çua i lidhur përpara ish-zotit të tij, i cili urdhëroi t'i priteshin në vend hunda, gjuha dhe njëri krah.²² Nga ana tjetër, venecianët kishin bërë

¹⁸ "quia non remanebunt Balse alii, quam Alexius Juras et Georgius Juras fratres", G. Valentini, AAV, tom 5, nr. 1274: 9 gusht 1407; Shih për këtë edhe: Pëllumb Xhufi, "Albansko-crnogorska podudaranja u srednjem vijeku," në *Balšići*. Zbornik radova sa skupa *Balšići* Ivanova Korita, 21-22. septembra 2011 (Cetinje-Podgorica: Matica Crnogorska, 2012), 211-242.

¹⁹ Valentini, AAV, pars II, tom 5, nr. 1272: 9 gusht 1407.

²⁰ "ser Marinus concessit dicto Duchaleto quicquid possidebat usque tunc, et ultra hoc concessit villam de Murichano et villam de Betigaret que omnia debeat tenere quousque fecerit et operatus fuerit ea que sint honoris dominationis nostre", po aty, nr. 1306: 10 nëntor 1407.

²¹ "durante guerra in illis partibus... tenendo ipsum equos decem ad servicia nostra", po aty.

²² "captus fuit et ductus ad presentiam Balse, qui fecit sibi abscidi nasum et linguam, et amputari unam manum", po aty.

të qartë në mënyrë të përsëritur se krerët e Pamalioëve dhe të Pobratëve u duheshin jo si individë, qoftë edhe të shoqëruar nga pak njerëz të afërt, por si udhëheqës që duhej t'i shërbenin Republikës duke bërë për vete të gjithë anëtarët e bashkësive të tyre.²³ Por duket se krerët në fjalë e kalonin kohën pa bërë gjë në qytetin e Shkodrës, së bashku me shpurat e tyre, duke i kushtuar jo pak arkës së shtetit venecian.²⁴ Në korrik 1409, kont-kapiteni i Shkodrës, Laurentius Superantio, i dërgoi Senatit një faturë mjaft të ngarkuar të shpenzimeve të bëra nga Dukë Leti “për misionet e fshehta kundër Balshës, që i ishin ngarkuar atij nga kont-kapiteni venecian Laurentio”, si edhe “për të ngrënat e të pirat e tij e të trimave të tij” gjatë kohës së qëndrimit në Shkodër.²⁵ Në nëntor 1407, Senati urdhëroi që vëllezërit Aleks, Pjetër e Mark Pobratit të detyroheshin të linin Shkodrën dhe të ktheheshin në vendin e tyre (*repatriando*).²⁶ Më herët, në muajin gusht të atij viti, Senati i Venedikut i kishte dorëzuar Dukë Letit 100 dukatë, që ai duhej t'i shpërndante për ta shkëputur bashkësinë e tij të Pamalioëve prej Balshës III dhe për ta futur atë nën hijen e Republikës.²⁷ Mirëpo, duket se Dukë Leti e kishte humbur autoritetin mbi bashkësinë e tij, e cila vijonte të refuzonte të njihte pushtetin venecian.

Shkelja e njëanshme e marrëveshjes së vitit 1408 nga ana e Venedikut e shtyu Balshën të kalonte në sulm. Në verën e vitit 1409 e gjithë treva e Shkodrës u përfshi nga një kryengritje e armatosur, e cila iu bashkua përpjekjeve të Balshës III për t'u rimarrë venecianëve zotërimet historike të familjes së tij.²⁸ Mes popullsisë të hedhura në kryengritje

²³ “*ad reducendum Pamalios et illos de Proprat sub honore et obedientia nostri domini*”, po aty, nr. 1300: 25 tetor 1407.

²⁴ “*quidam qui vocatur Duchaleti et est caput de Pamalios, moratur in Scutaro*”, po aty, nr. 1272: 9 gusht 1407.

²⁵ “*item Ducaleto et sociis, qui secrete tractabant negotia imposita eidem ser Laurentio per nostrum dominium pro factis Balse...e per pan e vin disnari e cene fate a un clamado Duchaleto e suo compagni*”, po aty, nr. 1447: 26 korrik 1409, ku paraqet faturën e shpenzimeve ekstra të Dukë Letit gjatë mandatit të tij.

²⁶ Po aty, nr. 1307: 10 nëntor 1407.

²⁷ “*ut sit promptior et magis dispositus ad reducendum suam societatem ad obedienciam nostram*”, po aty, nr. 1272: 9 gusht 1407.

²⁸ Po aty, nr. 1450: 29 qershor 1409.

ishin edhe Pamalioët e Tejbunës.²⁹ Nga letërkëmbimet mes Senatit dhe qeveritarëve venecianë në Shqipëri mësohet se në pranverë-verën e vitit 1410 Balsha III kishte rrethuar Shkodrën “si nga toka, ashtu edhe nga liqeni me anë të flotës” (*tam per terram, quam per aquam, faciendo armatam in lacu*).³⁰ Me Balshën u bashkua atëkohë edhe shtresa e pronjarëve, të cilët ishin shqetësuar nga lajmet për sekuestrimin e pronjave të tyre nga ana e autoriteteve veneciane.³¹ Siç mësohet, në krye të atij rebelimi ishte pikërisht kreu i Pamalioëve, Dukë Leti. Këtë ia njoftonte Senatit më 15 korrik 1410 kont-kapiteni venecian i Shkodrës, Benedikt Contareni. Sipas tij, kreu i Pamalioëve, të cilin ai e mbante nën vëzhgim prej kohësh, ishte organizator i revoltës dhe, për këtë arsye, në atë datë, Dukë Leti u arrestua, u gjykua dhe u ekzekutua pas një gjykimi të shpejtë.³² Qeveritari i Shkodrës kishte mbajtur edhe djemtë e mitur të krerëve të kryengritjes dhe i kishte nisur ata si pengje në Venecie. Mes tyre ishte edhe djali 11-vjeçar i Dukë Letit.³³ Më 14 shkurt 1411, në zyrën e avokatit të shtetit në Venecie u paraqit e veja e Dukë Letit, Vlada, e cila, tej mase e irrituar, protestoi ashpër kundër kont-kapitenit të Shkodrës, Benedikt Contareni, “të cilin e akuzoi, se kundra Zotit, kundra së Drejtës dhe kundra vetë Drejtësisë, kishte dënuar me vdekje të pamerituar të shoqin e saj, Dukë Letin, duke akuzuar si tradhëtar

²⁹ “*occasione novitatis noviter attentate per Ipamaliothi districtuales nostros in Saboiana contra honores et statum nostrum*”, Valentini, AAV, tom 6, nr. 1546: 5 maj 1410.

³⁰ *Po aty*, nr. 1527: 15 mars 1410; *po aty*, nr. 1589: 19 gusht 1410.

³¹ “*principalis causa rebellionis paesii fuit dubium quod habuerunt pronarii de essendo extracti de suis proniis*”, *po aty*, nr. 1589: 19 gusht 1410.

³² *Po aty*, nr. 1571: 15 korrik 1410.

³³ Nëna e kësaj fëmije shkoi deri në Venecie, u paraqit para Senatit “dhe me lot në sy u lut që t’i kthehej djali sepse ai ishte i pafajshëm e nuk ishte e drejtë që ajo foshnjë të dënohej për shkak të fajeve të të atit” (*de gratia lacrimabiliter supplicans, quod dictus puerulus filius suus sibi restituitur, considerato quod est innocens nec debet ex culpa patris damnari*), *po aty*, nr. 1571: 15 korrik 1410. Më 22 gusht 1410, Senati urdhëroi që edhe djali tjetër, ai i Dukë Letit, të mos internohej në Kretë, siç propozonte Contareni, por të mbahej në Venecie. Dhe, meqë ishte i vobektë, i pangrënë e i paveshur, “aq sa rrezikonte të vdiste nga të ftohtit dimrin e ardhshëm”, Senati urdhëroi që për mbajtjen e tij të shpenzoheshin 10 dukatë ari: “*et est quasi nudus et in yeme ventura est periturus frigore, nisi aliter provideatur de eo...et considerato quod non permittamus ipsum redire domum suam, dentur sibi, seu dispensentur pro eo ducati decem auri in illis rebus que utiles pro eo videbuntur*”. *Po aty*, nr. 1590: 22 gusht 1410.

pikërisht atë, burrin e saj, që tërë jetën kishte qenë një shërbëtor besnik e i sprovuar i Republikës”.³⁴ Familja e saj, pas ekzekutimit të të shoqit dhe sekuestrimit të pasurive të familjes nga ana e venecianëve, ishte zhytur në varfëri të thellë.³⁵ Për të tërhequr djalin e saj, i cili vijonte të mbahej peng në Venecie edhe pas ekzekutimit të të atit, Vlada ishte zhvendosur prej disa muajsh në atë qytet, ku, siç kishte deklaruar, jetonte falë ndihmës që i jepnin disa venecianë zemërmirë. Nisur nga gjendja e dëshpëruar në të cilën ndodhej pas ekzekutimit të të shoqit, ajo i paraqiti Senatit dëshminë e pajës që kishte sjellë kur ishte martuar me Dukë Letin. Bëhej fjalë për shumën e 781 hiperperëve dhe për disa sende të tjera, të cilat ishin sekuestruar pas dënimit të të shoqit dhe që ajo kërkonte t’i ktheheshin. Në këtë rast, Senati mbajti anën e së vesë së “tradhëtarit” Dukë Leti dhe urdhëroi që shuma bashkë me sendet e tjera t’i ktheheshin të zonjës, pasi “Sinjoria asnjëherë nuk kishte lejuar që gratë të privoheshin nga paja e tyre”.³⁶

³⁴ “*coram advocatoribus nostri comunis et offitio suo comparuit Vlada, relicta Duchaleti cum querella et gravi querimonia exponens contra et adversus virum nobilem Benedictum Contareno...asserens contra Deum, Jus et Justitiam justificari fecisse, et morte vituperabili mori fecisse ipsum Duchaletum tanquam proditorem nostre dominationis, existentem fidelem et legalem servitorem domini nostri*”, po aty, nr. 1636: 14 shkurt 1411. Në fakt, i informuar për abuzimet dhe sjelljet e vrazhda të kont-kapitenit Contareni, si dhe në përpjekje për të qetësuar gjendjen shpërthyesë të krijuar në trevën e Shkodrës, edhe për shkak të veprimeve të tij arbitrare, Senati e kishte shkarkuar nga detyra e qeveritarit të Shkodrës qysh para muajit gusht 1410 (po aty, nr. 1589: 19 gusht 1410).

³⁵ “*sicut notum est, Comes et Capitaneus noster Scutari, ser Benedictus Contareno, justificari fecerit quendam Ducaletum rebellem et proditorem nostrum et omnia sua bona confiscari*”, po aty, nr. 1601: 29 shtator 1410. Veç fshatrave Muriqan, Betigaret e Bolkia, Dukë Leti kishte përfutur edhe një vresht në kodrat e gjirit Vallenocë, mbi Ulqin, të cilat, pas ekzekutimit të tij, pretendoi t’i rimerrte ish-pronari, Jak Kolani nga Ulqini (*Jachi de Colanis de Dulcigno*), po aty, nr. 1642: 24 mars 1411.

³⁶ Valentini, AAV, tom 6, nr. 1601: 29 shtator 1410. Në vitin 1445 njihemi me rastin e një qytetari nga Ulqini, të cilit, vite më parë, Sinjoria i kishte sekuestruar të gjitha pronat, sepse kishte ngritur krye kundër Republikës. Po atë vit, djali i të dëmtuarit, Mateu, pretendonte t’i ktheheshin ato prona, “pasi në kohën kur i ati kishte ngritur krye, ai ishte fëmijë dhe nuk mund të mbante mbi shpinë fajet e tij”. Zgjidhja e çështjes vështirësohej nga fakti se pronat në fjalë i ishin dhënë nga komuna e Ulqinit pamalotit Nikolla Basani, njeri besnik i venecianëve, i cili po i shfrytëzonte ato prej një kohe shumë të gjatë. Nga ana tjetër, rezultonte që ato prona ishin pjesë e pajës që nëna e Mateut kishte sjellë kur ishte martuar. Kështu, për t’i kënaqur të gjithë dhe për të shmangur probleme të tjera në të ardhmen, Sinjoria vendosi që Mateu të zhdëmtuhej me vreshtin e pamalotit Benko Rosso (Rusi), i cili kishte kaluar në pronësi të komunës

Në fakt, Venediku ishte i interesuar të qetësonte gjendjen dhe të gjente mënyrën për t'i bërë përsëri për vete popullsitë kryengritëse. Më 5 maj 1410, Senati udhëzonte që “të faleshin pjesa më e madhe e tyre, duke përjashtuar krerët tashmë të arrestuar”.³⁷ Pas disa vjetësh, në fakt, Pamaliotët duken të integruar në sistemin venecian të mbrojtjes. Në vitin 1415, një person i quajtur Pal Gjini, i cili i kishte shërbyer me armë Republikës, u bë pronjar, duke u shpërblyer nga autoritetet veneciane me disa ara.³⁸ Po atë vit, Nikolla Pamalioti, luftëtar (*armiger, homo d'arme*) në Shkodër, u shpërblye nga Sinjoria për shërbimet e tij me disa ara dhe vreshta në Grishë e në fshatra të ndryshme përreth Shkodrës, të cilat, për hir të besnikërisë ndaj Republikës, iu konfirmuan edhe pas dy vjetësh.³⁹ Këto toka, të dhëna Nikollës në cilësinë e pronjës, i ishin sekuestruar një “tradhëtar” të Republikës, Pjetër Kojçinit (Kolgjinit).⁴⁰ Një tjetër pamaliot, Medon Armani, në vitin 1416 ishte kreu i fshatit Kazenë, pronar toke, si edhe prodhues e tregtar vere.⁴¹ Kështu, nën presionin e turqve dhe të despotit serb Stefan Lazareviç, Pamaliotët u rikthyen në besën e Venedikut. Marrëveshja e lidhur mes tyre parashikonte që ata të shërbenin si kalorës në trupat veneciane, për çka shpërbleheshin me pronja dhe me një pagë mujore.⁴² Në vitin 1423, Senati i Venedikut e çmonte lart trimërinë e Pamaliotëve në mbrojtjen e Shkodrës nga sulmet e despotit serb.⁴³

së Ulqinit pas vdekjes së Benkos në fjalë dhe të bijve të tij (Valentini, AAV, tom 19, nr. 5106: 8 qershor 1445). Tjetërsimi pa konsensus e testamenti i pajës së gruas, qoftë edhe nga i shoqi apo nga fëmijët e saj, ndalohej në mënyrë të prerë nga statutet e Shkodrës të vitit 1347. Shih: Lucia Nadin, *Gli Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469* (Roma: Viella, 2002), cap. 165.

³⁷ “*per maiorem partem eorum fuerit deliberatum reducere ad gratiam, de rebellibus nostris causa predicta, omnes vel partes eorum, non intelligendo tamen de principalibus neque de illis, qui iam forent capti, seu condemnati*”, Valentini, AAV, tom 6, nr. 1546: 5 maj 1410.

³⁸ *Po aty*, tom 7, nr. 1921-bis.

³⁹ *Po aty*, nr. 1951; *po aty*, tom 8, nr. 2045/87, 2132.

⁴⁰ *Po aty*, tom 8, nr. 2045/87, 90, 91, 93, 94-97: nëntor 1416 - dhjetor 1417.

⁴¹ *Po aty*, nr. 2021.

⁴² *Po aty*, nr. 2045/38-49 dhe 87-900.

⁴³ “*Pamalioi et alii...multum fuerunt favorabiles ut obtineremus intentionem nostram ad succurrendum civitati nostre Scutari*”, Valentini, AAV, tom 17, nr. 2702: 16 mars 1423.

Atëkohë, rolin drejtues të bashkësisë së Pamaliotëve e luajti familja Armani (rrallë edhe: *Armeni, Ermani, Ermanji, Hermannii*).⁴⁴ Në vitin 1416 dëshmohet i sipërthëni Medon Armani, banor i Shkodrës, i cili zotëronte fshatin Kazenë në rrethinat e Shasit dhe njëherësh ishte prodhues e tregtar vere.⁴⁵ Historia e marrëdhënieve të tij me Paolo Quirion, ish-kont e kapiten i Shkodrës, tregon se për të ruajtur statusin e tyre social dhe ekonomik, dinjitarët shqiptarë duhej, sigurisht, t'u shërbenin interesave të Republikës së Venedikut, por edhe të ulnin kokën përpara dhunës e prepotencës së qeveritarëve të saj në Shqipëri. Nën presionin e kont-kapitenit të Shkodrës, Medon Armani ishte detyruar të ndante nga bashkëshorti vajzën e tij, së cilës Quirini i kishte vënë syrin. Ai abuzoi për një kohë të gjatë me të duke e përdorur si konkubinë.⁴⁶ Në

⁴⁴ G. Valentini, ndonëse jo fort i bindur, hedh idenë se Armanët ishin me prejardhje vllahe (Valentini, "L'elemento vlah nella zona scutarina," 271, 274). Por, Armanët bënin pjesë në një bashkësi, atë të Pamaliotëve, që, siç kemi treguar në këtë punim, dokumentet e përcaktojnë rregullisht si "shqiptarë". Vetë Armanët cilësohen si të tillë. Burimet, veç atyre që janë cituar në këtë punim, tregojnë se ata jetonin në një mjedis ekskluzivisht shqiptar dhe se komandonin vetëm luftëtarë shqiptarë ("*Zorzi Armani... conducendo con lui molti Albanesi*", ASVe, *Senato Mar*, filza 80: 19 mars 1582; më 1575, "*Andrea Armani Albanese da Schutari*" deklaronte se në një rast "*sollevai in maggior parte essi Albanesi*" dhe në një rast tjetër e kishte ndihmuar Republikën "*deputandomi Albanesi, quindece in mia compagna*", ASVe, *Senato Mar*, filza 64: 22 tetor 1575. Shih edhe: ASVe, *Senato Mar*, filza 45: 2 korrik 1570, ku përmendet njëfarë Gjergj Armani bashkë me të tjerë persona, shqiptarë e katolikë, ndër të cilët Gjon Shkreli, Simon Kamsi, Mark Dabre, Gjergj Bushati, Lek Gjurko, Marin Mjekërmadhi, Dod Kruta, Gjon Leka, Kol Bardhi etj.). Nga ana tjetër, elementët vllah në dokumentacionin qoftë perëndimor, grek ose sllav, përcaktohen, si në gjithë Ballkanin, edhe në Shqipëri me termin "*Valachi, Βλάχοι, Vlasi*", si në këtë dokument të vitit 1417: "*I'è molte case sul terren de Scutari da la banda de sovra la quale se clama do Branci (Dobraç) e Vlach, e queste non paga ducato ne mozo ne obrocho perche non son gente stabelle, anzi son pegorari che va e vien e per questa casion non paga, ma se i semena in li terreni de Scutari i die pagar el diexiemo*". Ky pasazh, i cili i përshkruan vllahët si "njerëz që nuk paguajnë detyrime, sepse nuk qëndrojnë në një vend, por si barinj dhensh shkojnë e vijnë" nuk përputhet me statusin social të Armanëve. Këta të fundit i përkisnin aristokracisë së tokës, gjithnjë e më shumë të urbanizuar dhe të trajtuar si familje patrice sa në Shkodër, aq edhe në Shas e në Ulqin (Valentini, AAV, tom 8, nr. 2107/65; Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike, 1392-1479* (Tiranë: K&B, 2007), 205). Mbi familjen Armani, shih: Noel Malcolm, *Agjentë Perandorakë. Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shek. XVI* (Tiranë: Dudaj, 2016), 48-50.

⁴⁵ Valentini, AAV, tom 8, nr. 2021; Malcolm, *Agjentë Perandorakë*, 49.

⁴⁶ Malcolm, *Agjentë Perandorakë*, 49.

mënyrë që Armani të mos nxirrte në publik abuzimin e kont-kapitenit Quirini, ky i fundit i njohu atij të drejtën ekskluzive për të shitur verë me pakicë në tregun e Foletës, duke ndryshuar kështu dispozitën që lejonte cilindro tregtar ta ushtronte atë të drejtë.⁴⁷ Gjithsesi, kjo histori qarkullonte gojë më gojë mes qytetarëve të Shkodrës, të cilët e akuzonin kont-kapitenin venecian edhe për përfitime të paligjshme, veçanërisht për vendosjen e një detyrimi abuziv mbi çdo shtëpi, me pretendimin se shuma e mbledhur do t'i dorëzohej komandantit osman të Shkupit, në mënyrë që ai të mos sulmonte dhe të mos shkretonte viset e Shkodrës. Kështu, Senati u detyrua ta merrte në shqyrtim çështjen e kont-kapitenit të Shkodrës, i cili me sjelljet e tij “kishte rënduar e dëmtuar imazhin e Republikës, si dhe kishte përbaltur e mbuluar me turp qeverisjen e tij”.⁴⁸ Querini u pushua nga detyra dhe u privua nga e drejta të kryente në të ardhmen funksione publike në Shqipëri. Masa dhe vendime të marra prej tij u anuluan dhe, pasi u detyrua t'i paguante arkës së shtetit një shumë të hollash, Quirini u mbyll në burgun e Venecies për një periudhë gjashtëmujore.⁴⁹

Kur Shasi dhe vendi i Pamaliotëve kaluan nën juridiksionin e Venedikut në vitin 1421, tre vëllezërit Armani ia kaluan tokat dhe pasuritë e tjera Republikës. Më pas, ajo ua riktheu atyre një pjesë të këtyre zotërimeve në cilësinë e *pronjës*, të kushtëzuar me shërbim ushtarak. Si pronjarë,⁵⁰ Armanët detyroheshin të shërbenin në trupat e Republikës në krye të një grupi kalorësish, numri i të cilëve varej nga madhësia dhe cilësia e pronjave. Bëhet fjalë për një rikthim, *mutatis mutandis*, në sistemin bizantin të *pronjës* dhe të *pronjarit*, që kishte shënuar zhvillimin e marrëdhënieve feudale në Bizantin e shek. X-XI.⁵¹

⁴⁷ Valentini, AAV, tom 8, nr. 2021: 1 qershor 1416.

⁴⁸ “*committendo in magnum onus et infamiam dominacionis nostre ac in vituperium dedecus et infamiam dicti sui regiminis*”, po aty.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Në këtë mënyrë, shumë krerë fshatrash e bashkësish u transformuan në pronjarë. Ky status i ri u siguronte pronjarëve një dinjitet më të lartë, edhe për shkak të detyrave specifike luftarake që ata duhej të kryenin në këmbim të pronjave. Shih: Ivan Božić, “Proniarii et capita,” *Zbornik Radova Vizantoloski Institut*, VIII/1 (1963): 61, i cili citon: G. Ostrogorsky, *Pronija, prilog istoriji feudalizma u Vizantiji i u juznoslovenskim zemljama* (Beograd: 1951), 161.

⁵¹ Šufflay, *Historia e shqiptarëve të Veriut*, 49; David Jacoby, *La féodalité en Grèce médiévale. Les Assises de Roumanie* (Paris: Éd. Mouton et Cie, 1971), 248; Božidar Ferjančić, “Quelques significations du mot stratiote dans les chartes de basse

Pamaliotët luajtën një rol vendimtar në shpartallimin e trupave të despotit serb, të cilat gjatë vitit 1422 mbajtën nën rrethim Shkodrën.⁵² Në një dëshmi të mëvonshme, ipeshkvi i Shasit deklaronte se kishte qenë ai që, pas vdekjes së Balshës III, më 1421, kishte afruar me Republikën veneciane disa bashkësi, ndër to edhe Pamaliotët, që ndihmuan për t'ia rrëmbyer despotit serb Drishtin dhe mjaft territore të tjera në Zetë.⁵³ Këtë meritë ia atribuonte vetes edhe Jakob Seni, i cili, më 30 prill 1423, u paraqit përpara Senatit të Republikës së Venedikut si përfaqësues i komunës së Ulqinit. Në fjalën hyrëse, ai deklaroi se “kishte qenë faktori kryesor që arriti të bindë të viheshin nën autoritetin venecian Pamaliotët, me të cilët mori pjesë në betejën fitimtare të zhvilluar kundër armiqve sllavë që kishin sulmuar Shkodrën”.⁵⁴ Për këtë rol të pretenduar prej tij, Senati vendosi t'i lidhte ulqinakut një pension prej 100 dukatësh në vit, që do të paguhej nga zyra e financave në Shkodër. Një tjetër shumë prej 300 dukatësh u dërgua për t'iu shpërndarë krerëve të Pamaliotëve dhe të Trushëve, si shpërblim për trimërinë dhe për rolin e tyre në atë betejë.⁵⁵ Përkatësisht, provizione prej 300 e 200 dukatësh në vit iu premtuan edhe Gjon Kastriotit e Koja Zaharisë, me kusht që këta të mos ngrinin krye kundër Sinjorisë.⁵⁶

Gjithsesi, në vitin 1423, Pamaliotët dhe shqiptarë të tjerë të atyre viseve ishin vënë nën autoritetin e Republikës.⁵⁷ Atëkohë, drejtimin e bashkësisë së Pamaliotëve në rrethinat e Shasit e kishte marrë *vojvoda*,

Byzance,” ZRVI 21 (1982): 95-102; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit* (Tiranë: Pegi, 2006), 363-367.

⁵² “*Pamalioi... multum fuerunt favorabiles ut obtineremus intentionem nostram ad succurrendum civitati nostre Scutari*”, Valentini, AAV, tom 11, nr. 2702: 16 III 1423; *po aty*, nr. 2721: “... *Pamalios, cum quibus fuit ad obtentionem victorie et conflictus dati Sclavis inimicis nostris existentibus contra Scutarum*”.

⁵³ “*comparverit Reverendus pater dom. Paulus Episcopus Suacensis, exponens quod pro acquisitione Drivasti et locorum Zente se exercuerit pro nostro dominio reducendo Pamalios et multum paysium ad obedientiam*”, *po aty*, tom 18, nr. 4803: 11 prill 1443.

⁵⁴ “*fuit potissima causa reducendi ad nostram obedientiam Pamalios cum quibus fuit ad obtentionem victorie et conflictus dati sclavis inimicis nostris existentibus contra Scutarum*”, *po aty*, tom 11, nr. 2721: 30 prill 1423.

⁵⁵ *Po aty*, tom 11, nr. 2752: 29 qershor 1423.

⁵⁶ *Po aty*, nr. 2702: 16 mars 1423.

⁵⁷ “*pro illis Pamaliotis et aliis Albanensibus reductis ad obedientiam nostri dominii*”, *po aty*, nr. 2657: 7 janar 1423.

ose *kapiteni* Nikë Armani.⁵⁸ Nika, së bashku me Pjetër Rusin dhe të tjerë krerë pamaliotë, kishte ndikuar në lidhjen e bashkësisë së tyre me Republikën e Venedikut. Kjo i shpërbleu luftëtarët pamaliotë me pronja, të holla, si dhe me veshje, sigurisht “duke i favorizuar krerët me veshje më të shtrenjta se ato të Pamaliotëve të tjerë”.⁵⁹ Në shkurt të vitit 1424, Nika rezultoi i shpërngulur me familjen në Ulqin.⁶⁰ Një tjetër pronjar nga vendi i Pamaliotëve, Martin Gjini, ishte bërë pjesë e aristokracisë së Ulqinit.⁶¹ Ashtu si ai, edhe Armanët e vendosur në Ulqin në kohë të ndryshme, u përfshinë në patriciatin e Ulqinit, siç e dëshmojnë lidhjet e tyre familjare me familjet e para të qytetit, Brunët e Brutët.⁶² Martin Gjini, Nikë Armani e shumë Pamaliotë të tjerë kishin marrë si pronjë nga qeveritari venecian i Ulqinit, Françesk Goro, të gjitha pronat që iu konfiskuan “tradhëtarit” Nik Pjetër Gjinit.⁶³ Më vonë, e veja e Nikës, pasi pranoi se i ndjeri, burri i saj, e kishte pësuar “ngaqë qe shkëputur nga besa veneciane”, i lutej Senatit që ta mëshironte dhe t’i ktheheshin asaj e fëmijëve, të zhytur në varfërinë më të thellë, disa vreshta, 250 hiperperë që i shoqi ia kishte dhuruar në pajë, si edhe 140 dukatë të trashëguara pas vdekjes së të ëmës. Ajo e përfundonte lutjen e saj duke kujtuar se “Sinjoria e konsideronte të paprekshme pajën e gruas dhe, gjithashtu, nuk lejonte që gruaja të paguante për fajet e burrit”.⁶⁴

⁵⁸ Valentini, AAV, tom 12, nr. 2843: 20 janar 1424; ASVe, *Capi del Cons. de Dieci: Lettere Rettori*, b. 278: Ulqin, 17 qershor 1545.

⁵⁹ “*quod debeant ipsi Pamalioti indui ad expensas nostri comunis, sed capita de melioribus panis quam alii*”, Valentini, AAV, tom 12, nr. 2843: 20 janar 1424. Në Europën feudale, sigurimi i veshjes ishte një nga detyrimet kryesore të kryezotit ndaj vasalëve të tij, shih: M. Bloch, *La società feudale* (Torino: Einaudi, 1976), 85, 177; Pëllumb Xhufi, *Skënderbeu, ideja dhe ndërtimi i shtetit* (Tiranë: Dituria, 2019), 163.

⁶⁰ Valentini, AAV, tom 12, nr. 2868: 24 shkurt 1424.

⁶¹ *Po aty*, tom 19, nr. 5251.

⁶² Malcolm, *Agjentë Perandorakë*, 49.

⁶³ Valentini, AAV, tom 12, nr. 2986: 5 korrik 1425.

⁶⁴ “*cum quondam vir suus se retraxerit ab obedientia nostri domini vir nobilis ser Franciscus Guoro qui fuit Provisor Dulcigni fecit cuncta sua bona confiscari que ut videtur postea dispensavit inter Pamalios propter quam dispensationem dicta paupercula est privata aliquibus suis vineis et yperperis ducentis quinquaginta, quas et que quondam viro suo dedit in dotem, et ulterius privata est quadam dimissoria ducatorum centumquadragesima que sibi pervenerunt ex morte matris sue. Pro quibus supplicavit ut cum dominatio nostra semper fuerit consueta reservare dotes mulierum et nunquam voluerit mulieres portare iniquitatem virorum suorum,*

Në kuadrin e ndryshimeve që solli fitorja e aleancës veneto-shqiptare mbi despotin serb, më 3 shkurt 1424, Senati i Venedikut u rikonfirmoi vëllezërve Nikë e Gjergj Arman Pamalioti disa koncesione akorduar atyre nga venecianët në vitin 1422. Për më tepër, Senati vendosi t'u dhuronte atyre një shtëpi në qendër të qytetit të Shasit. Shtëpia i ishte sekuestruar fisnikut Pjetër Nika, i cili ishte dëbuar nga qyteti si mbështetës i despotit serb, Stefan Lazareviç.⁶⁵ Nikë Pamalioti bashkë me njerëzit e tij "mund të vinin e të banonin në atë shtëpi në rast se ndodhte që të dëboheshin nga fshati i tyre".⁶⁶ Ky saktësim i fundit provon se autoriteti i Nikës, ashtu si edhe ai i Dukë Letit para tij, nuk ishte i pakontestuar brenda përbrenda bashkësisë së Pamaliotëve. Fakti që ai vetë, si vëllai më i madh, ishte zhvendosur për të banuar në Ulqin, ndërsa synonte të merrte edhe në Shas një shtëpi, tregon se *vojvoda* Nikë e ushtronte autoritetin mbi Pamaliotët nëpërmjet vëllait të tij më të vogël, Gjergjit, i cili vijonte të banonte mes njerëzve të tij. Kështu, forca e vojvodë Nikë Armanit buronte kryesisht nga marrëdhëniet e privileguara që ai kishte krijuar me venecianët, zotër të Ulqinit, të cilët e kishin graduar si *kapiten* (vojvodë) me detyrë mbajtjen nën kontroll të territorit dhe të popullsisë përreth qytetit. Në këtë cilësi, bashkë me shtëpinë, Nikë Armanit iu dha në përdorim edhe një vresht, që gjithashtu i përkiste Pjetër Nikës. Venecianët i kaluan Nikë Armanit si pronjë edhe fshatin Bardhonjë, të cilin despoti Stefan Lazareviç ia kishte dhënë dikur një besniku të tij, "shkjaut Nikolla Zauli" (*Nicola Zauli sclavus*).⁶⁷

Nëse autoriteti dhe pasuria e Dukë Letit në fillimet e shek. XV u afirmuan falë pozicionimeve të tij oportune në konfliktin e zgjatur mes Balshës III dhe Venedikut, roli dhe rëndësia e Nikë Arman Pamaliotit në vitet pasardhëse u përcaktuan nga aleanca e tij me venecianët kundër despotit serb Stefan Lazareviç. Megjithatë, shumë shpejt, mes Venedikut dhe despotit serb Stefan Lazareviç u arrit një paqe, e cila u nënshkrua më 12 gusht 1423, "përballë kullës veneciane të Shirgjit". Marrëveshja i linte Republikës së Venedikut qytetin e Shkodrës me rrethina, Ulqinin,

dignemur sibi compati cum sit paupercula et vivat miserabiliter et habeat multos filios inter quos duas filias magnas", po aty.

⁶⁵ Po aty, nr. 2850: 3 shkurt 1424.

⁶⁶ "et si ipsi expelerentur de paesio habeant domum Petri de Nicho, que est ad plateam apud lobiam", po aty.

⁶⁷ Po aty; *I Libri Commemoriali della Repubblica di Venezia*. Regesti, tomo IV (Venezia: Istituto per gli Studi Adriatici, 1896), nr. 128, f. 47-48.

Kotorrin dhe gjithë territoret në krahun e majtë të rrjedhjes së Bunës. Nga ana tjetër, despoti Stefan Lazareviç dhe i nipi, Gjuraraj Brankoviç do të mbanin Tivarin, Budvën dhe Drishtin. Njeriu besnik i venecianëve, Andrea Humoj, pronjar i një fshati me 100 shtëpi në malësinë mbi Drisht, do të qëndronte nën varësinë e *vojvodës* së Drishtit, mëkëmbësit të Lazareviçit, të cilit do t'i shlyente edhe detyrimet. Ky status i ndërmjetëm i Humojt, mes Republikës dhe despotit serb, zot i Drishtit, do të vijonte derisa palët të binin në ujdi për një shkëmbim territoresh, me ç'rast Humojt do t'i jepej një pronjë e barasvlershme në zonën e Shkodrës. Më tej, kufiri mes zotërimeve të Venedikut dhe atyre të despotit serb ndiqte një vijë të qartë ndarjeje përgjatë rrjedhës së lumit Buna. Kjo shpallej zonë e çmilitarizuar dhe, si despoti në bregun verior të lumit, ashtu edhe Venediku në bregun jugor të tij, duhej të rrëzonin fortifikatat e ndërtuara gjatë viteve të luftës ndërmjet tyre. Palët duhej të kthenin të arratisurit nga territoret respektive dhe të lejonin lëvizjen e lirë të mallrave, pa u shkaktuar vështirësi e pengesa tregtarëve. Pronarët që zotëronin toka në territoret e huaja do të vazhdonin t'i gëzonin ato edhe më tej, duke i paguar, natyrisht, detyrimet shtetit përkatës. Përsa i përket bashkësisë së Pastrovikëve, që ndërkohë kishte pranuar sovranitetin venecian, statusi i tyre mbetej për t'u vendosur pas bisedimeve të mëtejshme. Megjithëse autoritetet veneciane u kishin premtuar Pastrovikëve e Pamalioëve se do t'i përfshinin edhe ata në një paqe eventuale me despotin serb,⁶⁸ marrëveshja e bërë me këtë të fundit nuk i përmend fare këto bashkësi. Aty trajtohej vetëm rasti i Nikë Armanit, kreut të Pamalioëve, i cili, gjatë periudhës së armëpushimit që i parapriu nënshkrimit të paqes, kishte vrarë tre njerëz të Gjuraraj Brankoviçit. Për të u vendos që të banonte në një vend 100 milje larg Shkodrës, derisa Sinjoria të merrte një vendim për dënimin e tij.⁶⁹ Edhe pas dy vjetësh, në bisedimet për paqe mes Venedikut dhe Gjuraraj Brankoviçit, nipit dhe trashëgimtarit të Stefan

⁶⁸ Një muaj përpara nënshkrimit të paqes ndërmjet përfaqësuesve të dogjit të Venedikut dhe të despotit të Serbisë, në korrik 1423, Senati porosiste që në atë paqe të përfshiheshin edhe Pamalioët e Pastrovikët, të cilëve u ishte premtuar një gjë e tillë (*quod in dicta pace teneatur ponere Pamalios et Pastrovichios, quibus promissum est de ponendo eos in pace predicta*), Valentini, AAV, tom 11, nr. 2781: 13 korrik 1423.

⁶⁹ “*chel dito Nicha Herman non debia stare, ne habitare apresso a Scutari a cento megia per fina a tanto che per la prefata inclita Sig.ia non seria fato somma soura el dito vaiuvoda Nicha*”, po aty, nr. 2805: 12 gusht 1423.

Lazareviçit, pala serbe vijoi të kërkonte me këmbëngulje kapjen dhe ndëshkimin e Nikë Armanit.⁷⁰

Ndërkohë, Nikë Armani jetonte në Venecie. Senati e dinte se periudha e paqes me despotin do të përfundonte një ditë, prandaj urdhëroi që Nikë Armani të sillej e të vendosej fshehurazi në atë qytet, ku do të mbahej me shpenzimet e shtetit nga gjashtë muaj deri në një vit. Nikës do t'i paguheshin 10 dukatë në muaj për veten dhe dy shërbëtorët e tij. Gjatë asaj kohe, edhe familja e Nikës në Ulqin do të mbështetej financiarisht nga shteti venecian.⁷¹ Presionet e despotit serb për të dënuar Nikë Armanin vijuan edhe më tej, derisa, në shtator 1425, kur rrethanat u kthyen në favor të venecianëve, Senati vendosi t'i pritej shkurt despotit, se “ndaj Nikë Armanit Sinjoria veproji ashtu si ju duk asaj e arsyeshme”.⁷² Kështu, çështja konsiderohej e mbyllur. Paskëtaj, Nikë Armani u vendos në Shkodër, ku, bashkë me të vëllanë, Gjergjin, dhe djalë të tij të rritur, figuron në listën e pronjarëve të angazhuar në mbrojtjen e qytetit dhe të rrethinave të tij. Në vitin 1425, venecianët e panë të arsyeshme të tregoheshin më të kujdesshëm ndaj Pamaliotëve, si edhe ndaj fqinjëve të tyre, Pobratëve dhe Trunshëve. Të gjithë këta u përjashtuan nga detyrimi për të paguar të dhjetën e prodhimit të tokave që u ishin dhënë në pronjë nga Sinjoria. Prej asaj kohe, ata do të duhej të paguanin vetëm një dukat dhe një mod grurë në vit.⁷³ Gjithashtu, tokat e dhëna në koncesion mund t'u kalonin në përdorim edhe bijve të tyre, në rast se këta respektonin kushtet, dorëzonin rregullisht detyrimet përkatëse dhe, sigurisht, i qëndronin besnikë Republikës së Venedikut.⁷⁴ Në këtë mënyrë hidhej një hap drejt kthimit të tokave të dhëna në përdorim të përkohshëm kundrejt kushteve të caktuara (pronja), në zotërime të përhershme dhe të trashëgueshme. Masa synonte, sigurisht, krijimin e një

⁷⁰ “*quod procedatur contra Nicham Armano*”, Valentini, AAV, tom 12, nr. 2999: 20 gusht 1425.

⁷¹ *Po aty*, nr. 2868: 24 shkurt 1424.

⁷² “*responsum fuit quod per nostrum dominium fuerat processum contra ipsum Nichermar [sic!], për: Nik Arman – P. Xh., prout nostro dominio apparuit convenire*”, *po aty*, nr. 2990: 17 korrik 1425.

⁷³ *Po aty*, nr. 3003: 3 shtator 1425.

⁷⁴ “*quod concessiones per nos eis facte de territoriis que habent sicut facte sunt solum ad ipsos se extendant ad eos et filios suos legitimos qui post eorum mortem ea habeant cum illis incarico et condicionibus quibus ipsa tenent presentialiter ipsi eorum patres servantibus ipsis fideliter nostro dominio*”, *po aty*, nr. 2990: 17 korrik 1425.

shtrese të qëndrueshme pronarësh, të lidhur pazgjidhmërisht me regjimin venecian, e pra, besnike e tij.

Masat e mësipërme tregonin se Sinjoria kishte filluar të ndiente shenja pakënaqësie te kreu i Armanëve dhe te Pamaliotët e tjerë, të cilët kishin dhënë gjithçka në favor të saj gjatë konfliktit me despotin serb Stefan Lazareviç. Këtë ndjenjë pakënaqësie e kishte shprehur pikërisht më 17 korrik 1425 vojvoda Nikë Armani, kur i ishte ankuar Senatit se, kundrejt pronave që u përkisnin Armanëve dhe që këta ia kishin dhënë Sinjorisë aty e ndonjë vit më parë, kjo e fundit u kishte kthyer në formë pronje veçse një pjesë fare të vogël. Prandaj, Nika kërkonte që, ose t'u jepej atyre si pronjë edhe pjesa e mbetur e pronave të dorëzuara, ose të pajtoheshin ai vetë, i vëllai dhe djali si kalorës në trupat veneciane kundrejt pagës që merrnin edhe kalorësit italianë. Ndryshe, ata nuk ishin në gjendje të mbanin familjet e tyre.⁷⁵ Senati vendosi për këtë zgjidhje të fundit. Në fakt, në vitin 1438 mësohet se vëllai i tij, Gjergj Armani, bashkë me nipin, djalin e Nikës, i cili ndërkohë kishte vdekur, vijonin të shërbenin si kalorës të paguar në trupat veneciane në Shqipëri.⁷⁶ Por pikërisht atë vit, kont-kapiteni venecian i Shkodrës ua kishte ndërprerë pagesën “pasi ata nuk banonin në Shkodër” (*quia non habitabant in Scutaro*). Armanët e konsideronin këtë masë të padrejtë, pasi tri pagat e kalorësve u ishin akorduar atyre për shkak të pronave të falura shtetit dhe për shkak të besnikërisë së treguar prej tyre ndaj shtetit venecian, *e jo për ndonjë arsye tjetër*.⁷⁷ Me këto fjalë të fundit, Armanët donin të thoshin se, në rastin e tyre dhënia e pronjës nuk gjeneronte detyrimin e kryerjes së shërbimit ushtarak. Në fakt, Armanët nuk thoshin të gjithë të vërtetën.

⁷⁵ “Cum ad nostram comparverit presentiam fidelis noster Nicha Erman Pamaliotus aggravans se quod in contracambium territoriorum suorum amissorum nundum habuerit nisi unam minimam partem et supplicavit quod dignaremur providere, quod habeat contracambium eius quod restat de territoriis nostris juxta concessionones nostras, vel quod ei concedamus tres equos ad latinam unum pro se unum pro fratre suo et tercium pro eius filio, ut se et familiam suam valeat sustentare”, po aty, nr. 2991: 17 korrik 1425.

⁷⁶ “cum nostra dominatio, pro concambio possessionum et bonorum que idem Nicha et sui relinquerunt, quando venerunt ad nostram obedientiam dederit illis stipendium trium equorum ut servirent nostro dominio cum personis suis et equis tribus”, po aty, nr. 3839: 31 maj 1438.

⁷⁷ “stipendium dictorum equorum potius pro contracambio sibi datum fuerit et pro fidelibus operibus suis, quam pro alia causa”, Valentini, AAV, tom 16, nr. 3839: 31 maj 1438.

Edhe pse nuk e konsideronin veten të tillë, ata kishin pranuar statusin e *pronjarit*, ashtu si shumë krerë të tjerë fshatrash e bashkësish. Vërtet, i kishin dorëzuar shtetit venedikas pronat e tyre, të cilat me gjasë nuk ishin në gjendje t'i mbanin, por, siç edhe u tha më sipër, në këmbim kishin marrë, në cilësinë e pronjës (d.m.th. të pronës së përkohshme e të kushtëzuar me shërbim ushtarak), ara dhe vreshta që u ishin sekuestruar armiqve të Republikës. Sigurisht, ata gëzonin një pjesë të mirë të të ardhurave që nxirreshin prej tyre, për çka i detyroheshin shtetit çdo vit të dhjetën e prodhimit, një mod grurë dhe një dukat ari.⁷⁸ Por nuk duhej të kalonte shumë kohë që të kuptohej se sistemi i pronjës gjente vështirësi të mëdha për t'u zbatuar. Në fakt, zbatimi i sistemit të pronjës kishte ndeshur në pakënaqësinë e të gjithëve qysh me vendosjen e sundimit venedikas. Kështu, më 30 prill 1423, komuna e Ulqinit i kërkoi Senatin që “askush të mos pretendonte të merrte në pronjë toka të asaj komune” (*algun non habia cason de domandar in pronia terren del nostro confin*).⁷⁹ Ajo denonconte rastin e disa Pamaliotëve që ishin shquar në betejën për mbrojtjen e Shkodrës “nga sulmet e armiqëve sllavë” dhe për këtë arsye ishin pajisur nga Sinjoria me pronja në territorin që i përkiste komunës së Ulqinit.⁸⁰ Senati vendosi që ato pronja t'i ktheheshin komunës, kurse pronjarët e tyre, Pamaliotët, të kompensoheshin me pronja të barasvlershme tjetërkund ose të shpërbleheshin me një kalë e me një pagë mujore si kalorës në shërbim të Republikës.⁸¹ Mirëpo, siç u cek më sipër, deri në vitin 1425 qeveritarët venecianë nuk kishin zbatuar as njërën dhe as tjetrën zgjidhje të ofruar nga Senati. Pakënaqësi e konflikte edhe më të thella shkaktoheshin kur toka e dhënë në pronjë i ishte sekuestruar një personi privat nën akuzën e bashkëpunimit me armiq të Republikës. Por kishte raste kur kjo akuzë rezultonte e rremë. Nga ana tjetër, në kushtet kur situata luftarake ndryshonte nga dita në ditë në favor të Republikës apo të despotit Stefan Lazareviç, pronjarët e rinj detyroheshin t'i braktisnin pronjat e sapomarra, që u kalonin pronarëve të parë, të cilët ktheheshin me ushtritë fitimtare. Dokumenti i cituar bën të ditur se tre Armanët – Nika, djali i tij dhe vëllai i tij Gjergji – ishin

⁷⁸ *Po aty*, tom 12, nr. 3003: 3 shtator 1425.

⁷⁹ *Po aty*, tom 11, nr. 2722: 30 prill 1423.

⁸⁰ *Po aty*, nr. 2722: 30 prill 1423.

⁸¹ “*possint dare de territoriis et possessionibus deinde totidem que sint equivalentia illis territoriis aut possessionibus per ipsum ser Franciscum eis datis vel providere ipsis de equis ad Albanensem aut soldo sicut melius facere poterunt*”, *po aty*.

caktuar për mbrojtjen e kështjellës së Shkodrës dhe të territorit të saj, gjë që e bënte të domosdoshme që ata të banonin pikërisht në Shkodër. Por, kont-kapiteni i Shkodrës ankohej se ata nuk kishin pranuar të banonin aty. Me sa duket, i tërhiqte vendlindja ose preferonin ta kalonin kohën sa në qytetet e Ulqinit dhe të Shasit, ku zotëronin edhe banesa, aq edhe, ndonjëherë, në Shkodër, ku merrnin pagën si kalorës në shërbim të Republikës, por pa u angazhuar konkretisht në mbrojtjen e qytetit dhe të rrethinave të tij. Statusi i pronjarit, me sa duket, nuk i kënaqte Armanët dhe, më 1425, Senati vendosi t'i merrte me të mirë, duke i liruar nga detyrimi i së dhjetës. Me këtë rast mësohet se ata nuk kryenin as shërbim efektiv ushtarak, detyrimi kryesor i pronjarit, për çka merrnin edhe një pagë mujore. Megjithatë, për të mos i humbur Armanët, kont-kapiteni i Shkodrës kishte propozuar që, në rast se ata do të vijonin të jetonin jashtë Shkodrës, ta kryenin aty ku banonin shërbimin si kalorës dhe të paguheshin me shtatë hiperperë në muaj. Nëse, përkundrazi, do të vendoseshin me banim në Shkodër, do të merrnin, njësoj si pronjarët e tjerë, pagën përkatëse, e cila ishte më e lartë se e para.⁸²

Në vitin 1438, një dokument venecian flet “për të ndjerin Nik” (*quondam Nicha*), provë kjo, se para asaj date vojvoda Nikë Armani nuk ishte më ndër të gjallët.⁸³ Burime të mëvonshme tregojnë se marrëdhëniet e Armanëve dhe të Pamaliotëve të tjerë me Venedikun nuk ishin më ato të parat. Në korrik 1446, kur edhe vëllai i Nikës, Gjergji, nuk jetonte më, djali i këtij, që mbante emrin e të ungjit, Nikë Armani, bashkë me Martin Gjinin, një fisnik pamaliot me banim në Ulqin, dhe me një pamaliot të tretë, Llazar Bossanin, i kërkuan Sinjorisë t'u kthente pronat patrimoniale që ia kishin kaluar asaj në kohët e vështira të konfliktit me despotin serb Stefan Lazareviç, rreth vitit 1423.⁸⁴ Atëkohë, pasardhësi i despotit Stefan, Gjurgj Brankoviçi, sundonte në një pjesë të Kosovës si vasal i dobët i Sulltanit dhe në Krujë ishte ngjitur ylli i Gjergj Kastriot Skënderbeut. Nuk ka ndonjë të dhënë se cili ishte qëndrimi i Armanëve në konfliktin e gjatë mes heroit shqiptar dhe Republikës së Venedikut, i zhvilluar për

⁸² “*quod fiat dictis Pamaliotis sicut consulit presens rector Scutari, videlicet quod si continue stabunt extra, et servierint cum tribus equis, sicut hucusque servierunt, habere debeant septem hyperpera pro quolibet in mense, sicut habent illi equites qui stant extra, et si continue stabunt in Scutaro, habeant stipendium quod habent equites, qui stant inter civitatem*”, Valentini, AAV, tom 16, nr. 3839, f. 28: 31 maj 1438.

⁸³ *Po aty*, nr. 3839: 31 maj 1438.

⁸⁴ *Po aty*, tom 19, nr. 5251: 26 korrik 1446.

zotërimin e Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Drishtit, Danjës, Ulqinit e Tivarit, qytete të cilat Republika ua kishte rrëmbyer, njërin pas tjetrit, Topiajve, Balshëve, Zahariajve e Dukagjinëve.⁸⁵

Pas rënies së Shkodrës në duart e turqve osmanë, më 1479, njëfarë Stefan Armani ishte ndër pinjollët e paktë të familjes që vijoi të banonte në Shkodër. Por, në vitin 1501, venecianët e arrestuan atë në Tivar dhe e burgosën nën akuzën se ishte agjent i turqve.⁸⁶ Ndërkohë, një pjesë e Armanëve të Shkodrës u vendos në Ulqin. Më 1505, në listën e anëtarëve të Këshillit të Ulqinit regjistrohet një Gjergj Armani, i cili mbante titullin vojvodë, të trashëguar tradicionalisht nga anëtarët e familjes Armani, dhe në këtë cilësi drejtonte forcat e mbrojtjes së qytetit e të territorit përreth.⁸⁷ Më 1545 përmendet si vojvodë i Pamaliotëve një Nikë Armani, i cili gjithashtu jetonte në Ulqin.⁸⁸ Ky ishte, me siguri, i biri i vojvodës Gjergj, të përmendur më 1505, prej të cilit kishte trashëguar statusin social dhe titullin e vojvodës. Sipas traditës shqiptare, i biri i vojvodës Nikë Armani, i përmendur në vitin 1545, mori emrin e gjyshit, Gjergj. Në një letër dërguar Senatit të Venedikut më 1582, gruaja e Gjergj Armanit, Marjeta, kujton se, gjatë luftimeve për mbrojtjen e Ulqinit nga sulmi i flotës osmane, më 1571, burri i saj, Gjergj Armani junior, kishte rënë rob bashkë me njërin nga djemtë e tyre.⁸⁹ Sipas rrëfimit të Marjetës, Gjergji bënte pjesë në fisnikërinë e Ulqinit (*Zorzi Armani nobile de Dolcigno*). Ai “i përkiste njëres prej familjeve të para të qytetit” dhe “pas vdekjes së të atit kishte trashëguar prej tij titullin e kreut dhe të vojvodës së Pamaliotëve”.⁹⁰ Në Ulqin kishte jetuar deri në pushtimin e qytetit edhe Andrea Armani, klerik. Ai prezantohej si “shqiptar nga Shkodra” (*io povero prete Andrea Armani Albanese di Schutari*)⁹¹. Në një letër drejtuar Senatit të Venedikut më 22 tetor 1575, Andrea rrëfen se në vitin 1571 kishte braktisur pronat e tij, mes të cilave edhe abacinë e Shën Gjergjit në breg të Bunës, dhe se, me 400 vullnetarë shqiptarë të

⁸⁵ Xhufi, *Skënderbeu, ideja dhe ndërtimi i shtetit*, 172-176.

⁸⁶ Shih: Zamputi, *Dokumenta për historinë e Shqipërisë*, pj. II, 273.

⁸⁷ Malcolm, *Agjentë Perandorakë*, 49.

⁸⁸ “Nica Armani asserto Vaivoda de Pamaliotti”, ASVe, *Capi del Consiglio de Dieci: Lettere di Rettori e di altre cariche*, busta 278: Ulqin, 17 qershor 1545.

⁸⁹ ASVe, *Sen. Mar*, filza 80: 19 mars 1582.

⁹⁰ “essendo egli di principali della cita, vaivoda et capo di Pamaliotti doppo la morte de suo padre”, ASVe, *Sen. Mar*, filza 80: 19 mars 1582.

⁹¹ ASVe, *Senato Mar*, filza 64: 22 tetor 1575.

mbledhur nga ai vetë, kishte luftuar kundër turqve për mbrojtjen e Ulqinit dhe më pas të Kotorrit. Në këto luftime humbën jetën i ati dhe njëri prej vëllezërve të tij.⁹² Sipas rrëfimit të Andreas, në atë rast, ai dhe vëllezërit “kishte vrarë me duart e tij jashtëzakonisht shumë turq”.⁹³ Më vonë, prifti Andrea Armani rezultoi i regjistruar në radhët e garnizonit të Kotorrit, ku, bashkë me shqytarin e tij, merrte një pagë prej 6 dukatësh në muaj. Andrea ishte ngarkuar nga venecianët edhe me detyra jashtë territorit të Kotorrit, si atëherë kur, me 15 luftëtarë shqiptarë, shkoi në mbrojtje të ishullit Paksos, përballë Pargës në Arbërinë e Poshtme.⁹⁴ Një tjetër klerik nga kjo familje, Dukë Armani, përmendet më 1584 në Itali, por kësaj radhe në rolin e njeriut të fesë dhe të kulturës, e jo të armëve, siç ishte rasti i përmendur i priftit luftarak Andrea Armani. Ky dhe dy misionarë të tjerë shqiptarë u nisën atë vit për në Shqipëri, të ngarkuar me 500 libra katekizmi në gjuhën shqipe. Në vitin 1590 mësohet se kleriku Dukë Armani u emërua ipeshkëv i Shkodrës.⁹⁵ Emri *Dukë* i tij, tregon se tek Armanët, ashtu si edhe në familje të tjera shqiptare të shtresës së lartë, trashëgohej nga breznia në brezni një numër i vogël emrash personi. Nga ana tjetër, emri *Dukë* na njeh edhe me një dukuri tjetër: atë të

⁹² “credo si debbano esser notissimi quando io nel tempo della prossima passata ghuera, abbandonando ogni sorte di substantia et facultà che avei in Albania et l'abbatia di S. Zorzi qual posedeva et posponendo il pericolo della propria vita, di parenti et fratelli qual povero mio padre ed uno fratello, per questa occasione furno crudelmente da Turchi morti, et uno fratello con una meschina surella, fatti schiavi; fui quello che sollevai in magior parte essi Albanesi, sostentai per alquanto l'insolito in quelli paesi di nemici Turchi, con uccisione di assaissimi di loro per le mie mani et di mei fratelli, sicome del tutto puo Vra. Ser.tà maggiormente esser fatta chiara per fede di vostri Cl.mi representanti, ultimamente ridotto da magior moltitudine e forza in Dolcigno con Albanesi 400 et de lì poi à Cataro sempre alli servitii soi”, ASVe, Senato Mar, filza 64: Venecie, 22 tetor 1575.

⁹³ “fui quello che sollevai in magior parte essi Albanesi, sostentai per alquanto l'insolito in quelli paesi di nemici Turchi, con uccisione di assaissimi di loro per le mie mani et di mei fratelli”, ASVe, Senato Mar, filza 64: Venecie, 22 tetor 1575.

⁹⁴ “dove de ordine di Vra Ser esendo io rimesso al Cl.mo Proveditor di Cataro à provedermi per mio sostentamento, mi fù stituito con tenir uno ragazzo di stipendio schudi sei al mese [...] in questo tempo ancora fui mandato de ordine del Cl.mo Proveditor Generale, Grimani, alla custodia dell'Isola di Paxo, deputandomi Albanesi quindec in mia compagnia, dove io ben'et honoratamente mi adoperai”, ASVe, Senato Mar, filza 64: Venecie, 22 tetor 1575.

⁹⁵ Matteo Mandalà, “Su un catechismo in albanese della seconda metà del '500,” në *Sprache und Kultur der Albaner. Zeitliche und räumliche Dimensionen* (Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2015), 429, shën. 32.

përzgjedhjes së emrit nga titullaturat ushtarake apo nga personalitete të shquara të botës bizantine, sllave, perëndimore e gjithashtu shqiptare, që ushtronin magji të veçantë të shqiptarët luftarakë. Në fakt, mes tyre ndeshen emra të tillë si Dukë, Kont, Kontostabël, Sebast, Kasnec, Knjez, Piro, Skënderbej, Vladik, Admiral, Komnen, Mbret etj.⁹⁶

Në vitin 1582 mësohet historia e Gjergj Armanit, “nobile de Dulcigno”.⁹⁷ Sipas rrëfimit të gruas së tij, Marjetës, Gjergji kishte ndërruar jetë pikërisht atë vit, “duke e lënë atë qyqe, pa atdhe, pa plang e katandi”.⁹⁸ Ishte bërë vojvodë dhe kreu i Pamalioëve pas vdekjes së të atit, më 1550. Më vonë, i zhvendosur në Ulqin, Gjergji i kishte shërbyer besnikërisht Republikës së Venedikut: bashkë me dhjetë Pamalioë të tjerë kishte shoqëruar dhe kishte mbrojtur nga piratët e Vlorës dhe të Durrësit anijen e kapitenit të flotës veneciane Piero Emo, gjatë një misioni të këtij të fundit në Lindje; më vonë ishte dërguar të luftonte kundër një skuadre anijesh turke, të komanduara nga detari i famshëm Karakoca, të cilat kishin zbarkuar në Gjiranë, afër Ulqinit. Me atë rast, Gjergj Armani i kishte zmbarsur ata, kishte vrarë 35 turq dhe kishte liruar disa robër të krishterë. E veja e Gjergj Armanit vijon rrëfimin e saj, duke thënë se, kur nisi lufta e hapur me Portën e Lartë më 1570 dhe Ulqini u godit nga një epidemi e rëndë murtaje, Gjergj Armani u emërua inspektor i shëndetësisë dhe “bashkë me vartësit e tij punoi ditë e natë për të pastruar qytetin, pa pyetur se rrezikonte jetën e tij, mjaft që të shpëtonte jetën e ushtarëve, ndërkohë që i duhej të zmbarshte edhe

⁹⁶ Luigi M. Ugolini, “Pagine di storia veneta ai tempi di Scanderbeg e dei suoi successori,” *Studi Albanesi* III-IV (1933-1934): 15; Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shek. XII-XV* (Tiranë: Botimet 55, 2009), 261-262; ASVe, *Dispacci Corfù*, busta 30: 20 shkurt 1663 (*Mbreti Pasha*); ASVe, *Senato Mar*, reg. 16, fol. 80^v (*Knjezi Bua*); ASVe, *Senato Mar*, filza 2: 28 qershor 1546 (*Sebast Helmi*); ASVe, *Senato Mar*, reg. 16, fol. 43^r (*Kondostabël Zoica*); Valentini, AAV, tom 8, nr. 2107/31 (*Vladik Hoti*); ASVe, *Sen. Mar*, reg. 16, fol. 85^v (*Piro Humoj*); Injac Zamputi, *Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV, pjesa I (1479-1499), (Tiranë: Universiteti Tiranës, 1967), nr. 218 (*Stefano che regna a Montenegro et Scanderbeg terzo fratello*). Përveç këtij pinjollit të Gjurash-Cërnojeviçëve të Malit të Zi, emrin Skënderbe e mbante në shek. XVI edhe një trashëgimtar i Dukagjinëve, shih: Giovanni Musachi, “Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi,” në Charles Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues* (Berlin: Librairie de Widmann, 1873), 284.

⁹⁷ ASVe, *Senato Mar*, filza 80: 19 mars 1582.

⁹⁸ “detto mio marito restò schiavo de Turchi nella guerra passata della perdita de Dolcigno, onde essendo rimasta vedova priva della patria et della facultà”, po aty.

sulmet e armiqve jo vetëm kundër qytetit, por edhe kundër fshatrave përreth, të cilat i mbrojtë me 200 trimat e tij duke vlarë shumë sosh gjatë përleshjeve e duke dorëzuar si trofé kokat e prera të tyre”.⁹⁹

Një e dhënë tjetër interesante për Armanët është ajo e vitit 1624. Bëhet fjalë për dëshminë e një banori të Budvës, Nikolet Markoviç, dhënë përpara autoriteteve veneciane. Ai ishte, me gjasë, pjesëtar i bashkësisë Markoe, etnikisht e përzier, që popullonte hapësirën mes Ulqinit e Tivarit. Markoviçi, i cili dyshohej se ishte agjent i mbretit të Napolit, dëshmoi me atë rast se ishte i martuar prej tridhjetë vjetësh me një grua nga familja Armani. Prindërit, motrat e vëllezërit e saj kishin vdekur, të afërm të tjerë kishin emigruar në Istrië para tre vjetësh. Vijonte të jetonte në Arbëri vetëm ndonjë pinjoll i rrallë i asaj familjeje. Një prej tyre, të cilin Markoviçi në fjalë e kishte vizituar pak kohë më parë, banonte në Shën Gjergj, buzë rrjedhës së Bunës.¹⁰⁰ Pak më herët, në vitin 1610, arqipeshkvi i Tivarit, Marin Bizzi, takonte në fshatin Shën Gjergj të Shasit, buzë lumit Buna, priftin Thoma Armani.¹⁰¹ Kujtojmë se, në vitin 1571, manastiri i Shën Gjergjit, buzë Bunës, bashkë me pronat e tij, i përkiste abatit Andrea Armani. Ka arsye të dyshojmë se edhe këta Armanë të viteve 1610 dhe 1624 duhet të kenë qenë të afërm të tij, ndoshta trashëgimtarë të manastirit dhe të pronave të tij. Kryesisht klerikë ishin edhe pinjollët e fundit të familjes Armani që përmenden në vijim nga dokumentacioni venecian dhe ai papal. Siç u cek më sipër, Marin Bizzi, arqipeshkëv i Tivarit, flet më 1610 për Thoma Armanin, famullitar i fshatit Shën Gjergj, buzë Bunës. Në vitin 1658, ipeshkvi i Shkodrës,

⁹⁹ “*per la gran peste accaduta in quella città l’anno del 1570 [...] fù deputato sig. alla sanità nel qual importante maneggio intrepidamente ha ateso giorno e notte facendo nettar la città con manifesto periculo della morte provedendo di continuo al viver di soldati et a reprimer l’audacia de nemici [...] et similmente essendo venuto alquante ville alla devotione di Vra Ser fù mandato con 200 soldati alla difesa di quelle [...] et molte volte portava delle teste de nemici aqistate nelle continue scaramuzze*”, ASVe, Senato Mar, filza 80: 19 mars 1582.

¹⁰⁰ “*respose io son mandato in Albania a S. Zorzi in la Bogiana e mia moglie è di casa Armani, ha parenti in Albania e credo che siano trenta anni che hò moglie...[...] I fratelli, il Padre e la madre, et i più congiunti di detta mia moglie sino morti, alcuni altri suoi parenti sono passati ad habitar in Istria già tre anni, ma non sò dirvi in che luoco particolarmente. Add.to se hà parenti per via di moglie in altri luochi che in Albania, respose non sò che n’habbia altrove, altro che uno ancora à San Zorzi*”, ASVe, Inquisitori di Stato: Dispacci dai Provveditori Generali in Dalmazia ed Albania, busta 274: Zara, 23 nëntor 1624.

¹⁰¹ Bartl, *Albania Sacra*, 128.

Pjetër Bogdani, relatonte se në fshatin Corni (shqip: Brija), i cili, bashkë me Shën Gjergjin formonin një famulli, shërbente prifti Thoma Armani (*Thomaso Harmanni*).¹⁰² Vështirë që ky të ishte i njëjti me famullitarin me të njëjtin emër, i përmendur në vitin 1610. Në fakt, pas trembëdhjetë vjetësh, më 1671, vizitatori apostolik Stefano Gaspari e takoi këtë Thoma të dytë, i cili, sipas tij, ishte 60 vjeç dhe shërbente në kishën e Shën Gjergjit prej 36 vjetësh.¹⁰³ Më 1678, si edhe më 1682, Armani vijonte të shërbente në kishën e Shën Gjergjit, në fshatin me të njëjtin emër, buzë rrjedhës së poshtme të Bunës.¹⁰⁴

Në atë kohë, Armanët kishin përfunduar rrugën e emigrimit drejt zotërimit venecian të Istrias, një rrugë e nisur pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit në duart e turqve osmanë (1571). Për një ikje masive të Armanëve dëshmon dokumenti i vitit 1624, i cituar këtu, i cili e vendos këtë ngjarje tre vjet më herët, në vitin 1621.¹⁰⁵ Në fakt, më 21 shtator 1622 mësohet se bëhej fjalë për tetë familje, të prira nga “prifti shqiptar Gjergj Armani” (*Padre Zorzi Arman Albanese*), të cilat ishin lejuar nga autoritetet istriane të vendoseshin në zonën e Kanalit Cherin (Garin), ku duhej të krijonin një fshat të ri.¹⁰⁶ Sigurisht, Armanët, si gjithë shqiptarët e tjerë, nuk gjetën një pritje miqësore nga vendasit, në një vend si ai i Istrias, i varfër, i braktisur, i lënë djerrë dhe pré e grabitësve. Pikërisht nga një bandë e tillë, e përbërë prej tridhjetë stratiotësh shqiptarë të çmobilizuar, u sulmuan më 1632 emigrantët Armanë, të vendosur rishtazi në lokalitetin Garin të Parencos në Istrië. Sulmuesit treguan një egërsi të pashpjegueshme ndaj bashkatdhetarëve të tyre emigrantë. Ndoshta i kishte irrituar fakti që shteti venecian i kishte lënë ata stratiotë, mbrojtësit e tij, në mes të katër rrugëve, ndërkohë që u jepte toka dhe kujdesej për këta të ardhur të rinj nga anët e Turqisë. Fakti është se stratiotët dogjën shtëpitë, therën bagëtitë e, madje, lanë pas një të vranë e disa të plagosur mes familjeve Armani.¹⁰⁷ Emri i komandantit të stratiotëve, Filip Milo, tregon se bëhej fjalë për stratiotë të rekrutuar në Korfuz apo në zotërime

¹⁰² *Po aty*, 149.

¹⁰³ “Relazione del Vescovato di Scutari data da me Stefano Gaspari, Visitatore d’Albania,” në *Hylli i Dritës*, viti VII-mars 1931-nr. 3: 156; Bartl, *Albania Sacra*, 178.

¹⁰⁴ Bartl, *Albania Sacra*, 183, 194, 202.

¹⁰⁵ ASVe, *Inquisitori di Stato: Dispari dai Provveditori Generali in Dalmazia ed Albania*, busta 274: Zara, 23 nëntor 1624.

¹⁰⁶ Matteo Mandalà, “Gli Albanesi in Istria, sec. XV-XVIII,” *Shejzat*, 1-2 (2020): 49.

¹⁰⁷ *Po aty*, 56.

të tjera veneciane në Peloponez ose Kretë. Kjo kompani stratiotësh, e cila kishte mbrojtur zotërimin venecian të Istriës nga sulmet osmane që nisnin nga prapatoka dalmate, ishte shpërndarë me një nga ato dekrete të Senatit, me të cilat ai urdhëronte uljen e numrit të stratiotëve “për të lehtësuar arkën e shtetit nga shpenzime të mëdha e të papërbalueshme”.¹⁰⁸ Kjo ndodhte sa herë që marrëdhëniet me Portën e Lartë normalizoheshin. Pas atij episodi nuk befason fakti që në vitin 1698 njëfarë Françesk Armani i atyshëm, fshatar i kamur, por që kishte probleme me ligjin për shkak të sjelljeve të dhunshme, u ofrua të shërbente si *barigello*¹⁰⁹ dhe, bashkë me trimat e tij, të siguronte qetësinë në atë zonë, duke “e pastruar atë nga keqbërësit”. Për këtë, ai pretendonte një pagë prej 15 dukatësh në muaj për veten dhe pesë dukatë për pjesëtarët e eskortës së tij.¹¹⁰ Siç duket, ky Arman kërkonte të ushtronte në atdheun e ri rolin e *vojvodës*, d.m.th. të plotfuqishmit të zonës, që, siç pamë, ishte një funksion i trashëgueshëm tek Armanët, krerët e dikurshëm të Pamaliotëve të Shasit, tashmë të shprishur nëpër botë.

Ndërkohë, ndërsa Armanët braktisnin vendin, emri i tyre ishte përjetësuar në qytetin e Shkodrës. Nga shek. XVII e këtej, burimet përmendin aty një lagje me emrin Armani (*Ermani-Ermanji*), që sot vendasit e thonë *Rmajë* dhe që, siç e thotë emri, është quajtur kështu nga të ardhurit e familjes Armani.¹¹¹ Lajmin e jep arqipeshkvi i Tivarit, Vincenzo Zmajević, në vitin 1703.¹¹² Vite më vonë, ipeshkvi i Shkodrës, Antonio Vladanji, shkruante se lagjia “Tophana”, bashkë me lagjen “Ermanji” (Ermagni), kishte gjithsej 81 familje katolike me 540 anëtarë.¹¹³ Një numër disi më të lartë jep, më 1737, një relacion i Misionit françeskan drejtuar Kongregacionit Propaganda Fide. Sipas tij,

¹⁰⁸ “*hora è molto conveniente alleviare el stato nostro de tanto grave et insuportabile spexa*”, kështu pas Luftës Veneto-Turke të viteve 1499-1503, shih: ASVe, *Sen. Mar*, reg. 16, c. 22^r: 7 tetor 1503. Po kështu, një vendim i Senatit i vitit 1563 thotë: “*noi regulassimo [...] la nostra militia di strathiotti, riducendo cosi quelli che ci servivano in Dalmatia, come anche nell’Albania*”, ASVe, *Senato Mar*, filza 55: 10 gusht 1573.

¹⁰⁹ Në venecianisht, *Barigelo-Bariselo* quhej drejtuesi i një bande keqbërësish, Giuseppe Boerio, *Dizionario del dialetto veneziano* (Venezia: Giovanni Cecchini edit., 1856), 65.

¹¹⁰ *Po aty*, 61.

¹¹¹ Valentini, “L’elemento vlah nella zona scutarina”, 270, 274; Bartl, *Albania Sacra*, 60.

¹¹² Bartl, *Albania Sacra*, 247.

¹¹³ *Po aty*, 306.

lagjet “Ermanj” dhe “Tophana” kishin gjithsej 87 familje me 783 të krishterë, “të cilët, ditët e festave, mblihdeshin për të dëgjuar meshën në Ermanj, në kishën e rrënuar të Shën Kollit, brenda një varreze ku banorët vazhdojnë të vendosin të vdekurit e tyre”.¹¹⁴

Burime arkivore e bibliografi:

I. Arkiva:

Archivio di Stato di Venezia (ASVe)

Fondet:

- *Dispacci di Rettori e altre cariche: Corfù*, busta 30.
- *Inquisitori di Stato: Dispacci dai Provveditori Generali in Dalmazia ed Albania*, busta 274.
- *Cinque Savi alla Mercanzia. Lettere Consoli: Durazzo*, busta 662.
- *Capi Consiglio dei Dieci: Lettere di Rettori e di altre cariche*, busta 274.
- *Senato Mar*, reg. 16, 17.
- *Senato Mar*, filza 2, 51, 55, 64, 80.

II. Botime dokumentare:

THALLOCY, Ludwig & Constantin Jireček & Milan Šufflay (eds.). *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia (Acta Albaniae)*. Vol. I–II. Vindobonae: Adolf Holzhausen, 1913-1918.

BARTL, Peter. *Albania Sacra: Geistliche Visitationsberichte aus Albanien*. Vol. 5: *Diözese Skutari*. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2021.

GASPARI, Stefano. “Relazione del Vescovato di Scutari data da me, Stefano Gaspari, Visitatore d’Albania.” Në *Hylli i Dritës*, viti VII, mars 1931.

GELCICH, Giuseppe & Ludwig Thalloczy. *Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae cum Regno Hungariae*. Budapest: M. Tud. Akadémia, 1887.

JORGA, Nicolae. “Notes et extraits pour servir à l’histoire des Croisades au XVe siècle.” *Revue de l’Orient Latin* VI (1898).

¹¹⁴ “I popoli cristiani di Scuttari, com’Ermagni e Tophana, che consistono in case cattoliche 87, anime 783 ne giorni festivi ascoltano la messa in Ermagni in un cimiterio dove ancora sotterrano i loro morti titolato S. Niccolò funditus dirocato”, po aty, 314.

- JORGA, Nicolae. *Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades au XVe siècle*. Ire série. Paris: Ernest Leroux, 1899.
- Libri Commemorativi della Repubblica di Venezia. Regesti*. Tomo IV. Venezia: Istituto per gli Studi Adriatici, 1896.
- NADIN, Lucia. *Gli Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*. Roma: Viella, 2002.
- UGOLINI, Luigi. "Pagine di storia veneta ai tempi di Scanderbeg e dei suoi successori." *Studi Albanesi* III-IV (1933-1934).
- VALENTINI, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV (AAV)*. Tomi I-XXIV. München-Palermo: Rudolf Trofenik, 1967-1979.
- ZAMPUTI, Injac. *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417*. Tiranë: Akademia e Shkencave, 1977.
- ZAMPUTI, Injac. *Dokumenta për historinë e Shqipërisë, 1479-1506*. Pj. I (1479-1499); II (1499-1506). Tiranë: Instituti i Historisë, 1967-1979.
- ZAMPUTI, Injac & Luan MALLTEZI. *Dokumente për Historinë e Shqipërisë të Shek. XV*. Vëll. I (1400-1405). Tiranë: Akademia e Shkencave, 1987.

III. Kronika:

- MUSACHI, Giovanni. "Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi." Në *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*. Ed. Charles Hopf. Berlin, Librairie de Widmann, 1873.
- PORPHYROGENITUS, Constantinus. *De Administrando Imperio*. Greek Text: Ed. Gyula Moravcsik. English Translation. R. J. H. Jenkins. Budapest: Egyetemi Görög Filológiai, 1949.

IV. Literaturë historiografike:

- BLOCH, Marc, *La società feudale*, Torino: Einaudi, 1976.
- BOERIO, Giuseppe, *Dizionario del dialetto veneziano*, Venezia: Giovanni Cecchini edit., 1856.
- BOŽIĆ, Ivan, "Proniarii et capita", *Zbornik Radova Vizantoloski Institut*, VIII/1 (1963).
- BUDAK, Neven, "Die südslawische Ethnogenesen an der östlichen Adriaküste im frühen Mittelalter." *Typen der Ethnogenese unter besonderer Berücksichtigung der Bayern*. Berichte des Symposions der Kommission für Frühmittelalterforschung, 27. bis 30. Oktober 1986, vol. I. Wien, Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 1990.

- FERJANČIĆ, Božidar. "Dolazak hrvata i srba na balkansko poluostrovo", *ZRVI*, 35 (1996).
- JACOBY, David. *La féodalité en Grèce médiévale. Les Assises de Romanie*. Paris: Éd. Mouton et Cie, 1971.
- JIREČEK, Constantin. *Geschichte der Serben*. Gotha: Friedrich Andreas Perthes, 1911.
- MALCOLM, Noel. *Agjentë Perandorakë. Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shek. XVI*. Tiranë: Dudaj, 2016.
- MANDALÀ, Matteo. "Su un catechismo in albanese della seconda metà del '500." *Sprache und Kultur der Albaner. Zeitliche und räumliche Dimensionen*. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2015.
- MANDALÀ, Matteo, "Gli Albanesi in Istria, sec. XV-XVIII." *Shejzat*, 1-2 (2020).
- MODRIĆ, Giuseppe. *La Dalmazia Romana. Note e ricordi di viaggio*. Roma: L. Roux, 1892.
- SCHMITT, Oliver Jens. *Arbëria Venedike, 1392-1479*. Tiranë: K&B, 2007.
- ŠUFFLAY, Milan. *Historia e shqiptarëve të Veriut. Serbët dhe shqiptarët*. Prishtinë: Rilindja, 1968.
- TADIN, Marin. "Les Arbanitai des chroniques byzantines, XI^e – XII^e s." *Actes du XVe Congrès International d'Études Byzantines*, IV: Histoire. Athènes: [na] 1980.
- VALENTINI, Giuseppe. "L'elemento vlah nella zona scutarina nel sec. XV." *Në Südosteuropa unter dem Halbmond*. München, 1975.
- XHUFI, Pëllumb. *Dilemat e Arbërit*. Tiranë: Pegi, 2006.
- XHUFI, Pëllumb. *Nga Paleologët te Muzakajt: Berati dhe Vlora në shek. XII-XV*. Tiranë: Botimet 55, 2009.
- XHUFI, Pëllumb. "Albansko-crnogorska podudaranja u srednjem vijeku." *Në Balšići. Zbornik radova sa skupa Balšići Ivanova Korita, 21-22. septembra 2011*. Cetinje-Podgorica: Matica Crnogorska, 2012.
- XHUFI, Pëllumb. *Skënderbeu, ideja dhe ndërtimi i shtetit*. Tiranë: Dituria, 2019.
- XHUFI, Pëllumb. *Voskopoja e bota përreth*. Tiranë: Dituria, 2025.

AKAD. PROF. DR. PËLLUMB XHUFİ

Academy of Sciences of Albania

pxhufi@gmail.com

*S u m m a r y*THE ARMANI FAMILY OF SHAS
(XV-XVI)

The Pamaliots appear in 15th- and 16th-century sources as a newly formed territorial community in the area around the city of Shas. In this sense, the somewhat derogatory term *Pamaliot*, meaning “those without mountains”, was intended to reflect the new geographical reality of the new settlement, which stood in contrast to the former homeland of the newcomers. The Pamaliots settled in two main villages, Briri and Calesena. The leading families of the Pamaliots were the Leti and the Armani, who took over as leaders of the community. A certain Medon Armani is mentioned in 1416 as the head of Calesena, which suggests that the rival Leti family was based in the neighboring village of Briri. After 1404, during the long conflict with the Albanian prince Balsha III, the Venetian authorities in Shkodra attempted to win over Duka Leti by granting him property and privileges, in the hope that he would rally the entire Pamaliot community to the Republic’s side against Prince Balsha. But the Pamaliots sided with Balsha III, forcing their leader, Leti, to defect from the Venetians. By then, the Venetians considered him a “traitor”. As such, they had him captured and executed in 1410. One of Duka Leti’s minor sons was sent to Venice and held there as a hostage. Subsequently, the Armani family took over the leadership of the Pamaliots community. This led to an alliance with the Venetian Republic, and after the death of Balsha III (1421), the city of Shas and the Pamaliot community passed under Venetian jurisdiction. Also in 1421, the Serbian despot Stefan Lazarević, Balsha III’s maternal uncle, attempted to seize the Venetian cities of Shkodra, Drisht, Ulqin, Budva, and Kotor. The Venetians owed the preservation of those cities to the Pamaliots and their leader, Nik Armani, who ran to their defense. In return, the Senate granted Nik Armani several estates belonging to the

Republic's enemies, including the village of Bardhonja near Shkodra, which the despot Stefan Lazarević had recently offered to one of his loyal followers, "the Slav Nicola Zauli" (Nicola Zauli sclavus). The Venetians also gifted Armani a house on the main square in Shas where, according to the act of donation, "Nik Armani and his family could move in the event that they were driven out of their village". The house had been seized from one of his rivals, Peter Nika, who sided with the Serbian despot Lazarević. Peter Nika, who was also a member of the Pamaliot community, had his own clan and enjoyed the support of many followers. In July 1423, a truce was agreed upon between the Venetians and Despot Lazarević, which was to be followed by the start of peace negotiations. This did not sit well with Nik Armani. During the truce, he killed three followers of Đurađ Branković, the nephew and designated successor of the Serbian despot. The latter urged the Venetians to hand over the murderer. The Senate instructed its negotiators to reject Lazarević's claim. Finally, the parties reached a temporary agreement, under which Nik Armani was required to move to a location 100 miles away from Shkodra pending the final decision. Armani could not settle in Shas, since the peace treaty had assigned that city to the Serbian despot. Consequently, to avoid Serbian vengeance, the Senate decided to secretly transfer him to Venice, while Armani's family was housed in the Venetian possession of Ulqin and supported with public funds. In 1425, when the situation in the Shkodra area turned in favor of the Venetians, Nik Armani returned from Venice and settled in Shkodra. Nik himself, his brother George, and his son requested and obtained permission from the Venetian governor of the city to serve the Republic as knights, with a reward befitting their rank. Then, other members of the Armani family, as well as members of other Pamaliot families, also settled in Shkodra. Even after the Ottoman occupation, members of the Armani family are mentioned in Shkodra. In the 17th century, there is mention of a neighborhood in Shkodra called *Armani-Ermani-Ermanji*, which still exists today under the name *Rmajë*, a derived form of Armani. There, in 1737, stood the Church of St. Nicholas, where the neighborhood's residents gathered, as well as the cemetery where the dead were buried. Meanwhile, some of the Armani family had taken refuge in Ulqin. Like *Voivode* Nik Armani, they too were welcomed into the city's patrician class, forming family ties with the Bruni, Bruti, and other distinguished families of Ulqin. During the battles against the Turks in 1571, several members of the Armani family became famous. One notable figure was the abbot of the monastery of St. George, located on the banks of the Buna River. Upon hearing news of the Ottoman siege of Ulqin, he left the monastery and, leading 400 volunteers, rushed to the city's

defense. Starting in 1550, Giorgio Armani made a name for himself in the public life of Ulqin; sources describe him as “an aristocrat, *voivode*, and leader of the Pamaliot”. After the Turkish occupation of the city, he, like many other Armani, emigrated to Venice. Other Armani are mentioned as newcomers in the Venetian territory of Istria.

Keywords: Mountain, community, count-captain, the years 1421, 1479, 1571, *voivode*, despot, concession, knight, Senate, *pronoia*, obligation, seizure, patrician, abbot, bishop, emigration.

DR. EDUART CAKA

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edicaka@hotmail.com

ISLAMIZIMI NË SANXHAKUN E ELBASANIT GJATË GJYSMËS SË PARË TË SHEK. XVI

Abstrakt:

Ekziston tashmë një korpus i madh shkrimesh, artikujsh, zërash enciklopedikë dhe studimesh mbi çështjen e islamizimit të shqiptarëve dhe faktorëve që kanë ndikuar në këtë proces, i cili filloi dhe arriti kulmin gjatë periudhës së sundimit osman në këtë hapësirë. Zbulimi apo publikimi i dokumenteve të reja që datojnë nga kjo periudhë është një zhvillim që hedh dritë dhe zbardh dinamika të reja mbi këtë tematikë, si dhe i shtyn studiuesit ta rimarrin atë sërish në shqyrtim. Në këtë kontekst, edhe ky artikull bazohet në të dhënat e përfuara nga regjistrat kadastrorë të shek. XVI mbi një hapësirë të caktuar administrative të kohës, siç ishte sanxhaku i Elbasanit dhe kazatë e Elbasanit, Durrësit dhe Shpatit, të cilat bënë pjesë brenda kësaj livaje.

Fjalë kyçe:

Sanxhaku i Elbasanit, shek. XVI, feja, islamizimi, regjistrat kadastrorë osmanë.

Hyrje

Me rënien e Shkodrës në duart e Mehmedit II në vitin 1479 dhe të Durrësit në vitin 1501, zhvillime që sollën tërheqjen përfundimtare të venecianëve nga ky port i rëndësishëm i Adriatikut Lindor, kohë e cila përkon me periudhën e sundimit të Bajezidit II, sulltani arriti ta shtrinte plotësisht sundimin e tij në këto hapësira, duke u vendosur përfundimisht në këtë vijë bregdetare. Në këtë drejtim, hapi i parë që ndërmorën osmanët ishte një riorganizim administrativ i kësaj zone dhe i një pjese të konsiderueshme të Shqipërisë Qendrore, e cila deri atëherë varej në masë

të madhe nga Ohri,¹ për t'u bashkuar në një sanxhak të vetëm, atë të Elbasanit, qendra e të cilit do të ishte qyteti me të njëjtin emër. Në këtë sanxhak të ri u grupuan hapësirat e dy anëve të Shkumbinit, si dhe pjesa fushore perëndimore që shtrihej deri në bregdet. Më konkretisht, livaja në fjalë ndahej në tri kaza: atë të Elbasanit, Durrësit dhe Shpatit.²

Sikurse do ta shohim edhe nga dokumentacioni arkivor i shek. XVI, organizimi i sanxhakut të Elbasanit jo vetëm që nënkuptonte konsolidimin e sundimit osman në këto hapësira, por gjithashtu, në vijim, do të shërbente edhe si një pikë mbështetëse në kuadër të mbrojtjes së kalave bregdetare ndaj një sulmi që do të vinte nga jashtë.³ Kështu, në kohën e sundimit të Bajezidit II, mund të thuhet se bregdeti lindor i Adriatikut nuk ishte më problem për osmanët, pasi ata e kishin shtrirë autoritetin e tyre deri në këto skaje, duke e kthyer detin në një kufi natyror ndërmjet tyre dhe Europës. Vetë pesha specifike e zonave shqiptare dhe e sanxhakut të Elbasanit në përgjithësi do të dilte në pah gjatë rivalitetit për dominim në Adriatik e Mesdhe, ku kjo gjeografi ishte vazhdimisht objekt i sulmeve të piratëve dhe flotave të ndryshme, veçanërisht asaj spanjolle.⁴

¹ Machiel Kiel, "İlbasan," *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII (İstanbul: TDV Yay., 2000), 79-81.

² Një dokument i hershëm që na jep informacione të detajuara mbi hapësirat territoriale që ishin pjesë e sanxhakut të Elbasanit, njësitë e tij administrative, kalatë dhe fshatrat bashkë, si dhe numrin e popullsisë dhe të ardhurat, është një regjistër i llogarive të kësaj livaje, i cili daton në vitin 1530. Për më shumë, shih: 367 *Numaralı Muhâsebe-i Vilâyet-i Rûm-ili Defteri ile Avlonya Livâsı Tahrîr Defterleri (926-1520/937-1530)*, C. III (Ankara: Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, 2008), 3.

³ Në *Mühimme Defterleri* gjenden urdhra të shumtë që i drejtohen kadiut apo sanxhakbeut të Elbasanit për çështje të rendit dhe sigurisë. Ndërsa, në rastet e rrezikut që kanosej nga deti apo gjatë mobilizimeve ushtarake për ekspedita, sanxhakbeu i Elbasanit rezulton të ketë qenë ndër drejtuesit kryesorë të kësaj hapësire, i cili urdhërohej për të organizuar vijën mbrojtëse ose për të mbledhur ushtarë. Madje, kjo nuk vlente vetëm për ngjarjet që ndodhnin në hapësirat përreth, por edhe për ekspedita më të largëta, siç ishte ajo e Maltës (1565) në Mesdhe, ku trupat e sanxhakut të Elbasanit rezultojnë të kenë qenë tejet aktive. Për më shumë detaje, shih: Eduart Caka, "Prania e elementit shqiptar në fushatën osmane të Maltës të vitit 1565," *Studime historike*, nr. 1-2 (2019): 44.

⁴ Për rivalitetin ushtarak në Adriatik e Ballkan dhe ndikimin e përplasjeve në hapësirat shqiptare, shih: Peter Bartl, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane*, përktheu Pëllumb Xhufi (Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria, 2011).

Ndërkohë që i biri i Bajezidit II, Javuz Selimi ose Selimi I, zgjodhi të ndiqte një trajektore tjetër gjatë sundimit të tij, duke u përqendruar kryesisht në zgjerimin osman drejt Lindjes dhe duke shtënë brenda kufijve të shtetit zona me rëndësi, si hapësirat e Sirisë së sotme, Irakut apo Egjiptit. Kurse pasardhësi i tij në fron, Sulejmani I, do t'i drejtonte sytë kah Perëndimi. Ky i fundit, i njohur ndryshe edhe si Ligjvënësi (Kanuniu) ose i Madhërishmi (Magnificent), u vu personalisht në krye të ushtrisë osmane, duke synuar të godiste zemrën e Europës, siç ishte triumfi në Mohaç më 1526 dhe rrethimi i Vjenës në vitin 1529.⁵

Sulltani nuk përdori vetëm rrugën tokësore në synimet e tij për të përparuar drejt Europës, por u angazhua maksimalisht edhe në ato detare. Pa tentuar këtu të përmenden të gjitha zhvillimet në këtë fushë që ndodhën gjatë periudhës së sundimit të Sulejmanit I dhe, duke u ndalur specifikisht në hapësirat shqiptare, në kontekstin e synimeve të Kanuniut për të sulmuar Europën, vlen të përmendet edhe ekspedita që ai urdhëroi të ndërmerrej në drejtim të Italisë, ku vetë ai erdhi deri në Vlorë.⁶

Të gjitha këto zhvillime, si në rang perandorak ashtu edhe në nivel lokal, lidhen me njëra-tjetrën kur bëhet fjalë për hapësirat kufitare që do të mobilizoheshin në rastet kur sulltani urdhëronte përgatitjet për ndërmarrjen e një fushate ushtarake. Për ta konkretizuar këtë qasje, mjafton të shihet mënyra e hartimit të regjistrit të parë fiskal që i përket hapësirës që po marrim në shqyrtim për shek. XVI. Më saktësisht, fjala është për regjistrin me numër 367 për financat e vilajetit të Rumelisë i vitit 1530, i cili, ndryshe nga praktika normale e hartimit të regjistrave në terren, është përpiluar përmes përfutimit të të dhënave që përmbanin defterët përkatës të hartuar më herët dhe që gjendeshin në duart e burokracisë osmane në qendër. Ky, sipas studiuesve, ishte një angazhim praktik për një nevojë konkrete, ku burokracisë në qendër i nevojitej një panoramë e situatës në terren, para se sulltani të ndërmernte një nismë me rëndësi të veçantë, siç ishte marshimi drejt Europës.⁷

⁵ Feridun M. Emecen, *Kanuni Sultan Süleyman ve Zamanı* (Ankara: Türk Tarih Kurumu Yay., 2022), 171-177.

⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), grup autorësh, redaktor përgjegjës Kristaq Prifti, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 560-561.

⁷ Bëhet fjalë për gjashtë regjistra përmbledhës, të cilët ofrojnë një panoramë demografike dhe fiskale të dy njësive bazë administrative të perandorisë, Rumelisë dhe

Ndonëse i hartuar për një qëllim tjetër, parë në kontekstin e historisë lokale, përkatësisht të sanxhakut të Elbasanit, regjistri i lartpërmendur mbart një simbolikë tejet domethënëse. Kjo lidhet me faktin se ky defter na paraqitet edhe si dokumenti i parë zyrtar që pasqyron një panoramë të detajuar të situatës administrative, demografike, ekonomike, ushtarake e fetare të kësaj zone pas vendosjes së plotë të osmanëve në hapësirën në fjalë.

Mbi fillimet e procesit të islamizimit të shqiptarët nën sundimin osman

Megjithëse mbetet ende një temë e pastudiuar në të gjitha detajet dhe kompleksitetet që paraqet çështja e konvertimit, historiografia shqiptare dhe studiuesit e huaj që e kanë trajtuar këtë temë bashkohen në mendimin se elitat ishin ato që kaluan të parat në besimin e ri, duke i hapur kështu rrugë depërtimit të besimit islam në shoqërinë shqiptare.⁸ Më konkretisht, kur vijmë në gjysmën e parë të shek. XV, vërejmë se thuajse gjysma e familjeve më të mëdha shqiptare kishte kaluar në

Anadollit. Ajo çka është atipike në këtë rast është mënyra e hartimit të regjistrave, të cilët nuk bazohen në të dhëna të mbledhura në terren, por në informacionet e defterëve më të hershëm. Sipas Inalcık-ut, kjo lidhet me nevojat e kancelarisë osmane për të nxjerrë një bilanc të të ardhurave dhe resurseve humane përpara një ngjarjeje të rëndësishme, sikurse ishte ndërmarrja e fushatës ushtarake në drejtim të Europës Qendrore, që do të kulmonte me rrethimin e parë të Vjenës në vitin 1529. Shih: Halil İnalcık, *Devlet-i ‘Alīyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, C. I (İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yay., 2016), 223, 351. Ndërsa sipas Kiel-it, defteri me numër 367, që përfshin edhe sanxhakun e Elbasanit, i përket vitit 1528. Shih: Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri, 1385-1912*, përktheu Klodiana Smajlaj (Tiranë: AIITC, 2012), 137.

⁸ Për një literaturë të zgjeruar në lidhje me islamizimin e elitave, shih: *Historia e Popullit Shqiptar*, 588-589; Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988), 35-38; Dritan Egro, *Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule*, PhD Dissertation (Ankara: Bilkent University, Department of History, 2003), 193-196; Anton Minkov, *Conversion to Islam in the Balkans, Kisve Bahası Petitions and Ottoman Social Life, 1670-1730* (Leiden: Brill, 2004), 71-72; Antonina Zhelyazkova, “Islamization in the Balkans as a Historiographical Problem: The Southeast-European Perspective,” *The Ottomans and the Balkans. A discussion of Historiography*, Ed. Fikret Adanır, Suraiya Faroqhi (Leiden: Brill, 2002), 241-242; Ferit Duka, “XV-XVIII. Yüzyıllarda Arnavut Nüfusunun İslamlaşma Süreci Üzerine Gözlemler,” *OTAM*, sy. 2, no. 2 (1991): 65-66.

besimin islam, ndërsa bijtë e tyre i gjejmë të inkuadruar brenda aparatit shtetëror të sulltanit, duke shërbyer si administratorë, komandantë e funksionarë nën urdhrat e tij. Madje, një pjesë e pinjollëve të këtyre familjeve i hasim si ofiqarë edhe në hapësirat e banuara prej shqiptarëve. Këtu mund të përmenden bijtë e Teodor Muzakës, Jakupi dhe Kasemi, djemtë e Gjin Zenebishit dhe pasardhës të bujarëve të tjerë si ata të Skurajve, Ashtinëve, Kastriotëve etj.⁹

Ndonëse synimi kryesor i konvertimit në këtë fazë të hershme lidhet me politikat e parisë shqiptare të kohës për të ruajtur pozitat, pasuritë dhe njësitë e tyre territoriale,¹⁰ një motivim tjetër, sikurse u përmend më sipër, ishte edhe integrimi në shkallët e burokracisë dhe të qeverisjes osmane, ku kalimi në besimin islam ishte një parakusht i pandryshueshëm. Vetëm në gjysmën e dytë të shek. XIX, më saktësisht si rrjedhojë e ndryshimeve shoqërore, juridike e institucionale që ndërmorën osmanët në kuadër të reformave të Tanzimatit, shtetasit jomyslimanë të perandorisë do të kishin mundësinë të merrnin poste administrative apo ushtarake në shtetin osman.

Kjo qasje e osmanëve ndaj parisë vendase gjatë fazës së vendosjes së tyre në këtë gjeografi duhet parë në një këndvështrim më të gjerë, brenda strategjisë së tyre të zgjerimit, të cilën Inalcık e përmbledh qartësisht me dy terma: atë gradual, pra të vazhdueshëm, dhe

⁹ Halil İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954), 158-161; Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 56-63. Edhe Skëndi e sheh procesin e islamizimit, veçanërisht të elitave, si një mënyrë që shqiptarët të përfitonin nga rendi i ri politiko-ushtarak që po formësohej në Ballkan me vendosjen këtu të një fuqie të re, siç ishin osmanët. Shih: Stavro Skendi, "Religion in Albania during the Ottoman Rule," *Südost-Forschungen*, vol. 15, no. 1 (1956): 311-327. Për një studim të mirëfilltë të gjendjes së elitave shqiptare në prag të depërtimit osman në këto hapësira, shih: Athanas Gegaj, *Shqipëria dhe invazioni turk në shekullin XV*, përktheu Qemal Velija (Tiranë: Zenit Editions, 2025).

¹⁰ Në regjistrin për sanxhakun e Arvanidit vërejmë se një pjesë e madhe e hapësirave territoriale që u përkisnin sinjorëve vendas është shënuar me emrin e tyre. Fjala vjen, zonat e Gjirokastrës, të cilat kishin qenë prej kohësh zotërime të familjes së madhe të Zenebishëve, edhe në këtë defter janë përmendur si *vilajet-i Zenebish*. Edhe tokat e Gjon Kastriotit në të njëjtin regjistër përmenden me emrin e tij, pra *Juvan-ili*. Për më shumë, shih: *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatitur për botim nga Halil İnalcık, përkthyer nga Mykerem Janina, përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim në shqip nga Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2017), XIII. Gjithashtu, shih: Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 62-63.

sistematik.¹¹ Pra, ndonëse krerët e familjeve të mëdha shqiptare të kohës, të cilët pranuan statusin e vasalit të sulltani, vijuan t'i ruanin zotërimet e tyre, pavarësisht faktit se mbetën jomyslimanë në aspektin konfesional, pasardhësit e tyre që u konvertuan arritën jo vetëm t'i ruanin, deri në njëfarë mase, zotërimet e paraardhësve, por edhe t'i forconin pozitat e tyre, duke u bërë pjesë e klasës qeverisëse. Parë nga ky këndvështrim, ky transformim në aspektin religjioz duket se i favorizonte osmanët në konsolidimin e sundimit të tyre në këto hapësira, ndërsa, nga ana tjetër, u ofronte njëfarë sigurie edhe familjeve të mëdha lokale, të cilat garantonin kështu vijimësinë e tyre brenda një realiteti të ri politik, ushtarak, ekonomik dhe kulturor, si ai osman.

Një praktikë tjetër që tërheq vëmendjen gjatë periudhës së depërtimit osman në hapësirat ballkanike në shek. XV, dhe që lidhet ngushtësisht me metodat e shtrirjes graduale të sundimit në këto zona, është përfshirja e timariotëve jomyslimanë brenda sistemit të timarit. Thamë "ballkanike" për arsye se ky fenomen haset edhe në pjesë të tjera të gadishullit, megjithëse këtu do të përqendrohemi kryesisht në gjeografinë e banuar nga shqiptarët.¹² Në studimin e tij, Egro paraqet një tabelë të timariotëve të krishterë që figurojnë në regjistrat osmanë të shek. XV për hapësirën shqiptare. Sipas këtyre të dhënave, në zonat e përfshira në defterin e Përmetit, Korçës dhe Konicës, kjo kategori përbënte 28,4% të numrit të përgjithshëm të zotëruesve të timareve, ndërsa në sanxhakun e Arvanidit kjo shifër arrinte në 11,6%, në defterin e Dibrës 9% dhe në atë të Shkodrës 7 %.¹³

¹¹ Halil Inalcık, "Ottoman Methods of Conquest," *Studia Islamica*, No. 2 (1954): 103-129.

¹² Për më shumë detaje mbi angazhimin e timariotëve të krishterë brenda sistemit osman të timarit në kontekstin ballkanik, shih: Halil Inalcık, "Stefan Dušan'dan Osmanlı İmparatorluğuna: XV. asırda Rumeli'de hristiyan sipahiler ve menşeleri," *Fuad Köprülü Armağanı* (İstanbul: Dil ve Tarih-Coğrafya Fakültesi, 1953), 207-248.

¹³ Për më shumë detaje, shih: Egro, *Islam in Albanian Lands*, 191. Në një artikull me teza "sfiduese" mbi procesin e islamizimit të shqiptarët, Kaleshi thekson faktin se timaret e zotëruara prej të krishterëve kishin të ardhura shumë më të vogla krahasuar me ato të timariotëve myslimanë. Prandaj, me synimin për të ruajtur statusin e tyre, këta detyroheshin të kalonin në besimin islam. Për më shumë, shih: Hasan Kaleshi, "Türkler'in Balkanlar'a girişi ve islamlaştırma. Arnavud halkının etnik ve milli varlığının korunmasının sebepleri," *Tarih Enstitüsü Dergisi*, sy. 10-11 (1979-1980): 188-189.

Të dhënat e mësipërme, edhe pse u përkasin rajoneve të ndryshme, kronologjikisht na lënë të kuptojmë se integrimi i timariotëve të krishterë në sistemin e timarit ka funksionuar në raport me fazat e depërtimit të osmanëve në hapësirat shqiptare. Zonat juglindore, të cilat u bënë objekt i mësymjeve osmane më herët dhe ku figurojnë edhe rastet më të hershme të ndarjes së timareve, paraqesin edhe numrin më të madh të timariotëve të krishterë.¹⁴ Ndërsa në defterin për sanxhakun e Shkodrës (1485), një hapësirë e përfshirë pothuajse në fund të shekullit nën sundimin osman, në një kohë kur kishte përfunduar rezistenca nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe venecianët ishin tërhequr nga kjo gjeografi, dhe kur territore të tjera ndodheshin prej dekadash nën administrimin e sulltanit, numri i të krishterëve që zotëronin timare ishte dukshëm më i vogël. Kjo panoramë korrespondon edhe me metodat graduale të pushtimit për të cilat Inalcık flet në artikullin e tij, pra me procesin e transformimit apo asimilimit të elitave ekzistuese.¹⁵

Regjistrat kadastrorë nxjerrin në pah faktin se një pjesë e bijve të të krishterëve që zotëronin timare u islamizuan, duke na lënë të kuptojmë se kjo praktikë e ndarjes së tokës shtetërore tek individë të caktuar, në kuadër të sistemit të timarit, shërbente gjithashtu edhe si një instrument që ndikonte në procesin e islamizimit. Fjala vjen, në defterin për zonat e Përmetit dhe të Korçës, timari që më herët zotërohej nga Dhimitri iu dha të birin të tij, i sapokonvertuar në besimin islam, i cili, siç mësohet, kishte ndryshuar edhe emrin, duke u quajtur Kasem.¹⁶

Pikëpamjet se ndarja e timareve tek të krishterët ishte një strategji e osmanëve për të thyer rezistencën e banorëve vendas dhe për të siguruar një depërtim sa më të butë në hapësirat që synonin, por edhe për të realizuar një transformim elitash në një projeksion më të gjatë, dallohen gjithashtu edhe nga madhësia e timareve që u jepeshin jomyslimanëve. Veçanërisht studimet e Pulahës, i cili i ka kushtuar një studim të mirëfilltë kësaj çështjeje, theksojnë qartësisht faktin se, ndonëse më të

¹⁴ Shpërndarjet më të hershme të timareve i përkasin defterit për zonat e Përmetit dhe Korçës të vitit 1431 dhe datojnë që në periudhën e sundimit të Bajezidit I (1389-1402). *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431*, përkthyer nga Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2018), XII-XV.

¹⁵ Inalcık, *Ottoman Methods of Conquest*, 109-113.

¹⁶ *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431*, 61. Për raste të ngjashme në të njëjtin defter, shih 84, 118, 131.

pakta në numër krahasuar me timaret që zotëronin myslimanët, feudet në duart e timariotëve të krishterë qëndronin më poshtë edhe në aspektin e të ardhurave. Sipas autorit të lartpërmendur, vetëm 20 % e timareve të jomyslimanëve kishin të ardhura vjetore që arrinin në 6 000-10 000 akçe, ndërsa pjesa më e madhe, përkatësisht rreth 33 %, siguronin diku mes 2 000-6 000 akçeve në vit.¹⁷

Një tjetër kategori, sigurisht më e vogël në numër, por që kishte ndikim të popullata e gjerë dhe që e gjejmë të përfshirë në regjistrat kadastrorë, ishin edhe klerikët. Ajo që tërheq më së shumti vëmendjen edhe në këtë rast, është fakti se timare u ishin shpërndarë edhe priftërinjve. Shembuj të tillë i hasim si në defterin për sanxhakun e Arvanidit (1431), ashtu edhe në atë për Përmetin dhe Korçën (1431), si dhe në defterin për zonat e Dibrës (1467). Kështu, në Kaninë peshkopi i këtushëm zotëronte një timar, ku, veç hiseve të tjera, pjesë e këtij feudi ishte edhe kisha Peshkopije që ndodhej aty, si dhe vreshti i këtij tempulli.¹⁸ Ky fenomen nuk mbetet i kufizuar vetëm te këta shembuj; ndarje të tilla për klerikët e krishterë, që reflektohen në këta regjistra, i hasim edhe në Korçë, Krujë, Berat, Mat etj.¹⁹

Nisur nga parashtrimi që realizuam më lart, mund të themi se përfshirja e një pjese të elitave shqiptare në strukturat qeverisëse, ushtarake, ekonomike e kulturore osmane duket se ka qenë një nga faktorët që ndikoi në përhapjen e besimit islam jo vetëm te shtresat e larta të shoqërisë, por edhe te popullsia e gjerë, proces i cili nis dhe merr vrull nga dekadat e fundit të shek. XV dhe në fillim të shekullit pasardhës. Ky konstatim nuk vlen vetëm për hapësirat e banuara me popullsi shqiptare, por edhe në rrafshin ballkanik. Kështu, sipas informacioneve të përfutuara nga burimet e kohës, përkatësisht nga regjistrat e xhizjes, e cila ishte taksa që vlej prej popullatës së krishterë për vitet 1488-1491, në gjithë hapësirën e Rumelisë, numri i personave që kalonin në besimin islam arrinte deri në 300 raste në vit.²⁰

Panorama nis të ndryshojë në gjysmën e parë të shek. XVI. Sipas regjistrave osmanë të kësaj periudhe, që japin një pasqyrë demografike të perandorisë, ndërmjet viteve 1520-1555 përllogaritej se brenda hapësirës

¹⁷ Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 63.

¹⁸ Timari i peshkopit në fjalë përbëhej në total nga një fshat, dhjetë shtëpi, një kishë dhe një vresht. Shih: *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, 83-84.

¹⁹ Për shembujt në fjalë, shih Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 69.

²⁰ İnalçık, *Devlet-i 'Aliyye*, 201.

së Rumelisë kishte plot 1 111 799 shtëpi (*hâne*), prej të cilave 832 707 ishin të krishtera, ndërsa 194 958 rezultojnë myslimane. Sipas këtyre të dhënave, popullsia myslimane e Rumelisë në atë kohë përbënte rreth 18% të numrit të përgjithshëm të banorëve që jetonin në këtë gjeografi.²¹ Sigurisht, pjesa më e madhe e kësaj popullsie (myslimane) jetonte në zonat urbane, ku dendësia ishte më e lartë.

Themi qendra urbane për arsye se edhe këto pësuan ndryshime, të cilat shkonin paralelisht me konsolidimin e aspektit administrativ, si edhe me zhvillimet ekonomike e kulturore që ndodhën këtu në kapërcyell të shek. XV-XVI. Kjo nuk vlen vetëm për trojet shqiptare, por për të gjitha ato hapësira kufitare ku u vendos plotësisht sundimi osman. Këtë herë, burimet nuk flasin më për qytete brenda mureve rrethuese të kalave, por për qendra urbane të mirëfillta, cilësuar si *shehir*, që nënkupton qytetin me të gjithë përbërësit e tij në kontekstin e infrastrukturës dhe urbanistikës.²² Në fillimet e shek. XVI, pasi ishte konsoliduar sundimi, ishte vendosur rendi dhe banorët ndiheshin më të sigurt, vërehet edhe vendosja e shtëpive jashtë mureve të kalave, në rrethina që, sipas përdorimit osman të kohës, emërtoheshin *varoshe*. Për këto, Evlija Çelebiu na jep informacione të detajuara në gjysmën e dytë të shek. XVII.²³

Në fundin e shek. XV dhe në fillimet e shek. XVI, qytetet shqiptare, të brishta si në aspektin demografik, ashtu edhe në atë ekonomik e urbanistik, figuronin të banuara në masën dërrmuese prej banorëve të krishterë. Me këtë formulim nënkuptohet popullsia vendase, pasi trupat ushtarake të pozicionuara kryesisht në kalatë e këtyre qendrave, si dhe administrata osmane, i përkisnin besimit islam. Megjithatë, duhet theksuar se ka edhe raste përjashtimore, sikurse vërehet në qytetin e Shkodrës apo në qendra të tjera urbane të Kosovës, si Peja, Vushtrria e Prishtina, ku hasen edhe familje myslimane.²⁴

²¹ Për më shumë detaje mbi numrin e përgjithshëm të banorëve të perandorisë në këtë kohë, shih: *po aty*.

²² Nikolai Todorov, *The Balkan City, 1400-1900* (Seattle: University of Washington Press, 1983), 20.

²³ Në rastin e qytetit të Elbasanit, që është temë shqyrtimi e këtij artikulli, shih përshkrimin që Çelebiu i bën pjesës së varoshit: *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, VIII. Kitap, C. 2, Haz. Seyit Ali Kahraman (Istanbul: Yapı Kredi Yay., 2011), 693-694.

²⁴ Për një panoramë më të gjerë, shih: *Historia e Popullit Shqiptar*, 589-590. Për gjendjen e qyteteve shqiptare gjatë shek. XV dhe në fillimet e shekullit pasardhës, shih

Qyteti i Elbasanit dhe sanxhaku me të njëjtin emër, si njësi më e madhe provinciale që përfshinte hapësirat përreth brigjeve të Shkumbinit deri në bregdet, paraqesin ndoshta rastin më ilustrues sa i përket raportit ndërmjet futjes së një zone të caktuar nën sundimin osman, organizimit të saj si njësi administrative dhe zhvillimit ekonomik, kulturor e politik, duke përfshirë këtu edhe procesin e islamizimit.

Islamizimi në sanxhakun e Elbasanit në gjysmën e parë të shek. XVI

Sipas regjistrit numër 367, në gjysmën e parë të shek. XVI, sanxhaku i Elbasanit figuron i ndarë në tri kaza: atë të Elbasanit, që shërbente në të njëjtën kohë si seli e sanxhakbeut dhe qendër e sanxhakut; kazanë e Durrësit (Draç në dokumentet osmane); dhe të Shpatit (İşbat). Vetë fakti se në këtë regjistër nuk bëjnë pjesë fshatra të nahijes së Çermenikës,²⁵ të cilat i vërejmë të përfshira në defterin nr. 472 të vitit 1569,²⁶ na lë të kuptojmë se sanxhaku i lartpërmendur është konsoliduar plotësisht në aspektin e përbërjes territoriale vetëm në gjysmën e dytë të shekullit. Ndërsa fshatra të tjera, të cilat më herët i hasim në defterin e sanxhakut të Arvanidit (1431), i gjejmë të përfshira që në regjistrin nr. 367.*

Për t'u futur në leximin e tekstit, duhet thënë se defteri i lartpërmendur është i llojit *ixhmal* (i përmbledhur), pra ai paraqet një

gjithashtu: Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973), 26-30.

²⁵ Në defterin për zonat e Dibrës të vitit 1467, nahijen e Çermenikës e hasim të regjistruar brenda kazasë së Dibrës, ndërsa në atë me nr. 367 të vitit 1530 për Elbasanin, Çermenika nuk është përfshirë si nahije; ndërkohë që një pjesë të fshatrave të saj i gjejmë të shënuara në listën e vendbanimeve që bënin pjesë në kazanë e Shpatit. Vetëm në regjistrat e viteve 1569-1570 dhe 1583 nahijen e Çermenikës e hasim të shënuar në defterin për sanxhakun e Elbasanit. Për më shumë në lidhje me këtë çështje, shih: Eduart Caka, "Krahina e Çermenikës në burimet osmane të shek. XV-XVI," *Çermenika dhe trevat e Librazhdit në regjistrat osmanë të shek. XV-XVII* (Tiranë: Barleti, 2023), 36-47.

²⁶ *Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi* (më tej: BOA), Tapu Tahrir Defterleri (TT.d.), nr. 472.

* Duke vazhduar nga fshatrat që bënin pjesë në zonën e Kërrabës deri te vendbanimet më të afërta me Elbasanin, siç mund të përmendet Bradasheshi në vitin 1431, ato i gjejmë të regjistruara dhe të ndara në defterin e sanxhakut të Arvanidit. Ndërsa në defterin nr. 367 të vitit 1530, ato, si dhe e gjithë hapësira përreth, janë përfshirë në sanxhakun e Elbasanit.

panoramë statistikore të timareve, emrave të fshatrave, numrit të familjeve dhe të ardhurave që vilesnin këtu – aspekt i cili e vështirëson evidentimin e kohës se kur mund të jenë konvertuar familjet apo individët që rezultojnë si myslimanë në këtë regjistrim.²⁷ Një problem i dytë që lidhet me saktësimin e procesit të datimit të këtyre konvertimeve ka të bëjë me faktin se defteri në fjalë është përpiluar plot një shekull pas regjistrimit të parë në këto hapësira, përkatësisht atij për sanxhakun e Arvanidit (1431), dhe, duke mos pasur regjistrime të ndërmjetme, e kemi të pamundur të kryejmë krahasime për të evidentuar kohën se kur ka ndodhur ndryshimi i besimit për shtëpitë që në vitin 1530 shënohen si myslimane.

Pas evidentimit të këtyre elementeve, le të futemi në brendësi të defterit, duke parë fillimisht në rang kazaje dhe më pas në nivel sanxhaku procesin e islamizimit në livanë e Elbasanit thuajse shtatë dekada pas ripopullimit të qytetit nga Mehmedi II.

Kazaja e Elbasanit

Qendra e kazasë ishte vetë qyteti i Elbasanit, i cili shërbente gjithashtu edhe si seli e sanxhakbeut dhe njëkohësisht si hapësira më e madhe urbane, ekonomike e demografike e gjithë livasë. Për këtë arsye, edhe regjistri fillon me lagjet e qytetit, të cilat i gjejmë të ndara në lagje myslimane dhe të krishtera. Banorët myslimanë të këtushëm numërojnë gjithsej 108 shtëpi, të ndara në: myslimanë që jetonin brenda kështjellës (45 shtëpi), të tjerë që jetonin pranë saj (55 shtëpi), si dhe lagjen “Kosar” me 8 shtëpi.²⁸

Ndërsa lagjet e krishtera (*mahalle-i gebran*) të Elbasanit qenë më të shumta në numër, gjë që nënkuptonte edhe epërsinë e të krishterëve në raportin demografik të popullsisë së kësaj qendre urbane. Një element tjetër thelbësor në lidhje me këto lagje ka të bëjë me origjinën e tyre, ku

²⁷ Në defterët e hollësishëm (*mufassal*), nën emrat e fshatrave përmenden edhe krerët e shtëpive, përkatësisht me emrin e banorit dhe atësinë e tij. Në rastet kur personi në fjalë është konvertuar rishtas, emri i të atit shënohet si *Abdullah*, gjë që na lejon të kuptojmë se ky është brezi i parë i konvertuar. Por, nëse konvertimi ka ndodhur më herët, atëherë në regjistrime dallohen dy emra myslimanë, pra i birit dhe i të atit. Fjala vjen, Hyseni, i biri i Abdullahut, duke na lënë të kuptojmë se Hyseni i përket brezit të dytë të konvertuar. Për shembuj të tillë regjistrimesh të ngjashme, shih: Egro, *Islam in Albanian Lands*, 216.

²⁸ BOA, TT.d 367, fl. 432. Gjithashtu, shih: Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137.

një pjesë u sollën këtu me detyrim nga Mehmedi II në vitin 1466, kur rindërtoi muret e kalasë duke e kthyer atë në një vend të banueshëm, ndërsa pjesa tjetër e këtyre lagjeve përbëhej nga banorë që erdhën dhe u vendosën me dëshirën e tyre. Të shpërngulurit (*Cema'at-i Gebran-ı Sürgünan der nefsi Ilbasan*) u vendosën në nëntë lagje: “Ohri”, “Kesrije”, “Narda”, “Sofja”, “Uskub”, “Janja”, “Siroz”, “Avlonja” dhe “Dhimo Nallband”, me një total prej 73 shtëpish, 15 beqarësh dhe 5 vejushash.²⁹ Ndërkaq, ata që erdhën dhe u vendosën vetë në qytet (*Cemaat-i gebran ki kendi ihtiyarı ile mütemekkin olmuşlardır*) ishin të shpërndarë në katër lagje, ku regjistroheshin gjithsej 97 shtëpi dhe 9 beqarë.³⁰

Një detaj tjetër që bie në sy është fakti se familjet e lagjeve të krishtera, të deportuara nga Mehmedi II për të populluar qytetin, rezultojnë të jenë përjashtuar nga taksat e ispenxhes dhe avariz-it, si rrjedhojë e statusit të tyre, pasi ishin detyruar të braktisin vendbanimet e tyre për të ardhur në Elbasan. Sipas shënimit në regjistër, sulltani i kohës, i cili duhet të ketë qenë Sulejmani I, kishte urdhëruar që familjeve në fjalë t’u ngarkohej taksa e avariz-it, por, pas ankesës së tyre dhe duke rikujtuar vendimin e mëhershëm të sulltanit që i kishte sjellë në qytet, urdhri u anulua dhe ato vijuan të mbeteshin të përjashtuar nga dy zërat e taksimit.³¹

Sipas shifrave të dhëna më lart, mund të dilet në përfundimin se në gjysmën e parë të shek. XVI, thuajse 38% e popullsisë së qytetit i përkiste

²⁹ Për vendet nga ku u deportuan këta banorë, numrin e shtëpive dhe përjashtimet nga disa detyrime taksore si rrjedhojë e faktit që u shpërngulën në mënyrë të pavullnetshme, shih: Eduart Caka, “The Making of a Bordering Town: The City of Elbasan during XV-XVI Centuries,” *Albanian Studies*, vol. 2, no. 2 (2023): 66-67. Njëra ndër pikëpamjet që shpjegon konvertimin e shqiptarëve në besimin islam është ajo sipas së cilës ky ndryshim në aspektin religjioz erdhi si rrjedhojë e taksave dhe e detyrimeve ekonomike. Njëri ndër të parët që e ka elaboruar këtë tematikë është edhe Stadtmüller-i. Shih: Georg Stadtmüller, “Die Islamisierung bei den Albanern,” *Jarbücher für Geschichte Osteuropas*, Bd. 3 (1995): 404-429.

³⁰ Përveç shtëpive të lartpërmendura, në regjistër shënohen edhe katër shtëpi të tjera, banorët e të cilave, sipas shënimit përkatës, ishin hekurpunues. Shih BOA, TT.d 367, fl. 432.

³¹ “*Der-nefs-i İlbasan. Mezkurun kafirler evvelde heman haraç virüp ispençden ve Avarız-ı divaniden muaf ve müsellemler idi. Şimdiki halde bi-emr-i padişah-ı alempenah adet üzere haraç ve ispenç ve gayrı rüsum emr olundu. Heman avarız-ı divaniyeden muafıdır diyü defter-i atikde mukayyed olduğu sebepten defter-i cedide dahi kayd olundu.*” Po aty.

besimit islam.³² Një shifër e konsiderueshme kjo, nëse kemi parasysh se qyteti ishte i ri krahasuar me qendrat e tjera urbane shqiptare, ndërsa kishte një numër popullsie relativisht të lartë, që sipas Kiel-it i afrohej shifrës së 1 500 banorëve.³³ Për më tepër, edhe peizazhi urbanistik, kulturor dhe social e favorizonte këtë klimë, ku përmes institucioneve të vakëfeve u ngritën objekte arkitekturore që shpalosnin edhe mentalitetin dhe “pamjen” e besimit të ri. Në këtë kontekst, veçanërisht për dekadat e para të shek. XVI, vlen të përmendet vakëfi i ngritur nga Sinan Pasha, një institucion që luajti rol thelbësor në transformimin kulturor, fetar dhe ekonomik të qytetit të Elbasanit.³⁴ Sa u përket faktoreve të besimit islam, regjistri nr. 367 përmend ekzistencën e tri xhamive në rang sanxhaku deri në vitin 1530, ndërsa numri i mesxhideve arrinte në nëntë.³⁵

Përveç qytetit, kazaja e Elbasanit në regjistër duket se kishte nën varësinë e saj edhe një total prej 71 fshatrash. Në përputhje me praktikën e ndarjes së tyre në kuadër të sistemit të timarit, edhe këto fshatra vërehen të kenë qenë pjesë e timareve që zotëroheshin nga ushtarakët. Nisur nga fakti se sanxhaku në fjalë shtrihej në një zonë kufitare, përqendrimi ushtarak në këtë hapësirë, që lidhej veçanërisht me sigurimin e kalave dhe të vijës bregdetare, ishte shumë më i theksuar. Për rrjedhojë, edhe fshatrat e kazasë së lartpërmendur shfaqen të ndara si timare të sanxhakbeut dhe të rojave të kalave, përkatësisht të Elbasanit dhe të Durrësit. Vetëm fshati Bradashesh bënte përjashtim, pasi ishte mylk i Sinan Pashës.³⁶

Në tabelën e mëposhtme paraqiten fshatrat që kishin shtëpi myslimane:

³² Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137.

³³ *Po aty*. Për demografinë e qyteteve shqiptare në këtë kohë, shih gjithashtu: Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 405-407; Selami Pulaha, “Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI,” *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989), 45-48.

³⁴ Për institucionin në fjalë, shih: Eduart Caka, “Vakëfi i Sinan Pashës dhe ndikimi i tij në zhvillimin urbanistik e kulturor të Elbasanit gjatë shek. XVI,” *Studime historike*, nr. 1 (2024): 5-25; Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 138-139.

³⁵ BOA, TT.d 367, fl. 451.

³⁶ Fshati në fjalë në regjistër figuron me 98 shtëpi, të gjitha të krishtera. Shih: *po aty*, fl. 439.

Emri i fshatit	Pronësia e timarit	Shtëpi myslimane	Beqarë (b) Vejusha (v)	Shtëpi të krishtera	Beqarë (b) Vejusha (v)
Murras	Has i sanxhakbeut	25		27	
Selçani	"	11	2 (b)	46	8 (b)
Dardhas	Timar	3		83	
Veshkaq	"	1		6	
Polis	"	2		60	71 (b)
Bullari	"	2	2 (b)	36	
Pajun	"	3		9	
Kavas	"	1		19	
Manes	Timar i rojave të Elbasanit	4		32	1 (b) 2 (v)
Dritas	"	2		9	1 (b)
Bizhutë	"	11		61	3 (b)
Shingjon	"	3		26	
Patresh	"	4		40	3 (b)
Lutmir	"	3		32	
Ishtemanik	"	2		48	
Shilbatër	"	5		38	
Kurtali	"	6		41	
Vilë	"	4		35	
Graçaç	"	3		33	
Letani	"	7		39	7 (b)
Lugaj	"	1		6	
Karveq	"	2		6	2 (b)
Pajengë	Timar i rojave të Durrësit	5		26	
Hasbiraj	"	2		101	

Sikurse vërehet edhe në tabelë, nga 71 fshatra që vareshin nga kazaja e Elbasanit në regjistrin nr. 367 të vitit 1530, 24 prej tyre kanë edhe familje myslimane në përbërje. Parë në aspektin numerik të shtëpive, defteri në fjalë regjistron 213 shtëpi myslimane në rang kazaje, ndërsa numri i shtëpive të krishtera arrin në 2 444.³⁷ Sipas këtyre të dhënave, rezulton se, nga përfshirja e kësaj hapësire nën sundimin osman

³⁷ Po aty.

deri në kohën e hartimit të regjistrit në shqyrtim, procesi i islamizimit në kazanë e Elbasanit varionte në shifrat 8-8,1 %.

Kazaja e Durrësit

Ndonëse qyteti i Durrësit dhe vija bregdetare përreth u futën më vonë nën sundimin osman, i cili u shtri në këtë hapësirë vetëm pas rënies së qytetit në vitin 1501, edhe këtu vërehet se, brenda një harku kohor prej thuajse tri dekadash, procesi i islamizimit nis të shfaqet nëpër fshatra. Më poshtë po paraqesim një tabelë ilustruese të fshatrave ku evidentohen shtëpi myslimane:

Emri i fshatit	Pronësia e timarit	Shtëpi myslimane	Beqarë (b) Vejusha (v)	Shtëpi të krishtera	Beqarë (b) Vejusha (v)
Bariq	Has i sulltanit	2		24	
Andrejas	"	2		56	
Diker ?	"	2		124	
Luz	Has i sanxhakbeut	14		133	
Milot ?	"	1		89	
Thelpenat ?	"	2		61	
Bugoj	"	2		78	
Mankaros	"	2		80	2 (b)
Kavajë	Timar	1		52	
Kryezi ?	"	1		94	50 (b)
Pjetër Andrea ?	"	1		42	
Ketes ?	Rojat e kalasë së Durrësit	2		31	
Mlik	"	2		85	
Batër	"	1		73	
Iflolani ?	"	2		10	
Lijas	"	1		11	
Gosë	"	1		2	
Galush	"	3		18	2 (b)
Mazarak	"	1		15	
Çerme	"	5		30	
Pallashin ?	"	1		22	
Ndroq	"	16		221	24 (b)

Sipas tabelës përmbledhëse në regjistër, vërehet se fshatrat e kësaj kazaje janë të ndara në hasë të padishahut,³⁸ hasë të sanxhakbeut, timare të rojave të kalasë së Durrësit dhe timare të zaimëve apo timariotëve të tjerë. Në total, e gjithë kazaja ka 66 fshatra, në 22 prej tyre numërohen 65 shtëpi myslimane, ndërsa numri i shtëpive të krishtera në rang kazaje arrinte në 3 100.³⁹ Bazuar në të dhënat e mësipërme, rezulton se procesi i islamizimit në kazanë e Durrësit në vitin 1530, pra thuajse tri dekada pas kalimit nën sundimin osman, varionte në shifrat 1,9-2%.

Kazaja e Shpatit

Kazaja e Shpatit kishte edhe numrin më të madh të fshatrave brenda sanxhakut; për rrjedhojë, edhe numri i fshatrave me shtëpi myslimane këtu rezulton më i lartë. Më poshtë paraqitet një tabelë e detajuar:

Emri i fshatit	Pronësia e timarit	Shtëpi myslimane	Beqarë (b) Vejusha (v)	Shtëpi të krishtera	Beqarë (b) Vejusha (v)
Prevale	Has i sanxhakbeut	14		43	
Dink ?	"	9		37	1 (b)
Shënvlash	Timar	2		35	3 (b)
Belsh	"	2		81	
Buga ?	"	12		21	1 (b)
Belasovë	"	5		111	
Kajçan	"	1		4	
Lubine ?	"	2		32	
Kukuçovë	"	9		1	
Bukëmir	"	9		57	
Shtrominë	"	7		63	4 (b)
Sulovë	"	4		19	1 (b)
Pashtresh	"	1		5	
Igovinë ?	"	2		10	

³⁸ Për haset e sultanit në Durrës dhe sanxhaqet e tjera shqiptare gjatë kësaj kohe, shih: Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare*, 186-188.

³⁹ Në tabelën e mësipërme rezultojnë 65 shtëpi myslimane, ndërsa në regjistër janë shënuar 63 të tilla, përkatësisht 46 që e paguanin taksën e avariz-it dhe 17 të tjera që mbeteshin të përjashtuara nga ky detyrim. Për shifrat përfundimtare të defterit, shih BOA, TT.d 367, fl. 445.

Poraçan i Epërm	"	2		24	4 (b)
Iskilabolisht ?	"	1		33	
Grabova	"	7		95	5 (b)
Valesh	"	1		9	
Dorëz	"	7		22	
Jarunish	"	2		16	4 (b)
Kuqani-Zovine	"	13		19	2 (b)
Peskopje ?	"	7		63	6 (b)
Sunova ?	"	1		24	
Menkani ?	"	2		5	1 (b) 1 (v)
Kuçan	"	6		24	1 (b)
Kurtekani	"	2		25	1 (b)
Gjerçan	"	1		27	1 (b)
Valesh	"	5		45	
Tunje ?	"	2		30	
Shushicë	"	1		24	
Buljares	"	7		64	
Shëmri	"	5		14	1 (b)
Sotira	"	7		21	
Gramësh	Rojat e kalasë së Durrësit	2		44	1 (v)

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në kazanë e Shpatit, e cila në regjistër figuron me 113 fshatra, 34 prej tyre banoreshin edhe nga popullsi myslimane. Sa i përket numrit të shtëpive, kazaja e lartpërmendur kishte gjithsej 250 shtëpi myslimane dhe 3 372 të krishtera.⁴⁰ Procesi i islamizimit në këtë kaza varionte në shifrën 6,9%.

Pasi u paraqitën me hollësi fshatrat në të cilat hasen shtëpi myslimane brenda kazave që bënin pjesë në livanë e Elbasanit, tashmë le ta shohim situatën në shifra të përmbledhura. Kështu, në fund të

⁴⁰ Në këtë numër përfshihen edhe 12 lagjet që vërehen në këtë kaza, të cilat kishin gjithashtu në përbërjen e tyre shtëpi myslimane, por që nuk i kemi përfshirë në tabelë. Për të dhënat e plota mbi kazanë e lartpërmendur, shih: *po aty*, fl. 451.

regjistrimit të sanxhakut të lartpërmendur, shënohet se kjo njësi administrative kishte gjithsej 250 fshatra, në të cilat numëroheshin 8 916 shtëpi të krishtera dhe 526 myslimane.⁴¹ Sipas këtyre të dhënave, rezulton se bëhet fjalë për një provincë me 9 442 shtëpi, ndërsa procesi i islamizimit varionte në shifrën 5,5%.

Të dhënat e mësipërme na mundësojnë të nxjerrim disa përfundime lidhur me shtrirjen dhe përmasat e procesit të islamizimit në sanxhakun e Elbasanit, vetëm disa dekada pas formimit të kësaj njësie administrative dhe gati një shekull pas përfshirjes së disa territoreve nën sundimin osman, të cilat iu bashkëngjitën livasë pas krijimit të saj. Kështu, konkluzioni i parë ka të bëjë me fillimin e procesit të islamizimit, i cili duket se ka nisur thuajse paralelisht me formësimin e sundimit osman në hapësirat shqiptare. Ndonëse pikëpamjet e deritanishme flasin për një proces islamizimi që nis nga shek. XVII dhe kryesisht në zonat urbane,⁴² së paku për sanxhakun e Elbasanit, sikurse shihet nga të dhënat që përmban regjistri i parashtuar më lart, mund të thuhet se ky fenomen shfaqet më herët. Kjo nuk vlen vetëm për elitat, siç qenë familjet e mëdha apo timariotët e krishterë të cilët ishin angazhuar në strukturat qeveritare apo ushtarake osmane, por edhe për banorët e thjeshtë që banonin brenda sanxhakut.

Aspekti i dytë që del në pah nga shqyrtimi i defterit nr. 367 lidhet me faktin se procesi i islamizimit nuk shihet i përqendruar vetëm në qytete,⁴³ por vërehet i shtrirë në gjithë hapësirën e sanxhakut, sigurisht jo në mënyrë të njëtrajtshme. Ndërkohë, në regjistrin e mësipërm shohim se, nga 250 fshatra që kishte i gjithë sanxhaku, në 80 prej tyre banonin edhe familje myslimane.

Një element i tretë që bëhet i dukshëm në regjistër lidhet me shtrirjen e islamizimit, i cili duket se ka ardhur në mënyrë graduale. Për ta ilustruar këtë pikëpamje, mjafton të shohim të dhënat mbi numrin e shtëpive myslimane në kazanë e Durrësit, e cila është edhe zona më e fundit e përfshirë brenda sanxhakut, po të kemi parasysh faktin se deri më 1501 këtu ishin të pranishëm venecianët. Ndryshe nga kazaja e Shpatit apo ajo e Elbasanit, fshatrat e të cilave i hasim në regjistrat osmanë që në vitet 1430, në vendbanimet që vareshin nga Durrësi dhe që kishin hyrë

⁴¹ *Po aty*, fl. 452.

⁴² *Historia e Popullit Shqiptar*, 588-589.

⁴³ “Depërtimi në shkallë të gjerë i fesë islame në radhët e popullit shqiptar gjeti shprehje pikësëpari në qytete.” Shih: *po aty*, 589.

rishtazi nën sundimin osman, procesi i islamizimit rezulton të ketë qenë dy deri në tri herë më i ulët.

Përfundime

Ndonëse sanxhaku i Elbasanit, si njësi administrative, i përket fillimeve të shek. XVI, pjesë të ndryshme të kësaj zone i gjejmë të regjistruara që një shekull më herët në defterët osmanë. Më konkretisht, zonat që më vonë do të përfshiheshin në këtë liva vërehen në defterin e sanxhakut të Arvanidit (1431) dhe në atë të zonave të Dibrës (1467). Ndërsa në këtë artikull jemi ndalur te regjistri i parë që i përket këtij sanxhaku, përkatësisht defteri nr. 367 i vitit 1530, duke u përqendruar në një temë të veçantë, atë të islamizimit. Kjo është bërë me synimin për të marrë si model një hapësirë të caktuar dhe për ta shqyrtuar këtë fenomen në krahasim me pikëpamjet dhe studimet që ekzistojnë deri më sot mbi procesin e islamizimit të shqiptarëve.

Sikurse u pa edhe nga të dhënat e paraqitura më lart, duket se islamizimi në sanxhakun e Elbasanit ka ndjekur disa trajektore, të cilat mund të përmbliidhen shkurtimisht si vijon: 1) nga elitat të banorët e thjeshtë, në aspektin e hierarkisë dhe statusit shoqëror; 2) një përhapje graduale në aspektin hapësinor dhe kronologjik, e cila tregon përparimin në raport me zgjerimin territorial të osmanëve dhe konsolidimin e pushtetit të tyre.

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi (më tej: BOA), Tapu Tahrir Defterleri (TT.d.), nr. 472.

Vëllime burimore:

367 Numaralı Muhâsebe-i Vilâyet-i Rûm-ili Defteri ile Avlonya Livâsı Tahrîr Defterleri (926-1520/937-1530), C. III, Ankara: Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, 2008.

Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431, përkthyer nga Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2018.

Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431, përgatitur për botim nga Halil Inalcık, përkthyer nga Mykerem Janina, përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim në shqip nga Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2017).

Literaturë historiografike:

BARTL, Peter. *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane*. Përkthyer nga Pëllumb Xhufi. Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria, 2011.

CAKA, Eduart. “Krahina e Çermenikës në burimet osmane të shek. XV-XVI.” Në *Çermenika dhe trevat e Librazhdit në regjistrat osmanë të shek. XV-XVII*, 36-47. Tiranë: Botimet Barleti, 2023, 36-47.

CAKA, Eduart. “Prania e elementit shqiptar në fushatën osmane të Maltës të vitit 1565.” *Studime historike*, nr. 1-2 (2019): 35-53.

CAKA, Eduart. “The Making of a Bordering Town: The City of Elbasan during XV-XVI Centuries.” *Albanian Studies* 2, nr. 2 (2023): 59-77.

CAKA, Eduart. “Vakëfi i Sinan Pashës dhe ndikimi i tij në zhvillimin urbanistik e kulturor të Elbasanit gjatë shek. XVI.” *Studime historike*, nr. 1 (2024): 5-25.

DUKA, Ferit. “XV-XVIII. Yüzyıllarda Arnavut Nüfusunun İslamlaşma Süreci Üzerine Gözlemler.” *OTAM* 2, nr. 2 (1991): 63-71.

EGRO, Dritan. *Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule*. PhD diss., Bilkent University, Department of History. Ankara, 2003.

EMECEN, Feridun M. *Kanuni Sultan Süleyman ve Zamanı*. Ankara: Türk Tarih Kurumu Yayınları, 2022.

Evliya Çelebi Seyahatnamesi. Vol. 8, bk. 2. Redaktuar nga Seyit Ali Kahraman. Istanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2011.

GEGAJ, Athanas. *Shqipëria dhe invazioni turk në shekullin XV*. Përkthyer nga Qemal Velija. Tiranë: Zenit Editions, 2025.

Historia e Popullit Shqiptar. Vëll. 1: Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX. Grup autorësh. Redaktuar nga Kristaq Prifti. Tiranë: Toena, 2002.

İNALCIK, Halil. “Ottoman Methods of Conquest.” *Studia Islamica*, nr. 2 (1954): 103-129.

- İNALCIK, Halil. "Stefan Dušan'dan Osmanlı İmparatorluğuna: XV. asırda Rumeli'de hıristiyan sipahiler ve menşeleri." Në *Fuad Köprülü Armağanı*, 207-248. İstanbul: Dil ve Tarih-Coğrafya Fakültesi, 1953, 207-248.
- İNALCIK, Halil. *Devlet-i 'Aliyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*. C. 1. İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2016.
- İNALCIK Halil. *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*. Völl. 1. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954.
- KALESHI, Hasan. "Türkler'in Balkanlar'a girişi ve islamlaştırma. Arnavud halkının etnik ve milli varlığının korunmasının sebepleri." *Tarih Enstitüsü Dergisi*, nr. 10-11 (1979-1980): 177-194.
- KIEL, Machiel. "İlbasan." Në *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII, 79-81. İstanbul: TDV Yayınları, 2000, 79-81.
- KIEL, Machiel. *Arkitektura osmane në Shqipëri, 1385-1912*. Përkthyer nga Klodiana Smajlaj. Tiranë: AIITC, 2012.
- MINKOV, Anton. *Conversion to Islam in the Balkans: Kisve Bahası Petitions and Ottoman Social Life, 1670-1730*. Leiden: Brill, 2004.
- PULAHA, Selami. "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI." Në *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. 1, 45-55. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989, 45-55.
- PULAHA, Selami. *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988.
- SKENDI, Stavro. "Religion in Albania during the Ottoman Rule." *Südost-Forschungen* 15, nr. 1 (1956): 311-327.
- STADTMÜLLER, Georg. "Die Islamisierung bei den Albanern." *Jahrbücher für Geschichte Osteuropas* 3 (1995): 404-429.
- SHKODRA, Zija. *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973.
- TODOROV, Nikolai. *The Balkan City, 1400-1900*. Seattle: University of Washington Press, 1983.
- ZHELYAZKOVA, Antonina. "Islamization in the Balkans as a Historiographical Problem: The Southeast-European Perspective." Në *The Ottomans and the Balkans: A Discussion of Historiography*, redaktuar nga Fikret Adanır dhe Suraiya Faroqhi. Leiden: Brill, 2002, 233-266.

DR. EDUART CAKA

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edicaka@hotmail.com

S u m m a r y

ISLAMIZATION IN THE SANJAK OF ELBASAN
DURING THE FIRST HALF OF THE 16TH CENTURY

There is already a large corpus of writings, articles, encyclopedic entries and studies on the issue of the Islamization of Albanians and the factors that influenced this process, which began and reached its peak during the period of Ottoman rule in this area. The discovery or publication of new documents dating from this period is a development that sheds light or illuminates new dynamics on this topic, as well as prompts researchers to reconsider it. In this context, this article is also based on the data obtained from the cadastral registers of the 16th century on a certain administrative area of the time, such as the sandjak of Elbasan and the kazas of Elbasan, Durrës and Shpat that were part of this liva.

Keywords: Sanxhak of Elbasan, 16th century, religion, islamization, ottoman cadastral registers.

DR. ALVIN SARAÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
saracialvin@hotmail.com

**ORIGJINA SHQIPTARE, JETA DHE VEPRA
E KARL GEGËS****Abstrakt:**

Artikulli trajton origjinën, jetën dhe veprën e Karl Gegës në fushën e inxhinierisë, duke u mbështetur në konferenca ndërkombëtare, ekspozita dhe katalogë kushtuar figurës së tij. Pavarësisht se kjo figurë i përket historisë së disa vendeve, artikulli analizon origjinën shqiptare të familjes së tij, emigrimin e dyfishtë në Kotorr dhe më pas në Venecie, karrierën e tij në fushën e inxhinierisë, si dhe kontributin e dhënë në ngritjen e rrjetit hekurudhor të Perandorisë Austriake, veçanërisht në ndërtimin e linjës hekurudhore Vjenë – Trieste dhe të segmentit më të vështirë Glognic – Myrcushlag, pjesë e hekurudhës malore të Semeringut, hekurudha e parë malore në Europë. Kjo ndërmarrje me vlerë kontribuoi në lehtësimin e komunikacionit ndërmjet kryeqytetit dhe portit më të rëndësishëm të kohës, Triestes, si edhe me vendet e tjera të Europës. Ajo ndikoi drejtpërdrejt në zhvillimin e tregtisë austriake dhe të portit të Triestes, në një kohë kur po përgatitej edhe projekti për hapjen e Kanalit të Suezit.

Fjalë kyçe:

Karl Gega, origjina shqiptare, hekurudhë, Venecie, Vjenë, Trieste, Semering.

Konferencat ndërkombëtare, ekspozitat dhe katalogët kushtuar inxhinier Karl Gegës nxorën në pah origjinën, jetën dhe veprimtarinë e tij si figurë e shquar në fushën e ndërtimit të rrugëve dhe rregullimit të lumenjve, veprimtari që arriti kulmin me kontributin e tij në ngritjen e rrjetit hekurudhor të Perandorisë Austriake. Ishte një periudhë kur

inxhinieria ndodhej në fazat para të zhvillimit të saj, prandaj nuk ekzistonte një ndarje e qartë ndërmjet fushave të ndryshme, si gjeodezia, mekanika, hidraulika etj., gjë që i përshtatej karakterit inovator të Gegës. Ai ishte një inxhinier me talent dhe vizion, i cili, falë gjenialitetit të tij, realizoi hekurudhën e parë malore të kontinentit, në Semering, duke bërë të mundur kapërcimin e masivit malor të Alpeve Norike me anë të lokomotivës, një arritje e jashtëzakonshme për kohën. Kozmopolitizmi i tij shfaqet në udhëtimet studimore, në takimet dhe shkëmbimin e përvojës me inxhinierë të njohur, në inovacionet në vegla, instrumente dhe teknika ndërtimi, në studimin e detajuar të veprave inxhinierike, në përditësimin me zhvillimet e teknologjisë, në botimet e tij mbi hekurudhat, si dhe në bibliotekën e tij të pasur me libra të autorëve bashkëkohës etj. Ngritja e rrjetit hekurudhor austriak shërbeu për lidhjen e vendeve të Europës nëpërmjet transportit hekurudhor, siç pohonte edhe ai vetë: “Hekurudhat zhdukin distancat, nxisin interesat ekonomike dhe ngrejne e përhapin kulturën”. (*Durch die Eisenbahnen verschwinden die Distanzen, die materiellen Interessen werden gefördert, die Kultur gehobene und verbreitet – Con le ferrovie spariscono le distanze, si promuovono gl’interessi materiali, la coltura si accresce e si diffonde*).¹

Karl Gega ishte një njeri i vendosur, serioz dhe i ndershëm; ai i inkurajonte kolegët dhe punëtorët dhe bënte një jetë modeste.² Jeta dhe veprimtaria e tij lidhen me tri shtete: Shqipërinë, si vendi i origjinës së hershme të familjes së tij; Italinë, ku lindi, kaloi vitet e rinisë dhe u kthye në fund të jetës; dhe Austrinë, ku zhvilloi dhe realizoi karrierën e tij të shkëlqyer si inxhinier hekurudhash.

Me anë të testamentit të tij, të hartuar në Vjenë më 21 janar 1858, Gega ua la dorëshkrimet dhe librat në italisht, gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht Bibliotekës Marciana të Venecies,³ si dhe portretin, pikturat e medaljet *Muzeut Correr* të Venecies.⁴ Në Bibliotekën e *Muzeut Correr*

¹ Erich Kurzel-Runtscheiner, “Carl Ritter von Ghega. Gedenken zum 100. Todestag,” *Blätter für Technikgeschichte*, 22 Heft, ed. Josef Nagler (Wien: Springer-Verlag, 1960), 88.

² Aldo Rampati, *Carlo Ghega, il cavaliere delle Alpi* (Trieste: Italo Svevo, 2002), 119-120.

³ Për një bibliografi të fondit të Karl Gegës në Bibliotekën Marciana të Venecies, shih: Carlo Campana, “Trashëgimia e Karl Gegës në Bibliotekën Marciana,” në *Karl Gega dhe Semeringu. Një hekurudhë për të ndryshuar historinë* (Tiranë: Ombra DVD, 2025), 136-140.

⁴ “Nga testamenti i Karl Gegës,” në *Karl Gega dhe Semeringu*, 179.

ruhet një pjesë e fondit Gega, i cili përfshin diploma dhe tituj, albume me litografi, gravura e fotografi të linjave hekurudhore, letërkëmbim, disa nga botimet e tij, stampa të monumenteve dhe skulpturave të disa muzeve, si dhe kurse të vizatimit ornamental nga disa revista franceze e projekte të inxhinierëve bashkëkohës. Këto materiale janë kataloguar nga autori i këtij artikulli dhe janë botuar në fund të katalogut.

Duke lexuar katalogun, lindin disa pyetje lidhur me origjinën e tij shqiptare: Nga cila zonë e Shqipërisë ishte familja Gega? Ndërsa, sa i përket emigrimit të dyfishtë të familjes, në cilën periudhë mund të ketë emigruar ajo nga Shqipëria drejt Perastit në Mal të Zi, që asokohe ishte pjesë e territorit venecian të Grykës së Kotorrit, dhe më pas në Venecie?

Duke u mbështetur në dokumentet kishtarë të Perastit, të përmendura nga Lucia Nadin, ky emigrim duhet të vendoset në fund të shek. XVII dhe në fillim të shek. XVIII.⁵ Gjon Batist Gega (Giovanni Battista Ghega), djali i xhaxhait të Karl Gegës dhe vikar apostolik i Patriarkatit të Venecies, krijoi një pemë gjenealogjike të familjes, ku si paraardhësi i saj shfaqet Gjergj Gega, i cili kishte emigruar nga Shqipëria në Perast.⁶ Ai përfaqëson brezin e parë të familjes Gega, e cila përfshin katër breza: Kristoforin, Gasprin dhe Antonin, nga e ka prejardhjen Karl Gega.⁷ Gjithashtu, mbi bazën e dokumenteve të ruajtura në Venecie, është ndërtuar pema gjenealogjike e familjes së tij, ku shfaqen babai Anton, nëna Ana Pribiq, si dhe vëllezërit e motrat e tij: Leonardi, Karli, Spiridioni, Gjergji, Angjela, Helenë-Pashka, Luigjia, Tereza dhe Jozefina.⁸

Tre brezat e fundit, Kristofori, Gaspri dhe Antoni, shërbyen në marinën veneciane me gradat oficer marine dhe kapiten. Familja banonte në Fondamentin e Shën Joakimit, në Via Garibaldi të gjashtierit të Kastelos, afër Arsenalit, pikërisht në zonën ku ndodheshin anijet e flotës

⁵ Lucia Nadin, "Familja Gega nga Shqipëria në Venecia dhe në Vjenë," në *Karl Gega dhe Semeringu*, 38-40, 45.

⁶ Venezia, Biblioteca Museo Correr (më tej: BMC), memoria manoscritta di Giovan Battista Ghega, manoscritto (më tej: ms. Cicogna 3418 bis.).

⁷ Alvin Saraçi, "Famous Albanians in Venice: Karl Gega, architect of Austro-Hungarian Empire," në *Studia Albanica*, 1-2, XLVI (XLII), (Tiranë: Académie des Sciences d'Albanie, Section des Sciences Sociales, 2009), 155-157.

⁸ Nadin, "Familja Gega," 45. Pema e familjes Gega u ekspozua në ekspozitën e Karl Gegës.

veneciane. Karli lindi në Venecie më 10 janar 1802 dhe u pagëzua në Katedralen e Shën Pjetrit, e cila ndodhej pranë banesës së familjes.

Përsa i përket origjinës shqiptare, ka shumë gjasa që familja Gega të ketë emigruar nga Shkodra, e cila ishte e lidhur me Grykën e Kotorrit përmes rrugëve detare dhe tokësore. Duke iu referuar studiueses Lucia Nadin, nëse familja Gega kishte lidhje farefisnore me familjet shqiptare Shilopi, Bronza e Gjoka nga Shkodra, të cilat rridhnin nga një trung i përbashkët familjar dhe ishin pjesë e rrethit të familjeve fisnike të Perastit, atëherë edhe ajo mund ta ketë prejardhjen nga qyteti i Shkodrës, ku mbiemri Gega gjendet edhe sot.⁹ Paulin Margjokaj mendon se familja ishte nga Shkodra dhe kishte ardhur në Venecie në shek. XV, por nuk flet për emigrimin në Perast.¹⁰ Në stemën e qytetit të Perastit, ku përfshihen stemat e dymbëdhjetë familjeve që e kanë themeluar atë, shfaqet një stemë me flamurin shqiptar, që mund të jetë emblema e Kastriotëve, por mund t'i përkasë edhe ndonjë familjeje tjetër shqiptare, si dhe stema e familjes Shilopi, e cila kishte një pemë me një pëllumb në majë. Në fakt, kur Karl Gegës iu dha titulli *Ritter* (fisnik austriak) në vitin 1851, jo për shkak të prejardhjes familjare, por si vlerësim për karrierën e tij, e cila arriti kulmin me ndërtimin e hekurudhës së Semeringut, ai krijoi një stemë familjare të përafërt me atë të familjes Shilopi. I vetmi ndryshim ishte se në stemën e tij paraqitej një pemë, në majën e së cilës qëndronte një shapکہ. Kjo dëshmon se familja mund të ketë pasur origjinë shkodrane ose lidhje farefisnore me familje të këtij qyteti.

Ka edhe një hipotezë tjetër që familja mund të ketë emigruar në Perast me ndihmën e arqipeshkvit të Tivarit, me origjinë perastine, Vinçenc Zmajeviq, në fillim të shek. XVIII. Asokohe pati disa emigrime nga zonat përreth Tivarit për shkak të taksave të larta dhe për të shmangur kalimin në fenë myslimane, duke ruajtur besimin katolik. Në këtë rast, mendohet se familja Gega mund ta ketë origjinën nga zonat shqiptare që përfshihen në qarkun e Tivarit, si Kraja e Shestani, por nuk përjashtohet as Kelmendi. Pikërisht nga zonat përreth Tivarit u themeluan dy koloni shqiptare në Zarë (Zadar) të Kroacisë: Arbanasi (1726) dhe Xemoniku (1727).¹¹

⁹ Po aty, 48-49.

¹⁰ Rampati, *Carlo Ghega*, 15; Pjetër Logoreci, "Shqiptari Karl Gega, mjeshtri i ndërtimit të hekurudhës së parë malore në botë," *Shqiptarja*, nr. 18, 7 tetor 2012.

¹¹ Tullio Erber, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara, cenni storici* (Dubrovnik: Flori, 1883), 20-27, 30-34.

Alen Dyselje pohon se shqiptarët emigruan në Kotorr nga Shqipëria, pasi aty gjenin mundësi për të ushtruar profesionin e tyre. Kotorri, i njohur për traditën e tij detare, u ofroi atyre, ashtu si edhe anëtarëve të familjes Gega, mundësinë për t'u regjistruar dhe për t'u punësuar në anijet e flotës veneciane, ku përfshiheshin edhe anijet e Perastit me ekuipazhe të përbashkëta, në të cilat bënin pjesë edhe marinarë nga Shqipëria.¹² Perasti në veçanti kishte një numër të madh anijesh dhe një shkollë marine të hershme. Nga fundi i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII, Venecia u dha perastinëve të drejtën për të kryer transportin e mallrave nga portet shqiptare të Durrësit, Vlorës dhe Shëngjinit të Shkodrës drejt Venecies. Megjithatë, një pjesë e transportit të mallrave kryhej nga anijet e Ulqinit, porti shqiptar që asokohe konkurronte Perastin. Në rastin e Durrësit, në shek. XVIII, ndër emrat e pronarëve dhe kapitenëve të anijeve nuk haset mbiemri Gega. Duhet pasur parasysh se nëna e Karlit dhe bashkëshortja e Anton Gegës quhej Ana Pribiq dhe, me sa duket, rridhte nga një familje perastine.

Edukimin Gega e mori në kolegjin ushtarak të marinës së Shën Anës, ku lëndët kishin drejtim shkencor-teknologjik, si matematika, hidraulika, mekanika etj.¹³ Pas një viti studimesh në një shkollë private për matematikë dhe ndërtim anijesh, ai u regjistrua në vitin e dytë në Universitetin e Padovës. Aty përfundoi një kurs njëvjeçar në matematikë-fizikë dhe, në vitin e tretë, u diplomua në inxhinieri-arkitekturë.¹⁴ Përpos studimeve, ai ndiqte edhe Akademinë e Arteve të Bukura të Venecies, në

¹² Michele Santoro, "La marinarezza bocchese. Traffici e pratiche culturali nelle Bocche di Cattaro (secoli XV-XVII)," *Stato da Mar* 6: Incroci di Sguardi. Lo stato da mar nello sguardo degli altri / gli altri nello sguardo dello Stato da Mar e altri contributi, *Atti del 10 Convegno Internazionale Venezia e il suo Stato da mar / Venice and its Stato da mar, Venezia / Venice, 7-8-9 aprile 2022*, në *Società Dalmata di Storia Patria*, ed. Bruno Crevato Selvaggi – Despina Vlassi (Roma: Società Dalmata di Storia Patria, 2023), 320-321; Alain Ducellier, "Cattaro punto di convergenza degli emigranti albanesi?," *Città e sistema adriatico alla fine del medioevo*, *Convegno di Studi, Padova 4-5 aprile 1997*, në *Atti e Memorie della Società dalmata di Storia Patria*, vol. XXVI, me versionin në anglisht (Venezia: Società dalmata di storia patria, 1997), 99-119.

¹³ Wolfgang Straub, *Karl Gega: biografi*, përktheu Sejdi Demiri (Shkup: Tiranë: Prishtinë: Alfa 94, 2013), 21.

¹⁴ Piero Del Negro, "Carlo Ghega," *Dizionario bibliografico degli italiani*, vol. 53 (Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana "Giovanni Treccani", 2000), 527.

degën e ornamentit për arkitektë.¹⁵ Ishte një periudhë e sinkretizmit mes artit dhe inxhinierisë, ku ndërthureshin stili neoklasik me zbukurimet në ndërtim, si dhe vizatimi, piktura dhe vizatimi teknik. Kjo prirje, siç do të shihet më tej, pasqyrohet edhe në peizazhet me hekurudhën, të realizuara në litografi dhe gravura bardhezi dhe në ato me ngjyra.

Karl Gega e nisi aktivitetin e tij profesional në vitin 1819 si inxhinier praktikant në Inspektoratin Qendror të Ujërave dhe Rugëve të Mbretërisë Lombardo-Venete, nën Kurorën Austriake, nën drejtimin e Ermenegjildo Françeskonit. Aty ai u mor me ndërtimin e rrugëve, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte *Strada d'Alemagna*, që lidhte Koneljanon e Trevizon me Belunon e Kadoren, deri në Dobiako (Toblah), sot në zonën tiroleze të Italisë së Veriut, duke shërbyer për komunikimin e Venecies me Austrinë dhe Bavarinë.¹⁶ Pjesa më e vështirë ishte ajo prej 3 km përgjatë rrugës “Kavalera”, që përfshinte kalimin e një disnivele prej 172 metrash. Më pas, më 1824, punoi si inxhinier departamenti (reparti) në seksionin rrugor dhe hidraulik të Trevizos. Në atë periudhë u mor me sistemimin e lumit Piave. Po atë vit, në bashkëpunim me inxhinier Francesco Mantovanin, në kuadër të ristrukturimit të *Piazza del Duomo*-s, projektoi Gjykatën e Trevizos, përballë katedrales. Ndërtimi i saj nisi në vitin 1835 dhe u përfundua në vitin 1842, pas vdekjes së kolegut të tij.¹⁷

Në vitet 1830-1833, Gega kaloi në Rovigo, ku u mor me argjaturat e lumit Po. Pas kësaj, në vitin 1833 u promovua si inxhinier i klasit të parë në Zyrën Qendrore të Ndërtimeve në Venecie.¹⁸ Në atë kohë, nën ndikimin e revolucionit industrial dhe duke qenë se shkenca e inxhinierisë ishte në hapat e saj të parë, inxhinierët bënë shpikje, inovacione ose përmirësime të veglave dhe instrumenteve që u shërbenin gjatë fazave të punës. Ai i paraqiti Institutit të Shkencave, Letërsisë dhe Arteve të Venetos, me seli në Venecie, një shpikje ose përmirësim të oktantit me dioptër për gjurmimin e rrjedhës së kthesave rrethore në plan në fushën e gjeodezisë në vitin 1831, dhe për këtë iu dha medalja e

¹⁵ Camillo Tonini, “Trashëgimia e Karl Gegës në Muzeun Correr: Fati i një fondi të veçantë,” në *Karl Gega dhe Semeringu*, 124.

¹⁶ Andrea Franco, “Karl Gega: veprat kryesore të tij në provincën e Trevizos në periudhën e sundimit të Habsburgëve,” *Karl Gega dhe Semeringu*, 71.

¹⁷ Po aty, 74.

¹⁸ Marika Caiola, *Karl Ritter von Ghega* (Venezia: Istituto universitario di Architettura di Venezia, 2000-2001, tesi di laurea), 9.

argjendë.¹⁹ Edhe në vitin 1829, ai i kishte paraqitur të njëjtit komision një nivelues për rievimin e terrenit që e kishte përdorur në Trevizo, i cili kishte marrë vetëm një vlerësim pozitiv. Asokohe, ky institut konsiderohej si Akademia veneciane dhe, në vitin 1845, sipas njërës prej diplomave të tij të ruajtura në fondin Gega, e pranoi Karl Gegën si anëtar korrespondent. Ky titull u jepej anëtarëve që banonin jashtë territorit të Mbretërisë Lombardo – Venete, e cila atëherë ishte pjesë e Perandorisë Austriake.²⁰ Për meritat e tij në fushën e gjeodezisë, Gega u shpall në vitin 2018 “gjeodezisti i vitit” nga Këshilli European i Gjeodezistëve.²¹

Perandoria Austriake kishte nisur ndërtimin e linjës së parë hekurudhore Çeske Budejovice (Budvais) – Linc – Gmunden për lidhjet e Çekisë me Austrinë, e cila u realizua në periudhën 1825-1836. Në vitin 1829, Franc Ripl projektoi një hekurudhë që do të arrinte nga Vjena në minierat e kripës të Boknia-s (Galicisë) në Poloni, e deri në Lviv (Ukrainë), e cila më pas do të kishte një zgjatim deri në Krakovë dhe do të arrinte deri në kufirin me Rusinë, duke u quajtur Hekurudha e Veriut e Ferdinandit (*Ferdinands Nodbahn*). Ajo do të vazhdonte nga Vjena në Lindje drejt Hungarisë dhe më pas në drejtim të jugut drejt Triestes dhe do të përbënte më vonë Hekurudhën e Jugut (*Südbahn*).²² Koncesioni për ndërtimin e Hekurudhës së Veriut iu dha financierit Salomon fon Rothschild në vitet 1830-1835. Në mars 1836, linja Vjenë – Brno –Tropau, si pjesë e Hekurudhës së Veriut do të lidhte Austrinë me Çekinë dhe do të arrinte deri në kufirin verior të asokohshëm të perandorisë me Saksoninë. Kështu nisi karriera e Karl Gegës në fushën e inxhinierisë së hekurudhave në Austri, ku ai projektoi linjën Lundenburg (Breklay) – Bryn (Brno) – Olmyc (Olomouc). Punimet nisën nën drejtimin e inxhinier Johan fon Kudriafskit, i cili projektoi seksionin e parë

¹⁹ Carlo Urbani, “Karl Gega në Institutin e Shkencave, Letërsisë dhe Arteve të Venetos,” në *Karl Gega dhe Semeringu*, 80.

²⁰ Inventari i fondit të Karl Gegës në Muzeun Correr të Venecias, Cartella 1, Diplomi, Titoli, Opuscoli di Onorificenze Cavalleresche, Decorazioni, 20 janar 1845.

²¹ Rinaldo Paar, “Carl Ritter Ghega – 2018 Surveyor of the year,” *Kartografija i geoinformacije* vol. XVIII, nr. 32, 64 (December 2019), DOI:10.32909/kg.18.32.5.

²² Andreas Hollerer, *Die Südbahn über den Semmering – Eine Pionierleistung im frühen Eisenbahnwesen Österreich-Ungarns und deren Bedeutung als Initiatorin einer aufstrebenden Fremdenverkehrsregion im steirisch-niederösterreichischen Grenzraum im Zeitraum 1842 bis zum Ende der Donaumonarchie* (e pabotuar, tezë diplome për master në Art në Institutin e Historisë, (Graz: Karl Franzens-Universität Graz, 2022), 20-21.

hekurudhor Vjenë – Florisdorf; Franc Bretshnajder ndërtoi seksionin e dytë Florisdorf - Lundenburg (Brekav), ndërsa Karl Gega u mor me seksionin e tretë Lundenburg (Břeclav) – Bryn (Brno).²³ Kjo linjë, që do të shërbente për komunikacionin Vjenë – Brno dhe kishte si qëllim lidhjen e lumenjve Danub dhe Moldovë, u inaugurua më 7 korrik 1839. Për këtë ndërtim, Gegës iu dha qytetaria e nderit e qytetit të Brno-s. Ndërsa linja Lundenburg (Brekav) – Prerau (Prerov) – Olmyc (Olomouc) përfundoi në tetor 1841.

Në nëntor 1836, Gega, i shoqëruar nga Ermenegjildo Françeskoni dhe Goldshmiti, i cili ishte përfaqësues i Hekurudhës Veriore, ndërmori një udhëtim studimor në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Gjermani dhe Francë.²⁴ Kjo i shërbeu Karl Gegës për studimin e ndërtimit të hekurudhave, urave, tuneleve etj., me qëllim grumbullimin e përvojës në terren dhe të literaturës bashkëkohore që do t'i shërbente për ndërtimin e hekurudhave në Perandorinë Austriake, dhe kryesisht linjës më të vështirë malore të Semeringut. Perandorisë Austriake i nevojiteshin lokomotiva, prandaj ajo i porositi ato te Stifensoni, i njohur si “babai i lokomotivës” dhe te Xhon Tejlari. Në mars të vitit 1838, ata dërguan dy lokomotiva me katër rrota, “Austria” dhe “Morava”, si dhe katër lokomotiva me gjashtë rrota, së bashku me specialistë nga Anglia për t'i vënë ato në përdorim.²⁵ Asokohe, për Karl Gegën rëndësi të veçantë patën edhe takimet me disa prej bashkëkohësve të tij në Angli, të cilët do t'i shërbenin në fushën e tij. Ndër ta ishte edhe Zhorzh Stifensoni në Njukesëll, krijuesi i lokomotivës së parë në vitin 1814, themeluesi i kompanisë së parë hekurudhore për linjën Stokton – Darlington më 1825 dhe ndërtuesi i linjës së parë hekurudhore Liverpul – Mançester në vitin 1830. Po ashtu, Gega u takua me inxhinierin e shquar Isambard Brunel gjatë vizitës së tij në tunelin që Bruneli po ndërtonte nën lumin Tejms në

²³ Friedel Stratjel, Dieter Friedl, *Bernhardthal und die “Kaiser-Ferdinands-Nordbahn”*. *Beiträge zur Geschichte von Bernhardthal und Umgebung* (Bernhardthal: Friedel, Stratjel, 2010-2014), 81-82; Lorenz Valentin Kleinknecht, *Allgemeiner Taschen-Atlas der europäischen Eisenbahnen. Kaiser Ferdinand's Nordbahn Section B. Bruenn bis Wien* (Schweinfurt, Kunstverlag, 1845), 14; Hermann Strach, “Geschichte der Eisenbahnen der Oesterreich – Ungarns von den ersten Anfängen bis zum Jahre 1867,” në *Geschichte der Eisenbahnen der österreichisch-ungarische Monarchie* (Wien, Teschen, Leipzig: Karl Prochaska, 1898), vol. I, 142-143.

²⁴ Alfred Niel, *Carl Ritter von Ghega, Ein Leben für die Eisenbahnen* (Wien: Zeitschriftenverlag Ployer & Co, 1977), 12.

²⁵ Strach, “Geschichte der Eisenbahnen”, 145-147.

Londër.²⁶ Gjithashtu, ai studioi edhe tunelin e linjës Londër – Birmingëm, të ndërtuar nga Kilsbi, përvojë që do t'i shërbente më vonë gjatë ndërtimit të tunelit të Semeringut.

Pas kthimit të tij si kryeinxhinier, Karl Gega ndërtoi linjën Breklav – Brno, duke e nisur nga Rabensburgu, në kufirin e sotëm të Austrisë me Republikën Çeke, me një gjatësi 90 km.²⁷ Këtu vlen të përmendet viadukti prej guri mbi lumin Shvarca, në afërsi të Brno-s, me gjatësi 637 metra dhe 72 harqe, si edhe urat e varura prej guri që ai projektoi. Më 7 korrik 1839 u inaugurua linja hekurudhore Vjenë-Brno, me gjatësi 155 km,²⁸ në të cilën u përdor lokomotiva “Morava”. Pas kësaj vazhduan punimet për linjën Brno – Olomouc.²⁹ Ndërkohë, Gega përgatiti edhe projektin e linjës deri në Pragë, e cila u inaugurua për transportin e pasagjerëve më 1 shtator 1845 dhe u hap për transportin e mallrave më 1 tetor 1845.

Kështu, iu hap rruga ndërtimit të linjës hekurudhore Pragë – Dresden, e njohur edhe si linja moravo-saksone, e cila do të lidhte Perandorinë Austriake me Saksoninë. Ndërtimi i saj u bë i mundur pas marrëveshjes së nënshkruar nga të dyja palët në vitin 1842 dhe zgjedhjes së luginës së lumit Elba si vendkalim. Linja ishte parashikuar të kalonte nga Praga në Bodenbah (Deçin) dhe, më pas, përgjatë 11 kilometrave të fundit, deri në kufirin ndërmjet dy vendeve.³⁰ Megjithëse drejtimi i punimeve iu besua Këpit në cilësinë e kryeinxhinierit, linja hekurudhore u ndërtua gjatë viteve 1845-1850 mbi bazën e projektit të Karl Gegës. Linja u kompletua nga pala gjermane, nga Dresdeni, duke përfshirë edhe seksionin e fundit Krippen – Bodenbah, më 8 prill 1851. Viadukti i Pragës, me gjatësi 1.1 km dhe 87 harqe, i ndërtuar nga Gega, u cilësua si “një vepër e vërtetë romake e shek. XIX”. Në fondin Gega ruhet edhe një ftesë, e datës 7 prill 1851, për të marrë pjesë në darkën gala të organizuar me rastin e inaugurimit të linjës hekurudhore në Dresden.³¹ Të nesërmen,

²⁶ Caiola, *Karl Ritter Ghega*, 18; Stratjel, Friedl, *Bernhardsthal und die “Kaiser-Ferdinands-Nordbahn”*, 82.

²⁷ Del Negro, “Carlo Ghega”, 527.

²⁸ Strach, “Geschichte der Eisenbahnen”, 154-155.

²⁹ Günter Dinobhl, *Die Semmeringerbahn: der Bau der ersten Hochgebirgseisenbahn der Welt* (Wien: Köln: Weimar: Böhlau Verlag, 2003), 50.

³⁰ Strach, “Geschichte der Eisenbahnen”, 232-236; Wilhelm Ritter von Engerth, *Gedenkrede bei Enthüllung des Ghega-Monumentes auf dem Semmering am 22 Juli 1869* (Wien: Leopold Sommer, 1869), 6.

³¹ Inventari i fondit të Karl Gegës në Muzeun Correr të Venecies, 90.

dy trenat e nisur për inaugurimin e linjës – njëri nga Dresdeni, ku udhëtonte Alberti, Mbreti i Saksonisë, dhe tjetri nga Praga, me të cilin udhëtonte Karl Ludvig fon Bruk, ministri austriak i Tregtisë, Industrisë dhe Punëve Publike – u takuan në kufirin midis dy vendeve.³²

Megjithatë, qëllimi kryesor i Perandorisë Austriake ishte lidhja e kryeqytetit, Vjenës, me portin e saj më të rëndësishëm, Triesten. Kjo do të ndikonte në zhvillimin e shkëmbimeve tregtare dhe në reduktimin e kohës së komunikacionit. Që në vitin 1717, Perandori Karli VI kishte pasur si qëllim zhvillimin e portit të Triestes, duke e kthyer atë në një port të lirë dhe në një bazë të marinës austriake. U morën një sërë masash për nxitjen e tregtisë pas Traktatit të Paqes së Pasarovicit (Pozharevacit) ndërmjet Austrisë dhe Perandorisë Osmane, më 27 korrik 1718, siç ishte ngritja e Kompanisë për tregtinë me Lindjen (*Privilegierte Orientalische Kompanie*), e cila e zhvilloi aktivitetin e saj deri në vitin 1734, si dhe dekreti i 18 marsit 1719. Ishte një periudhë kur zotërimi venecian në Adriatik po i afrohej fundit dhe në skenë po dilnin fuqi të tjera detare, si Austria. Kjo politikë vazhdoi edhe gjatë sundimit të vajzës së tij, Maria Terezës, e cila, në vitin 1749, vendosi ta kthente Triesten në qendrën më të madhe tregtare të perandorisë, me themelimin e Bordit drejtues për Tregtinë (*Kommerzien Oberdirektorium*), dhe më pas gjatë sundimit të Jozefit II, me themelimin e “Société Impériale Asiatique de Trieste” më 1781, për zhvillimin e tregtisë me Lindjen e Largët.³³ Zhvillimi i portit të Triestes vazhdoi pas rënies së Republikës së Venecies më 1797-1813, kur dy qendrat e dikurshme të republikave tregtare, Venecia dhe Raguza (Dubrovniku), u shndërruan në porte austriake.³⁴ Kështu, porti i Triestes e kthye në një udhëkryq të tregtisë ndërkombëtare, ku kalonte edhe një pjesë e konsiderueshme e shkëmbimeve tregtare me Lindjen, duke lënë pas portin e Venecies, i cili dikur kishte pasur një rol parësor.³⁵

³² Strach, “Geschichte der Eisenbahnen”, 238.

³³ Franz Xaver von Neumann-Spallart, *Österreichs Maritime Entwicklung und die Hebung von Triest. Eine Volkswirtschaftliche Studie* (Stuttgart: Julius Maier, 1882), 17-18; Adolf Beer, *Die Österreichische Handelspolitik unter Maria Theresa und Josef II* (Wien: Carl Gerold's sohn, 1898), 5.

³⁴ Boro Bronza, “The Austrian trade towards the Ottoman Empire and Asia during the 18th Century,” *Original Scientific Paper* (10 August 2016), (shikuar më 19.02.2026), doi: 10.19090/i.2026.27.139-152, 147.

³⁵ Beer, *Die Österreichische Handelspolitik*, 36; Stuart Woolf, “L’Ottocento. 1997-1918. Nota introduttiva,” *Storia di Venezia: L’Ottocento e il Novecento*, ed. Stuart Woolf, Mario Isnenghi (Roma: Enciclopedia veneziana Giovanni Treccani, 2002), vol.

Siç u përmend më lart, ideja e një hekurudhe jugore, e propozuar nga Franc Ripl, parashikonte lidhjen e këtyre dy qendrave ekonomike përmes Hungarisë. Megjithatë, realizimi i saj u bë i mundur falë disa faktorëve të rëndësishëm, si mbështetja e arkidukës Johan, ngritja më 2 prill 1836 e Komitetit për ndërtimin e hekurudhës në Trieste, ku bënë pjesë qytetarë dhe tregtarë, si dhe mbështetja e Karl Ludvig fon Brukut, themelues i “Llojdit austriak”. Po ashtu, një rol të rëndësishëm luajti edhe dhënia e koncesionit për ndërtimin e hekurudhës Vjenë – Budapest kontraktuesit me origjinë shqiptare, Simon Jorgo Sina.³⁶ Sina rridhte nga një familje tregtarësh nga Voskopoja, e cila emigroi fillimisht në Nish të Serbisë dhe më pas në Vjenë, ku ai dhe i ati njiheshin si bankierë.

Fon Bruku ishte me origjinë gjermane dhe kishte themeluar “Llojdin austriak” në Trieste, sipas modelit anglez, me tri seksione: i pari, i krijuar në vitin 1833, si kompani sigurimesh dhe informacioni ekonomik; i dyti, i ngritur më 12 tetor 1835, si kompani lundrimi ndërkombëtare me anije me avull, me linja që shtriheshin edhe drejt porteve shqiptare; dhe i treti, si tipografi për shtypjen e librave.³⁷

Linja Vjenë – Trieste ngjalli shpresa për ndërtimin e hekurudhës lombardo-venete, e cila parashikohej të lidhej më pas me të. Në këtë kontekst, në vitin 1835, inxhinierët e Dhomës së Tregtisë të Venecies, Sebastiano Wagner dhe Francesco Varè, paraqitën kërkesën për ndërtimin e kësaj hekurudhe. Më 19 prill 1836, në mungesë të Françeskonit dhe Gegës, drejtimi teknik i punimeve iu besua kryeinxhinier Xhovani Milanit, i cili gëzonte mbështetjen e Pietro Paleokapës. Kompania aksionare për ndërtimin e hekurudhës u

I, 1; Emmanuele Banfi, “Dinamika gjuhësore në zonën e Adriatikut mes shekujve XVIII-XIX: mes diglosish, dygjuhësish dhe synimit të gjuhëve kombëtare,” *Shejzat*, 1-2, (2020): 187-188.

³⁶ Max Demeter Peyfuss, “Sina zu Hodos und Kizdia, Georg Simon Freiherr von (1782-1856),” *Österreichisches Biographisches Lexicon* (më tej: *ÖBL*) 1815-1950, vol. XII, nr. 57 (2004) https://www.biographien.ac.at/oebl/oebl_S/Sina-Hodos-Kizdia_Georg-Simon_1782_1856.xml (shikuar më 20.09.2025), 289; Dinhlobl, *Die Semmeringbahn*, 73-74.

³⁷ Armando Zimolo, “I protagonist: Karl Ludwig von Bruck tra passato e futuro,” në *Dalle Alpi all’Adriatico in ferrovia con la Meridionale (1857) e con la Transalpina (1906)*, ed. Marina Bressan (Venezia: edizione laguna, 2007), 44.

konfirmua nga perandori më 1840.³⁸ Por në vitin 1841, kryeinxhinier Milani u zëvendësua nga Luigji Duodo. Hekurudha nisi të ndërtohej në të dy krahët, nga Milano dhe Venecia. Nga njëra anë, në vitin 1840 u ndërtua linja hekurudhore Milano-Monxa, ndërsa nga ana veneciane Mestre – Padova. Në vitin 1848, Luigji Negreli mori postin e komisarit ministerial të hekurudhës lombardo-venete. Megjithatë, ndërtimin e plotë të hekurudhës lombardo-venete e përfundoi Gega në vitin 1857.³⁹

Arkiduka Johan, i cili fillimisht i dha emrin Hekurudhës Jugore, donte që nëpërmjet saj të lidhej porti gjerman i Hamburgut me portin e Triestes, pra Deti i Veriut me Mesdheun. Megjithatë, ai nuk ishte dakord që hekurudha të kalonte nëpër Hungari, por që ajo të shtrihej nga Austria e Poshtme drejt zonës industriale të Stirias (Shtajermarkut).⁴⁰ Kjo e shtyu atë të merrej me studimin e terrenit dhe të angazhonte inxhinierë dhe gjeologë për të përcaktuar itinerarin e përshtatshëm. Si kalim i mundshëm u propozua Semeringu, përmes masivit të Alpeve Norike, kapërcimi i të cilit dukej një ndërmarrje tejet e vështirë për shkak të disnivelit të lartësive dhe terrenit të thepisur shkëmbor.

Perandoria Austriake ndërmori në vitin 1839 ndërtimin e hekurudhës Vjenë – Trieste. Sina, i cili kishte hequr dorë më parë nga koncesioni për ndërtimin e hekurudhës hungareze, lidhi vetëm kontratën për ndërtimin e seksionit të parë të Hekurudhës Jugore, Vjenë – Glognic që përfundoi në vitin 1842, sipas projektit të inxhinier Matias Shënererit. Ky seksion kishte një gjatësi prej 25,7 km dhe përfshinte tri tunele.⁴¹

Kur Karl Friedrih Kybek fon Kybau, në vitin 1840, erdhi në krye të Dhomës së Oborrit (një institucion që përkonte me Ministrinë e Financave), mori gjithashtu përsipër drejtimin e projektit për ndërtimin e rrjetit hekurudhor.⁴² Në atlasin e tij, të ilustruar me litografi të palosura prej 7 metrash nga Ludvig Cerni, i botuar në dy versione, gjermanisht dhe frëngjisht, Gega përshkruan të gjithë rrjetin hekurudhor të Perandorisë Austriake dhe ndalet në mënyrë të veçantë në hekurudhën e Semeringut,

³⁸ Adolfo Bernardello, *La prima ferrovia fra Milano e Venezia. Storia dell'Imperial-Regia Privilegiata Strada ferrata Ferdinanda Lombardo-Veneta (1835-1852)*, (Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, 1996), 17-20, 32.

³⁹ *Po aty*, 341.

⁴⁰ Dinohobl, *Die Semmeringerbahn*, 74.

⁴¹ Johann Dultinger, *Die Erzherzog Johann Bahn* (Rum: Dr. Rudolf Erhard, 1985), 54.

⁴² Straub, *Karl Gega*, 110-111.

në linjën Glognic – Myrcushlag, pjesën më të rëndësishme të hekurudhës Vjenë – Trieste.⁴³

Megjithatë, në vitet 1840-1842, Gega ishte larguar nga hekurudhat dhe ishte dërguar në Tirolin e Jugut për të punuar si ndihmësinxhinier në ndërtimin e rrugëve të Val Suganës, Finstermyncit dhe të një ure me zinxhir mbi lumin Adixhe.⁴⁴ Këtu punoi së bashku me ekspertin e ndërtimit të rrugëve, inxhinierin austriak Jozef Duile. Por ajo që ishte edhe më e rëndësishme ishte njohja me Luigji Negrelin, projektuesin e ardhshëm të Kanalit të Suezit, i cili u mor me këtë projekt në vitet 1836-1858.

Dekreti për ndërtimin e Hekurudhës Jugore (*Südbahn*) doli më 1841. Kështu, në vitin 1842 u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave dhe në krye të saj u vendos Ermenegildo Françeskoni nga Trevizo, i cili kishte punuar me Karl Gegën në Veneto. Gegës iu dha posti i inspektorit të Hekurudhës Jugore, ndërkohë që Luigji Negreli u emërua inspektor i Hekurudhës Veriore (*Nordbahn*).

Në shkurt të vitit 1842, Karl Gega, së bashku me arkitektin Moric Lër, që e njihnte mirë gjuhën angleze, u dërgua për një periudhë gjashtëmujore në një udhëtim studimor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aty ai studioi linjat hekurudhore dhe, kryesisht, linjën malore Baltimor – Ohaio, e cila do t'i shërbente si model për hekurudhën malore të Semeringut. Për këtë, ai i dërgoi një relacion Kybekut, i cili më pas u botua si libër në gjuhën gjermane, i shoqëruar me një atlas me skica ku paraqiteshin llojet e lokomotivave, vagonëve dhe shinave.⁴⁵ Përveç kësaj, Gega shkroi edhe një traktat mbi ndërtimin e urave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁴⁶

⁴³ Carl Ritter von Ghega, *Malerischer Atlas der Eisenbahn über den Semmering* (Wien: Carl Gerold, 1854); Carl Ritter Ghega, *Atlas Pittoresque de chemin de fer du Semmering, Précédé d'un Aperçu Historique et Statistique sur Les Chemins de fer en Exploitation en Autriche*. Par le Ch. C. de G. (Vienna: Imprimerie de Charles Gerold et Fils., 1854).

⁴⁴ Straub, *Karl Gega*, 31-32.

⁴⁵ Carl Ghega, *Die Baltimore – Ohio Eisenbahn untersucht von Carl Ghega auf seine Reise in den Vereinigten Staaten von Nordamerika. Atlas von 19 Zeichnungstafeln* (Wien: Kaulfuss Witwe, Prandel & Comp., 1844), Taf. VIII-XVIII; Carl Ghega, *Atlas von 19 Zeichnungens-Tafeln zur Darstellung der Baltimore-Ohio Eisenbahn untersucht von Carl Ghega* (Wien: Kaulfuss Witwe, Prandel & Co., 1844).

⁴⁶ Carl Ghega, *Über nordamerikanischen Brückenbau und Berechnung des Tragungsvermögens der Howe'schen Brücken* (Wien: Kaulfuss Witwe, Prandel &

Pjesa më e vështirë e hekurudhës Vjenë – Trieste ishte seksioni Glognic – Myrcushlag, i njohur gjithashtu si linja hekurudhore e Semeringut. Në një periudhë dyvjeçare, dhjetor 1842 – janar 1844, Gegës iu desh të përgatiste një projekt për hekurudhën e Semeringut, detyrë që i ishte ngarkuar nga Françeskoni.⁴⁷ Kapërcimin e Semeringut ai e hartoi në tri variante: 1. me lokomotivë; 2. me sistem atmosferik; 3. me kuaj. Varianti i parë i projektit kalonte në Klam dhe Braitenshtajn, ndërsa varianti i dytë në jug të luginave, nga Glognici në Shotvien, kurse i treti kishte një rampë të pjerrët në luginën jugore në Shotvien.⁴⁸ Gega ishte një mbështetës i idesë së kapërcimit të lartësive malore me anë të lokomotivës, duke marrë parasysht edhe kthesat e forta dhe pjerrësinë, e cila në rastin e Semeringut ishte 1:50, duke treguar se teknika të tilla mund të zbatoheshin edhe në terrene malore, njësoj si në terrenin fushor.⁴⁹

Ndërkohë, në vitin 1842, Gega nisi punën për ndërtimin e seksioneve të Hekurudhës Jugore. Ndër to ishte linja Grac – Myrzushlag, të cilën e përfundoi më 24 tetor 1844 dhe për këtë iu dha titulli i këshilltarit perandorak për ndërtimet. Ai u mor gjithashtu me ndërtimin e linjës hekurudhore Grac – Çelje, e cila u inaugurua më 2 qershor 1846, dhe Çelje – Lubjanë, më 16 shtator 1849, si pjesë e hekurudhës Vjenë – Trieste.⁵⁰ Në ditën e inaugurimit këto linja hekurudhore u ilustruan me litografi bardhezi dhe me ngjyra, si dhe me gravura* me planimetrinë dhe tekstin shpjegues të linjës, të cilat i dedikoheshin Perandorit Franc Jozef I. Një pjesë e mirë e tyre gjenden në fondin Gega pranë *Muzeut Correr* të Venecies dhe pasqyrojnë ndërthurjen e peizazhit me hekurudhën. Në fakt, litografia** lindi në Bavari të Gjermanisë nga Alois Zenefelder në vitin 1796, i cili eksperimentoi edhe litografinë me ngjyra, ndërsa kromolitografitë shumëngjyrëshe u përmirësuan nga Godëfrua Engelman në Francë në vitin 1837. Në shumicën e rasteve, litografitë ishin stampa të pikturave dhe, në disa raste, litografët ishin edhe piktorë, ndërsa gravurat realizoheshin mbi bazën e vizatimeve.

Comp., 1844).

⁴⁷ Ritter Ghega, *Malerischer Atlas*, 11.

⁴⁸ Caiola, *Karl Ritter Ghega*, 111.

⁴⁹ Ritter Ghega, *Die Baltimore – Ohio*, XI.

⁵⁰ Del Negro, “Carlo Ghega”, 529.

* Gdhendje në sipërfaqen e sheshtë të një sendi në gur, metal, dru ose xham.

** Figura të shtypura nga stampa të gdhendura në gur.

Në periudhën 1842-1848 pati disa variante projektesh për kalimin e Semeringut me lokomotivë, sistem atmosferik dhe kabëll teleferik, duke marrë parasysh terrenin malor.

Hekurudha atmosferike konsistonte në pajisjen e vagonëve me tuba dhe në përdorimin e presionit të ajrit të kompresuar, të krijuar nga pompa me piston, për lëvizjen e tyre. Ndërkaq, sistemi me kabëll bazohej në tërheqjen e vagonëve nga një kabëll i mbështjellë në makara, sipas të njëjtit parim që përdorej te teleferiku.⁵¹ Sistemi i tërheqjes me kabëll (teleferik) njihej në Amerikë që në vitin 1836, ndërsa sistemi atmosferik ishte i përhapur në Sent Zhermen, në Francë.⁵²

Në atë kohë ndiqej më shumë sistemi atmosferik, i cili kishte pasur sukses në Francë, prandaj mbështetej edhe nga qeveria austriake. Ministri i Tregtisë, Industrisë dhe Punëve Publike, Andreas Baumgartner, dekretoi ndërtimin e hekurudhës së Semeringut më 27 qershor 1848 dhe miratoi projektin e Karl Gegës, i cili ishte mbështetur nga shumica e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave, së bashku me variantin me sistem atmosferik.⁵³

Në fakt, në vitin 1848, megjithëse punimet kishin nisur, disa inxhinierë, si Eduard Shmidl i Shoqatës së Inxhinierëve Austriakë, e kundërshtuan projektin e Gegës dhe ngritën një komision për shqyrtimin e punimeve të linjës Glognic – Myrcushlag. Ky komision arriti në përfundimin se duhej përdorur sistemi i tërheqjes me kablllo (teleferik) në lartësi, ndërsa Gega vazhdoi të qëndronte i patundur në bindjet e tij.⁵⁴ Edhe hekurudha atmosferike nuk jepte garanci për t'u aplikuar në hekurudhën e Semeringut.⁵⁵ Për disa, kalimi i lokomotivave me avull në lartësi rreth 900 m mbi nivelin e detit, sidomos në dimër, dukej i pamundur. Një nga mbështetësit e Gegës ishte Karl fon Ecel, i cili në një artikull kishte shkruar se lokomotivat gjermane “Eslinger” ishin një garanci për kalimin e Semeringut, pasi mund të tërhiqnin një ngarkesë prej të paktën 100 tonësh.⁵⁶

⁵¹ Caiola, *Karl Ritter Ghega*, 114-116.

⁵² Dinhlöbl, *Die Semmeringbahn*, 64.

⁵³ *Po aty*; Ghega, *Atlas Pittoresque*, 11.

⁵⁴ Caiola, *Karl Ritter Ghega*, 122.

⁵⁵ Dinhlöbl, *Die Semmeringbahn*, 81.

⁵⁶ *Po aty*, 83.

Megjithatë, pati edhe projekte të tjera për linjën Glognic – Paierbah, ndër të cilat ai i propozuar nga Kaisler, me një tunel 6 km të gjatë, i cili konsiderohej i parealizueshëm me mjetet e kohës.

Karl Gega dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët ai i drejtonte dhe që u morën me rievimin gjeodezik dhe përgatitjen e projektit, ishin: Kazimir Pilarski, Franc Dimer, Anton Rost, Ferdinand Semrad, Anton Levicski, Edoardo Paolica e Xhiovani Roseti. Ata u vendosën në bujtinën “Kronenhaus” në Shotvien.⁵⁷ Ndërsa grupi i inxhinierëve për ndërtimin e hekurudhës dhe zbatimin e projektit përbëhej nga inspektori Filip Bolce, Kazimir Pilarski, Jozef Graber, Ludvig Hoifler, Feliks fon Szinglarski, Karl Bernardt, Karl Venke, Karl Riter fon Barikar, Jozef fon Vurt, si dhe nga inxhinierët mbështetës baron Senus dhe Franc Cerni.⁵⁸ Për ndërtimin e tuneleve dhe viadukteve u ngritën zyra të posaçme, të cilat iu besuan Anton Levicski-t.⁵⁹ Ndërtimi i stacioneve dhe i kabinave të kryqëzimeve në vitet 1851-1854 iu la inxhinierëve Moric Lër, Johan Salcman dhe Franc Cervenka.

Linja Glognic – Myrcushlag, e projektuar nga Gega si pjesë e hekurudhës Trieste – Vjenë me gjatësi 522 km dhe e ndarë në 14 seksione, iu dha me koncesion kompanive ndërtuese. Madje, për të ulur koston e ndërtimit, Gega e shkurtoi distancën nga Reichenau drejt Paierbahut, duke kaluar përmes lumit Shvarca.

Në periudhën 1848-1854, rreth 20 000 punëtorë u angazhuan për ndërtimin e hekurudhës së Semeringut.⁶⁰ Pikërisht në këtë kohë, kjo hekurudhë hapi vende të reja pune, ndërsa Perandoria Austriake po tronditej nga lëvizjet revolucionare brenda saj dhe në Mbretërinë Lombardo – Venete. Punimet nisën nga të dyja anët: në seksionin Glognic – Paierbah më 7 gusht 1848 dhe në seksionin Myrcushlag – Spital më 30 gusht 1848, ndërsa hekurudha ishte projektuar me dy binarë.

Gjatë punimeve u krijuan fshatra shumëkombëshe, ku u vendosën familjet e punëtorëve në shtëpi prej druri ose guri, sipas profesioneve: muratorë, gurëthyes, karpentierë, minatorë etj.⁶¹ Gjithashtu u ngritën

⁵⁷ Rampati, *Carlo Ghega*, 57-58.

⁵⁸ Cajola, Karl Ritter von Ghega, 121.

⁵⁹ Marina Bressan, “La costruzione: la ferrovia del Semmering,” në *Dalle Alpi all’Adriatico in ferrovia*, 56.

⁶⁰ Welterbe Semmeringbahn, <https://semmering.at/tourismus/weltkulturerbe-semmeringbahn-2/> (shikuar më 14.11.2025).

⁶¹ Bressan, “La costruzione: la ferrovia del Semmering,” 50.

dyqane me produkte ushqimore dhe artizanale, si dhe infermieri për kujdesin shëndetësor etj.

Duhej të lidheshin stacione me lartësi të ndryshme: nga njëra anë Glognic, në lartësi 439 m, në një distancë prej 41, 8 km, me Myrcushlag-un, në lartësi 677 metra, mes të cilëve gjendej Semeringu, që arrinte kuotën 898 m.⁶² Me gjithë kundërshtimet e disa inxhinierëve, Gega vazhdoi të mbronte tezën e kalimit të lartësive me anë të lokomotivës.

Kapërcimi i Alpeve Norike dukej një ndërmarrje e jashtëzakonshme në një kohë kur për gërmimet përdorej vetëm baruti, ndërsa makinat e shpimit dhe mjetet e punës ishin kryesisht manuale, si çekiçët dhe daltat, pasi dinamiti nuk ishte shpikur.⁶³ Gjatë punimeve u lëvizën 2, 02 milionë m³ dhe e u nxorën 1, 39 milionë m³ shkëmb.⁶⁴ Kalimi i masivit malor të Vaincetelvandit ishte i pamundur dhe, sipas Gegës, një “fantazi”.⁶⁵ Këtu, gjatë punimeve, më 27 tetor 1850, nga rrëshqitja e gurëve humbën jetën 14 punëtorë. Më pas, anët e shkëmbit u sheshuan me ndihmën e barutit, dhe Gega, me talentin e tij, depërtoi nga rrëza në brendësi të shkëmbinjve dhe arriti të lidhte tri tunele përmes galerive me qemer.⁶⁶

U ndërtuan 15 tunele me një gjatësi totale prej 4 600 m, 16 viadukte me gjatësi 1 500 m, 118 ura prej guri dhe 12 ura prej hekuri.⁶⁷ Tuneli kryesor i Semeringut kishte një gjatësi prej 1, 443 m. Në albumin e tunelit të Semeringut, që gjendet në fondin Gega të *Muzeut Correr* dhe është botuar nga kompania ndërtuese “Vëllezërit Klain”, paraqitet një prerje gjatësore e tunelit, i cili përshkohej nga 9 puse që shërbenin për ajrosje gjatë punimeve. Këto puse ishin të pajisura me pompa me avull, të cilat lehtësonin transportin e materialeve, heqjen e mbetjeve shkëmbore dhe thithjen e ujit.⁶⁸ Hapja e tunelit të Semeringut

⁶² Caiola, *Karl Ritter Ghega*, 110-111; Alvin Saraçi, “Hekurudha e Semeringut: E pamundura bëhet realitet,” në *Karl Gega dhe Semeringu*, 100-101.

⁶³ Armand von Schweiger-Lerchenfeld, *Die Überschienung der Alpen*, ed. Erhard Born (Moers: Steiger, 1884), 39; Rampati, *Carlo Ghega*, 55.

⁶⁴ Dinhobl, *Die Semmeringbahn*, 91.

⁶⁵ Ritter Ghega, *Atlas Pittoresque*, 13, 16.

⁶⁶ Dinhobl, *Die Semmeringbahn*, 89-90.

⁶⁷ “Semmeringeisenbahn”, <https://www.niederoesterreich.at/weltkulturerbe-semmeringeisenbahn> (shikuar më 24.09.2025).

⁶⁸ “Inventari i fondit të Karl Gegës në Muzeun Correr të Venecies,” në *Karl Gega dhe Semeringu*, 193-194. Albumi i tunelit të Semeringut, dedikuar Karl Gegës, përmban

më 12 qershor 1851 ishte një triumf i vërtetë i njeriut mbi natyrën.⁶⁹ Dhjetë ditë më pas, Gegës iu dha titulli *Ritter* dhe u dekorua me Urdhrin perandorak të Kurorës së Hekurt të klasit të 3-të, për merita në ndërtimin e hekurudhës dhe tunelit të Semeringut. Kjo pasqyrohet edhe në portretin e Karl Gegës, që mendohet të jetë vepër e piktorit Jozef Vaidner, të cilin, së bashku me një akualet të të njëjtit autor të viaduktit të Brno-s përgjatë linjës Lundenburg (Brekav) – Bryn (Brno), Gega ia la me testament *Muzeut Correr* të Venecies.

Më 4 gusht 1853 u nënshkrua marrëveshja e privatizimit të hekurudhës nga Simon Jorgo Sina dhe kompania Vjenë – Glognic u inkorporua në Hekurudhën shtetërore të Jugut.⁷⁰

Në vitin 1849, Karl Ludvig fon Bruk, i cili e kishte mbështetur ndërtimin e linjës dhe idenë e projektuesit të saj Karl Gegës për përdorimin e lokomotivave, mori postin e ministrit të Tregtisë, Ekonomisë dhe Punëve Publike. Pas ndërtimit të seksionit të parë Glognic – Paierbah – Aihberg në vitin 1850, u vendos të organizohej një garë për testimin e kalimit të tij me lokomotiva, në periudhën gusht – shtator 1851 deri në mars 1852. Pikërisht në vitin 1850, Karl Gega u emërua drejtor i përgjithshëm i hekurudhave të Perandorisë Austriake. Në këtë garë u paraqitën katër lokomotiva: “Viner-Noishtad” e prodhuar nga Gynter, “Vindobona” e linjës Vjenë-Glognic, “Bavaria” prodhim i Mafeit në Mynih dhe “Seraing” e Kokerillit nga Belgjika. Lokomotiva “Bavaria” e kompanisë “Mafei” të Mynihut u shpall fituese, duke u vlerësuar për shpejtësinë, aftësinë e tërheqjes së ngarkesës dhe konsum më të ulët të lëndës djegëse.⁷¹ Më 26 qershor 1851, Gega dhe Franc Fisher fon Rëstershtam ndërmorën një udhëtim prove me lokomotivën “Save” në seksionin Glognic – Kyb.⁷² Megjithëse këto lokomotiva tetërrotëshe ishin përmirësuar dy herë më shumë se në vitin 1848, ndërtuesit të lokomotivës “Vindobona”, Vilhelm fon Engert,

18 skica me ngjyra nga kompania sipërmarrëse e hapjes së tunelit të Semeringut, “Vëllezërit Klain”.

⁶⁹ Dinhobl, *Die Semmeringbahn*, 57.

⁷⁰ Dultinger, *Die Erzherzog Johann Bahn*, 26.

⁷¹ Cavaliere Carlo di Ghega, *Quadro dei progressi principali delle strade ferrate nel decennio 1840-1850 e di resultamenti delle corse di prova con locomotive di concorso sulla strada ferrata del Semmering in Austria* (Vienna: J. P. Sollingher, 1851), 73-116. Shogëruar me një atlas me tetë skica, që gjendet në Bibliotekën e *Muzeut Korrer* të Venecies.

⁷² *Po aty*.

iu ngarkua përgatitja e një modeli të ri lokomotive me peshë 200 tonë. Edhe pse hekurudha e Semeringut ishte përshkuar më parë nga lokomotiva më të lehta, sipas fon Engertit, Gega ishte i bindur për përmirësimin e vazhdueshëm të lokomotivave me avull me kalimin e kohës.⁷³ Hekurudha e Semeringut u përmbyll me ndërtimin e viaduktit të Kalte Rine-s në afërsi të Braitenshtajnit, i cili ishte dykatësh, rreth 183,3 m i gjatë, 46,3 m i lartë dhe me 15 harqe.

Ndërsa seksioni i fundit ishte linja Lubjanë – Trieste prej 145 km, për të cilën Gega që në vitin 1845 kishte propozuar dy variante: njëri që ndiqte rrugën e Idrës dhe Izoncos dhe tjetri nëpërmjet Karstit, që ishte rruga më e shkurtër. Gega zgjodhi këtë të fundit, pasi kursente rreth 45 km; për këtë arsye u quajt Hekurudha e Karstit. Ajo u ndërtua mes viteve 1849-1857 dhe u inaugurua më 27 korrik 1857.⁷⁴ Në këtë mënyrë u bë e mundur lidhja ndërmjet kësaj linje dhe hekurudhës lombardo-venete. Linja do të kalonte nga Lubjana drejt Postumias dhe Aurizinës (Nabrezinës) për të zbritur më pas drejt Triestes. Një ndër vështirësitë ishte kalimi i kënetës së Lubjanës, me gjatësi rreth 2,2 km, e cila lidhte dy stacionet Nostranje Gorice me Zhalostna Gora-n, të vendosura në dy skajet shkëmbore të saj. Për këtë u hapën dy kanale me gjatësi prej 1, 512 metrash secili, që devijonin ujin drejt lumit Ljubljana, duke bërë të mundur bonifikimin e kënetës. Më pas, ajo u mbulua me dhe, si edhe me 37, 800 m³ gurë shkëmborë të nxjerrë nga zonat përreth, me qëllim krijimin e një bazamenti mbi shtresën e saj argjilore, nëpërmjet ndërtimit të një dige mbi të cilën u ngrit traseja hekurudhore në një lartësi prej 3,9-4,8 m.⁷⁵ Gjatë punimeve në këtë linjë, në shpellat e Aurizinës (Nabrezinës) u zbuluan rastësisht burime ujore dhe u ndërtua një ujësjellës, i cili furnizonte me ujë qytetin e Triestes, si dhe stacionet e Grinjanos dhe të Aurizinës.⁷⁶

Linja hekurudhore Veronë – Bolcano – Innsbruck – Kufshajnt kishte rëndësi të veçantë për lidhjet e Mbretërisë Lombardo – Venete dhe të

⁷³ Von Engerth, *Gedenkrede bei Enthüllung*, 12.

⁷⁴ Alessandro Puhali, "Karl Gega dhe Hekurudha Jugore," në *Karl Gega dhe Semeringu*, 92; Rampati, *Carlo Ghega*, 90; *Zur Erinnerung an die Eröffnung der StaatsEisenbahn von Laibach bis Triest unter den allerhöchsten Auspicien seiner k. k. Apost. Majestaet des Kaiser Franz Joseph I* (Wien: 1857), 3.

⁷⁵ Marina Bressan, "La costruzione: la Ferrovia del Carso Lubiana – Trieste," në *Dalle Alpi all' Adriatico in ferrovia*, 89-93.

⁷⁶ Po aty, 103-105; Puhali, "Karl Gega dhe Hekurudha Jugore", 92.

Perandorisë Austriake me Bavarinë, rrjetin hekurudhor gjerman dhe Europën Veriore. Ideja për ndërtimin e saj ishte hedhur nga ekonomisti gjerman Fridrih List në vitin 1837.⁷⁷ Ndërkohë, në vitin 1846 u krijua kompania për linjën hekurudhore Venecie – Basano – Trento – Brenero, e cila, ashtu si edhe linja hekurudhore lombardo – venete, mund të shërbente për ripërtëritjen e portit të Venecies.⁷⁸ Por qeveria austriake vendosi ndërtimin e seksioneve Veronë – Bolcano dhe Insbruk – Kufshtain. Punimet për ndërtimin e të dyja linjave nisën në vitin 1853. Për seksionin Veronë – Brenero – Insbruk, që u quajt Hekurudha e Breneros, u krijua Kompania Mbretërore Perandorake e Hekurudhave Shtetërore Tiroleze, e drejtuar nga Luigji Negreli, por vetëm aksi hekurudhor Veronë – Bolcano u përfundua nga Karl fon Ecel dhe u inaugurua më 14 maj 1859. Ndërsa linja Insbruk – Kufshtajn, e ndërtuar për të lidhur Austrinë dhe Bavarinë, u projektua nga Karl Gega dhe u hap më 24 nëntor 1858.⁷⁹ Bashkimi i këtyre dy linjave përgjatë seksionit Bolcano – Insbruk u realizua pas vdekjes së Karl Gegës, në vitin 1867, sipas projektit të Karl fon Ecelit, një prej mbështetësve të tij gjatë polemikave për Semeringun, i cili ndërroi jetë në vitin 1865.

Në vitin 1853, Karl Gega kishte përgatitur një projekt të rrjetit hekurudhor austriak. Prandaj, ai ndërmori edhe ndërtimin e hekurudhave hungareze dhe polake, për të cilat nevojitet një studim i mëtejshëm.

Së fundi, me privatizimin e hekurudhave në vitet 1854-1858, Gega u dërgua në Itali si përfaqësues i Perandorisë Austriake në Firenze dhe si këshilltar për ndërtimin e hekurudhave të Italisë Qendrore, për linjën Piacenza – Bolonja – Pistoia.⁸⁰

Ndërsa në vitin 1859, me mbylljen e Drejtorisë së Ndërtimeve, Karl Gega u emërua drejtues departamenti pranë Ministrisë së Financave, ku roli i tij ishte i kufizuar. Më pas, ai u dërgua në Transilvani për të përgatitur një raport mbi ndërtimin e hekurudhave në zonën gjermanishtfolëse të Sibenbyrgen-it.

⁷⁷ Caiola, *Karl Ritter von Ghega*, 36.

⁷⁸ Loris Scaggiante, *Le strade ferrate: l'Italia preunitaria e gli elementi dell'identità nazionale* (e pabotuar, tezë diplome, Venezia: Università Ca' Foscari di Venezia, 2012-2013), 174-275.

⁷⁹ “La linea ferroviaria del Brennero - Premesse generali”, http://www.tecneum.eu/index.php?option=com_tecneum&task=object&id=414&lang=de&lang=it#literatur (shikuar më 12.02.2026).

⁸⁰ Dinohobl, *Die Semmeringbahn*, 60.

Për ndërtimin e linjës Glognic – Myrcushlag të Hekurudhës së Semeringut, ai u dekorua me medaljen e Urdhrit të Leopoldit, ndërsa për “projektimin dhe realizimin” e të gjithë Hekurudhës Jugore Vjenë – Trieste, më 27 korrik 1857, siç shkruhet në diplomën që gjendet në fondin Gega, u nderua me medaljen më të lartë të Urdhrit të Perandorit Franc Jozefi I.

Gega vdiq në Vjenë nga tuberkulozi më 14 mars 1860. Ai dhe vepra e tij u përkujtuan me monumente, medalje, pulla postare dhe emra rrugësh etj. Në vitin 1869, në Kongresin e hekurudhave gjermane, inspektori i përgjithshëm i hekurudhave austriake, Johan Ferdinand Vagner fon Vagensburg, propozoi ngritjen e një monumenti në Semering, vepër e Hainrih fon Ferstel-it.⁸¹ Gjithashtu, me rastin e 25-vjetorit të ndërtimit të Hekurudhës së Semeringut, në vitin 1879, Shoqata e Inxhinierëve dhe Arkitektëve të Triestes e nderoi Karl Gegën me një bust përkujtimor, vepër e skulptorit Xhovani Depauli, i cili sot ndodhet në stacionin e Triestes dhe është transferuar aty nga Muzeu Revoltela.

Më 6 shtator 1887, Shoqata Austriake e Inxhinierëve dhe Arkitektëve e zhvendosi trupin e Gegës nga varrezat e Veringerit në një varr monumental në varrezat qendrore të Vjenës, pranë figurave më të shquara të Austrisë.

Si përfundim, Karl Gega dha një kontribut të madh në ndërtimin e rrjetit hekurudhor austriak: ai ndërtoi një pjesë të Hekurudhës së Veriut dhe pothuajse të gjithë Hekurudhën e Jugut Vjenë – Trieste. Në albumin me litografi të botuar me rastin e inaugurimit të linjës hekurudhore Vjenë – Trieste, kjo vepër përshkruhet si një nga triumfet më të mëdha të artit të ndërtimit të hekurudhave: “einen der grössten Triumphe neuer Eisenbahnbaukunst”.⁸² Talenti i Gegës u shfaq më së miri në ndërtimin e hekurudhës së Semeringut, hekurudhës së parë malore dhe një prej më të lartave në Europë, një vepër pothuajse e pamundur për t’u realizuar, e cila më pas shërbeu si model për ndërtimin e hekurudhave të tjera malore.

⁸¹ Rampanti, *Carlo Ghega*, 116-117.

⁸² *Zur Erinnerung an die Eröffnung*, 4.

Burime e bibliografi:

Bibliotekë:

Venezia, Biblioteca Museo Correr më tej BMC, memoria manoscritta di Giovan Battista Ghega, Manoscritto (ms. Cicogna 3418 bis.)

Literaturë:

BANFI, Emmanuele. “Dinamika gjuhësore në zonën e Adriatikut mes shekujve XVIII-XIX: Mes diglosish, dygjuhësish dhe synimit të gjuhëve kombëtare.” *Shejzat* 1-2 (2020): 178-225.

BEER, Adolf. *Die österreichische Handelspolitik unter Maria Theresa und Josef II.* Wien: Carl Gerold's Sohn, 1898.

BERNARDELLO, Adolfo. *La prima ferrovia fra Milano e Venezia: Storia dell'Imperial-Regia Privilegiata Strada ferrata Ferdinanda Lombardo-Veneta (1835-1852).* Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, 1996.

BOROVA, Jona. “Carlo Ghega: La leggenda che cambiò la concezione dell'impossibile.” Në *Diaspora albanese, Dossier, Storia*. 2 dhjetor 2017. <https://www.albanianews.al/diaspora/carlo-ghega> (shikuar më 24 dhjetor 2025).

BRONZA, Boro. “The Austrian Trade towards the Ottoman Empire and Asia during the 18th Century.” *Original Scientific Paper* (10 August 2016): 139-152. <https://doi.org/10.19090/i.2026.27.139-152> (shikuar më 19 shkurt 2026).

BRESSAN, Marina. “La costruzione: la ferrovia del Semmering.” Në *Dalle Alpi all'Adriatico in ferrovia con la Meridionale (1857) e con la Transalpina (1906)*. Venezia: Edizione Laguna, 2007, 49-86.

BRESSAN, Marina. “La costruzione: la Ferrovia del Carso Lubiana – Trieste.” Në *Dalle Alpi all'Adriatico in ferrovia con la Meridionale (1857) e con la Transalpina (1906)*, redaktuar nga Marina Bressan. Venezia: Edizione Laguna, 2007, 87-112.

CAIOLA, Marika. *Karl Ritter von Ghega*. Tezë diplome e pabotuar, Istituto Universitario di Architettura di Venezia, Venezia, 2000-2001.

DEL NEGRO, Piero. “Carlo Ghega.” Në *Dizionario biografico degli italiani*, vol. 53. Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana “Giovanni Treccani”, 2000, 527-529.

DINHOBL, Günter. *Die Semmeringerbahn: Der Bau der ersten Hochgebirgseisenbahn der Welt.* Wien, Köln, Weimar: Böhlau Verlag, 2003.

- DUCELLIER, Alain. "Cattaro punto di convergenza degli emigranti albanesi?" Në *Città e sistema adriatico alla fine del medioevo: Convegno di Studi, Padova, 4-5 aprile 1997*, në *Atti e Memorie della Società Dalmata di Storia Patria*, vol. 26. Venezia, 1997, 99-119.
- ENGERTH, Wilhelm Ritter von. *Gedenkrede bei Enthüllung des Ghega-Monumentes auf dem Semmering am 22 Juli 1869*. Wien: Leopold Sommer, 1869.
- ERBER, Tullio. *La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara: Cenni storici*. Dubrovnik: Flori, 1883.
- FRANCO, Andrea. "Karl Gega: Veprat kryesore të tij në provincën e Trevizos në periudhën e sundimit të Habsburgëve." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*. Tiranë: Ombra DVD, 2025, 68-76.
- GHEGA, Carl. *Die Baltimore-Ohio Eisenbahn über das Alleghanygebirge mit besonderer Rücksicht auf Steigungen und Krümmungen*. Wien: Kaulfuss Witwe, Prandel & Comp., 1844.
- GHEGA, Carl Ritter von. *Atlas pittoresque du chemin de fer du Semmering, précédé d'un aperçu historique et statistique sur les chemins de fer en exploitation en Autriche*. Vienna: Imprimerie de Charles Gerold et Fils, 1854.
- GHEGA, Carl Ritter von. *Malerischer Atlas der Eisenbahn über den Semmering: Mit historisch-statistischer Übersicht der im Betriebe stehenden Eisenbahnen in Oesterreich*. Wien: Carl Gerold, 1854.
- HARTL, Gerta, dhe Herbert Viktor Patera. *Strassen, Bruecken, Eisenbahnen: Karl Ghega*. Graz: Styria, 1960.
- HOLLAND, Gustav Albert. *Eisenbahn-Lexikon von Mittel-Europa*. Friedrichshafen dhe Leipzig: Julius Hoechel's Verlag, 1855.
- HOLLERER, Andreas. *Die Südbahn über den Semmering: Eine Pionierleistung im frühen Eisenbahnwesen Österreich-Ungarns und deren Bedeutung als Initiatorin einer aufstrebenden Fremdenverkehrsregion im steirisch-niederösterreichischen Grenzraum im Zeitraum 1842 bis zum Ende der Donaumonarchie*. Tezë masteri në Art në Institutin e Historisë, e pabotuar, Karl-Franzens-Universität Graz, Graz, 2022.
- Karl Gega dhe Semeringu. Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*, ed. Lucia Nadin, Gjon Radovani me bashkëpunimin shkencor të Camillo Toninit. Tiranë: Ombra DVD, 2025.
- NADIN, Lucia, Gjon Radovani, dhe Camillo Tonini, red. *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*. Tiranë: Ombra DVD, 2025.

- KURZEL-RUNTSCHNEIDER, Erich. "Carl Ritter von Ghega: Gedenken zum 100. Todestag." Në *Blätter für Technikgeschichte*, redaktuar nga Josef Nagler. Wien: Springer-Verlag, 1960.
- "La linea ferroviaria del Brennero. Premesse generali", http://www.tecneum.eu/index.php?option=com_tecneum&task=object&id=414&lang=de&lang=it#literatur (shikuar më 12.02.2026)
- "Ligne de chemin de fer de Semmering", Unesco, <https://whc.unesco.org/fr/list/785/> (shikuar më 17.09.25).
- LOGORECI, Pjetër. "Shqiptari Karl Gega, mjeshtri i ndërtimit të hekurudhës së parë malore në botë." *Shqiptarja*, nr. 18 (7 tetor 2012).
- NADIN, Lucia. "Familja Gega nga Shqipëria në Venecia dhe në Vjenë." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*, 35-56. Tiranë: Ombra DVD, 2025.
- NEUMANN-SPALLART, Franz Xaver von. *Österreichs maritime Entwicklung und die Hebung von Triest: Eine volkswirtschaftliche Studie*. Stuttgart: Julius Maier, 1882.
- NIEL, Alfred. *Carl Ritter von Ghega: Ein Leben für die Eisenbahnen*. Wien: Zeitschriftenverlag Ployer & Co., 1977.
- PAAR, Rinaldo. "Carl Ritter Ghega – 2018 Surveyor of the Year." *Kartografija i Geoinformacije* 18, nr. 32 (December 2019): 64-78. <https://doi.org/10.32909/kg.18.32.5>.
- PEYFUSS, Max Demeter. "Sina zu Hodos und Kizdia, Georg Simon Freiherr von (1782-1856)." Në *Österreichisches Biographisches Lexikon 1815-1950*, vol. 12, nr. 57 (2004): 289. Shikuar më 20 shtator 2025. https://www.biographien.ac.at/oeb1/oeb1_S/Sina-Hodos-Kizdia_Georg-Simon_1782_1856.xml.
- PUHALI, Alessandro. "Karl Gega dhe Hekurudha Jugore." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*, 85-96. Tiranë: Ombra DVD, 2025.
- RAMPATI, Aldo. *Carlo Ghega, il cavaliere delle Alpi*. Trieste: Italo Svevo, 2002.
- SANTORO, Michele. "La marinarezza bocchese: Traffici e pratiche culturali nelle Bocche di Cattaro (secoli XV–XVII)." Në *Stato da Mar 6: Incroci di sguardi. Lo stato da mar nello sguardo degli altri / Gli altri nello sguardo dello Stato da Mar e altri contributi. Atti del 10 Convegno Internazionale Venezia e il suo Stato da mar / Venice and Its Stato da Mar, Venezia/Venice, 7-9 aprile 2022*, redaktuar nga Bruno Crevato Selvaggi dhe Despina Vlassi. Roma: Società Dalmata di Storia Patria, 2023, 304-331.

- SARAÇI, Alvin. "Famous Albanians in Venice: Karl Gega, Architect of the Austro-Hungarian Empire." *Studia Albanica* 1-2, XLVI (2009): 155-164. Tiranë: Académie des Sciences d'Albanie, Section des Sciences Sociales.
- SARAÇI, Alvin. "Hekurudha e Semeringut: E pamundura bëhet realitet." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*. Tiranë: Ombra DVD, 2025, 97-106.
- "Semmeringebahn." Shikuar më 24 shtator 2025.
<https://www.niederoesterreich.at/weltkulturerbe-semmeringebahn>.
- SCHUHBÖCK, Christian. *Weltkulturerbe Semmeringbahn: Führer zur ersten UNESCO-Eisenbahn-Welterbestätte der Welt*. Berndorf: Kral-Verlag, 2009-2010.
- SCHWEIGER-Lerchenfeld, Armand von. *Die Überschienung der Alpen*. Redaktuar nga Erhard Born. Moers: Steiger, 1884.
- STRACH, Hermann. "Geschichte der Eisenbahnen der Österreich-Ungarns von den ersten Anfängen bis zum Jahre 1867." Në *Geschichte der Eisenbahnen der österreichisch-ungarischen Monarchie*, vol. 1. Wien, Teschen dhe Leipzig: Karl Prochaska, 1898.
- STRATJEL, Friedel, dhe Dieter Friedl. *Bernhardthal und die "Kaiser-Ferdinands-Nordbahn": Beiträge zur Geschichte von Bernhardthal und Umgebung*. Bernhardthal: Friedel Stratjel, 2010-2014.
- STRAUB, Wolfgang. *Carl Ritter von Ghega: Der geniale Pionier des Eisenbahnzeitalters im profunden Porträt*. Graz: Verlag Styria, 2004.
- STRAUB, Wolfgang. *Karl Gega: Biografi*. Përkthyer nga Sejdi Demiri. Shkup: Alfa, 2013.
- URBANI, Carlo. "Karl Gega në Institutin e Shkencave, Letërsisë dhe Arteve të Venetos." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*. Tiranë: Ombra DVD, 2025, 77-84.
- TONINI, Camillo. "Trashëgimia e Karl Gegës në Muzeun Correr: Fati i një fondi të veçantë." Në *Karl Gega dhe Semeringu: Një hekurudhë për të ndryshuar historinë*. Tiranë: Ombra DVD, 2025, 119-134.
- WAGNER, Robert. "Carl Ritter von Ghega: Malerischer Atlas der Eisenbahn über den Semmering." Në *Bibliothek, Technik, Recht: Festschrift für Peter Kubalek zum 60. Geburtstag*, redaktuar nga Hans Hrusa, 199-204. Wien, 2005. Shikuar më 14 nëntor 2025.
<https://semmering.at/tourismus/weltkulturerbe-semmeringbahn-2/>.
- WEIDMANN, Franz Carl. *Die Alpengegenden Niederösterreichs und Obersteiermarks im Bereiche der Eisenbahnen von Wien bis Mürzzuschlag*. Wien: Tendler & Compagnie, 1851.
- ZIMOLO, Armando. "I protagonisti: Karl Ludwig von Bruck tra passato e futuro." Në *Dalle Alpi all'Adriatico in ferrovia con la Meridionale*

(1857) *e con la Transalpina* (1906), redaktuar nga Marina Bressan, 44-48. Venezia: Edizione Laguna, 2007.

Zur Erinnerung an die Eröffnung der Staats-Eisenbahn von Laibach bis Triest unter den allerhöchsten Auspizien seiner k. k. Apost. Majestät des Kaiser Franz Joseph I. Wien, 1857.

DR. ALVIN SARAÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

saracialvin@hotmail.com

S u m m a r y

KARL GEGA'S ORIGIN, LIFE AND WORKS

Karl Gega's biography, origin, life and works are dealt with in this item. As it turns out from the international conference, exhibition and catalogue on him, the Albanian origin is already witnessed, but now we have to define whether the family Gega's town of origin was Shkodra or the region of Bar (Tivar) as his forefathers' migration towards Perast of Kotor took place by the end of the XVII or during the XVIII Century. After the Treaty of Passarowitz (Požarevac, 1718), The Austrian Empire had as project to promote trade by means of its port of Trieste and the strengthening of its navy. As far as it concerns his career in the realm of the engineering and railways, I cast light on the Lundenburg (Břeclav) – Brünn (Brno) - Olmütz (Olomouc) - Prague – Bodenbach (Děčín) rail line as part of the Northren Railway (*Nordbahn*) and focuss especially on the Vienna – Trieste rail line or the Southern Railway (*Südbahn*) and its most difficult section Gloggnitz – Mürzzuschlag, which was the most important of the Austrian Empire and contributed for the development of trade in a period when the Suez Canal's project was ready and would become another trade route in 1869. For his biography and works, I have made use of some parts of the Ghega's Fund in Museum Correr Library in Venice such as the Albums and the titles of honor.

Keywords: Karl Gega, albanian origin, railways, Venice, Vienna, Trieste, Semmering.

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
romeo_gurakuqi@hotmail.com; romeo.gurakuqi@asa.edu.a

**LINDJA DHE ZHVILLIMI I NACIONALIZMIT SHQIPTAR
(SHEK. XIX DERI NË VITET 1920)****Abstrakt:**

Ky artikull trajton procesin historik të shfaqjes dhe zhvillimit të nacionalizmit shqiptar, duke e vendosur atë në kuadrin e debateve teorike mbi kombin dhe nacionalizmin. Analiza mbështetet në disa qasje të rëndësishme teorike: theksin e Ernest Gellner-it mbi arsimin dhe modernizimin; rolin e nukleve të Kulturës së Lartë dhe diasporës patriotike në formësim dhe njëjtësim; dallimin e John Plamenatz-it ndërmjet nacionalizmave “perëndimorë” dhe “lindorë”; si dhe interpretimin e Adrian Hastings-it mbi rrënjët kulturore kristiane të nacionalizmit. Në këtë kornizë, rasti shqiptar paraqitet si një shembull i vonuar dhe kompleks i formimit kombëtar, si pasojë e prapambetjes ekzistuese në periferinë lindore të Perandorisë Osmane. Studiuesja Nathalie Clayer ka vënë në dukje pengesat strukturore me të cilat u përball nacionalizmi shqiptar: prapambetjen ekonomike, komunikimet e dobëta, analfabetizmin masiv dhe mungesën e një aparati shtetëror. Ndërkohë, Lea Ypi thekson ndërthurjen dialektike mes idealeve iluministe të sovranitetit dhe shekullarizmit, nga njëra anë, dhe rrymave romantike europiane të shek. XIX, nga ana tjetër, në formësimin e nacionalizmit shqiptar. Shoqëria shqiptare e kohës, e mbështetur mbi një strukturë agrare dhe fisnore dhe e karakterizuar nga një diversitet i theksuar fetar (islam, ortodoksi, katolicizëm), u bë një pengesë e madhe për përhapjen e njësuar të vetëdijes kombëtare. Për më tepër, ndalimi nga autoritetet osmane i shkollimit në gjuhën shqipe dhe i përdorimit të alfabetit latin e shtyu më tej procesin e ndërtimit kombëtar dhe të shkollës kombëtare. Si pasojë, vetëdija kombëtare u konsolidua fillimisht në rrethet intelektuale dhe në diasporën patriotike, të mbështetura nga kleri katolik dhe protektoratet austro-hungareze, përpara se të depërtonte në shtresat më të gjera të popullsisë.

Shpallja e Pavarësisë në vitin 1912 solli atë që studiuesit e kanë quajtur “sovrانيت negativ”: çlirimin nga sundimi osman pa ndërtimin e institucioneve shtetërore funksionale, të shtrira në të gjithë territorin dhe të njohura ndërkombëtarisht. Në një masë të madhe dhe në planin ndërkombëtar, sovraniteti u rikuperua gjatë Principatës së Shqipërisë, por kohëzgjatja ishte e reduktuar si në kohë, ashtu edhe në hapësirë. Kundërshtimi i brendshëm nga grupimet proosmane dhe esadiste, i shoqëruar me ndërhyrjet e shteteve fqinje, çoi në rrëzimin e shtetit të brishtë shqiptar në vitin 1914. Megjithatë, rasti shqiptar tregon se nacionalizmi mund të zhvillohet edhe në kushte të pafavorshme, duke u mbështetur te ringjallja kulturore, veprimtaria intelektuale dhe diplomacia ndërkombëtare. Ringritja e tij mori sërish hov gjatë viteve 1916-1918, në zonën austro-hungareze të kontrollit ushtarak dhe, paradoksisht, edhe në zonat italiane dhe franceze. Megjithatë, ripërtëritja e plotë dhe konsolidimi i tij u arritën vetëm gjatë viteve '20, në kuadrin e një shteti laik modern dhe të balancuar krahinarisht.

Fjalë kyçe:

Rilindja Kombëtare Shqiptare, iluminizmi dhe shekullarizmi, diversiteti fetar, shoqëria agrare dhe fisnore, “sovrانيت negativ”, “sovrانيت pozitiv”, identiteti kombëtar, diaspora patriotike, kultura e lartë nacionaliste.

Historia e lindjes dhe e zhvillimit të nacionalizmit shqiptar

Rilindja Kombëtare / Nacionalizmi shqiptar u rishfaq në fillim të shek. XIX, por u bë i rëndësishëm vetëm pas gjysmës së këtij shekulli. Ndërsa përhapja e tij në gjirin e rretheve më të gjera se ato të veprimtarëve të parë të shqiptarizimit – pra nxitësve të parë të një identiteti kombëtar shqiptar¹ – si qarqet intelektuale katolike në veri dhe rrethet patriotike ortodokse e myslimane në Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Përmet, Berat, Elbasan dhe Kosovë etj., si edhe në diasporë, i përket 25 vjetëve të fundit të shek. XIX dhe dekadave të para të shek. XX.²

Sipas studiueses Lea Ypi, Rilindja Kombëtare Shqiptare paraqet një dialektikë të ndërlikuar midis iluminizmit dhe romantizmit. Duke iu përshtatur veçorive historike dhe kulturore shqiptare, kjo Rilindje mbështeti idealet iluministe të sovranitetit, shekullarizmit dhe dijes së arsyeshme. Këto ideale përcaktuan kuadrin kulturor dhe sfidën politike të Rilindjes, e cila, pavarësisht afërësive të përkohshme me romantizmin europian, mbeti thelbësisht e lidhur me projektin iluminist.³

Sipas Nathalie Clayer-it, përhapja e ngadaltë e nacionalizmit shqiptar, në krahasim me nacionalizmat e tjerë ballkanikë, lidhej me zhvillimin ekonomik të kufizuar, mungesën e rrjeteve efikase të komunikimit, përqindjen e lartë të analfabetizmit, dobësinë e arsimit kombëtar dhe, mbi të gjitha, mungesën e një shteti që do të mund ta prodhonte dhe ta ushqente atë nëpërmjet një politike irredentiste. Por

¹ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë* (Tiranë: Përpjekja, 2009), 636.

² Vepra më e plotë mbi nacionalizmin shqiptar është: *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, e autorit Sali Kadria (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020). Tezat e paraqitura nga autori i këtij artikulli janë produkt i një pune të gjatë kërkimore dhe studimore, të mishëruara në monografitë e tij: *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Gregisë, 1913-1914* (Tiranë: UET Press, 2011); *Shqipëria 1911-1914* (Tiranë: UET Press, 2012); *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore, 1918-1921* (Tiranë: UET Press, 2013); *The Versailles Order and making Albania 1918-1926 (forthcoming 2026)*; *Shqipëria në Luftën e Madhe, 1914-1918* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2026).

³ Lea Ypi, "The Albanian Renaissance in Political Thought: Between the Enlightenment and Romanticism," *East European Politics and Societies*, Vol 21, Issue 4 (Nov. 2007): 662.

Clayer-i nuk e sheh arsyen e kësaj vonese tek ekzistenca e disa besimeve fetare në gjirin e kombit shqiptar dhe aq më pak në vetë natyrën e shqiptarëve,⁴ gjë që për ne, në dallim prej saj, rezulton si një arsye e rëndësishme dhe themelore për masën e popullsisë, por jo për elitën, e cila kishte arritur ta kapërcente përkatësinë religjioze dhe krahinore si barrierë për bashkimin kombëtar. Kjo barrierë ekzistonte, sipas nesh, edhe pse elita e Rilindjes Kombëtare u përpoq të dallonte etninë nga religjioni, duke u lidhur me idealet e tolerancës dhe me kritikën ndaj obskurantizmit fetar. Megjithatë, në fund, ishin masat ato që mbizotëruan dhe imponuan rrëzimin e shtetit të institucionalizuar mbi modelin perëndimor, në shtator të vitit 1914.

Brenda elitës shqiptare me ndërgjegje kombëtare mbizotëroi prirja për të kërkuar autonomi pa shpëputje të plotë nga Perandoria Osmane. Ky qëndrim nuk shpjegohet vetëm me interesa ekonomike apo me konservatorizëm social, por edhe me frikën nga shtetet fqinje, si dhe me afinitetin politik e fetar që buronte nga statusi i privilegjuar i shqiptarëve brenda perandorisë.⁵ Pajtohemi me tezën e Todorovës për një pjesë të elitës myslimane, por ky orientim prootoman nuk përfshinte gjithë elitën e Rilindjes, as intelektualët katolikë të Veriut, as ortodoksët që kishin kapërcyer varësinë nga kisha greke, veçanërisht në Korçë, Gjirokastrë e Berat. Të formuar në sistemin arsimor fetar dhe të ndikuar nga diaspora patriotike, ata përqafuan herët nacionalizmin shqiptar dhe kërkonin shpëputje të menjëhershme nga perandoria. Në vitet 1914-1915, identiteti prootoman u ringjall në Shqipërinë Qendrore dhe në ish-qendrat osmane, si pasojë e një procesi të gjatë kulturizimi që kishte krijuar një simbiozë midis identitetit shqiptar dhe atij osman.

Pavarësia e Shqipërisë u pranua si fakt, por pa krijuar një shtet funksional në kufijtë etnikë dhe pa garanci për vetëqeverisje efektive. Shqipëria fitoi një “sovrانيتet negativ” – lirinë nga pushtuesi shumëshekullor – por i mungoi “sovrانيتeti pozitiv”, pra aftësia për të ndërtuar një qeverisje civile dhe të qëndrueshme. Shoqëria agrare, e mbështetur mbi lidhje fisnore, mbetej primitive dhe e thjeshtë strukturalisht; përballë kërkesës për modernizim institucional e politik, ajo rrëshqiste lehtësisht drejt formave autokratike të pushtetit.⁶ Në rastin

⁴ Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, 636.

⁵ Maria Todorova, *Imaging the Balkans* (Oxford: Oxford University Press, 1997), 167.

⁶ Todorova, *Imaging the Balkans*, 185.

e Shqipërisë, shteti u rrëzua në kaos politik dhe anarki sociale e ndërkomunitare, duke u shoqëruar me shpërthime integralizmi dhe me pushtime të huaja që sollën pastrime etnike të hapura. Kështu, gjatë viteve 1914-1915, popullsia myslimane në jug u godit nga vorioepirotistët, ajo katolike në jug të Matit nga forcat ehlikjamiste dhe esadiste, ndërsa banorët e Kelmendit dhe të Shqipërisë Lindore e Verilindore u dëbuan nga ushtritë malazeze dhe serbe.

Pyetjet që ngrihen në këtë rast janë: Pse flasim për një “sovrانيتet negativ” ndër shqiptarë? Cilat janë arsyet e kësaj mungese të pranimit të përgjithshëm të një shteti shqiptar të europianizuar nga masa e popullsisë në agimin e shtetformimit?

Ndryshe nga qëndrimi ndaj popujve të tjerë të krishterë në sundimin e saj, Porta e Lartë mbajti një politikë të veçantë ndaj nënshetasve myslimanë shqiptarë, të mbështetur në parimin e traditës. Ajo ndaloi hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e gjuhës amtare me alfabet latin, i cili kishte qenë në përdorim që në Mesjetë, para pushtimit osman,⁷ në mjediset e Kulturës së Lartë arbërore. Kjo politikë antishqiptare, e ndihmuar gjerësisht edhe nga Patrikana e Kostandinopojës, shërbeu për të dobësuar vetëdijen kombëtare dhe për të zbehur vazhdimësinë kulturore të Arbërisë.⁸ Duhet të kujtojmë se nacionalizmi në Ballkan në shek. XIX, u ndërtua kryesisht rreth identiteteve gjuhësore dhe fetare. Gjuha u perceptua nga të gjithë udhëheqësit kombëtarë dhe kulturorë në vendet ballkanike që arritën të fitonin autonominë ose pavarësinë si një agjent i fuqishëm i bashkimit. Përpjekjet e shteteve të reja u përqendruan në krijimin e sistemeve arsimore të laicizuara, të centralizuara dhe uniforme, si një nga agjentët

⁷ Në vitin 1332, Guillaume Adam (*Guillelmus Adam*), në librin e tij “DIRECTORIUM AD PASSAGIUM FACIENDUM (UDHËZIM PËR TË KRYER KALIMIN [E DETIT], shkruan: “Edhe pse shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, ata megjithatë, kanë në përdorim alfabetin latin edhe në të gjitha librat e tyre” “*Et licet Albanenses aliam omnino linguam a Latina habent et diversam, tamen literam Latinam habent in usu et in omnibus suis libris*” “Directorium ad Faciendum Passagium Transmarinum,” II in: *The American Historical Review*, Vol. 13 (1907): 97. Guillaume Adam ka qenë frat dominikan, argjipeshkëv i Tivarit, ku edhe ka vdekur, ndoshta në vitin 1348. Adam-i konsiderohet si autori i veprës së cilës i jemi referuar, por mes studiuesve ekzistojnë ende pikëpyetje.

⁸ Ferdinando Salleo, *Shqipëria: Gjashtë muaj mbretëri* (Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000), 24-25.

më të fuqishëm të nacionalizmit, krahas ushtrisë.⁹ Te shqiptarët, veçanërisht te popullsia myslimane, zhvillimi i gjuhës dhe kulturës kombëtare u pengua nga autoritetet osmane, të cilat, me kushtetutën e vitit 1908, tentuan ta zëvendësonin alfabetin latin me atë arab, në kundërshtim me traditën mesjetare dhe përpjekjet rilindëse. Megjithatë, rrjetet e Rilindjes ishin mjaft të fuqishme për të rikthyer përdorimin e alfabetit latin dhe për ta orientuar identitetin kulturor shqiptar drejt Europës. Ndryshe nga kombet e tjera ballkanike, që e konsoliduan identitetin përmes gjuhës, letërsisë dhe fesë, shqiptarët mbetën të vonuar në këtë proces nga sundimi osman, duke e zhvilluar atë kryesisht falë përpjekjeve të elitës dhe diasporës.

Teza jonë është se nacionalizmi shqiptar, si në fillesat e tij ashtu edhe në zhvillimin e mëvonshëm, nuk përbënte një rrymë homogjene, por një dukuri të segmentuar në kuptim, vetëdije, traditë, kulturë dhe orientim strategjik. Krahas rrymës rilindëse, e cila mbështetej në kujtesën historike, në gjuhën shqipe me alfabet latin dhe në idealin e një shteti kushtetues, laik e të baraspeshuar midis gegëve dhe toskëve, pas vitit 1908 u shfaqën edhe forma të tjera të nacionalizmit, të ndikuara nga xhonturqit dhe të përfaqësuara nga esadistët dhe ehlikjamistët-otomanistë, të cilët promovuan një model shtetëror sulltanor e integralist, në kundërshtim me traditën iluministe të Rilindjes. Edhe brenda vetë lëvizjes rilindëse – nga Lidhja e Prizrenit të Vlora (1912) dhe Durrësi (1914) – ekzistonin vizione të ndryshme për shkallën e pastërtisë nacionale dhe kulturore: nga nacionalizmi i klerit katolik në Shkodër dhe ai i diasporës shqiptare në SHBA, Zvicër, Ruman, Egjipt e Itali, tek ai i intelektualëve myslimanë në Stamboll dhe qëndrimi më i moderuar i bejlerëve patriotë, të cilët mbështetnin shkëputjen nga perandoria, por jo një ndarje të plotë dhe radikale prej saj. Pse i përmbahemi një teze të tillë? Ky është një përfundim i arritur për shkak të kërkimit në përgjithësi. Diferencimet, sipas meje, lidhen kryesisht me strukturën krahinore dhe religjioze të Shqipërisë, orografinë e vendit, shkallën e pranimit të pushtetit otoman dhe të imponimeve të tij superstrukture, nivelin e emancipimit ose të përhapjes së padijes në shoqërinë shqiptare, si dhe shkollimin etj. Bëhet fjalë për një shoqëri patriarkale, ku të drejtat dhe privilegjet e veçanta mbijetuan në një kontekst anarkie të lënë qëllimisht

⁹ Todorova, *Imaging the Balkans*, 176-177.

nga pushteti otoman, dhe e cila kishte pak ose aspak ngjashmëri me shoqëritë borgjeze dhe me shoqërinë civile në lindje të tyre.¹⁰

Të gjithë këta faktorë – që lidhen me historinë e politikave pushtuese, me përçarjet dhe zhvillimet me drejtime të ndryshme ndër shtresat e popullsisë shqiptare – vonuan rizgjimin kombëtar dhe bënë që ai të zhvillohej në mënyrë të pabarabartë dhe me ndërprerje.¹¹ Edhe pasi shteti shqiptar u pranua ndërkombëtarisht, territori i tij mbeti i copëtuar, pasi zona të tëra në veri, lindje dhe jug – ndër më rezistueset dhe më të ndërgjegjshmet, si malësitë katolike, Kosova dhe Labëria – mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë si pasojë e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913). Ndërkaq, pjesa qendrore që mbeti brenda kufijve të shtetit shqiptar kishte qenë më pak e përfshirë në lëvizjen rilindëse dhe përbëhej nga bashkësi me përvoja historike të ndryshme, për të cilat koncepti i shtetit kushtetues dhe laik mbetej i huaj. Kësisoj, procesi i shtetformimit u shndërrua në një mision tejet të vështirë, që kërkonte mbështetje të jashtme për mbrojtjen e shtetit dhe për zhvillimin e një identiteti të ri kombëtar, përmes shkollës shqipe dhe institucioneve publike.

Në dhjetëvjeçarin e dytë të shek. XX, largimi i Perandorisë Osmane nuk solli ndryshime të menjëhershme në Shqipëri. Pas pesë shekujsh nën sundimin e Stambollit, shqiptarët mbetën pjesë e një bote ballkanike të formësuar nga qytetërimi osman, i cili ndryshonte thelbësisht nga modeli i qeverisjes që nacionalistët u përpoqën të vendosnin në Vlorë dhe Durrës. Kjo trashëgimi, e rrënjësuar në jetën e përditshme dhe në zonat e prapambetura me analfabetizëm të lartë, e vështirësoi përvetësimin e kulturës së re politike dhe shtetërore.¹²

Në Shqipëri, pavarësia e vitit 1912 solli një ndryshim të thellë: krijimin e një shteti laik dhe europian, me barazi të plotë për të gjithë qytetarët – përfshirë ata që deri atëherë kishin qenë nënshtruar të dorës së dytë. Kjo solli një tronditje të veçantë për shtresat e konvertuara dhe për bejlerët konservatorë, të mësuar me privilegje nën rendin osman. Për ta, shteti i ri shekullar u perceptua si humbje statusi dhe si kërcënim nga *raja*-të e dikurshme. Në qytetet kryesore dhe në zonat me ndërgjegje kombëtare të dobët, ky ndryshim qytetëruar u përjetua si cenim i pozitës

¹⁰ Ypi, *The Albanian Renaissance in Political Thought*, 662.

¹¹ Salles, *Shqipëria: Gjashtë muaj mbretëri*, 28.

¹² Barbara Jelavich, *History of Balkans, Twentieth Century*, volume 2 (Cambridge: Cambridge University Press, first publication 1983, reprinted in 1999), 104.

së trashëguar. Në mungesë të një sistemi arsimor kombëtar dhe nën ndikimin pengues të shkollave të huaja, të kishave greke dhe të institucioneve fetare osmane, ky reagim ishte i kuptueshëm: “zgjimi nga gjumi” dhe ndërtimi i një vetëdijeje kombëtare do të kërkonin ende kohë.

Shqipëria nuk përbënte një rast tipik shkëputës si shtetet e tjera ballkanike. Rilindja dhe programet autonomiste ishin kryesisht produkt i elitave të shpërndara, me ndikim të pabarabartë, për shkak të zhvillimeve të ndryshme shoqërore, kujtesës historike paraosmane dhe statusit të privilegjuar të disa shtresave në Perandorinë Osmane. Në veri, mbështetja e Austro-Hungarisë ndaj klerit katolik frenoi presionin sllav e ortodoks, ndërsa në jug ndërhyrja e Patrikanës Greke, përmes ndalimit të shkollimit në shqip, dëmtoi identitetin ortodoks shqiptar, i cili mbijetoi falë elitës së vet të mërguar. Në fillim të shek. XX, teksa lëvizja kombëtare mori vrull, shqiptarët u përballën me ambiciet ekspansioniste të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Lindja e Shqipërisë së pavarur, e lidhur me shpërbërjen e Perandorisë Osmane, u bë e mundur kryesisht nën presionin e Austro-Hungarisë dhe, në mënyrë më të kufizuar, të Italisë.¹³

Ngadalësimi i konsolidimit kombëtar shqiptar u ndikua nga diversiteti fetar kompleks, trashëgimi e periudhës osmane që kishte krijuar tri komunitete të dallueshme me qendra të ndryshme ndikimi. Në agimin e shtetformimit, kujtesa paraosmane po zbehej, sidomos në jug ndër ortodoksët dhe në qendër ndër myslimanët, duke e bërë trashëgiminë osmane një faktor të qëndrueshëm demografikisht dhe kulturorisht. Procesi u ndërlikua më tej nga format e ndryshme të vetëdijes kombëtare në krahina dhe qytete si Shkodra, Korça, Elbasani, Gjirokastra e Berati. Për disa komunitete, trashëgimia osmane u perceptua si pjesë e identitetit, deri në kundërvënie me shtetin e ri, siç dëshmon kryengritja otomaniste e viteve 1914-1915. Në këtë kontekst, kufiri ndërmjet ndikimit të trashëgimisë osmane dhe veprimit të nacionalizmit turk të xhonturqve mbetet i paqartë dhe delikat për t’u përcaktuar. Në këtë pikë, ne pajtohemi me tezën e Todorovës.¹⁴

Rilindja e nacionalizmit shqiptar i përket epokës së ngritjes së irredentizmit, e cila filloi me Revolucionin nacional grek dhe përfundoi me Luftën e Parë Botërore.¹⁵ Në qoftë se për vendet e Europës

¹³ Todorova, *Imaging the Balkans*, 170.

¹⁴ *Po aty*, 176.

¹⁵ Ernest Gellner, *Nations and Nationalism*, Second Edition (Oxford: Blackwell Publishing, 2006), XVI, “Introduction”, dhe në 62-84, 85-105. Bazuar në një

Perëndimore lindja e kombit në kuptimin modern ka qenë produkt i përçarjes së rendit ndërkombëtar të krishterimit mesjetar dhe përfaqësonte projeksionin në një plan kombëtar kolektiv të frymës së Rilindjes së individualizmit aventuresk dhe vetafirmues,¹⁶ Rilindja Kombëtare dhe formësimi i nacionalizmit shqiptar si entitet politik ishin produkt i shpërbërjes së gjatë të Perandorisë Osmane, tërheqjes graduale të Fuqive të Mëdha nga mbrojtja e *status quo*-së, zhvillimit të segmenteve me kujtesë paraosmane dhe ndikimit të Europës në brigjet adriatike. Pyetjet kryesore lidhen me vonesën e këtij procesi dhe veçoritë që e dallojnë nga nacionalizmat e tjerë ballkanikë. Ky ishte zgjimi gradual i një populli mbi kujtesën e turbullt të një indpendence të dikurshme adriatikase, në një kohë kur Perandoria Osmane po shpërbëhej, duke ruajtur struktura arkaike ekonomike, shoqërore e kulturore, veçanërisht në trojet shqiptare. Ndërsa qendra osmane adoptonte elemente administrative europiane, periferia perëndimore mbetej e prapambetur – një “njollë mesjetare” në agimin e shek. XX. Nacionalizmi shqiptar u shfaq si lëvizje romantike e elitës së emancipuar të të tria besimeve, por me ritme të ndryshme, në një kohë kur ndryshimet ndërkombëtare dhe depërtimi ekonomik e kulturor i Europës në perandori po transformonin perceptimin e rendit osman edhe ndër shqiptarët.

Hobsbawm-i mendon se koncepti mbi përkatësinë shqiptare dhe identitetin nacional ka qenë kryesisht një vetëdije e të diturve, pasi nuk është e qartë se deri në ç’masë shqiptarët e zakonshëm, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, e shihnin veten si të tillë apo ndienin afinitet me njëri-tjetrin. Kjo do të thotë se ata, jomasivisht, kishin një ndjenjë të fortë të identitetit kolektiv. Si shembull, ai përmend emigracionin drejt SHBA-së gjatë kësaj periudhe, i cili përbëhej nga shqiptarë ortodoksë që shpesh nuk e identifikonin veten me shqiptarët,¹⁷

periodizim të E. H. Carr-it, në veprën e tij, *Nationalism and After* (London: Macmillan & Co. LTD, 1945), 2-37), që e ndante lindjen dhe zhvillimin e nacionalizmit në katër faza: 1. Europa pas paqes së vitit 1815; 2. ngritja e irredentizmit, që fillon me Lëvizjen për pavarësinë e Greqisë; 3. epoka e Versajës/Wilson-it, në të cilën u ndërtuan shumë shtete-kombe të reja; 4. epoka e pastrimeve etnike në fund të viteve 1930 dhe përgjatë viteve 1940; si dhe 5. epoka e pestë, e cila, sipas Gellner-it, njihet si epoka e “zbutjes” (attenuation), pasi rritja e pasurisë do të ndikonte në zvogëlimin e pasioneve nacionaliste.

¹⁶ Edward Carr, *Nationalism and After* (London, Macmillan & Co. LTD, 1945), 1.

¹⁷ E. J. Hobsbawm, *Nations and Nationalism since 1780. Programme, Myth, Reality* (Cambridge: Cambridge University Press, 1997), 53.

por me ortodoksët epirotë grekë. Megjithatë, ishin pionierët e nacionalizmit ata që, për të kapërcyer përçarjet e brendshme mes klaneve dhe zotërinjve, u bënë thirrje bashkatdhetarëve të tyre për solidaritet, duke përdorur argumente bindëse, përpara se t'i drejtoheshin gjuhës si faktor bashkues. Siç thoshte Naim Frashëri: “Të gjithë jemi një fis, një familje e vetme, jemi të një gjaku dhe të një gjuhe”. Gjuha, megjithëse nuk mungonte, ishte e fundit.¹⁸

Gjithsesi, nacionalizmi shqiptar lindi si një ide e inteligjencies, që e barte brez pas brezi këtë kujtim krenar të Arbërisë në komunitetet ku ndërlihdja me kohën paraosmane nuk ishte shuar plotësisht. Kësaj pikëpamjeje të përgjithshme mbi lindjen e nacionalizmit, fillimisht si ide e elitave intelektuale, i përmbahet Elie Kedryrie.¹⁹ Ky nacionalizëm, shkëndijë e mendjeve më të kthjellëta të shoqërisë shqiptare, lindi në disa zona me zhvillim të veçantë ose në diasporën patriotike, ndërkohë që shoqëria vendase mbetej thellësisht rurale, e fragmentuar dhe e prapambetur ekonomikisht e kulturorisht. Shqipëria ruante mbetje të feudalizmit, të strukturave fisnore dhe të një vetëdijeje të mjegullt për prejardhjen dhe identitetin kombëtar. Nacionalizmi shqiptar ishte, në thelb, produkt i tranzicionit ballkanik nga rendi osman drejt lindjes së shteteve kombëtare, në kuadër të zhvillimit kapitalist dhe urbanizues të rajonit. Në këtë proces, ngjizja e nacionalizmit shqiptar dhe shndërrimi i tij në lëvizje shtetformuese ndodhi ndër më të fundit në Ballkan. Kjo vonesë lidhej me karakterin kompleks dhe thellësisht agrar të shoqërisë shqiptare, që nuk mundësonte zhvillimin e shpejtë të vetëdijes kombëtare.²⁰ Edhe pse shqiptarët reagues mbi identitete të caktuara, ndasitë e brendshme penguan formimin e unitetit kombëtar dhe të një nacionalizmi të qëndrueshëm. Shqipëria përbëhej nga komunitete që ndanin të njëjtën gjuhë me dy dialekte, por që u përkisnin kulturave e besimeve të ndryshme, të ndara nga mungesa e komunikimit, infrastruktura e dobët dhe hendeku midis qyteteve të pakta dhe zonës së gjerë rurale. Shoqëria agrare, e dominuar nga struktura fisnore, privilegje klasore dhe ndikimi i klerit, prodhonte identitete të fragmentuara. Pas largimit të elitës princërore në shek. XV, vendi mbeti i ngurtësuar në një model perandorak aziatik, me komunitete të izoluara, analfabetizëm

¹⁸ *Po aty*, 54.

¹⁹ Elie Kedryrie, *Nationalism*, fourth edition (Oxford: Blackwell, 1993), 56-86.

²⁰ Gellner, *Nations and Nationalism*, “Introduction”, by John Breuilly, XXI.

masiv dhe pa arsim kombëtar. Ndalimi nga autoritetet osmane i përdorimit të gjuhës shqipe pengoi krijimin e një kulture të shkruar popullore – një parakusht për formimin e një kombi modern. Kësisoj, deri në shek. XIX, shqiptarët nuk përballeshin me detyrën e krijimit të kombit nga e para, por me “zgjimin” e tij dhe rivendosjen në shinat e kulturës vendase, përmes gjuhës së shkruar shqipe, përcaktimit të territorit kombëtar dhe ndërtimit të një ideologjie unifikuese mbi identitetin kombëtar, përtëj dallimeve fetare.

Fati ishte se shqiptarët zotëronin qartë njëfarë ndërgjegje proto-kombëtare, edhe pse ishin të ndarë nga një numër më i madh dallimesh fetare sesa zakonisht ndodh në një territor me madhësinë e Uellsit (forma të ndryshme të islamit, ortodoksisë, katolicizmit romak).²¹ Dhe identiteti i veçantë fetar, sado i fuqishëm të jetë, i marrë në vetvete, nuk është i ngjashëm me nacionalizmin ose përkatësinë në një fis etnik.

Nacionalistët shqiptarë kërkuar që gjuha shqipe të shkruhej me alfabet latin, jo me germa arabe apo greke. Kjo zgjedhje lidhej jo vetëm me traditën mesjetare të shkrimit të shqipes dhe me rolin e klerit katolik gjatë sundimit osman, por edhe me dëshirën për të afirmuar një identitet të veçantë kulturor, të barabartë me atë të popujve fqinj, pavarësisht nivelit të lartë të analfabetizmit në vend.²²

Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte produkt i ndryshimeve të brendshme që po përjetonin trevat shqiptare, veçanërisht në qendrat ekonomike e kulturore si Shkodra, Gjakova, Korça e Berati – që u bënë shtylla morale të nacionalizmit purist. Këto hapësira urbane krijuan kushtet për zgjimin kombëtar, për vetëdijen e përkatësisë dhe për rikthimin të memoria paraosmane, duke formësuar një identitet të pashartuar me ndikime të huaja. Si në çdo shoqëri paraindustriale, ndërveprimi i drejtpërdrejtë (*face to face societies*) përcaktonte strukturat sociale: individët njihnin rolin dhe pozitën e njëri-tjetrit, dhe pikërisht kjo strukturë i jepte kuptim identitetit, ndërsa kultura shërbente për ta përforcuar atë.²³

Duke mos harruar veprat e para të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, krizat e viteve 1875-1881, kryengritjet e viteve 1910, 1911, 1912 dhe luftërat ballkanike (1912-1913), përfaqësojnë njëkohësisht pika kthese në

²¹ Hobsbawm, *Nations and Nationalism since 1780*, 70.

²² *Po aty*, 115.

²³ Gellner, *Nations and Nationalism*, 85-105.

historinë e Gadishullit Ballkanik dhe në historinë osmane dhe janë, pa asnjë dyshim, edhe referenca në zhvillimin e nacionalizmit shqiptar.

Konsulli austro-hungarez në Janinë shkruan në vitin 1912 se kryengritja e vitit 1911 në veri vërtet “nuk solli me vete një bashkëpunim të shqiptarëve muslimanë me shqiptarët katolikë, edhe pse lëvizjes së çetavet të formuara në Toskëri u mungonte veprimi i përbashkët dhe energjik, prapëseprapë nuk mohohet se ngjarjet e verës së kaluar e kanë forcuar ndjenjën e bashkimit midis veriut dhe jugës, dhe ndërgjegjen kombëtare ato e kanë ngritur. ... Sot çdo bariu tosk, po t'i drejtosh pyetjen për kombësinë e tij, të përgjigjet «Unë jam shqiptar». Taktika e gabuar e xhonturqve, të cilët në rastin e shqiptarëve donin të hidhnin në luftë fenë kundër kombësisë, e ka çuar sot punën tek toskët deri në atë shkallë, sa që sot feja është vënë krejtësisht në vijë të fundit, ndërsa çështja vendimtare është bashkimi kombëtar”.²⁴

Clayer-i mendon se nacionalizmi shqiptar ka qenë specifik, pasi u zhvillua kryesisht rreth gjuhës dhe jo rreth fesë.²⁵ Edhe Todorova argumenton se rasti shqiptar përbën një përjashtim, sepse ideali nationalist u zhvillua njëkohësisht midis përbërësve të ndryshëm fetarë, shumica e të cilëve ishin myslimanë, dhe sepse rreziku i perceptuar nga jashtë vinte nga lagjet e krishtera (greke dhe serbe) dhe jo nga qendra myslimane.²⁶ Zhvillimi i nacionalizmit shqiptar u bë kryesisht përmes gjuhës, kulturës dhe shkollës, por jo në mënyrë të njësuar në gjithë territorin që në fillësë. Shtrirja e tij e plotë dhe ndërkomunitare u arrit gradualisht: fillimisht me pavarësinë e vitit 1912, më pas gjatë viteve 1916-1918, dhe u konsolidua në vitet 1920, kur shteti shekullar e kushtetues u bë funksional. Në periudhën e Rilindjes dhe të pavarësisë së parë, ky zhvillim kufizohej në qendra me autonomi kulturore ose në kolonitë shqiptare të diasporës – në SHBA, Zvicër, Egjipt, Rumani, Bullgari e Itali – ku ideali kombëtar u ruajt dhe u kultivua nga elitat intelektuale e administrative të formuara jashtë vendit. Në hapësirat ku presioni otoman ishte i fortë dhe liria e kufizuar, nacionalizmi nuk mund të zhvillohej natyrshëm. Megjithatë, qendrat e ndriçimit kombëtar, edhe

²⁴ *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit (Studime, materiale, dokumente)*, editorë: A. Buda, M. Domi, S. Pollo, K. Prifti, M. Samara (Tiranë: Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1972), 397.

Raport i konsullit Bilinski, Janinë, 5 shkurt 1912.

²⁵ Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, 639.

²⁶ Todorova, *Imaging the Balkans*, 177.

pse të pakta dhe të shpërndara në një shoqëri të prapambetur e analfabete, u bënë gradualisht motorë të rigjenerimit të vetëdijes kombëtare paraosmane. Ato përgatitën moralisht pavarësinë, mbijetuan gjatë viteve të restaurimit otomanist dhe pushtimeve të huaja (1914-1916), dhe u ringjallën fuqishëm në periudhën 1916-1918, duke hapur rrugën për zhvillimin e mëtejshëm të shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Nacionalizmi shqiptar, si të gjithë nacionalizmat e tjerë, është zhvilluar nga intelektualët, në interes të frymëzimit të elitës dhe më pas është përhapur ndër masa, sipas nivelit të kuptimit të tyre, i cili në shoqërinë shqiptare ka ndryshuar në përthithje sipas rajoneve dhe niveleve të zhvillimit arsimor. Para së gjithash, përhapja dhe përftimi u përkasin disa prej qendrave urbane kryesore të vendit.

Shqiptarizimi

Përkufizimet e nacionalistëve rilindës nuk u mbështetën vetëm në gjuhë, por edhe në idetë e origjinës së përbashkët, gjakut, zakoneve dhe territorit të përbashkët. Çdo komb është, në thelb, një konstrukt kulturor, i lidhur nga historia, kujtesa, gjuha, ndjenjat metafizike të përkatësisë dhe ndjesia e fatit të përbashkët. Këtyre u shtohen ngjashmëritë në zakone, kulturë, fe, muzikë, art dhe madje edhe në besimet politike. Prandaj, nuk ekziston një përkufizim unik apo objektiv i konceptit të kombit që të përcaktojë qartë të drejtën për vetëvendosje, nacionalitet apo shtetësi.²⁷

Adrian Hastings e përdor rastin e kombit shqiptar për të shpjeguar një sërë termash. Ai shkruan se “përkatësia etnike është një bashkësi e përbashkët e kulturës, por në etni të ndryshme, elemente të ndryshme merren për të siguruar kriteret vendimtare të përkatësisë. Mund të ketë, **nën-etni të qëndrueshme, të cilat mund të bazohen në zonën, diferencimet gjuhësore, fenë ose një histori të bazuar në asimilimin e pjesshëm të ndonjë grupi shtesë.** Është e vështirë të përkufizohet se çfarë përbën një diferencim të brendshëm, që është domethënës në vetvete, por jo përçarës i një etnie të vetme, për shembull feja – katolike apo myslimane – mes shqiptarëve. Gjithsesi, mbijetesa e vazhdueshme e një diversiteti kaq domethënës si ky brenda një grupi, që ende e sheh

²⁷ Harry G. Gelber, *Sovereignty Through Interdependence* (London-The Hague-Boston: Kluwer Law International, 1997), 102-103.

veten si të lidhur shoqërisht, do të duhet të jetë një faktor kryesor në ndërtimin e këtij të fundit si 'komb' dhe jo si 'etni'. Shkalla e vetëdijes shoqërore e nevojshme për pranimin e një diversiteti të tillë brenda grupit të dikujt është me të vërtetë një karakteristikë e kombësisë”.²⁸

Clayer-i mendon se, nëse shqiptaria dhe i gjithë spektri i konstruksioneve të saj shihen më gjerë, do të konstatohet ekzistenca e konstrukteve identitare që përgjithësisht kanë qenë “në caqe”, të cilat nuk janë ligjëruar mbi bazën e divergjencave dhe të kundërshtive, por mbi konvergjenca dhe kombinime; këto konstruksione hibride kanë qenë më të brishta dhe më jetëshkurtra sesa konstruksionet ekskluzive. Në hapësirën myslimane të pjesës qendrore të gadishullit, veçanërisht në Maqedoni dhe në Kosovë, e sidomos në qendrat urbane, shqiptaria dhe turqizmi patën prirje të përziheshin me njëri-tjetrin. Turqizmi dhe shqiptaria shkriheshin në një identitet osman dhe islam. Ky kombinim, si në këto rajone ashtu edhe në disa epiqendra të tjera të adhurimit të së kaluarës, eci me të njëjtin hap me idenë se vetëm Perandoria Osmane ishte e aftë të mbronte myslimanët përballë orekseve të vendeve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha.²⁹ Teza e mbrojtjes së identitetit shqiptar mysliman vetëm nën Perandorinë Osmane, e përhapur në një shoqëri pa mundësi analitike të gjerë, u interpretua shpesh në mënyrë të ngushtë. Në të vërtetë, si myslimanët ashtu edhe të krishterët shqiptarë e gjetën mbrojtjen e identitetit të tyre në një “religjion” të ri – atë nacional, të ndërtuar mbi trashëgiminë arbërore dhe simbolikën skënderbegiane. Në anën katolike, elita e mbrojtur nga Protektorati i Kultit të Austro-Hungarisë ndërtoi modelin paraosman të identitetit kombëtar përmes shkollës, botimeve, veprimtarisë kulturore e gazetare dhe shoqatave promovuese. Qëllimi ishte jo vetëm ringjallja e komunitetit katolik dhe ngritja arsimore e brezit të ri, por edhe përhapja e këtij konstruksioni identitar në mbarë shoqërinë shqiptare. Megjithatë, ky ideal nuk u pranua në mënyrë të njëjtë në hapësirat ku identiteti ishte i lidhur ngushtë me islamin dhe otomanizmin. Aty, për shkak të formësimeve kulturore të përziera dhe ndikimit të vazhdueshëm të rrjeteve proosmane, ideja e bashkimit mbi bazën e një nacionalizmi të përbashkët shpesh perceptohej me dyshim.

²⁸ Adrian Hastings, *The Construction of Nationhood, Ethnicity, Religion and Nationalism*, sixth publication (Cambridge: Cambridge University Press, 2006), 173.

²⁹ Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, 643-644.

Kemi të bëjmë me një sub-nacionalitet të krishterë brenda nacionalitetit shqiptar, elita e të cilit ndoqi një linjë të qartë politike drejt formimit të kombit: rikthimin në identitetin paraosman, arsimimin në shqip me alfabet latin, ndërtimin e një sistemi shkollor vendas dhe themelimin e një shteti kushtetues e laik, të barabartë për të gjitha komunitetet. Kjo prirje ishte e natyrshme për popujt e krishterë të Europës, sipas përkufizimit të Adrian Hastings-it, i cili e lidh lindjen e nacionalizmit me traditën e krishterë. “Në shoqëritë jokrishtere, nacionalizmi, – thotë ai, – lind si produkt i ‘perëndimorizimit’ përmes kujtesës historike, protektorateve kulturore, tregtisë dhe ndërveprimeve me Perëndimin”. Shqipëria post-osmane, me shumicë jo të krishterë, e përqafoi nacionalizmin si pjesë të modernitetit perëndimor, jo si ideologji me rrënjë fetare, ndonëse vetë konceptet e kombit dhe të shtetit kombëtar mbeten të lidhura me mendimin e krishterë. Edhe në vende ku këto ide u shfaqën jashtë botës së krishterë, ato shpesh u përhapën si pjesë e një procesi më të gjerë të imitimit të kulturës perëndimore (dhe, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, të kulturës së krishterë).³⁰ Dhe ky, sipas nesh, është rasti tipik i përbashkimit të elitës shqiptare të Rilindjes dhe të shtetformimit, e cila vinte nga nënshtresa të veçanta të nacionit, për sa u përkiste religjioneve dhe krahinave të vendit.

Clayer-i vëren se, edhe pse në qarqet patriotike shqiptare u ndie herët nevoja për ndërtimin e një identiteti kombëtar përtej fesë, ishte tepër e vështirë të shmangej identifikimi kolektiv mbi baza fetare, pasi ky element mbetej qendror në funksionimin e shoqërisë. Shtojmë se, në fillimet e modernitetit, inkuadrimi fetar i popullsisë po bëhej më rigoroz dhe kufijtë ndërmjet komuniteteve po përcaktoheshin më qartë, pikërisht në kohën kur shqiptarët kishin nevojë t’i kapërcenin këta kufij për t’u bashkuar përballë agresioneve të fqinjëve sllavë e grekë. Kështu, individi ishte i detyruar të përvetësonte norma identitare më të dallueshme, duke e afruar konfensionalizmin me ideologjinë kombëtare. Katolikët dhe myslimanët sunitë kishin gjithashtu prirjen për ta përzier identitetin kombëtar shqiptar me identitetin fetar, dhe kjo krijonte problemin³¹ kryesor në procesin përbashkues të nacionit, aq të vjetër, por edhe aq të ri, duke pasur parasysh ndryshimet e pësura në konstruksion gjatë shekujve të fundit.

³⁰ Hastings, *The Construction of Nationhood*, 185-186.

³¹ Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, 640.

Elita nacionaliste shqiptare e bazoi kërkesën për shtetësi mbi kriterin etnogjuhësor, i cili u bë themelor për legjitimimin e shtetformimit. Si kudo te popujt e kërcënuar nga asimilimi apo nga vonesat historike, nacionalizmi shqiptar mori formën e një kundërnacionalizmi mbrojtës të së drejtës për ekzistencë kombëtare. Megjithëse lindja e shtetit u shoqërua me idealet e lirisë, këto u përqafuan kryesisht nga elita, jo nga masa agrare, analfabete dhe e ngujuar në struktura fisnore. Kjo elitë kontribuoi në përhapjen e ndjenjës së përkatësisë kombëtare, përballë propagandës xhonturke dhe greke, që synonte asimilimin e ortodoksëve shqiptarë. Në veri, nacionalizmi gjeti terren të favorshëm falë punës së klerit katolik dhe izolimit shoqëror nga pushtuesi. Për shkak të shumëllojshmërisë fetare, veprimtarët e shqiptarizimit theksuan gjuhën, etnicitetin dhe trashëgiminë iliro-arbërore si faktorë unifikues, megjithëse energjia kombëtare mbeti e kufizuar për të mbështetur gjerësisht aktin e Pavarësisë së vitit 1912. Hobsbawm-i shkruan se ishte e natyrshme për pionierët e nacionalizmit shqiptar ta kërkonin identitetin kulturor te gjuha, duke qenë se besimi fetar dhe pothuajse çdo gjë tjetër në Shqipëri, dukej më shumë ndarëse sesa përbashkuese.³² Kemi të bëjmë me lindjen dhe zhvillimin e një nacionalizmi afetar, i cili herë pas here u kërcënua nga politika panislamike e Turqisë, si në vitet 1914-1915, dhe nga politikat asimiluese të Greqisë ndaj ortodoksëve shqiptare, veçanërisht nga qarqet që synonin përfshirjen e Shqipërisë së Jugut – të quajtur prej tyre “Epir”, sipas terminologjisë iliro-epirote antike – brenda shtetit helen.

Pra, një veçanti e nacionalizmit shqiptar qëndron në faktin se konstruksionet e identitetit kombëtar kanë qenë të larmishme dhe se hendeku midis ligjërimit dominues dhe konstruksioneve të ndryshme mbetet elementi më i rëndësishëm dallues krahasuar me nacionalizmat e tjerë ballkanikë.³³ Tiparet specifike kulturore dhe filozofike të shpërfaqura nga Rilindja Kombëtare Shqiptare kanë qenë jo të zakonshme dhe të vështira për t’u kuptuar, nëse dikush i zbaton në mënyrë skematike kategoritë tradicionale të Europës Perëndimore. Megjithatë, sipas Lea Ypit, një kombinim i artikuluar i ideve kryesore filozofike të iluminizmit dhe romantizmit, i lidhur me një shqyrtim të kujdesshëm të ngjarjeve historike, mund të prodhojë, sipas të gjitha

³² Hobsbawm, *Nations and Nationalism since 1780*, 53.

³³ Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, 641.

gjasave, një kuptim më të sofistikuar të mitit të identitetit nacional dhe lidhjeve të tij me shfaqjen e strukturave shtesore moderne. Gjithsesi, në përmbajtjen e pjesës elitare të nacionalizmit kanë qenë themelore konceptet fundamentale të iluminizmit, të tilla si shekullarizmi, arsyeja, autokritika dhe teleologjia racionale, të cilat ndikuan në hapat e parë intelektualë për krijimin e një identiteti nacional shqiptar.³⁴

Tipologjitë e shtresave mbi të cilat ushtroi ndikim Rilindja Kombëtare: Rasti i Shqipërisë, i vendosur brenda kornizës së analizës mbi tipologjitë e nacionalizimit të Ernest Gellner-it

Në fillim të shek. XX, Shqipëria mbeti një shoqëri kryesisht agrare dhe e fragmentuar, ku kushtet nuk favorizuan formimin e kombit. Pushtimi osman dhe mungesa e traditës perëndimore kishin dobësuar homogenitetin e dikurshëm, ndërsa elita arbërore ishte zhdukur ose ishte mërguar. Vendi përbëhej nga bashkësi malore vetëqeverisëse në veri, komunitete myslimane në verilindje, fshatarësi në qendër dhe jug, si dhe qytete me orientime të ndryshme – disa drejt Perëndimit, të tjera nën ndikimin osman. Shoqëria ishte e prapambetur, nën kontrollin e bejlerëve, nuk kishte sistem arsimor kombëtar dhe ishte e dominuar nga analfabetizmi; vetëm kleri katolik dhe shtresat e formuara prej tij përfaqësonin një elitë të kultivuar me prirje perëndimore.

Nacionalizmi shqiptar nuk lindi nga fshatarësia, por nga segmentet më të arsimuara dhe të internacionalizuara të shoqërisë, si edhe nga diaspora. Megjithëse shqipja përdorej në dy dialekte kryesore, kultura vendase arbërore ishte dobësuar nga presioni politik, kulturor dhe fetar osman, duke krijuar në disa zona identitete hibride: shqiptarë që flisnin shqip, por ishin të shkëputur nga tradita vendase dhe ajo adriatikase. Kjo është ajo që Adrian Hastings e quan një përzierje të rrënjëve gjenetike në një hapësirë të caktuar, në të cilën, për shkak të kontrollit politik dhe territorial ose të marrëdhënieve familjare, krijohet një sens i përbashkët përkatësie etnike midis komponentëve socialë që bashkëjetojnë, por që, në thelb, në botëkuptimet, vetëdijen dhe përkatësinë e tyre etnike kanë shpesh vektorë të ndryshëm.³⁵

³⁴ Ypi, *The Albanian Renaissance in Political Thought*, 278.

³⁵ Hastings, *The Construction of Nationhood*, 171-172.

Një nga studiuesit bashkëkohorë më të njohur të nacionalizmit, sociologu Ernest Gellner, ka ndërtuar një model të tipologjive të nacionalizmit.³⁶ Bëhet fjalë për një model të tipologjive të situatave sociale që, njëkohësisht, si e lindin, ashtu edhe e pengojnë zhvillimin e nacionalizmit. Tipologjitë e zhvillimit të kombeve ai i lidh me tre faktorë përcaktues, të cilët ndikojnë në formimin e shoqërisë moderne. ***Faktori i parë është fuqia dhe pushteti; faktori i dytë është aksesimi në arsimim dhe në një kulturë moderne e të qëndrueshme, pra lexueshmëria, si e kundërta e analfabetizmit; ndërsa faktori i tretë është ekzistenca e një kulture të përbashkët ose e një diversiteti kulturor.*** Kjo pikënisje analitike, për rastin tonë, është e logjikshme, por jo plotësisht shteruese, sipas arsytimit që do të parashtrijmë më poshtë. Duke u nisur nga faktori i parë, shoqëria shqiptare e dekadës së dytë të shek. XX ishte, në pjesën më të madhe, një shoqëri kryesisht agrare, për shkak të frenimit të zhvillimit në krahasim me vendet e tjera adriatikase. Ky ngadalësim u shkaktua nga sundimi i gjatë otoman, i cili konservoi marrëdhëniet feudale më shumë se kudo tjetër në këtë pjesë të perandorisë. Ajo ishte një shoqëri periferike e perandorisë, në të cilën pushteti i sulltanit ushtrohej përmes bejlerëve dhe pashallarëve, vendas ose të dërguar enkas nga Stambolli, si edhe përmes administratës së krijuar prej saj. Për shkak të terrenit malor, në pjesën më të madhe të saj, ajo ishte një shoqëri baritore me ndërthurje të marrëdhënieve fisnore. (Malësori, prijësi i kësaj shoqërie në shumë pjesë të vendit, ishte njëkohësisht ushtari dhe, shpeshherë, edhe senatori, juristi dhe ministri i fisit të tij. E gjithë kultura, ose pothuajse e gjithë shoqëria, dukej e përqendruar tek individ dhe jo e shpërndarë mes tyre në forma të ndryshme.) Kjo shoqëri, pas luftërave ballkanike, doli nga sundimi i Perandorisë Osmane në një liri që nuk ishte ajo për të cilën kishte luftuar udhëheqësia. Fuqitë e Mëdha, me një sërë vendimesh, krijuan shtetin shqiptar në vetëm gjysmën e territorit të tij etnik dhe i imponuan vendosjen në një kuadër institucional të një shoqërie moderne, por me gjymtyrë funksionale të copëtuar. Kjo nënkupton se, për shkak të cungimit territorial, në këtë vend u ndërpre në “arteriet” e jetës shekullore, ndërsa në pjesën e mbetur, të caktuar për jetësimin politik, shteti shqiptar u kornizua në një sërë institucioneesh të një shoqërie të centralizuar. Ruajtja e rendit, nga ai moment e tutje, nuk do të ishte më e shpërndarë në gjithë shoqërinë, si një detyrë e parësisë

³⁶ Gellner, *Nations and Nationalism*, 85-105.

fisnore baritore apo e të fortëve krahinorë të lidhur me pushtetin qendror otoman, por do të kalonte në duart e një agjencie ose grupi agjencish të centralizuara.³⁷ Kapërcimi drejt shtetit modern burokratik ishte i papranueshëm për bejlerët dhe të fortët krahinorë, të cilët humbnin privilegjet e tyre tradicionale. Në fillim të shek. XX, shoqëria shqiptare mbeti kryesisht analfabete, pa një sistem arsimor kombëtar, pa një alfabet të unifikuar dhe pa një gjuhë zyrtare të standardizuar. Përpjekjet e para për arsimim erdhën nga Austro-Hungaria, kleri katolik dhe iniciativa private në qendra si Shkodra e Korça; ndërsa vetëm me Qeverinë e Vlorës dhe Principatën e Wied-it filloi ndërtimi i një sistemi shtetëror arsimi. Megjithatë, specialistët e formuar në kulturën perëndimore shpesh përjashtoheshin nga administrata, të penguar nga pasunaret krahinorë të trashëguar nga rendi osman. Shoqëria shqiptare që hyri në modernitet ishte thellësisht e ndryshuar: pushtimi, konvertimet, emigrimi dhe kolonizimet kishin krijuar një mozaik kulturor e krahinor me interesa të ndryshëm. Ndërkohë, mbetjet e kulturës arbërore kishin mbijetuar vetëm në periferi, në zonat më të izoluara. Sfidat e Rilindjes ishte që kjo trashëgimi e reduktuar – kujtesa skënderbegiane, gjuha dhe lidhja me Europën – të depëronte sërish në një shoqëri të varfër, të shtypur dhe pa arsim laik.

Tipat që përcakton Gellner-i në teorinë e tij kombinojnë analizën e pushtetit me aksesin në edukim dhe kulturën e përbashkët, ose mungesën e saj. Këto tipologji gjenerojnë menjëherë katër situata të ndryshme. Në lidhje me aksesin në arsim (në këtë kuptim), ekzistojnë alternativa dhe situata të ndryshme të mundshme. Sipas Gellner-it, ekzistojnë katër mundësi të dallueshme: 1. mund të ndodhë që vetëm pushtetmbajtësit të kenë akses në arsimim dhe ta përdorin privilegjin e pushtetit për të ruajtur për vete monopolin e këtij akses; 2. si alternativë, mund të ndodhë që si pushtetarët, ashtu edhe pjesa tjetër e shoqërisë, të kenë akses në arsimim; 3. mund të ndodhë gjithashtu që vetëm pjesa tjetër e shoqërisë të ketë akses në arsimim, ndërsa pushtetarët jo – një situatë që, në pamje të parë, mund të duket absurde, e pabesueshme ose joreale; 4. së fundi, mund të ndodhë që asnjëra palë të mos gëzojë përfitimet e një aksesit të tillë; ose, thënë më thjesht, që si pushtetarët, ashtu edhe ata mbi të cilët ushtrohet

³⁷ *Po aty*, 85.

pushteti, të jenë “*dy tufa injorantësh, të zhytur në idiotësinë e jetës fshatare*”.³⁸

Ku bën pjesë shoqëria shqiptare e kohës në këtë klasifikim? Është e vështirë t'i jepet një përgjigje e prerë këtij rasti. Shoqëria shqiptare e shek. XX, deri në pavarësi, mund të konsiderohet si një shoqëri e tipave të ndërthurur 4 dhe 3, për arsyt që i kemi shpjeguar. E lëmë të hapur opsionin 3, për shkak të asaj që është shpjeguar më sipër mbi përpjekjet për zhvillim qytetar dhe arsimor në disa prej pak qendrave urbane të vendit, si dhe për përfitimin e një elite të ngushtë në edukim nga shërbimi ndaj pushtetit ose shkollimi i mbështetur nga Austro-Hungaria. Megjithatë, kjo elitë kryesisht operonte jashtë vendit, ose në Shkodër dhe Korçë. Pas shpalljes së Pavarësisë, ndryshimet në Shqipëri ishin të kufizuara për shkak të kohës së shkurtër dhe rrethanave të jashtme. Shoqëria mbeti kryesisht analfabete dhe pa akses në arsim, ndërsa pushtetin e mbante një udhëheqësi e ngushtë. Qeveria e Vlorës dhe ajo e Princ Wied-it u përpoqën të krijonin një sistem arsimor gjithëpërfshirës, me mbështetjen e Austro-Hungarisë dhe, pjesërisht, të Italisë, por politika shoviniste e Turqisë, Greqisë dhe Serbisë pengoi çdo përparim. Kështu, klasa e vjetër, e lidhur me rendin osman dhe pa arsimim, nuk ishte e gatshme të pranonte institucionet moderne europiane, ndërsa minoritetet e arsimuara, me kulturë liberale perëndimore, mbetën pa ndikim real. Me ardhjen e ehlikjamistëve dhe esadistëve, pushtetin e mori një lidership paradoksalisht i paarsimuar, i cili u imponua me forcë mbi masat analfabete dhe mbi elitat e kulturuara, duke përjashtuar çdo përpjekje për një shtet laik e europianizues. Shqipëria e viteve 1914-1915 përfaqëson, në terminologjinë e Gellner-it, një gjysmërast të “tipologjisë 3”: një shoqëri tradicionale agrare, ku si sundimtarët, ashtu edhe të sunduarit, ishin të mbyllur ndaj dijes dhe pa kontakt me industrializimin dhe modernitetin. Kjo ishte një shoqëri që vlerësonte luftën, autoritetin dhe pronën, por jo dijen, tregtinë e lirë apo administratën civile – një sistem që pengonte daljen nga prapambetja dhe modernizimin e shtetit.

Këto katër tipologji të lidhura me nivelin e aksesit në edukim, sipas Gellner-it, gjenerojnë menjëherë tetë situata të mundshme të shoqërive, si: 1. *industrializimi i hershëm pa katalizator etnik*; 2. *nacionalizmi i lindur në Perandorinë Habsburge, që përfshiu Europën Lindore dhe Jugore*; 3. *Industrializimi i pjekur dhe homogjen*; 4. *nacionalizmi klasik*

³⁸ Po aty, 87 (Gellner-i këtu përdor një shprehje të Karl Marksit).

*liberal perëndimor; 5. situata revolucionare dekabriste në Rusi, që nuk ishte një situatë nacionaliste; 6. nacionalizmi i diasporës; 7. situata jotipike paranacionaliste; 8. situata tipike paranacionaliste.*³⁹ Ne do të përpiqemi të përcaktojmë se ku gjendej shoqëria shqiptare e periudhës në studim, duke u bazuar në këtë klasifikim të Gellner-it mbi situatat e shoqërive. Nisur nga ky model i tipologjive dhe situatave që rrjedhin nga aksesit në edukim, ne mendojmë se shoqëria shqiptare kishte një strukturë mjaft heterogjene dhe nivele të ndryshme kulturore, ku përfshiheshin, në një minoritet të saj, të shpërndarë në disa segmente, elemente të liberalizmit klasik të Europës Perëndimore dhe të ndërveprimit paralel progresist të diasporës nacionaliste. Të gjitha këto elemente ekzistojnë mbi një shtrat masiv agrar, në mungesë të një sistemi të konsoliduar të shkollimit nacional dhe në kushte të analfabetizmit masiv. Këtu përfshiheshin edhe situatat jotipike paranacionaliste ose ato tipike paranacionaliste. Pra, në shoqërinë shqiptare nuk kemi të bëjmë vetëm me dy situata, apo vetëm me dy grupime shoqërore që priren të konvergojnë, por me një shumëllojshmëri situatash zhvillimore, si edhe me grupime të ndryshme sociale e kulturore. Për rrjedhojë, është e vështirë ta vendosim pa ngurrim rastin shqiptar në njërin nga prerjet apo situatat e mundshme të ofruara nga Gellner-i, njëllë siç patëm vështirësi në klasifikimin e rastit tonë sipas modeleve të aksesit në edukim, midis pushtetarëve dhe pjesës tjetër të popullsisë. Gjithsesi, ne do të përpiqemi të arsyetojmë në këtë mënyrë: në Shqipërinë e fundit të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, ku gjejmë të pranishme së paku tri sfera kulturore religjioze, të kombinuara me dy konstrukte dialektore dhe disa nëndialektore, ndeshim një situatë hipotetike kryesisht të linjës 8, por me disa shëmbëllime të linjës 7 dhe me refleksë nga jashtë të linjës 6 të këtij klasifikimi. Njëkohësisht, në disa segmente të territorit, të kufizuara në lagje të krishtera, evidentohet linja 4. Të shpjegojmë: linja 8, e cila karakterizon një situatë tipike paranacionaliste, tregon një prani shoqërore në të cilën dy kultura bashkëjetojnë në të njëjtin territor. Në fakt, në rastin e Shqipërisë, kemi të bëjmë me më shumë se kaq: me një kulturë autoktone të ruajtur që nga Mesjeta paraosmane (kultura iliro-arbërore, e lidhur kryesisht me popullsinë katolike të vendit, por jo vetëm), e cila nuk ka pësuar deformime të rënda. Megjithatë, në disa qendra urbane – si Shkodra, Gjakova, Prizreni, Lezha, Shëngjini – për

³⁹ Po aty, 91.

shkak të Protektoratit të Kultit, si dhe në Korçë, Berat, Gjirokastrë, për shkak të ndikimit të diasporës patriotike ose të shkollimit të shtresave të larta të popullsisë myslimane shqiptare, kryesisht në jug dhe në Elbasan, të gjitha këto hapësira kulturore, kush më pak e kush më shumë, kanë marrë injektive të elementeve të linjës 4. Kjo do të thotë jo vetëm se kanë pasur akses në kulturë në kuptimin antropologjik, por edhe se elitat e këtyre grupimeve bënë pjesë në Kulturën e Lartë të Europës Perëndimore, ose në atë të ofruar cilësisht brenda Perandorisë Osmane, për shkak të shërbimit në administratë (p.sh. fëmijët e bejlerëve të Shqipërisë së Jugut). Por, krahas saj, një masë e madhe e popullsisë gjendej në një konditë tipike ose jotipike paranacionaliste. Linja 7 tregon një situatë jotipike paranacionaliste, ku dy kultura (në rastin tonë, të paktën tri kultura madhore dhe disa subkultura, nën një emërtesë që reflekton jehonën e Arbërisë) bashkëjetonin në të njëjtin territor dhe funksiononin për homogjenitetin kulturor. Mirëpo, në rastin e Shkodrës dhe të Korçës, gjejmë gjurmë të nacionalizmit klasik liberal dhe perëndimor, të ndikuar në jug edhe nga diaspora nacionaliste, e cila kishte emigruar në SHBA, Zvicër, Rumani, Misir, Greqi, Stamboll etj. Në një rast të tillë, këta “xhepa kulturore” zhvendosen në linjën 4, ku grupet kulturore kishin akses në edukim (dhe janë përpjekur ta standardizonin edhe gjuhën amtare), ose nuk e kishin dhe kërkonin ta merrnin atë. Në rastin e Shqipërisë nuk bëhet fjalë vetëm për dy kultura, por për të paktën tri kultura, secila e bazuar në religjion dhe në dy komunitete të mëdha nëngjuhësore, grupime të mëdha nëndialektore, të cilat, në fakt, nuk janë vetëm gjuhësore, por edhe të kodit të sjelljes sociale, kuptimit të raporteve njerëzore, zakoneve që ndjekin etj. Ndaj mund të themi se ne ecim në këtë territor përgjatë linjave 8, 7 dhe 4 të shpjegimit të situatave të Gellner-it. Linjat 7 dhe 8 përjashtohen nga problematika nacionaliste edhe për një arsye tjetër: sepse çështja e aksesit në një Kulturë të Re të Lartë, e cila është parakusht për hyrjen dhe përfitimet nga stili i ri i jetës, thjesht nuk lind. Ajo do të imponohet më pas gradualisht, sidomos pas vitit 1916 dhe veçanërisht pas rithemelimit të shtetit, me krijimin e sistemit nacional të edukimit në gjuhën shqipe dhe me zhvillimin e kulturës nacionale vendase (1918 e vijim). Këtu, në këtë hapësirë të Shqipërisë, ku mbizotëronin tipologjitë 3 dhe 4 dhe situatat 7 dhe 8, sipas teorisë së referuar më lart, askush nuk e kishte Kulturën e Re të Lartë; pra, askush nuk e kishte atë më shumë se kushdo tjetër. Pikërisht në këtë hapësirë do të gëlonte kundërrevolucioni nacional

ehlikjamist dhe esadist. Ky është, natyrisht, elementi thelbësor dhe qendror për teorinë e Gellner-it: nacionalizmi ka të bëjë me hyrjen, pjesëmarrjen dhe identifikimin me një kulturë të lartë arsimore nacionale, origjinale, e cila është e përbashkët me një njësi të tërë politike dhe me popullsinë e saj totale. Dhe, që të jetë i këtij lloji, duhet të jetë në përputhje me llojin e ndarjes së punës dhe me mënyrën e prodhimit, mbi të cilën bazohet kjo shoqëri. Shoqëria shqiptare, megjithatë, nuk ishte e tillë në çdo segment në periudhën që po shqyrtojmë dhe analizojmë. Përkatësia në linjat e situatave 7 dhe 8 mungon, madje edhe në formën e një ndërgjegjësimi apo aspirote për të. Nuk ka kulturë të lartë, as ndonjë normë, aq më pak një kulturë që të ketë prirjen dhe kapacitetin për t'u përgjithësuar në të gjithë shoqërinë dhe për t'u bërë kusht për funksionimin e saj në mënyrë efektive. Linja 7 përjashtohet dy herë nga çështjet nacionaliste: një herë për arsyet që sapo u përmendën dhe një herë sepse i mungon edhe diferencimi kulturor që mund t'i jepte “pickim”, ngacmim apo shtysë për problemet e tjera, cilatdo qofshin ato. Rreshtimi 8 është më tipik për shoqëritë komplekse agrare sesa linja 7: shtresa sunduese është e identifikueshme nga një kulturë e veçantë që shërben si etiketë e gradës, duke pakësuar paqartësinë dhe, rrjedhimisht, tendosjen. Linja 7 me vazhdimësinë e saj kulturore, është jotipike për botën agrare.⁴⁰

Edukimi nacional dhe sistemi i komunikimit ekzistonin në xhepat e përparuar të Kulturës së Lartë të Shqipërisë, por mungonin tërësisht në Shqipërinë e linjës 8, ose 7, në qoftë se duam t'i marrim këto të fundit si situata që ndeshen ndër ne, brenda tipologjive 3 dhe 4, që ndërthuren në Shqipërinë e periudhës së fundit të pushtimit otoman dhe atë post-otoman. Me revolucionin nacional të viteve 1910-1912, pavarësinë e parë (1912-1914), në Shqipëri ndodhën zhvendosje të shpejta dhe të befasishme ndërmjet llojeve të ndryshme të nacionalizmit brenda së njëjtës shoqëri, në të mirë të përthithjes së pjesës së Shqipërisë të mbetur në linjën 8 brenda xhepave të konstruksionit nationalist, i cili prirej të transformonte kulturën e ndërlikuar dhe të përzier të shoqërisë agrare drejt traditës paraosmane/ boshteve të Rilindjes Kombëtare dhe, pse jo, në një plan perspektiv, edhe drejt kulturës liberale perëndimore. Mirëpo, shoqëria parakombëtare e Shqipërisë së përgjumur vazhdoi të rezistonte, sërish me ndihmën e agjentëve të ish-perandorisë. Duhej ndërhyrja e

⁴⁰ *Po aty*, 92.

Austrisë, që xhepat e Kulturës së Lartë të impononin ndryshimin total të shoqërisë gjatë viteve 1916-1918 dhe të përgatitnin ringritjen autonome dhe të vetvetishme të viteve 1919-1924. Pas kësaj, konstruksioni nacionalist e transformoi kulturën popullore në një kulturë vendase më të kultivuar dhe të sistemuar në sektorët më pak të ndikuar nga otomanizmi, ndërsa në sektorët me vendosje rastësore 7 dhe 8 filloi një zhvendosje graduale drejt identitetit fillestar, një proces spontan dhe mjaft i vështirë për t'u arritur.

Në fillim të shek. XX, Shqipëria ishte një shoqëri që po përpiquej të ringrihej kombëtarisht, por me vështirësi, për shkak të mungesës së një kulture të lartë të qëndrueshme dhe të centralizuar. Pjesa më e madhe e popullsisë mbeti pa arsim dhe pa të drejta politike, por ndante një kulturë popullore të përbashkët, të mbështetur në gjuhën dhe traditën zakonore, e cila mund të shndërrohej në kulturë kombëtare nëse pengesat identitare do të kapërceheshin. Intelktualët shqiptarë, të shpërndarë në diasporë, në Stamboll apo në zonat e mbrojtura nga protektoratet e kultit, përpiqeshin të ringjallnin kujtesën historike, të unifikonin gjuhën dhe alfabetin, të themelonin shkolla dhe të hartonin kuadrin kushtetues të shtetit. Megjithatë, kjo rrugë drejt ndërgjegjësimi kombëtar nuk u përqaftua plotësisht nga të gjitha shtresat e shoqërisë.

Rasti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si rilindje e vështirë e një populli të privuar nga aksesit në arsim dhe në kulturën e lartë të vetë nationit, dikur pjesë e Europës, në fillim të shek. XX, i mbarsur edhe me injektive të fuqishme të kulturës së zhvilluar nga Perandoria Osmane, **mund të shpjegohet përmes ndarjes që profesori me origjinë malazeze i Universitetit të Oksfordit, John Plamentaz**, ka bërë në një studim të tijin. Ai dallon dy tipa nacionalizmi: nacionalizmin e lindur në Europën Perëndimore (si rastet e bashkimit të Gjermanisë dhe të Italisë) dhe nacionalizmin në Europën Lindore, ku përfshihet edhe Ballkani,⁴¹ dhe rasti i Shqipërisë, i cili është më i ndërlikuar për shkak të veçorive të tij. Plamentaz-i e shihte nacionalizmin perëndimor si relativisht pozitiv dhe më të “këndshëm”, ndërsa nacionalizmin lindor si të neveritshëm dhe të dënuar me neveri nga vetë kushtet që e krijuan. Nacionalizmi perëndimor, sipas tij, vepronte në emër të kulturave të larta, të zhvilluara

⁴¹ John Plamenatz, “Two Types of Nationalism,” in: *Nationalism, The nature and evolution of an idea*, Eugene Kamenka (ed.) (Canberra: Australian National University Press, 1973), 23-36.

mirë, të centralizuara normativisht dhe të pajisura me një klientelë popullore mjaft mirë të përcaktuar. Gjithçka që kërkohej ishte paksa përshtatje ndaj situatës politike dhe kufijve ndërkombëtarë, në mënyrë që këtyre kulturave, folësve dhe praktikuesve të tyre t'u sigurohej e njëjta mbrojtje e qëndrueshme që rivalët e tyre gëzonin.⁴²

Plamenatz-i shpjegon se lindja, zhvillimi dhe zbatimi i nacionalizmit në vendet e Europës Lindore kaluan përmes revolucionit dhe diplomacisë, në të njëjtën masë sikurse edhe realizimi i nacionalizmit perëndimor. Por çështja nuk mbaronte me kaq. Sipas tij, ky lloj nacionalizmi lindor nuk operoi në emër të një kulture të lartë ekzistuese, të mirëpërcaktuar dhe të kodifikuar, e cila e kishte parambuluar në aspektin gjuhësor territorin e vet me aktivitete të qëndrueshme të shkrim-leximit, që nga Rilindja e hershme europiane ose nga shekulli i Reformacionit në kishë. Përkundrazi, ky nacionalizëm ishte aktiv në emër të një kulture të lartë të pakristalizuar siç duhet, një kulture që ishte thjesht aspiruese në krijimin e saj më të spikatur. Ai kryesoi, ose u përpoq të kryesonte, në një rivalitet të ashpër me konkurrentë të ngjashëm, mbi një hartë etnografike kaotike, të karakterizuar nga shumë dialekte, aleanca të paqarta historike e gjuhësore dhe nga popullsia që sapo kishin filluar të vetidentifikoheshin me këto kultura të larta kombëtare të rishfaqura. Kushtet objektive të botës moderne i kishin detyruar këto popullsia që, herët a vonë, të identifikoheshin me njërin prej këtyre komponentëve. Por, para se të ndodhte kjo, atyre u mungonte një bazë kulturore e përcaktuar qartë, si ajo që gëzonin kombet perëndimore.⁴³ Në çfarë mase qëndron kjo sentencë konkluzive e studimit të Plamenatz-it, e përpunuar më tej nga Gellner-i, për rastin e nacionalizmit shqiptar? Në rastin e Shqipërisë, Kultura e Lartë arbërore e kohës së Rilindjes u transferua nga Arbëria në Perëndim, në mërgatat dhe në qendrat universitare italiane, dhe mbijetoi si gjurmë vetëm në një sferë të lartë të komunikimit të kishës katolike, te prelatët katolikë shqiptarë (Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Pal Hasi, Andrea Bogdani, Kuvendi i Arbrit,⁴⁴ shkollat fillore në Kurbin,

⁴² Po aty, 23- 29; Gellner, *Nations and Nationalism*, 96.

⁴³ Plamenatz, "Two Types of Nationalism", 30, 31, 33-34; Gellner, *Nations and Nationalism*, 97.

⁴⁴ Shih: Robert Elsie, *A biographical Dictionary of Albanian History* (London-New York: I.B. Tauris in association with The Center of Albanian Studies, 2013), 30-31, 44, 56, 66-67, 299-300; Odette Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente*

Blinisht të Zadrimës, Pdhanë), si edhe në kishën ortodokse (piktorët Onufri dhe i biri Andrea, Mihali nga Jerma, piktorët anonimë të kishës së manastirit të Shën Prodhomit në Voskopojë; Theodor Haxhifilipi (Dhaskal Todri) nga Elbasani që hartoi një alfabet të posaçëm; Grigor Durrsaku, i cili më 1761 përktheu Dhiatën e Re; Kostë Berati; Theodor Kavaljoti; nxënës i shkollës së Voskopojës, që botoi më 1779 edhe fjalorin greqisht-arumanisht-shqip; Grigor Gjirokastriti, që botoi Dhiatën e Re⁴⁵). Megjithatë, në masën e popullsisë së Arbërisë së shtrënguar në shtypje, kjo kulturë erdhi gradualisht: fillimisht duke u deformuar, më pas ra në harresë dhe në fund u shndërrua. Ajo u rishfaq në fillim të shek. XIX nën ndikimin e zhvillimeve europiane dhe, nga fundi i shekullit, nisi të përhapej mbi qendrat mbijetuese, duke u bërë bartëse e shpresës rilindëse për pjesën tjetër të kombit “të fjetur” nën kultura të huaja. Në një mjedis të ndërlikuar, me krahina të izoluara, dialekte të shumta dhe besime të ndryshme, rilindësit përcaktuan bazat e përbashkimit gjuhësor, arsimor dhe kulturor, duke thirrur kujtesën e Arbërisë mesjetare dhe të rezistencës së shek. XV. Ky proces përfaqësonte një formë të qëndrueshme të “inxhinierisë kulturore”, që synonte unifikimin e energjive gjuhësore, zakonore e shpirtërore drejt një qëllimi të përbashkët: krijimit të një lidhjeje organike ndërmjet kulturës dhe shtetit – thelbi i nacionalizmit modern shqiptar.

Është kjo arsyeja që studiuesit më në zë të historisë së kulturës kanë arritur në përfundimin se liturgjia dhe letërsia kishtare shqipe, e kohës së Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit, shpëtuan gjuhën shqipe nga rreziku i asimilimit dhe i bastardimit tërësor të huaj, duke e futur sërish në rrugën e një gjuhe dhe letërsie të shkruar.⁴⁶ Pikërisht këtë fill kapën rilindësit e shek. XIX për të rivendosur në një drejtim vektorët kulturorë të nacionalizmit shqiptar.

Ashtu si popullsitë e tjera të Europës Lindore e Juglindore, edhe shqiptarët në fillim të shek. XX mbetën të lidhur pas besnikërive

(Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997), 9-26; *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, grup autorësh: Aleks Buda, Frano Prendi, Hasan Ceka, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Selim Islami, Skënder Anamali, Stavri Naçi, Stefanaq Pollo, Zija Shkodra (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1959), 324- 327, 364-365, 373-384.

⁴⁵ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984), 75.

⁴⁶ *Po aty*, 74.

tradicionale ndaj fisit, territorit dhe fesë. Rilindësit dhe shtetformuesit shqiptarë duhej t'i vendosnin këto lidhje në shërbim të idealit kombëtar, duke ndërtuar një bosht identitar të qartë dhe duke përdorur diplomacinë për të afirmuar të drejtën e shqiptarëve mbi territorin dhe shtetësinë e tyre. Ata u përballën me sfida të shumta: mbrojtjen e popullsisë së dëbuar, shmangien e asimilimit, ruajtjen e tërësisë tokësore dhe përballjen me politikat ekspansioniste të fqinjëve dhe të Perandorisë Osmane. Më e vështira ndër to ishte kundërshtia e segmenteve proosmane dhe e klasës së bejlerëve, të cilët synonin të ruanin modelin oriental të sundimit dhe një identitet të veçuar nga ai i elitave që mbështetën pavarësinë, europianizimin dhe shekullarizimin e shtetit shqiptar.

Plamenatz-i i koncepton zhvillimet e nacionalizmit në vendet e Europës Lindore, përfshirë edhe Shqipërinë si një rast të veçantë të kësaj hapësire, si procese të brendshme të shoqërive respektive. Ndërkohë, skema e tipologjive dhe sistemeve referuese e Gellner-it e lë këtë ndarje mes Europës Perëndimore dhe Lindore brenda linjës 2 dhe 4, por njëkohësisht mban të hapur edhe interferencën e faktorit të diasporës nacionaliste, si një nënlloj i rëndësishëm dhe një fakt historik i spikatur, i cili, në rastin e nacionalizmit shqiptar, luajti një rol bazor në formësimin, orientimin, shtetformimin, diplomacinë dhe mbështetjen e minorancave të flliuara të Kulturës së Lartë vendase. Këtë e theksojmë sepse diaspora nacionaliste e Shqipërisë luajti një rol të jashtëzakonshëm në trajtimin e problemeve të ringjalljes kulturore dhe identitare, në pikasjen e territorit nacional, në mbrojtjen diplomatike, në transformimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë, si edhe në procesin e shtetndërtimit.

Përfundime

Fundi i Luftës së Parë Botërore përbënte një moment dramatik për Shqipërinë, për shkak të zhdukjes nga skena europiane të Perandorisë Austro-Hungareze. Kjo krijoi dy vakuume të menjëhershme: të brendshëm – institucional, në pjesën më të madhe të territorit që ishte administruar nga austriakët për gati tre vjet – dhe të jashtëm, në arenën diplomatike, ku Shqipëria humbi përfaqësuesin e saj më të besueshëm midis Fuqive të Mëdha. Italia, ndonëse fituese përkrah Antantës, nuk mundi të luante një rol të qëndrueshëm në mbrojtjen e çështjes shqiptare. Megjithatë, vendimi i Këshillit të Lartë të Antantës për t'i dhënë Italisë

kontrollin ushtarak mbi Shqipërinë shmangu përsëritjen e pushtimeve serbe dhe greke, duke u dhënë forcave nacionaliste mundësinë të nisnin procesin e ripërtëritjes së shtetit, restaurimit të institucioneve dhe përfaqësimit në Konferencën e Paqes në Paris.

Përvoja ehlikjamiste dhe esadiste mbeti një kujtim i hidhur i së kaluarës, ndërsa administrimi austriak, italian dhe francez në pjesë të ndryshme të vendit la gjurmë pozitive në strukturimin e nacionalizmit dhe në ringritjen e administratës publike. Edhe pse vitet pasuese do të sillnin sfida të reja shtetformuese, elita nacionaliste nisi të ndërtonte një vetëdije më të qartë për përkatësinë dhe për nevojën e bashkimit mbi parimet e Kulturës së Lartë. Ish-esadistët, të mbetur pa udhëheqës pas ndalimit të Esad Pashës për t'u kthyer në vend, u përshtatën me rendin e ri politik dhe u bashkuan me forcat konservatore të bejlerëve të ish-perandorisë, duke gjetur figurën e tyre qendrore te Ahmet Bej Zogu. Ky i fundit, fillimisht në prapaskenë e më pas hapur, ndërtoi gradualisht një legalitet të ri institucional, që zëvendësoi kornizat e kongreseve të Durrësit (1918) dhe të Lushnjës (1920), duke përfunduar me konsolidimin e pushtetit të tij personal pas dhjetorit 1924, me mbështetjen e Serbisë. Elita e europianizuar e Kulturës së Lartë – diaspora nacionaliste, rrethet katolike të Veriut dhe nationalistët e Toskërisë – punoi gjatë viteve 1918-1924 për ripërtëritjen e Shqipërisë mbi bazat e pavarësisë së vitit 1912 dhe të Principatës së vitit 1914, duke ndjekur frymën e Kongresit të Durrësit dhe të Lushnjës. Qëllimi i tyre ishte rikthimi i legalitetit kushtetues me Mbretin Wied ose pasardhësin e tij, si garantë të një shteti europian të qëndrueshëm. Përplasjet politike të viteve 1920-1924 përfunduan me humbjen e elitës demokratike dhe fitoren e forcave konservatore, përfshirë ish-esadistët e transformuar, të cilët morën pushtetin pas dhjetorit 1924. Megjithëse regjimi i tyre përdori dhunë ndaj elitës properëndimore (si në shtypjen e Kryengritjes së Dukagjinit më 1926⁴⁷), pas vitit 1928 konservatorët ahmetianë u detyruan

⁴⁷ Shih për këtë: Camillo Libardi, *Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu* (Tiranë: Naimi, 2012). Shih gjithashtu: *The National Archives* (TNA), London (më tej: TNA), Foreign Office (FO) 371/11209, C 13324/925/90, *Mr William Seeds to Sir Austen Chamberlain*, Durazzo, 6 December 1926; C 13324/925/90, *Sir Austen Chamberlain to Mr William Seeds*, Durazzo, 27 December 1926; TNA FO 371/12070, C 2585/2585/90, *Annual Report, 1926*, Mr William Seeds to Sir Austen Chamberlain, Durazzo, 7 March 1927, pp. 10-12; C 2581/2591, *Sir Odo Russell to Holly See, Alleged persecution of*

të adoptonin elementet themelore të shqiptarizmit, shekullarizmit dhe europianizmit. Me shpalljen e mbretërisë, Shqipëria hyri në një fazë të re stabiliteti institucional: u krijua një administratë e rregullt, u zhvillua programi kombëtar i arsimit dhe u miratuan politika modernizuese që e orientuan vendin drejt Europës, ndërsa ndikimi turk në jetën e brendshme u zhduk përfundimisht.

Bibliografi:

Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit: Studime, materiale, dokumente. Redaktuar nga Aleks Buda, Mahir Domi, Stefanaq Pollo, Kristaq Prifti dhe M. Samara. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1972.

BUDA, Aleks & Frano Prendi, Hasan Ceka, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Selim Islami, Skënder Anamali, Stavri Naçi, Stefanaq Pollo dhe Zija Shkodra. *Historia e Shqipërisë*. Vëll. 1. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1959.

CARR, E. H. *Nationalism and After*. London: Macmillan & Co. Ltd., 1945.

CLAYER, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*. Tiranë: Përpjekja, 2009.

ELSIE, Robert. *A Biographical Dictionary of Albanian History*. London–New York: I.B. Tauris, në bashkëpunim me The Center for Albanian Studies, 2013.

GELBER, Harry G. *Sovereignty Through Interdependence*. London–The Hague–Boston: Kluwer Law International, 1997.

GELLNER, Ernest. *Nations and Nationalism*. 2nd ed. Oxford: Blackwell Publishing, 2006.

Roman Catholics in Albania, 18 March 1927, pp. 28-30; C 3525/2591/90, *Execution of Catholic priest at Scutari*, Mr William Seeds to Sir Austen Chamberlain, Durazzo, 8 April 1927, pp. 31-33; TNA FO 371/12069, C 7573/946/90, Mr. Leeper to Sir Austen Chamberlain, Durazzo, 29 August 1927.

- HASTINGS, Adrian. *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*. 6th ed. Cambridge: Cambridge University Press, 2006.
- HOBBSBAWM, E. J. *Nations and Nationalism since 1780: Programme, Myth, Reality*. Cambridge: Cambridge University Press, 1997.
- JELAVICH, Barbara. *History of the Balkans: Twentieth Century*. Vol. 2. Cambridge: Cambridge University Press, 1983. Reprint, 1999.
- KADRIA, Sali. *Nacionalizmi Shqiptar në vitet 1912–1924*. ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2020.
- KEDOURIE, Elie. *Nationalism*. 4th ed. Oxford: Blackwell, 1993.
- MARQUET, Odette. *Pjetër Bogdani: Letra dhe dokumenta*. Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997.
- PLAMENATZ, John. “Two Types of Nationalism.” Në *Nationalism: The Nature and Evolution of an Idea*, redaktuar nga Eugene Kamenka. Canberra: Australian National University Press, 1973.
- SALLEO, Ferdinando. *Shqipëria: Gjashtë muaj mbretëri*. Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000.
- SHKODRA, Zija. *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984.
- TODOROVA, Maria. *Imagining the Balkans*. Oxford: Oxford University Press, 1997.
- YPI, Lea. “The Albanian Renaissance in Political Thought: Between the Enlightenment and Romanticism.” *East European Politics and Societies* 21, nr. 4 (November 2007).

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

romeo_gurakuqi@hotmail.com; romeo.gurakuqi@asa.edu.al

*S u m m a r y***THE BIRTH AND DEVELOPMENT OF ALBANIAN NATIONALISM
19TH CENTURY TO THE 1920S**

This article examines the historical emergence and development of Albanian nationalism, situating it within the broader theoretical debates on nation and nationalism. The analysis engages with several key perspectives: Ernest Gellner's emphasis on education and modernisation, the formative role of the nuclei of High Culture and the Patriotic Diaspora, John Plamenatz's distinction between "Western" and "Eastern" nationalisms, and Adrian Hastings's interpretation of the Christian cultural roots of nationalism. Within this framework, the Albanian case is presented as a late and complex instance of nation-formation, shaped by the structural backwardness characteristic of the eastern periphery of the Ottoman Empire. Nathalie Clayer has drawn attention to the structural impediments confronting Albanian nationalism, including economic underdevelopment, weak communications, widespread illiteracy, and the absence of a state apparatus. Lea Ypi, in turn, highlights the dialectical interplay between Enlightenment ideals of sovereignty and secularism, on the one hand, and the Romantic currents of nineteenth-century Europe, on the other, in shaping the Albanian national movement. Albanian society of the time, predominantly agrarian and clan-based, and marked by pronounced religious diversity (Islam, Orthodoxy, Catholicism), posed significant obstacles to the unified diffusion of national consciousness. Moreover, Ottoman restrictions on schooling in the Albanian language and on the use of the Latin alphabet further delayed both the nation-building process and the establishment of a national school system. Consequently, national awareness first consolidated within intellectual circles and diaspora communities, supported by the Catholic clergy and Austro-Hungarian protectorates, before reaching the largely illiterate peasantry. The Proclamation of Independence in 1912 brought what scholars have termed

“negative sovereignty”: liberation from Ottoman rule without the establishment of internationally recognised and functionally operative state institutions across the whole territory. To a considerable extent, sovereignty was only partially recovered during the Albanian Principality, yet its scope and duration remained severely limited. Internal opposition from pro-Ottoman and Essadist groups, combined with the interventions of neighbouring states, resulted in the collapse of the fragile Albanian state in 1914. Nevertheless, the Albanian case illustrates how nationalism can emerge under highly adverse conditions through cultural revival, intellectual agency, and international diplomacy. Its resurgence took shape once again during 1916-1918 under Austro-Hungarian military control, and paradoxically, within the Italian and French zones of occupation. However, full revival and consolidation were achieved only in the 1920s, within the framework of a secular and regionally balanced modern state.

Keywords: The Albanian National Awakening, enlightenment and secularism, religious diversity, agrarian and tribal society, illiteracy and education, “negative sovereignty”, “positive sovereignty”, the formation of national identity.

PROF. ASOC. DR. HASAN BELLO

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
hasanbello1@gmail.com

**KONFLIKTI I SHQIPTARËVE ME XHONTURQIT
PËR ÇËSHTJEN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE
(shtator 1909 – dhjetor 1910)**

Abstrakt:

Ky artikull shqyrton konfliktin midis nacionalizmit shqiptar dhe politikës së xhonturqve (shtator 1909 – dhjetor 1910), i cili u përqendrua kryesisht rreth çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe. Pas Revolucionit të 1908-s dhe Kongresit të Manastirit, që vendosi alfabetin latin si simbol të unitetit kombëtar dhe emancipimit kulturor, xhonturqit nisën një fushatë agresive për të imponuar alfabetin arab, duke shfrytëzuar fanatizmin fetar, propagandën, klubet proosmane, mitingjet e sponsorizuara dhe presionin administrativ për të penguar aplikimin e alfabetit latin. Kjo përplasje u shfaq përmes protestave masive, mitingjeve në Korçë, Elbasan, Shkup, Berat etj., rezistencës së nxënësve dhe mësuesve në institucionet arsimore, artikujve në shtypin shqiptar dhe kulmoi me Kongresin e Dytë të Manastirit (1910), që kërkoi liri të plotë për përdorimin e alfabetit latin dhe mbrojtje të të drejtave kulturore. Konflikti thelloi çarjen shqiptaro-osmane, radikalizoi Lëvizjen Kombëtare dhe përshpejtoi rrugën drejt pavarësisë, duke ekspozuar politikën osmanizuese dhe antishqiptare të xhonturqve.

Fjalë kyçe:

Nacionalizmi shqiptar, xhonturq, alfabeti shqip, Lëvizja Kombëtare.

Fillimi i fushatës kundër alfabetit latin të gjuhës shqipe

Arritjet e shqiptarëve në fushën arsimore dhe kulturore, si dhe zgjimi kombëtar i popullit shqiptar, i frikësuan xhonturqit, të cilët i shihnin këto zhvillime si tendenca të fshehta për t'u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe si intriga të shteteve të huaja. Për këto arsye, ata u përpoqën të nxitnin fanatizmin fetar dhe shkrimin e gjuhës shqipe me alfabet arab. Në vjeshtën e vitit 1909, kjo politikë u përvijua qartë dhe u pasqyrua në artikujt e shumtë që u botuan në shtypin xhonturk të Stambollit. Kështu, redaktori i gazetës “Tasvir-i Efkar”, Sulejman Nazif, botoi një artikull të gjatë, me anën e të cilit synonte të ndante gegët nga toskët dhe myslimanët nga të krishterët. Sipas tij, përhapja e alfabetit latin ishte fryt i intrigave të shteteve të huaja; prandaj, ai nuk duhej të mësohej nga shqiptarët myslimanë. Në të kundërt, ata nuk do të ishin më në gjendje të lexonin Kur'anin dhe, gradualisht, mund të ndërronin edhe fenë. Shqiptarët e vërtetë ishin të lirë të përpiqeshin për përhapjen e gjuhës së tyre, por “s’duhet të harrojmë se shqipja s’munt të bëhet kurrë gjuhë zyrtare, se ka të tjera gjuhë që janë njëmijë herë më të larta se ajo. Shqipja, si dhe gjuhët e tjera jozyrtare, janë të dënuara për fishkje dhe humbje”.¹ Ai e mbyllte shkrimin e tij me paralajmërimin se, nëse shqiptarët do të punonin për shqiptarizmin, ata do të bënin tradhti ndaj historisë së tyre. Këto u përgënjeshtruan nga deputetët nacionalistë shqiptarë, të cilët botuan një përgjigje të argumentuar në gazetën e njohur të Stambollit “Tanin”.²

Në qytetin e Durrësit, disa shqiptarë që i shërbenin klubit xhonturk propaganduan kundër gjuhës shqipe, duke pretenduar se ajo i bënte “kaur”. Ata i dërguan një kërkesë valiut të Shkodrës, nëpërmjet së cilës kërkonin që ai të kujdesej, pasi, sipas tyre, njerëzit rezikonin të dilnin nga feja. Ndërsa disa të tjerë shkuan në Kavajë, në Shijak, Ndroq dhe në fshatrat përreth, duke qortuar fshatarët që të mos lexonin libra në gjuhën shqipe. Për të goditur elementët atdhetarë, Komisioni i riorganizimit të vilajetit të Shkodrës pushoi nga puna 25 nëpunës shqiptarë, të cilët

¹ “Osmanlılık ve Arnavutlar,” *Tanin*, İstanbul, 4 shtator 1909, 1; “Tasfir-i Efkar,” *Dielli*, nr. 26, Boston, 24 shtator 1909, 3.

² Said Olgun, *Arnavut milliyetçiliğinin gelişiminde mektepler* (Ankara: Gece Kitaplığı, 2016), 274-275.

shquheshin për idetë dhe veprimtarinë e tyre patriotike.³ Reaksioni xhonturk kundër mësimin të gjuhës shqipe veptoi më shumë se kudo tjetër në vilajetin e Kosovës. Me urdhër të valiut, në mesin e shtatorit 1909, u mbyll shkolla shqipe e Pejës dhe mësuesi i saj u kërcënua. Autoritetet lokale nuk morën aspak parasysh faktin se ky institucion ishte nën patronazhin e Austro-Hungarisë.⁴

Në janar të vitit 1910, një grup deputetësh shqiptarë në Parlamentin Osman i drejtuan një mesazh kryeministrit, të cilët, duke u paraqitur si “interpretë të ndjenjave të popullit shqiptar”, kërkonin që për shkrimin e gjuhës shqipe të përdorej alfabeti arab.⁵ Këtë çështje ata e shihnin të pandarë nga feja, e cila, sipas tyre, përbënte faktorin kryesor që i lidhte shqiptarët me turqit. Për këtë arsye, ata i referoheshin edhe Kongresit të Dibrës. “Ne, si përgjegjës për fatin e popullit, – theksonin ata, – vendosëm që ky alfabet [latin] të mos pranohet dhe të mos futet nëpër shkolla. Ne, me neveri të thellë, shikojmë propagandën për alfabetin latin, të cilin duan të na fusin të huajt, që duan të gëlltisnin atdheun tonë”.⁶ Ky qëndrim u kritikua në shtypin e kohës. Në një artikull të Thanas Floqit, shprehej habi për disa individë, mes të cilëve edhe disa deputetë shqiptarë, që guxonin të pohonin se përdorimi i alfabetit latin prishte fenë myslimane. Ai theksonte se një gjë e tillë nuk ishte dëgjuar kurrë në botë; se gjuha dhe alfabeti s’kishin asnjë lidhje me besimet; dhe se feja dhe kombësia kishin vendin e vet. “Ata që përpiqen të na prishin alfabetin, – theksonte ai, – janë njerëz pa ndonjë ndjenjë atdhetarësie, janë njerëz që i falen parasë dhe përpara saj mund të shesin jo vetëm alfabetin shqip, por edhe shumë gjëra të tyre më të vyera”. Ai u bënte thirrje shqiptarëve që të qëndronin larg këtyre elementëve tradhtarë dhe intrigave xhonturke.⁷

³ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.19-7-729. Raport i konsullit austro-hungarez në Durrës, Halla, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Durrës, 13 nëntor 1909.

⁴ *Po aty*, Vj.19-14-1481. Raport i nënkonsullit austro-hungarez në Prizren, Prohaska, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Prizren, 29 shtator 1909.

⁵ Ndër nënshkruesit ishin disa nga deputetët e njohur për qëndrimet e tyre pro xhonturqve, si Mahmud Bedriu i Pejës, Haxhi Aliu i Elbasanit, Fuat Pasha i Prishtinës, Sait Efendi i Shkupit, Hasan Basriu i Dibrës, Riza Efendi i Shkodrës etj. *Po aty*, Vj.20-14-1449. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfai, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 25 janar 1910.

⁶ Zekeria Cana, “Reaksioni xhonturk kundër shkollës dhe shkrimit shqip,” në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1 (Prishtinë: 1969): 94.

⁷ Thanas Floqi, “Rreziku i abesë,” *Korça*, nr. 30, Korçë, 15 janar 1910, 1.

Në bashkëpunim me klerin fanatik, xhonturqit provokuan shkatërrimin e shkollës shqipe në Gjilan. Orenditë e saj u nxorën jashtë, ndërsa librat shqip u dogjën.⁸ Nga Selaniku, Komiteti Qendror i Partisë “Bashkim dhe Përparim” dërgoi në Kosovë Arif Hikmetin me detyrë që të propagandonte në favor të alfabetit arab.⁹ Ndërsa në fillim të muajit shkurt, valiu i Kosovës lëshoi një urdhër për mbylljen e të gjitha shkollave kombëtare dhe për heqjen e mësimi të gjuhës shqipe nga shkollat osmane, në të cilat ajo ishte futur disa muaj më parë.¹⁰ Kjo masë u justifikua me arsyetimin se çështja e gjuhës shqipe kishte marrë karakter politik. Në një takim me disa anëtarë të Klubit shqiptar të Shkupit, valiu deklaroi se nuk do të lejonte themelimin e shkollave fillore shqipe me shpenzimet e shtetit.¹¹ Ky qëndrim hasi në kundërshtimin e patriotëve shqiptarë, si Hasan Prishtina, Nexhip Draga etj., të cilët i kërkuan qeverisë xhonturke në Stamboll largimin e tij nga Kosova, duke e paralajmëruar se, në rast të kundërt, punët do të shkonin keq e më keq.¹² Më vonë, kjo situatë u shndërrua në një klimë terrori ndaj të gjithë atyre që konsideroheshin “latinxhinj”.

Krahas administratës, shtypit, agjitorëve dhe klerit në favor të përdorimit të alfabetit arab, xhonturqit përdorën të gjitha ato mjete të cilat nën regjimin e Abdylhamidit II i kishin demaskuar si despotike.¹³

Një nga qendrat ku u zhvillua një luftë e ashpër kundër shkrimit dhe mësimi të shqipes me alfabet latin ishte qyteti i Tiranës. Kjo ndodhi për shkak të ndikimit të klubit xhonturk të oficerëve, i cili në atë periudhë luajti një rol shumë negativ. Kështu, shpalljet e dërguara nga Stambolli që lejonin mësimin e shqipes në institucionet arsimore osmane, të vendosura në tregun e qytetit, qëndruan vetëm një ditë; të nesërmen ato u gjetën të grisura.¹⁴

⁸ Olgun, *Arnavut milliyetçiliğinin gelişiminde mektepler*, 281; Cana, “Reaksioni xhonturk kundër shkollës dhe shkrimit shqip”, 130.

⁹ Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti* (İstanbul: YKY, 2007), 773.

¹⁰ Muhamet Pirraku, “Legalizimi i alfabetit të Manastirit,” *Përparimi*, nr. 11-12 (Prishtinë: 1968): 1043.

¹¹ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-10-1040. Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, Adamkieviç, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 6 shkurt 1910.

¹² “Lëvizja dhe të reat e saja,” *Shqypja e Shqypënis*, nr. 19, Sofje, 11 mars 1910, 4.

¹³ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-14-1451. Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Prohaska, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Prizren, 13 shkurt 1910.

¹⁴ “Letrë prej Tirane,” *Shqipëtar*, nr. 2, Stamboll, 7 janar 1910, 1.

Në fillim të vitit 1910, në Shkup u themelua një shoqëri për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe me germa arabe. Kjo shkaktoi reagimin e patriotëve, të cilët e akuzuan atë si përçarëse të kombit shqiptar.¹⁵ Një klub i ngjashëm u çel nga disa shqiptarë edhe në lagjen “Aksaray” në Stamboll,¹⁶ rreth të cilit u grumbulluan elementë me lidhje të forta me Komitetin Xhonturk.¹⁷ Me anë të një letre që kjo shoqëri i drejtoi myftiut dhe Kryesisë së bashkisë së Elbasanit, ajo i vinte në dijeni për shpërndarjen e abetareve me alfabet arab në Shkup, Prishtinë, Ohër etj., si dhe për krijimin e degëve të saj në disa qytete të tjera.¹⁸

Megjithëse qeveria osmane hiqej sikur mbante një qëndrim asnjës,¹⁹ autoritetet lokale filluan të ndalonin përdorimin e shkronjave latine,²⁰ ndërsa në disa qytete nëpunësit dhe oficerët xhonturq shpërndanë abetare shqip me shkronja arabe.²¹ Kjo binte në kundërshtim me urdhrin e ministrit të Arsimit, i cili u kishte dërguar pesë vilajeteve (Selanik, Kosovë, Manastir, Janinë dhe Shkodër) një qarkore, sipas së cilës mësimi i gjuhës shqipe duhej të bëhej sipas dëshirës.²²

Në fakt, në elitën xhonturke, lidhur me këtë çështje, nuk kishte një qëndrim unik. Kjo vihet re edhe në një shkrim të gazetarit të njohur

¹⁵ “Në Shkup,” *Lirija*, nr. 69, Selanik, 2 janar 1910, 2.

¹⁶ Në total vetëm në Stamboll u krijuan tri klube, të cilat kishin si objektiv shkrimin e gjuhës shqipe me alfabet arab. Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve arnavutlar: II. Meşrutiyet döneminde arnavut ulusçuluğu ve Arnavutluk sorunu* (İstanbul: BÜKE KİTAPLARI, 2004), 224-225; Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 144.

¹⁷ “Një klub i ri në Stamboll,” *Lirija*, nr. 77, Selanik, 27 shkurt 1910, 2.

¹⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 143, Viti (më tej: V.) 1909, Dosja (më tej: D.) 1785, fl. 1. Letër e shoqërisë për shkrimin dhe mësimin e gjuhës shqipe me shkronja arabe, drejtuar myftiut dhe Kryesisë së Bashkisë së Elbasanit, Stamboll, 31 mars 1909.

¹⁹ “Urdhër i ministrit Talat be që të mos përziejehen nëpunësit e qeverisë në shkronjat shqipe,” *Lirija*, nr. 72, Selanik, 23 janar 1910, 1. Sipas këtij artikulli, ministri i Brendshëm, Talat Pasha, me kërkesë të Hasan Prishtinës, kishte lëshuar një urdher telegrafik për katër vilajetet shqiptare, që nëpunësit të mbanin një qëndrim asnjës lidhur me alfabetin e gjuhës shqipe. “Për shkronjat,” *Korça*, nr. 18, Korçë, 30 janar 1910, 1; “Prej ministerit të msoisimit i erdh hyqymetit,” *Bashkimi*, nr. 8, Shkodër, 20 shkurt 1910, 1.

²⁰ “Të dalë në shesh e vërteta. Qeverisë dhe depytetëve,” *Lirija*, nr. 75, Selanik, 12 shkurt 1910, 1.

²¹ “Xhemieti përziejehet edhe në çështjen e abesë së gjuhës shqip,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 37, Janinë, 17 dhjetor 1909, 1; “Alfabeti i ri,” *Dielli*, nr. 42, Boston, 14 janar 1910, 1.

²² Olgun, *Arnavut milliyetçiliğinin gelişiminde mektepler*, 277; “Urdhëri i Ministorit të Mësimin. Qeveria po rri e paantë,” *Lirija*, nr. 73, Selanik, 30 janar 1910, 1.

Hysejn Xhahid në gazetën “Tanin”, sipas të cilit shqiptarët do të përparonin më tepër me alfabetin latin. Ai shprehej kundër pikëpamjeve të disa bashkatdhetarëve, të cilët çështjen e alfabetit e ngatërronin me fenë.²³

Në këtë kontekst u organizuan mitingje²⁴ dhe kundërmitingje nga përkrahësit e alfabeve të ndryshme, të cilët nënshkruan edhe peticione drejtuar qeverisë osmane.²⁵ Kështu, populli i Mitrovicës u dërgoi telegrame proteste parlamentit dhe qeverisë së saj kundër shkronjave arabe.²⁶ Epiqendra e këtyre mitingjeve²⁷ dhe e propagandës shqiptariste ishte Korça.²⁸ Por një miting i madh në mbështetje të alfabetit latin, ku morën pjesë afërsisht 15 000 veta, u mbajt edhe në Berat.²⁹ Ndërkaq, i gjithë shtypi i Stambollit u mbush me artikuj në lidhje me qëndrimet pro

²³ “Hysejin Xhahid... ç’thotë për shkronjat shqip,” *Korça*, nr. 30, Korçë, 15 janar 1910, 3.

²⁴ “Një zemër shqiptare,” *Korça*, nr. 18, Korçë, 30 janar 1910, 1. Në këtë artikull flitet për “kongresin” e një pjese të parisë myslimane të Shkupit, i cili vendosi që në shkollat të mësohej gjuha shqipe me alfabet arab. Autori shkruan se askush nuk do t’i ndiqte vendimet e tyre, pasi shqiptarët e të gjitha feve ishin bashkuar rreth Kongresit të Manastirit dhe alfabetit latin të pranuar njëzëri në këtë kongres. “Meseleja e harfeve,” *Flamuri*, nr. 7, Boston, 1 prill 1910, 2. Lajme mbi mitingjet dhe protestat e zhvilluara në Elbasan, Korçë, Përmet, Leskovik, Berat, Gramsh, Filat, Gjirokastrë, Prevezë dhe Janinë kundër alfabetit arab, si dhe për dy mitingje të rreme që, me nxitjen e xhonturqeve, u mbajtën në Manastir dhe Shkup pro tij.

²⁵ “Çështje e shkrimit shqip,” *Lirija*, nr. 72, Selanik, 13 janar 1910, 2; “Letra,” *Lirija*, nr. 75, Selanik, 13 shkurt 1910, 1-2; “Elbasanasit,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 68, Janinë, 15 shkurt 1910, 2; “Çështja e abesë dhe mitingjet në Shqipëri,” *Dielli*, nr. 51, Boston, 18 mars 1910, 1-2; “Alfabeti dhe shqiptarët,” *Dielli*, nr. 56, Boston, 22 prill 1910, 1.

²⁶ “Letër nga Mitrovica,” *Lirija*, nr. 72, Selanik, 23 janar 1910, 3.

²⁷ “Atdhetar të dashur shqiptarë osmanllinj,” *Korça*, nr. 36, Korçë, 6 shkurt 1910, 3; “Tejshkrim nga Korça,” *Lirija*, nr. 76, Selanik, 20 shkurt 1910, 1; “Çështja e abesë,” *Flamuri*, nr. 7, Boston, 1 prill 1910, 1-2.

²⁸ “Mbledhja për abenë shqipe në Korçë,” *Korça*, nr. 35, Korçë, 18 shkurt 1910, 1-2; “Mitingu në Korçë,” *Lirija*, nr. 76, Selanik, 20 shkurt 1910, 1; “Ç’bënë,” *Korça*, nr. 31, Korçë, 22 janar 1910, 1. Kryeartikull kundër deputetëve që kërkuar vendosjen e shkronjave turke për gjuhën shqipe. “Mitingu i shkronjave shqip,” *Lidhja Orthodoxe*, nr. 14, Korçë, 22 shkurt 1910, 1; “Letër prej Korçe,” *Shqipëtar*, nr. 9, Stamboll, 25 shkurt 1910, 1-2. Lajme mbi mbledhjen e mbajtur nën kryesinë e myderrizit të Korçës për të kundërshtuar shkronjat shqipe dhe mitingun e madh prej 10 000 vetash që u mbajt për mbrojtjen e tyre. “Nga një korrespondencë e veçantë,” *Flamuri*, nr. 9, Boston, 15 prill 1910, 1-2.

²⁹ “Një letër e hapëtë,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 72, Janinë, 15 mars 1910, 1.

dhe kundër alfabetit.³⁰ Një nga periodikët më të rëndësishëm të kohës, gazeta “Lirija”, theksonte hapur se çështja e shkronjave shqipe po zgjidhej në favor të alfabetit latin.³¹ Ajo doli kundër qeverisë osmane, e cila, në kundërshtim me vendimin e saj, urdhëroi që në vilajetin e Kosovës gjuha shqipe të mësohej me shkronja arabe.³² Ndërsa në Dibër, nën kryesinë e kryetarit të Xhemijetit, u zhvillua një mbledhje për heqjen e shkronjave latine, gjë që shkaktoi pakënaqësinë e të gjithë popullsisë.³³

Një qëndrim pro alfabetit latin mbajti edhe gazeta “Shqipëtar”, e cila botohej nga Dervish Hima.³⁴ Në një nga numrat e saj ribotohej artikulli i filologut, historianit, përkthyesit, gazetarit dhe orientalistit gjerman Friedrich Schrader (1865-1922), botuar fillimisht në gazetën “Osmanischer Lloyd” për çështjen e alfabetit. Sipas tij, alfabeti semitik, siç ishte ai arab, shkencërisht nuk mund të aplikohet në asnjërën prej gjuhëve ariane; për këtë arsye, autori argumentonte se shqipja duhej të shkruhej me germa latine.³⁵

Për shkak të këtyre zhvillimeve, thuhej se valiu i Kosovës, Maz`har Beu, kishte dhënë dorëheqjen në shenjë proteste. Ndërsa në vilajetin e Manastirit, autoritetet shkarkuan drejtorin e idadies së Shkupit, sepse kishte lejuar mësimin e shqipes me alfabetin latin. Kjo situatë shkaktoi zemërimin e patriotëve shqiptarë.³⁶ Nga Durrësi njoftohej gjithashtu për kundërshtimin që prindërit dhe nxënësit e shkollës idadie i bënin mësimin të shqipes me germa arabe.³⁷ Drejtori i shkollës ushtroi presion mbi mësuesin e gjuhës shqipe, Sali Nivica, i cili kishte deklaruar se nuk pranonte që t`ua mësonte shqipen me këtë alfabet.³⁸

³⁰ “Çështje e shkrimit shqip dhe shtypi,” *Lirija*, nr. 75, Selanik, 13 shkurt 1910, 2. Jepen lajme nga gazetat e Stambollit “Sabah”, “Tanin”, “Rumeli”.

³¹ “Çështje e shkronjavet shqip,” *Lirija*, nr. 7, Selanik, 9 janar 1910, 1; “Kundërshtarët e shkronjave shqipe ene e vërteta,” *Lirija*, nr. 77, Selanik, 27 shkurt 1910, 1-2.

³² “Ç`u bë për shkronajtë shqip,” *Lirija*, nr. 76, Selanik, 20 shkurt 1910, 1.

³³ “Letër prej Dibre,” *Shqypja e Shqypnis*, nr. 18, Sofje, 21 shkurt 1910, 2.

³⁴ “Çështja e shkronjave,” *Shqipëtar*, nr. 4, Stamboll, 21 janar 1910, 1; “Çështja e abecesë,” *Shqipëtar*, nr. 6, Stamboll, 10 shkurt 1910, 1.

³⁵ “L`écriture Albanaise,” *Shqipëtar*, nr. 5, Stamboll, 28 janar 1910, 1.

³⁶ “Andej-Këtej,” *Korça*, nr. 1, Korçë, 16 mars 1910, 4.

³⁷ “Letër e hapur,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 21, Manastir, 28 janar 1910, 1; “Prej Durrësit,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 22, Manastir, 4 shkurt 1910, 2; “Nga Durrësi,” *Dielli*, nr. 47, Boston, 18 shkurt 1910, 2.

³⁸ Në Durrës, për këtë qëllim, ishin dërguar 100 abetare shqipe me shkronja arabe. “Letër redaksisë,” *Bashkimi*, nr. 5, Shkodër, 30 janar 1910, 3.

Një qëndrim të ngjashëm mbajtën edhe nxënësit e idadies së Korçës, Janinë, Leskovikut³⁹ dhe Elbasanit, ku populli organizoi një miting të madh.⁴⁰ Mësuesi Hysein Ceka dha dorëheqjen në shenjë proteste,⁴¹ ndërsa mytesarifin dhe komisarin e policisë kërkuan nga drejtori i idadies që të përdorte alfabetin arab.⁴² Në Filat, 700 banorë nënshkruan një peticion drejtuar ministrit të Arsimit, në të cilin kërkonin që të lejohej mësimi i gjuhës shqipe me alfabetin latin dhe, njëkohësisht, të merreshin masa kundër përçarësve të kombit shqiptar.⁴³ Në Manastir, 23 nxënës të shkollës idadie braktisën mësimin dhe deklaruan se ishin kundër përdorimit të alfabetit arab.⁴⁴

Shtypi i kohës kritikoi përpjekjet e grekomanëve⁴⁵ dhe turkomanëve, të cilët kërkonin t'i impononin gjuhës shqipe alfabetet e tyre.⁴⁶ Gazeta "Flamuri" botoi deklaratën e Enver Pashës, dhënë një të përditshmeje londineze, lidhur me qëndrimin e qeverisë osmane ndaj alfabetit të gjuhës shqipe.⁴⁷ Ndërsa në gazetën xhonturke u botuan artikuj në favor të tyre, si edhe jepeshin shifra të fryra për përkrahësit e alfabetit arab.⁴⁸

Në shtyp u kritikua edhe një pjesë e deputetëve shqiptarë që mbështesnin këtë alfabet⁴⁹ dhe u sollën argumente në mbrojtje të

³⁹ "Greva e nxënësve të idadies së Korçës," *Lidhja Orthodoxe*, nr. 13, Korçë, 9 shkurt 1910, 4.

⁴⁰ "Çështja e alfabetit në Elbasan," *Korça*, nr. 34, Korçë, 12 shkurt 1910, 1-2.

⁴¹ "Gjuha shqip nuk mësohet me shkronja arabishte," *Tomorri*, nr. 1, Elbasan, 10 mars 1910, 3.

⁴² "Korrespondencë e rregullshme na Elbasani," *Korça*, nr. 37, Korçë, 16 mars 1910, 2.

⁴³ "Letër nga Filati," *Zgjim i Shqipërisë*, nr. 71, Janinë, 8 mars 1910, 2.

⁴⁴ "Nxënësit e idadies," *Tomorri*, nr. 1, Elbasan, 10 mars 1910, 1.

⁴⁵ "Shkrimi," *Shqipëtar*, nr. 10, Stamboll, 4 mars 1910, 1.

⁴⁶ "Ata që nxjerrin sy tek vënë vetulla," *Lirija*, nr. 74, Selanik, 6 shkurt 1910, 1; "Aforosët," *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 67, Janinë, 8 shkurt 1910, 1; "Alfabeti shqip," *Korça*, nr. 1, Korçë, 16 mars 1910, 4; "Nga Shkodra," *Dielli*, nr. 57, Boston, 22 prill 1910, 1-2.

⁴⁷ "Alfabeti shqip dhe Enver Pasha," *Flamuri*, nr. 7, Boston, 1 prill 1910, 1.

⁴⁸ "Shkrimi shqip dhe shtypi," *Lirija*, nr. 73, Selanik, 30 janar 1910, 2. Përmbledhje lajmesh nga shtypi i Stambollit, pro dhe kundër shkrimit të gjuhës shqipe me germa latine.

⁴⁹ "Gjuha shqip dhe depytetët," *Lirija*, nr. 70, Selanik, 9 janar 1910, 2; "Rreziku i abesë," *Korça*, nr. 30, Korçë, 15 janar 1910, 1; "Për shkronjat shqip," *Lirija*, nr. 71, Selanik, 16 janar 1910, 1; "L'Alphabet Albanais," *Shqipëtar*, nr. 8, Stamboll, 18 shkurt 1910, 1-2. Në këtë numër botohen telegrame dhe letra nga Elbasani, Shkodra, Korça, Bukureshti, Kostanca etj., në të cilat shprehej protesta dhe zemërimi i

shkronjave latine.⁵⁰ Sipas gazetës “Lirija”, grupi tjetër i deputetëve, i cili përbëhej nga dhjetë veta, ku bënin pjesë Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Esat Toptani dhe Shahin Kolonja, nënshkroi një deklaratë kundër kolegëve të tyre.⁵¹ Në një intervistë për gazetën e Stambollit “Osmanicher Lloyd”, deputeti Myfid Bej Libohova mbajti një qëndrim në favor të alfabetit latin dhe u shpreh hapur kundër përdorimit të shkronjave arabe.⁵² Gazeta “Lirija” kritikoi gjithashtu përkrahjen morale që disa deputetë serbë u jepnin kundërshtarëve të alfabetit latin.⁵³

Një qëndrim pro alfabetit latin mbajtën edhe studentët shqiptarë të Fakultetit të Teologjisë, Drejtësisë, Mjekësisë, Bujqësisë, Inxhinierisë etj. në Stamboll,⁵⁴ të cilët nënshkruan një deklaratë kundër atyre deputetëve që kërkonin futjen e alfabetit arab.⁵⁵ Ata organizuan një manifestim para shtypshkronjës së gazetës “Tanin”, në shenjë falënderimi për artikujt në favor të shkronjave shqipe,⁵⁶ dhe i drejtuan Vezirit të Madh një kërkesë për të lejuar mësimin e shqipes. Ndërkohë, në Klubin shqiptar të Stambollit, filozofi i njohur Riza Teufik (1869-1949) mbajti një konferencë, ku u deklarua hapur si përkrahës i alfabetit latin.⁵⁷

Këto përpjekje u mbështetën edhe nga shqiptarët që jetonin në vende të ndryshme. Kolonitë shqiptare në SHBA, Rumania⁵⁸ dhe Argjentinë organizuan mitingje për mbrojtjen e alfabetit latin.⁵⁹ Ndërsa

shqiptarëve të mbledhur në mitingje kundër disa deputetëve që kërkonin të fusnin shkronjat arabo-turke në gjuhën shqipe. “Lajm,” *Bashkimi*, nr. 8, Shkodër, 20 shkurt 1910, 1; “Abecetë t’ona dhe mbledhja e deputetëve t’anë në Stamboll,” *Dielli*, nr. 49, Boston, 4 mars 1910, 2.

⁵⁰ “Gjuha shqip me shkronjat e Arapëvet,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 20, Manastir, 21 janar 1910, 1-2; “Gjuha shqip me shkronjat e Arapëvet,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 22, Manastir, 4 shkurt 1910, 1-2; “L’Alphabet Albanais,” *Shqipëtar*, nr. 9, Stamboll, 25 shkurt 1910, 1.

⁵¹ “Gjuha shqip dhe depytetët,” *Lirija*, nr. 71, Selanik, 16 janar 1910, 1-2.

⁵² “La question de l’alphabet albanais. Déclarations de Myfid bej,” *Shqipëtar*, nr. 6, Stamboll, 4 shkurt 1910, 1.

⁵³ “Intrigat e serbëve në Shqipëri,” *Lirija*, nr. 74, Selanik, 6 shkurt 1910, 1-2.

⁵⁴ “Darü l-fünûn Arnavud Talebesi,” *Arnavud*, İstanbul, 3 shkurt 1910, 1.

⁵⁵ “Nxënësit në Stamboll dhe gjuha shqipe,” *Lirija*, nr. 71, Selanik, 16 janar 1910, 2.

⁵⁶ “Nga Stambolli,” *Lirija*, nr. 71, Selanik, 16 janar 1910, 2.

⁵⁷ “Në Stamboll,” *Lirija*, nr. 78, Selanik, 6 mars 1910, 1; “Lajmet e javës: Shtypi shqyp,” *Bashkimi*, nr. 11, Shkodër, 13 mars 1910, 3-4.

⁵⁸ “Shkronjat shqipe edhe shqiptarët e jashtë,” *Tomorri*, nr. 1, Elbasan, 10 mars 1910, 3.

⁵⁹ “Letrë nga Buenos Aires,” *Lirija*, nr. 87, Selanik, 8 maj 1910, 2.

Komiteti i kolonisë shqiptare në Sofje i konsideronte veprimet e qeverisë osmane si akte që binin në kundërshtim si me kushtetutën, ashtu edhe me dëshirën e kombit shqiptar. Sipas komitetit, kjo konfirmohej edhe nga mitingjet e shumta në mbështetje të alfabetit.⁶⁰

Nga xhonturqit, çështja e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabet latin u interpretua si një përpjekje e Austro-Hungarisë dhe e shteteve të tjera për të rritur influencën e tyre politike te shqiptarët. Prandaj, sipas tyre, perandoria duhej të mbrohej kundër këtij ekspansioni duke instrumentalizuar fenë. Për këtë arsye, patriotët shqiptarë botuan artikuj ku argumentonin se shkronjat e shqipes nuk kishin aspak lidhje me këtë problem.⁶¹ Ata i kërkuan qeverisë osmane që të subvenciononte jo vetëm shkollat që përdornin alfabetin arab, por edhe ato në të cilat mësohej alfabeti latin.⁶²

Shtypi xhonturk fliste gjerësisht për çdo miting që ishte pro alfabetit arab, duke ekzagjeruar numrin e pjesëmarrësve dhe duke e paraqitur çështjen sikur i gjithë populli shqiptar, me pak përjashtime, ishte në anën e tyre.⁶³ Mitingjet e organizuara në këtë periudhë, përveç çështjes së alfabetit dhe kufizimit të kërkesave të nacionalizmit shqiptar, kishin për qëllim të goditnin edhe deputetët shqiptarë që qëndronin në pozita patriotike.⁶⁴ Kjo lëvizje, e veshur me petkun fetar, përpiqej të nxiste fanatizmin e myslimanëve kundër Lëvizjes Kombëtare dhe të përçante shqiptarët e besimeve të ndryshme.⁶⁵ Në përgjithësi, këto mitingje përfunduan me disfatë dhe komprometuan edhe më tepër politikën antishqiptare të xhonturqve. Me nxitjen e drejtuesve të Partisë “Bashkim dhe Përparim”, më 6 mars 1910, disa shqiptarë turkomanë

⁶⁰ “Lëvizja dhe të reat e saja,” *Shqypja e Shqypnis*, nr. 19, Sofje, 11 mars 1910, 4.

⁶¹ “Feja me karakteret a ka të bënjtë,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 65, Janinë, 25 janar 1910, 1; “Cilat shkronja janë të shenjta,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 69, Janinë, 22 shkurt 1910, 2; “L’Albanais et l’écriture de sa langue,” *Shqipëtar*, nr. 11, Stamboll, 10 mars 1910, 1; Ndoci Çoba, “Shkronjat latinishte,” *Bashkimi*, nr. 9, Shkodër, 27 shkurt 1910, 1; *po ai*, “Gërmat arabishte,” *Bashkimi*, nr. 15, Shkodër, 10 prill 1910, 1-2.

⁶² “Konstitucioni ka liri,” *Zgjimi i Shqipërisë*, nr. 68, Janinë, 15 shkurt 1910, 1.

⁶³ HHSt.A.P.A.A. në *AIH*, Vj.20-13-1312. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemizca, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 24 mars 1910.

⁶⁴ Cana, “Reaksioni xhonturk kundër shkollës dhe shkrimit shqip”, 129.

⁶⁵ HHSt.A.P.A.A. në *AIH*, Vj.20-13-1312. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemizca, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 24 mars 1910.

formuan në Stamboll shoqërinë “Rrethi arsimor shqiptar” (“*Arnavud Mahfil mearifi*”), me në krye senatorin dhe klerikun Haxhi Ali Elbasani. Për këtë u njoftuan myftinitë dhe bashkitë e katër vilajeteve dhe iu kërkua që të vinin në dijeni të gjithë shqiptarët.⁶⁶ Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajti shefi i policisë së Stambollit, Galib Beu, i cili, me udhëzimet e drejtpërdrejta të qeverisë, mori përsipër të organizonte dhe të zhvillonte propagandë kundër shkrimit shqip, si edhe të punonte me të gjitha mjetet për çorientimin e lëvizjes shqiptare.⁶⁷ Pjesëmarrësit e kësaj shoqërie lidhën besën se në asnjë mënyrë nuk do t’i pranonin shkronjat latine. Me fjalimet e mbajtura nga kryetari, deputetët joshqiptarë dhe nënkryetari i parlamentit, u theksuan “lidhjet e shqiptarëve me atdheun osman”. Në rregulloren e shoqërisë parashikohej, ndër të tjera, hapja e një shtëpie botuese për shtypjen e librave dhe gazetave shqipe me alfabetin arab, si dhe shpërndarja e tyre kudo ku kishte shqiptarë.⁶⁸ Për të realizuar misionin e saj, Galib Beu dërgoi emisarët e tij në vise të ndryshme të Shqipërisë. Në fokus të punës së tyre ishte organizimi i tubimeve kundër alfabetit latin, me qëllim mbjelljen e përçarjes në mesin e klubeve shqiptare. Pavarësisht mjeteve që kishin në dispozicion, misioni i emisarëve të Galib Beut dështoi. Veprimtaria e shoqërisë së tyre u kufizua kryesisht në Stamboll dhe nuk vazhdoi gjatë. Drejtor i kësaj shoqërie u emërua Arif Hikmeti, i cili njëkohësisht drejtoi edhe organin e saj zyrtar, gazetën “Doğru Söz” (“Fjala e drejtë”). Në 49 numrat e kësaj gazete u propagandua shkrimi i shqipes me alfabet arab, si dhe interesat e politikës xhonturke. Kjo u vu re që në editorialin e parë të shkruar nga Arif Hikmeti, i cili theksonte rëndësinë e ruajtjes së identitetit osman nga shqiptarët.⁶⁹ Shoqëria i shtriu degët e saj në qytetet kryesore shqiptare. Drejtuesit e tyre ishin kryesisht klerikë ose nëpunës të administratës.⁷⁰ Përveç organeve të shtypit dhe propagandës, ajo botoi edhe një abetare shqip me shkronja arabe, me një tirazh që arrinte deri në 20 000 kopje.⁷¹

⁶⁶ “İttihâd-ı Osmanî Arnavud Maârif Mahfili,” *Tasvir-i Efkar*, İstanbul, 7 mars 1910, 3.

⁶⁷ Zekeria Cana, *Lëvizja kombëtare në Kosovë 1908-1912* (Prishtinë: Rilindja, 1979), 98.

⁶⁸ Cana, “Reaksioni xhonturk kundër shkollës dhe shkrimit shqip”, 109.

⁶⁹ Arif Hikmet, “Makasat ve Vazifemiz Fakat Nasıl Muvaffak Olacağız?,” *Doğru Söz*, İstanbul, 24 nëntor 1910, 1-2.

⁷⁰ Në shtator të vitit 1910 një degë e saj u themelua në qytetin e Durrësit. “Dıraç’ta Mahfil Şubesi,” *Doğru Söz*, İstanbul, 15 shtator 1910, 3.

⁷¹ “Arnavutça Tedrisat,” *Doğru Söz*, İstanbul, 30 mars 1911, 3.

Kundër saj u ngritën jo vetëm patriotët, por edhe studentët shqiptarë të Universitetit të Stambollit, të cilët formuan “Shoqatën e intelektualëve të rinj shqiptarë” dhe dolën hapur në mbrojtje të alfabetit kombëtar.⁷² Kjo e detyroi qeverinë xhonturke të ndryshonte taktikë. Për të vërtetuar “neutralitetin” e saj, vilajetit të Kosovës, Manastirit, Shkodrës, Janinës dhe Selanikut iu dërgua një telegram, në të cilin theksohej se, meqenëse shumë shqiptarë donin ta shkruanin gjuhën e tyre me shkronja të ndryshme, qeveria e linte të lirë këtë çështje.⁷³ Por kjo ishte një manovër që nuk përputhej me veprimet dhe qëndrimet e saj konkrete. Konsulli serb i Shkupit konstatoi se, megjithëse qeveria osmane kishte deklaruar se do të mbante një pozicion neutral, ajo bënte ç` ishte e mundur për të penguar pranimin e alfabetit latin.⁷⁴ Një politikë e tillë konfirmohej edhe nga një deklaratë e Vezirit të Madh, Ibrahim Hakki Pasha, i cili i tha një deputeti shqiptar se qeveria e konsideronte dëshirën e shqiptarëve për të adaptuar alfabetin latin si hapin e parë të shkëputjes nga Perandoria Osmane. Prandaj, ajo duhej të bënte çmos për të ndaluar përhapjen e tij.⁷⁵ Në vilajetin e Manastirit u dha urdhër që të përdorej abetarja shqipe me shkronja arabe,⁷⁶ e hartuar nga myftiu i Tetovës, Rexhep Efendiu (Hoxhë Voka).⁷⁷

Përpyjekjet e shqiptarëve për të mbrojtur alfabetin latin të gjuhës shqipe

Në pranverë të vitit 1910, lufta kundër alfabetit arab mori përmasa shumë të gjera. Kryesisë së parlamentit në Stamboll iu dërguan protesta

⁷² Cana, *Lëvizja kombëtare në Kosovë*, 98.

⁷³ “Shkronjat shqipe,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 21, Manastir, 10 shkurt 1910, 1.

⁷⁴ Shukri Rrahimi, “Qëndrimi i pushtetit turk ndaj çështjes së alfabetit,” në *Gjurmime albanologjike*, Seria historike I (Prishtinë: 1969): 19.

⁷⁵ Stavro Skendi, *The Albanian national awakening, 1878-1912* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 1967), 187; Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 144.

⁷⁶ “Arnavutluk'ta Hurûf Meselesi ve Hurûf-u Arabiye'nin Hükümetçe Kabulü,” *Sırât-ı Müstakim*, İstanbul, 3 mars 1910, 420.

⁷⁷ AQSH, F. 143, V. 1910, D. 1802, fl. 1-13. Abetare shqipe me shkronja arabe, e shkruar nga Rexhep Efendiu, 1910.

të ndryshme kundër propagandës që bëhej për alfabetin e gjuhës shqipe, si nga shtypi osman, ashtu edhe nga ndonjë deputet shqiptar.⁷⁸

Në atë kohë, përpara Lëvizjes Kombëtare u shtrua detyra për organizimin e një manifestimi të ri mbarëkombëtar. Për këtë qëllim u thirr Kongresi i Dytë i Manastirit me nismën e klubit qendror “Bashkimi”, i cili, me anën e një letre drejtuar klubeve dhe shoqërive shqiptare, i njoftonte se kishte vendosur që më 28 mars të mbahej një mbledhje e përgjithshme.⁷⁹ Në këtë kongres ftoheshin të merrnin pjesë ata shqiptarë që dëshironin përparimin e gjuhës së tyre dhe lulëzimin e Shqipërisë.⁸⁰ Për shkak të ardhjes me vonesë të disa delegatëve, kongresi u hap disa ditë më pas nga sa ishte parashikuar. Punimet u zhvilluan më 2-3 prill 1910.⁸¹ Në Kongresin e Dytë të Manastirit morën pjesë 20 delegatë, të cilët përfaqësonin klubet dhe shoqëritë e vilajeteve shqiptare të Manastirit, Kosovës, Shkodrës dhe Janinës, si dhe klubet shqiptare të Stambollit, Selanikut etj.⁸² Ai u përshëndet nga 40 telegrame nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga kolonitë shqiptare. Për mbajtjen e tij nuk u kërkuar leje nga vali, por, në përputhje me kushtetutën, ai u njoftua paraprakisht për këtë takim. Në pamundësi për ta penguar, vali u përpoq ta mbante nën kontroll, duke dërguar si përfaqësues komisar in e policisë.

Në këtë kongres u mbajtën fjalime me karakter patriotik dhe u shtruan për diskutim disa çështje të përgjithshme që kishin të bënin me situatën e krijuar kohët e fundit. Fjalimin kryesor e mbajti Dervish Hima, i cili, duke u ndalur gjerësisht te problemi i alfabetit dhe i gjuhës shqipe, nuk la mënjanë edhe çështjet me karakter politik. Ai analizoi marrëdhëniet e acaruara me xhonturqit dhe rreziqet e shkombëtarizimit e të copëtimit që i kërcënoheshin Shqipërisë nga shtetet e huaja, si Serbia, Greqia dhe Bullgaria. Gjithashtu, ai foli për kontributin e madh që

⁷⁸ *Po aty*, F. 143, V. 1910, D. 1794, fl. 1. Protestë drejtuar Kryesisë së Parlamentit në Stamboll lidhur me propagandën që bëhej kundër alfabetit të gjuhës shqipe nga ana e gazetës xhonturke “Tanin” dhe deputetit të Pejës, Mahmud Bedri Beu, 3 mars 1910.

⁷⁹ *Po aty*, F. 99, V. 1910, D. 173, fl. 1. Letër e Klubit qendror të Manastirit, drejtuar klubeve dhe shoqërive shqiptare për të dërguar delegatë në mbledhjen e Kongresit të Dytë të Manastirit, Manastir, 21 shkurt 1910.

⁸⁰ “Zëdhënje,” *Bashkimi i Kombit*, nr. 26, Manastir, 4 korrik 1910, 2.

⁸¹ HHSt.A.P.A.A. në *AIH*, Vj.20-10-1065. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfai, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 4 prill 1910.

⁸² “Arnauvud Kongresi,” *Tanin*, İstanbul, 6 prill 1910, 3; “Kongresi shqyptar në Manastir,” *Bashkimi*, nr. 10, Shkodër, 17 prill 1910, 4.

shqiptarët kishin dhënë gjatë revolucionit dhe zhgënjimin e tyre për shkak se xhonturqit nuk i kishin mbajtur premtimet e dhëna. Si shembull, ai përmendi ndërhyrjen në çështjen e alfabetit.⁸³

Delegatë të ndryshëm vunë në dukje se propagandimi i alfabetit arab dhe përpjekjet për t'ia imponuar atë kombit shqiptar kishin si qëllim që t'i përçanin ata dhe të pengonin përparimin e tyre. Kongresi miratoi 10 pika dhe një promemorie drejtuar organeve qeveritare xhonturke. Në këto dy akte përfshihen kryesisht çështje që lidheshin me zhvillimin dhe organizimin e arsimit dhe të klubeve shqiptare.⁸⁴ Në program parashikohej që në Stamboll të zgjidhej një pleqësi qendrore, midis të cilëve të kishte edhe disa deputetë shqiptarë.⁸⁵ Sipas Dervish Himës, kjo pleqësi do të ngarkohej me përgatitjen e një plani të përgjithshëm për drejtimin e arsimit shqiptar dhe për caktimin e një programi për mësimin e gjuhës shqipe.⁸⁶ Një detyrë tjetër e saj ishte të ndërmjetësonte pranë qeverisë për të gjitha çështjet kulturore shqiptare dhe t'i bënte të qartë Ministrisë së Arsimit se duhej të mbronte shkrimin kombëtar, si e vetmja rrugë për përparimin e Shqipërisë, si dhe të përpiqej të frenonte hovin e propagandës greke në Toskëri.⁸⁷ Përveç pikave të tjera, si krijimi i një shoqërie arsimore-shkencore, e cila do të kujdesej për botimin e teksteve shkollore; çelja e një normaleje në Shkup; botimi i një gazete shqipturqisht etj., me rëndësi për objektin tonë të studimit ishte se pleqësia konsultative pranë klubit qendror duhej të bisedonte me Sheh-ul-Islamin lidhur me shkronjat, ta bindte atë që alfabeti i gjuhës shqipe nuk përbënte rrezik për fenë islame dhe të nxirrte prej tij një fetva.⁸⁸ Parashikohej gjithashtu që kongresi t'i parashtronte qeverisë xhonturke një promemorie, për të cilën u diskutua gjerë e gjatë pas miratimit të vendimeve.⁸⁹ Ajo përmbante kryesisht çështje që lidheshin me alfabetin

⁸³ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-10-1065. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfai, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 4 prill 1910.

⁸⁴ "Kongresi i Manastirit," *Korça*, nr. 2, Korçë, 25 mars 1910, 1.

⁸⁵ Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996), 279.

⁸⁶ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-9-942. Raport i konsullit austro-hungarez në Selanik, Para, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 5 prill 1910.

⁸⁷ Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar*, 279.

⁸⁸ "Vendimet e mbledhjes së Manastirit," *Lirija*, nr. 81, Selanik, 9 prill 1910, 2.

⁸⁹ "Mbledhja e shqiptarëve në Manastir," *Bashkimi i Kombit*, nr. 29, Manastir, 28 mars 1910, 1-2.

dhe shkollat kombëtare.⁹⁰ Në radhë të parë kërkohej liri e plotë për mësimin e shqipes, në përputhje me parimet kushtetuese. Kongresi shprehej kundër politikës së qeverisë xhonturke dhe kërkonte që të respektoheshin të drejtat e shqiptarëve, duke i lejuar ata të punonin për përparimin dhe shkronjat kombëtare, sipas vendimeve të Kongresit të Dibrës, të cilat ishin pëlqyer nga qeveria. Në promemorie protestohej kundër atyre që thurnin intriga ndaj shkronjave kombëtare dhe shqiptarëve.⁹¹

Një nga pikat e kongresit, me interes për raportet e shqiptarëve me xhonturqit, shtronte detyrën përpara klubeve që të hartonin një peticion drejtuar Vezirit të Madh, me të cilin i kërkohej që qeveria e tij të mbante në fuqi vendimin që u lejonte atyre të ushtronin të drejtën e garantuar nga kushtetuta, për të mësuar dhe për të dhënë mësim në shkollat private shqiptare, por edhe në ato osmane (pika 9). Në përputhje me këtë, në pikën 10 të vendimit thuhej se Shqipëria jepte besën se do të mbronte me pasurinë dhe gjakun e saj qeverinë kushtetuese dhe Perandorinë Osmane kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, por njëkohësisht do të mbronte edhe të drejtat e saj kulturore, të cilat i ishin njohur prej kohësh. Ajo që të bën përshtypje është se Kongresi i Dytë i Manastirit vendosi që qendra e të gjitha klubeve të Shqipërisë të ishte në Stamboll.⁹² Ky vendim u mor nën ndikimin e Dervish Himës, i cili e argumentonte këtë me faktin se aty vepronte grupi i deputetëve shqiptarë, që në përbërjen e tij kishte atdhetarë të flaktë, si Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja etj. Ai mendonte, me shumë të drejtë, se në kryeqytetin e perandorisë duhej të formohej një udhëheqje e vetme politike e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ku do të bashkoheshin drejtuesit e klubeve dhe deputetët shqiptarë.⁹³ Kjo do të shërbente gjithashtu për të penguar përpjekjet e klubit që ishte krijuar me nxitjen e xhonturqve. Megjithatë,

⁹⁰ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-9-942. Raport i konsullit austro-hungarez në Selanik, Para, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 5 prill 1910.

⁹¹ “Mbledhja e shqiptarëve në Manastir,” *Tomori*, nr. 3, Elbasan, 31 mars 1910, 4; “Memoriale del Congresso Albanese di Monastir alla Sublime Porta,” *La Nazione Albanese*, nr. 8, Catanzaro, 15 maj 1910, 8.

⁹² HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-10-1065. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfai, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 4 prill 1910.

⁹³ Kristaq Pifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, (Tiranë: 8 Nëntori, 1987), 202-203.

kërkesa për zhvendosjen e qendrës nuk u pëlqye nga të gjitha rrethet patriotike.⁹⁴

Në Kongresin e Dytë të Manastirit, krahas mbledhjeve të hapura, u zhvilluan edhe takime të fshehta. Në fokus të tyre ishte zhvillimi i propagandës kombëtare, si dhe marrja e masave kundër politikës që qeveria xhonturke kishte ndjekur ndaj kombit shqiptar. Me propozimin e Dervish Himës u shtrua problemi i krijimit dhe forcimit të komiteteve të fshehta, i përgatitjes së kryengritjes së përgjithshme dhe i organizimit të demonstratave masive në mbrojtje të alfabetit. Pavarësisht arritjeve dhe qëllimeve që i vuri vetes, ky kongres shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të afirmimit të të drejtave kombëtare. Sipas konsullit austro-hungarez të Manastirit, ai do t'i bindte me siguri rrethet drejtuese të Perandorisë Osmane se nacionalizmi shqiptar ishte një faktor me të cilin duhej bërë llogari dhe që nuk mund të eliminohej aq lehtë.⁹⁵

Në diskutimet e zhvilluara në Kongresin e Dytë të Manastirit u ra dakord që, pas disa kohësh, të organizohej një kongres tjetër në Janinë. Por gjatë kësaj periudhe, për shkak të politikës dhe represionit xhonturk, në vilajetin e Kosovës shpërtheu kryengritja.⁹⁶ Një ndër shkaqet kryesore të saj ishte shtypja sistematike e kombësisë shqiptare dhe e gjuhës shqipe, si dhe qëndrimi i qeverisë ndaj alfabetit latin.⁹⁷ Për shtypjen e kësaj kryengritjeje u dërgua ministri i Luftës, Shefqet Turgut Pasha.⁹⁸ Në kundërshtim me deklaratën që kryeministri i bëri ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, se operacioni kishte si qëllim vetëm vendosjen e rregullit në Shqipëri dhe futjen dalëngadalë të popullit shqiptar në qarkun e kulturës,⁹⁹ Dervish Hima i shkruante në atë kohë nga Stambolli një personaliteti austriak se vija politike e Turqve të Rinj synonte zhdukjen e

⁹⁴ "Kongresi i Manastirit," *Dielli*, nr. 58, Boston, 6 maj 1910, 2.

⁹⁵ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-10-1065. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Posfai, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 4 prill 1910.

⁹⁶ Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi, İkinci Meşrûtiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1918-1918)*, Cilt.IX (Ankara: TTK, 1999), 246.

⁹⁷ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-14-1458. Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Stamboll, 3 prill 1910.

⁹⁸ Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk* (İzmir: 1944), 390-391.

⁹⁹ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-15-1522. Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Stamboll, 29 qershor 1910.

plotë të kombit shqiptar, të gjuhës, të njerëzve të shquar dhe të ekzistencës së tij politike.¹⁰⁰ Pas Kosovës, ekspedita e Shefqet Turgut Pashës kaloi në krahinat e tjera të Shqipërisë, duke mbyllur të gjitha klubet, shoqëritë, gazetatat dhe shkollat shqipe. Kjo u shoqërua me keqtrajtimin, arrestimin dhe burgosjen e personave që konsideroheshin si nacionalistë. Një pjesë e tyre u rrah dhe u torturua nën tingujt e bandës muzikore dhe në sytë e popullit. Kështu, në Shkup u arrestuan kryetari i klubit të atyshëm Beqir Efendiu dhe mësuesi i gjuhës shqipe Bedri Pejani; në Manastir, Fehim Bej Zavalani, vëllezërit Kristo dhe Dhimitër Qiriazi etj.; në Elbasan, Kristo Dako e Lef Nosi; në Dibër, Qamil Daci, në Tiranë, H. Ibrahim Dalliu, Mahmud Fortuzi, Jusuf Elezi etj.; në Durrës, dom Nikoll Kaçorri, si edhe shumë të tjerë në krahina dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë.¹⁰¹ Në kuadër të kësaj fushate antishqiptare të xhonturqve, krahas shkollave të tjera shqipe, u mbyll edhe Normalja e Elbasanit me pretekstin se aktiviteti i saj ishte i rrezikshëm për fenë dhe kushtetutën.¹⁰² Gjithashtu, u mbyll shtypshkronja “Bashkimi i Kombit” në Manastir, e cila nga valiu u konsiderua si shkak i gjithë kryengritjes dhe i rezistencës që hasi çarmatimi i popullsisë. Ai e konsideronte atë si luftëtarë e vijës së parë të alfabetit latin, që synonte të dëmtonte fenë islame.¹⁰³ Policia e Selanikut zhvilloi kontrollë ndaj shtypshkronjës “Mbrothësia” të Kristo Luarasi, i cili u detyrua ta transferonte përsëri në Sofje.¹⁰⁴ Ndërsa një numër i madh gazetash dhe revistash shqiptare u mbyllën me urdhër të qeverisë.

Në Tiranë, Shefqet Turgut Pasha shpalli shtetrrëthimin dhe ushtroi terror. Pas largimit nga qyteti, komandën ia dorëzoi kolonel Esat Beut, me qëllim që, në rast nevojë, të gjithë përgjegjësinë t’ia hidhte vartësit të tij.¹⁰⁵ Kjo ekspeditë u shoqërua me kontrollë, arrestime dhe rrahje

¹⁰⁰ *Po aty*, Vj.20-9-933. Letër e Dervish Himës drejtuar ambasadorit austro-hungarez, Pallavacini, Stamboll, 28 qershor 1910.

¹⁰¹ Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar*, 292.

¹⁰² Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit 1909-1912* (Tiranë: Albpaper, 2004), 258.

¹⁰³ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-13-1347. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemisza, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 27 gusht 1910.

¹⁰⁴ Uran Asllani, *Kristo P.Luarasi: jeta, vepra dhe familja e tij* (Tiranë: Plejad, 2009), 119-120.

¹⁰⁵ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-7-725. Raport i konsullit austro-hungarez në Durrës, Rudnay, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Durrës, 2 shtator 1910.

publike. Sipas konsullit austro-hungarez të Durrësit, të gjitha këto u bënë në bazë të akuzave të myftiut të Tiranës, i cili konsiderohej si një armik i betuar i patriotëve shqiptarë.¹⁰⁶ Tortura çnjerëzore iu bënë klerikut, patriotit dhe mësuesit të Normales së Elbasanit H. Ibrahim Dalliu, i cili u konsiderua tradhtar i atdheut dhe u dënua nga gjykata ushtarake.¹⁰⁷ Një kontroll i imtësishëm u bë edhe në shtëpinë e kryetarit të klubit shqiptar Refik Bej Toptani, ku u gjet libri i Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe çdo të bëhetë”. Në aktet gjyqësore thuhej se ky libër, me shumë kurajë të rrezikshme, paraqiste vetëqeverimin e Shqipërisë. Prandaj, poseduesi i tij u konsiderua si “kryetar i intrigave” dhe u dënua në mungesë me 15 vjet burg.¹⁰⁸

Në Vlorë shkoi personalisht valiu i Janinës, i cili shqyrtoi ankesat e ngritura kundër shkollës shqipe, e cila akuzohej për tendencë antipatriotike, duke rrënjosur në zemrat e fëmijëve urrejtje ndaj qeverisë dhe aspirata autonomiste. Ai bëri vërejtje, duke theksuar se emërimi i mësuesve të krishterë ishte kundër unitetit islamik; dha këshilla për çështjen e alfabetit dhe, me këtë rast, theksoi oportunitetin e shkronjave arabe.¹⁰⁹

Autoritetet qeveritare morën masa edhe ndaj mësuesve të gjuhës shqipe, duke i transferuar në provinca të largëta të perandorisë ose duke i pushuar nga puna. Kjo u shoqërua me favorizimin e elementëve proqeveritarë, siç ishte rasti i H. Sulejman Kungullit, i cili konsiderohej kundërshtari më i madh i alfabetit latin. Fillimisht, atij iu rrit rroga dhe më pas u emërua inspektor i shkollave fillore osmane në kazanë e Elbasanit.¹¹⁰

Qeveria xhonturke kishte planifikuar që, pas “aksionit të çarmatimit”, të riorganizonte në mënyrë unike sistemin arsimor. Sipas këtij plani, në të gjitha shkollat ekzistuese do të futej gjuha turke, ndërsa

¹⁰⁶ *Po aty*.

¹⁰⁷ Ibrahim Dalliu, *Patriotizma në Tiranë* (Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1930), 59.

¹⁰⁸ AQSH, F. 143, V. 1910, D. 928, fl. 1. Vendime të Gjyqit Ushtarak të Elbasanit për dënimin e anëtarëve të shoqërisë “Bashkimi”, ku, ndër të tjera, përmendet edhe gjetja e veprës së Sami Frashërit në shtëpinë e Refik Bej Toptanit, Elbasan, 14 shtator 1910.

¹⁰⁹ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-7-748. Raport i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Kolrus, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 12 gusht 1910.

¹¹⁰ “Nji shembull i shqiptarëve patriotë e tradhëtorë,” *Lirija*, nr.93, Selanik, 26 qershor 1910, 2.

frekuentimi i shkollave fillore do të bëhej i detyrueshëm për të gjithë.¹¹¹ Një politikë e tillë ishte në funksion të homogjenizimit të kombësive të ndryshme¹¹² dhe binte në kundërshtim me interesat e nacionalistëve shqiptarë.

Pavarësisht rezultateve që pati ekspedita e Shefqet Turgut Pashës për çarmatosjen e popullsisë dhe për vendosjen e rendit në vilajetet shqiptare, pasojat e saj ishin të jashtëzakonshme. Ajo i acaroi në kulm raportet e shqiptarëve me regjimin xhonturk. Sipas konsullit austro-hungarez të Manastirit, këto ngjarje i kishin afruar aq shumë shqiptarët e krahinave dhe të rrymave të ndryshme me njëri-tjetrin, sa nuk kishte arritur ta realizonte dot asnjë kongres, as gazetat dhe as agjitacioni i viteve të fundit.¹¹³ Politika e qeverisë xhonturke ngjalli indinjatë të thellë brenda dhe jashtë vendit.¹¹⁴ Në shtypin e kolonive shqiptare ajo u kritikua ashpër. Ndërsa në kryeqytetin osman më shumë se 200 studentë shqiptarë shprehën gatishmërinë për të braktisur auditorët dhe për të ardhur në Shqipëri.¹¹⁵ Mbyllja e shkollës Normale në Elbasan, e klubeve dhe e gazetave shqiptare i shtyu disa personalitete që qendrën e veprimtarisë së tyre ta zhvendosnin në shtete të tjera. Kështu, Luigj Gurakuqi dhe Dervish Bej Biçaku, në takimin që patën me ambasadorin austro-hungarez në Romë, i treguan atij se kishin ndër mend të çelnin përsëri Normalen në Bosnjë ose në Egjipt. Megjithëse shpenzimet për mbajtjen e saj do t'i siguronin nga kontributet vullnetare të shqiptarëve, ata i kërkuan Vjenës që t'i përkrahte në mënyrë dashamirëse, duke dhënë edhe ajo kontributin e saj. Mirëpo, si ambasadori austro-hungarez në Romë,

¹¹¹ *Po aty*, Vj.20-7-748. Raport i konsullit austro-hungarez në Vlorë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 12 gusht 1910.

¹¹² Yaşar Semiz, "İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Türkçülük Politikası," *Türkiyat Araştırmaları Dergisi*, Sayı. 35 (2014): 232.

¹¹³ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-13-1347. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemisza, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 27 gusht 1910.

¹¹⁴ *AQSH*, F. 96, V. 1910, D. 21, fl. 1. Thirrje e kolonisë shqiptare të Sofjes për përkrahjen e kryengritësve kosovarë dhe për të protestuar kundër qëndrimit të xhonturqve ndaj shqiptarëve, Sofje, 1910.

¹¹⁵ HHSt.A.PA.A. në *AIH*, Vj.20-9-973. Letër e Dervish Himës drejtuar ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, Stamboll, 28 maj 1910.

ashtu edhe Ballhausplatz-i, në parim ishin kundër çeljes së Normales në këto vende.¹¹⁶

Në disa lokalitete, administrata osmane mbajti një qëndrim më të butë ndaj kërkesave të Lëvizjes Kombëtare. Kjo varej shumë nga drejtuesit e vilajeteve dhe interesat e tyre politikë. Kështu, valiu i Janinës, Mustafa Zihnin Pasha, në një mbledhje që organizoi me mësuesit myslimanë të kazave të ndryshme, kërkoi ngritjen e shkollave të reja iptidaie (fillore), në të cilat do të mësohej edhe gjuha shqipe, por me alfabet arab. Në këtë mënyrë, ai mendonte t'i kundërvihej propagandës panheleniste.¹¹⁷

Në një thirrje që “Komiteti qendror i studentëve shqiptarë” në Stamboll u drejtoi qeverisë, shtypit dhe shteteve të huaja, dënohej persekutimi sistematik i xhonturqve dhe protestohej energjikisht kundër politikës së tyre tiranike. Në njërën prej pikave theksohej sulmi shovinist i Turqve të Rinj kundër patriotëve, publicistëve, shkollave e klubeve kombëtare, shtypshkronjave e organeve të shtypit, gjuhës dhe alfabetit shqiptar.¹¹⁸ Ndërsa patrioti dhe publicisti Mihal Grameno kërkonte nëpërmjet shtypit që qeveria xhonturke të ndryshonte politikën antishqiptare dhe i bënte thirrje parlamentit që t'i jepte kombit shqiptar diturinë dhe arsimin në gjuhën amtare.¹¹⁹

Në nëntor të vitit 1910, kur masat represive nuk kishin dhënë asnjë rezultat, u duk se qeveria xhonturke mori njëfarë kthese.¹²⁰ Në urdhrin telegrafik që i dërgoi vilajetit të Manastirit, ministri i Brendshëm Talat Pasha shkruante se shkollat shqipe të Korçës dhe të Elbasanit ishin mbyllur pa miratimin e qeverisë dhe në kundërshtim me kushtetutën. Prandaj, ato duhej të rihapeshin. Në telegram përmendej shprehimisht se ai nuk kishte urdhëruar asnjëherë mbylljen e Normales dhe se nuk e kishte miratuar vendimin e këshillit administrativ të vilajetit të Manastirit

¹¹⁶ *Po aty*, Vj.20-2-298. Letër e ambasadorit austro-hungarez në Romë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Romë, 4 tetor 1910.

¹¹⁷ *Po aty*, Vj.20-6-636. Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë, Bilinski, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Janinë, 27 tetor 1910.

¹¹⁸ AQSH, F. 143, V. 1910, D. 929, fl. 14. Thirrje e Komitetit Qendror të studentëve shqiptarë drejtuar shteteve europiane kundër regjimit xhonturk, Stamboll, 3 tetor 1910.

¹¹⁹ Mihal Grameno, “Çelja e parlamentit,” *Lirija*, nr. 103, Selanik, 26 nëntor 1910, 12.

¹²⁰ “Për shkollat shqipe,” *Lirija*, nr. 103, Selanik, 26 nëntor 1910, 2.

për këtë çështje. Për këtë arsye, ajo mund të çelej përsëri.¹²¹ Në vijim të kësaj politike, edhe vali u i Shkodrës deklaroi se lejohej të hapeshin shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe se ato ishin të lira të zgjidhnin alfabetin që preferonin. Në këtë linjë veproi edhe mytesarifi i Elbasanit. Këto lëshime u bënë për shkak të situatës politike. Konsulli austro-hungarez në Manastir i konsideronte ato si koncesione të rreme. Sipas tij, qarqet sunduese xhonturke donin të përparonin në rrugën panosmane dhe panislamiste dhe, në këtë kuadër, përpiqeshin të mashtronin shqiptarët me disa masa favorizuese.¹²²

Përfundime

Përplasja e shqiptarëve me xhonturqit lidhur me çështjen e alfabetit në harkun kohor shtator 1909 – dhjetor 1910 përbën fazën e parë të një konflikti, i cili u përqendrua kryesisht, nga njëra anë, në fushatën propagandistike në shtypin e kohës dhe, në anën tjetër, në masat konkrete që qeveria osmane ndërmori për të penguar institucionet arsimore të zbatonin këtë alfabet. Gjithashtu, kjo u shoqërua me një ekspeditë ushtarake dhe me dhunë strukturore të administratës xhonturke kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Një politikë e tillë ngjalli reaksion të kundërt të nacionalistët shqiptarë. Në qytete të ndryshme ajo u pasqyrua me mitingje, peticione dhe artikuj në shtypin e kohës. Për këtë arsye, xhonturqit në fund të vitit 1910 filluan të ndryshonin qëndrim, duke zbutur politikën represive ndaj elementit shqiptar.

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH)

¹²¹ HHSt.A.PA.A. në AIH, Vj.20-2-300. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemisza, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 25 nëntor 1910.

¹²² *Po aty*, Vj.20-13-1363. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Bornemisza, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Manastir, 19 dhjetor 1910.

Literaturë:

- Asllani, Uran. *Kristo P. Luarasi: Jeta, vepra dhe familja e tij*. Tiranë: Plejad, 2009.
- Cana, Zekeria. “Reaksioni xhonturk kundër shkollës dhe shkrimit shqip.” *Gjurmime albanologjike*, nr. 1. Prishtinë, 1969.
- Cana, Zekeria. *Lëvizja kombëtare në Kosovë 1908–1912*. Prishtinë: Rilindja, 1979.
- Çelik, Bilgin. *İttihatçılar ve Arnavutlar: II. Meşrutiyet Döneminde Arnavut Ulusçuluğu ve Arnavutluk Sorunu*. İstanbul: Buke Kitapları, 2004.
- Dalliu, Ibrahim. *Patriotizma në Tiranë*. Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1930.
- Karal, Enver Ziya. *Osmanlı Tarihi, İkinci Meşrutiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1908-1918)*. Cilt IX. Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1999.
- Myzyri, Hysni. *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996.
- Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasanit 1909-1912*. Tiranë: Albpaper, 2004.
- Olgun, Said. *Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*. Ankara: Gece Kitaplığı, 2016.
- Piraku, Muhamet. “Legalizimi i alfabetit të Manastirit.” *Përparimi*, nr. 11-12. Prishtinë: 1968.
- Prifti, Kristaq. *Dervish Hima (1872-1928)*. Tiranë: 8 Nëntori, 1987.
- Rrahimi, Shukri. “Qëndrimi i pushtetit turk ndaj çështjes së alfabetit.” *Gjurmime albanologjike*, Seria historike I. Prishtinë: 1969.
- Külçe, Süleyman. *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk*. İzmir, 1944.
- Skendi, Stavro. *The Albanian National Awakening, 1878-1912*. Princeton, NJ: Princeton University Press, 1967.
- Semiz, Yaşar. “İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Türkçülük Politikası.” *Türkiyat Araştırmaları Dergisi*, nr. 35 (2014).
- Sönmez, Banu İşlet. *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2007.

Gazeta dhe revista:

Bashkimi, Shkodër
Bashkimi i Kombit, Manastir
Dielli, Boston

Doğru Söz, İstanbul
Flamuri, Boston
Korça, Korçë
La Nazione Albanese, Catanzaro
Lidhja Orthodoxe, Korçë
Lirija, Selanik
Shqipëtar, Stamboll
Shqypja e Shqypënis, Sofje
Sırât-ı Müstakim, İstanbul
Tanin, İstanbul
Tasvir-i Efkâr, İstanbul
Tomorri, Elbasan
Zgjimi i Shqipërisë, Janinë

ASSOC. PROF. DR. HASAN BELLO

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
hasanbello1@gmail.com

S u m m a r y

THE CONFLICT OF ALBANIANS WITH THE YOUNG TURKS
ON THE ISSUE OF THE ALBANIAN ALPHABET
(SEPTEMBER 1909 – DECEMBER 1910)

The conflict over the Albanian language alphabet between Albanian nationalists and the Young Turks marked a decisive turning point in Albanian-Ottoman relations. What began as a technical debate over scripts quickly turned into an open ideological and political battle over national identity, religious unity, and cultural autonomy. The Young Turks, by instrumentalizing religion and the Arabic alphabet to preserve Ottoman unity and hinder the emancipation of the Albanian nation, provoked widespread popular resistance ranging from massive rallies to armed uprisings. This clash ultimately resulted in: the strengthening of national consciousness; the unification of Albanians around the Latin alphabet as a symbol of cultural independence; and the acceleration of the collapse of the illusion of coexistence within the Ottoman Empire following the Young Turk Revolution.

Keywords: Albanian nationalism, Young Turks, albanian alphabet, Albanian National Movement.

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
ledia_dushku@yahoo.com

REGJIMET E PUSHTIMIT DHE SHOQËRITË LOKALE: NJË QASJE SOCIOPOLITIKE MBI KRAHINËN AUTONOME TË KORÇËS

Abstrakt:

Artikulli analizon regjimin francez të pushtimit në Shqipërinë Juglindore gjatë Luftës së Parë Botërore, duke e vendosur atë në kuadrin e prapavijës së luftës si hapësirë qeverisjeje, mobilizimi dhe shndërrimi shoqëror. I fokusuar në Krahinën Autonome të Korçës (1916-1918), studimi e trajton zonën franceze si territor prapavije, ku dhuna e drejtpërdrejtë ishte relativisht e kufizuar, ndërsa kontrolli ushtarak dhe ndërhyrja administrative depërtonin sistematikisht në jetën civile.

Prapavija paraqitet si hapësirë me funksion të dyfishtë: njëkohësisht zonë shfrytëzimi logjistik për frontin e Selanikut dhe terren eksperimental për forma të reja administrimi përmes një autonomie të mbikëqyrur. Analiza shqyrton ndikimin e kësaj logjike në mobilizimin ekonomik dhe njerëzor të popullsisë (rekuizime, punime infra-strukturore, furnizim të trupave dhe riorganizim të shërbimeve publike), si edhe në procese reformuese ku dallon hapja e institucioneve arsimore në gjuhën shqipe. Këto dinamika bashkëjetuan me censurë dhe kufizim të lirive politike. Studimi argumenton se, në kushtet e prapavijës, pushtimi ushtarak nuk funksionoi vetëm si mekanizëm kontrolli, por edhe si proces riorganizimi shoqëror dhe institucional.

Fjalë kyçe:

Regjime pushtimi, prapavija e luftës, Krahina Autonome e Korçës, shoqëri lokale, shndërrime institucionale.

Prapavija e luftës si laborator qeverisjeje: Regjimet e pushtimit dhe shoqëritë lokale

Në historiografinë bashkëkohore të Luftës së Parë Botërore, regjimet e pushtimit përkufizohen si forma të administrimit dhe kontrollit ushtarak të një territori nga një fuqi e huaj gjatë një konflikti të armatosur. Ato përfaqësojnë sisteme të ndërlikuara pushteti që ndërthurin forcën, represionin, negocimin dhe bashkëpunimin e imponuar, me qëllim ruajtjen e kontrollit mbi territorin dhe popullsinë e pushtuar, administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore e njerëzore vendase, si edhe minimizimin e çdo forme rezistence që mund të sfidojë autoritetin e pushtuesit.¹

Nën mbikëqyrjen e strukturave ushtarake, këto regjime shpesh shoqërohen nga forma të përkohshme administrimi civil, apo bërthama të kësaj natyre, të cilat synojnë sigurimin e stabilitetit, funksionimin e përditshëm të territorit dhe krijimin e kushteve për një kontroll sa më efikas të shoqërisë lokale. Si të tilla, ato nuk analizohen vetëm si mekanizma represivë apo instrumente të dominimit ushtarak, por edhe si forma të veçanta qeverisjeje që ndërhyjnë në strukturat sociale, ekonomike dhe institucionale të shoqërive vendase. Në këtë kuptim, pushtimi shfaqet si një proces dinamik që prodhon transformime afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat shpesh tejkalojnë synimet e tij fillestare dhe dalin përtej kornizës së planifikimit të autoriteteve pushtuese.

Duke u fokusuar në Ballkanin e Luftës së Parë Botërore, rajoni u përball me një mozaik regjimesh pushtimi që pasqyronin interesat

¹ Për një diskutim mbi analizimin e regjimeve të pushtimit si forma qeverisjeje gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: Pieter M. Judson, *The Habsburg Empire: A New History* (Cambridge, MA: Belknap Press of Harvard University Press, 2016); *State, Society and Mobilization in Europe during the First World War*, edited by John Horne (Cambridge: Cambridge University Press, 1997); *Total War and Social Change*, edited by Arthur Marwick (London: Palgrave Macmillan, 1988); Tamara Scheer, "Similarities and Particularities of Habsburg Occupation Regimes during the First World War (with a Special Reference to Serbia)," *The First World War and the Balkans: Historic Event, Experience, Memory*, edited by Wolfgang Höpken & Wim van Meurs (Bern: Peter Lang, 2018), 41-58.

ushtarakë, politikë dhe ideologjikë të Fuqive të Mëdha ndërluftuese.² Austro-Hungaria, Gjermania, Italia dhe Franca zbatuan modele të ndryshme administrimi, të cilat nuk ishin as homogjene, as statike, por ndryshonin në varësi të kontekstit lokal, raporteve të forcës dhe marrëdhënieve të ndërtuara me popullsitë vendase. Për shembull, Austro-Hungaria dhe Gjermania vendosën regjime ushtarake në Serbi dhe Rumani, me synim kontrollin e infrastrukturës dhe të burimeve strategjike që mbështesnin përpjekjet e tyre luftarake, duke treguar interes të kufizuar për ndërtimin e strukturave civile apo politike afatgjata. Këto regjime karakterizoheshin nga represioni i ashpër, shkatërrimi i infrastrukturës dhe eksodeve të popullatave vendase. Në kontrast me to, Italia synoi një aneksim më të qëndrueshëm të territoreve të pushtuara, duke zbatuar politika që synonin vendosjen e kontrollit të drejtpërdrejtë territorial, me objektivin e ruajtjes së influencës edhe pas përfundimit të luftës.³ Franca, nga ana tjetër, ndonëse në një kontekst të ndryshëm strategjik, eksperimentoi forma administrimi që shkonin përtej pushtimit thjesht ushtarak, duke synuar krijimin e regjimeve autonome, të cilat reflektonin interesat e saj të menjëhershëm ushtarakë, por edhe përhapjen afatgjatë të ndikimit kulturor dhe politik në rajon.⁴

² Për regjimet e pushtimit në Ballkan gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: James Lyon, *Serbia and the Balkan Front, 1914: The Outbreak of the Great War* (London - New York: Bloomsbury Academic, 2015); Judson, *The Habsburg Empire: A New History*; Scheer, "Similarities and Particularities of Habsburg Occupation Regimes", 41-58.

³ Për politikën italiane në vitet e Luftës së Parë Botërore, shih: Pietro Pastorelli, *Dalla prima alla seconda guerra mondiale. Momenti e problemi della politica estera italiana 1914-1943* (Milano: LED Edizioni Universitarie, 1998); Massimo Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939). La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'operazione Oltre mare Tirana* (Milano: Franco Angeli, 2007); Francesco Caccamo, "Italy, the Adriatic and the Balkans: From the Great War to the Eve of the Peace Conference," *Italy in the Era of the Great War Series: History of Warfare*, vol. 120, Volume Editor: Vanda Wilcox (Brill 2018).

⁴ Për politikën franceze të administrimit dhe konceptin e "pushtimit moral" gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: Demetre Kolovani, *La Question de Koritza* (Paris: Imprimeria Henri Diéval, 1920); General Sarrail, *Mon commandement en Orient (1916-1918)*, (Paris: Ernest Flammarion, 1920); *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, vëll. I (Shqipëria dhe Maqedonia), shkrime të kolonelit Andre Ordion, paraqitur nga nipi i tij Dominique Danguy des Deserts (Tiranë: Papirus, 2014), 158-376; Général Descoins, *Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917). Revue d'histoire de la guerre mondiale (Extrait des numéros d'octobre 1929 et janvier 1930)* (Paris: Alfre Costes, Éditeur, 1930), 5-58; Ștefan Popescu, "Les Français et la République de Körtcha (1916-1918)," *Guerres mondiales et conflits contemporains*, no. 213 (2004):

Një aspekt thelbësor i regjimeve të pushtimit lidhet me pozicionimin e tyre hapësinor në raport me vijën e frontit, nëse ato funksionojnë si territore frontale apo si zona prapavije. Ndryshe nga hapësirat e ekspozuara ndaj përplasjes ushtarake në vijën e parë të frontit, ku dhuna, shkatërrimi dhe zhvendosjet masive të popullsisë janë elemente përbërëse të përditshmërisë, prapavija vepron si një hapësirë ku lufta përjetohet kryesisht përmes presioneve strukturore, ekonomike dhe administrative. Ajo është po aq vendimtare sa vetë fronti, pasi funksionimi i saj garanton mbijetesën logjistike, organizative dhe morale të përpjekjeve ushtarake.⁵

Për këtë arsye, regjimet e pushtimit në prapavijë synojnë jo vetëm kontrollin territorial, por edhe rregullimin e jetës shoqërore, ekonomike dhe institucionale të popullsisë lokale, duke e shndërruar atë në një komponent funksional të luftës. Pikërisht në këto hapësira, pushtimi tenton të marrë forma më komplekse qeverisjeje, ku kontrolli ushtarak shoqërohet edhe me administrim funksional e mekanizma që synojnë të “bëjnë për vete” shoqërinë lokale. Si rezultat, prapavija e luftës krijon një formë të veçantë presioni shoqëror, pasi nuk e shkatërron tërësisht jetën civile, por e riorganizon atë në funksion të nevojave ushtarake.

Në këtë proces, kufiri midis jetës civile dhe asaj ushtarake zbehet, pasi shoqëria vendase shndërrohet në një aktor të nënshtuar, por njëkohësisht mbështetës dhe të domosdoshëm për funksionimin e luftës. Kjo e bën prapavijën jo vetëm një hapësirë kufizimesh, por edhe një terren ndërhyrjesh strukturore. Funksioni i saj mbështetës krijon mundësi për investime infrastrukturore dhe organizative, të cilat, ndonëse të diktuar nga nevojat ushtarake, prodhojnë pasoja afatgjata për vendasit.

77-88; Alexis Palaticy, *La zone d'occupation française en Albanie (1916-1920)*, Universita Marc Bloch Sciences Humaines, UFR des Sciences Historiques, Strasbourg: 2002 (tezë doktorature). Materiali është konsultuar në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë (AIH), A-IV-472; Stefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, thèse de doctorat (3e cycle) en histoire (Paris: Université Paris I Panthéon-Sorbonne, 2013), 51-150; Ledia Dushku, “Nga ‘armike’ në ‘mike dhe burim qytetërimi’: Dualizmi në perceptimin e shqiptarëve për Francën,” *Studime historike*, 3-4 (2017): 62-78.

⁵ Për prapavijën si hapësirë administrative, ekonomike dhe shoqërore me rëndësi gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: *State, Society and Mobilization in Europe; Total War and Social Change*; Susan R. Grayzel, *At Home and Under Fire: Air Raids and Culture in Britain from the Great War to the Blitz* (Cambridge: Cambridge University Press, 2012), 1-19.

Ndërtimi i rrugëve, përmirësimi i komunikimit dhe zhvillimi i shërbimeve bazë, ku përfshihet edhe shëndetësia, bëhen pjesë e një procesi transformues, gjurmët e të cilit mbeten të dukshme edhe pas përfundimit të luftës apo pushtimit. Për rrjedhojë, prapavija nuk përbën vetëm një hapësirë të shfrytëzimit ushtarak, por edhe një mjedis ku marrin formë procese të qëndrueshme ndryshimi shoqëror dhe institucional.

Pikërisht ky karakter i dyfishtë i prapavijës shërben si pikënisje për një interpretim më të gjerë të përvojës shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Ai përbën çelësin interpretues për të kuptuar marrëdhënien midis regjimeve të pushtimit dhe shoqërisë shqiptare, e cila në të tria zonat – austro-hungareze, italiane dhe franceze – funksionoi kryesisht si prapavijë e luftës. Brenda këtij kuadri krahasues, rasti i Shqipërisë Juglindore, e posaçërisht i Krahinës Autonome të Korçës, ofron një shembull domethënës për të analizuar mënyrën se si një fuqi pushtuese sikurse Franca, ndërton një regjim prapavije në një kontekst lokal të fragmentuar, nëpërmjet ndërveprimit me strukturat dhe pritshmëritë e shoqërisë vendase. Artikulli nuk e trajton pushtimin dhe administrimin francez si një raport statik dominimi, por si proces dinamik negocimi dhe ndryshimi, i formësuar njëkohësisht nga nevojat e luftës dhe nga kapacitetet përshtatëse të aktorëve lokalë. Duke e përdorur Krahinën Autonome të Korçës si rast studimi, analiza fokusohet te praktikat dhe teknikat konkrete të qeverisjes, administrimit dhe ndërhyrjes sociopolitike, në kushtet e një territori në prapavijë lufte.

Kjo qasje e zhvendos analizën nga niveli thjesht politik drejt një perspektive më të gjerë sociohistorike. Deri më tani, literatura shqiptare dhe ajo e huaj e ka trajtuar Krahinën Autonome të Korçës kryesisht në dimensionin e saj politik dhe diplomatik, duke u përqendruar në rivalitetet ndërraleate, në strategjinë franceze në Ballkan apo në rolin e elitave nacionaliste shqiptare në kuadrin e çështjes kombëtare. Ndërkohë, dimensionin social i pushtimit, ndikimi i tij në strukturat ekonomike, në organizimin e jetës së përditshme, në marrëdhëniet ndërkomunitare, në formimin e administratës vendore, në krijimin dhe funksionimin e institucioneve lokale, ka mbetur thuajse i patrajtuar. Pikërisht në këtë nivel bëhet i dukshëm roli i ushtrisë, që shfaqet jo vetëm si forcë luftarake, por edhe si aktor qendror në organizimin e jetës së përditshme, duke ndërhyrë në rregullimin e marrëdhënieve ekonomike e shoqërore, në administrimin e territorit dhe në ndërveprimin e vazhdueshëm me

popullsinë vendase. Përmes këtyre ndërhyrjeve, prapavija shndërrohet në një hapësirë qeverisjeje. Nisur nga kjo perspektivë, artikulli propozon një qasje që analizon ndërthurjen midis kontrollit ushtarak dhe shndërtimeve shoqërore. Shoqëria lokale nuk shihet vetëm si objekt i politikave të pushtimit, por edhe si aktor që negocion, përshtatet dhe përvetëson forma të reja organizimi institucional. Kësisoj, plotësohet një boshllëk historiografik mbi zonën franceze dhe Luftën e Parë Botërore në tërësi, duke e zhvendosur vëmendjen analitike nga dimensionin politik drejt ndërveprimit midis pushtimit, shoqërisë dhe jetës së përditshme.

Interesat francezë për zonën e Korçës dhe bashkëpunimi me vendasit

Përfshirja e Francës në skenën ballkanike gjatë Luftës së Parë Botërore nuk ishte e menjëhershme, por rezultat i një procesi të ndërlikuar, rrjedhojë e zhvillimeve ushtarake dhe diplomatike.⁶ Pas dështimit të ofensivave të para të Antantës në frontin perëndimor dhe kostove të larta njerëzore që shoqëruan betejat e vitit 1915, vëmendja franceze filloi të zhvendosej drejt Ballkanit, tashmë i konceptuar jo vetëm si një front i dytë, por edhe si një zonë e rëndësishme për ruajtjen e ekuilibrave ushtarakë dhe politikë në Europën Juglindore. Kjo qasje u konkretizua në tetor të vitit 1915 me zbarkimin e trupave në Selanik dhe themelimin e Armatës së Lindjes (Armée d'Orient), në bashkëpunim me trupat britanike, italiane dhe, më vonë, ato serbe.⁷

Prania ushtarake aty nuk ishte vetëm rezultat i një riorientimi strategjik, por u ushqye edhe nga zhvillimet në terren, veçanërisht nga

⁶ Për një pasqyrë të përgjithshme mbi strategjinë ushtarake dhe diplomatike të Francës gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: Jean-Jacques Becker, *The Great War and the French People*. Translated from the French by Arnold Pomerans. With an introduction by Jay Winter (New York: St. Martin's Press: 1986); Stéphane Audoin-Rouzeau and Annette Becker, *14-18: Understanding the Great War*. Translated from the French by Catherine Temerson (New York: Hill and Wang, 2002); Robert A. Doughty, *Pyrrhic Victory: French Strategy and Operations in the Great War* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 2008).

⁷ Për themelimin e Armatës së Lindjes dhe funksionimin e frontit të Selanikut, shih: Sarraïl, *Mon commandement en Orient*, 15-25; Alan Wakefield and Simon Moody, *Under the Devil's Eye: Britain's Forgotten Army in Salonika 1915-1918* (The History Press, 2004).

kolapsi i frontit serb, në fund të vitit 1915. Pushtimi i Serbisë dhe i Malit të Zi nga trupat austro-hungareze dhe bullgare solli largimin e përkohshëm nga skena të dy aktorëve të rëndësishëm ballkanikë. Kjo tronditje në ekuilibrat rajonalë u perceptua dhe u artikulua në diskursin ushtarak francez si një kërcënim për stabilitetin e frontit juglindor dhe, rrjedhimisht, si një ftesë për ndërhyrje të drejtpërdrejtë në territore që deri atëherë ishin lënë nën ndikimin e fqinjëve me pretendime të qarta territoriale, sikurse ishte Greqia. Kësisoj, Shqipëria Juglindore, dhe në mënyrë të veçantë rajoni i Korçës, u identifikua si një hapësirë e brishtë, por me rëndësi tranzitore dhe ndikim të mundshëm gjeopolitik; si një pikë nevralgjike ku mbivendoseshin interesa strategjike, politike dhe kulturore.⁸

Korça, e pushtuar nga trupat greke që në vitin 1914, ndodhej në një pozitë të vështirë. Nga njëra anë, Mbreti i Greqisë, Konstandin, i lidhur me dinastinë gjermane dhe me simpati të shprehura për Bllokun Qendror, ndiqte një politikë të neutralitetit aktiv, e cila minonte përpjekjet e Antantës në rajon. Nga ana tjetër, nacionalistët venizelistë synonin të konsolidonin kontrollin mbi Shqipërinë e Jugut, duke e përdorur praninë ushtarake në hapësirën shqiptare si mjet presioni për të forcuar pretendimet territoriale.⁹ Për të shmangur përplasjen midis këtyre dy grupimeve rivale, Franca vendosi të ndërhynte vetë në territorin shqiptar. Njëkohësisht, ajo synoi të mbante larg Shqipërisë Juglindore zgjerimin italian, i cili rrezikonte të komplikonte balancat mes dy aleatëve të Antantës.¹⁰

Vendimi i marrë në qershor të vitit 1916 nga komandanti i Armatës së Lindjes, gjenerali Maurice Sarrail, për të pushtuar Korçën dhe zonat përreth, ishte i motivuar nga konsiderata të qarta strategjike.¹¹ Ai synonte

⁸ Popescu, "Les Français et la République de Kortcha", 77-87.

⁹ Në lidhje me përplasjen mes dy krahëve të politikës greke gjatë Luftës së Parë Botërore, shih: Michael Llewellyn Smith, *Ionian Vision: Greece in Asia Minor, 1919-1922* (London: Hurst & Company, 1973), 12-18; George B. Leon, *Greece and the Great Powers, 1914-1917* (Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1974), 25-40; Paschalis M. Kitromilides, *Eleftherios Venizelos: The Trials of Statesmanship* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 2006), 77-90.

¹⁰ Isa Blumi, "Albania," in *International Encyclopedia of the First World War 1914-1918* – online, <https://encyclopedia.1914-1918-online.net/article/albania/> (shikuar më 10 shkurt 2023); Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France*, 87-88.

¹¹ Territori nën kontrollin francez në Shqipërinë Juglindore arriti shtrirjen e tij maksimale më 10 shtator 1917, pas marrjes së Pogradecit me një numër total popullsie

të mbronte krahun e majtë të frontit të Selanikut dhe të ndërpriste linjën kritike të komunikimit Pogradec–Korçë–Janinë, e cila mundësonte lidhjen mes forcave të Bllokut Qendror dhe kundërshtarëve të Antantës në Greqi. Krahas këtij objekti ushtarak, operacioni francez kishte një dimension politik të theksuar: të ndalonte përplasjet ndërraleate për kontrollin e territorit shqiptar, “të krijonte një zonë qetësie të plotë në Korçë” dhe ta paraqiste Francën si një fuqi rregullatore e të paanshme në rajon.¹²

Megjithatë, ndërhyrja franceze nuk ishte e kufizuar vetëm në logjikën ushtarake. Ajo u shoqërua nga një projekt politik dhe kulturor që synonte të zbatonte atë që në doktrinën republikane franceze njihej si “pushtim moral” (*occupation morale*) – një projekt që nuk kërkonte aneksim territorial, por përhapjen e modelit francez të qeverisjes, rendit dhe qytetërimit.¹³ Në kuadrin e kësaj politike, shqiptarët nuk u trajtuan vetëm si popullsi e nënshtruar ndaj pushtimit, por edhe si bashkëpunëtorë të mundshëm në ndërtimin e një rendi të ri administrativ e shoqëror, për aq kohë sa garantonin stabilitetin dhe neutralitetin e zonës.

Ndryshe nga Italia dhe Greqia, të cilat kishin pretendime të hapura territoriale mbi Shqipërinë, ushtarakët francezë zgjodhën të aplikonin një formë ndërhyrjeje të përkohshme, duke ofruar për komunitetin lokal një model “vetëqeverisjeje” që synonte t’i afronte shqiptarët me interesat francezë të momentit.

Kjo taktikë u mishërua nga koloneli H. Descoins, i cili u dërgua në Korçë në nëntor të vitit 1916 në krye të misionit ushtarak francez. Në vend që të mbështetej te strukturat ekzistuese greke, ai zgjodhi të vepronte hapur me parinë shqiptare. Ky bashkëpunim synonte të ulte kostot administrative dhe njerëzore të pushtimit, si dhe të reduktonte

prej 122 315 banorësh, nga të cilët 40 070 të krishterë dhe 82 245 myslimanë. Popescu, *L’Albanie dans la politique étrangère de la France*, 92; Kolovani, *La Question de Koritza*, 38-39.

¹² Brendon Salih, “Aventura e krahinës autonome dhe dinamikat e administrimit të rajonit të Korçës, nën protektoratin francez (1916-1920),” *Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike* (Përmbledhje e artikujve të Konferencës shkencore ndërkombëtare në përkujtim të 110-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe 108-vjetorit të vetëqeverimit të Korçës), organizuar nga Universiteti “Fan Noli” me mbështetjen e Këshillit të qarkut, Korçë, më 6-7 dhjetor 2024, përgatiti për botim Eftiona Bylykbashi (Tiranë: Vassi, 2025), 72; Descoins, *Six mois d’histoire de l’Albanie*, 10, 13-21, 54-55.

¹³ Dushku, “Nga ‘armike’ në ‘mike dhe burim qytetërimi’”, 62.

rrezikun e rezistencës së hapur. Përfshirja e elitës lokale nuk synoi transferimin real të sovranitetit, por garantimin e funksionalitetit të pushtetit ushtarak. Me mbështetjen e figurave nacionaliste me ndikim, ku spikatnin Themistokli Gërmenji, Sali Butka e Qamil Panariti, koloneli Descoins ndërtoi një “aleancë” funksionale që synonte garantimin e rendit dhe bashkëpunimin me objektiva të përbashkët. Mbështetja e vendasve do të arrihej duke u ofruar atyre një formë “vetëqeverisjeje”, në këmbim të së cilës do të siguroheshin resurse natyrore dhe njerëzore në mbështetje të Armatës së Lindjes.¹⁴ Kësisoj, bashkëpunimi nuk ishte produkt i një simpatie ideologjike, por një marrëveshje pragmatike ndërmjet një fuqie ushtarake të orientuar në stabilitetin e zonës dhe një elite nacionaliste që kërkonte të mbronte interesat kombëtarë dhe të shmangte copëtimin e territorit.

Për të gjitha sa më sipër, ndërhyrja franceze në zonën e Korçës ishte rrjedhojë e një ndërthurjeje faktorësh: ushtarako-strategjikë, për të mbrojtur frontin e Selanikut; diplomatikë, për të frenuar ndërhyrjen greke dhe italiane; gjeopolitikë, për të krijuar një zonë të qëndrueshme në një hapësirë të kontestuar; dhe ideologjikë, për të përhapur modelin republikan francez, si edhe konceptin e “misionit civilizues”. Ky i fundit zbatohej në mënyrë të përzgjedhur në një territor që, ndonëse nuk ishte pjesë e territoreve me statuse të ndryshme koloniale, u trajtua si një hapësirë ku Franca mund të projektonte vlerat e saj politike dhe administrative pa ndërhyrë formalisht në sovranitetin e vendit.

Ndërtimi i një regjimi në prapavijë të frontit: Krahina Autonome e Korçës (1916-1917)

Bashkëpunimi me korçarët u konkretizua më 10 dhjetor 1916, me krijimin e “Krahinës Autonome të Korçës”, e cila njihet edhe si “Republika Shqipëtare e Korçës”.¹⁵ Ky akt institucionalizoi një regjim të

¹⁴ Kaliopi Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve “Adriatiku” dhe “Gazet’ e Korçës” (dhjetor 1916-gusht 1918). Trajtesë dhe Dokumente* (Tiranë: Kristalina-KH, 2017), 42-43; Shaban Sinani, “Korça në ditarët e komandantëve ushtarakë francezë dhe italianë,” në Konferencën shkencore *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës* (Korçë: Promo Print, 2016), 68.

¹⁵ Për një trajtim të detajuar në lidhje me Krahinën Autonome të Korçës / Republika Shqipëtare e Korçës dhe politikën e ndjekur nga ushtarakët dhe diplomatët francezë, shih: Muin Çami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë (1916-1920)*, (Tiranë: Dituria,

përkohshëm qeverisjeje lokale nën mbrojtjen e ushtarakëve francezë, duke i dhënë një formë të strukturuar marrëdhënies së ndërtuar mbi interesat reciprokë. Në kontekstin e një Shqipërie të fragmentuar politikisht dhe të pushtuar ushtarakisht, kjo formë qeverisjeje, megjithëse e kufizuar në hapësirë dhe kohë, u perceptua nga vendasit si një mundësi për të afirmuar jo vetëm identitetin kulturor dhe gjuhësor, por edhe aspiratën për përfaqësim politik dhe kombëtar.

Administrimi francez në zonë funksionoi mbi parimin e delegimit të kufizuar të kompetencave. Strukturat vendore kishin hapësirë veprimi në çështje të administrimit të përditshëm, por vendimmarrja strategjike mbetej gjithnjë në duart e autoriteteve ushtarake franceze. Ky mekanizëm krijoi një formë autonomie të kontrolluar, e cila siguronte funksionimin e shoqërisë pa rrezikuar interesat ushtarake të pushtuesit. Sipas dispozitave të protokollit, rajoni – ku, krahas qytetit të Korçës, përfshihej edhe Bilishti, Kolonja, Gora dhe Opari – do të administrohej nga një këshill vendas i përbërë prej 14 anëtarësh (shtatë myslimanë dhe shtatë të krishterë), me një ndarje të baraspeshuar konfesionale që synonte të ruante paqen sociale dhe kohezionin komunitar. Një oficer francez, i deleguar nga komanda e Armatës së Lindjes, do të qëndronte vazhdimisht pranë tij si përfaqësues mbikëqyrës dhe garant i linjës ushtarake. Administrata civile dhe xhandarmëria përbëheshin nga shqiptarë, të cilët ishin nën kontrollin operacional të autoriteteve franceze, duke reflektuar modelin e një protektorati të butë në formë, por me theks të qartë në mbikëqyrjen ushtarake. Ato u organizuan sipas parimit të hierarkisë dhe përgjegjësisë, ku çdo nivel kishte kompetenca të përcaktuara qartë, por mbetej i varur nga kontrolli i komandës ushtarake.

Një element qendror i këtij modeli ishte normalizimi i pushtetit përmes rregullimit të jetës së përditshme. Procedurat, urdhrat e shkruar, afatet, regjistrat dhe hierarkia burokratike shërbenin si mjete kontrolli po aq të rëndësishme sa edhe prania ushtarake. Disiplina administrative kishte kështu një funksion të dyfishtë: nga njëra anë, garantonte zbatimin e urdhrave të pushtetit ushtarak; nga ana tjetër, krijonte ndjesinë e rendit dhe stabilitetit në një shoqëri të tronditur nga lufta. Qëllimi nuk ishte mobilizimi politik i popullsisë, por administrimi dhe disiplinimi i saj në funksion të ruajtjes së rendit; për këtë arsye, administrata vendore u

shndërrua në mekanizmin kryesor të ndërmjetësimit midis pushtetit ushtarak dhe shoqërisë lokale.

Në këtë vazhde, regjimi i ri njohu gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare të administratës dhe lejoi ngritjen e flamurit shqiptar, të shoqëruar nga një dekor simbolik francez në anë të tij. Përcaktimi i rotacionit të kryetarit të këshillit midis komunitetit mysliman dhe atij të krishterë, si dhe praktika e zëvendësimit konfesional të anëtarëve, tregojnë për një përpjekje për të institucionalizuar tolerancën fetare dhe për të shmangur përçarjen sociale në një rajon që kishte vuajtur nga tensionet e luftërave ballkanike (1912-1913) dhe zhvillimet që pasuan.

Autoritetet franceze u përpoqën të ruanin ekuilibrin fetar, duke mos favorizuar asnjërin prej komuniteteve. Nga pala shqiptare nuk u shfaqën kundërshtime ndaj kësaj ndarjeje paritare, çka dëshmon për një përpjekje të vetëdijshme të elitave vendore për të mbajtur të ndarë përkatësinë fetare nga përfaqësimi politik dhe për të ruajtur kohezionin ndërkomunitar. Kjo strategji konsensuale u pasqyrua edhe në praktikën e funksionimit të këshillit administrativ, ku vendimet synoheshin të miratoheshin me unanimitet, pavarësisht se formalisht mjaftonte një shumicë e thjeshtë.

Përdorimi i termit “Republika Shqipëtare” në dokumentet e brendshme të këshillit, megjithëse nuk u pranua zyrtarisht nga autoritetet franceze, dëshmoi përpjekjet e elitës lokale për ta paraqitur këtë entitet si shprehje të vullnetit kombëtar shqiptar. Ky emërtim nuk duhet interpretuar si një pretendim formal për sovranitet të pavarur, por si një gjest politik i vetëdijshëm, që synonte të afirmonte karakterin shqiptar të qeverisjes lokale në një moment kritik, kur identiteti kombëtar kërcënohej nga copëtimi territorial dhe konkurrenca e pretendimeve të fqinjëve. Për më tepër, zgjedhja e termit “republikë” nuk ishte e rastësishme: ajo reflektonte një afrim të elitës vendase me format moderne të legjitimitetit politik dhe organizimit shtetëror, si edhe ndikimin simbolik të modelit republikan francez, i cili në Europën e kohës përfaqësonte një nga shprehjet më të konsoliduara të qeverisjes laike.

Megjithëse autoritetet franceze u treguan të kujdesshme për të mos i dhënë këtij emërtimi një domethënie politike që do të tejkalonte kufijtë e autonomisë së lejuar prej tyre, modeli i sistemit republikan francez ndikoi si në formën e organizimit institucional, ashtu edhe në përfytyrimet politike të aktorëve lokalë për të ardhmen e shtetit shqiptar.

Struktura e këshillit, theksi te përfaqësimi qytetar (edhe pse nëpërmjet përkatësisë fetare) dhe ideja e një administrate që funksiononte e ndarë nga pushteti i trashëguar i monarkut, afronin deri diku me imagjinatën republikane që Franca sillte me vete, si model i rendit politik modern.

Ndikimi francez shtrihej edhe përtej organizimit institucional, duke depërtuar në fushën e simbolikës politike dhe të koncepteve mbi shtetin dhe sovranitetin. Në këtë kontekst, për elitat korçare, bashkëpunimi me autoritetet ushtarake nuk ishte vetëm një garanci e sigurisë fizike, por edhe një mundësi për të legjitimuar aspiratat e tyre shtetërore përmes përvetësimit simbolik të modelit republikan francez, i cili gëzonte prestigj të konsiderueshëm ndërkombëtar. “Republika Shqipëtare”, edhe si koncept retorik, bëhej kështu një mënyrë për ta lidhur çështjen shqiptare me modelet europiane të shtetformimit, në kontrast me projektet e dominimit territorial të fqinjëve ballkanikë dhe paternalizmin e vjetër perandorak.

Përtej ndikimit ideologjik dhe simbolik, zbatimi konkret i një modeli republikan qeverisjeje në realitetin shqiptar, ndonëse frymëzonte vendasit, paraqiste sfida të konsiderueshme për autoritetet franceze. Ndërtimi i qeverisjes në Krahinën Autonome të Korçës, u konsiderua prej tyre si një formë eksperimentale administrimi, në një hapësirë që nuk ngjasonte me territoret tradicionale koloniale franceze. Në dallim nga Perandoria Habsburgase, e cila kishte një histori të gjatë veprimi e ndërveprimi me klasën politike shqiptare, si edhe me vendasit përmes mekanizmave të Protektoratit të Kultit (*Kultusprotektorat*), Franca u përball me sfidën e përshtatjes së një modeli republikan të centralizuar në një kontekst lokal ballkanik, për të cilin kishte njohuri të kufizuara. Eksperienca koloniale e oficerëve francezë në Afrikë dhe në Indokinën franceze mund të ketë ndikuar në mënyrë të pjesshme në përfytyrimin e qeverisjes në zonën e Korçës, por konteksti gjeopolitik, struktura sociale dhe dinamika e fuqive ndërluftuese në Ballkan e tejkalonin kornizën e zakonshme të administrimit kolonial.¹⁶

Pikërisht për shkak të kësaj mospërputhjeje mes modelit shtetëror francez dhe realitetit shqiptar, autoritetet ushtarake u detyruan të vepronin me kujdes në terren, duke u orientuar drejt zgjidhjeve pragmatike që respektonin strukturat ekzistuese dhe sensibilitetet lokale. Ato toleruan format e organizimit tradicional, të trashëguara nga periudha osmane,

¹⁶ Salih, “Aventura e krahinës autonome”, 74.

veçanërisht në nivelin komunal dhe rural. Po ashtu, përzgjedhën individë të besuar për administratën lokale, shpesh të lidhur me elitën qytetare, me të cilët kishin vendosur raporte të ngushta personale apo institucionale. Në këtë frymë bashkëpunimi dhe përshtatjeje, vazhdimësia e një pjese të administratës së mëparshme u bë një zgjidhje praktike përballë mungesës së një kuadri të gjerë alternativash. Prania e oficerëve francezë në shtëpitë e disa familjeve të njohura të qytetit dhe vendosja e shtabit të përgjithshëm në godinën e ish-mitropolisë greke ishin shprehje e formës së butë të vendosjes në terren të rendit të ri, i cili ndërthurte kontrollin ushtarak me ndjeshmëritë lokale dhe negocimin shoqëror. Gjithsesi, kjo marrëdhënie kishte kufij të qartë. Autonomia e ofruar ishte e kushtëzuar dhe e kthyeshme, siç dëshmoi edhe abrogimi i saj më 16 shkurt 1918 dhe rivendosja e administrimit të drejtpërdrejtë ushtarak. Në këtë mënyrë, administrata vendore nuk përbënte një subjekt politik më vete, por një instrument të përkohshëm në shërbim të strategjisë franceze të luftës.

Të jetosh në prapavijë: Shoqëria korçare në vitet 1916-1918

Megjithëse aspektet institucionale dhe politike të Krahinës Autonome të Korçës janë trajtuar gjerësisht si një eksperiment i veçantë i qeverisjes në rrethana pushtimi, po aq i rëndësishëm për analizën historike mbetet ndikimi që regjimi ushtarak ushtroi mbi jetën e përditshme të popullsisë vendase. Kjo përvojë e prapavijës nuk u kufizua në marrëdhëniet ndërmjet elitave dhe autoriteteve franceze, por u shtri thellë në indin shoqëror, duke prekur ekonominë, arsimin, shëndetësinë, shtypin dhe përfytyrimin e vetë shqiptarëve për shtetin dhe shoqërinë.

Në këtë kuadër, regjimi francez gjatë viteve të ekzistencës së Krahinës Autonome të Korçës (1916-1918) nuk ndikoi vetëm në organizimin politik dhe administrativ të zonës, por edhe në transformimin e praktikave të përditshme dhe të marrëdhënieve shoqërore. Popullsia vendase u bë pjesë aktive – shpesh në mënyrë të detyruar, por jo rrallë edhe me përfshirje të vetëdijshme – në ndërtimin e një rendi të ri që kombinonte stabilitetin me reformimin. Kësisoj, realiteti i prapavijës ndihmoi në formësimin e një ndërgjegjeje kolektive të strukturuar jo vetëm nga nevojat e luftës, por edhe nga kontaktet e reja me modelet perëndimore të organizimit shtetëror dhe social. Këto dinamika nuk u shfaqën vetëm në nivelin e institucioneve apo të ideve

politike, por u materializuan edhe në përvojën e përditshme të popullsisë lokale, e cila u përfshi në mekanizmat ekonomikë dhe logjistikë që mbështetnin funksionimin e prapavijës së luftës.

Lufta e Parë Botërore, sikurse çdo luftë me përmasa të tilla, solli me vete një nevojë të madhe për burime njerëzore dhe materiale, duke mos përjashtuar as shqiptarët. Në kushtet kur vendi nuk u ballafaqua me luftime të ashpra intensive, popullsia luajti një rol kyç në furnizimin me ushqime të trupave ushtarake në vijën e frontit që ndodhej pranë. Një pjesë e madhe e popullsisë mashkullore, sidomos në zonat rurale, u detyrua të braktiste punën e përditshme dhe të angazhohej në projekte që shërbenin për përmirësimin e kapaciteteve logjistike të ushtrive, si ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe i objekteve ushtarake. Këtyre përpjekjeve iu bashkuan edhe ushtarë francezë të rekrutuar nga kolonitë afrikane, pjesëtarë të batalionit senegalez, të cilët, megjithëse të pakualifikuar, u angazhuan në projektet infrastrukturore dhe në punimin e tokave bujqësore, duke u bërë pjesë e ndërveprimit social dhe ekonomik të zonës.¹⁷

Ky fenomen, në qendër të të cilit ishte mobilizimi i popullsisë lokale për nevojat e luftës, pati dy pasoja kryesore që, ndonëse në dukje kontradiktore, përbëjnë dy anë të së njëjtës përvojë në zonat e prapavijës. *Së pari*, krijoi një lidhje të drejtpërdrejtë midis popullsisë së zonës dhe luftës, duke e zhvendosur angazhimin e shoqërisë nga një ekonomi dhe jetesë familjare e tradicionale drejt një ekonomie të orientuar thujtëse tërësisht drejt nevojave kolektive dhe planifikimit për ushtrinë. Në kontekstin e një ekonomie të prapambetur bujqësore, rekuizimi i të korrave, i kafshëve dhe i burimeve të tjera natyrore ishte një nga pasojat më të rënda të kësaj përfshirjeje.

Në përpjekje për t'i zbutur pasojat dhe për të ruajtur rendin social në një territor të rëndësishëm për vijën e frontit, autoritetet franceze ndërmorën një sërë masash për të stabilizuar ekonominë lokale dhe për të rritur furnizimin e frontit me ushqime. Në vitin 1917 u ngrit shërbimi bujqësor, i cili synoi rritjen e prodhimit përmes shpërndarjes falas të farërave dhe lidhjes së kontratave të mbikëqyrura me fermerët vendas. Paralelisht, për ruajtjen e gjësë së gjallë, u organizua shërbimi veterinar nën drejtimin e një mjeku ushtarak francez. Për të përmbushur nevojat e frontit, pothuajse të gjitha tokat pjellore të zonës u vunë në shfrytëzim,

¹⁷ Një oficer francez në Ballkan (1917-1925), 367.

ndërsa u sistemua edhe regjimi i ujërave. Dy mullinjtë e blojës me motor që funksiononin në qytet u përdorën për furnizimin civil dhe atë ushtarak.¹⁸ Për të zbutur mungesat fillestare ushqimore, u importua grurë e misër dhe, me mbështetjen e tregtarëve lokalë, u vendosën çmime fikse për produktet bazë. Drejtuesi i policisë së qytetit, Themistokli Gërmenji, urdhëroi standardizimin e prodhimit të bukës dhe vendosjen e një kontrolli rigoroz mbi çmimet.¹⁹ Këto ndërhyrje rikonfiguruan raportet ndërmjet administratës dhe popullsisë lokale. Ato ishin pjesë e një strategjie më të gjerë për integrimin e shoqërisë me logjikën e prapavijës së luftës, duke sjellë forma të reja kontrolli, përshtatjeje dhe varësie, të cilat ndikuan në mënyrë të qëndrueshme jetën sociale dhe strukturën ekonomike të zonës.

Së dyti, pavarësisht kostove sociale që solli përfshirja e popullsisë në prapavijën e luftës, u vu re një ndryshim i strukturës fizike dhe logjistike të rajonit. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe zgjerimi i shërbimeve publike ishin pjesë e përpjekjeve strategjike të ushtrisë franceze për të garantuar efikasitetin operativ në një territor periferik, por me rëndësi për frontin e Selanikut. Ato krijuan parakushtet për një ndërveprim më të qëndrueshëm të shqiptarëve me konceptin e shtetit modern dhe me funksionimin e shërbimeve publike. Nga një perspektivë më e gjerë, investimet infrastrukturore të ndërmarra gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore do të kontribuonin në krijimin e një themeli për zhvillimin ekonomik në periudhën pasuese. Shqipëria, e cila në fillim të shek. XX trashëgonte një infrastrukturë minimale, përfitoi nga ndërtimi i rrugëve, sistemet e kanalizimeve, përmirësimi i infrastrukturës së qyteteve, furnizimi me ujë dhe riorganizimi i shërbimeve komunale. Këto përmirësime sollën një rritje të kapacitetit urban dhe rural për të përballuar kërkesat e kohës, duke lehtësuar komunikimin, qarkullimin dhe aksesin ndaj tregjeve, si edhe duke përmirësuar kushtet e jetesës së popullsisë vendase.

¹⁸ *Po aty*, 365; Valentina Duka, “Krahina Autonome e Korçës dhe francezët,” në Konferencën shkencore *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës* (Korçë: Promo Print, 2016), 108.

¹⁹ “Mjell në Korçë,” *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 10/23 dhjetor 1916, 1; “Lajmërim N. 4,” *Adriatiku*, Korçë, 21 dhjetor 1916, 1. *Shih* edhe Duka, “Krahina Autonome e Korçës dhe francezët”, 103-104, 109.

Për të mbikëqyrur dhe drejtuar sektorët e punëve publike, autoritetet franceze emëruan kapitenin Dumont, një inxhinier me eksperiencë në ndërtimin e rrugëve dhe urave në Azinë e Vogël. Nën drejtimin e tij, trupat franceze dhe punëtorët vendas u mobilizuan në mënyrë sistematike për realizimin e objektivave inxhinierikë të luftës, si edhe për ruajtjen e “paqes sociale”. Vendasit përfitonin racione ushqimore të njëjta me ato të ushtarëve francezë dhe një pagë të rregullt ditore, çka përfaqësonte një formë të re të marrëdhënieve socioekonomike në një shoqëri përgjithësisht të karakterizuar nga ekonomia e vetëprodhimit.²⁰

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve logjistike dhe të furnizimit të frontit të Selanikut, autoritetet franceze ndërmorën investime infrastrukturore. Në bashkëpunim me trupat italiane, u mirëmbajt dhe u shfrytëzua aksi Sarandë–Korçë–Follorinë–Selanik, i cili u shndërrua në arterien më të rëndësishme ushtarake dhe ekonomike të rajonit. Paralelisht, u përmirësuan lidhjet rrugore të Korçës me Ersekën, Leskovikun, Voskopojën e Bilishtin. Këtu dallon puna e grave, të cilat thyenin gurët për të bërë çakëll për shtrimin e rrugëve. Ndërhyrje të ngjashme infrastrukturore u shtrinë edhe në qendra të tjera të zonës së administruar, si në Pogradec, ku përmirësimi i rrjetit rrugor dhe i komunikimit lidhej drejtpërdrejt me funksionet logjistike të prapavijës.²¹ Ndërtimi dhe riparimi i urave, i ndërtesave publike dhe bonifikimet e kryera në kënetën e Maliqit²² tregonin përpjekjet për ta kthyer prapavijën në një zonë funksionale dhe të integruar rajonale.²³

²⁰ Descoins, *Six mois d'histoire de l'Albanie*, 36-38.

²¹ Ledjon Zeqollari, “Territori i Pogradecit gjatë administrimit francez 1917-1920,” *Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike* (Përmbledhje e artikujve të Konferencës shkencore ndërkombëtare në përkujtim të 110-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe 108-vjetorit të vetëqeverimit të Korçës), organizuar nga Universiteti “Fan Noli” me mbështetjen e Këshillit të qarkut, Korçë, më 6-7 dhjetor 2024, përgatiti për botim Eftiona Bylykbashi (Tiranë: Vassi, 2025), 52.

²² Për një trajtim të hollësishëm rreth projektit të tharjes së kënetës së Maliqit nga periudha osmane në atë të komunizmit, shih: Artan R. Hoxha, *Tharja e kënetës së Maliqit dhe ndërtimi i regjimit komunist në periferi të Shqipërisë* (Tiranë: Onufri, 2021).

²³ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 366; Valter Gjoni, *Kujtesë 1912-1922. Shqipëria në llogore luftërash* (Tiranë: Imprimë par Gent Grafik, 2022), 203; “Mjell në Korçë,” *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 10/23 dhjetor 1916, 1; Duka, “Krahina Autonome e Korçës”, 109.

Përballë mungesës së mjeteve të motorizuara, francezët aplikuan një model të frymëzuar nga përvoja e tyre koloniale në Marok, i cili ishte i njohur edhe për banorët. Ata organizuan një sistem transporti të bazuar në karvanë me kuaj dhe mushka, të siguruara nga burimet vendase. Ky sistem alternativ përfaqësonte një zgjidhje pragmatike dhe efikase për nevojat logjistike të ushtrisë franceze dhe, si i tillë, u bë themelor për garantimin e linjave të furnizimit në terrenin e vështirë malor të zonës.²⁴

Një dimension tjetër me rëndësi ishte komunikimi, i cili u vitalizua përmes përpjekjeve për të rikthyer funksionalitetin e shërbimeve postare, telegrafike dhe telefonike.²⁵ Megjithëse komunikimi telefonik mbeti i rezervuar vetëm për autoritetet franceze, ai luajti një rol kyç në koordinimin ushtarak. Ndërkohë, në një rajon si Korça, i lidhur ngushtë me emigracionin dhe me një diasporë aktive, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, funksionimi i shërbimit postar ishte thelbësor për mbajtjen e lidhjeve me botën e jashtme dhe për ruajtjen e kohezionit shoqëror në kushte pushtimi. Vendorsja e një sistemi të rregullt postar, e shoqëruar me emetimin e pullave,²⁶ përfaqësonte jo vetëm një mjet administrimi të komunikimit, por edhe një shprehje konkrete të autoritetit institucional të regjimit të ri në jetën e përditshme.

Përtej përpjekjeve logjistike, një tregues tjetër i dimensionit afatgjatë të prapavijës ishte interesimi për shfrytëzimin dhe studimin sistematik të burimeve natyrore. Pavarësisht kufizimeve të vendosura nga lufta, autoritetet franceze ndërmorën hapa për të evidentuar potencialin industrial dhe natyror të zonës, e cila, krahas një baze të theksuar bujqësore, shfaqte një prani modeste të industrisë së manifakturës, përfshirë prodhimin e qilimave, kuvertave, armëve artizanale dhe përpunimin e argjendit. Funksionimi i disa punishteve dhe mullinjve me avull dëshmonte për një aktivitet ekonomik të kufizuar. Në mungesë të kapitalit të qëndrueshëm, fokusi i administratës franceze u përqendrua te dokumentimi i burimeve natyrore pyjore, ujore dhe nëntokësore. Për këtë qëllim u angazhuan oficerë me formim shkencor, si togeri i xhenios Bidon, inxhinier minierash, apo Jacques Bourcart, gjeograf në Universitetin e Sorbonës. Bourcart-i realizoi një studim të gjerë

²⁴ Descoins, *Six mois d'histoire de l'Albanie*, 38.

²⁵ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 365, 367.

²⁶ "Posta," *Adriatiku*, Korçë, 26 dhjetor 1916, 1-2. *Shih* edhe Kaliopi Naska, "Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve "Adriatiku" dhe "Gazet" e Korçës" (dhjetor 1916-gusht 1918)," *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*, 160.

gjeologjik dhe gjeografik të zonës, i cili shërbeu si bazë për tezën e tij të doktoratës dhe kontribuoi në zgjerimin e interesit akademik francez për Shqipërinë.²⁷ Procesi i dokumentimit dhe i eksplorimit u ndërthur ngushtësisht me nevojat e frontit, duke e shndërruar njohurinë shkencore në instrument operacional. Ushtria franceze shfrytëzoi rezervat e qymyrgurit në zonën Mborje–Drenovë, ku, që nga 1 dhjetori 1917 deri në përfundim të luftës, u nxorën rreth 2 milionë okë qymyr (afërsisht 2 400 tonë). Për këtë qëllim u angazhuan punëtorë vendas, të cilët punonin nën mbikëqyrjen e ushtarakëve francezë. Eksplorime me vlerë u realizuan gjithashtu në Vithkuq dhe Boboshticë.²⁸ Në të njëjtën frymë shfrytëzimi dhe mobilizimi ekonomik, autoritetet franceze riaktivizuan një pjesë të infrastrukturës industriale ekzistuese, e cila kontribuoi si në mbështetjen e logjistikës ushtarake, ashtu edhe në furnizimin e popullsisë civile.

Gjithsesi, këto përpjekje shfaqnin edhe elemente të një logjike koloniale, të ngjashme me praktikat që Franca kishte zhvilluar në territore jashtë Europës. Hartëzimi i pasurive natyrore, vlerësimi i potencialeve ekonomike dhe mbledhja e të dhënave gjeografike e gjeologjike nuk synonin vetëm njohjen më të mirë të territorit, por edhe identifikimin e burimeve që mund të vihehin në shërbim të nevojave ushtarake, ekonomike dhe shkencore të autoriteteve franceze. Kësisoj, pushtimi dhe administrimi francez i zonës së Korçës, ndonëse të përkohshëm dhe të kushtëzuar nga konteksti i luftës, shfaqnin ngjashmëri me forma më të gjera të kontrollit perandorak, ku ndërhyrjet mbi territorin dhe popullsinë tejkalonin nevojat e momentit dhe krijonin premisa për një prani e ndikim më të qëndrueshëm në rajon.²⁹ Një pasqyrim të kësaj perspektive e gjejmë edhe në diskursin e vetë ushtarakëve francezë: “Shqipëria e panjohur dhe pjesërisht e pashfrytëzuar, po fillonte të na i zbulonte të

²⁷ Descoins, *Six mois d'histoire de l'Albanie*, 36-38; Salih, “Aventura e krahinës autonome”, 77.

²⁸ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 370; Duka, “Krahina Autonome e Korçës”, 109.

²⁹ Praktikant e dokumentimit shkencor, hartëzimit dhe studimit të burimeve natyrore në territore të kontrolluara nga Franca janë trajtuar gjerësisht në historiografinë mbi administrimin kolonial francez. Për përdorimin e dijes shkencore si instrument qeverisjeje dhe kontrolli, shih: Jacques Boucart, *L'Albanie et les Albanais* (Paris: Editions Bossard, 1931); Paul Rabinow, *French Modern: Norms and Forms of the Social Environment* (Chicago: University of Chicago Press, 1989); si dhe Edmund Burke III, *The Ethnographic State: France and the Invention of Moroccan Islam* (Berkeley: University of California Press, 2014).

fshehtat e saj një e nga një; falë një shfrytëzimi të mençur ajo na ofroi resurse të çmueshme që do të na shërbenin për t'i rritur furnizimet tona”.³⁰ Në të njëjtën frymë, evidentohet se “burimet pyjore u shfrytëzuan me rregull dhe me mençuri për ndërtim dhe ngrohje”, një diskurs që e konceptonte territorin kryesisht si hapësirë burimesh të administrueshme dhe të shfrytëzueshme.

Të qenët në prapavijë, në distancë nga përplasjet e dhunshme, krijoi hapësirën e nevojshme për zhvillimin e arsimit kombëtar dhe reformimin e administratës. Riorganizimi i sistemit arsimor, përdorimi i gjuhës shqipe në shkolla dhe administratë përbënin një hap cilësor drejt formimit të një shoqërie më të ndërgjegjshme për identitetin e saj, më të organizuar dhe më të institucionalizuar. Krijimi i një sistemi shkollor të unifikuar, i frymëzuar nga modeli arsimor francez dhe nga konceptet perëndimore mbi marrëdhëniet midis shtetit dhe shoqërisë, synonte të nxiste përhapjen e arsimit laik dhe të forconte ndërgjegjen kombëtare në popullatë. Në vitet 1917-1918, u hapën rreth 60 shkolla fillore që kryenin procesin mësimor në gjuhën shqipe, dhe një vit pas institucionalizimit të Krahinës Autonome, më 25 dhjetor 1917, u themelua e para shkollë e mesme e përgjithshme në historinë e arsimit shqiptar, i mirënjohuri Liceu Francez i Korçës.

Përtej nevojave administrative, strategjia e ndjekur në fushën arsimore ishte pjesë e një vizioni më të gjerë ideologjik dhe politik. Siç shprehej koloneli Ordion: “I nxisja familjet e pasura të Korçës të dërgonin një fëmijë në universitetet e Francës. Kjo masë mund të jepte rezultate të mira me kalimin e kohës... Arsimi falas dhe i detyrueshëm kishte dhënë rezultate të shkëlqyera: kjo ishte vetë baza e pushtimit moral që projektonim të bënim në Shqipëri, si në të gjithë Orientin. Njerëzit dhe institucionet mund të shkojnë apo të pësojnë çfarëdolloj dëmi, por ideja, ideja zotëruese, mbetet e paprekshme. Dhe ideja franceze po hidhte rrënjë në mendjet e shqiptarëve”.³¹ Kësisoj, investimi në arsimin shqip dhe në formimin e një administrate vendase të shkolluar ishin njëkohësisht elemente të stabilitetit lokal dhe pjesë e strategjisë franceze për ndikim ideologjik e kulturor në rajon.³² Në këtë klimë transformimi u vunë re

³⁰ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 365.

³¹ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 374.

³² Mbi ndikimin kulturor francez në Korçë, *shih*: Pandi Bello, “Ndikimi kulturor francez në Korçë ndërmjet Luftës I dhe Luftës II Botërore,” në Konferencën shkencore 100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës (Korçë: Promo Print, 2016), 219-225.

edhe fillesat e një jete të organizuar kulturore në qytete si Korça dhe Pogradeci, ku shoqëritë kulturore dhe arsimore kontribuan në formësimin e një hapësire publike më të strukturuar dhe në përhapjen e ideve kombëtare.³³

Në kontekstin e një territori të pushtuar dhe të pozicionuar në prapavijë lufte, shtypi i shkruar u bë një instrument i rëndësishëm komunikimi me funksione të shumëfishta. Ai përfaqësonte njëherazi një mjet propagande për nevojat e luftës dhe një hapësirë për komunikim publik e emancipim kulturor. Të mbikëqyrura nga autoritetet ushtarake franceze dhe të mbështetura nga këshilli administrativ, gazetat “Adriatiku” dhe “Gazet’e Korçës” vepruan për të legjitimuar praninë franceze, për të ndërtuar imazhin e një administrimi të drejtë, përparimtar dhe në harmoni me aspiratat kombëtare të shqiptarëve. Ato përçuan diskursin e bashkëjetesës mes trupave franceze dhe popullsisë vendase, duke promovuar idealin e lirisë dhe partneritetit ushtarak. Koloneli Descoins shprehej me patos se: “Edhe djemt e Francës po qe se do të jetë nevoja të derdhnin gjakun e tyre për kombin tuaj, do të e derdhnin me gas. Djemt e Republikës së bashkuar me djemtë e Skënderbeut do të luftojnë të gjithë për atë shkak, për lirinë”,³⁴ duke përkthyer, me gjuhën e shtypit, vizionin romantik dhe strategjik të asaj që ai e konsideronte si “aleancë franko-shqiptare”.

Megjithëse i kontrolluar dhe censuruar nga autoritetet ushtarake, shtypi nuk u kufizua vetëm në informimin zyrtar. Ai pasqyroi edhe jetën shoqërore e kulturore, raportoi mbi arsimin, aktivitetet dhe organizimet qytetare, duke kontribuar në një proces të ngadaltë, por të qëndrueshëm të emancipimit politik dhe kulturor të shoqërisë vendase. Përmes kësaj ndërthurjeje, gazetatat lokale mbeten dëshmi e mënyrës se si pushtimi ushtarak tentonte të krijonte legjitimitet përmes fjalës së shkruar, ndërsa vetë elitat korçare e përdorën këtë hapësirë për të artikuluar aspiratat e tyre politike dhe identitare.

Krahas rolit të shtypit si mjet komunikimi dhe artikulimi politik, vetë struktura institucionale e ngritur gjatë administrimit francez ofroi një kontekst të ri për aktivizimin e aktorëve vendorë dhe për formimin e

³³ Për zhvillimin e arsimit dhe të jetës kulturore në Pogradec gjatë administrimit francez, përfshirë krijimin e shoqërive dhe zgjerimin e rrjetit shkollor, *shih*: Zeqollari, “Territori i Pogradecit gjatë administrimit francez”, 53.

³⁴ “Z. Komandant Descoins. Popullit Korçës, Korçë,” *Gazet’e Korçës*, Korçë 3/16 janar 1917, 1; Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 35.

kapitalit burokratik lokal. Zona franceze, pavarësisht ulje-ngritjeve në marrëdhëniet mes autoriteteve të Armatës së Lindjes dhe elitave vendase, funksionoi si një hapësirë eksperimentale për prodhimin e një brezi të ri veprimtarësh politikë dhe administrativë, të cilët po dilnin nga hija e figurave themeluese të periudhës së shpalljes së Pavarësisë. Zhvillimet aty paraqesin ngjashmëri me përvojën e zonës austro-hungareze, ku pushtimi dhe administrimi i huaj krijuan kushte për zhvillimin e një burokracie vendase me identitet kombëtar. Kontribut të rëndësishëm në këtë proces pati ndërtimi i një administrate vendore të centralizuar dhe funksionale, e bazuar në kritere përzgjedhjeje që i jepnin peshë njohjes së gjuhës shqipe dhe kapaciteteve teknike të nëpunësve.³⁵ Eksperienca e ndërveprimit mes nëpunësve shqiptarë dhe autoriteteve ushtarake kontribuoi jo vetëm në formimin e kapitalit burokratik lokal, por edhe në përvetësimin e praktikave të reja të administrimit dhe qeverisjes, duke lënë një trashëgimi administrative që do të rezultonte e dobishme në procesin e rindërtimit institucional pas përfundimit të luftës.

Një tjetër element që dëshmon për konsolidimin e një rendi administrativ funksional ishte vendosja e praktikave të regjistrimit dhe identifikimit të popullsisë. Krahës urdhrin për regjistrimin e shtetasve të huaj dhe pajisjen e tyre me letërnjoftime, autoritetet ndërmorën edhe hapa për evidentimin më të gjerë të popullsisë së territorit të administruar.³⁶ Këto masa, përtej funksionit praktik të kontrollit të lëvizjes në rrethana lufte, synonin krijimin e një kuadri juridik të unifikuar dhe përfshirjen e individëve në strukturën e re institucionale. Në mënyrë simbolike, ato përforconin autoritetin e administratës dhe e afirmonin atë si instancë legjitime e rendit publik. Njëkohësisht, regjistrimi kishte edhe një dimension politik, pasi shërbente për të kundërshtuar pretendimet e aktorëve të tjerë rajonalë mbi përkatësinë etnike dhe për të konsoliduar kontrollin mbi territorin. Administrimi i popullsisë nuk ishte vetëm një procedurë burokratike, por pjesë e procesit më të gjerë të ndërtimit dhe legjitimitetit të rendit të ri administrativ në zonën franceze.

Në të njëjtën logjikë të konsolidimit të autoritetit administrativ dhe të administrimit të hapësirës së prapavijës, kujdesi shëndetësor përfaqësoi jo vetëm një nevojë ushtarake emergjente, por edhe një instrument të

³⁵ Sali Kadria, *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, ASA/Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020), 282-289.

³⁶ *Po aty*, 296-297.

rëndësishëm të ndërveprimit mes autoriteteve ushtarake dhe popullsisë vendase. Organizimi i shërbimeve mjekësore ishte pjesë integrale e logjikës së administrimit të prapavijës: sigurimi i vazhdimësisë së operacioneve ushtarake kërkonte një sistem efikas për trajtimin e të plagosurve dhe për kontrollin e sëmundjeve epidemike, të cilat përbënin një rrezik të madh në kushtet e një ekonomie të dobësuar dhe të një infrastrukture të fragmentuar.

Në shkurt të vitit 1917 u themelua spitali ushtarak nën drejtimin e mjekëve francezë, i pajisur me shërbim kirurgjikal dhe ambulanca lëvizëse, një risi për Shqipërinë e kohës. Një vit më vonë, në tetor, u hap edhe një spital civil sipas modelit francez, i cili u përqendrua në trajtimin e sëmundjeve kronike, infektive e virusale që përhapeshin gjerësisht në rajon.³⁷ Këtu dallon gripi spanjoll, i cili u soll në Korçë nga ushtarët senegalezë. Gjithashtu, vepruan misione humanitare që kontribuan me ndihma për popullsinë civile. Kryqi i Kuq Amerikan dha një ndihmë të çmuar përmes shpërndarjes së barnave cilësore, organizimit të ambulancave shëtitëse dhe krijimit të strehëve për fëmijët, duke zgjeruar fushën e ndërhyrjeve nga shëndetësia emergjente drejt kujdesit social për shtresat më të pambrojtura.³⁸

Në bashkëpunim me administratën lokale, u morën masa për kontrollin e tregjeve, inspektimin sanitar dhe përmirësimin e higjienës publike. Një rregullore e posaçme për pastrimin e qytetit (5 dhjetor 1917) detyronte çdo “ndenjës të një shtëpie” të pastronte hapësirën përpara banesës, duke parashikuar edhe sanksione për moszbatim.³⁹ Veprimtaria mjekësore u shoqërua me fushata higjienizuese, vendosjen e koshave të mbeturinave në të gjithë qytetin dhe masa rigorozë për kontrollin e sëmundjeve ngjitëse.⁴⁰

Një aspekt tjetër domethënës lidhej me përkujdesjen për popullsinë e varfër dhe të pambrojtur, për të cilën mbuloheshin shpenzimet për medikamentet kundër difterisë, me kusht që sëmundja të konfirmohej nga

³⁷ Salih, “Aventura e krahinës autonome”, 79-80; Gjoni, *Kujtesë 1912-1922*, 218.

³⁸ Gjoni, *Kujtesë 1912-1922*, 206-210; *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 365.

³⁹ “Kanonizëm mi të qeruarit e udhëve,” *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 16/29 nëntor 1917, 2. Shih edhe Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 81.

⁴⁰ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 365; Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 78-81; Duka, “Krahina Autonome e Korçës”, 110; Gjoni, *Kujtesë 1912-1922*, 151, 207-209.

mjekët ushtarakë.⁴¹ Kjo ndërhyrje synonte jo vetëm mbrojtjen nga një prej sëmundjeve më të rrezikshme të kohës, por edhe nxitjen e raportimit mjekësor dhe kontrollit institucional mbi shëndetin publik.

Për më tepër, me funksionimin e sëmuretove (spitaleve) ushtarake, u krijua një regjim i diferencuar qasjeje ndaj kujdesit shëndetësor, ku të varfrit kishin të drejtë të vizitoheshin falas me autorizim nga policia, ndërsa të pasurit mund të trajtoheshin në spital me mjekët e tyre.⁴² Ky sistem me kriterë të diferencuara, ndonëse i motivuar nga mungesat strukturore dhe kapacitetet e kufizuara të luftës, pasqyronte hierarkitë sociale ekzistuese dhe ruante pabarazitë në aksesin ndaj kujdesit mjekësor. Në një kuadër më të gjerë, këto politika, sado të pjesshme dhe të varura nga konteksti ushtarak, përfaqësonin një trajtë të hershme të ndërhyrjeve sociale të shtetit modern, ku dimensionin human kombinohej me nevojat e kontrollit politik dhe logjistik në zona të pushtuara. Në tërësi, ato ishin të kushtëzuara nga nevojat strategjike të një administrimi ushtarak që, përtej humanizmit të projektuar, synonte stabilitetin, legjitimitetin dhe projektimin ideologjik të influencës franceze në rajon.

Përveç ndërhyrjeve në infrastrukturë, ekonomi, arsim dhe shëndetësi, prania franceze ndikoi edhe në ristrukturimin e sistemit juridik. Autoritetet ndërmorën hapa për të ndërtuar një sistem të ri, i cili do të kombinonte kontrollin ushtarak me ruajtjen e disa formave tradicionale të arbitrazhit lokal. Më 19 mars 1917 u krijua Këshilli i Luftës, i përbërë vetëm nga oficerë francezë. Ky organ kishte kompetenca për të gjykuar çështjet më të rënda penale, krimet dhe problemet e sigurisë publike, duke reflektuar fokusin e autoriteteve ndaj stabilitetit në prapavijë. Në maj të po atij viti hyri në fuqi Kodi Penal i frymëzuar nga modeli francez, i cili parashikonte krijimin e Këshillit të Rendit dhe Policisë, një strukturë me kompetenca të fokusuara në ruajtjen e rendit publik, ndëshkimin e spekulimeve ekonomike dhe trajtimin e shkeljeve të natyrës ordinere. Një vit më vonë, pas abrogimit të Krahinës Autonome të Korçës, u krijua Gjykata e Faktit, e cila shqyrtonte të gjitha shkeljet e

⁴¹ “Lajmërim,” *Adriatiku*, Korçë, 22 dhjetor 1916, 2. Shih edhe Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 81.

⁴² “Lajmërim 17,” *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 29 maj 1917, 1-2. Shih edhe Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 78.

ligjit dhe disiplinës në territorin e pushtuar.⁴³ Organizimit gjyqësor i mungoi Gjykata e Apelit.

Në sferën civile e familjare, autoritetet franceze zgjodhën të mos cenonin juridiksionet tradicionale, duke lejuar gjykatat fetare të trajtonin çështjet që lidheshin me martesat, divorcet dhe trashëgimitë.⁴⁴ Kjo “tolerancë” institucionale përbënte një kompromis funksional që synonte ruajtjen e ndjenjës së autonomisë komunitare dhe shmangien e tensioneve sociale në një rajon me përbërje të larmishme fetare.

Megjithatë, përtej ndërtimit të institucioneve dhe përpjekjeve për përmirësimin e jetës së përditshme, prania franceze në Korçë mbeti një projekt i mbështetur mbi logjikën e një pushtimi ushtarak, ku stabiliteti i prapavijës kishte përparësi absolute ndaj lirive qytetare. Kjo vërehej qartë në kontrollin e rreptë mbi sferën publike dhe politike, ku nevoja për të garantuar rendin dhe për të shmangur çdo formë të rezistencës ose ndikimi subversiv çonte në kufizime të theksuara, madje edhe ekzekutime.⁴⁵ Kësisoj, jeta e përditshme e shqiptarëve në Krahinën Autonome të Korçës, sikurse gjithkund në Shqipëri apo gjetkë në periudha lufte, u karakterizua nga kufizime të gjera, të cilat kishin të bënin me mungesën e lirive personale dhe politike, tregti të kontrolluar e të monopolizuar, masa të rrepta për kontrollin e popullsisë, përfshirë ndalimin e tubimeve publike, censurën e shtypit dhe kufizimet e lëvizjes. Masat e ndërmarra për ruajtjen e rendit publik ishin pjesë e një politike mbikëqyrëse dhe kontrolli, e cila, ndonëse synonte stabilitetin dhe qetësinë në zonë, ndërpreu proceset e natyrshme të zhvillimit të jetës politike dhe shoqërore të popullsisë vendase.

Përfundime

Eksperienca e Krahinës Autonome të Korçës nën administrimin francez përfaqëson një paradigmë për t’i kuptuar regjimet e pushtimit jo vetëm si struktura kontrolli ushtarak, por edhe si forma të ndërveprimit institucional e transformimi të pjesshëm politik e shoqëror. Në këtë rast, pushtimi nuk u reduktua vetëm në dhunë apo imponim, por u ndërthur

⁴³ Salih, “Aventura e krahinës autonome”, 79.

⁴⁴ Descoins, *Six mois d’histoire de l’Albanie*, 35; “Të vendit,” *Adriatiku*, Korçë, 15 janar 1917, 1-2; Shih edhe Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve*, 67.

⁴⁵ *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*, 196.

me forma të organizimit lokal, përpjekje për stabilitet dhe projekte të ndërtimit shtetëror në miniaturë.

Prania franceze, e lindur si zgjidhje pragmatike në një kontekst të paqëndrueshëm ndërkombëtar, përbën një rast të veçantë pushtimi “hibrid”, që kombinonte logjikën ushtarake me mekanizma të administrimit vendor. Krijimi i këshillit administrativ, angazhimi i elitave korçare dhe zhvillimi i politikave në fusha si arsimi, shëndetësia apo drejtësia, tregojnë përpjekjen për ta bërë pushtimin funksional në dobi të garantimit të stabilitetit, rendit publik, si edhe sigurimit të burimeve njerëzore dhe materiale për frontin.

Megjithatë, këto struktura administrative bashkëjetuan me kufizime të rënda mbi jetën politike dhe liritë qytetare. Pushtimi mbeti thelbësisht një projekt i ndërtuar mbi logjikën e stabilitetit të prapavijës, ku kontrolli i sferës publike, censura dhe ndalimi i organizimeve shoqërore ishin të zakonshme. Ky dualitet mes përpjekjeve për modernizim dhe natyrës autoritare të pushtimit, është thelbësor për të kuptuar kompleksitetin e përvojës së zonës franceze. Shoqëria lokale nuk ishte thjesht objekt i politikave pushtuese, por edhe aktore aktive në proceset e negocimit, përshtatjes dhe, herë pas here, të sfidimit të pushtetit të huaj.

Përvoja e zonës franceze në Korçë mund të ndriçohet përmes një krahasimi me zonën austro-hungareze në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore. Edhe administrata franceze, ashtu si ajo austro-hungareze, ndërmori politika për modernizimin e jetës institucionale dhe përfshirjen e elitave vendase në administrim, veçanërisht përmes arsimit, shërbimeve publike dhe përpjekjeve për rregullim urban. Megjithatë, ndryshe nga përvoja austro-hungareze, e karakterizuar nga një administrim ushtarako-civil më i qëndrueshëm dhe më i sistemuar, mbështetur mbi një projekt të qartë të zgjerimit të ndikimit perandorak, prania franceze në Korçë rezultoi më e improvizuar dhe më e kushtëzuar nga balancat gjeopolitike dhe mungesa e një strategjie afatgjatë. Kjo e bën zonën franceze një përvojë më fleksibël, por edhe më të brishtë në raport me ndërtimin e strukturave shtetërore pas luftës.

Në këtë krahasim bie në sy edhe një përmbysje rolesh: në zonën franceze ushtarakët shfaqën një qasje më pozitive ndaj shqiptarëve sesa diplomacia, ndërsa në atë austro-hungareze ndodhi e kundërta, me një diplomaci më mbështetëse dhe një administrim ushtarak shpesh të ashpër. Gjithsesi, të dyja rastet tregojnë se pushtimi mund të funksionojë jo vetëm si mjet kontrolli, por edhe si nxitës i shndërrimeve institucionale,

të kushtëzuara nga mënyra e qeverisjes dhe marrëdhëniet me shoqërinë vendase.

Trashëgimia e zonës franceze lidhet edhe me simbolikën politike që la pas. Në kujtesën kolektive, Krahina Autonome e Korçës u përjetësua si një përvojë e veçantë administrimi, duke shërbyer si pikë referimi për idenë e ndërhyrjes ndërkombëtare në ndërtimin e shtetit kombëtar. Ajo mbetet një kapitull i rëndësishëm jo vetëm për të kuptuar pushtimin, por edhe për të analizuar mënyrën se si shoqëritë lokale e përballojnë, e përshtatin ose i japin kuptim përvojës së tij në funksion të aspiratave të tyre politike.

Një nga shfaqjet më të qëndrueshme të kësaj trashëgimie ishte fusha e arsimit, ku vazhdimësia institucionale rezultoi veçanërisht e prekshme. Liceu i Korçës, i themeluar nga ushtarakët francezë, u shndërrua në një nga institucionet më të rëndësishme arsimore në vend. Në vitin 1921, ai mori statusin e shkollës së mesme në rang kombëtar, i financuar nga shteti shqiptar. Kjo përvojë dëshmon se ndërhyrjet e pushtimit, ndonëse të kushtëzuara nga logjika ushtarake, mund të prodhojnë forma institucionale të përvetësueshme, të afta për të kontribuar në ndërtimin e shtetit kombëtar.

Bibliografi:

- AUDOIN-Rouzeau, Stéphane, dhe Annette Becker. *14-18: Understanding the Great War*. Translated by Catherine Temerson. New York: Hill and Wang, 2002.
- BECKER, Jean-Jacques. *The Great War and the French People*. Translated by Arnold Pomerans, with an introduction by Jay Winter. New York: St. Martin's Press, 1986.
- BELLO, Pandi. "Ndikimi kulturor francez në Korçë ndërmjet Luftës I dhe Luftës II Botërore." Në *Konferenca shkencore: 100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*. Korçë: Promo Print, 2016.
- BLUMI, Isa. "Albania." Në *International Encyclopedia of the First World War 1914-1918* [online]. (Shikuar më 10 shkurt 2023).
- BORGOGNI, Massimo. *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939). La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'operazione Oltre mare Tirana*. Milano: Franco Angeli, 2007.
- BOUCART, Jacques. *L'Albanie et les Albanais*. Paris: Editions Bossard, 1931.

- BURKE III, Edmund. *The Ethnographic State: France and the Invention of Moroccan Islam*. Berkeley: University of California Press, 2014.
- CACCAMO, Francesco. "Italy, the Adriatic and the Balkans: From the Great War to the Eve of the Peace Conference." Në *Italy in the Era of the Great War*, red. Vanda Wilcox. Leiden: Brill, 2018.
- ÇAMI, Muin. *Shqiptarët dhe francezët në Korçë (1916-1920)*. Tiranë: Dituria, 1999.
- DESCOINS, Général. *Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*. Paris: Alfred Costes, 1930.
- DORLHIAC, Renaud. *Les territoires albanais sous administration française (1916-1920)*. Mémoire de DEA, EHESS, 1999.
- DOUGHTY, Robert A. *Pyrrhic Victory: French Strategy and Operations in the Great War*. Cambridge, MA: Harvard University Press, 2008.
- DUKA, Valentina. "Krahina Autonome e Korçës dhe francezët." Në *Konferenca shkencore: 100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*. Korçë: Promo Print, 2016.
- DUSHKU, Ledia. "Nga 'armike' në 'mike dhe burim qytetërimi': Dualizmi në perceptimin e shqiptarëve për Francën." *Studime historike* 3-4 (2017): 62-78.
- GRAYZEL, Susan R. *At Home and Under Fire: Air Raids and Culture in Britain from the Great War to the Blitz*. Cambridge: Cambridge University Press, 2012.
- GJONI, Valter. *Kujtesë 1912-1922. Shqipëria në llogore luftërash*. Tiranë: Gent Grafik, 2022.
- HORNE, John, ed. *State, Society and Mobilization in Europe during the First World War*. Cambridge: Cambridge University Press, 1997.
- JUDSON, Pieter M. *The Habsburg Empire: A New History*. Cambridge, MA: Belknap Press of Harvard University Press, 2016.
- KADRIA, Sali. *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*. Tiranë: Botimet albanologjike, 2020.
- KITROMILIDES, Paschalis M. *Eleftherios Venizelos: The Trials of Statesmanship*. Edinburgh: Edinburgh University Press, 2006.
- KOLOVANI, Demetre. *La Question de Koritza*. Paris: Imprimerie Henri Diéval, 1920.
- LEON, George B. *Greece and the Great Powers, 1914-1917*. Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1974.
- LYON, James. *Serbia and the Balkan Front, 1914: The Outbreak of the Great War*. London-New York: Bloomsbury Academic, 2015.
- MARWICK, Arthur, ed. *Total War and Social Change*. London: Palgrave Macmillan, 1988.

- NASKA, Kaliopi. *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve "Adriatiku" dhe "Gazet" e Korçës* (dhjetor 1916–gusht 1918). *Trajtesë dhe Dokumente*. Tiranë: Kristalina-KH, 2017.
- NASKA, Kaliopi. "Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve 'Adriatiku' dhe 'Gazet' e Korçës" (dhjetor 1916–gusht 1918)." Në *Konferenca shkencore 100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*. Korçë: Promo Print, 2016.
- Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*. Vëll. I. Tiranë: Papirus, 2014.
- PALATICKY, Alexis. *La zone d'occupation française en Albanie (1916-1920)*. Tezë doktore, Université Marc Bloch, Strasbourg, 2002.
- PASTORELLI, Pietro. *Dalla prima alla seconda guerra mondiale. Momenti e problemi della politica estera italiana 1914-1943*. Milano: LED Edizioni Universitarie, 1998.
- POPESCU, Stefan. "Les Français et la République de Kortcha (1916-1918)." *Guerres mondiales et conflits contemporains*, no. 213 (2004): 77-88.
- POPESCU, Stefan. *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919–juin 1940)*. Paris: Université Paris I Panthéon-Sorbonne, 2013.
- RABINOW, Paul. *French Modern: Norms and Forms of the Social Environment*. Chicago: University of Chicago Press, 1989.
- SALIH, Brendon. "Aventura e krahinës autonome dhe dinamikat e administrimit të rajonit të Korçës, nën protektoratin francez (1916-1920)." Në *Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike*. Tiranë: Vassi, 2025.
- SARRAIL, Général. *Mon commandement en Orient (1916-1918)*. Paris: Ernest Flammarion, 1920.
- SCHEER, Tamara. "Similarities and Particularities of Habsburg Occupation Regimes during the First World War." Në *The First World War and the Balkans*, 41-58. Bern: Peter Lang, 2018.
- SINANI, Shaban. "Korça në ditarët e komandantëve ushtarakë francezë dhe italianë." Në *Konferenca shkencore 100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*. Korçë: Promo Print, 2016.
- SMITH, Michael Llewellyn. *Ionian Vision: Greece in Asia Minor, 1919-1922*. London: Hurst & Company, 1973.
- WAKEFIELD, Alan, dhe Simon Moody. *Under the Devil's Eye: Britain's Forgotten Army in Salonika 1915-1918*. Stroud: The History Press, 2004.
- ZEQOLLARI, Ledjon. "Territori i Pogradecit gjatë administrimit francez 1917-1920." Në *Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike*. Tiranë: Vassi, 2025.

Shtypi:

Adriatiku (Korçë), 21 dhjetor 1916; 22 dhjetor 1916; 26 dhjetor 1916; 15 janar 1917.

Gazet' e Korçës (Korçë), 10/23 dhjetor 1916; 3/16 janar 1917; 29 maj 1917; 16/29 nëntor 1917.

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

ledia_dushku@yahoo.com

S u m m a r y

OCCUPATION REGIMES AND LOCAL SOCIETIES: FRENCH OCCUPATION AND
SOCIO-POLITICAL CHANGE IN THE AUTONOMOUS PROVINCE OF KORÇË
(1916-1918)

The article analyzes the French occupation of southeastern Albania (1916–1918) by conceptualizing the Autonomous Province of Korçë as a wartime rear area rather than a direct combat zone. It argues that the rear area was not a passive background to military operations, but an active space of governance, mobilization, and social restructuring shaped by the needs of the Salonika front.

The study focuses particularly on the social dimension of occupation. The local population was drawn into the war effort through requisitions, agricultural regulation, labor mobilization, and infrastructure projects that supported military logistics. These measures altered economic structures and everyday life, integrating society into the operational framework of war. At the same time, French authorities reorganized public administration, expanded Albanian-language education, invested in roads and public works, and introduced reforms in public health and judicial practice. Such interventions, though designed to secure stability and resources, produced longer-term institutional effects.

The article emphasizes the dual character of the rear area: it functioned simultaneously as a space of control, marked by censorship, surveillance, and restricted political freedoms, and as a site of structural transformation and limited modernization. By examining these dynamics,

the study presents occupation as a socio-political process shaped by negotiation and interaction between military authorities and local actors, leaving a lasting imprint on patterns of governance and state formation in Albania.

Keywords: Autonomous Province of Korçë, French occupation regime, wartime rear area, military-society interaction, socio-institutional transformations.

PROF. ASOC. DR. ERIND MERKURI

Fakulteti i Drejtësisë / Universiteti i Tiranës
erind.merkuri@fdut.edu.al

**KOMISIONI LIGJPËRGATITËS DHE VEPRIMTARIA
“TJETËR” E TIJ NË PERIUdhËN
1926 – 1929**

Abstrakt:

Ky punim synon të trajtojë një aspekt të veprimtarisë së komisionit ligjpërgatitës, i cili deri më tani ka mbetur pak i njohur dhe lidhet me mendimet dhe opinionet që ky organ ka dhënë në fusha të ndryshme të së drejtës. Kështu, përveç hartimit të projektkodeve penale dhe civile, si dhe të shtojcës së Kodit të Procedurës Civile, komisioni ishte i përfshirë gjerësisht edhe në ofrimin e ekspertizës juridike për institucionet shqiptare të kohës në lidhje me tematika të ndryshme.

Fjalë kyçe:

Komisioni ligjpërgatitës, interpretime ligjore, pronë, administratë, kontratë.

Hyrje

Komisioni ligjpërgatitës përmendet shpeshherë në literaturën historike dhe juridike të vendit tonë, kryesisht në lidhje me proceset e para kodifikuese në vendin tonë. Megjithatë, burimet arkivore tregojnë se veprimtaria e tij nuk kufizohej vetëm në këtë funksion. Përkundrazi, nga analiza e praktikës së tij rezulton se komisioni ka ushtruar edhe një rol të rëndësishëm këshillimor dhe interpretues, duke kontribuar drejtpërdrejt në formësimin e një praktike të hershme të jurisprudencës administrative në Shqipëri. Ky aspekt, deri më tani, pak i eksploruar, përbën fokusin e këtij punimi.

Edhe në këtë punim, metodat shkencore të përdorura përfshijnë analizën historike dhe krahasuese të dokumenteve ligjore të periudhës, duke përfshirë praktikën shkencore të institucioneve dhe përgjigjet e ndryshme të dhëna nga ky komision, të cilat zbulojnë procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjet e tij për çështje të ndryshme ligjore.

Ky studim synon të argumentojë se komisioni ligjapërgatitës e ushtroi veprimtarinë e tij edhe në drejtime të tjera, përtej rolit fillestar kodifikues për të cilin ishte konceptuar. Nëpërmjet veprimtarisë së tij provohet shfaqja e një forme të hershme të jurisprudencës administrative në vendin tonë. Kështu, bazuar në kërkesat e institucioneve të ndryshme, ky komision dha “mendime” të ndryshme për çështje konkrete, duke kontribuar në ndërtimin e parimeve themelore që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e së drejtës. Praktika që ky komision krijoi, përcolli një opinion pozitiv në mjedisin juridik shqiptar të kohës dhe, me qëllim ruajtjen e kësaj praktike, ajo u pasqyrua më pas në krijimin e Këshillit të Shtetit në Shqipëri.

Punimi përbëhet nga dy pjesë, ku fillimisht paraqitet historiku i përpjekjeve për krijimin e komisioneve të ndryshme me qëllim reformimin e legjislacionit në Shqipëri, ndërsa pjesa e dytë fokusohet në kontributin që komisioni ligjapërgatitës ka dhënë në fusha të ndryshme të së drejtës. Në fund, punimi mbyllet me përfundimet dhe bibliografinë.

Një historik i shkurtër për ngritjen e komisioneve për reformimin e legjislacionit

Shqipëria, me shpalljen e Pavarësisë, pranoi legjislacionin osman si korpusin juridik veprues në vend. Megjithatë, nevoja për t’u shkëputur nga ky legjislacion ishte e nevojshme dhe tentativat e para janë bërë që në fazat e para të krijimit të shtetit shqiptar. Gjatë qeverisjes së Princ Vilhelm Vidit, rezulton të jetë ngritur një komision juridik, i përbërë nga Petro Poga, Kristaq Tutulani dhe Feim Mezhgorani,¹ puna e të cilit u kurorëzua me hartimin e “Kanunit për Gjykatat e Drejtësisë në Shqipëri”, një ligj i cili rregullonte organizimin gjyqësor në vend, si edhe disa aspekte të procedurës penale. Pavarësisht kësaj, dhe për shkak të trazirave

¹ Kastriot Dervishi, *Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet* (Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2012), 210.

të brendshme, shpërthimit të Luftës së Parë Botërore dhe pushtimit të vendit, deri në vitin 1921 nuk pati tentativa të tjera për hartimin dhe miratimin e ligjeve të reja që do të zëvendësonin legjislacionin e vjetër.

Megjithatë, në vitin 1921 shohim tentativën e parë në këtë drejtim, ku qeveria e asaj kohe, bazuar në kërkesën e parlamentit të kohës dhe të Kryesisë së Këshillit Kombëtar,* vendosi ngritjen e një komisioni me qëllim reformimin e legjislacionit.² Ky vendim qeverie, në fakt, nuk krijoi një komision legjislativ të mirëfilltë, por një strukturë e cila do të përzgjidhte emrat që do të punonin në hartimin e projektligjeve. Megjithatë, nuk rezulton që kjo strukturë e brendshme të ketë vepruar më tej.

Tentativa tjetër është ajo e vitit 1922, kur qeveria e asaj kohe i paraqiti Këshillit të Lartë** një propozim për miratimin e një projektligji për krijimin e komisionit legjislativ.³ Ky projektligj, i përbërë nga 11 nene, parashikonte ngritjen e një organi me tre anëtarë, me mundësinë e shtimit të një anëtari nderi nga radhët e ekspertëve të huaj që kontribuonin në organizimin e drejtësisë në Shqipëri. Anëtarët duhej të kishin arsim universitar, përvojë të spikatur profesionale, njohje të mirë të gjuhës shqipe dhe të paktën të një gjuhe të huaj europiane, si edhe aftësi përkthimi, ndërsa mosha minimale përcaktohej 30 vjeç dhe kërkohej integritet moral i pacenuar.⁴

Emërimi i anëtarëve parashikohej të bëhej me dekret të Këshillit të Lartë të Regjencës, mbi propozimin e kryeministrit dhe me pëlqimin e Këshillit të Ministrave, ndërsa mandati i tyre do të ishte pesëvjeçar dhe i shoqëruar me garancinë e patundshmërisë. Komisioni do të mbështetej nga një administratë ndihmëse dhe do të kishte gjithashtu të drejtën të botonte një periodik me shpenzimet e shtetit.⁵

Sa u përket funksioneve, projektligji i njihte komisionit dy kompetenca kryesore dhe ekskluzive: përgatitjen e të gjitha projektligjeve

* Parlamenti i kohës.

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 155, V.1921, Dosja (më tej: D.) nr. II-60 fl.2. Vendim nr. 553, datë 16.06.1921 i Këshillit të Ministrave.

** Bëhet fjalë për Këshillin e Lartë të Regjencës që funksionoi në Shqipëri në periudhën 1920-1925.

³ AQSH, F.149, V.1921, D. I-461, fl.1. Shkresë e qeverisë drejtuar Këshillit të Naltë.

⁴ Po aty, fl. 2.

⁵ Po aty.

të shtetit, mbi bazën e raporteve që ministritë do të paraqisnin për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, si edhe dhënien e interpretimeve të dispozitave ligjore sipas kërkesave të tyre. Përveç këtyre kompetencave, qeveria mund t'i delegonte komisionit edhe detyra të tjera me natyrë këshillimore dhe vendimmarrëse në çështje financiare, administrative apo kontraktore.⁶

Megjithatë, kjo ide nuk përparoi më tej, pasi u kundërshtua nga Këshilli i Lartë i Regjencës,⁷ i cili argumentoi se, *së pari*, përbërja e këtij komisioni me vetëm tre anëtarë, konsiderohej e pamjaftueshme, pasi këta persona nuk mund të ishin kompetentë në të gjitha degët e administratës. *Së dyti*, që prej Kongresit të Lushnjës ishte shprehur dëshira që kjo reformë të realizohej me ndihmën e organizatorëve të huaj, të cilët, sipas projektligjit, do të ishin vetëm anëtarë nderi; dhe *së treti*, komisionit i ishin ngarkuar aq shumë kompetenca, sa që nuk do të ishte e mundur të realizonte detyrat e tij. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë sugjeronte që të caktoheshin organizatorë të huaj për çdo degë të administratës, të cilët do të bashkëpunonin me ministritë në fushat përkatëse.⁸

Pavarësisht problematikave të kohës, synimi për ngritjen e një komisioni që do të hartonte akte ligjore moderne u ngrit në nivel kushtetues, duke u sanksionuar fillimisht në nenin 28 të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës. Ky parashikim u mbart më pas edhe në Statutin Themeltar të Republikës të vitit 1925, i cili, në nenin 32, përcaktonte përsëri ngritjen e një komisioni për hartimin e kodeve të reja. Për këtë arsye, të dyja dhomat e parlamentit miratuan ligjin përkatës për krijimin e tij.⁹ Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se veprimtaria e këtij komisioni ka filluar në fund të muajit dhjetor 1926.¹⁰

⁶ *Po aty*, fl.1-2.

⁷ Kreu i shtetit në atë periudhë.

⁸ *Po aty*, fl.3-4. Shkresë e Këshillit të Lartë drejtuar Kryeministrit, nr. 284/IV, datë 31.07.1922.

⁹ AQSH, F.155, V.1926, D. II-273, fl.79. Shkresë e Kryesisë së Republikës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, nr.1327/IX, datë 01.12.1926.

¹⁰ Në *Fletoren Zyrtare*, nr. 5, 21 kallnuer 1927, f. 1, ndodhet i publikuar një njoftim për emërimin e sekretarit dhe të kopistit të këtij komisioni, 27 dhjetor 1926.

Veprimtaria “tjetër” e komisionit ligj-përgatitës

Komisioni ligj-përgatitës, sipas ligjit të datës 24.11.1926, në nenin 1, kishte si kompetencë të vetme përkthimin dhe hartimin e kodeve. Bazuar në këtë kompetencë, nga ky komision u hartuan Kodi Penal (1927), Kodi Civil (1928), si edhe Shtojca e Dytë e Procedurës Civile (1929), ndërsa puna për Kodin Tregtar mbeti e papërfunduar. Përveç kësaj veprimtarie, nga burimet arkivore rezulton se ky komision, duke pasur një ekspertizë të lartë juridike, shërbeu si një burim i rëndësishëm për interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, veçanërisht në çështje që kërkonin sqarime ligjore dhe orientim për zbatimin e dispozitave ekzistuese.

Bazuar në burimet arkivore të hulumtuara, të cilat do të trajtohen në vijim të këtij punimi, komisioni ka dhënë mendime profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës, si në çështjet e pronësisë, të së drejtës tregtare, të administrimit të pronave shtetërore dhe interpretimit të kontratave administrative, duke u shndërruar kështu në një autoritet të rëndësishëm për orientimin dhe konsolidimin e praktikave administrative dhe juridike të vendit. Në vijim do të trajtohen me radhë kontributet e tij në secilën prej këtyre fushave.

Pavlefshmëria e akteve administrative

Megjithëse shteti shqiptar konsiderohej relativisht i ri në atë kohë, e drejta administrative ka qenë gjithmonë prezente dhe ka shoqëruar organizimin shtetëror. Përsa i përket legjislacionit konkret që zbatohej në atë periudhë, pas shpalljes së Pavarësisë, rezulton se vijoi të zbatohej e drejta osmane, e cila më pas u zëvendësua dhe u plotësua gradualisht me legjislacionin shqiptar. E drejta administrative u përdor nga shteti edhe për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme midis privatëve, si dhe aspekte të tjera që, në dukje, i përkasin së drejtës civile. Kështu, rezulton se ligjvënësi i kohës kishte miratuar një akt ligjor mbi posedimin, i cili parashikonte zgjidhjen në rrugë administrative të mosmarrëveshjeve lidhur me posedimin e pronave ndërmjet privatëve. Organet kompetente për shqyrtimin e këtyre çështjeve, sipas rastit, ishin këshillat administrativë të nënprefekturave dhe prefekturave (kjo e fundit vepronte dhe ushtronte kompetencat në të ashtuquajturën nënprefekturë qendrore,

pra në rrethin ku ndodhej selia e prefekturës. Në këtë rast, nuk krijohet një nënprefekturë e veçantë për rrethin qendror).

Sipas së drejtës administrative të kohës, aktet e këtyre këshillave mund të apeloreshin në Këshillin e Ministrave, i cili vendoste përfundimisht. Megjithatë, për konfliktet posedimore, ligji i ri parashikonte se vendimet e tyre ishin të formës së prerë. Në këtë aspekt, përpara komisionit ligj-përgatitës u paraqit, me qëllim dhënien e një mendimi këshillimor, çështja e vlerës dhe kuptimit të këtij parashikimi ligjor, pra deri në ç'masë shtrihej fuqia e kësaj vendimmarrjeje, për të cilën komisioni u shpreh se:

“Komisioni Legjislatif mbi kërkesën apeloire të katundit Labovë e madhe dhe Labov e vogël të dhanun kundra vendimit të Këshillit Administrativ të Gjinokastrës, ka nderin të çfaqë kët mejtëm:

Sikundër rezulton nga shqyrtimi i akteve, katundi Labovë ka pretendue para Këshillit Administrativ të Gjinokastrës inkompetencën e këtij Këshilli për shkak se këto kullota ndodhen në rrethin e N/Prefekturës së Tepelenës, por këtë kundërshtim Këshilla e ka refuzue tuj u bazue në një rregjistrim kadastruer të vitit 1923, pa mos marun parasyesh tapit e paraqituna ng'an e Labovës, dhe në vendimin Nr. 48 datë 24.I.1928 i ka lanë nëdorësiën Sheraf Karagjozit.

Kët vendim katundet e nalt-përmenduna e kundërshtojn tue thanë se vendimi asht i jashtëligjëshëm si i dhanun prej një këshilli inkompetentë dhe jashtë konditave qi lypë ligja.

Nga shqyrtimi i vendimit rezulton se Këshilli administrativ asht mjaftue vetëm në tapin e paraqitun nga an'e Sherafit për me provue se kullotat janë në rrethin e Gjinokastrës dhe nuk ka bā fjalë për atë të paraqitun prej Labovës.

Gjithashtu ky vendim në themel nuk tregon kushtet e lypuna prej ligjës d.m.th. se Sherafi ka qenë nëdorës të paktën një vjet dhe që nëdorësiya e tij i asht marrë jo ma parë se ç'prej 6 muej dhe përdhunësisht ose me dredhi.

Sa do që neni 7 i ligjës në fjalë thotë se vendimet e Këshillave mbi çashtjet e nëdorësiës janë të preme, por se supozohet kurdoherë që vendimi asht dhanun prej një këshille mbrenda kompetencës saj dhe se përmban elementat e lypuna prej ligjës dhe këto rezultojnë nga vendimi. Për ndryshe vendimi është i pavlefshëm.

Vetëm pra, në këto raste vendimi nuk mund t'atakohet dhe autoritetet superiore nuk mundën me ndërhye në ç'mimin e fakteve dhe në shqyrtimin e vendimit.

Ligjvuesi tue i u dhanë fuqiën e premë vendimeve të këshillave, ka caktue dhe konditat dhe rastet kur këto janë kompetentë, dhe pikën në se eksistojnë në një çashtje këto kondita ose jo ka të drejtë t'a shqyrtoj autoriteti m'i nalt. Për ndryshe këshillat do mundnin të kalonin pushtetin q'u asht dhanë tue u përziej në detyra të hueja, dhe, posë kësaj, do të shkaktoheshin konfuzione mādīs autoritetve të ndryshme.

Pra dhe vendimi në fjalë për me qenë i pacenueshëm duhet që këshilli të ketë veprue mbrenda kompetencës landore e teritoriale, që të cilën mund t'a shqyrtojë Këshillit Ministruer.

Për këto arsye na jemi të mejtimit që: për zgjidhjen e konfliktit në fjalë, dhe për të çmue vleftësiën e vendimit, duhet të hetohet si nga rregjistrat kadastrorë ashtu dhe nga fakte të tjera në se kullotat e kontestuese ndodhen në rrethin e Gjinokastrës ose n'atë të Tepelenës, si dhe nëdorësiën e mëparëshme dhe mënyrën e marrjes të sajë, dhe, në qoftë se nga ato hetime rezulton se kullota asht në rrethin e Tepelenës, duhet të prishet vendimi dhe t'urdhënohet kthimi në gjendjen e maparëshme tue lanë të lirë anën e interesuese t'i drejtohet këshillit administrativ kompetentë, dhe përkundrazi në qoftë se rezulton që kullota asht në qarkun administrativ të Gjinokastrës dhe Sheraf Karagjozi ka pasë nëdorësiën e kullotës qysh prej një viti dhe se përdhunisht ose me dredhi i ash marrë 6 muej ma parë, vendimi duhet t'aprovohet, dhe në rast që sa do që kullota asht në këtë qark por nuk vërtetohet nëdorësija e Sherafit qysh prej një viti dhe marrja e nëdorësiës qysh 6 muej para drejtimit në këshillë duhet që të lihet në dorën e katundit Labovë, tue pasë të drejtë ana tjetër me ju drejtue Gjyqit Kompetentë".

Nga analiza e mësipërme rezulton se ndodhemi përpara qëndrimit të parë, të paktën sipas hulumtimeve të deritanishme, ku konstatohet pavlefshmëria absolute e një akti administrativ. Në rastin konkret, komisioni shprehet se aktet administrative të nxjerra në mungesë të kompetencës ligjore, në këtë rast të kompetencës tokësore në diskutim, konsideroheshin si akte absolutisht të pavlefshme. Si të tilla, ato mund të

konstatoheshin edhe nga organet që shqyrtonin ankesat kundër këtyre akteve, kompetencë që në atë kohë ushtrohej nga Këshilli i Ministrave për aktet e këshillave administrativë, pavarësisht se, formalisht, vendimmarrja konsiderohej e formës së prerë. Ky parashikim nuk zbatohet për aktet absolutisht të pavlefshme, të cilat konsideroheshin të paqena.

Kontratat administrative

Një tjetër fushë në të cilën komisioni ligjpërgatitës dha mendimin e tij ishte ajo e së drejtës kontraktore. Megjithëse e drejta dhe legjislacioni i kohës njihnin kontratat administrative, mbi to zbatoheshin edhe parimet e së drejtës civile në rastet kur legjislacioni i posaçëm nuk kishte parashikime apo rregullime konkrete. Një rregullim i ngjashëm njihet edhe nga legjislacioni i sotëm.¹¹

Një çështje që duhej të trajtonte komisioni ligjpërgatitës kishte të bënte me kompetencën për zgjidhjen e kontratës në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore. Kështu, mbi bazën e kërkesës së zyrës së financës së qytetit të Shkodrës, këshilli administrativ i prefekturës kishte vendosur zgjidhjen e kontratës ndërmjet saj dhe një sipërmarrësi për administrimin e “dajlanëve” në Lezhë dhe në Shkodër. Sipërmarrësi, duke mos qenë dakord me këtë vendim, e ankimoi atë në Këshillin e Ministrave, i cili paraprakisht kërkoi mendimin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa kjo e fundit iu drejtua komisionit ligjpërgatitës. Komisioni, në këtë rast, u shpreh se

“Nga pikpamja juridike dhe tue marre parasyesh dispozitat e ligjave administrative në veprim të cillat flasin e caktojnë kompetencat e këshillave Administrative përgjithsisht, shifet se këshilla Administrative e Shkodres ka kapërcye kompetencen administrative tue vendos prishjen e një kontrate sinalogmative administrativisht, zgjedhje e cilla mund të vendosej vetëm prej Gjyqjit kompetent që ka të drejtë me çmue pretendime asodore.

¹¹ Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 124: “Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore.”

M’anë tjetër dhe si mbas Nenit 4, të letër-adjudikatës të drejtën e zgjidhjes e ka Drejtoria e Financave në rast që sipermarrësi kishte m’i mungue pagimit të kisteve tjera. Por sado që n’atë nen thuhet se Drejtoria e Financave mundet me zgjidhë kontratën pa i drejtue Gjyqijt por se kjo e drejt nuk mundet t’ushtrohet apsolutisht edhe kur ana tjetër pretendon shkaqet të cilat Gjyqi kompetent tue marrun parasysh cirkustancën, e tue interpretue kontratën mund t’i çmojn si t’arsyeshme për refuzim pagimi.

Prandej, tue qenë se kërkesa apeloire asht dhanë mbrena afatit të 20 ditve dhe vendimi i këshillit nuk shifet i ligjeshëm, komisioni bashkarisht asht i mendimit qi vendimi në fjalë të prishet e Drejtoria e Financave t’i drejtohet Zyres së përmbarimit për me ekzekutue kontratën ose të kërkojë nga Gjyqi prishjen e saj”.¹²

Referuar analizës së mësipërme, del qartë se qëllimi i komisionit ligjvërtetues në këtë rast ishte kufizimi i kompetencave të organeve administrative për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratave të lidhura me palët e tjera.

Një tjetër tematikë e trajtuar nga komisioni ligjvërtetues lidhej me fazën paraprake të prokurimit publik, konkretisht me garancinë e dhënë nga palët pjesëmarrëse në një ofertë publike. Kështu, rezultoi se Forcat e Armatosura të kohës, për nevojat e tyre, kishin porositur kafshë tërheqëse (mushka) të tipit “amerikan”. Në këtë procedurë morën pjesë dy shoqëri, të cilat depozituan edhe garancitë përkatëse. Megjithatë, gjatë verifikimit të kafshëve, u konstatua se mushkat e ofruara nga njëra prej shoqërive nuk përmbushnin kërkesat e shpallura. Atëherë, Forcat e Armatosura anuluan procedurën e parë të prokurimit dhe shpallën një procedurë të re. Debati që lindi kishte të bënte me subjektin e skualifikuar dhe me çështjen nëse garancia e depozituar në procedurën e parë duhej apo jo t’i kthehej atij. Duke qenë se ky subjekt kërkonte kthimin e saj, ndërsa Komanda e Lartë e Forcave të Armatosura pretendonte të kundërtën, për këtë çështje u kërkuar mendimi i komisionit ligjvërtetues, i cili u shpreh se:

¹² AQSH, F.155, V.1928, D. V-534, fl.1. Mendim i komisionit legjislativ pranë Ministrisë së Drejtësisë lidhur me çështjen e prishjes ose jo të kontratave midis kontraktuesve të Dajlanit të Shkodrës, si dhe me ekzekutimin e vendimit gjyqësor nga zyra e përmbarimit.

“Qëllimi i kancionit në raste kësodore asht sigunimi i ekzekutimit të kontratës në qoftë se pranohet oferta dhe lidhet kontrata. Por një kontratë e tillë nuk asht lith me Begollin. Posë kësaj nuk mund të bahen pretendime kundra këtij për mos blemjen e mushkave amerikane, jo vetëm se vetë Komn.P.F. armate mbas anulimit të kontratës së lidhun me Strafilin shpalli adjudikatë tjetër, pa caktue llojin dhe origjinën e mushkave, siç thuhet n’atë shkresë, po dhe se ajo Komandë autorizoj blenjen’e mushkave Italiane dhe lidhi kontratë tjetër me Strafilen, e kështu nuk ka vend për ndalimin e kancionit. Prandaj jemi të mejtimit që t’i kthehet Guarnierit (e përfaqësuem prej Z. Begolli) kancioni i depozituem”.¹³

Nga analiza e rasteve të mësipërme rezulton se komisioni ligj-përgatitës konstatoi se procedura e re e prokurimit nuk parashikonte kriteret lidhur me llojin e kafshëve, pra nuk përcaktonte as llojin dhe as origjinën e tyre, duke e lidhur kontratën pikërisht me të njëjtin subjekt që ishte skualifikuar në procedurën e parë. Për këto arsye, komisioni vlerësoi se qasja e Komandës së ushtrisë për mbajtjen e garancisë ishte e tepruar dhe e veshur me një formalizëm të panevojshëm. Këto qëndrime tregojnë përkushtimin e komisionit që procedurat e prokurimeve publike të ishin të drejta dhe për palët në proces të gjente zbatim parimi i sigurisë juridike.

E drejta tregtare

Megjithëse, siç u përmend më sipër, puna e komisionit për projekt-kodin tregtar ishte shumë e paktë, në Shqipëri vijonte të zbatohet Kodi Tregtar osman i vitit 1850, me ndryshimet përkatëse. Një nga kompetencat që rridhnin nga legjislacioni tregtar i asaj kohe ishte verifikimi nëse statuti i shoqërive tregtare me ortakë të huaj, të cilat do të vepronin në Shqipëri, ishte ose jo në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar. Sipas procedurës së kohës, verifikimi fillestar kryhej nga Ministria e Financave, e cila ia përcillte më pas Këshillit të Ministrave, i cili vendoste përfundimisht. Gjatë verifikimit fillestar, nëse

¹³ Po aty, F.155, V.1928, D. V-152, fl.5-6. Kërkesë dhe korrespondencë e Ministrisë së Drejtësisë me komisionin ligj-përgatitës mbi dhënien e mendimit ligjor për zbatimin e kontratave.

kishte vërejtje, Ministria e Financave i sugjeronte shoqërisë realizimin e ndryshimeve përkatëse. Nëse shoqëria nuk ishte dakord, atëherë çështja vendosej nga Këshilli i Ministrave. Megjithatë, pas krijimit të komisionit ligj-përgatitës, Këshilli i Ministrave, në rast kundërshtimi midis Ministrisë së Financave dhe shoqërisë, dukej se kërkonte edhe mendimin e këtij komisioni. Kështu, në një rast të gjurmuar në arkiv rezulton se një shoqëri e formuar nga një shtetas italian kishte aplikuar sipas kësaj procedure. Ministria e Financave sugjeroi disa ndryshime në statut, konkretisht që ortakët themelues të ishin më shumë se një, që statuti të hartohej në gjuhën shqipe, si edhe të rregulloheshin disa kontradikta midis neneve të ndryshme të statutit lidhur me trashëgiminë e aksioneve. Duke qenë se përfaqësuesi i shoqërisë nuk ishte dakord, çështja kaloi për vendimmarrje në Këshillin e Ministrave,¹⁴ i cili, nga ana e tij, kërkoi mendimin e komisionit ligj-përgatitës.¹⁵ Në mendimin e tij, komisioni ligj-përgatitës arsyetoi se:

“A-- Statuti i Shoqëries në fjalë nuk përmban nënshkrimet që të munt të kuptohet se cillët janë themeltarët ose Këshilla e përkoheshme administrative e Shoqërisë.

B-- Që të jetë e mundur t’aprovuemit e një Statuti Shoqërie duhet si mbas nenit 31 të Kodit Tregtar, të bëhet me akt zyrtar.

C-- Në nenin 4 të Statutit ku caktohet qëllimi i Shoqërisë, përmendet se ka me u marrun me punëra bujqësore, metalike, industriale, hekurudhash dhe me punëra në degën detare në lumenj etj., shumë punëra të cilat lypin përgjithësisht një kapital mjaft të randë.

Për një shumë prej 100,000 fr. ari që tregohet si kapital i Shoqërisë nuk duket e mjaftme për atë entrepriza. Veçanërisht, tue u marun parasysh punërat që ka për qëllim të bajë si në Shqipënie ashtu edhe përjashta si mbas art.4, si dhe kapitali i përmendun n’art.5 nuk mbesohet se një e tillë shoqërie ka me qenë serioze në veprimet dhe sidomos ka me mujtë me fillue e me realizue ato punëra.

¹⁴ *Po aty*, F.149, V. 1927, D. III-1042, fl.1. Shkresë e Ministrisë së Financave drejtuar Kryesisë së Këshillit Ministruer, nr. 954/III, datë 12.01.1927.

¹⁵ *Po aty*, fl.2. Shkresë e Kryesisë së Këshillit Ministruer drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, datë 20.01.1927.

Ç-- N'Art. 14 të Statutit nuk është parashikue rasti që, kur aksionisti i ka të pagueme ose të depozitueme gjetkë aksionet e veta të ketë të drejtë me marun pjesë dhe me votue në kuvendin po sa që të mundë të provojë se asht i zoti i aksioneve të pagueme ose të depozitueme dhe zotnimi i tij mbi ato aksione nuk asht i kontestuem; dhe kështu aksioneri n'artikullin e naltë-përmendum ka me humbë të drejtën pa qe të ketë ndonjë arsye a dobi për Shoqëninë.

D--Në nenin 19 thuhet se Këshilli administrativ i kësaj Shoqënie mundet të përmbahet prej dy vetave, gja kjo që tue marun parasysh punërat e mëdhaja me të cilat ka m'u marun dhe detyrat që kanë me pasë njani si Kryetar dhe tjetri si arkëtar, nuk shihet e pëlqyeshme për interesin dhe mbarëvajtjen e shoqënisë; pra Këshilli duhet me qenë i formuem të paktën prej tre, në mos prej pesë vetash, për me mujtë me i ba ballë nevojave që lyp puna.

Dh-- N'art 21 të Statutit ku bahet fjalë për zgjedhjen e një kryetari dhe të këshilltarit-sekretar, nuk është caktue se, këta nga të cilët do të merren, veçanërisht nga pikëpamja e zgjedhjes së komitetit prej Këshillit administrativ, ka me lindë një konfuzion tue qenë se këshilli administrativ i përbamë prej dy vetave munt të zgjedhë vehten dhe për antar në komitet e në raste që do të jetë e nevojshme për zgjedhjen dhe të një nënkryetari nuk do të jetë e mundun kur këshilla do të jetë e përmbame prej dy vetash si mbas art.19.

E--Artikulli 23 nuk ka kuptimin e plotë të kompetencës që ka pasë komiteti administrativ e cila kompetencë i referohet Këshillit administrativ, përkundrazi në këtë mënyrë shifet një konfuzion kompetencash të këshillit dhe të komitetit kur janë veç e veç.

Veçan këtyne të metave asht për t'u permend dhe gjuha e keqe dhe pa kuptim të plotë q'asht përdorë në redaktimin e këtij Statuti".¹⁶

Nga analiza e komisionit ligjpergatitës rezulton se verifikimi i statutit të shoqërisë është bërë në disa plane, ku përfshiheshin aspekti ligjor, administrativ, ekonomik dhe gjuhësor. Konkluzionet e komisionit u pranuan nga Këshilli i Ministrave, i cili ia përcolli ato Ministrisë së

¹⁶ Po aty, fl.5-6. Mendim-ligjuer i komisionit ligjpergatitës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Financave, duke i kërkuar kësaj të fundit të vinte në dijeni shoqërinë, me qëllim që ajo të redaktonte statutin e saj në përputhje me këto konkluzione.¹⁷

Gjithashtu, dispozita të caktuara të Kodit Tregtar mund të ishin të paqarta për t’u zbatuar në rrethana të caktuara. Për këtë arsye, komisioni ligj-përgatitës ka dhënë mendimin e tij edhe në këtë fushë. Kështu, mbi bazën e kërkesës së një tregtari në Korçë, i cili kërkonte që të emërohej nga gjykata një administrator për ato shoqëri që ishin në konflikt, komisioni ligj-përgatitës dha mendimin e tij si vijon:

“Në legjislacionin q’asht në fuqi nuk ka dispozita me të cilat t’i lejohet Gjykatës t’emnojë një person të tretë si administrator të shoqnisë sipërmarrjeje ose pune q’asht në grindje. Aq ma tepër një tagër i tillë nuk u asht akordue autoriteteve qeveritare ose administrative. Prandaj Ministrija e Punevet të Brendshme nuk mundet me mare massën që lypin kërkuesit.

Shtojmë vetëm se Kodi Civil i ri dhe Shtojca e re e Procedurës Civile që hynë në fuqi me 1 Prillë 1929 lejojnë që gjykata në raste analloge, kur ekzistojnë konditat e nenit 1787 të K.C. tue mare parasyesh dhe nenin 388 të Shtojcës II të Pr. civile të vendosë sekuestro gjyqësore tue emnue një sekuestratar me tagrat e tregueme në K.C”.¹⁸

Në rastin e mësipërm, komisioni ligj-përgatitës u përpoq të zgjidhte një situatë e cila dukej se nuk kishte gjetur parashikim në legjislacionin tregtar të kohës. Kështu, sipas komisionit, legjislacioni në fuqi nuk i jepte gjykatës apo institucioneve të tjera administrative kompetencën për të ndërhyrë në administrimin e shoqërive private përmes emërimit të një personi të tretë në cilësinë e administratorit. Ky qëndrim tregon kujdesin e komisionit, i cili u vinte në dukje autoriteteve shtetërore dhe atyre gjyqësore se nuk duhej të vepronin në mungesë të parashikimeve ligjore dhe se e vetmja mundësi ishte të pritej hyrja në fuqi e akteve të reja ligjore që do të rregullonin një situatë të tillë.

¹⁷ Po aty, fl.7. Shkresë e Kryesisë së Këshillit të Ministrave drejtuar Ministrisë së Financave.

¹⁸ AQSH, F. 149, V. 1927, D. I-1953, fl.1. Shkresë e datës 08.03.1929 e komisionit ligj-përgatitës, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, e cila, me shkresën nr. 657/1, datë 23.03.1929 ia përcillte z. Dhimitër Mano, tregtar në Korçë.

Vërtetimi i pronësisë mbi pyjet

Çështja e pronësisë mbi toka të ndryshme në vendin tonë ka qenë gjithmonë problematike. Një ndër këto problematika ka qenë edhe vërtetimi i pronësisë mbi pyjet, ku subjekte të ndryshme pretendonin pronësi private mbi to.

Me sa duket, me qëllim marrjen e një mendimi sa më të specializuar lidhur me vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet private, duhet kërkuar arsyeja se përse filloi të kërkohej edhe mendimi i komisionit ligj-përgatitës në këto procedura. Kështu, në burimet arkivore gjendet edhe një kërkesë e Kryesisë së Këshillit Ministror drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim,¹⁹ e cila shërbente si ndërmjetëse midis institucioneve të ndryshme dhe komisionit ligj-përgatitës.²⁰

Nga analiza e burimeve arkivore rezulton se komisioni ligj-përgatitës, gjatë shqyrtimit të kërkesave për dhënie mendimi, kërkonte plotësimin e dokumentacionit,²¹ siç ishte paraqitja e origjinalit të fermanit mbretëror apo të “mazbatasë”.^{***} Mendimi i komisionit, i gjetur në dokumentacionin arkivor, është në fakt interesant, pasi rezulton se anëtarët ishin ndarë në mënyrë të barabartë. Nga dosja arkivore rezulton se si qëndrim i shumicës është konsideruar ai i mbajtur nga kryetari i komisionit.

Referuar këtyre burimeve, rezulton se pronësia në atë kohë mund të vërtetohej vetëm përmes analizës së dokumentacionit të prodhuar nga administrata osmane, si edhe të legjislacionit osman përkatës, i cili, në bazë të vendimit të Qeverisë së Vlorës, konsiderohej si pjesë e

¹⁹ *Po aty*, F. 155, V. 1928, D. IV-215, fl. 48. Shkresë e Kryesisë së Republikës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, nr.144, datë 03.02.1928.

²⁰ *Po aty*, fl. 49. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Kryesisë së Republikës, nr. 2815 (pa datë); *po aty*, fl. 59. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Kryesisë së Republikës, datë 24.06.1928; *po aty*, fl. 62. Shkresë e Kryesisë së Republikës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, datë 24.07.1928.

²¹ *Po aty*, fl. 46. Shkresë (pa numër dhe datë) e komisionit ligj-përgatitës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

^{***} Fjala “mazbata” është një term juridiko-administrativ me prejardhje osmane (nga turqishtja *mazbata*), që përdorej në administratën shqiptare në periudhën e viteve 1912-1930. Ky term nënkupton një “akt zyrtar të shkruar”, në të cilin pasqyrohet një vendim, një konstatim, një procedurë ose një ngjarje e zhvilluar nga një organ publik.

legjislacionit të shtetit shqiptar. Në këtë drejtim, rezulton se për këto lloje çështjesh legjislacioni i zbatueshëm ishte Kodi Rural dhe Ligji Osman i Pyjeve.

Përsa i përket dokumentacionit, rezulton se nga ana e këtij komisioni janë analizuar vendimet e këshillave administrativë, si edhe fermanët e nxjerrë nga Porta e Lartë.²²

Në lidhje me interpretimin e ligjeve osmane, dy anëtarë të komisionit ligj-përgatitës, të cilët i cilësojmë shumicë, kanë mbajtur qëndrimin se:

“Asht e tepërt me shpjegue se, pylli e kullotë nuk janë një, por kanë kuptim të ndryshëm në pikëpamjen e Kodit rural. Një pyell në për majet e ndopër regjinat, sidomos kur janë të nalta kanë kullota verore qi quhen jajlak, pra tapiët e lajlakës nuk mund të konsiderohen si dokument për zotnimin privat të një pyelli.

Popullsië e katundeve Qatrom e Orevnik kundrejt ktij vendimi paraqisin një ferman me datë 15/Shaban/1254 exhir. Ky ferman mbasi bën fjalë mbi konfliktin e ngjamun midis katundit Drenovë edhe katundevet Kajas (qi asht Qatromi vjetër) edhe mbasi referohet në regjistrat e deferhanës imperiale ose perandore shton se, n’atë regjistra n’emën korie nuk asht pa gjë sendi prandaj pyelli në kontestm asht (xhibali-muhaba) d.mth. pyell i lirë ku kanë të drejtë katundet në fjalë të presin dru për zjarm dhe për nevoja bulqësore dhe të tjera të tyne. Natyrisht qi ky ferman qi ka një datë ma të vjetër se mazbatatë edhe tapiet në fjalë tregon me një mënyrë të parrëfysueshëm se pyelli në kontestim asht konsiderue pyell i lirë edhe simbas nenit 104 të kodit rural, asht e ndalueme shitja e tyne. Me promulgimin e ligjës Ottomane mbi pyejt edhe simbas nenit 5 të ktij ligji kto pyelle të lira me të vuemunit në zbatim të ktij ligji bënen pyelle shtetnore. Edhe simbas nenit të parë po t’asaj ligje kto pyelle për të hyrë në zotnimin e shtetit efektivisht lipset të kufizohen e të merren në rregullim prej zyrës së pyjevet.

Edhe pyllt shtetnore me qenë se i takojnë interesës publike nuk mund të shiten veç se me një ligj të posaçme. Prandaj merret vesht vetvetiu se katundi i Drenovës duke qenë çiflik me 1290 u asht shitë katundarëve me shumën e sipërcaktueme edhe simbas dispozitave të ligjevet përkatëse në veprim asi kohe pyelli

²² Po aty, fl. 63-67. Mendimi i datës 12.08.1928 i komisionit ligj-përgatitës.

Drenovës as mund të shitej e as nuk asht shitë privatëve. M'anë tjetër ky pyell qi edhe simbas nenit 5 të ligjës ottomane mbi pyjet, virtualisht konsiderohet pyell i shtetit për efektivisht me qenë se nuk asht kufizue e nuk asht marrë në rregullim deri sa të kryhen kto formalitetet efektivisht mbetet xhibali-muhaba. Si do qi të konsiderohet pyelli në kontestim e pyell i lirë ose pyell i Shtetit ato katunde qi si mbas zakonisht të moçëm edhe si mbas nevojës kanë të drejtë në konformitet të ligjës së pyjeve, me pre drue për zjar, landë për ndërtesë edhe për vegla bujqësore. Me qenë se dhe e drejta e të premes dru ka dhe kjo një nëdorësie edhe me qenë se kjo nëdorësie ekziston deri në ditën e sotme vendimi i Këshillës administrative asht konform me ligjë edhe vendimi i Ministriës së Bujqësiës përse i përket pyellit duhet t'anulohet se është në kundërshtim me ligjet”.²³

Nga analiza e këtij arsytimi duket qartë përpjekja e komisionit për të shpjeguar gjendjen juridike dhe legjislacionin e zbatueshëm lidhur me pronësinë mbi pyjet. Më pas, komisioni kalon në analizën e regjimit juridik të pyjeve, duke shpjeguar edhe llojet e pronësisë që ekzistojnë mbi to (pyll i lirë dhe pyll shtetëror), pamundësinë e disponimit të tyre, si edhe të drejtat që gëzojnë banorët e fshatrave të ndryshme për shfrytëzimin e këtyre pyjeve. Interesant në këtë rast është fakti se, përveç të drejtave që buronin nga ligji i kohës, fshatarët, të cilët ishin edhe posedues të këtyre pyjeve, kishin të drejtë t'i përdornin ato edhe në bazë të zakonit të vjetër. Kështu, në këtë mendim të komisionit pranohej si e zbatueshme edhe e drejta zakonore, megjithëse nuk e trajton në mënyrë të zgjeruar.

Në vijim të kësaj çështjeje, dy anëtarët e tjerë, të cilët mbetën në pakicë, mbajtën qëndrimin se:

“Tue lanë në një ana çmimin e vlefshmërisë së dokumentave, i cili siç u tha më sipër, i përket gjyqit, asht një fakt i pakontestueshëm se të dy palët çprej një kohe të gjatë kanë pasë një nëdorësië në pyllin e kontestuem dhe kanë pre dru vazhdimisht, e grindja e Drenovës sikur nuk ka qenë në gradë që t'a heqë derën Qatromit e Rahovës me anë gjyqi, prandaj jemi të mendimit që:

²³ Po aty, fl. 66-67. Mendimi i datës 12.08.1928 i komisionit ligj-përgatitës.

1/ Vendimi i kshillit Administrativ të Korçës sado që asht në një kohë kur ajo nuk ka qenë kompetente me vendosë mbi status quon si mbas ligjës së re të nëdorësisë për shkak se ajo ligjë nuk ka qenë promulgue, përse Këshilli Ministrues e shqyrton si apel dhe ajo ligjë sot ndodhet në fuqië, duhet që ay vendim të ligjërohet tu u modifikue në mënyrë që:

2/ Të detyrohen katundet Qatrom e Rsvnik m’i drejtue gjykatës kompetente brenda një kohe të arsyeshme për me vleftësue të drejtën e premjes dru që përmban fermani, mbasi ligji i pyjeve i ka ngritë pyjet e lira dhe deri në provim të kundërtën prerja e lirë asht e papajtueshme në privatësin e një pylli që Ministria kompetente e ka njoft si t’atillë”.²⁴

Nëse analizojmë mendimin e këtyre dy anëtarëve të tjerë, rezulton se ata ishin për ruajtjen e gjendjes ekzistuese, siç kishte vendosur këshilli administrativ i prefekturës së Korçës, por me qëllim që palët t’i drejtoheshin gjykatës për vërtetimin dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Administrimi i pronave shtetërore

Shteti i pavarur shqiptar trashëgoi nga Perandoria Osmane edhe disa prona shtetërore. Por identifikimi i saktë dhe ruajtja e tyre kanë qenë problematike që në fillim. Mjafton të përmendim një nga vendimet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, e cila ngriti një komision verifikues për këtë qëllim, por që nuk pati shumë sukses. Kjo problematikë e shoqëroi shtetin shqiptar edhe në vijim. Për këtë arsye, kontrollet e vazhdueshme nga organet shtetërore dhe përballja me persona privatë, të cilët, në bazë të akteve të ndryshme, pretendonin pronësinë mbi pronat shtetërore, ishin diçka e zakonshme në atë kohë. Në përpjekje për të ndërmarrë veprime, gjithmonë brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, autoritetet shtetërore kërkonin vazhdimisht mendime lidhur me mënyrën e procedimit në raste të tilla. Është e kuptueshme se, pas krijimit të komisionit ligj-përgatitës, për çështje të caktuara kërkohej edhe mendimi i këtij organi.

²⁴ Po aty, fl. 74. Mendimi i datës 12.08.1928 i dy anëtarëve të komisionit ligj-përgatitës.

Kështu, në një rast konkret, me qëllim ruajtjen e të drejtave pronësore mbi llixhat e Elbasanit, për të cilat pretendonin të drejta pronësie edhe persona privatë, mbi bazën e kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, komisioni ligjvënës dhe shpjegimet vijuese:

“Ujënat minerale që burojnë në Llixhë dhe e drejta e përdorimit të këtyne, i takon Shtetit dhe në qoftë se ky i ka koncedue Bashkisë Elbasanit i përket kësaj.

Sa për tokat që ndodhen pa kundërshtim qysh prej njëzet vjetve në posedimin e Bashkisë, edhe këto me shkakun e një zotnimi të tillë i takojnë po asaj, po për ato toka të cilat disa privatë kanë titra kadastrorë këto duhen të çfuqizohen me anë gjyqi, në qoftë se Bashkia pretendon ndonji të drejtë.

Si kundër kuptohet nga faktet e tregueme në hetimet dhe në raportin e inspektorit të M. Brendshme, tapia që ka marrë Z. Gani Bunga bazohet në një akt-gjykim të kundër-ligjshme i cili asht dhanë mbi një padie fiktive, prandaj Zyra e Bashkies duhet t’i drejtohet Gjyqit Shk.I. me cilësi kundërshtimi personit të tretë dhe të kërkojë prishjen e akt-gjykimit, si edhe anulimin e tapisë së marrun në atë mënyrë.

Kështu munt të bëjë paditë dhe për të tjerët që kanë tapina në qoftë se shëf vehten të damtueme.

Eksproprijimi i padinave të ngrehuna prej privatëve nuk duhet të bahet veç se në rast që Bashkia nuk fiton të drejtë në Gjyq”.²⁵

Nga mendimi i mësipërm i këtij komisioni rezulton se, në radhë të parë, ujërat termale që burojnë nga nëntoka ky institucion i konsideron në mënyrë të padiskutueshme si pasuri shtetërore. Më tej, në lidhje me problematikat që shfaqeshin me personat privatë, komisioni sugjeron si zgjidhje ndjekjen e rrugës gjyqësore, pa u shprehur për injorimin e tyre apo shfuqizimin në rrugë administrative. Pra, siç mund të konstatohet,

²⁵ AQSH, F. 155, V. 1928, D. IV-243, fl. 4. Korrespondencë e Ministrisë së Drejtësisë me Kryesinë e Këshillit të Ministrave dhe komisionin legjislativ mbi studimin dhe dhënien e mendimit për konfliktin e lindur nga bashkia e shtetit lidhur me posedimin e tokave në llixhat e Elbasanit, si edhe për shpronësimin e tokave me rastin e stabilizimit të banjave.

titujt e pronësisë, të fituar në çfarëdolloj mënyre, mund të shfuqizoheshin vetëm në rrugë gjyqësore.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në të drejtën familjare

Një tjetër aspekt për të cilin është kërkuar mendimi i këtij komisioni lidhet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës familjare. Rasti konkret ka të bëjë me refuzimin e një babai për t’i lejuar nënës të shihte fëmijën e saj. Në atë kohë, e drejta familjare rregullohej nga e drejta fetare, ndërsa drejtësia familjare ushtrohej nga gjykatat fetare, ku, në rastin e komunitetit mysliman, nga gjykatat e sheriatit.

Në këto raste, zyrat e përmbarimit, duke zbatuar ligjin e përmbarimit të kohës osmane, aplikuan me analogji një dispozitë që lejonte burgimin e debitorit, në rastin konkret të prindit që duhej të lejonte ushtrimin e së drejtës së takimit të prindit tjetër, në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi. Kjo mënyrë veprimi solli reagimin e prokurorisë, e cila iu drejtua Ministrisë së Drejtësisë për marrjen e një mendimi, ndërsa kjo e fundit kërkoi mendim nga komisioni ligj-përgatitës, i cili mbajti qëndrimin se:

“Po neni 32 i ligjës përmbarimit parashikon rastin e mos pagimit të detës dhe sadoqë, në fjalën detë hynë çdo obligim për një gjë që përfshihet në kuptimin’e fjalëvet send, pasuni ca ma mirë në sensin e fjalës vet-gjë, kurrë nuk mund të zgjanohet kuptimi i ktyen ekspresionevet aq sa të përfshijë edhe domethanjen e fjalës person në të cilën hynë dhe detyrimi me dorëzu një të vogël. Këtë kuptim kanë dhe dy vendimet e Këshillit Drejtësiës të vitit gusht 305 allaturka të cillat flasin për burgimin e të dënuemvet që nuk duen me dhanë sendet e lujtëshme me dorëzimin e të cilavet janë dënuë. Nuk ka as një dyshim se n’ekspresionin send i luejtshëm nuk përfshihet personi.

M’anë tjetër, ligja e përmbarimit nuk ka lejuë burgimin e nëpunësit për asnjë rast, dhe ligjvnësi po të kishte për qëllim burgimin e një nëpunësi eksepsionalisht për këto raste, nuk do të mungonte me e thanë shprehimisht mbasi mjeti shtrëngues i nenit 32 asht një masë

kundra liriës personale, dhe dispozitat përkatëse duhet kurdoherë t'interpretohen ngushtësisht.

Prandaj,

tue mos qenë n'akord me mendimin e çfaqun prej Këshillit Ligjier me datë 3/VII/926 nr.1076/II jemi të mendimit që vendimi i Zyrës përmbarueset të Gjinokastrës asht i kundraligjshëm.

Sa për mënyrën e ekzekutimit t'akt-gjykimit të Shëris zyra përmbaruese duhet me anën e policiës dhe të gjindarmëriës t'a kërkojë e t'a gjejë Pranverën. Në rast që kujtohet se i detyruemi vajzën e mban të fshehun tue i privue lirinë vetiake, mund të lajmërohet prokuroria e vendit për me ndjekë autorin, si mbas rastit q'i çfaqet asaj zyre, për privimin nga liria vetiake të vajzës në qoftë se ekzistojn elementat e këtij faji, ose për mos tregimin e banesës t'asanj në qoftë se asht rasti (nenet 162 e 484 K. Penal).²⁶

Nga mendimi i mësipërm rezultojnë disa elemente mjaft interesante. Së pari, komisioni bën një interpretim mbi kuptimin e termave ligjorë, konkretisht të fjalës “detë”, duke përdorur si metodë atë të interpretimit tekstual. Me qëllim mbështetjen e qëndrimit të tij dhe duke qenë se ligji në origjinë ishte osman, komisioni i referohet edhe interpretimit të bërë nga Këshilli i Drejtësisë i Perandorisë Osmane. Pra, komisioni nuk synon t'i japë normës një kuptim të ndryshëm nga ai që i kanë dhënë vetë zbatuesit e saj. Kjo qasje e komisionit tregon se, nga ana e tij, është ndjekur dhe zbatuar metoda interpretuese origjinaliste e së drejtës. Më tej, ai bën një interpretim mjaft të rëndësishëm lidhur me kuptimin e normave juridike. Duke qenë se norma bën fjalë për kufizimin e lirisë së personit, një e drejtë kushtetuese kjo, këto norma duhet të interpretohen në mënyrë sa më ngushtë dhe jo të zgjeruar. Bazuar në këtë fakt, komisioni, duke synuar që “mendimin” e dhënë prej tij ta mbështeste edhe në qëllimin që kishte pasur ligjvënësi i kohës, konkludoi

²⁶ *Po aty*, F. 155, V. 1928, D. V-158, fl.11-12. Kërkesë dhe korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë pranë Gjyqit të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe komisionit ligjipërgatitës, lidhur me dhënien e mendimit për ekzekutimin e vendimit të zyrës së përmbarimit, nëpërmjet marrjes së masës së burgimit, me qëllim dorëzimin e fëmijëve te prindi të cilit i takojnë.

se edhe për këtë lloj mase përmbartimore, duhej që ligjvënësi të kishte bërë një parashikim të qartë për kufizimin e lirisë personale dhe jo t’ua linte organeve përmbartimore nxjerrjen e këtij konkluzioni përmes interpretimeve të ndryshme. Më tej, komisioni tregon edhe mënyrën se si duhej të vepronte zyra përmbartimore, por vë në dukje edhe elemente të veprave penale që mund të ishin konsumuar në atë çështje konkrete.

Në fushën e kulturës

Vendi ynë, duke qenë i banuar që në kohët e hershme të zhvillimit të njerëzimit, ka pasuri të shumta arkeologjike. Për këto pasuri dhe statusin e tyre ligjor ka pasur interes edhe nga të huajt. Në këtë drejtim, legata britanike, duke marrë shkas nga gjetjet arkeologjike në Zelandën e Re, kishte filluar të kërkonte informacion lidhur me gjendjen juridike të veprave dhe zbulimeve arkeologjike në vende të ndryshme. Në Shqipëri, ky informacion kërkohej në dy plane: në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me atë që ishte në proces ndryshimi,²⁷ duke qenë se vendi ynë synonte zëvendësimin e legjislacionit të vjetër osman me një legjislacion të ri. Dhënia e përgjigjes së kërkuar, në thelb, iu ngarkua komisionit ligj-përgatitës i cili po merrej edhe me hartimin e kodeve të reja. Ky komision u përgjigj se:

“Pikat mbi të cilat kërkon çkoqitje Legata Britanike përfshihen në nenin 796 të Kodit Civil të Ri, dhe të projekt-ligjit mbi veprat arkeologjike që ashtë paraqitë Parlamentit-kopja nenit në fjalë edhe ajo projekt-ligjit u paraqitet bashkangjitur, për me ja transmetue Legatës sipërtregueme.

Deri sa të vihen në veprim ligjet e reja, sot për sot, aplikohet ligja Ottomane mbi Arqeologjinë me datë 23 Rebinlaher 301 edhe 9 Fruer 1299 e cila ndodhet e reshtueme në shtojcën katërtë të desturit dhe faqe 389, Volum’i II të koleksionit George Joung, dhe çpronësimi bahet si mbas ligjës Ottomane mbi këtë çashtje.

²⁷ *Po aty*, F. 155, V. 1927, D. IX-63, fl.2. Shkresë e legatës britanike, 29.10.1927.

Ligja në fuqië ndodhet në volumn 6, faqe 127 të koleksionit Jounge”.²⁸

Përgjigjja e mësipërme e komisionit ligj-përgatitës dëshmon, në radhë të parë, kujdesin që duhej treguar për pasuritë arkeologjike të vendit tonë edhe në legjislacionin e ri që po përgatitej. Njëkohësisht, ajo ofron një informacion të vyer mbi mënyrën se si veprohej me legjislacionin e vjetër osman dhe se ku mund të gjendej ai, me qëllim përdorimin e tij nga institucionet shqiptare. Në fakt, siç e theksuam më sipër, përpjekjet për zëvendësimin e legjislacionit të trashëguar nga periudha osmane me një legjislacion të ri kombëtar filluan me vonesë. Për rrjedhojë, për shumë vjet në Shqipëri vijoi të zbatohesh legjislacioni osman. Nga ana tjetër, edhe pse me kalimin e kohës u miratuan kode dhe ligje të tjera, zëvendësimi i plotë i legjislacionit të vjetër osman nuk u arrit në të gjitha fushat. Në këtë drejtim, rezulton se identifikimi i legjislacionit osman nuk bëhej mbi bazën e gazetave zyrtare të Perandorisë Osmane, por duke iu referuar koleksioneve të përgatitura nga autorë të huaj. Në veçanti, institucionet shqiptare mbështeteshin në vëllimet e koleksionit të përgatitur nga George Jounge.

Përfundime

Komisioni ligj-përgatitës, gjatë kohës së shkurtër të ekzistencës së tij, bëri një punë të lavdërueshme. Gjatë kësaj periudhe u hartuan prej tij dhe më pas u miratuan Kodi Penal, Kodi Civil dhe Shtojca II e Procedurës Civile. Këto tri akte përfshiheshin në kompetencën e tij kushtetuese, por veprimtaria e komisionit u shtri edhe në dhënien e mendimeve në fusha të tjera, për të cilat kërkohej vazhdimisht opinioni i tij.

Ekspertiza e lartë juridike që ofronin anëtarët e këtij komisioni solli edhe rritjen e kërkesave nga autoritetet e larta shtetërore për trajtimin e çështjeve të ndryshme, duke krijuar kështu një traditë këshillimore të vazhdueshme.

²⁸ Po aty, fl. 4. Kërkesë e legatës britanike drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për dhënien e shpjegimeve mbi njohjen e mbetjeve të trashëgimisë historike, si edhe korrespondencë e Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe komisionin legjislativ për këtë çështje.

Në përfundim, me ndryshimin e formës së regjimit në vitin 1928, u hartua edhe një kushtetutë e re, Statuti Themeltar i vitit 1928. Me shfuqizimin e Statutit Themeltar të vitit 1925, u rrëzua edhe baza kushtetuese që autorizonte krijimin dhe veprimtarinë e këtij komisioni. Pavarësisht kësaj, duke u bazuar në ligjin organik të miratuar më parë, komisioni vijoi veprimtarinë e tij edhe gjatë muajve të parë të vitit 1929. Por, sipas statutit të ri, kompetencat e këtij komisioni iu caktuan një organi tjetër, Këshillit të Shtetit. Për këtë institucion të ri, parlamenti miratoi ligjin e datës 19 mars 1929, i cili u botua në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 11 prill 1929, dhe hyri në fuqi po atë ditë. Më pas u bë emërimi i anëtarëve të Këshillit të Shtetit, i njoftuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 22 prill 1929, nga ku rezultoi se kryetari i komisionit ligj-përgatitës ishte emëruar kryetar i Këshillit të Shtetit. Anëtarët e këtij këshilli zhvilluan mbledhjen e tyre të parë më 15 prill 1929, çka shënoi edhe përfundimin e veprimtarisë së komisionit ligj-përgatitës.

Çështjet që i ishin referuar komisionit ligj-përgatitës, por që nuk ishin përfunduar prej tij, iu kthyen institucioneve respektive me kërkesën që t’i referoheshin Këshillit të Shtetit.²⁹

Burime e bibliografi:

I. Arkiva

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

- F.149, V.1921, D. I-461
- F.149, V.1927, D. I-1953
- F.149, V.1927, D. III-1042
- F.155, V.1921, D. II-60
- F.155, V.1926, D. II-273
- F.155, V.1928, D. IV-215
- F.155, V.1928, D. IV-243

²⁹ Po aty, F. 155, V. 1929, D. IV-247, fl.103. Shkresë nr.2798/1, datë 02.05.1929, e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Kryeministrisë, në të cilën thuhet: “Kemi nderin me J’u paraqitë ktu njitun kopjen e shkresës nr.74/1, d. 5/XI/1928 të Ministries së Bujqësisë e Pyjeve zbashkut me aktet tjera relative me lutje që t’i referohen P.T. Këshillit të Shtetit, mbasi ish Komisioni Ligj-përgatitës nuk pat qenë në gjendje me u marrë me studjim të tilla çashtjeve për sa kohë ka pas vazhdue pranë kësaj Ministrie për elaborimin e projektligjave të Drejtësisë”.

- F.155, V.1929, D. IV-247
- F.155, V.1928, D. V-152
- F.155, V.1928, D. V-158
- F.155, V.1928, D. V-534
- F.155, V.1927, D. IX-63

II. Botime dokumentare:

Fletorja Zyrtare nr. 5, 21 Kallnuer 1927.

Ligj nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Ligjë e datës 24.11.1926 “Mbi formimin e një komisije ligjë-pregatitëse”.

II. Literaturë:

DERVISHI, Kastriot. *Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet*. Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2012.

MERKURI, Erind. “Komisioni ligjprepërgatitës dhe veprimtaria e tij”. Në aktet e konferencës *Shqipëria mes dy luftërave botërore: Aspekte të politikës, të së drejtës dhe shoqërisë shqiptare në vitet 1925-1939*, përgatitur për botim nga prof. asoc. dr. Sali Kadria & prof. asoc. dr. Erind Merkuri, Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, 2025.

PROF. ASSOC. DR. ERIND MERKURI

Faculty of Law / University of Tirana

erind.merkuri@fdut.edu.al

S u m m a r y

THE LEGISLATIVE DRAFTING COMMISSION AND ITS ‘OTHER’ ACTIVITIES
1926–1929

This study examines the “other” activity of the Albanian Drafting Commission (Komisioni Ligjprepërgatitës) during the 1920s, beyond its constitutional mandate to prepare the fundamental codes of the state. While the Commission is primarily known for drafting the Penal Code, the Civil Code and the Second Annex to the Code of Civil Procedure, archival research reveals that it also exercised an extensive advisory and interpretative function across multiple branches of law.

The paper demonstrates that the Commission played a decisive role in shaping early principles of Albanian administrative law, particularly through its reasoning on the absolute invalidity of administrative acts issued without legal competence. In the field of administrative contracts, it limited unilateral termination by public authorities and reaffirmed the jurisdiction of courts in contractual disputes. In commercial law, the Commission reviewed company statutes, clarified normative gaps, and safeguarded legality and legal certainty.

Significant contributions are also identified in matters concerning forest ownership, state property administration, and the interpretation of Ottoman legislation still in force. The Commission harmonized positive law with elements of customary law and adopted a methodologically advanced approach, especially in cases involving restrictions of personal liberty, where it insisted on strict interpretation of coercive norms.

Ultimately, the advisory practice of the Drafting Commission illustrates its broader institutional function as a precursor to administrative jurisprudence and as a key actor in consolidating the rule of law in interwar Albania.

Keywords: Drafting commission, administrative law, administrative contracts, legal interpretation.

PROF. ASOC. DR. GENTIANA KERA

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë / Departamenti i Historisë
gentiana.kera@fhf.edu.al

**ZHVILLIMI DEMOGRAFIK NË SHQIPËRI NË GJYSMËN
E PARË TË SHEK. XX*****Abstrakt:**

Studimet historiko-demografike mbi Shqipërinë janë përqendruar kryesisht në zhvillimet demografike pas Luftës së Dytë Botërore, fakt që mund t'i atribuohet përmirësimit të regjistrimit të ngjarjeve amzore dhe, si rrjedhojë, ekzistencës së të dhënave demografike më të besueshme. Analiza e zhvillimeve demografike për gjysmën e parë të shek. XX përballlet me sfida të rëndësishme për shkak të mangësive të statistikave demografike, të cilat, për arsye të ndryshme, mungojnë ose janë të paplota. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë tiparet kryesore të zhvillimit demografik në Shqipëri gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave, si dhe faktorët përcaktues që ndikuan në nivelet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë. Analiza bazohet në regjistrimin e popullsisë të vitit 1918, të kryer nga administrata austro-hungareze në zonën e saj të pushtimit, si dhe në të dhëna demografike arkivore dhe statistika zyrtare të publikuara.

Fjalë kyçe:

Tranzicion demografik, Shqipëri, lindshmëri, vdekshmëri, zhvillim demografik, regjistrim i popullsisë.

* Digjitalizimi i materialeve të regjistrimit të popullsisë, të analizuar në këtë artikull, është kryer në kuadrin e projektit “The 1918 Albanian Population Census: Data Entry and Basic Analyses”, i financuar nga Fondi për Financimin e Kërkimit Shkencor (FWF – Fonds zur Förderung der wissenschaftlichen Forschung, Austri). Stafi i projektit, i realizuar në Universitetin e Gracit gjatë viteve 2000-2003, përbëhej nga Helmut Eberhart, Karl Kaser, Siegfried Gruber, Gentiana Kera dhe Enriketa Pandelejmoni. Të gjitha statistikat mbi regjistrimin e popullsisë të vitit 1918, të paraqitura në këtë artikull, janë përlllogaritur nga autorja, me përjashtim të rasteve kur citohet ndryshe.

Studimet historiko-demografike mbi Shqipërinë janë përqendruar kryesisht në zhvillimet demografike pas Luftës së Dytë Botërore, fakt që mund t'i atribuohet përmirësimit të regjistrimit të ngjarjeve amzore dhe, si rrjedhojë, ekzistencës së të dhënave demografike më të besueshme. Historia demografike e shekujve të fundit përshkruhet nga teoria e tranzicionit të parë demografik përmes një modeli me katër faza. Faza e parë karakterizohet nga nivele të larta të vdekshmërisë dhe lindshmërisë, si dhe norma të ulëta të rritjes së popullsisë, dhe lidhet me shoqëritë paraindustriale. Në fazën e dytë, vdekshmëria bie, ndërsa lindshmëria mbetet e lartë, duke çuar në një rritje të shpejtë të popullsisë. Në fazën e tretë, lindshmëria fillon të bjerë me shpejtësi, ndërsa rënia e vdekshmërisë ka tendencë të ngadalësohet. Faza e dytë dhe e tretë lidhen me revolucionin industrial dhe kalimin nga shoqëritë agrare në ato industriale. Së fundi, faza e katërt karakterizohet nga nivele të ulëta të lindshmërisë dhe të vdekshmërisë, një fazë tipike për vendet industriale të zhvilluara.¹

Ndërsa teoria klasike e tranzicionit të parë demografik i interpreton ndryshimet e popullsisë si një përgjigje ndaj zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në një shoqëri që kalon nga një gjendje kryesisht agrare dhe rurale në një gjendje kryesisht industriale dhe urbane, si dhe si rezultat i ndërveprimit midis treguesve demografikë, rënia e lindshmërisë në shumicën e vendeve të Europës Jugore dhe Lindore filloi në një periudhë kur në këto vende mbizotëronin ekonomi kryesisht agrare dhe strukturat shoqërore rurale. Vendet e Ballkanit përbëjnë një shembull ekstrem në këtë drejtim. Për më tepër, niveli i arsimit në rajon ishte shumë i ulët në fillimin e rënies së lindshmërisë.²

Ndër arsyt e fillimit të tranzicionit demografik në një ekonomi kryesisht agrare ishin ritmet e larta të rritjes së popullsisë dhe sistemi patrilinear i trashëgimisë me të drejta të barabarta për burrat, i cili rriti menjëherë presionin mbi burimet e disponueshme të tokës. Si rezultat i procesit të ngadaltë të industrializimit, kërkesa për fuqi të re punëtore ishte e ulët dhe, si rrjedhojë, pronarët e vegjël në sektorin bujqësor nuk

¹ Nikolaj Botev, "Features of the fertility decline in the Balkan countries since the end of XIX Century", në *Etudes Balkaniques*, 4 (1988): 87.

² Po aty, 88.

kishin nxitje për t'u zhvendosur në zonat urbane, por u detyruan të përballeshin me problemin e mbipopullimit agrar në mënyra alternative. Situata u përkeqësua më tej nga kriza ekonomike botërore e periudhës ndërmjet dy luftërave, e cila rriti ndjeshëm presionin ekonomik për kufizimin e lindshmërisë.³

Nivelet e lindshmërisë përpara fillimit të tranzicionit të parë demografik ishin dukshëm më të larta në vendet e Ballkanit krahasuar me pjesën tjetër të Europës, ndërsa roli i rregullatorëve demografikë, si shtyrja e martesës, beqaria dhe emigrimi, ishte shumë i kufizuar. Lindshmëria në vendet e Ballkanit kufizohej përmes kushtëzimit të lindjeve brenda martesës dhe normat kulturore stimulonin lindshmëri të lartë. Ndër to mund të përmenden institucionet e martesës dhe familjes, pozita e nënshtruar e grave dhe normat që rregullonin riprodhimin dhe marrëdhëniet seksuale. Tradicionalisht, sistemi i përzgjedhjes së bashkëshortit bazohej në martesë të rregulluar nga prindërit, të cilat, së bashku me tipin e familjes dhe norma të tjera kulturore që nxisin martesën dhe lindjen e fëmijëve, rezultonin në modele të martesës së hershme dhe universale, si dhe në nivele të larta të lindshmërisë.⁴

Studimet mbi tranzicionin e parë demografik në Shqipëri vazhdojnë të jenë të pakta. Në vitin 1945, Shqipëria kishte lindshmërinë më të lartë në Europë, me një mesatare prej më shumë se gjashtë lindjesh për grua. Rënia e lindshmërisë ndodhi me vonesë krahasuar me pothuajse të gjitha vendet e tjera europiane. Të dhënat demografike dëshmojnë se Shqipëria vazhdonte të ndodhej në fazën e parë të tranzicionit demografik deri në vitet 1920 dhe vetëm më pas kaloi në fazën e dytë.⁵ Vetëm në vitet 1960 rënia e lindshmërisë u bë e konsiderueshme, pas një rritjeje në vitet 1950.⁶ Në një artikull mbi tranzicionin demografik në Shqipëri, Hofstein-i arrin në përfundimin se një periudhë e tranzicionit të shpejtë demografik mbizotëronte në Shqipëri gjatë viteve 1970. Faza e parë e tranzicionit demografik, që përfshinte rënien e shpejtë të vdekshmërisë, kishte përfunduar, ndërsa rënia e theksuar e lindjeve tregonte se faza e dytë e

³ Po aty, 95-96.

⁴ Po aty, 92-95.

⁵ Michael Schmidt-Neke, Örjan Sjöberg, "Bevölkerungsstruktur", në *Albanien* (Südosteuropa-Handbuch Band VII), (ed.) Klaus-Detlev Grothusen (Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht, 1993), 468.

⁶ Jane Falkingham, Arjan Gjonca, "Fertility transition in Communist Albania, 1950-90", në *Population studies*, vol. 55, nr.3 (2001): 310, 318.

këtij procesi, e cila përfshinte rënien e shpejtë të lindshmërisë, po zhvillohej gjatë kësaj periudhe.⁷

Analizat e lindshmërisë dhe vdekshmërisë paraqesin një sfidë për studiuesit për shkak të mangësive të statistikave demografike mbi ngjarjet amzore për periudhën para Luftës së Dytë Botërore. Kjo lidhet me faktin se sistemi zyrtar për regjistrimin e lindjeve, vdekjeve dhe migrimit u krijua vetëm në vitet 1920; ekzistencën e një takse për regjistrimin e lindjeve, e cila përbënte një barrë të konsiderueshme për familjet; si dhe me nivelin e lartë të analfabetizmit në vend. Përveç kësaj, sistemi i regjistrimit zyrtar të ngjarjeve amzore sapo kishte filluar të zbatohej dhe nuk ishte i plotë ose nuk ekzistonte në disa nga zonat më pak të zhvilluara të vendit. Si rrjedhojë, kishte ose mungesë të të dhënave të plota për rajonet, ose raportim të pasaktë të ngjarjeve jetësore.⁸

Të dhënat e disponueshme mbi vdekshmërinë dhe lindshmërinë në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore, si dhe mungesa e të dhënave të tilla për shek. XIX dhe fillimin e shek. XX, nuk lejojnë një analizë të saktë të fazave të tranzicionit të parë demografik në Shqipëri për periudhën e studimit, për shkak të pamundësisë për të krahasuar normat e lindshmërisë dhe vdekshmërisë të periudhës ndërmjet dy luftërave me normat e periudhave të mëparshme. Për këtë arsye, qëllimi i këtij artikulli është të analizojë tiparet kryesore të zhvillimit demografik në Shqipëri gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave dhe faktorët përcaktues që ndikuan në nivelet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë, pa u përqendruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në tranzicionin demografik. Analiza bazohet në regjistrimin e popullsisë të vitit 1918, të kryer nga administrata austro-hungareze në zonën e saj të pushtimit,⁹ si dhe në të dhëna demografike arkivore dhe statistika zyrtare të botuara për periudhën mes Dy Luftërave Botërore. Analiza e regjistrimit të parë të popullsisë të vitit 1923 dhe regjistrimit të vitit 1930, të realizuara nga administrata shtetërore, do të ishte me interes për të kuptuar tendencat në zhvillimin e lindshmërisë në krahasim me regjistrimin e popullsisë të vitit 1918. Megjithatë, një

⁷ Erland Hofsten, "Demographic Transition and Economic Development in Albania", në *European Demographic Information Bulletin*, vol. 6, nr. 3 (1975): 151.

⁸ Arjan Gjonça, Arnstein Aassve, Letizia Mencarini, "Trends and patterns, proximate determinants and policies of fertility change: Albania", në *Demographic research*, vol. 19, nr.11 (2008): 265.

⁹ Siegfried Gruber, Karl Kaser, Gentiana Kera, Enriketa Pandelejmoni. *1918 Census of Albania*, Version 1.0. Graz.

analizë e tillë nuk mund të bëhet mbi bazën e statistikave të botuara për këto dy regjistrime. Për të realizuar analizën e lindshmërisë sipas materialeve të regjistrimeve të popullsisë, do të ishte i nevojshëm digjitalizimi i të dhënave të regjistrave të gjendjes civile të hartuar mbi bazën e këtyre regjistrimeve.

Lindshmëria sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 1918

Nga normat e ndryshme demografike, matja e lindshmërisë është ndër më të ndërlikuarat, pasi ajo varet më tepër nga faktorët individualë dhe nga modelet sociale e kulturore sesa çdo normë tjetër demografike. Normat shoqërore, përfshirë moshën e martesës, rimartesën, rregullat mbi marrëdhëniet seksuale para martesës, si dhe ndëshkimet dhe tabutë e mundshme, ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e individit. Meqenëse çdo regjistrim i popullsisë jep një shpërndarje të popullsisë sipas moshës, ai përmban informacion mbi lindshmërinë, pasi personat që rezultojnë me moshë a në ditëlindjen e fundit janë të mbijetuarit e atyre që kanë lindur saktësisht a deri në $a+1$ vite përpara regjistrimit. Për shembull, foshnjat nën një vjeç në ditëlindjen e fundit janë të mbijetuarit e lindjeve gjatë dymbëdhjetë muajve të mëparshëm (jo domosdoshmërisht të vitit kalendarik). Numri i fëmijëve të mbijetuar është më i vogël se numri i lindjeve; prandaj, për të vlerësuar numrin e lindjeve nga të dhënat e regjistrimeve të popullsisë, janë të nevojshme supozime mbi vdekshmërinë.¹⁰

Materialet e regjistrimit të popullsisë, i realizuar në vitin 1918 nga administrata ushtarake austro-hungareze në territoret shqiptare të pushtuara, përmbajnë informacione të hollësishme mbi popullsinë, si përkatësinë etnike dhe fetare, moshën, profesionin, arsimimin dhe strukturën familjare, dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm për analizën e strukturës së popullsisë në zonat nën administrimin austro-hungarez.¹¹

¹⁰ Thomas W. Pullum, "Natality - Measures based on Censuses and Surveys," në *The Methods and Materials of Demography*, botues Jacob S. Siegel (Elsevier, Amsterdam, 2004), 408.

¹¹ Për një përshkrim të hollësishëm mbi organizimin e regjistrimit të popullsisë, shih: Franz Seiner, *Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem von den österr.-ungar. Truppen 1916-1918 besetzen Gebiete* (Vienna: Wien-Leipzig, 1922). Për një analizë të të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe karakteristika të përgjithshme

Të dhënat e këtij regjistrimi përfshijnë informacion mbi moshën e fëmijëve, por paraqesin disa mangësi. *Së pari*, mosha e fëmijëve mund të mos jetë plotësisht e saktë. Është e mundur që për disa fëmijë të jetë dhënë një moshë e rrumbullakosur, si për shembull një vjeç, ndërkohë që në të vërtetë mund të kenë qenë më të rritur se një vjeç. Kjo ngre pyetjen nëse fëmijët njëvjeçarë duhet të përfshihen apo jo në llogaritjen e lindjeve. Regjistrimi nuk u krye njëkohësisht në gjithë territorin dhe, për rrjedhojë, numri i fëmijëve të regjistruar mund të paraqesë ndryshime rajonale. *Së dyti*, mungesa e informacionit mbi vdekshmërinë në vitin 1918 e bën praktikisht të pamundur formulimin e supozimeve të besueshme për nivelin e saj. Për shkak të pasojave të Luftës së Parë Botërore, norma e vdekshmërisë mund të ketë qenë më e lartë se zakonisht. Prandaj, numri i fëmijëve nën moshën njëvjeçare nuk përkon domosdoshmërisht me numrin e lindjeve të regjistruara në atë vit.¹²

Tabela 1 paraqet numrin e fëmijëve të regjistruar deri në moshën pesë vjeç. Është interesant fakti se numri i fëmijëve deri në moshën një vjeç (12,174) ishte shumë më i ulët se ai i fëmijëve dyvjeçarë (14,147). Kjo mund të interpretohet si një rënie e normës së lindshmërisë, por mbetet vetëm një supozim për sa kohë që nuk disponohen të dhëna mbi normat e vdekshmërisë foshnjore. Ky dallim mund të ketë qenë rezultat i rritjes së vdekshmërisë foshnjore të shkaktuar nga pasojat e Luftës së Parë Botërore.

Tabela 1: Numri i fëmijëve në moshën 0-5 vjeç në vitin 1918*

Mosha	Numri	Përqindja
0.00	2	0.0
0.02	59	0.1
0.03	1	0.0
0.04	5	0.0
0.08	189	0.3
0.09	1	0.0

demografike e sociale të popullsisë në zonën austro-hungareze të pushtimit, shih: Siegfried Gruber, Gentiana Kera, Enriketa Pandelejmoni, "The Impact of WWI on Marriage Patterns in Albania," në *The Impact of World War I on Marriages, Divorces, and Gender Relations in Europe*, (ed.) Sandra Bree & Saskia Hin (New York and London: Routledge, 2020), 119-154.

¹² Gentiana Kera, *The Albanian Population Census of 1918: Basic Statistics and Analyses* (punim diplome i pabotuar, Universiteti i Grazit, 2003), 21-22.

* *Burimi*: Regjistrimi i popullsisë i vitit 1918 (llogaritur nga autorja).

0.12	2	0.0
0.17	162	0.2
0.20	3	0.0
0.25	166	0.2
0.33	75	0.1
0.40	1	0.0
0.42	42	0.1
0.50	703	1.1
0.58	24	0.0
0.67	45	0.1
0.75	5	0.0
1.00	10,689	16.0
1.17	1	0.0
1.25	1	0.0
1.50	207	0.3
2.00	14,147	21.2
2.20	1	0.0
2.50	88	0.1
3.00	13,528	20.2
3.50	33	0.0
4.00	12,640	18.9
4.50	9	0.0
5.00	14,000	20.9
Total	66,829	100.0

Meqenëse supozimet mbi vdekshmërinë për periudhën kur u krye regjistrimi i vitit 1918 mbeten kryesisht spekulative, për shkak të mungesës së të dhënave, mund të përdoren dy metoda të tjera për analizën e lindshmërisë të bazuara në të dhënat e regjistrimit të popullsisë. Metoda e parë është llogaritja e raportit fëmijë – gra, konkretisht numri i fëmijëve nën moshën 5 vjeç në raport me numrin e grave në moshën e fertilitetit (14-49 vjeç), sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë. Ky raport mund të llogaritet nga shpërndarja e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Nëse vdekshmëria neglizhohet, raporti fëmijë – gra është afërsisht sa pesëfishi i normës së përgjithshme të lindshmërisë.¹³

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 1918, pothuajse nuk kishte dallime sipas përkatësisë fetare në raportin fëmijë –

¹³ Pullum, “Nativity”, 409.

gra, ndërsa ekzistonin dallime të konsiderueshme rajonale. Prefekturat me lindshmërinë më të lartë ndodheshin në veri dhe në jug të vendit, ndërsa ato me lindshmërinë më të ulët në qendër dhe në verilindje. Gratë në qytete kishin një lindshmëri pak më të ulët se gratë në fshatra, dhe veçanërisht gratë e arsimuara kishin lindshmëri më të ulët se ato analfabete.¹⁴

Lindshmëria martesore ishte pothuajse e njëjtë në zonat rurale dhe urbane, ndërsa vëreheshin disa ndryshime midis zonave rurale dhe midis qyteteve të ndryshme. Feja nuk kishte ndikim të dukshëm në lindshmërinë martesore, ndërsa arsimimi i burrit e rriste atë. Çiftet e martuara, ku të dy bashkëshortët kishin lindur në vendbanimin aktual, kishin një nivel lindshmërie pothuajse të barabartë me mesataren e grave të martuara. Çiftet ku burri kishte lindur në vendbanimin aktual, ndërsa gruaja diku tjetër, shfaqnin një lindshmëri pak më të ulët. Lindshmëria më e lartë vërehej te çiftet ku gruaja kishte lindur në vendbanimin aktual, ndërsa burri kishte lindur jashtë tij. Çiftet ku asnjëri prej partnerëve nuk kishte lindur në vendbanimin aktual kishin një lindshmëri pak më të lartë se mesatarja. Një pakicë e vogël grash ishin të regjistruara si të martuara, por në regjistrim nuk ishte shënuar bashkëshorti i tyre; ato kishin lindshmëri dukshëm më të ulët, pothuajse të krahasueshme me atë të grave të veja. Analiza e dy nëngrupeve – grave që nuk ishin të pranishme në kohën e regjistrimit dhe grave, bashkëshortët e të cilave nuk ishin të pranishëm në atë kohë – tregoi se të dyja këto grupe kishin lindshmëri më të ulët se mesatarja e grave të martuara, për shkak të ndarjes së çifteve.¹⁵

Një tregues tjetër i lindshmërisë, që mund të matet mbi bazën e materialeve të regjistrimit të popullsisë, është numri mesatar i fëmijëve të burrave dhe grave të martuara dhe të veja. Duhet theksuar se ky tregues ka disa mangësi, sepse ai paraqet numrin e fëmijëve që një person ka në një moment të caktuar kohor, pa marrë parasysh fëmijët që mund të kenë vdekur ose ata që mund të lindin në të ardhmen. Ai gjithashtu nuk përfshin vajzat që janë martuar dhe kanë lënë familjen prindërore përpara

¹⁴ Siegfried Gruber, "The influence of migration on fertility in Albania around 1900", në *Annuario: The Albanian Yearbook of Historical and Anthropological Studies*, nr.1 (2011): 122-155.

¹⁵ Po aty, 138-139; Siegfried Gruber, "Marital fertility in Albania during WWI", në *Nominative Data in Demographic Research in the East and the West*, (ed.) Elena Glavatskaya, Gunnar Thorvaldsen, Georg Fertig & Mikolaj Szoltysek (Ekaterinburg: Ural University Press, 2019), 93.

kryerjes së regjistrimit. Numri mesatar i përgjithshëm i fëmijëve në Shqipëri në vitin 1918 ishte 1.60 për gratë dhe 1.64 për burrat. Si për burrat, ashtu edhe për gratë, numri i djemve ishte më i lartë se ai i vajzave. Për gratë, numri mesatar i djemve ishte 1.00 dhe ai i vajzave 0.60, ndërsa për burrat numri mesatar i djemve ishte 0.96 dhe ai i vajzave 0.68. Numri mesatar i fëmijëve në Shqipëri ishte më i ulët se pritshmëritë, duke marrë parasysh burimet e shumta etnografike dhe shënimet e udhëtarëve të huaj, në të cilat përshkruhet një numër i lartë fëmijësh në familjet shqiptare.

Numri mesatar i fëmijëve për personat e martuar dhe të ve ishte më i lartë në qytete sesa në fshatra. Për gratë e martuara dhe të veja në qytete, numri mesatar i fëmijëve ishte 1.64, ndërsa në fshatra ishte 1.60. I njëjti fenomen vërehej edhe te burrat: numri mesatar i fëmijëve për burrat në qytete ishte 1.71, ndërsa për burrat në fshatra ishte 1.63. Ky është një rezultat i papritur, po të merret parasysh fakti se gratë dhe burrat në qytete martoheshin në moshë më të madhe sesa në fshatra. Numri mesatar i fëmijëve do të duhej të ishte më i lartë në fshatra, ku, për shkak të martesave më të hershme, çiftet lindin fëmijë më herët sesa në qytete. Për më tepër, nevoja për fuqi punëtore ishte më e madhe në zonat rurale, gjë që do të duhej të nxiste lindjen e më shumë fëmijëve në familjet fshatare. Një shpjegim i mundshëm është vdekshmëria më e lartë foshnjore në fshatra, për shkak të kushteve më të këqija të jetesës dhe mungesës së kujdesit shëndetësor.

Analiza e numrit mesatar të fëmijëve sipas grupmoshave për burrat e martuar dhe të ve tregon se numri mesatar më i lartë i fëmijëve për gratë qytetare ndeshet në grupmoshën 40-44 vjeç, ndërsa për gratë fshatare në grupmoshën 45-49 vjeç. Numri mesatar më i lartë i fëmijëve për burrat gjendet në grupmoshën 55-59 vjeç, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Ky dallim ndërmjet kulmeve të numrit mesatar të fëmijëve për burrat dhe gratë mund të shpjegohet me moshën më të lartë të martesës së burrave dhe me rimartesat e tyre pas vdekjes së bashkëshortes së parë, shpesh me gra më të reja. Rimartesa ishte më e zakonshme për burrat sesa për gratë.¹⁶

¹⁶ Gentiana Kera, "Aspekte demografike në zonën e pushtimit austro-hungarez gjatë Luftës së Parë Botërore (Demographische Aspekte im Ersten Weltkrieg in Albanien)," në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria (Österreich-Ungarische Monarchie und Albanien)*, (Tirana: Muzeu Historik Kombëtar, 2019), 152.

31,6% e burrave të martuar ose të ve dhe 30,2% e grave të martuara ose të veja nuk kishin fëmijë. Kur analizohet numri i fëmijëve për gratë e martuara ose të veja në moshë riprodhuese (15-49 vjeç), 34,7% e tyre nuk kishin fëmijë. Vetëm 13,5% e burrave dhe 12,3% e grave kishin më shumë se tre fëmijë. Sipas përkatësisë fetare, numri mesatar më i lartë i fëmijëve gjendet te popullsia katolike (1.73 për gratë dhe 1.76 për burrat), ndërsa më i ulëti te popullsia myslimane (1.58 për gratë dhe 1.62 për burrat). Numri mesatar i fëmijëve për popullsinë ortodokse ishte 1.64 për gratë dhe 1.69 për burrat. Dallimet në numrin mesatar të fëmijëve janë më të mëdha ndërmjet popullsive me përkatësi të ndryshme etnike. Romët kishin numrin më të ulët të fëmijëve, si për burrat ashtu edhe për gratë. Numri mesatar më i lartë i fëmijëve u regjistrua te sllavët. Dallimi më i vogël ndërmjet numrit mesatar të fëmijëve për gratë dhe burrat vërehet te popullsia shqiptare.¹⁷

Përveç dallimeve që rezultojnë nga krahasimi i numrit mesatar të fëmijëve për popullsinë sipas përkatësisë fetare ose etnike, vërehen edhe disa dallime në numrin mesatar të fëmijëve për personat që jetonin në tipa të ndryshëm familjesh. Për analizën e numrit mesatar të fëmijëve sipas tipit të familjes përdoret klasifikimi i familjeve sipas Peter Laslett-it, i cili përshkruan familjen e thjeshtë (*simple family – nuclear family household*), e njohur ndryshe si familja nukleare, familja elementare ose familja biologjike, e cila përbëhet nga një çift bashkëshortësh me ose pa fëmijë, ose nga një person i ve me fëmijët e tij; familjen e zgjeruar (*extended family household*), që përbëhet nga anëtarët e familjes së thjeshtë dhe nga një ose më shumë persona të afërm, të cilët nuk i përkasin kategorisë së fëmijëve dhe që jetojnë së bashku në të njëjtën shtëpi; dhe familjen e shumëfishtë (*multiple family household*), e cila përfshin disa familje të thjeshta.¹⁸

Si për burrat ashtu edhe për gratë, numri mesatar i fëmijëve ishte më i larti në familjet e thjeshta (2.10 për burrat dhe 2.09 për gratë). Numri mesatar i vajzave ishte 0.86 për gratë dhe 0.92 për burrat që jetonin në familje të thjeshta, ndërsa numri mesatar i

¹⁷ Po aty, 153-154.

¹⁸ Peter Laslett, "Introduction: The history of the family", në *Household and family in past time*, (ed.) Peter Laslett (Cambridge University Press: Cambridge, 1972), 29-31.

djemve ishte 1.23 për gratë dhe 1.18 për burrat. Në familjet e zgjeruara, numri mesatar i fëmijëve ishte 1.28 si për gratë ashtu edhe për burrat. Numri mesatar i vajzave ishte 0.45 për gratë dhe 0.62 për burrat, ndërsa numri mesatar i djemve ishte 0.83 për gratë dhe 0.66 për burrat. Në familjet e shumëfishta, numri mesatar i fëmijëve ishte 1.53 për gratë dhe 1.56 për burrat. Numri mesatar i vajzave ishte 0.54 për gratë dhe 0.59 për burrat, ndërsa numri mesatar i djemve ishte 0.99 për gratë dhe 0.97 për burrat. Rezultatet e analizave të numrit mesatar të fëmijëve sipas tipit të familjes janë befasuese, pasi pritej një numër mesatar më i lartë fëmijësh në familjet e shumëfishta. Analizat e numrit mesatar të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale treguan se numri mesatar më i lartë i fëmijëve për burrat dhe gratë gjendej në familjet e thjeshta, si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, ndërsa burrat dhe gratë që jetonin në familje të zgjeruara kishin numrin mesatar më të ulët të fëmijëve.

Numri mesatar më i lartë i fëmijëve gjendet te burrat dhe gratë e martuara që jetonin në familje të thjeshta. I njëjti fenomen vërehet edhe te personat e ve. Tabela 2 paraqet numrin mesatar të fëmijëve për burrat dhe gratë e martuara dhe të veja që jetonin në tipa të ndryshëm familjesh.

Tabela 2: Numri mesatar i fëmijëve sipas tipologjisë së familjes dhe statusit civil**

Tipi i familjes	Burra		Gra	
	I martuar	I ve	E martuar	E ve
Familje e thjeshtë	2.12	1.82	2.04	2.22
Familje e zgjeruar	1.36	0.77	1.29	1.28
Familje e shumëfishtë	1.58	1.37	1.51	1.61

Një ndikim vendimtar në numrin mesatar të fëmijëve duket se ka pasur pozicioni i burrit brenda familjes. Kryefamiljarët kishin më shumë fëmijë sesa burrat që nuk mbanin këtë status, në të gjithë tipat e familjes. Numri mesatar më i ulët i fëmijëve në familjet e shumëfishta shpjegohet me praninë e burrave që nuk ishin kryefamiljarë. Këta përbënin shumicën e burrave të martuar dhe të ve në këto familje dhe, për rrjedhojë, e ulnin

** Burimi: Regjistrimi i popullsisë i vitit 1918 (llogaritur nga autorja).

mesataren e përgjithshme. Shumë burra kalonin një periudhë pas martesës në një familje të përbashkët dhe krijonin një familje të pavarur vetëm në një fazë më të vonshme të jetës; ky model është dukshëm arsyeja e numrit mesatar më të ulët të fëmijëve brenda familjeve të zgjeruara. Një shpjegim tjetër lidhet me rastet kur vëllezërit jetonin në një familje të shumëfishtë, ku njëri prej tyre nuk kishte fëmijë; kjo mund ta ketë penguar atë të ndahej nga familja.¹⁹

Një veçori e spikatur e Ballkanit është se tranzicioni demografik filloi dhe u zhvillua brenda një modeli martese që nuk ndryshoi ndjeshëm gjatë kësaj periudhe. Reagimi i popullsisë ballkanike ndaj rritjes së qëndrueshme të popullsisë pas fillimit të tranzicionit demografik, në kushtet e presionit të madh mbi burimet e kufizuara, kryesisht bujqësore, me pak alternativa ekonomike dhe mundësi të kufizuara për emigrim, rezultoi në një sërë përshtatjesh, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte kalimi drejt kontrollit të lindjeve brenda modelit ekzistues të martesës. Deri në Luftën e Parë Botërore mund të vërehen vetëm fillimet modeste të këtij trendi, zhvillimi i vërtetë i të cilit ndodhi në periudhën ndërmjet dy luftërave dhe u përmbyll vetëm pas Luftës së Dytë Botërore.²⁰

Analiza e moshës në martesë, bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 1918, tregon një moshë të lartë martese për burrat dhe një moshë martese më të lartë se pritshmëria për gratë në qytete. Qytetet shqiptare karakterizoheshin nga një model martese që ndryshonte nga ai i zonave rurale. Dallimet në modelet e martesës midis zonave urbane dhe rurale ishin rezultat i kombinimit të elementeve të caktuara të sjelljes martesore. Ekzistenca e ekzogamisë fshatare në zonat rurale zgjeronte fushën e martesës për burrat dhe gratë në fshatra dhe nxiste një moshë të ulët martese. Nevoja për sigurimin e krahut të punës përmes martesës, për shkak të mungesës pothuajse të plotë të shërbyesve në zonat rurale, si dhe shpenzimet e kufizuara të familjes së nuses për martesën e vajzës së tyre, ishin dy faktorë të rëndësishëm që ulnin moshën e martesës për gratë në këto zona. Situata paraqitej ndryshe në qytete. Endogamia e qytetit, e

¹⁹ Siegfried Gruber, "The 'Tradition' of many children in Albania... and the Evidence: The Census of 1918", kumtesë e mbajtur në konferencën *26th Annual meeting of the Social Science History Association*, Chicago, 15-18 nëntor, 2001, 10-11.

²⁰ Maria N. Todorova, *Scaling the Balkans* (Leiden: Brill, 2018), 259; Siegfried Gruber, "Demographic Growth: Patterns and Problems, 1878-1939," në *The Routledge Handbook of Balkan and Southeast European History*, (ed.) John R. Lampe & Ulf Brunnbauer (London: Routledge, 2021), 306.

kombinuar me endogaminë fetare, ekzistenca e pajës dhe raporti i pabarabartë gjinor ndikonin në rritjen e moshës së martesës për gratë. Diversiteti i aktiviteteve ekonomike e kulturore jashtë shtëpisë dhe nivelet më të larta të arsimit në zonat urbane ndikonin në mënyrën se si njerëzit e konceptonin martesën dhe familjen.²¹ Dallimet në modelet e martesës dhe të organizimit familjar mund të jenë faktorë socialë e kulturorë që ndikojnë në dallimet e normave të lindshmërisë mes zonave urbane dhe rurale.

Lindshmëria dhe vdekshmëria në periudhën mes Dy Luftërave Botërore

Nga fillimi i viteve 1920, institucionet shtetërore i kushtuan rëndësi regjistrimit të saktë të popullsisë dhe të ngjarjeve amzore. Sipas ligjit të administratës civile të shtetit shqiptar, të miratuar më 5 mars 1922, ishte detyrë e pleqësisë së katundeve që të ndihmonin krahinarin për ngjarjet civile, si lindjet, vdekjet, martesat, ndarjet dhe transferimet.²² Pavarësisht parashikimeve ligjore për dërgimin e statistikave mbi lindjet dhe vdekjet, siç dëshmon një urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në qershor 1922, këto statistika nuk dërgoheshin nga prefekturat dhe nënprefekturat.²³ Në një qarkore tjetër, vetëm dy javë më vonë, Ministria e Brendshme përsëriti mosrespektimin e parashikimeve ligjore për dërgimin e statistikave të ngjarjeve amzore, duke paralajmëruar pushimin nga puna të personave që nuk e kryenin këtë detyrë.²⁴ Statistikat e para të pjesshme mbi ngjarjet amzore, për muajt e parë të vitit 1922, u publikuan në numrin 14 të gazetës “Dit’e re”, me shënimin se prefekturat e tjera nuk kishin dërguar statistika.²⁵ Në vitin 1923, Ministria e Punëve të Brendshme publikoi sërish një qarkore mbi rëndësinë e dërgimit të statistikave të lindjeve dhe të vdekjeve, duke kërkuar zbatimin e legjislacionit për këtë çështje nga pleqësitë e katundeve.²⁶

²¹ Gentiana Kera & Enriketa Pandejmoni, “Marriage in Urban Albania (during the First Half of the Twentieth Century),” në *The History of the Family* 13, no. 2 (2008): 136-137.

²² *Dit’e re*, 24 maj 1922, nr. 9, 6.

²³ *Po aty*, 7 qershor 1922, nr. 11, 7.

²⁴ *Po aty*, 21 qershor 1922, nr. 13, 2.

²⁵ *Po aty*, 24 qershor 1922, nr. 14, 3.

²⁶ *Fletorja zyrtare*, 2 shtator 1923, nr. 45, 3.

Mosdeklarimi i rregullt i lindjeve dhe vdekjeve, pavarësisht parashikimeve ligjore, duhet të ketë vazhduar gjatë gjithë dekadës. Në një letër drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë në vitin 1924, mjeku i bashkisë së Tiranës deklaronte se po dërgonte të dhënat mbi numrin e vdekjeve, pasi lindjet nuk regjistroheshin nga banorët.²⁷ Në vitin 1928, prefekti i Tiranës shkruante se, për shkak se seksioni i gjendjes civile në bashkinë e Tiranës nuk ishte krijuar, numri i saktë i popullsisë së kryeqytetit nuk dihej.²⁸ Nëse probleme të tilla evidentoheshin në kryeqytet, atëherë situata e regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve në prefekturat e tjera duhej të ishte edhe më problematike.

Të dhënat e publikuara mbi rritjen e popullsisë në Shqipëri tregojnë se norma e rritjes së popullsisë nga viti 1927 deri në vitin 1932 ishte 3.8 për mijë (me një rënie të ndjeshme në vitin 1929) dhe 5.06 për mijë për periudhën nga viti 1930 deri në vitin 1938. Të dyja normat ishin më të ulëta se normat në vendet e tjera të rajonit si Bullgaria (13.8) dhe Rumania (14.0). Arsyeja kryesore për këtë rritje të ngadaltë të popullsisë i është atribuar nivelit të lartë të vdekjeve, kryesisht për shkak të vdekshmërisë së lartë foshnjore dhe gjakmarrjes.²⁹ Rritja e ngadaltë e popullsisë në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të Europës Juglindore tregon se si niveli i lindjeve ashtu edhe ai i vdekjeve ishin shumë të larta gjatë viteve 1920. Norma pak më e lartë e rritjes së popullsisë në vitet 1930 mund të jetë një tregues se vdekshmëria po binte, duke shënuar fillimin e tranzicionit të parë demografik në Shqipëri. Megjithatë, duhet theksuar se, për shkak të vështirësive në kryerjen e regjistrimit të popullsisë në një vend me një përqindje të lartë analfabetizmi dhe pa statistika të sakta të mëparshme të popullsisë, është e mundur që popullsia reale të ketë qenë disi më e ulët se shifra e publikuar në regjistrimin e vitit 1930,³⁰ që do të thotë se rritja e vërtetë e popullsisë ishte më e lartë sesa sugjerojnë të dhënat demografike.

Skëndi ka argumentuar se në fillim të viteve 1930 pati një rënie të theksuar të normës së lindshmërisë në Shqipëri, ndërkohë që norma e vdekshmërisë ishte ndër më të lartat në Europë. Megjithatë, ndërmjet

²⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 380, Viti (më tej: V.) 1924, Dosja (më tej: D.) 133, fl. 6.

²⁸ *Po aty*, F. 380, V. 1928, D. 34, fl. 2.

²⁹ John Myres, H.S.L. Winterbotham, F. Longland, *Albania, Geographical Handbook Series*, Naval Intelligence Division (Oxford: Oxford University Press, 1945), 129.

³⁰ Stavro Skëndi, *Albania* (New York: Praeger, 1958), 49-50.

viteve 1935 dhe 1939, norma e lindshmërisë u rikthye në nivele rekord, në atë masë sa, pavarësisht vdekshmërisë së lartë, shtesa natyrore mesatare për vitet 1930 ruajti prirjen e dekadës së mëparshme.³¹ Gjatë fazës së parë të tranzicionit demografik, ulja e lindshmërisë është një përgjigje ndaj rënies së vdekshmërisë. Një rënie e normave të lindshmërisë në Shqipëri, në një kohë kur normat e vdekshmërisë mbeteshin shumë të larta, duhet të vihet seriozisht në dyshim. Rënia afatgjatë e lindjeve duhet parë kryesisht si një proces përshtatjeje ndaj uljes së vdekshmërisë. Kjo e fundit lidhet kryesisht me rënien e vdekshmërisë foshnjore.³² Si rrjedhojë, normat më të larta të lindshmërisë gjatë gjysmës së dytë të viteve 1930 mund të lidhen më tepër me përmirësimin e regjistrimit të ngjarjeve amzore sesa me një rritje reale të lindshmërisë. Në tabelën 3 paraqiten ngjarjet amzore për 1 000 banorë në periudhën 1922-1940. Statistikat për vitet 1920 duhet të konsiderohen si të paplota, për shkak të mosregjistrimit dhe mosdeklarimit të rregullt të ngjarjeve amzore nga të gjitha prefekturat. Me konsolidimin gradual të institucioneve të shtetit shqiptar, raportimi dhe statistikat mbi ngjarjet amzore bëhen më të besueshme.

Tabela 3: Ngjarjet amzore për vitet 1922 deri 1940 (për 1 000 persona)^{***}

Viti	Martesa	Lindje	Vdekje	Shtesa natyrore	Vdekje të fëmijëve nën një vjeç për 1 000 lindje të gjalla
1922	-	14.12	9.31	4.81	-
1923	4.3	9.76	9.29	0.47	25.33
1924	4.7	11.88	9.94	1.95	60.46
1925	6.3	11.86	10.64	1.22	68.68
1926	6.8	14.61	10.98	3.63	58.41
1927	6.3	12.7	10.0	2.7	44.35
1928	5.7	12.5	9.6	2.9	-
1929	4.2	12.8	12.0	0.8	-

³¹ Po aty, 55.

³² Rothenbacher, *Central and East*, 43-44.

^{***} Burimi: Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetësisë, *Statistikë e lëvizjes demografike dhe gjendjes shëndetsore në periudhën 1927-1932* (Tiranë: Kristo Luarasi, 1933), 10-17; Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetësisë, *Statistikë shëndetësore dhe demografike për periudhën 1932-1940* (Tiranë: Kastrioti, 1942), 13-17; Teki Selenica, *Shqipëria më 1927* (Tiranë: Tirana, 1928), CXIV; Skëndi, *Albania*, 56; Franz Rothenbacher, *The Central and East European Population since 1850*. The Societies of Europe 5 (London: Macmillan, 2013), 200-201.

1930	5.8	19.2	16.0	3.2	170
1931	5.9	24.9	16.6	8.3	114
1932	4.7	25.0	17.8	7.2	126
1933	7.8	28.6	19.8	8.8	126
1934	8.1	33.1	15.1	18.0	102
1935	8.1	32.3	14.4	17.9	101
1936	7.7	32.8	16.8	16.0	111
1937	8.3	33.4	19.5	13.9	121
1938	9.7	33.0	17.2	15.8	100
1939	7.8	27.9	15.3	12.6	120
1940	5.3	28.1	14.3	13.8	111

Sipas të dhënave arkivore, norma bruto e lindshmërisë në Shqipëri në vitin 1937 ishte 33.7, ndërsa norma e vdekshmërisë ishte 19.4.³³ Jetëgjatësia në vitin 1938 ishte vetëm 38.3 vjet.³⁴ Normat e lindshmërisë dhe vdekshmërisë pas vitit 1937 shfaqin një prirje rënese të vdekshmërisë, ndërsa lindshmëria mbeti në nivele shumë të larta.

Normat e lindshmërisë në Shqipërinë e periudhës ndërmjet dy luftërave ishin më të larta se ato të regjistruara në vendet e tjera europiane gjatë së njëjtës periudhë. Norma e përgjithshme e vdekshmërisë për vitin 1938 ishte më e lartë se ajo e regjistruar në çdo vend tjetër europian, me përjashtim të Rumanisë (19.2) dhe Spanjës (18.4). Norma e përgjithshme e vdekshmërisë për vitin 1939 ishte e krahasueshme me normat e regjistruara në Francë (15.3), Austri (15.3), Estoni (15.0) dhe Jugosllavi (15.0) gjatë atij viti.³⁵ Norma e lindshmërisë në Shqipëri ishte 5.50 për periudhën 1920-1939. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ajo ra në 5.00, por u rrit përsëri deri në mesin e viteve 1960, kur filloi një rënie e saj e qëndrueshme. Ndërkohë, norma e lindshmërisë ishte më e larta ndër vendet e Europës Juglindore.³⁶ Fillimi i rënies së normave të lindshmërisë në shtetet ballkanike ndodhi me një vonesë prej afërsisht dy deri në tri dekadash (më pak për zonat urbane) krahasuar me Europën Perëndimore dhe, në përgjithësi, pas Luftës së Parë Botërore. Në dy pole

³³ Llogaritur sipas të dhënave nga AQSH, F. 152, V. 1937, D. 600, fl.1-2.

³⁴ Arqile Bërzholi, Perikli Qiriaz, *Albanien. Geographischer Überblick* (Tiranë: 8 Nëntori, 1987), 70.

³⁵ Myres, Winterbotham, Longland, *Albania*, 121.

³⁶ Marzio Barbagli, David I. Kertzer, "Introduction", në *Family Life in the Twentieth Century*, (ed.) David I. Kertzer & Marzio Barbagli (New Haven-London: Yale University Press, 2003), XXII.

të kundërta në Ballkan ishin Sllovenia (dhe pjesë të Kroacisë), ku fillimet e kontrollit të lindshmërisë mund të gjurmohen që në shek. XVIII, dhe Shqipëria, ku rënia e ndjeshme e lindshmërisë filloi në vitet 1960.³⁷

Në kundërshtim me argumentin e dhënë nga Skëndi mbi rënien e normës së lindshmërisë në Shqipëri në fillim të viteve 1930, statistikat zyrtare dëshmojnë për një rritje të ndjeshme të numrit të lindjeve gjatë viteve 1930-1932, ndërkohë që në tri vitet e mëparshme ky numër kishte mbetur i qëndrueshëm. Kjo rritje vërehet edhe në numrin e vdekjeve. Meqenëse një shtim kaq i lartë dhe i njëjtë i numrit të lindjeve dhe vdekjeve nuk mund të ishte një tendencë normale, këto shifra mund të shpjegohen vetëm përmes mbajtjes më të rregullt të statistikave pas vitit 1930. Niveli i ulët i lindjeve në një vend me strukturë ekonomike dominuese agrare mund të shpjegohet me regjistrimin jo të plotë të lindjeve ose ekzagjerimin e numrit të popullsisë. Edhe në rast të korrigjimit të këtyre gabimeve, norma e lindjeve mbetet e ulët. Si rrjedhojë, shkaqet më të thella të numrit të ulët të lindjeve mund të kenë qenë varfëria, niveli i ulët ekonomik dhe gjendja e keqe shëndetësore. Prefekturat me numrin më të lartë të lindjeve ishin ato që gëzonin kushte më të mira ekonomike dhe klimaterike.³⁸

Rritja e numrit të lindjeve gjatë periudhës 1933-1940 mund të shpjegohet me një regjistrim më të plotë të lindjeve krahasuar me periudhën 1927-1932. Nga ana tjetër, regjistrimi i vdekjeve duket se është kryer në mënyrë më të saktë, pasi norma e vdekshmërisë kishte mbetur relativisht e qëndrueshme (13.5 për periudhën 1927-1932 dhe 16.5 për periudhën 1933-1940), ndërsa norma e lindshmërisë pothuajse ishte dyfishuar (17.0 për periudhën 1927-1932 dhe 31.2 për periudhën 1933-1940).³⁹

Burime të rëndësishme për analizën e lindshmërisë janë anketat e lindshmërisë, të cilat regjistrojnë numrin e fëmijëve që gratë kanë lindur gjatë jetës së tyre dhe sa prej tyre ishin gjallë. Në Shqipëri, anketa të tilla janë kryer vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Statistikat e publikuara nga regjistrimi i popullsisë i kryer në vitin 1960 tregojnë numrin mesatar të lindjeve të gjalla dhe të fëmijëve që ishin gjallë për gratë sipas

³⁷ Todorova, *Scaling the Balkans*, 258; Rothenbacher, *Central and East*, 185.

³⁸ *Statistikë e lëvizjes demografike dhe gjendjes shëndetësore në periudhën 1927-1932*, Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësis (Tiranë: Kristo Luarasi, 1933), 9, 11-12.

³⁹ *Statistikë shëndetësore dhe demografike për periudhën 1932-1940*, Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësis (Tiranë: Kastrioti, 1942), 17.

grupmoshave të ndryshme. Për analizën në vijim janë përfshirë vetëm statistikat për gratë mbi moshën 35 vjeç. Arsyeja e kësaj përzgjedhjeje lidhet me faktin se gratë e grupmoshës 35-39 vjeç kishin lindur gjatë periudhës 1921-1925 dhe, duke marrë parasysh moshën mesatare të martesës së grave në Shqipëri, është e pritshme që ato janë martuar dhe kanë lindur fëmijën e tyre të parë gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave. Në tabelën 4 paraqitet numri mesatar i lindjeve të gjalla dhe i fëmijëve të gjallë për gratë që ishin mbi 35 vjeç në vitin 1960.

Nga tabela 4 duket qartë se gratë e lindura pas vitit 1920 kanë lindur më pak fëmijë sesa gratë e lindura në fillim të shek. XX, megjithëse kjo diferencë nuk është e theksuar (afërsisht një lindje e gjallë më pak), ndërkohë që periudha e fertilitetit për gratë e kësaj grupmoshe nuk kishte përfunduar. Gratë e lindura gjatë periudhës 1921-1925 kishin gjithashtu më shumë mundësi të kishin një numër më të madh fëmijësh të mbijetuar krahasuar me gratë e lindura në fillim të shek. XX. Ndërsa gratë mbi 60 vjeç humbnin mesatarisht 2.6 fëmijë, gratë e grupmoshës 35-39 vjeç humbnin mesatarisht 1.22 fëmijë. Numri mesatar i fëmijëve të mbijetuar rritej vazhdimisht, çka mund të konsiderohet një tregues i uljes graduale të vdekshmërisë.

Tabela 4: *Numri mesatar i lindjeve të gjalla dhe i fëmijëve të gjallë për gratë në vitin 1960*****

Grupmosha	Numri mesatar i lindjeve të gjalla	Numri mesatar i fëmijëve të gjallë
35-39	5.14	3.92
40-44	5.87	4.26
45-49	6.12	4.22
50-54	6.20	4.05
55-59	6.15	3.86
60-	5.82	3.22

Tabela 5 paraqet ndryshimet në numrin mesatar të lindjeve të gjalla dhe të fëmijëve që ishin gjallë ndërmjet grave që jetonin në zonat urbane dhe atyre që jetonin në zonat rurale. Ndërsa pothuajse nuk ka dallim midis grave qytetare dhe fshatare të lindura në fillim të shek. XX

**** Burimi: *Vjetari statistikor* (1964), 70.

sa i përket numrit të lindjeve të gjalla, gratë qytetare të lindura gjatë periudhës 1921-1925 lindën rreth një fëmijë më pak sesa gratë fshatare të lindura në të njëjtën periudhë. Kjo mund të konsiderohet si një tregues i normave më të ulëta të lindshmërisë në zonat urbane gjatë viteve 1930.

Tabela 5: Numri mesatar i lindjeve të gjalla dhe i fëmijëve të gjallë për gratë në vitin 1960 në qytete dhe fshatra****

Grupmosha	Numri mesatar i lindjeve të gjalla		Numri mesatar i fëmijëve të gjallë	
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat
35-39	4.58	5.43	3.64	4.06
40-44	5.27	6.10	3.94	4.38
45-49	5.53	6.35	3.81	4.39
50-54	5.82	6.34	3.70	4.18
55-59	5.82	6.28	3.54	3.98
60-	5.73	5.85	3.05	3.28

Vdekshmëria duhet të ketë qenë më e lartë në fshatra, pasi numri mesatar i fëmijëve të mbijetuar ishte më i ulët në zonat rurale. Të dhënat tregojnë gjithashtu se vdekshmëria ishte në rënie si në zonat rurale, ashtu edhe në ato urbane. Numri i lartë i fëmijëve që nuk mbijetuan te gratë mbi 50 vjeç tregon se vdekshmëria vazhdonte të ishte e lartë gjatë viteve 1920 dhe filloi të ulej vetëm në vitet 1930. Ulja e vdekshmërisë shpjegohet me përmirësimin e shërbimeve shëndetësore gjatë viteve 1930, veçanërisht në qytete, ku ishte përqendruar shumica e institucioneve të reja shëndetësore. Megjithëse ulja e numrit mesatar të lindjeve të gjalla nuk ishte shumë e madhe (0.68), një numër më i madh fëmijësh arriti të mbijetonte (tabela 6).

Tabela 6: Numri mesatar i lindjeve të gjalla që nuk mbijetuan për gratë në vitin 1960*****

Grupmosha	Total	Qytet	Fshat
35-39	1.22	0.94	1.37
40-44	1.61	1.33	1.72
45-49	1.9	1.72	1.96

**** Burimi: Vjetari statistikor (1964), 70.

***** Burimi: Llogaritur nga autorja sipas të dhënave në tabelat 4 dhe 5.

50-54	2.15	2.12	2.16
55-59	2.29	2.28	2.3
60-	2.6	1.68	2.57

Para Luftës së Dytë Botërore, për shkak të mungesës së kujdesit mjekësor, vdekshmëria foshnjore ishte jashtëzakonisht e lartë dhe jetëgjatësia mesatare shumë e ulët. Norma e vdekshmërisë në Shqipëri tejkalonte 17 për mijë; në Bullgari ishte 13.4 (1939), 13.0 në Greqi (1939), 13.7 në Hungari (1939) dhe 13.8 në Poloni (1938). Normat më të larta të shtesës natyrore në Shqipëri u regjistruan në rrethet e Shkodrës dhe Beratit (mbi 20 për mijë), ndërsa më të ulëtat në Tiranë (nën 10 për mijë). Normat më të larta të vdekshmërisë u regjistruan në Vlorë (18 për mijë), Durrës dhe Berat (midis 16 dhe 17 për mijë). Normat më të larta të vdekshmërisë foshnjore u evidentuan në Vlorë (183 për 1 000 lindje të gjalla), Peshkopi (180), Durrës (177) dhe Elbasan (169). Normat e larta në Vlorë, Durrës dhe Elbasan ishin, pa dyshim, pasojë e përhapjes së malaries.⁴⁰

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria konsiderohej si një vend me gjendje të rëndë shëndetësore dhe me përhapje të jashtëzakonshme të malaries. Në vitin 1923, qeveria shqiptare i paraqiti një kërkesë Komitetit të Shëndetësisë të Lidhjes së Kombeve për ndihmë në hartimin e planeve për zhdukjen ose kontrollin e malaries. Shërbimi i Shëndetit Publik me një Drejtor të Shëndetësisë u krijua në vitin 1922. Buxheti i tij përdorej për financimin e spitaleve shtetërore në qytetet e mëdha, për mjekët krahinorë, për vaksinimin publik dhe për laboratorin bakteriologjik në Tiranë. Synimi ishte që mjekët krahinorë të punësoheshin me kohë të plotë, por ata nuk u penguan të vazhdonin praktikën private. Në disa qytete kishte mjekë bashkiakë, por bashkitë kishin njohuri shumë të kufizuara për çështjet e shëndetit publik, ndërsa emërimet e personelit shpesh diktoheshin nga konsiderata politike. Në asnjë qytet nuk kishte pajisje për dezinfektim. Revolucioni i vitit 1924 çoi në pushimin nga puna të mjekëve krahinorë për arsye ekonomike, ndërsa mjekët bashkiakë mbetën i vetmi personel mjekësor në dispozicion.⁴¹

⁴⁰ Skëndi, *Albania*, 55-56.

⁴¹ Myres, Winterbotham, Longland, *Albania*, 119-120.

Një studim mbi kushtet shëndetësore në Shqipëri, i kryer nga dr. W. E. Haigh në vitet 1923-1924, ofron informacion të rëndësishëm mbi përhapjen e sëmundjeve, si edhe mbi kushtet sociale e ekonomike të popullsisë në Shqipëri. Sipas tij, popullsia jetonte në një nivel shumë të ulët ekonomik dhe, për rrjedhojë, kequshqyerja ishte e dukshme. Të ardhurat mesatare familjare ishin të pamjaftueshme për të siguruar një dietë të përshtatshme për fëmijët. Buka e misrit dhe pak djathë përbënin ushqimet bazë të përditshme. Mishi konsumohej rrallë, ndërsa vezët, qumështi dhe patatet ishin të shtrenjta. Pjeprat dhe rrushi ishin ndër frutat më të lira, por kostoja e tyre ishte e papërbalueshme për fëmijët e varfër të qyteteve. Në përgjithësi, dieta ushqimore përmbante një sasi shumë të ulët të yndyrave dhe proteinave shtazore.⁴²

Ndër sëmundjet, lija, tifoja epidemike dhe borrelioza nuk ishin endemike. Tifoja abdominale shfaqej, por diagnostikohej rrallë, ndërsa në vitin 1924 ajo ishte endemike në Gjirokastrë. Dizenteria dukej se ishte e rrallë. Gripi i viteve 1918-1919 nuk kurseu asnjë pjesë të Shqipërisë. Shpërthime të lehta të skarlatinës, kollës së mirë dhe fruthit ndodhnin çdo vit. Difteria ishte e rrallë, ndërsa tuberkulozi ishte shumë i përhapur dhe tepër i zakonshëm. Vlen të theksohet incidenca e lartë e tuberkulozit pulmonar në moshë adoleshente, sidomos te popullsia femërore myslimane. Sëmundja shkaktoi vdekshmëri të lartë, veçanërisht në Gjirokastrë, Shkodër dhe Krujë. Sifilizi ishte shumë i përhapur në zonat rurale, ku fshatra të tëra rezultonin të prekura. U regjistruan gjithashtu raste të shumta të sifilizit kongjenital, ndërsa infeksionet e fituara nuk kishin gjithmonë origjinë veneriane. Pothuajse kudo ishte e pranishme malaria, dhe më shumë se gjysma e pacientëve që vizitonin qendrat shëndetësore dhe klinikat vuanin prej saj.⁴³

Pavarësisht faktit se shëndeti publik përbënte zërin e dytë më të madh të shpenzimeve shtetërore, Shqipëria e periudhës ndërmjet dy luftërave vazhdoi të kishte standardin më të ulët të kujdesit shëndetësor në Ballkan. Normat e vdekshmërisë foshnjore mbetën të larta dhe përhapja e sëmundjeve epidemike ishte shqetësuese. Përmirësimi më i madh u arrit në luftën kundër malaries: gjatë dy dekadave ndërmjet dy luftërave, numri i rasteve u ul me rreth 75%. Stacionet kundër malaries u financuan nga Fondacioni Rockefeller, i cili kontribuoi gjithashtu në

⁴² *Po aty*, 119.

⁴³ *Po aty*, 120-121.

ndërtimin e Institutit të Higjienës në Tiranë në vitin 1938. Në vitin 1922, në vend punonin vetëm 22 mjekë, 7 dentistë, 32 farmacistë dhe 5 mami të trajnuara. Në vitin 1932 u krijua shërbimi i mjekëve ambulantë.⁴⁴ Numri i personave që punonin në sektorin e shëndetit publik u rrit gradualisht, por në vitin 1937 kishte vetëm 155 mjekë për të gjithë vendin. Në qytetet kryesore kishte tetë spitale dhe një spital psikiatrik në Vlorë.⁴⁵

Në vitin 1933 u diagnostikuan rreth 250 000 raste të malaries në Shqipëri. Sëmundje të tjera që përbënin probleme të rëndësishme shëndetësore ishin sifilizi, tuberkulozi, tifoja abdominale, skarlatina, difteria, fruthi, meningjiti epidemik, trakoma, tërbimi dhe toksemia gjatë shtatzënisë. Probleme të tjera të zakonshme ishin kequshqyerja e përgjithshme, gripi, ftohja e zakonshme, rubeola dhe kariesi dentar.⁴⁶

Në vitin 1939, drejtori i përgjithshëm i Shëndetit Publik, pjesë e personelit të Ministrisë së Brendshme, administronte spitalet, dispanseritë, stacionet e ambulancës, mjekët ambulantë që vizitonin fshatrat dhe fondet për studentët e mjekësisë që trajnoheshin jashtë vendit. Spitale nën administrim shtetëror ishin ndërtuar në Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastrë, ndërsa një sanatorium ishte ngritur në Voskopojë. Spitali qendror në Tiranë ishte modern dhe i pajisur mirë, me aparatura radiologjie, pavijone materniteti, pavijon për tuberkulozin dhe shërbim farmaceutik. Instituti Kimik dhe Bakteriologjik ndodhej pranë tij. Dispanseritë ishin të lidhura me të gjitha spitalet. Në të gjitha bashkitë ofroheshin stacione ambulance dhe mjekë, krahas shërbimeve spitalore ose të dispanserive. Mjekët ambulatorë vizitonin fshatrat, duke ekzaminuar nxënësit e shkollave dhe pacientët në dispanseri. Qendrat e ambulancës për fëmijë në Tiranë dhe Shkodër përhapnin njohuri elementare mbi higjienën ndër nënat analfabete dhe evidentonin përhapjen e malaries, kequshqyerjes dhe sëmundjeve të trashëgueshme.⁴⁷

⁴⁴ Milan Hauner, "Human resources", në *The economic History of Eastern Europe 1919-1975*, vol. 1, (ed.) Michael Kaser & E.A. Radice (New York: Oxford University Press, 1985), 105-106.

⁴⁵ *Shqipëria më 1937. Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit* (1938), vëll. 2 (Tiranë: Kristo Luarasi, 1937), 12-16.

⁴⁶ Myres, Winterbotham & Longland, *Albania*, 122.

⁴⁷ *Po aty*, 223-224.

Përfundime

Të dhënat demografike tregojnë se nivelet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë në Shqipëri vazhduan të ishin të larta gjatë periudhës midis Dy Luftërave Botërore, ndërsa një rënie e vdekshmërisë u vu re gjatë viteve 1930. Arsytet ishin të ndryshme dhe kryesisht të lidhura me konsolidimin e shtetit shqiptar dhe rolin e qeverisë në sigurimin e shërbimeve publike që mund të ndikonin në uljen e vdekshmërisë, si sigurimi i ujit të pastër, fushatat e vaksinimit, kontrolli i epidemive dhe masa të tjera të shëndetit publik. Vendosja e rendit publik dhe rritja e sigurisë publike ulën gjithashtu numrin e vdekjeve të dhunshme.

Burime e bibliografi:

I. Burime arkivore

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

F. 380, V.1924, D. 133

F. 380, V. 1928, D. 34

F. 152, V. 1937, D. 600

II. Literaturë:

BARBAGLI, Marzio, dhe David I. Kertzer. "Introduction." Në *Family Life in the Twentieth Century*. Botuar nga David I. Kertzer dhe Marzio Barbagli. New Haven-London: Yale University Press, 2003, xi-xliv.

BËRXHOLI, Arqile, dhe Perikli Qiriazi. *Albanien. Geographischer Überblick*. Tirana: 8 Nëntori, 1987.

BOTEV, Nikolaj. "Features of the fertility decline in the Balkan countries since the end of XIX Century." Në *Etudes Balkaniques* no.4 (1988): 87-98.

Statistikë e lëvizjes demografike dhe gjendjes shëndetsore në periudhën 1927-1932. Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësis. Tiranë: Kristo Luarasi, 1933.

Statistikë shëndetsore dhe demografike për periudhën 1932-1940. Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësis. Tiranë: Kastrioti, 1942.

- FALKINGHAM, Jane, dhe Arjan Gjonca. "Fertility transition in Communist Albania, 1950-90." Në *Population studies* vol.55, no.3 (2001): 309-318.
- GRUBER, Siegfried. "The 'Tradition' of many children in Albania... and the Evidence: The Census of 1918." Kumtesë e mbajtur në konferencën *26th Annual meeting of the Social Science History Association*, Chicago, 15-18 nëntor 2001.
- GRUBER, Siegfried. "Albanian urban fertility in the beginning of the 20th century". Kumtesë e mbajtur në konferencën *Fifth European Social Science History Conference*, Berlin, 24-27 Mars, 2004.
- GRUBER, Siegfried. "The influence of migration on fertility in Albania around 1900." Në *Annuario: The Albanian Yearbook of Historical and Anthropological Studies* no.1 (2011): 122-155.
- GRUBER, Siegfried. "Marital fertility in Albania during WWI." Në *Nominative Data in Demographic Research in the East and the West*, (ed.) Elena Glavatskaya, Gunnar Thorvaldsen, Georg Fertig dhe Mikolaj Szoltysek. Ekaterinburg: Ural University Press, 2019, 80-96.
- GRUBER, Siegfried, Gentiana Kera, Enriketa Pandelejmoni. "The Impact of WWI on Marriage Patterns in Albania." Në *The Impact of World War I on Marriages, Divorces, and Gender Relations in Europe*, (ed.) Sandra Bree & Saskia Hin, 119-54. New York: Routledge, 2020.
- Gruber, Siegfried & Karl Kaser, Gentiana Kera & Enriketa Pandelejmoni. *1918 Census of Albania*, Version 1.0. Graz.
- GRUBER, Siegfried. "Demographic Growth: Patterns and Problems, 1878-1939." Në *The Routledge Handbook of Balkan and Southeast European History*, (ed.) John R. Lampe & Ulf Brunnbauer, 301-7. London: Routledge, 2021.
- GJONÇA, Arjan, Arnstein Aassve, Letizia Mencarini. "Trends and patterns, proximate determinants and policies of fertility change: Albania." Në *Demographic research* vol.19, no.11 (2008): 261-292.
- HAUNER, Milan. "Human resources." Në *The economic History of Eastern Europe 1919-1975*, vol. 1, (ed.) Michael Kaser & E.A. Radice. New York: Oxford University Press, 1985, 66-147.
- HOFSTEN, Erland. "Demographic Transition and Economic Development in Albania." Në *European Demographic Information Bulletin* vol.6, no.3 (1975): 147-158.
- KERA, Gentiana. "The Albanian Population Census of 1918: Basic Statistics and Analyses." Temë diplome, Universiteti i Grazit, 2003.

- KERA, Gentiana, dhe Enriketa Pandelejmoni. "Marriage in Urban Albania (during the First Half of the Twentieth Century)." Në *The History of the Family* 13, no. 2 (2008): 126-37.
- KERA, Gentiana. "Tirana. Demography, Family and Urban Life (1918-1939)." Punim doktrate, Universiteti i Grazit, 2013.
- KERA, Gentiana. "Aspekte demografike në zonën e pushtimit austro-hungarez gjatë Luftës së Parë Botërore (Demographische Aspekte im Ersten Weltkrieg in Albanien)." Në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria (Österreich-Ungarische Monarchie und Albanien)*, 145-164 (shqip) and 396-416 (gjermanisht). Tirana: Muzeu Historik Kombëtar, 2019.
- LASLETT, Peter. "Introduction: The history of the family." Në *Household and family in past time*, (ed.) Peter Laslett. Cambridge: Cambridge University Press, 1972, 29-31.
- MYRES, John, H.S.L. Winterbotham & F. Longland. *Albania, Geographical Handbook Series*, Naval Intelligence Division. Oxford: Oxford University Press, 1945.
- PULLUM, Thomas W. "Natality - Measures based on Censuses and Surveys." Në *The Methods and Materials of Demography*, (ed.) Jacob S. Siegel. Amsterdam: Elsevier, 2004.
- ROTHENBACHER, Franz. *The Central and East European Population since 1850*. The Societies of Europe 5. London: Palgrave Macmillan, 2013.
- SCHMIDT-Neke, Michael & Örjan Sjöberg. "Bevölkerungsstruktur." Në *Albanien (Südosteuropa-Handbuch Band VII)*, (ed.) Klaus-Detlev Grothusen. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht, 1993, 464-490.
- SEINER, Franz. *Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem von den österr.-ungar. Truppen 1916-1918 besetzen Gebiete*. Vienna: Wien-Leipzig, 1922.
- SELENICA, Teki. *Shqipëria më 1927*. Tiranë: Tirana, 1928.
- Shqipëria më 1937. Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverrimit* (1938), vëll. 2. Tiranë: Kristo Luarasi, 1937.
- SKËNDI, Stavro. *Albania*. New York: Praeger, 1958.
- TODOROVA, Maria N. *Scaling the Balkans*. Leiden: Brill, 2018.
- Vjetari statistikor i R.P.SH 1963*. Tiranë: Drejtoria e Statistikës, 1963.

III. Shtypi:

Dit' e re, 24 maj 1922, nr. 9

Dit' e re, 7 qershor 1922, nr. 11

Dit' e re, 21 qershor 1922, nr. 13

Dit' e re, 24 qershor 1922, nr. 14

Fletorja zyrtare, 2 shtator 1923, nr. 45

PROF. ASOC. DR. GENTIANA KERA

Faculty of History and Philology / Department of History
gentiana.kera@fhf.edu.al

S u m m a r y

DEMOGRAPHIC DEVELOPMENT IN ALBANIA IN THE FIRST HALF
OF THE 20TH CENTURY

Historical-demographic studies on Albania have focused mainly on demographic developments after World War II, a fact that can be attributed to the better registration of vital events and, consequently, the existence of more reliable demographic data. The analysis of demographic developments for the first half of the 20th century faces significant challenges due to the shortcomings of demographic statistics, which for various reasons are missing or incomplete. The aim of this article is to analyze the main features of demographic development in Albania during the interwar period and the determining factors that influenced fertility and mortality. The analysis is based on the 1918 population census conducted by the Austro-Hungarian Administration in its zone of occupation, archival demographic data and published official statistics.

Demographic data show that fertility and mortality rates in Albania continued to be high in the interwar period, while a decrease in mortality rates happened in 1930s. The reasons were varied and probably foremost related to the consolidation of the Albanian state and the role played by government. With increasingly active government came public services that reduced mortality, such as the provision of clean water, vaccination campaigns, the control of epidemics as well as other public health measures. The establishment of public order and increased public safety also reduced the number of deaths in tribal and clan feuds, in random violence.

Keywords: Demographic transition, Albania, fertility, mortality, demographic development, population census

PROF. DR. AFRIM KRASNIQI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
afrimkrasniqi@gmail.com, afrim.krasniqi@asa.edu.al

**DOSJA E ARIT SHQIPTAR: NGA KONFLIKTI IDEOLOGJIK
TE ZGJIDHJA NË PERIU DHËN E TRANZICIONIT****Abstrakt:**

Procesi i kthimit të arit monetar shqiptar të grabitur gjatë Luftës së Dytë Botërore përbën një nga çështjet më të ndërlikuara dhe më të zgjatura të pasluftës europiane, i ndikuar nga faktorë politikë, ideologjikë dhe juridikë. Ai u shoqërua me paqartësi mbi burimet e konfiskimit dhe u instrumentalizua në diskursin politik, duke u ndërthurur me pretendime ndaj fuqive të kohës dhe me çështjen e Kanalit të Korfuzit.

Shqipëria ishte vendi i fundit në Europë që përfitoi nga mekanizmi ndërkombëtar i kthimit të arit, duke e përmbyllur procesin vetëm në mesin e viteve 1990, pas një ndryshimi thelbësor në qasjen shtetërore pas vitit 1992. Artikulli argumenton se kjo zgjidhje duhet kuptuar si rezultat i një transformimi historik: kalimi nga një regjim i izoluar ideologjik drejt një aktori që vepron në përputhje me normat e rendit ndërkombëtar.

Depolitizimi i çështjes dhe riformësimi i politikës së jashtme krijuan kushtet për një trajtim pragmatik, të mbështetur në dokumente arkivore dhe mekanizma diplomatikë. Nga perspektiva e studimeve historike, ky rast dëshmon se rindërtimi i narrativës mbi të kaluarën ndikon drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjeve të trashëguara ndërkombëtare. Përmbyllja e dosjes së arit përfaqëson kështu një moment kyç, ku ndërthuren historia, diplomacia dhe e drejta ndërkombëtare në kontekstin e tranzicionit shqiptar.

Fjalë kyçe:

Ari monetar, kthimi i arit, konflikt ideologjik, tranzicioni postkomunist, e drejta ndërkombëtare.

Hyrje

Historia e arit monetar përbën një komponent të rëndësishëm të trashëgimisë së Luftës së Dytë Botërore, pasi ndërthur zhvillimet ekonomike me politikën e jashtme dhe mekanizmat e rendit ndërkombëtar të pasluftës. Në shumicën e rasteve në Europë, konfiskimi dhe kthimi i rezervave monetare u trajtuan si pjesë e proceseve të stabilizimit financiar dhe të rregullimit diplomatik pas vitit 1945. Megjithatë, interpretimi historik i këtyre proceseve ka qenë i pabarabartë, shpesh i fragmentuar dhe i ndikuar nga kontekste politike të ndryshueshme.

Në këtë kuadër, çështja e arit monetar shqiptar përfaqëson një rast studimor veçanërisht domethënës, jo vetëm për dinamikat e brendshme, por edhe për funksionimin e mekanizmave ndërkombëtarë në raport me shtete të vogla dhe institucionalisht të dobëta. Në historiografinë shqiptare dhe në diskursin publik, kjo çështje është trajtuar për dekada përmes narrativave të thjeshtuara, të ngarkuara me mite, interpretime ideologjike dhe përdorime politike të së kaluarës. Fokusimi në përgjegjësi individuale ose në fajësime morale ka lënë në hije kompleksitetin historik dhe kontekstin ndërkombëtar të procesit.

Si pasojë, rasti shqiptar është izoluar në punime studimore dhe rrallëherë është vendosur në perspektivë krahasuese me përvojat e vendeve të tjera europiane të prekura nga konfiskimi i arit monetar gjatë luftës. Ky artikull niset nga premisa se historia e arit monetar shqiptar nuk mund të kuptohet përmes kategorive binare apo interpretimeve lineare, por si një proces i zgjatur dhe kompleks, i kushtëzuar nga ndryshimet politike e diplomatike, si edhe nga kapacitetet reale të shtetit shqiptar për të vepruar në arenën ndërkombëtare.

Konfiskimi i arit gjatë viteve 1943-1944, përjashtimi *de facto* i Shqipërisë nga mekanizmat e hershëm të kthimit pasluftës dhe zvarritja e zgjidhjes deri në mesin e viteve 1990 pasqyrojnë ndërveprimin e disa faktorëve: izolimin politik gjatë regjimit komunist, ideologjizimin e së kaluarës dhe pasojat afatgjata të konflikteve diplomatike të pazgjidhura. Vonesa unike e Shqipërisë në përmbylljen e procesit – duke qenë vendi i fundit në Europë që arriti një zgjidhje – nuk ishte thjesht rezultat i pengesave teknike apo juridike, por pasojë e një qasjeje shtetërore që, për

një kohë të gjatë, privilegjoi koherencën ideologjike mbi pragmatizmin diplomatik.

Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë historinë e konfiskimit dhe kthimit të arit monetar shqiptar si një proces konkret që ndihmon në kuptimin e marrëdhënieve midis politikës së brendshme, diplomacisë dhe rendit ndërkombëtar të pasluftës. Pyetja qendrore që udhëheq studimin është: Pse dhe si ndryshon qasja shtetërore shqiptare ndaj kësaj çështjeje vetëm pas vitit 1992. Teza kryesore argumenton se rënia e regjimit komunist, rishikimi i narrativës historike zyrtare dhe riorientimi i politikës së jashtme krijuan kushtet për një trajtim më pragmatik dhe të harmonizuar me praktikat ndërkombëtare. Duke u mbështetur në dokumente arkivore shqiptare dhe në burime diplomatike ndërkombëtare, disa prej të cilave publikohen për herë të parë, studimi synon të kontribuojë në një lexim më të balancuar dhe historikisht të argumentuar të një teme të politizuar për dekada.

Nga pushtimi te konfiskimi: Origjina e çështjes së arit shqiptar (1939-1944)

Debati mbi arin shqiptar është ndërtuar shpesh mbi një mbivendosje konceptuale dhe kronologjike të disa proceseve të ndryshme: rezervat e arit të konfiskuara nga Gjermania naziste gjatë viteve 1943-1944; administrimi i rezervave monetare nga Italia fashiste pas pushtimit të prillit 1939; tërheqja e një pjese valutore nga Mbreti Zog në prag të pushtimit; si dhe sekuestrimi i arit privat të qytetarëve shqiptarë nga forcat pushtuese. Kjo mbivendosje ka prodhuar konfuzion analitik dhe ka penguar dallimin midis dosjeve që kanë natyrë të ndryshme juridike dhe historike.

Nga pikëpamja analitike, disa prej këtyre çështjeve janë periferike ndaj problematikës së arit nazist. Kapitullimi i Italisë fashiste në shtator 1943 e reduktoi ndjeshëm rëndësinë e rolit italian, ndërsa konfiskimi i pasurisë private të individëve nuk u përfshi në mandatin e Komisionit Trepalësh për Arin Monetar (Tripartite Gold Commission – TGC) dhe nuk është i identifikueshëm statistikisht në mënyrë të plotë.¹ Për më tepër, praktika e konfiskimeve kolektive të pasurisë private vijoi edhe pas

¹ Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, *Final Report* (Brussels: Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 1998), 1-3.

vitit 1945 nga regjimi komunist, duke ndjekur një model të njohur në shumicën e vendeve ish-komuniste.²

Gjatë periudhës komuniste, debati mbi arin shqiptar ishte i mbyllur, ndërsa narrativa historike u krijua nga udhëheqja politike dhe u unifikua në botimet zyrtare dhe në diskursin institucional. Brenda kësaj kornize ideologjike, figura e Mbretit Zog dhe drejtuesit shqiptarë të periudhës së pushtimit u paraqitën apriori si të korruptuar dhe përgjegjës për humbjen e rezervave valutore të shtetit, përmes një analogjie të drejtpërdrejtë midis tërheqjes së një sasive valutore dhe konfiskimit nazist.³ Ky interpretim shërbeu për legjitimimin e rendit të ri pas vitit 1945 dhe për diskreditimin e elitave nacionaliste, ndërsa riprodhimi i tij edhe në periudhën postkomuniste dëshmon për qëndrueshmërinë e kësaj narrative në kujtesën kolektive.

Thelbi i çështjes së arit shqiptar lidhet me konfiskimin e arit monetar nga autoritetet gjermane gjatë pushtimit nazist të Shqipërisë në vitet 1943-1944, i cili më pas u përfshi në mekanizmat ndërkombëtarë të rikuperimit pas Luftës së Dytë Botërore.⁴ Në kuadrin e ekonomisë së luftës, prania ushtarake gjermane gjeneronte kosto të konsiderueshme, të cilat, sipas argumentimit të përfaqësuesit të posaçëm Hermann Neubacher,⁵ duhej të mbuloheshin nga burimet vendore.⁶ Ky qëndrim u konkretizua më 16 shtator 1943, kur forcat gjermane tërhoqën nga Banka e Romës bankënota shqiptare në franga dhe konfiskuan sasinë e arit në monedha (853 070), si edhe në shufra dhe lingota ari (7 627 757) të shtetit shqiptar, në vlerë totale rreth 8 milionë fr. ari.⁷ Përpjekjet e

² János Kornai, *The Socialist System: The Political Economy of Communism* (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1992), 61-72.

³ Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 1-3.

⁴ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 179 (Banka Kombëtare e Shqipërisë / Drejtoria Qendrore), Viti (më tej: V.) 1944, Dosja (më tej: D.) 10, fl. 7-8. Borxhi i shtetit gjerman kundrejt shtetit shqiptar.

⁵ *1945 Final Report of the German Wehrmacht in Albania* [Abschlußbericht der Deutschen Wehrmacht in Albanien, typescript in the National Archives, Washington DC, Captured German Records, Roll T501/258].

⁶ Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Fondi MPJ (më tej: AMPJ), V. 1997, D. 68, fl. 1. 1997. Çështja e arit monetar. Grabitja e arit monetar të Bankës Kombëtare Shqiptare nga nazistët gjermanë. Hebrenjtë në Shqipëri.

⁷ AQSH, F. 506, V. 1947, D. 68, fl.1-2. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës, raport mbi sasitë e ndryshme të arit shqiptar të grabitura nga gjermanët.

autoriteteve shqiptare për të depozituar rezervat në vende neutrale,⁸ veçanërisht në Zvicër, u refuzuan, duke dëshmuar kufijtë realë të sovranitetit formal shqiptar. Ari u transferua në Reichsbank në Berlin dhe u integrua në sistemin financiar të Rajhut.⁹ Garancitë e dhëna në marrëveshjen reciproke ishin formale dhe, pas luftës, sasia e gjetur e arit e të gjitha vendeve nën pushtim u sekuestrua nga forcat aleate. Përlllogaritjet e pasluftës tregojnë se, duke përfshirë edhe konfiskimet brenda territorit shqiptar, sasia totale e arit të grabitur arrinte rreth 23.408 kilogramë, ku përfshihet edhe ari i marrë në Romë, si dhe tërheqja e bërë nga Banka Kombëtare e Shqipërisë gjatë periudhës së fundit të luftës. Pas vitit 1945, çështja e arit shqiptar u përfshi në mekanizmin e Komisionit Trepalësh të Arit Monetar. Përpjekjet për njohjen e legjitimitetit të qeverisë jashtë dhe integrimi në zonën e influencës sovjetike u shoqëruan edhe me përpjekjet për të përfutur reparacione nga Italia e Gjermania, si dhe për rikthimin e arit të sekuestruar nga forcat naziste. Megjithatë, për Shqipërinë këto sfida rezultuan shumë më të vështira sesa për vendet e tjera ish-komuniste. Funksionimi si vend satelit dhe, më vonë, vetizolimi politik i regjimit komunist, së bashku me faktorë të tjerë në kontekstin e Luftës së Ftohtë, vonuan ndjeshëm realizimin e kërkesës shqiptare, duke e bërë Shqipërinë rastin e vetëm që nuk përfitoi nga ky mekanizëm deri në vitet '90.

Ari shqiptar dhe impakti i Gjykatës Ndërkombëtare

Në janar 1946, fuqitë perëndimore fituese të Luftës së Dytë Botërore arritën një dakordësi politike dhe financiare për trajtimin e reparacioneve dhe kthimin e rezervave të arit të konfiskuara nga Gjermania naziste.¹⁰ Një parim themelor i kësaj marrëveshjeje ishte ndarja e qartë midis reparacioneve të luftës dhe kthimit të arit monetar, i cili u konceptua si një proces teknik, financiar dhe juridik, i shkëputur

⁸ *Po aty*, F. 490, V. 1945, D. 123, fl. 1-5. Këshilli i Ministrave. Korrespondencë e Këshillit të Ministrave me Bankën e Shtetit Shqiptar, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Financave, mbi tërheqjen e arit të depozituar në Bankën e Reich-ut në Gjermani.

⁹ *Po aty*, F. 179, V. 1944, D. 10, fl. 6-7. Banka Kombëtare e Shqipërisë, raport mbi çështjet monetare dhe financiare për t'u shqyrtuar nga Komisioni shqiptaro-gjerman.

¹⁰ *Agreement on Reparation from Germany and on the Establishment of an Inter-Allied Reparation Agency*, January 14, 1946, 61 Stat. 3157.

nga përgjegjësitë politike të shteteve humbëse. Kthimi i arit do të realizohej mbi bazën e proporcionalitetit, në përputhje me sasinë reale të arit të identifikuar dhe me peshën e pretendimeve të verifikuara, dhe jo mbi bazën e humbjeve të pretenduara.¹¹

Për administrimin e këtij procesi, Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Franca krijuan më 27 shtator 1946 Komisionin Trepalësh për Arin Monetar, me mandat për identifikimin, administrimin dhe rishpërndarjen e arit monetar të konfiskuar nga Gjermania naziste. Komisioni vepronte mbi procedura të standardizuara dhe bazohej në dokumentacion arkivor dhe bankar që vërtetonte origjinën e arit, aktet e konfiskimit dhe lidhjen juridike me shtetin pretendues. Vendimet e tij ishin konsensuale dhe të detyrueshme. Ky mekanizëm synonte të shmangte politizimin e procesit dhe ta mbante atë brenda kornizave të një zgjidhjeje shumëpalëshe, të bazuar në prova dhe kompromis.¹²

Në vitin 1947, qeveria shqiptare paraqiti kërkesën për kthimin e arit monetar të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, rezervë e tërhequr fillimisht në Romë gjatë pushtimit italian dhe e konfiskuar më pas nga forcat gjermane. Dokumentacioni shqiptar u vlerësua pozitivisht dhe, pas disa vendimeve, më 13 qershor, TGC vendosi kthimin e 1121 kg ar, ¹³ duke njohur parimisht të drejtën e Shqipërisë mbi këtë rezervë. Vendimi u kundërshtua nga pala italiane, e cila pretendoi se ari i tërhequr nga Banka e Romës përbënte pronë italiane, duke u mbështetur në strukturën aksionare të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe në marrëveshjen e bashkimit monetar shqiptaro-italian të vitit 1939. Pala shqiptare argumentoi, ndër të tjera, se marrëveshja e vitit 1939 kishte humbur çdo efekt juridik pas përfundimit të luftës dhe Traktatit të Paqes të shkurtit 1947. Për shkak të kompleksitetit të çështjes, komisioni ua delegoi problemin qeverive përbërëse, të cilat më 25 prill 1951 kërkuan një opinion juridik nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.¹⁴ Me opinionin

¹¹ Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 4.

¹² Po aty, 5.

¹³ AMPJ, V. 1948, D. 488, fl. 2-3. Dosja e arit monetar. CC/ALB, 30 qershor 1948, nga Komisioni Trepalësh (KTA).

¹⁴ International Court of Justice. *Monetary Gold Removed from Rome in 1943* (Italy v. France, United Kingdom and United States). Advisory Opinion, 15 June 1954. I.C.J. Reports 1954.

e 20 shkurtit 1953, gjykata konfirmoi se ari i tërhequr në Romë ishte pronë e shtetit shqiptar, duke rrëzuar përfundimisht pretendimin italian.¹⁵

Në plan krahasues, shumica e shteteve përfituese nga vendimet e TGC-së pranuan kompromisin shumëpalësh dhe realizuan kthimin e shumicës së sasisë së arit brenda një harku kohor relativisht të shkurtër. Procesi u zhvillua kryesisht në periudhën 1947-1958, vijoi me korrigjime teknike dhe rishpërndarje shtesë gjatë viteve 1960-1980 dhe u mbyll përfundimisht në vitet '90.¹⁶ Vende si Belgjika, Holanda, Austria, Çekosllovakia, Greqia, Polonia, Hungaria, Rumania, Jugosllavia dhe Franca përfituan ar monetar, por në çdo rast në sasi më të vogla sesa pretendimet fillestare, për shkak të kufizimeve reale të rezervave të gjetura, si edhe, në disa raste, edhe për shkak të pozicionit të tyre gjatë luftës.¹⁷

Në kontrast me këtë praktikë, procesi i kthimit të arit shqiptar u bllokua që në fazën e hershme, jo për arsye teknike apo juridike, por për shkak të konfliktit me Britaninë e Madhe pas incidentit të Kanalit të Korfuzit. Më 22 tetor 1946, në ujërat territoriale shqiptare pranë Sarandës, dy luftanije britanike ranë mbi mina detare, duke shkaktuar vdekjen e 44 ushtarakëve britanikë dhe plagosjen e 42 të tjerëve. Ngjarja u shndërrua në një krizë të rëndë politike dhe juridike në një moment kritik të pasluftës.¹⁸ Shqipëria vazhdimisht deklaroi se “*nuk ka pasur dijeni për këtë dhe nuk ka asnjë lidhje direkte ose indirekte me këtë ndodhi fatkeqe, prandaj nuk mban asnjë përgjegjësi për të*”,¹⁹ por dokumente zyrtare dëshmojnë se qeveria shqiptare bashkëpunoi me jugosllavët në vendosjen e minave,²⁰ fakt që njëhej edhe nga shtetet e përfshira. Pas mosmarrëveshjeve lidhur me përgjegjësinë direkte ose

¹⁵ *Monetary Gold Removed from Rome in 1943*, Advisory Opinion, International Court of Justice, 20 February 1953, I.C.J. Reports 1953, 1.

¹⁶ Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, *Report on the Work of the Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 1946-1998* (Brussels, 1998).

¹⁷ Po aty, 1-5.

¹⁸ *Corfu Channel (United Kingdom v. Albania)*, Merits, Judgment, International Court of Justice, 9 April 1949, I.C.J. Reports 1949, 4.

¹⁹ AQSH, F. 373/Arkivi i Partisë (AP), V. 1985, D. 707, fl. 2-3. Informacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Ramiz Alisë dhe Adil Çarcanit, 27.05.1985.

²⁰ Po aty, F. 14/AP-MP, V. 1957, D.1, fl. 17. Nga takimi që u bë në KQ të PPSH-së ndërmjet delegacionit të PPSH-së dhe delegacionit parlamentar kinez të kryesuar nga shoku Pen Çen, më 16.01.1957.

indirekte, çështja iu referua Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Me vendimin e 9 prillit 1949, gjykata e shpalli Shqipërinë përgjegjëse sipas së drejtës ndërkombëtare, ndërsa më 15 dhjetor 1949 e detyroi atë të dëmshpërblente Britaninë e Madhe me 843 947 sterlina.²¹ Shqipëria nuk e kundërshtoi shumën e dëmshpërblimit dhe tentoi të zhvillonte bisedime me palën britanike (bisedimet midis B. Shtyllës – S. Beckett-it) në fillim të viteve '50, duke propozuar një pagesë simbolike prej 50 mijë sterlinash. Pala britanike e cilësoi këtë propozim si “qesharak” dhe bisedimet u ndërpre. ²² Ky fakt tregon se mosmarrëveshja fillestare u lidh më shumë me shifrat financiare të dëmshpërblimit sesa me legjitimitetin ose vendimin e gjykatës. Më pas, Tirana zyrtare, e nxitur edhe nga motive ideologjike dhe nga zgjedhja politike për të mos vendosur marrëdhënie me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, deklaroi se nuk e pranonte përgjegjësinë dhe as vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke refuzuar kështu edhe pagesën financiare përkatëse.²³ Ky qëndrim rezultoi një gabim strategjik me pasoja afatgjata.

Britania e Madhe kushtëzoi normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe me zbatimin e vendimit të gjykatës, një pozicion i mbështetur edhe nga Shtetet e Bashkuara.²⁴ Në këtë mënyrë, ndryshe nga vendet e tjera europiane, ku kthimi i arit u realizua si pjesë e normalizimit ndërkombëtar, Shqipëria mbeti për afro katër dekada jashtë mekanizmave kompensues dhe të dialogut të pasluftës. Përfashtimi nuk lidhej me mungesën e dokumentacionit apo me refuzimin e pretendimeve, por me paaftësinë strukturore për ta trajtuar çështjen e arit si pjesë të paketës së detyrimeve në mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë, pa mbivendosje me konfliktet politike. Regjimi komunist zgjodhi ta ideologjizonte procesin për kthimin e arit dhe, mbi këtë bazë, edhe ta ndërthurte atë me

²¹ Records of the Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, *Final Report to the Three Governments (1998)*, U.S. Department of State (<https://2009-2017.state.gov/s/l/65668.htm>); dhe *AMPJ*, V. 1985, D. 1160, fl. 135; 843 947 sterlina është shuma që u caktua nga Gjykata e Hagës në dhjetor 1949 për incidentin e Kanalit të Korfuzit. 843 947 me kursin e këmbimit të vitit 1949-1967 ishte baras me 2 363 051 60 dollarë.

²² *AQSH*, F. 14/AP-STR, V. 1990, D. 222, fl. 14. Informacion për bisedimet që do të zhvilloheshin me anglezët për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe kthimin e arit. Mbi çështjen e arit monetar dhe incidentin e Kanalit të Korfuzit.

²³ *AMPJ*, V. 1985, D. 1163, fl. 43. Mbi arin shqiptar.

²⁴ *The National Archives*, London, FCO, 28/3706, JCR Gray-Eastern European and Soviet Department, “Marrëdhëniet anglo-shqiptare”, 5 dhjetor 1979.

narrativa konfrontuese ndaj rendit ndërkombëtar perëndimor, duke e zhvendosur procesin nga aspekti procedural në arenën gjeopolitike. Ky bllokim krijoi një kontekst strukturor që shpjegon pse Shqipëria hyri në fazën e mëvonshme negociuese jo si përfituese e vonuar e një procesi teknik, por si palë e izoluar, e ngarkuar me një trashëgimi të pazgjidhur konfliktesh juridike dhe diplomatike.²⁵

Vitet 1985-1990: Negociata dogmatike dhe mungesë progresi

Gjatë viteve '80, ndryshimet në marrëdhëniet Lindje-Perëndim dhe transformimet e brendshme në një sërë shtetesh krijuan një kontekst më të favorshëm për rishikimin e çështjeve të pazgjidhura të pasluftës. Këto zhvillime u reflektuan edhe në dosjen e kthimit të arit monetar shqiptar dhe në përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit me Britaninë e Madhe lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit. Nisma më e rëndësishme ishte propozimi i planit me shtatë pika nga vendet anëtare të Komisionit Trepalësh, i përcjellë qeverisë shqiptare më 20 prill 1984 nga ambasadori francez Marcel Martin.²⁶ Kjo nismë u ndërmor me kërkesë të palës amerikane dhe britanike, të cilat prej viteve '70 kishin shprehur gatishmëri për dialog politik me Shqipërinë komuniste. Në atë periudhë, Shqipëria ishte i vetmi vend europian pa marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara, Britaninë e Madhe dhe Bashkimin Sovjetik, ndërsa deri në vitin 1987 edhe pa marrëdhënie me Republikën Federale të Gjermanisë (RFGJ).

Plani me shtatë pika konfirmonte vendimin e vitit 1948 të Komisionit Trepalësh për kthimin e arit të konfiskuar nga Gjermania naziste. Ai parashikonte, gjithashtu, detyrimin që Shqipëria t'i paguante qeverisë amerikane më pak se 2 milionë dollarë për shpronësimet e dhunshme të pasurive të shtetasve amerikanë dhe t'i shlyente Britanisë së Madhe rreth 2 milionë dollarë në përmbushje të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këmbim, qeveria amerikane dhe britanike do të deklaronin me shkrim zgjidhjen përfundimtare të pretendimeve të tyre ndaj Shqipërisë, pa kërkuar një deklaram reciprok

²⁵ AQSH, F. 505, V. 1978, D. 206, fl. 1-10. Mbi problemin e arit të bllokuar nga Anglia, raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Financave.

²⁶ AMPJ, V. 1984, D. 606, fl. 140-142. Mbi problemin e arit shqiptar të bllokuar nga Anglia.

nga pala shqiptare.²⁷ Qeveria franceze, pa pretendime të drejtpërdrejta, i bëri të ditur palës shqiptare se oferta nuk mund të ishte e hapur për shumë kohë dhe se refuzimi i saj do t'u jepte palëve të tjera të drejtën për rishikimin e pozicioneve.

Dokumenti përbënte një ofertë të avancuar diplomatike dhe një kontrast të qartë me retorikën dogmatike të udhëheqjes shqiptare. Megjithatë, Shqipëria konsumoi edhe 8-10 vjet me politikë refuzuese, retorikë konfrontuese, bisedime të pasuksesshme dhe formula alternative, derisa në vitin 1992 pranoi një marrëveshje²⁸ në thelb të ndërtuar mbi të njëjtat terma reference të planit të vitit 1984.

Në maj 1984, Tirana zyrtare e shqyrtoi formalisht propozimin, por dokumentacioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) tregon se pala shqiptare e keqkuptoi qasjen konstruktive të palëve perëndimore, duke supozuar se ndodhej në pozita për të diktuar kushte më të favorshme. Në përgjigjen e saj, ajo kërkoi interesa shtesë mbi vlerën e arit (fitimin e munguar), duke e justifikuar këtë me mbajtjen e arit në bankat britanike që prej vitit 1948. Paralelisht dhe me arrogancë ajo hodhi poshtë kërkesat amerikane dhe britanike, duke mohuar ekzistencën e pasurive amerikane të shpronësuar, përgjegjësinë për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe vetë vlefshmërinë e vendimit të Gjykatës së Hagës. Ajo vijoi retorikën e akuzave ndaj amerikanëve dhe britanikëve për dëme dhe qëndrime tradicionale armiqësore e subversive ndaj Shqipërisë.²⁹ Britania kishte një rol të veçantë në këto akuza, pasi identifikojë si shteti që kishte grabitur arin shqiptar, atë të depozituar nga ish-Mbreti Zog dhe atë të sekuestruar nga forcat pushtuese gjermane.³⁰ Në formë dhe përmbajtje, këto vlerësime ishte në vijimësi të plotë me qëndrimet e artikuluara nga Enver Hoxha që në vitin 1949.³¹

Reagimi i palëve perëndimore ishte i përmbajtur, pasi synonte ruajtjen e dialogut. Në vitin 1985 u vendos një komunikim i përkohshëm

²⁷ *Po aty*, fl. 142. Mbi problemin e arit shqiptar të bllokuar nga Anglia.

²⁸ Afrim Krasniqi, "Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe dhe ndikimet gjatë tranzicionit," në Afrim Krasniqi (ed.), *Marrëdhëniet shqiptaro-britanike: 100 vjet raporte – historia, bilanci dhe perspektiva* (Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave, 2026), 228.

²⁹ *AMPJ*, V. 1985, D. 1161, fl. 288. Procesverbal i bisedimeve të zhvilluara në Paris ndërmjet delegacionit të RPSSH-së dhe delegacionit të Britanisë së Madhe për çështjen e arit shqiptar.

³⁰ Krasniqi (ed.), *Marrëdhëniet shqiptaro-britanike. 100 vjet raporte*, 10.

³¹ Krasniqi, "Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike", 218.

midis palëve,³² megjithatë dokumentet tregojnë se pala shqiptare i konceptoi bisedimet jo si proces negociues, por si platformë për riafirmimin e qëndrimeve të saj dhe për maksimalizimin e kërkesave.³³ Asnjë nga skenarët e parashikuar nga ministri Malile nuk përfshinte mundësinë e pranimi të ofertës ekzistuese ose të një kompromisi real. Ajo jo vetëm vijoi të refuzonte apriori pagesat detyruese, por zgjeroi edhe listën e pretendimeve, duke përfshirë kërkesa për kompensim dëmsh nga veprimtaria e grupeve diversante të viteve '49-'50, reparacione lufte dhe rillogaritje monetare sipas kursit të ri të këmbimit. Procesverbalet e takimeve tregojnë se zyrtarët dhe ekspertët shqiptarë të angazhuar demonstuan një qasje dogmatike dhe ideologjike,³⁴ shpesh në kontrast të hapur me argumentet juridike dhe financiare të palëve përëndimore dhe me praktikat e ndjekura me vendet e tjera. Kjo sjellje prodhoi një dialog të ngurtë, më tepër një monolog sesa negociatë, duke ndikuar negativisht edhe në fleksibilitetin e ofertave të palëve të tjera, veçanërisht të Britanisë së Madhe, për të cilën përmbushja e vendimit të gjykatës përbënte çështje prestigji politik dhe drejtësie.

Nga takimi në takim, të njëjtët zyrtarë dhe diplomatë propozonin dhe mbronin teza, të cilat në takimet vijuese i tërhiqnin ose i ndryshonin, duke pranuar në konsultimet shkresore me MPJ-në se disa prej tyre ishin të paarsyeshme dhe nuk ishin aplikuar nga pala shqiptare as në bisedimet për rivendosjen e marrëdhënieve me RFGJ-në. Ky tipar u përsërit edhe në prill 1990, kur eksperti kryesor i delegacionit, historiani Arben Puto, përmes një materiali të shkruar, ndonëse pranoi se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ishte një fakt juridik i detyrueshëm dhe se ishte *"thjesht një gjyq i humbur, padrejtësisht, por megjithatë i humbur"*, mbështeti tezën se Shqipëria kishte pasur dhe kishte plotësisht të drejtë ta atakonte këtë vendim, përderisa ai nuk pasqyronte të vërtetën dhe nuk përputhej me kuptimin e përgjithshëm të drejtësisë.³⁵

³² Ksenofon Krisafi, *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore* (Tiranë: Dita, 2008), 177-188.

³³ AMPJ, V. 1990, D. 89, fl. 1-2. Informacione, radiograme, shkëmbime korrespondence etj., mbi takimet dhe bisedimet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, si dhe diskutime mbi çështjen e arit me Anglinë. Mendime për rifillimin e bisedimeve.

³⁴ AQSH, F. 14/AP-STR, V. 1990, D. 222; si dhe AMPJ, V. 1990, D. 89; *po aty*. V. 1991, D. 64. Mbi bisedimet me Anglinë, procesverbalet e bisedimeve.

³⁵ AQSH, F. 14/AP-STR, V. 1990, D. 222, fl. 14. Informacion për bisedimet që do të zhvilloheshin me anglezët për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe për kthimin e arit. Mbi çështjen e arit monetar dhe incidentin e Kanalit të Korfuzit.

Nga pikëpamja kronologjike, bisedimet e vitit 1985 në ambasadat respektive shqiptare dhe britanike në Paris³⁶ (15, 18 dhe 20 mars; 6-7 qershor; 23-26 korrik) konfirmuan pozicionet ekzistuese pa sjellë ndonjë progres real. Tentativa për rifillimin e dialogut në OKB në vitin 1987³⁷ dhe raundet pasuese në vitin 1990 në Romë dhe Gjenevë shënuan ndryshime të vogla: pala shqiptare hoqi dorë nga kërkesat për fitim të munguar dhe forma reparacionesh, duke u përqendruar në negocimin e shifrave detyruese, ndërsa pala britanike rriti kërkesën për dëmshpërblim deri në 6 milionë dollarë, një qëndrim i ndikuar edhe nga dinamika e brendshme politike britanike.³⁸ Rritja e shifrës u lexua si akt destruktiv sjelljeje, por, sipas një këshillimi nga drejtuesit e shoqatës së miqësisë shqiptaro-angleze në Londër, pala shqiptare nuk duhej ta theksonte shqetësimin për shifrën e re të kërkuar, pasi ajo u servir më tepër nga Departamenti i Thesarit si pasojë e situatës së brendshme politike në Angli përpara zgjedhjeve.³⁹ Koha tregoi se sugjerimi ishte i drejtë.

Një element kyç ishte përfshirja personale e Ramiz Alisë, i cili, jo vetëm gjatë periudhës së regjimit, por edhe dy ditë pas lejimit të pluralizmit politik, me shkrim dore në shkresën e ministrit Malile, përcaktoi “vijat e kuqe” të negociatave.⁴⁰

“nuk mund të pranojmë të paguajmë as përgjegjësi për incidentin e Korfuzit”, “mund të pranojmë të paguajmë 1.9 milionë dollarë, nëse anglezët në dëftesën e marrjes na japin me shkrim garanci mbështetëse për kthimin e plotë të arit” dhe se “me amerikanët nuk do të diskutohet, sepse edhe ne kemi pretendime”.

³⁶ *AMPJ*, V. 1985, D. 1161, fl. 272. Procesverbal për bisedimet e zhvilluara në Paris midis delegacionit të RPSSH-së dhe delegacionit të Britanisë së Madhe për çështjen e arit shqiptar.

³⁷ *Po aty*, V. 1987, D. 1169, fl. 6. Informacion për bisedimet me anglezët për kthimin e arit shqiptar. Radiogram nr. 1304 dërguar Ramiz Alisë, Adil Çarçanit dhe Ministrisë së Jashtme nga zëvendësministri i Jashtëm, Muhamet Kapllani, 30.09.1987.

³⁸ *Po aty*, V. 1991, D. 64/1, fl. 1. Disa mendime për takimin me ministrin e Punëve të Jashtme të Anglisë.

³⁹ *Po aty*, V. 1991, D. 64, fl. 1-3. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e Foreign Office (FO) për problemin e arit monetar. Informacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 07.11.1991.

⁴⁰ *AQSH*, F. 14/AP-STR, V. 1990, D. 222, fl.1. Informacion për bisedimet që do të zhvilloheshin me anglezët për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe për kthimin e arit. Shënim nga Ramiz Alia 14.12.1990.

Shënimi përbën një dëshmi origjinale të hendekut midis qasjes së regjimit dhe praktikave reale negociuese, si dhe kontrastin me fleksibilitetin që do të shfaqej vetëm disa muaj më pas, në kushtet e avancimit të ndryshimit të sistemit politik.

Me pluralizmin dhe rotacionin, vullnet dhe frymë konstruktive

Zhvillimet politike të viteve 1990-1991 reflektuan transformimet e brendshme në Shqipëri dhe një ripozicionim gradual të Perëndimit ndaj këtyre realiteteve. Gjatë vitit 1990, as Shtetet e Bashkuara dhe as Britania e Madhe nuk treguan interes për një zgjidhje të shpejtë të çështjes së arit, duke synuar ruajtjen e presionit për ndryshime thelbësore. Përkundrazi, ishte vetë regjimi në ikje që tentoi të largohej nga politika izolacioniste, të anëtarësohej në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (KSBE), të rivendoste marrëdhënie me dy fuqitë e Komisionit Trepalësh, si dhe të siguronte akses në ndihma ekonomike për të përballuar krizën në vend. Reagimi amerikan e britanik ishte nga skeptik deri në kritik, veçanërisht pas ngjarjeve të korrikut 1990, të cilat evidentuan limitet e reformimit të brendshëm të sistemit. Në këtë fazë, çështja e kthimit të arit monetar nuk trajtohej më si një objektivi i pavarur, por u integrua në një kuadër më të gjerë politik, ku kriteret politike morën prioritet dhe u konfirmuan edhe nga vizita e De Concini-t në gusht 1990.⁴¹

Ndryshimi u bë më i dukshëm pas lejimit të pluralizmit politik në dhjetor 1990, kur SHBA-ja dhe Britania e Madhe intensifikuan kontaktet dhe bisedimet për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, duke mbështetur hapur tranzicionin demokratik. Kjo u reflektua edhe në votën e tyre përcaktuese për përfshirjen e Shqipërisë në strukturat e KSBE-së⁴² dhe në shndërrimin e Bashkimit Europian (atëherë TPE) në donatorin kryesor për përballimin e krizës së thellë sociale dhe ekonomike. Aktet politike dypalëshe përfshinë angazhimet për zgjidhjen e problematikave, por ishte e qartë se një qeverisje demokratike do të ishte partner më i

⁴¹ AQSH, V. 1990, D. 379, fl. 8. Procesverbal i takimit të Ramiz Alisë, Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, më datë 21.08.1990, me delegacionin e kongresit të SHBA-së për sigurimin dhe bashkëpunimin në Europë të kryesuar nga kryetari i këtij delegacioni, Senatori Denis de Koncini.

⁴² AMPJ, V. 1991, D. 64, fl. 220. Njoftime dhe programe mbi takimin me delegacionin e FO-së për problemin e arit monetar.

besueshëm dhe konstruktiv, gjë që u reflektua edhe në qëndrimet britanike.

Në mjedisin shqiptar të viteve 1991-1992, debati mbi arin nazist dhe detyrimet shqiptare ndaj SHBA-së e Mbretërisë së Bashkuar (MB) shkaktuan keqkuptime të konsiderueshme. Ishte e vështirë që publiku, i pamësuar me debate të tilla dhe koncepte të marrëdhënieve ndërkombëtare, të pranonte se dy shtete aleate, të angazhuara në mbështetjen e tranzicionit demokratik, sidomos SHBA-ja – *“që populli ynë e shikon këtë vend si idhull dhe mbështetje të demokracisë shqiptare”*⁴³ – kushtëzonin bllokimin e arit dhe kërkonin paralelisht shlyerje financiare. Kur sekretari amerikan Bejker njoftoi akordimin e 6 milionë dollarëve ndihmë për Shqipërinë në mitingun e madh të pritjes që iu bë, disa media të së majtës e përqeshën shifrën duke e akuzuar se do të merrte përsëri një pjesë të saj. Në perceptimin publik dhe politik mbizotëroi ideja se rrëzimi i regjimit komunist do të sillte automatikisht edhe zhdukjen e detyrimeve të trashëguara prej tij. Ky keqkuptim u ushqye nga dinamika e brendshme politike, por edhe nga përdorimi instrumental i historisë në funksion të betejave politike të ditës.

Në prag dhe pas zgjedhjeve të vitit 1992, aktorë politikë perëndimorë, përfshirë struktura të lidhura me Partinë Konservatore britanike, si edhe institutet demokratike dhe republikane amerikane, luajtën një rol të rëndësishëm në mbështetjen politike dhe teknike të forcave të reja demokratike.⁴⁴ Kur ndodhi rotacioni politik brenda një kohe të shkurtër, elitat politike shqiptare – të vjetra dhe të reja – u ripozicionuan hapur si proamerikane dhe probritanike. Në funksion të interesave politikë të ditës, debatin e munguar për arin nazist e zëvendësoi diskutimi mbi arin e supozuar që Mbreti Zog mori gjatë largimit.* Me nismat për rishikimin e formës së regjimit, monarkia duhej anatemuar dhe delegjitimuar edhe më shumë, ndërsa mitet shërbenin me sukses për këtë qëllim. Debati për arin gjerman u rikthye përkohësisht vetëm kur në Tiranë nisën bisedimet për miratimin e varrezave gjermane në Shqipëri; edhe në këtë rast, ai u zhvillua më shumë si debat politik dhe

⁴³ *Po aty*, V. 1994, D. 1105, fl. 16. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Relacion i ministrit të Financave, 22.04.1993.

⁴⁴ Afrim Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri, 1920-2006* (Tiranë: ISP, 2006), 293.

* Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u detyrua të krijonte Komisionin e Përkohshëm të Thesarit (1991). Raporti i komisionit dhe debati parlamentar u zhvilluan më 29.01.1992.

ideologjik në kontekstin e brendshëm shqiptar, sesa si çështje ligjore apo e marrëdhënieve midis dy vendeve apo me Komisionin Trepalësh.⁴⁵ Gjithsesi, zhvillimet e asaj periudhe dëshmuar se vetëm pas konsolidimit të sistemit pluralist dhe ndryshimit të qasjes shtetërore ndaj trashëgimive të së kaluarës do të krijoheshin kushtet për një trajtim realisht pragmatik dhe konstruktiv të çështjes së arit monetar shqiptar.

Zgjidhja me Mbretërinë e Bashkuar

Ecuria e bisedimeve me Mbretërinë e Bashkuar ishte e lidhur ngushtë me zhvillimet politike në Shqipëri dhe me ndryshimin gradual të kontekstit ndërkombëtar.⁴⁶ Ndryshe nga praktika shqiptare, ku parlamenti nuk zhvilloi asnjë debat për çështjen e arit, në Parlamentin Britanik kjo temë u ngrit periodikisht përmes pyetjeve drejtuar *Foreign and Commonwealth Office* (FCO). Veçanërisht gjatë vitit 1991 u rrit interesi dhe presioni politik për zgjidhjen e kësaj problematike. Për palën britanike, kushtëzimi i bisedimeve me respektimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për incidentin e Kanalit të Korfuzit ishte çështje parimore, e lidhur me drejtësinë, prestigjin shtetëror, nderimin e viktimave dhe zbatimin e rendit juridik ndërkombëtar, më tepër sesa me rëndësinë financiare të pretendimit.⁴⁷ Një raport i MPJ-së e cilësonte para së gjithash si çështje dinjiteti për palën britanike.⁴⁸ Refuzimi i vazhdueshëm nga një shtet i vogël dhe në krizë perceptohej si i papranueshëm për një fuqi të madhe. Kjo bëhet veçanërisht e dukshme po të merret parasysh se vetëm gjatë vitit 1991, Britania e Madhe kontribuoi për Shqipërinë rreth 10-11 milionë dollarë ndihma përmes TPE/BE-së,⁴⁹

⁴⁵ AMPJ, V. 1991, D. 64, fl. 227. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e FO-së për problemin e arit monetar.

⁴⁶ Po aty, V. 1990, D. 89, fl. 3. Informacione, radiograme, shkëmbim korrespondence etj., mbi takimet dhe bisedimet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, si dhe diskutime mbi “Çështjen e Arit” me Anglinë.

⁴⁷ Po aty, V. 1991, D. 58, fl. 1-2. Informacione, komunikatë mbi rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Anglinë. Mbi normalitetin e marrëdhënieve me Anglinë.

⁴⁸ Po aty, V. 1994, D. 1104, fl. 5. Ari monetar, informacion, 23.07.1993.

⁴⁹ Po aty, V. 1992, D. 1159, fl. 18-19. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje.

pra rreth pesëfishin e shumës së pretenduar për incidentin e Kanalit të Korfuzit.

Bisedimet u ndikuan edhe nga kriza e vitit 1991 dhe nga ndryshimet e shpejta politike, të shoqëruara me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-në (mars) dhe me Britaninë e Madhe (maj), aplikimin për anëtarësim në KSBE dhe krijimin e qeverisë së stabilitetit. Takimi i 7 qershorit 1991 në Gjenevë nuk prodhoi rezultat konkret, ndonëse në të njëjtën periudhë Britania votoi pro anëtarësimit të Shqipërisë në KSBE.⁵⁰ Më 23 korrik 1991, ndihmësekretari i FCO-së, Michael Tait, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë me synimin për të nxitur një zgjidhje përfundimtare. Dy elemente të reja u shfaqën në këto bisedime: rritja e kërkesës britanike në 6 milionë dollarë dhe propozimi i zëvendëskryeministrit Gramoz Pashko për përdorimin hipotetik të një kredie britanike afatgjatë ose afatshkurtër si instrument për rregullimin e pretendimeve financiare.⁵¹ As kjo fazë nuk solli zgjidhje dhe bisedimet u shtynë për vitin 1992.

Pas zgjedhjeve parlamentare dhe rotacionit politik të marsit 1992, qeveria e re u angazhua për një zgjidhje të shpejtë të çështjeve të hapura me Britaninë e Madhe, e cila nuk kishte hapur përfaqësi diplomatike në Tiranë. Bisedimet rifilluan në maj 1992 në ambasadën britanike në Romë.⁵² Delegacioni britanik vijonte të drejtohej nga Michael Tait, ndërsa pala shqiptare përfaqësohej nga zëvendësministri i Jashtëm, Mëhill Marku. Klima e re politike ndikoi drejtpërdrejt në ecurinë e negociatave, të cilat u zhvilluan në frymë konstruktive dhe në një kohë relativisht të shkurtër. Tait-i propozoi zgjidhjen paralele të dy problematikave: shlyerjen e pretendimeve financiare britanike dhe dhënien e pëlqimit të Mbretërisë së Bashkuar pranë Komisionit Trepalësh për kthimin e arit Shqipërisë. Ai iu referua dakordësisë paraprake me zëvendëskryeministrin Gramoz Pashko, sipas së cilës qeveria shqiptare do të bënte një deklaratë për njohjen e vendimit të Gjykatës

Mbi bisedimet e zhvilluara në Romë me palën angleze lidhur me problemin e arit monetar shqiptar.

⁵⁰ *Po aty*, V. 1991, D. 64, fl. 220. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e FO-së lidhur me problemin e arit monetar.

⁵¹ *Po aty*, fl. 322. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e FO-së lidhur me problemin e arit monetar. Disa mendime për takimin me ministrin e Punëve të Jashtme të Anglisë, 09.09.1991.

⁵² *Po aty*, V. 1997, D. 68, fl. 1-5. Çështja e arit monetar. Grabitja e arit monetar të Bankës Kombëtare Shqiptare nga nazistët gjermanë. Hebrenjtë në Shqipëri.

Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit.⁵³ Ky element kishte rëndësi të veçantë për palën britanike, sidomos në kontekstin e ndjeshmërive politike të brendshme.

Procesverbali i takimit tregon se pala shqiptare theksoi distancimin politik nga qeveritë komuniste, duke deklaruar se

“qeveria e re shqiptare që doli nga zgjedhjet e 22 marsit 1992 nuk ka lidhje me qeveritë e kaluara komuniste dhe nuk ndjehet përgjegjëse për veprimet e tyre”.⁵⁴

Ndryshe nga Pashko, Marku vuri në dukje vështirësitë e pranimi të drejtpërdrejtë të vendimit të Gjykatës së Hagës, për shkak të mungesës së dokumenteve që provonin përgjegjësinë shqiptare dhe, sidomos, të kostove politike të brendshme që do të sillte një pranim i tillë. Në fakt, gjetja e një formulimi kompromisi mbi përgjegjësinë për incidentin e Kanalit të Korfuzit rezultoi një proces i ndërlikuar dhe gradual. Në fund të vitit 1991, përmes kanaleve joformale, pala britanike sugjeroi një formulë sipas së cilës mund të pranohej se “*ka mundësi që dikush në qeverinë shqiptare të asaj kohe të ketë pasur dijeni për incidentin*”, pa i atribuuar përgjegjësi qeverisë aktuale.⁵⁵ MPJ-ja shqiptare propozoi një formulim alternativ: “*Përveç pohimit të bërë në shtyp nga Bedri Spahiu, person me përgjegjësi të lartë në udhëheqjen shqiptare të asaj kohe, pala shqiptare gjer tani nuk disponon asnjë dokument ose të dhënë tjetër që të konfirmojë deklaratën e Bedri Spahiut*”,⁵⁶ i cili në thelb e pranonte mundësinë e ekzistencës së deklaratës, duke shmangur një pranim deklarativ të fajësisë, ndërsa linja zyrtare mbeti edhe më tej evituese. Në maj 1992, MPJ-ja shqiptare paraqiti një tekst kompromisi, sipas të cilit të dyja palët “mbanin shënim” për incidentin, ndërsa qeveria shqiptare deklaronte se nuk ishte në gjendje të mbante qëndrim përfundimtar mbi

⁵³ *Po aty*, V. 1991, D. 64, fl. 323. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e FO-së lidhur me problemin e arit monetar.

⁵⁴ *AMPJ*, V. 1992, D. 1159, fl. 17-18. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje. Mbi bisedimet e zhvilluara në Romë me palën angleze lidhur me problemin e arit monetar shqiptar.

⁵⁵ *Po aty*, V. 1991, D. 64, fl. 2. Njoftime dhe programe mbi takimet me delegacionin e FO-së lidhur me problemin e arit monetar. Informacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 07.11.1991.

⁵⁶ *Po aty*, V. 1997, D. 68, fl. 103, 1997. Çështja e arit monetar.

ngjarjen.⁵⁷ Ky formulim u pranua dhe negociatat kaluan në fazën financiare. Duke reflektuar situatën politike dhe ekonomike të Shqipërisë, pala britanike hoqi dorë nga kërkesa prej 6 milionë dollarësh dhe propozoi një shifër kompromisi prej 2 milionë dollarësh, të njëjtë me propozimin e vitit 1984, duke vënë në dukje se ndërkohë kishte akorduar për Shqipërinë rreth 6 milionë sterlina ndihmë pa kthim.⁵⁸ Propozimi u pranua nga pala shqiptare.

Më 8 maj 1992, Mëhill Marku dhe Michael Tait nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, i miratuar më pas me VKM nr. 258/1992.⁵⁹ Memorandumi parashikonte që Mbretëria e Bashkuar të jepte pëlqimin për livrimin e rreth 1.574 kg ari Shqipërisë nga rezervat e administruara nga Komisioni Trepalësh, ndërsa Shqipëria do të paguante detyrimin financiar ndaj MB-së. Pas kryerjes së pagesës, pretendimet financiare britanike do të konsideroheshin të zgjidhura plotësisht dhe përfundimisht. Palët theksuan se livrimi i arit kërkonte gjithashtu pëlqimin e dy shteteve të tjera në komision.⁶⁰ Në tetor 1992, Ministria e Punëve të Jashtme vijonte të evidentonte nevojën për sqarime teknike me palën britanike, përfshirë modalitetet e pagesës dhe transportin e arit. U shqyrtua edhe alternativa që ari të mos transportohej fizikisht, por të konvertohej në vlerë monetare të transferueshme, për të shmangur kostot e sigurimit dhe transportit.⁶¹

Në aspektin juridik, dispozitat kryesore kushtetuese të asaj periudhe parashikonin detyrimin për ratifikim parlamentar të marrëveshjeve me pasoja financiare. Për shkak të paqartësive institucionale dhe mungesës

⁵⁷ *Po aty*, V. 1992, D. 1159, fl. 17-18. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje. Mbi bisedimet e zhvilluara në Romë me palën angleze lidhur me problemin e arit monetar shqiptar.

⁵⁸ *Po aty*, V. 1994, D. 1104, fl. 1. Ari monetar, njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 17.07.1991.

⁵⁹ *Po aty*, V. 1992, D. 36, fl. 41-42. Informacione mbi bisedimet midis dy delegacioneve për problemin e arit monetar, të zhvilluara më 08.05.1992 në Romë, takimet me palën angleze dhe për çështje të tjera; memorandum mirëkuptimi.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, V. 1992, D. 1159, fl. 28. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje. Për ndjekjen e çështjes së kthimit në Shqipëri të arit shqiptar të bllokuar në Angli, 22.10.1992.

së përvojës, kjo procedurë u shty, derisa më 18 korrik 1995 Ministria e Financave kërkoi miratimin urgjent parlamentar të memorandumit për të siguruar një mandat të qartë në negociatat përfundimtare me palën britanike dhe Komisionin Trepalësh.⁶²

Pas arritjes së marrëveshjes me Mbretërinë e Bashkuar, fokusi u zhvendos drejt zgjidhjes së çështjeve me Shtetet e Bashkuara dhe sigurimit të dakordësisë franceze.

Zgjidhja me Shtetet e Bashkuara

Trajtimi i çështjeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të Komisionit Trepalësh për kthimin e arit monetar ndoqi në mënyrë lineare ecurinë e marrëdhënieve politike dypalëshe. Nga viti 1984 deri në vitin 1990, Tirana zyrtare refuzoi apriori kërkesat amerikane, fillimisht duke mohuar ekzistencën e shpronësimeve të pronës së shtetasve amerikanë dhe më pas duke kundërshtuar kostot e parashikuara në planin 7-pikësh të vitit 1984.⁶³ Në kushtet e mungesës së marrëdhënieve diplomatike dhe duke e konsideruar çështjen e arit kryesisht si problem të raporteve me Mbretërinë e Bashkuar, Shqipëria nuk tregoi vullnet dhe as interes për avancim me palën amerikane. Deri në vitin 1990, autoritetet shqiptare duket se nuk e kishin perceptuar sa duhet faktin se kërkesa amerikane për kompensim prej rreth 2 milionë dollarësh përbënte kusht procedural për vijimin e procesit të kthimit të arit nga Komisioni Trepalësh.

Ndryshe nga rasti britanik, në raportet me SHBA-në çështja e pretendimeve financiare mbeti dytësore edhe gjatë procesit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike në vitet 1990-1991. Prioritet për Uashingtonin ishte ndryshimi politik në Shqipëri dhe orientimi i saj pro-perëndimor, më shumë sesa zgjidhja e menjëhershme e mosmarrëveshjeve financiare.⁶⁴ Kjo qasje u reflektua në Memorandumin

⁶² *Po aty*, V. 1995, D. 1141, fl. 21-22. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve për arin e grabitur nga gjermanët.

⁶³ *AMPJ*, V. 1984, D. 606, fl. 140. Mbi problemin e arit shqiptar të bllokuar nga Anglia.

⁶⁴ Afrim Krasniqi, "Nga rivendosja e marrëdhënieve te ndërtimi i një aleance strategjike," në *Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane gjatë shekullit XX* (Tiranë: Instituti i Historisë/ASA, 2023), 76-77.

e marsit 1991, i cili parashikonte se, pas rivendosjes së marrëdhënieve, palët do të hynin në negociata për zgjidhjen e pretendimeve financiare dhe pasurore të mbetura pezull.⁶⁵ Megjithatë, gjatë pjesës tjetër të vitit 1991 dhe fillimit të vitit 1992 nuk pati progres konkret, pjesërisht për shkak të bindjes shqiptare se bisedimet do të ishin të lehta, duke u nisur nga realiteti i ri politik dhe nga roli i SHBA-së si donator kryesor i reformave. Kjo pritshmëri doli shpejt e gabuar. Në takimin e 24 gushtit 1992 në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pala shqiptare i kërkoi ambasadorit amerikan Rajerson pëlqimin për kthimin e arit shqiptar, duke e konsideruar të mirëqenë dakordësinë amerikane.⁶⁶ Në përgjigje, ambasadori riafirmoi pozicionin amerikan të vitit 1984, duke theksuar se kthimi i arit mund të realizohej vetëm pas zgjidhjes së çështjes së shpronësimeve të shtetasve amerikanë nga regjimi komunist. Ai pranoi se vlerësimi financiar nuk ishte përfundimtar, por nënvizoi se praktika e kushtëzimit ishte ndjekur edhe me shtete të tjera përfituese nga mekanizmi i Komisionit Trepalësh.⁶⁷

Bisedimet faktike rezultuan më të gjata dhe më komplekse sesa ishin parashikuar. Gjatë fazës përgatitore (1991-1993), MPJ-ja shqiptare shpresonte se, përmes dokumenteve, pretendimet amerikane nuk do të justifikonin shifrat e propozuara, duke iu referuar edhe faktit se, në vitin 1954, përfaqësuesi amerikan në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë pati mohuar ekzistencën e kërkesave ndaj Shqipërisë.⁶⁸ Megjithatë, hapja e kësaj dosjeje evidentoi se vetë shteti shqiptar, pavarësisht periudhës së gjatë në dispozicion, nuk i kishte shqyrtuar dhe as dokumentuar të dhënat shteruese lidhur me pronat e sekuestruara të shtetasve amerikanë. Për këtë arsye, MPJ-ja sugjeroi përgatitjen e një inventari të detajuar të pronave dhe të bazës ligjore përkatëse, në mënyrë që pala shqiptare të kishte një pozicion negociues më të strukturuar.⁶⁹ Procesi u vonua, kështu

⁶⁵ AMPJ, V. 1991, D. 851, fl. 3. Korrespondencë e informacion mbi takimet mes ekspertëve dhe diplomatëve për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike SHBA-Shqipëri, janar-mars 1991. Memorandum mirëkuptimi.

⁶⁶ Po aty, V. 1992, D. 1159, fl. 1. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje. Informacion mbi takimin me ambasadorin amerikan, 24.08.1992.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Po aty, V. 1994, D. 1104, fl. 1. Ari monetar. Informacion, 23.07.1993.

⁶⁹ Po aty, V. 1992, D. 1159, fl. 25. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar. Për ndjekjen e çështjes së kthimit të arit shqiptar të bllokuar në Angli, 22.10.1992.

që si bazë referimi u morën të dhënat e ofruara nga pala amerikane. Ajo paraqiti dokumente për rreth 700 raste pretendimesh. Në prill 1993, në përpjekje për kompromis, pala shqiptare ofroi një pagesë prej 1.5 milionë dollarësh dhe paraqiti kundërp pretendime lidhur me dëmet e shkaktuara nga qarkorja nr. 655 e Departamentit të Thesarit të SHBA-së, e cila për dekada kishte ndaluar transferimin e pensioneve dhe pasurive të shtetasve shqiptarë ose me origjinë shqiptare. Sipas përlogaritjeve shqiptare, këto dëme arrinin rreth 4 milionë dollarë, me interesa.⁷⁰

Shkëmbimi i informacionit gjatë muajve prill-maj 1993 provoi se kompensimi i kërkuar nga pala amerikane ishte bazuar në vlerësimet e shpronësimeve të kryera kryesisht në vitet 1945-1946, të cilat përfshinin troje dhe shtëpi, fabrika ose magazina, si dhe toka bujqësore.⁷¹ Takimet zyrtare të 28-30 prillit 1993 u përqendruan pikërisht në këtë çështje. Pala shqiptare, përmes diplomatit Leonard Demi, propozoi trajtimin e pretendimeve sipas ligjit shqiptar për pronat, i miratuar vetëm disa ditë më parë, por kjo qasje u refuzua nga pala amerikane, e cila kërkoi kompensim të plotë financiar deri në 3 milionë dollarë.⁷² Mospërputhja e qëndrimeve çoi në ndërprerjen e përkohshme të progresit në bisedime. Në muajt vijues u hodhën disa propozime kompromisi. Më 7 korrik 1993, pala shqiptare rikonfirmoi ofertën prej 1.5 milionë dollarësh, ndërsa në fund të vitit pala amerikane paraqiti shtojca në draft-marrëveshje, duke përjashtuar nga objekti i saj pasuritë e Fondacionit Kennedy në Korçë, të cilat do të trajtoheshin sipas legjislacionit shqiptar.⁷³ Shqipëria e pranoi këtë ndryshim, duke kërkuar në këmbim garanci për kthimin e arit

⁷⁰ *Po aty*, V. 1994, D. 1105, fl. 16. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Relacion i ministrit të Financave, 22.04.1993.

⁷¹ *Po aty*, fl. 47-48. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar, lidhur me shpjegimet që pala amerikane ka dhënë për metodat dhe vlerësimin e disa pretendimeve.

⁷² *Po aty*, fl. 1. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Informacion mbi vijueshmërinë e përpjekjeve për të zgjidhur pretendimet pasurore të SHBA-së ndaj vendit tonë, 07.03.1994.

⁷³ *Po aty*, fl. 47-48. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar, lidhur me shpjegimet që pala amerikane ka dhënë për metodat dhe vlerësimin e disa pretendimeve.

monetar. SHBA-ja nuk ofroi garanci formale, por u angazhua të minimizonte rreziqet procedurale gjatë procesit të kthimit.⁷⁴

Përparimi real u arrit gjatë bisedimeve të 26 prillit 1994 në Uashington, ku palët hartuan një projekt marrëveshje. Çështja e vetme e hapur mbeti shuma e kompensimit. Marrëveshja parashikonte ratifikimin parlamentar dhe angazhimin e SHBA-së për të mbështetur thirrjen e Komisionit Trepalësh në Londër për zgjidhjen e çështjeve teknike të kthimit të arit. Në kushtet e përkeqësimit të situatës financiare dhe të borxhit të jashtëm shqiptar, Ministria e Financave (MF) vlerësoi se çdo zvarritje e përfundimit të këtij problemi ishte në dëm të palës sonë dhe e ndërlikonte më tej sjelljen në Shqipëri të arit.⁷⁵ Ndaj, gjatë verës, ajo pranoi si kompromis shumë prej 2 milionë dollarësh.⁷⁶ Me VKM nr. 338, datë 01.08.1994, qeveria shqiptare miratoi marrëveshjen, duke pranuar pagesën dhe duke ia deleguar palës amerikane shpërndarjen e saj te shtetasit përfitues. Marrëveshja përfshinte edhe një *Agreed Minute*, ku parashikohej trajtimi, sipas ligjit shqiptar, i tri pronave të Fondacionit Kennedy në Korçë.⁷⁷

Zbatimi i marrëveshjes u shoqërua me vështirësi institucionale dhe mungesë koordinimi midis MPJ-së dhe Ministrisë së Financave gjatë viteve 1994-1995. Deri në vitin 1993, MPJ-ja ishte organi kryesor përgjegjës për ndjekjen e çështjes, por VKM-ja e vitit 1993 ia kaloi Ministrisë së Financave përgjegjësinë, bazuar në nevojën për ekspertizë financiare.⁷⁸ Kjo e fundit u ankua për mosbashkëpunim nga Ministria e

⁷⁴ *Po aty*, fl. 24-25. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Informacion mbi vijueshmërinë e përpjekjeve për të zgjidhur pretendimet pasurore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj vendit tonë.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 47. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar, lidhur me shpjegimet që pala amerikane ka dhënë për metodat dhe vlerësimet e disa pretendimeve, 15.07.1994.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 47. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Informacion i ministrit të Financave, 15.07.1994.

⁷⁷ *Po aty*, fl. 59. Bisedime mes SHBA-së dhe Shqipërisë për problemin e arit monetar. Mbi pretendimet pasurore të Shteteve të Bashkuara, 26.10.1994.

⁷⁸ *AMPJ*, V. 1995, D. 1141, fl. 1. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Mbi zgjidhjen e disa pretendimeve financiare midis Shqipërisë dhe SHBA-së. Letër e ministrit Serreqi drejtuar ministrit të Financave Dylber Vrioni, 07.02.1995.

Punëve të Jashtme, si dhe pati disa shkëmbime shkresore midis ministrave, ku theksohej se

“mbi gjithçka, është politike dhe diplomatike dhe është meritë e fitores së demokracisë që u zhblllokua një problem i mbetur pezull për 50 vjet”.

Pala amerikane gjithashtu pati ankesa për mospërgjigje nga MPJ-ja. Paqartësitë detyruan qeverinë të korrigjonte VKM-në 338/1994, ndërkohë që vijuan bisedimet lidhur me çështje teknike e juridike. Kur u arrit kompromisi edhe për të tria pronat e misionit baptist amerikan në Korçë, të sekuestruara nga shteti shqiptar (Shkolla Kennedy ose Misioni Evangjelist; rezidenca e banimit për personelin, si dhe një pronë prej 27 akrash, e njohur si Kodra Hill), më 10 mars 1995 u nënshkrua marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e pretendimeve financiare, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 7913, datë 06.04.1995. Sipas saj, SHBA-ja angazhohej të informonte Komisionin Trepalësh për gatishmërinë e saj për kthimin e arit monetar në përputhje me vendimet e pasluftës.⁷⁹

Zgjatja e bisedimeve për pranimin e ofertës amerikane të vitit 1984 dëshmon jo vetëm kompleksitetin objektiv të çështjes dhe defektet në koordinimin dhe vendimmarrjen strategjike koherente nga ana e institucioneve shqiptare, por edhe paradoksin se rasti i konsideruar fillimisht ndër më të lehtët në raport me palët e Komisionit Trepalësh u shndërrua në një nga proceset më të zgjatura dhe të fragmentuara të negociatave.

Zgjidhja me Francën

Krahas Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar, Franca ishte anëtarja e tretë e Komisionit Trepalësh të Arit Monetar dhe, për shkak të rregullit të konsensusit, mbështetja e saj ishte e domosdoshme për zhbllokimin e arit shqiptar. Gjatë gjithë procesit rezultoi se raportet

⁷⁹ *Po aty*, fl. 9. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Minuta bisedimesh.

me Francën ishin më pak problematike dhe se ajo shihej e diferencuar,⁸⁰ pasi midis dy vendeve nuk ekzistonin mosmarrëveshje politike apo pretendime financiare të hapura.⁸¹ Franca ishte gjithashtu vendi i vetëm perëndimor me prezencë të vazhdueshme diplomatike në Shqipëri dhe kishte një rol të veçantë historik, përfshirë formimin intelektual të një pjese të elitës komuniste shqiptare. Roli ndërmjetësues i Francës u shfaq qartë në vitin 1984, kur Parisi përcolli planin me shtatë pika për zgjidhjen e çështjes së arit, si dhe gjatë viteve 1985-1990, kur ai u bë qendra kryesore e bisedimeve shqiptaro-britanike. Që në kontaktet e para të vitit 1985 u bë e ditur se pala franceze ishte e gatshme të mbështeste kthimin e arit shqiptar pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, kur Ministria e Punëve të Jashtme kërkoi dokumentacion mbështetës, rezultoi se kjo dakordësi nuk ishte formalizuar në formë deklarimi zyrtar.⁸²

Qëndrimi francez mbeti i lidhur ngushtë me ecurinë e negociatave të Shqipërisë me dy aleatët e tjerë të Komisionit Trepalësh. Për këtë arsye, gjatë gjithë procesit, Parisi inkurajoi zgjidhjen e çështjeve me Londrën dhe Uashingtonin, duke shmangur çdo angazhim të njëanshëm.⁸³ Vetëm pas arritjes së marrëveshjeve me Mbretërinë e Bashkuar (1992) dhe me Shtetet e Bashkuara (1994-1995), pala shqiptare kërkoi zyrtarisht dhënien e pëlqimit formal edhe nga Franca. Në fillim të korrikut 1995, MPJ-ja shqiptare i kërkoi ambasadorit francez në Tiranë mbështetje zyrtare, duke theksuar se Shqipëria kishte siguruar tashmë dakordësinë e dy anëtarëve të tjerë të Komisionit Trepalësh.⁸⁴ Ministria

⁸⁰ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. V, grup autorësh, drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2023), 254.

⁸¹ *AMPJ*, V. 1995, D. 1141, fl. 1. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Letër e ministrit të Jashtëm, Alfred Serreqi, drejtuar Ministrisë së Financave, 17.10.1995.

⁸² *Po aty*, V. 1992, D. 1159, fl. 26. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar. Për ndjekjen e çështjes së kthimit të arit shqiptar të bllokuar në Angli, 22.10.1992.

⁸³ *Po aty*, fl. 3. Bisedimet me anglezët dhe amerikanët për kthimin e arit monetar, si dhe memorandum i nënshkruar me Anglinë për këtë çështje. Për ndjekjen e çështjes së kthimit në Shqipëri të arit shqiptar të bllokuar në Angli, 27.10.1992.

⁸⁴ *Po aty*, V. 1995, D. 1141, fl. 1. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Notë ambasadës franceze, 08.07.1995.

udhëzoi ambasadorin shqiptar në Paris që ta ndiqte çështjen në nivel institucional,⁸⁵ pasi kërkohej një deklaram formale i qeverisë franceze. Korrespondenca e muajve korrik-tetor 1995 dëshmon një proces të ngadaltë konsultimesh të brendshme në Paris, të ndikuar edhe nga ndryshimet qeveritare në Francë gjatë kësaj periudhe. Disa komunikime ndërmjet MPJ-së dhe Ministrisë së Financave, si edhe ambasadave respektive në Tiranë dhe Paris, ngritën shqetësimin për vonesën e një reagimi zyrtar francez.⁸⁶

Më 16 nëntor 1995, drejtori për Europën në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vili Minarolli, u takua me ambasadorin francez Lui Domenisi, i cili konfirmoi qëndrimin parimor pozitiv të qeverisë së tij, por pa dhënë një përgjigje zyrtare, duke e justifikuar vonesën me riorganizimet në qeverinë e Kryeministrit Zhypë.⁸⁷ Për të përshpejtuar procesin, pala shqiptare përdori edhe kanale lobuese parlamentare, duke nxitur senatorin Patrice Gelard t'i drejtonte pyetje zyrtare ministrit të Jashtëm Hervé de Charette lidhur me çështjen e arit shqiptar.⁸⁸ Në përgjigje, Ministria e Jashtme franceze riafirmoi se Shqipërisë i njihej e drejta për kthimin e arit dhe se procedurat po shkonin drejt përfundimit.⁸⁹

Në fund të dhjetorit 1995, pala franceze informoi zyrtarisht se çështja mund të mbyllej në një seancë të vetme në Tiranë, në fillim të vitit 1996, duke kërkuar paraprakisht dërgimin e një misioni teknik për

⁸⁵ *Po aty*, fl.1. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Mesazh ambasadës, Paris, 28.07.1995.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 23. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve lidhur me arin e grabitur nga gjermanët.

⁸⁷ *Po aty*, fl. 1. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Dërgohet informacion mbi takimin me ambasadorin francez në Tiranë lidhur me çështjen e arit shqiptar, 17.11.1995.

⁸⁸ *Po aty*, fl. 37. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Informacion i ambasadës në Paris.

⁸⁹ *AMPJ*, V. 1996, D. 1115, fl. 1-2. VKM dhe korrespondenca mbi bisedimet për marrëveshje dorëzimi të arit monetar. Informacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 07.02.1996.

përgatitjen e draft-marrëveshjes dypalëshe.⁹⁰ Ky angazhim u materializua më 5 shkurt 1996, kur qeveria franceze njoftoi zyrtarisht gatishmërinë për kthimin e arit shqiptar, me kushtin e nënshkrimit paraprak të një marrëveshjeje dypalëshe që do të mbyllte çdo detyrim publik ose privat të mbetur pezull midis dy vendeve.⁹¹ Më 12 shkurt 1996 u nënshkrua marrëveshja midis qeverisë së Republikës së Francës dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë.⁹² Sipas saj, Franca konfirmonte vendimin e Komisionit Trepalësh të janarit 1946 dhe pranonte se zgjidhja e çështjes së arit monetar nuk prodhonte pasoja mbi detyrime të tjera publike ose private. Marrëveshja u miratua në parim me VKM nr. 667, datë 19 shkurt 1996, duke mbyllur kështu kapitullin e fundit politik dhe juridik të konsensusit trepalësh.⁹³

Me arritjen e marrëveshjeve me Mbretërinë e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Francën, rruga ligjore dhe administrative për tërheqjen e arit monetar shqiptar u hap përfundimisht. Tri qeveritë depozituan qëndrimet e tyre pranë Komisionit Trepalësh dhe procesi vijoi sipas procedurave bankare ndërkombëtare. Në plan krahasues, rasti francez spikat për kohëzgjatjen e shkurtër të negociatave: bisedimet nisën në korrik 1995 dhe përfunduan në shkurt 1996, një interval dukshëm më i shkurtër sesa me dy palët e tjera. Ky ritëm u interpretua gjithashtu si një sinjal politik mbështetës ndaj qeverisë dhe presidentit shqiptar në prag të një fushate elektorale vendimtare.

Zgjidhja finale dhe kthimi i arit (1995-1998)

Nënshkrimi nga Shqipëria i marrëveshjeve të dakordësisë me Mbretërinë e Bashkuar (1992), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (1995) dhe Francën (1996) hoqi pengesën e fundit juridike dhe politike për

⁹⁰ *Po aty*, V. 1995, D. 1141, fl. 39. Informacione mbi zhbllokimin e arit monetar nga pala franceze dhe ajo amerikane, si dhe mbi bisedimet dhe kopjet e marrëveshjeve për zgjidhjen e disa pretendimeve. Ambasadës shqiptare në Paris.

⁹¹ *Po aty*, V. 1996, D. 1115, fl. 5. VKM dhe korrespondenca mbi bisedimet për marrëveshje dorëzimi të arit monetar. Notë nga ambasada franceze, 05.02.1996.

⁹² *Po aty*, fl. 10-11. VKM dhe korrespondenca mbi bisedimet për marrëveshje dorëzimi të arit monetar. Teksti i marrëveshjes 13.02.1996.

⁹³ *Po aty*, fl. 14. VKM dhe korrespondenca mbi bisedimet për marrëveshje dorëzimi të arit monetar. VKM 669/1996, 19.02.1996.

vijimin e procedurave të Komisionit Trepalësh për Kthimin e Arit Monetar.⁹⁴ Për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore, pala shqiptare pranoi formalisht kuadrin ndërkombëtar brenda të cilit do të zgjidhej përfundimisht çështja e arit monetar të grabitur nga Gjermania naziste. Në vitin 1996, qeveria Meksi miratoi në parim aktet “mbi heqjen dorë nga të drejtat” dhe “mbi marrjen në dorëzim” të arit shqiptar.⁹⁵

Duke qenë se Komisioni Trepalësh kishte selinë në Bruksel, ambasada shqiptare luajti rol ndërmjetësues në fazën përgatitore. Në mars 1996, ambasadori Bashkim Trenova zhvilloi bisedime me drejtuesit e komisionit, të cilët kërkuan përcaktimin e përfaqësuesit shqiptar të autorizuar për marrëveshjen përfundimtare. Më 12 prill 1996, kryetari i komisionit, Terry A. Breese, informoi zyrtarisht palën shqiptare se komisioni ishte në gjendje të procedonte me dorëzimin e pjesës kryesore të arit që i takonte Shqipërisë, në përputhje me vendimin e 9 qershorit 1958, me propozimin që dorëzimi të realizohej në dy faza, kryesisht përmes Bankës së Anglisë. Kriza politike dhe zgjedhore e vitit 1996 ndikoi negativisht në ritmin e procedurave. Në një komunikim me MPJ-në më 20 shtator 1996, ambasadori Trenova shprehte shqetësimin për mungesën e reagimit nga Tirana ndaj dokumenteve të përcjella nga Komisioni Trepalësh,⁹⁶ çka rrezikonte vonesa të mëtejshme në një proces të ndjeshëm dhe të avancuar teknikisht.

Në prag të takimit të Londrës më 29-30 tetor 1996, komisioni kërkoi përfaqësim të autorizuar, si dhe dokumentacion të qartë lidhur me qëndrimin dhe pritshmëritë shqiptare. Ekspertët e tij bënë të ditur se vetëm rreth 64% e sasisë së arit të grabitur ishte identifikuar, ndërsa pjesa tjetër përbëhej nga monedha me vlera numizmatike, të cilat e rrisnin vlerësimin financiar me rreth 20%.⁹⁷ Rreth 36% e arit mbetej e paidentifikuar; për këtë arsye, kthimi do të realizohej në masën e gjetur, me shtesë rreth 50 kg ari nga një fond i përbashkët për disa shtete.

⁹⁴ *Po aty*, V. 1996, D. 1114, fl. 54. Bisedimet për arin monetar. Deklarata e komisionit, 29.10.1996.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 2. Bisedimet për arin monetar. VKM përkatëse. VKM nr. 693/1996.

⁹⁶ *Po aty*, V. 1996, D. 1115, fl. 1. VKM, korrespondenca mbi bisedimet për marrjen në dorëzim të arit shqiptar. Njoftim i Komisionit Trepalësh për ambasadën shqiptare në Bruksel, 14.03.1996.

⁹⁷ *Po aty*, fl. 2. VKM, korrespondenca mbi bisedimet për marrjen në dorëzim të arit shqiptar. Njoftim i Komisionit Trepalësh për ambasadën shqiptare në Bruksel, 14.03.1996.

Ministria e Punëve të Jashtme sqaroi se shifra 64% i referohej sasisë fillestare prej 2,454.8745 kg ari të pretenduar pas luftës,⁹⁸ ndërsa vendimi i Komisionit Trepalësh i vitit 1958 – i njohur zyrtarisht nga pala shqiptare – i caktonte Shqipërisë 1,574.35 kg ari,⁹⁹ shifër që kishte shërbyer si bazë reale kompromisi në negociatat me Mbretërinë e Bashkuar.

Në fund të shtatorit 1996, qeveria shqiptare ngriti delegacionin për marrjen në dorëzim të arit në Londër, të kryesuar nga guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kristaq Luniku.¹⁰⁰ Më 18 tetor 1996, komisionerët amerikanë, britanikë dhe francezë i konfirmuan Bankës së Anglisë kalimin e sasisë së përcaktuar në favor të Bankës së Shqipërisë.¹⁰¹ Më 25 tetor, Banka e Shqipërisë komunikoi me Bankën e Rezervës Federale në Nju Jork për pagesën prej 4 milionë dollarësh,¹⁰² sipas marrëveshjeve përkatëse me SHBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Akti përfundimtar i dorëzimit u realizua më 29 tetor 1996. Dokumentet u nënshkruan nga guvernatori Luniku dhe sekretari i përgjithshëm i Komisionit Trepalësh, E. Davies, dhe u kryen transaksionet bankare për kalimin në llogari të Republikës së Shqipërisë të 49,804.149 ons ari të pastër, përmes Bankës së Anglisë, Bankës së Rezervës Federale të SHBA-së dhe Bankës së Shqipërisë.¹⁰³ Nga pikëpamja teknike, Shqipëria mori në dorëzim 77 shufra dhe 49 thasë me monedha ari, në total 1,549.0821 kg ari të pastër. Paralelisht, pala shqiptare firmosi heqjen dorë nga çdo pretendim i mëtejshëm ndaj Gjermanisë, Komisionit Trepalësh apo palëve të treta,¹⁰⁴ duke mbyllur përfundimisht kapitullin e hapur që prej vitit 1946.

Përmes një deklarate zyrtare më 29 tetor 1996, zëdhënësi i FCO-së njoftoi se

⁹⁸ *Po aty*, fl. 1. VKM, korrespondenca mbi bisedimet për marrjen në dorëzim të arit shqiptar. Informacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 12.04.1996.

⁹⁹ Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, *Decisions on the Allocation of Monetary Gold to Claimant Countries* (London, 1958), section on Albania.

¹⁰⁰ *AMPJ*, V. 1996, D. 1114, fl. 36. Bisedimet për arin monetar. VKM përkatëse. VKM nr. 668/1996.

¹⁰¹ *Po aty*, fl. 54. Bisedimet për arin monetar. Deklarata e komisionit, 29.10.1996.

¹⁰² *Po aty*, fl. 56. Bisedimet për arin monetar. Akti nënshkruar. Komunikimi me Bankën e Anglisë, 25.10.1996.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 54-56. Bisedimet për arin monetar. Akti nënshkruar. Komunikim i Bankës së Shqipërisë me Federal Reserve Bank, 25.10.1996.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 46-47. Bisedimet për arin monetar. Akti nënshkruar, 29.10.1996.

“Mbretëria e Bashkuar është e kënaqur që ari i mbajtur nga Komisioni i Arit Trepalësh tani po i kthehet Shqipërisë. Çështjet që kishin mbetur në mosmarrëveshje midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë tashmë janë zgjidhur. Kjo është një ditë historike për Shqipërinë dhe për marrëdhëniet tona dypalëshe. Ajo shënon përfundimin e mosmarrëveshjes sonë mbi këtë çështje me regjimin e mëparshëm.”¹⁰⁵

Zgjidhja e çështjes së arit u mirëprit nga elitat politike dhe ekonomike të të dyja vendeve. Sipas informacionit të ambasadorit Qesku, të nesërmen e arritjes së akordit, ministri i Shtetit për Punët e Jashtme, Nicholas Bonsor, organizoi një darkë për delegacionin, ku, përveç diplomatëve britanikë që merreshin me rajonin e Europës Juglindore, ambasadorëve dhe kabinetit, ishin të pranishëm edhe zyrtarë të lartë të fushës së tregtisë, si dhe drejtorët ekzekutivë të Premier Oil, Bankës së Anglisë dhe Bankës Rothschilds & Sons Ltd etj.¹⁰⁶

Marrëveshja, ceremonia dhe marrja në dorëzim e avancuan, por nuk e zgjidhën përfundimisht çështjen e kthimit të arit. Gjatë vitit 1997, Shqipëria u përfshi në një krizë të thellë politike e shtetërore, kështu që procesi i mbylljes së dosjes së arit pati vonesa politike dhe administrative. Një prej treguesve është se përfaqësuesi i autorizuar shqiptar u ndryshua tri herë brenda nëntë muajve, ndërsa Komisioni Trepalësh kishte të njëjtët drejtues për shumë vjet.

Në të njëjtën periudhë, në nivel europian u intensifikuan hetimet mbi pasuritë monetare të grabitura nga komunitetet hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Verifikime të tilla ishin shumë të vështira dhe më komplekse sesa verifikimi i dokumentacionit bankar të lëvizjes së arit dhe rezervave monetare shtetërore.¹⁰⁷ Shqipëria nuk kishte implikime financiare direkte, pasi nuk kishte pretendime për sekuestrime ndaj hebrenjve,¹⁰⁸ por gjithsesi kërkohej përfaqësim diplomatik aktiv. Kur Britania inicioi në fund të vitit 1997 një konferencë konsultative në Londër, më 5 gusht 1997 Shqipërisë iu kërkuua kontributi vullnetar në

¹⁰⁵ *Po aty*, fl. 5-6. Bisedimet për arin monetar. Faks i ambasadës në Londër nr. 275, 29.10.1996.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 5. Bisedimet për arin monetar. VKM përkatëse. VKM nr. 693/1996.

¹⁰⁷ *AMPJ*, V. 1997, D. 58, fl. 68-69. 1997. Çështja e arit monetar. Informacion mbi konferencën për rikthimin e arit nga nazistët, 08.08.1997.

¹⁰⁸ *Po aty*, V. 1997, D. 68, fl. 39. 1997. Çështja e arit monetar. Mbi çështjen e kthimit të arit monetar të grabitur individëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, 05.08.1997.

fondin e kompensimit,¹⁰⁹ duke akorduar një pjesë ose të gjithë sasinë e arit që duhej të përfitonte nga procesi i rikthimit. Tri ditë më vonë, MPJ-ja iu përgjigj apelit duke krijuar një grup pune me diplomatë, ekspertë dhe historianë, i cili kishte për detyrë evidentimin e pretendimeve të shtetasve shqiptarë për kompensime nga fondi në fjalë, shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur prej tyre dhe përpilimin e raportit për t'u paraqitur në mbledhjen e shtatorit në Bruksel dhe të dhjetorit në Londër.¹¹⁰ Në përfundim, më 30 shtator, Ministria e Punëve të Jashtme shprehu qëndrimin zyrtar, sipas të cilit Shqipëria ishte dakord me krijimin e fondit, por, duke u bazuar në faktin se ishte një nga vendet ku hebrenjtë nuk ishin objekt persekutimi, si dhe në gjendjen e rëndë ekonomike në vend dhe nevojën për ndihma dhe investime nga institucione ndërkombëtare financiare etj., premtoi një kontribut financiar modest për fondin.¹¹¹ Përmes një letre të datës 20 tetor 1997, ambasada e SHBA-së në Belgjikë e falënderoi palën shqiptare për përgjigjen pozitive. Ndërkohë, më 2-4 dhjetor u mbajt në Londër konferenca mbi arin nazist, ku delegacioni izraelit veçoi Shqipërinë dhe Danimarkën për mbështetjen e dhënë për qytetarët hebrenj dhe shprehu konsideratën e lartë të qeverisë së tij ndaj këtyre shteteve.¹¹² Vlen të theksohet se arsyetimi për konferencën që përdori nënsekretari amerikan i Shtetit, Stuart E. Eizenstat, se

“në kuadrin e ekzistencës së blloqeve kundërshtare, me synimin e ruajtjes së balancave të domosdoshme, nuk ishte shkuar deri në zgjidhjen përfundimtare disa çështjeve, midis cilave edhe problemit të arit dhe pasurive të tjera të grabitura nga nazistët gjatë luftës; se sot, në fund të këtij shekulli, nuk mund të hyjmë në shekullin e ri pa zgjidhur punët e papërfunduara të këtij shekulli. Ne kemi përgjegjësi kolektive në qoftë se nuk do të bëjmë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbuluar të vërtetën dhe për të

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 1-2. 1997. Çështja e arit monetar. Mbi çështjen e kthimit të arit monetar të grabitur individëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, 05.08.1997.

¹¹⁰ *Po aty*, V. 1997, D. 58. 1997, fl. 76. Çështja e arit monetar. Mbi krijimin e një grupi pune për kthimin e arit monetar që u ishte grabitur individëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, 12.08.1997.

¹¹¹ *Po aty*, V. 1997, D. 68, fl. 38. Çështja e arit monetar. Informacion mbi konferencën, 05.12.1997.

¹¹² *Po aty*, fl. 37. Çështja e arit monetar. Informacion mbi konferencën, 05.12.1997.

vendosur drejtësinë”,¹¹³ *vlente si argument edhe për pretendimet shqiptare lidhur me arin nazist.*

Pasiviteti institucional shqiptar, mungesa e koordinimit dhe ndryshimet e shpeshta krijuan shqetësime, aq sa ministri i Financave, Malaj, në një komunikim zyrtar kritikoi Ministrinë e Punëve të Jashtme për mungesë serioziteti në trajtimin e një problemi me interes për shtetin shqiptar.¹¹⁴ Komisioni Trepalësh vijoi komunikimin me ambasadorin Trenova, por të dyja palët ndanin të njëjtin opinion kritik për mosmarrjen e përgjigjeve për shkresat nga MPJ-ja.¹¹⁵ Pas sqarimeve me komisionin, ambasadori Trenova kërkoi zyrtarin e autorizuar nga Tirana për të kryer veprimet, pasi zyrtari i mëparshëm ishte shkarkuar. Me këtë rast, ambasadori informoi qeverinë se disa shtete nuk kishin nxitim për tërheqjen e shumave të tyre financiare, kryesisht për shkak se bëhej fjalë për sasi simbolike në raport me thesarin e tyre financiar, ndërsa shtete si Italia vijonin presionin për të marrë të gjithë shumën e vet, duke konsumuar kështu fondin e plotë në dispozicion të Komisionit Trepalësh.¹¹⁶

Në fillim të vitit 1998, shumica e zyrtarëve që koordinuan bisedimet me Komisionin Trepalësh, përfshirë guvernatorin dhe ambasadorët në Bruksel e Londër, ishin shkarkuar. Nga ana tjetër, në kontekstin politik të kohës, çështja e arit nuk kishte më rëndësinë e viteve '90 dhe sasia që do t'i kthehej Shqipërisë nuk pritej të ofronte zgjidhje për nevojat e shumta të ekonomisë vendore. Shtetet respektive, sidomos SHBA-ja në raport bilateral dhe dy shtetet e tjera në kuadër të Bashkimit Europian, akorduan miliona dollarë ndihma për Shqipërinë dhe asistuan në reformat kryesore. Përpara këtyre kontributeve, përfitimi nga rezerva e arit nazist kishte vlerë minore dhe procedurale. Edhe në aspektin politik, çështja nuk kishte më sensibilitetin dhe impaktin që kishte pasur në periudhën e Luftës së Ftohtë dhe në fillim të viteve '90.

¹¹³ *Po aty*, f. 36. Çështja e arit monetar. Informacion rreth mbledhjes së Task Force me ambasadën britanike në Bruksel, 30.09.1997.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 101. Çështja e arit monetar. Për mospjesëmarrjen e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e Brukselit të datës 12 shtator 1997 lidhur me problemin e arit shqiptar.

¹¹⁵ *Po aty*, V. 1997, D. 58. 1997, fl. 14. Çështja e arit monetar. Informacion drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 05.08.1997.

¹¹⁶ *Po aty*, fl. 1. 1997. Çështja e arit monetar. Lidhur me notën e Komisionit Trepalësh për kthimin e arit, 01.10.1997.

Për të gjitha këto motive pati vonesa disamujore. Akti i fundit zyrtar u miratua më 9 korrik 1998, kur qeveria Nano autorizoi guvernatorin Shkëlqim Cani për nënshkrimin e “Aktit të Dorëzimit”. Kryeministri kritikoi ministrat e tij për vonesat e shkaktuara.

“Më vdiqët, të nderuar kolegë, që rrezikoni të humbisni paratë e trajtuara 50 vjet historikisht, për 50 orë, sepse ditën e hënë kalonte në një llogari që Shqipëria i thoshte “mirupafshim” sasisë përfundimisht”, *citohet të jetë shprehur kryeministri*.¹¹⁷

Duket paradoksale, por pas 52 vjetësh negociata, debatesh, mosmarrëveshesh dhe retorike politike e shtetërore për arsye burokratike dhe mungesë vëmendjeje, Shqipëria po rrezikonte aktin final të tërheqjes së arit. Akti u firmos vetëm disa orë përpara skadimit të afatit kohor. Pas firmosjes, qeveria u mbledh edhe dy herë të tjera për të saktësuar shifrat: më 28 gusht, për të kaluar fondet e marra në rezervë valutore,¹¹⁸ dhe më 26 tetor, për të bërë disa ndryshime korrektuese në të njëjtin vendim.¹¹⁹ Ky është akti i fundit zyrtar lidhur me dosjen e arit të sekuestruar nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përfundimisht, Shqipëria përfitoi gjithsej 51,375.857 ons ari të pastër dhe 2,106.24 sterlina angleze, të cilat u përfshinë në rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pagesa prej 4 milionë dollarësh u kompensua me kundërvlerën përkatëse në ar.

Me këto veprime, 55 vjet pas grabitjes së arit shqiptar dhe tetë vjet pas ndryshimit të sistemit politik, u mbyll përfundimisht historia e kthimit të arit monetar shqiptar të sekuestruar nga Gjermania naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kujtesa historike, interpretimi dhe përfundime

Siç u provua përgjatë këtij studimi, çështja e arit monetar shqiptar nuk mund të kuptohet thjesht si një proces teknik i kthimit të një pasurie të grabitur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo përfaqëson një rast

¹¹⁷ AQSH, F. 490, V. 1998, D. 411, fl. 2-3. VKM nr. 414, dt. 09.07.1998, “Për marrjen në dorëzim të pjesës së mbetur të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe procesverbali i mbledhjes”.

¹¹⁸ *Po aty*, F. 490, V. 1998, D. 532, fl. 2-4. VKM nr. 551, “Për veprimet e kthimit të arit të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore”, 28.08.1998.

¹¹⁹ *Po aty*, F. 490, V. 1998, D. 613, fl. 2-3. VKM nr. 675, dt. 26.10.1998, për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 551, dt. 28.08.1998, “Për veprimet e kthimit të arit të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

kompleks, ku ndërthuren historiografia, ideologjia politike, diplomacia ndërkombëtare dhe praktika shtetërore. Mbyllja formale e procesit në vitet 1997-1998 shënoi fundin juridik dhe financiar të një dosjeje të hapur që prej vitit 1946, por nuk solli një mbyllje përfundimtare në kujtesën kolektive dhe as në diskursin publik shqiptar. Përkundrazi, çështja e arit vijoi të mbijetonte si një nga temat më të ngarkuara ideologjikisht dhe simbolikisht të së kaluarës së Luftës së Dytë Botërore.

Në diskursin publik të periudhës së tranzicionit, ari monetar u trajtua shpesh jo si objekt i një procesi të gjatë shumëpalësh, por si reminiscencë e së kaluarës, si metaforë e padrejtësisë historike ndaj Shqipërisë. Debatet politike dhe mediatike anashkaluan faktin se kthimi i arit u realizua mbi bazën e vendimeve të konsoliduara të Komisionit Trepalësh për Kthimin e Arit Monetar, veçanërisht atij të vitit 1958, dhe në përputhje me praktikat e zbatuara edhe për vende të tjera europiane. Në vend të analizës së këtyre mekanizmave dhe respektimit të përgjegjësive shtetërore, ligjërimi zyrtar e zhvendosi fokusin drejt tezave dhe kërkesave politikisht e emocionalisht të ngarkuara mbi “arin e munguar”, “reparacionet”, “dëmet e supozuara”, “mbajtjen peng të arit” dhe “përgjegjësit historikë”. Ky reduktim i realitetit historik në narrativa binare të humbjes ose mashtrimit e zhveshi procesin nga dimensionet e tij strukturor dhe krahasues. Kthimi i një sasie konkrete ari, i dokumentuar, i arkivuar dhe i finalizuar përmes institucioneve ndërkombëtare, humbi peshë përballë një perceptimi publik që kërkonte më shumë përgjigje simbolike sesa shpjegime historike.

Një element thelbësor i këtij diskursi është rikthimi i miteve të ndërtruara gjatë periudhës së regjimit komunist, veçanërisht miti i “arit të plotë të grabitur dhe të pakthyer”, i cili vazhdon të jetë një nga më të qëndrueshmit në kujtesën kolektive shqiptare. Ky mit injoron faktin se sasia e arit që i atribuohet Shqipërisë u përcaktua në kuadër të një procesi ndërkombëtar legjitim, të pranuar nga vetë pala shqiptare. Po aq problematike ka qenë edhe përzierja, në diskursin publik, e arit monetar shtetëror me pasuri të tjera të grabitura gjatë luftës, përfshirë arin me burim privat, duke krijuar perceptimin e një detyrimi financiar më të madh se ai real dhe të një borxhi ndaj Shqipërisë. Në realitet, mekanizmat e Komisionit Trepalësh kishin një objekt të kufizuar dhe nuk përfshinin dëmshpërblime të përgjithshme apo kompensime morale. Në këtë kontekst, vendimarrja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi përgjegjësitë për incidentin në hapësirën shqiptare, ku humbën jetën 44

marinarë britanikë, nuk u pranua si argument, ndonëse ishte një akt ligjor, i detyrueshëm dhe i pakthyeshëm. Keqinterpretimet u ushqyen edhe nga mungesa e transparencës, aplikimi i censurës dhe imponimi i tezave të gatshme gjatë periudhës komuniste. Arkivat e mbyllura dhe narrativa ideologjike zyrtare e ndërtuan çështjen e arit si pjesë të një konflikti të vazhdueshëm me Perëndimin, pa sqaruar rolin e izolimit diplomatik të Shqipërisë dhe refuzimin e kompromisit ndërkombëtar. Pas vitit 1990, ky boshllëk informacioni u tentua, jo pa sukses, të mbushej më lehtë me mite sesa me analiza të bazuara në burime arkivore dhe dokumentare.

Studimi evidenton kështu një hendek të thellë midis historiografisë profesionale dhe narrativës publike mbi arin monetar shqiptar. Historiografia, e mbështetur në dokumentacionin shqiptar dhe ndërkombëtar, e trajton këtë çështje si një proces të gjatë negociator, të kushtëzuar nga rregulla juridike dhe balanca politike të pasluftës. Narrativa publike, përkundrazi, vijon ta perceptojë atë si një histori humbjeje ose mashtrimi. Ky hendek lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si është ndërtuar kujtesa kolektive në Shqipëri, ku historia është përdorur për dekada si instrument legjitimimi ideologjik dhe jo si fushë e kërkimit kritik.

Në këtë kontekst, analiza e procesit të kthimit të arit nxjerr në pah edhe gabime strukturore të shtetit shqiptar. Gjatë periudhës 1950-1980, Shqipëria e trajtoi çështjen e arit më shumë si instrument diskursiv sesa si objekt negocimi ndërkombëtar. Refuzimi i kompromisit juridik, mosnjohja e vendimeve ndërkombëtare dhe ndërthurja e çështjes së arit me reparacionet e luftës dhe konfliktet ideologjike e nxorën Shqipërinë jashtë kornizës funksionale të Komisionit Trepalësh. Ky pozicion jo vetëm që e zgjati procesin për disa dekada dhe krijoi konflikt me fuqi të mëdha politike si Britania e Madhe dhe SHBA-ja, por edhe e shndërroi Shqipërinë në rastin e fundit evropian që përfitoi nga mekanizmi i kthimit të arit monetar. Edhe pas ndryshimit të sistemit politik, vonesat nuk u shpjeguan vetëm me tranzicionin demokratik. Dokumentacioni i viteve 1990-1998 dëshmon mungesë koordinimi institucional, hezitim politik dhe nënvlerësim të urgjencës administrative. Në fund, Shqipëria ishte pranë humbjes përfundimtare të së drejtës për përfitim për shkak të pasivitetit të vet institucional, jo për shkak të kundërshtimit të palëve ndërkombëtare.

Megjithatë, përgjegjësia nuk ishte e njëanshme. Edhe tri shtetet anëtare të Komisionit Trepalësh vepruan brenda një logjike politike të

Luftës së Ftohtë, ku dosja shqiptare u trajtua si një rast periferik dhe politikisht i ndërlikuar. Kushtëzimi i avancimit të çështjes së arit me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tjera, veçanërisht me Mbretërinë e Bashkuar, ishte politikisht i kuptueshëm, por jo gjithmonë i domosdoshëm nga pikëpamja e mandatit teknik të komisionit. Megjithatë, asnjë nga të tria shtetet nuk e mohoi parimisht të drejtën e Shqipërisë për kthimin e arit, dhe vendimet kyçe ndërkombëtare mbetën në favor të saj.

Në terma financiarë, vlera e arit të përfituar nga Shqipëria, ndonëse më e vogël sesa pritshmëria publike, duhet parë në raport me përmasat reale të ekonomisë shqiptare në fillim të viteve '90. Në këtë këndvështrim, ajo përfaqësonte një peshë makroekonomike jo të papërfillshme: në vitet 1991-1992 (rreth 7-9% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Kjo e vendos çështjen e arit monetar jo vetëm në planin simbolik të drejtësisë historike, por edhe në dimensionin konkret financiar për një ekonomi postkomuniste, strukturalisht të brishtë dhe në nevojë për financim për mbijetesë. Megjithatë, kostoja e zgjatjes shumëdekadëshe të procesit nuk ishte thjesht ekonomike. Ajo u shoqërua me pasoja të dukshme politike dhe institucionale, përfshirë konsumimin e panevojshëm të kapitalit diplomatik e shtetëror, humbjen e mundësive për një normalizim më të hershëm të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe dëmtimin e perceptimit të besueshmërisë shtetërore në arenën ndërkombëtare.

Në përfundim, historia e arit monetar shqiptar ilustron qartë se ndërveprimi midis ideologjisë, historiografisë dhe diplomacisë mund të prodhojë vonesa strukturore afatgjata. Shqipëria ishte rasti i fundit europian jo sepse iu mohua drejtësia, por sepse për dekada refuzoi rregullat e rendit ndërkombëtar brenda të cilit kjo drejtësi mund të realizohej. Ky rast studimor mbetet i rëndësishëm jo vetëm për historinë ekonomike dhe diplomatike të Shqipërisë, por edhe për analizën kritike të mënyrës se si shoqëritë postkomuniste përballen me trashëgiminë e së kaluarës, me kufijtë e përgjegjësisë shtetërore dhe me ndërtimin e kujtesës historike.

Burime e bibliografi:

I. Arkiva:

Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Tiranë (AMPJ)

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, Tiranë (AQSH)

National Archives and Records Administration (NARA). Record Groups 84, 59, 260. Diplomatic correspondence U.S.–U.K.–France on Albanian monetary gold and related issues.

The National Archives (TNA), Kew, London. Foreign Office (FO) files on the Corfu Channel Case and its linkage to Albanian monetary gold.

II. Burime dokumentare:

International Court of Justice. *Corfu Channel Case (United Kingdom v. Albania)*. Judgment, 1949.

Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold. *Final Report of the Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 1946-1998*. Paris and Washington, DC, 1998.

U.S. Department of State. *Nazi Gold and the Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold*. Declassified documents and reports, 1945-1996.

II. Literaturë:

EIZENSTAT, Stuart E. *Imperfect Justice: Looted Assets, Slave Labor, and the Unfinished Business of World War II*. New York: PublicAffairs, 2003.

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëll. V. Grup autorësh. Drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2023.

KRASNIQI, Afrim (ed.). *Marrëdhëniet shqiptaro-britanike: 100 vjet raporte – historia, bilanci dhe perspektiva*. Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2026.

KRASNIQI, Afrim. *Partitë politike në Shqipëri, 1920-2006*. Tiranë: ISP, 2006.

- KRASNIQI, Afrim. *VOA dhe Shqipëria: Viti 1990 në "Zërin e Amerikës"*. Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2025.
- KRISAFI, Ksenofon. "Ari shqiptar në labirintet diplomatike." *Economicus* 7 (2011): 73-94.
- "Restitution of Nazi-Looted Gold: Legal and Political Challenges." *Holocaust and Genocide Studies*.

PROF. DR. AFRIM KRASNIQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
afrimkrasniqi@gmail.com

S u m m a r y

THE ALBANIAN MONETARY GOLD CASE: FROM IDEOLOGICAL CONFLICT
TO RESOLUTION IN THE TRANSITIONAL PERIOD

The restitution of Albanian monetary gold looted during the Second World War constitutes one of the most complex and protracted cases of the European post-war order, shaped by political, ideological, legal, and geopolitical factors. Closely linked to the evolution of Albania's political system, the issue became subject to competing narratives, myths, and political instrumentalization, further complicated by overlapping claims related to Fascist Italy, Nazi Germany, and former King Zog, as well as by the legal and diplomatic implications of the Corfu Channel case.

Albania was the last European country to benefit from the international mechanism for the restitution of monetary gold, concluding the process only in 1997–1998. This delay did not stem from a denial of Albania's legal entitlement, but rather from the ideologically driven approach of the communist regime, the conflation of restitution claims with broader demands for war reparations, and later institutional weaknesses during the early years of transition.

Drawing on a comparative perspective and archival evidence, the article argues that the resolution of the case reflects a broader historical transformation: the shift from an ideologically isolated system to a state operating within the norms of the international order. The depoliticization of

the issue and the reorientation of foreign policy after 1992 enabled a pragmatic, negotiation-based outcome.

From a historical perspective, the case highlights the persistent gap between professional historiography and public narrative. The closure of the gold case thus represents not only a legal and financial settlement, but also a key moment illustrating the interaction between historical memory, diplomacy, and international law in post-communist Albania.

Over time, all parties involved revised their initial positions, albeit to different degrees. Albania underwent the most profound shift, moving from a rigid, ideologically driven stance to a more flexible and legally grounded approach. International actors also adjusted their positions within the broader context of changing geopolitical dynamics, particularly after the end of the Cold War, facilitating a negotiated resolution.

Nevertheless, the process extended far beyond what might be justified by its material value. Myths, propaganda, and domestic political needs often prevailed over legal reasoning and the principles of international law, contributing to delays and distortions in public understanding. As a result, the case illustrates how political narratives and ideological legacies can overshadow juridical logic and prolong the resolution of otherwise manageable international disputes.

Keywords: Monetary gold, gold return, ideological conflict, post-communist transition, international law.

PROF. ASOC. DR. SONILA BOÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
sonilaboci23@gmail.com

**REFORMA PA TRANSFORMIM: DINAMIKA TË PUSHTETIT
POLITIK NË SHQIPËRINË E VITEVE
1953-1956**

Abstrakt:

Ky artikull analizon dinamikat e pushtetit në Shqipëri gjatë viteve 1953-1956, një periudhë e shënuar nga ndryshime tronditëse në Bashkimin Sovjetik, të reflektuara në gjithë Bllokun Lindor. Në Shqipëri, vitet që pasuan vdekjen e Stalinit u karakterizuan nga përpjekjet për të ruajtur kontrollin e brendshëm, ndërkohë që udhëheqja shqiptare synonte të ndiqte ritmin e reformave të “Kursit të Ri” të Nikita Hrushovit, të imponuara nga Moska. Duke u mbështetur në një rilexim të dokumenteve arkivore dhe në gjetje të reja burimore, studimi shqyrton hendekun midis pranimit formal të direktivave reformuese sovjetike dhe zbatimit selektiv të tyre në praktikë. Artikulli argumenton se procesi i reformave të nxitura nga Moska nuk solli transformim të strukturës së pushtetit në Shqipëri. Lufta kundër kultit të individit nuk preku thelbin e autoritetit personal dhe të personalizimit të vendimmarrjes, por u kufizua në riformulimin e narrativës publike, ku partia duhej të përmendej përpara individit. Artikulli analizon manovrat e Enver Hoxhës për të konsoliduar autoritetin e tij, si brenda hierarkisë së lartë partiake, ashtu edhe në shoqëri. Raste si ai i Tuk Jakovës dëshmojnë se çdo përpjekje për depersonalizimin e historisë dhe relativizimin e rolit të udhëheqësit përbënte kufirin e pakalueshëm të reformës. Për këtë arsye, periudha 1953-1956 përkufizohet si reformë pa transformim, pasi nuk preku themelet ideologjike të një regjimi të orientuar drejt stalinizmit.

Fjalë kyçe:

Destalinizim, Kursi i Ri, Enver Hoxha, kult i individit, dinamika të pushtetit.

Hyrje

Vdekja e diktatorit sovjetik, Josif Visarionaviç Stalin, solli ndryshime të shumta në Bashkimin Sovjetik, të cilat u reflektuan edhe në Europën Qendrore dhe Lindore. Studiuesi Robert C. Tucker argumenton se destalinizimi në Bashkimin Sovjetik (BRSS) nisi jo me Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (PKBS), por që me vdekjen e Stalinit,¹ në momentin kur shteti totalitar, i krijuar rreth pushtetit personal, hyri në krizë. Në të vërtetë, në Bashkimin Sovjetik procesi i destalinizimit filloi që prej gushtit të vitit 1953, me dënimin e ministrit të Brendshëm Lavretiy Beria dhe me kthimin te parimet leniniste të kolegjalitetit të udhëheqjes, e cila *de facto* ishte preludi i dënimit të autoritetit të njëshit. Destalinizimi vijoi pas ardhjes në krye të shtetit sovjetik të Nikita Hrushovit, i cili me “Kursin e Ri” dhe politikën e “shkrirjes së akujve”, rishikoi marrëdhëniet e pushtetit me qytetarët, por edhe orientimin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik. Pjesa më kontroverse e kësaj politike ishte afrimi me Jugosllavinë e Titos. Kongresi XX i PKBS-së (shkurt 1956), me raportin sekret kundër kultit të Stalinit, ishte pika kulmore e procesit të destalinizimit dhe ajo që trazoi më së shumti botën komuniste.

Në mënyrë të përgjithshme, vdekja e Stalinit krijoi krizë legjitimiteti për regjimet staliniste të Europës Qendrore dhe Lindore. Siç vë në dukje studiuesi Mark Kramer, pasuesit e Stalinit “i inkurajuan (dhe, kur ishte e nevojshme, i urdhëruan)”, autoritetet qeverisëse të këtyre vendeve të zbatonin “Kursin e Ri” të reformave ekonomike dhe politike.² Direktiva për aplikimin e udhëheqjes kolektive shqetësoi më së shumti “stalinistët e vegjël”, pasi diktoi shpërndarjen e pushtetit. Në këtë proces ndarjeje përgjegjësish midis autoriteteve partiake dhe atyre qeveritare, duke u dhënë gjithnjë rëndësi të parave, BRSS-ja ndërhyri edhe për

¹ Robert C. Tucker, "Introduction," në *Stalinism, essay in historical interpretation*, edited by Robert C. Tucker (New Jersey: Transaction Publishers, 1999).

² Mark Kramer, "The Changing Pattern of Soviet–East European Relations 1953–1968," në *The Cambridge History of Communism*, vol. 2: *The Socialist Camp and World Power, 1941–1960*, Norman M. Naimark, Silvio Pons, dhe Sophie Quinn-Judge eds. (Cambridge: Cambridge University Press, 2017), 140.

zëvendësim figurash. Politika e Bashkimi Sovjetik synonte forcimin e Bllokut Komunist dhe, gradualisht, imponoi një model të ri integrimi ekonomik e ushtarak brenda Bllokut.

Procesi krijoi pështjellim në shoqëritë e këtyre vendeve, të cilat përqaftuan frymën liberalizuese të ndryshimeve. Fillimisht në Bullgari, më pas në Çekoslovakia dhe në Republikën Demokratike të Gjermanisë, protestat dhe reagimet popullore filluan që në maj-qershor të vitit 1953.³ Në shtete të tjera, si Hungaria e Polonia, pas Kongresit XX të PKBS-së u krijuan pështjellime edhe më të forta. Ato kulmuan me protestat popullore të vjeshtës së 1956-s. Pavarësisht nëse këto protesta morën karakter patriotik, si në Hungari,⁴ apo liberalizues, si në Poloni, ato dëshmonin pakënaqësinë ndaj modelit stalinist dhe varësisë nga Moska.

Në Shqipëri, përjetimi i “Kursit të Ri” të Nikita Hrushovit ka më shumë pika takimi me Rumaninë e Gheorghe Gheorghiu-Dej-it.⁵ Aty nuk pati reagime masive kundër elitave politike, as lëvizje disidente të dallueshme, pasi shumica e shoqërisë shqiptare njoftohej aq sa ç’donin drejtuesit e saj politikë. Fillimisht, ata u treguan, në dukje, shumë të zellshëm në zbatimin e direktivave të Moskës. Në historiografinë shqiptare ekziston pothuajse një konsensus mbi tezën e mungesës së dëshirës së drejtuesve të lartë të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) dhe, veçanërisht, të Enver Hoxhës për t’u përfshirë realisht në procesin e destalinizimit të diktuar nga drejtuesit e Bashkimit Sovjetik.⁶

Trajtesa e përgjithshme e këtij artikulli mbështet tezën se në vitet 1953-1955 drejtuesit e lartë të PPSH-së u përfshinë në një proces të padëshiruar dhe të imponuar nga Moska. Vëmendja e Enver Hoxhës, si drejtues i PPSH-së dhe i shtetit shqiptar, u përqendrua në menaxhimin dhe neutralizimin e procesit, duke u fokusuar njëkohësisht në konsolidimin e autoritetit të tij absolut. Ndryshe nga disa punime të tjera

³ Po aty.

⁴ Árpád von Klimó, *Hungary since 1945*, translated by Kevin McAleer (New York and London: Routledge, 2018), 26-27.

⁵ Për Rumaninë në procesin e destalinizimit, shih: Vladimir Tismaneanu, *Stalinism for All Seasons: A Political History of Romanian Communism* (Berkeley: University of California Press, 2003).

⁶ Ana Lalaj, *Pranvera e rrejshme e '56* (Tiranë: Infbotime, 2015); Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania’s 1956,” *Journal of Cold War Studies*, vol. 13, no. 4 (Fall 2011): 4-56. Tezën e Mëhillit e përsërit edhe Ylber Marku, “Shifting Alliances: Albania in the Early Cold War,” në *Journal of Cold War Studies*, vol. 24, no. 3 (Summer 2022): 81, https://doi.org/10.1162/jcws_a_01074.

që e analizojnë këtë periudhë në raport me politikën e jashtme, ky artikull përqendrohet te dinamikat brenda udhëheqjes më të lartë komuniste shqiptare, duke evidentuar dilemat, manovrimet dhe luftën e brendshme. Duke ndjekur këtë qasje, artikulli synon të shpjegojë arsyet pse stalinizmi mbetej rruga e vetme për mbijetesën e regjimit dhe pushtetin e Enver Hoxhës. Nga pikëpamja metodologjike, artikulli ofron një rilexim të dokumenteve arkivore tashmë të njohura, si dhe plotësimin e tyre me gjetje të reja burimore. Ai përqendrohet në një qasje analitike të fillimit të procesit të destalinizimit në Shqipëri, duke bërë dallimin midis vendimmarrjes, reformave në letër dhe zbatimit praktik të tyre.

Mbreti vdiq! Rroftë Mbreti!: Vdekja e Stalinit dhe reformat që iu imponuan Shqipërisë

Më 6 mars, në orën 6:00 të mëngjesit, në një nga sallat e Pallatit të Brigadave u thirr me të shpejtë një mbledhje e përbashkët e Komitetit Qendror të PPSH-së, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave. Në një atmosferë zie, Enver Hoxha njoftoi lajmin për vdekjen e drejtuesit të PKBS-së dhe të shtetit sovjetik, Josif Visarionaviç Stalin.⁷ Në fjalën e tij, Enver Hoxha u kujtoi të pranishmëve kuptimin e stalinizmit për Shqipërinë dhe shpalli se ishte momenti për të “çelikosur” dashurinë dhe besnikërinë ndaj Bashkimit Sovjetik, i cili “na ngriti dhe na solli në dritë, pse ai na shpëtoi nga mjerimet e mëdha. Populli tonë çdo gjë ia detyron Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin”.⁸

Në ato pak fjalë, Enver Hoxha përmbledhonte gjithçka që kishte ndodhur në Shqipëri midis viteve 1948-1953 dhe pse stalinizmi ishte shndërruar në një nga shtyllat e legjitimitetit të pushtetit të elitës politike. Ishte konflikti Tito-Stalin ai që jo vetëm pengoi shndërrimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë jugosllave, por edhe i dha asaj mundësinë të faktorizohej në arenën ndërkombëtare, veçanërisht brenda Bllokut Komunist. Mbështetja e Stalinit i kishte dhënë mundësi Enver Hoxhës të eliminonte kundërshtarët e tij politikë në Byronë Politike dhe në

⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (AP)-Organet Udhëheqëse (OU), Viti (më tej: V.) 1953, Dosja (më tej: D.) 1/9, fl. 9. Mbledhje e përbashkët e KQ të PPSH-së me Presidiumin e Kuvendit Popullor, me rastin e vdekjes së Stalinit, 6 mars 1953.

⁸ Po aty.

Komitetin Qendror, duke i siguruar autoritetin absolut në hierarkinë e lartë komuniste në Shqipëri.⁹ Shembulli i Stalinit i kishte shërbyer atij për të ngritur, në një kohë të shkurtër, një kult individ, çka i lejoi të kontrollonte me dorë të fortë një shoqëri në proces ideologjizimi. Për më tepër, ndihma e gjithanshme e Bashkimit Sovjetik ishte oksigjeni që kishte mbajtur në këmbë projektin sovjetizues e modernizues të Shqipërisë.¹⁰

Për Enver Hoxhën, kjo ishte mundësia për t'i treguar mirënjohjen Stalinit, por njëkohësisht për të ripohuar besnikërinë ndaj Bashkimit Sovjetik. Ceremonia mortore e organizuar për Stalinin në Shqipëri ishte ajo që do t'i dedikohej çdo figure të lartë politike vendase.¹¹ Në të vërtetë, deri në vdekjen e Enver Hoxhës nuk u organizua një ceremoni kaq madhështore.¹² Më 9 mars 1953, ditën e varrimit të Stalinit, në sheshin kryesor të kryeqytetit u organizua një miting madhështor. Mitingje të ngjashme u zhvilluan në të gjitha qytetet kryesore të vendit. Në një gjest më shumë se simbolik, përpara drejtuesve të shtetit dhe popullsisë së gjunjëzuar përpara statujës së Stalinit, Enver Hoxha shqiptoi betimin e besnikërisë ndaj udhëheqësit të madh të PKBS-së, “mësuesi gjenial i të gjithë njerëzimit përparimtar, flamurtari i paqes në botë, miku i shtrenjtë dhe shpëtimtari i popullit tonë”.¹³ Teksti i betimit u

⁹ Sonila Boçi, “Trajektorja e një kulti: Enver Hoxha dhe sendërtimi i udhëheqësit stalinist (1944-1948),” në *Studime historike*, nr. 2/2025 (Tiranë: 2026) <https://doi.org/10.61773/b8qp629>.

¹⁰ Për një studim të detajuar dhe të mirargumentuar mbi sovjetizimin e Shqipërisë, ndërveprimin e saj me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Bllokut Lindor për të çuar përpara projektet modernizuese, të cilat do t'i shërbenin edhe konsolidimit të regjimit, shih: Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World* (Ithaca: Cornell University Press, 2017).

¹¹ Përveç shpalljes së zisë kombëtare dhe ngritjes së flamurit në gjysmështizë, në Shqipëri më 6 mars u ndërpre puna e mësimi në të gjitha qendrat e punës, zyrat e administratës dhe shkollat. Sipas traditës shqiptare të mortit, u hapën dyert për të pritur vizitat e ngushëllimit. Në Tiranë vizitat do të priteshin në Kryeministri, ndërsa në rrethe në komitetet e partisë. Për të përjetësuar emrin e Stalinit, më 7 mars, një pjesë e bulevardit të madh të kryeqytetit u pagëzua me emrin e tij. Shih: AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 1/9, fl. 18.

¹² Marku, “Shifting Alliances,” 90.

¹³ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 1/9, fl. 14.1. Thirrje e mbledhjes së përbashkët të KQ të PPSH-së me Presidiumin e Kuvendit Popullor, me rastin e vdekjes së Stalinit, 9 mars 1953.

nënshkrua nga 749 440 veta dhe iu dërgua telegrafisht udhëheqjes komuniste sovjetike në Moskë.¹⁴

Nuk ka dyshim se Enver Hoxha ishte i singërtë, si në dhimbjen që shprehu për vdekjen e Stalinit, ashtu edhe në vendosmërinë e tij për të vijuar zbatimin e modelit stalinist të qeverisjes. Ajo për të cilën ai nuk ishte i përgatitur ishin zhvillimet në Bashkimin Sovjetik. Në kujtimet e tij, Hoxha shprehet se ai priste të ishte Molotovi, “bashkëpunëtori më i afërt i Stalinit”,¹⁵ një vazhdues i politikave të tij. Figurat që zëvendësuan Stalinin paralajmëronin për ndryshim thelbësor të kursit politik. Shumë dekada më vonë, Enver Hoxha do të pohonte se udhëheqësit e rinj sovjetikë “nuk na pëlqyen aspak”.¹⁶

Për Enver Hoxhën, ashtu si për të gjithë drejtuesit e partive komuniste të Bllokut Lindor, ishte e qartë se legjitimimi i autoritetit të tyre varej më shumë nga mbështetja e Bashkimit Sovjetik sesa nga mbështetja e brendshme popullore. Kështu, ndryshimet në kupolën drejtuese në vendin amë të socializmit botëror po i prishnin gjumin “Stalinit të vogël” të Shqipërisë. Shqetësimi i Enver Hoxhës u materializua tre muaj pas betimit solemn në këmbët e Stalinit. Ashtu si të gjithë drejtuesit e lartë të Lindjes, edhe Enver Hoxha u thirr me nxitim në Moskë në qershor 1953, në një takim ku merrnin pjesë drejtuesit më të lartë të KQ të PKBS-së: Malenkov, Beria, Molotov, Bulganin dhe Mikojan. Ky takim i dha menjëherë të kuptonte Hoxhës se ndryshimi, të cilit ai i frikësohej, kishte filluar të ndodhte. Enver Hoxha, më vonë, do të kujtonte se atmosfera nuk kishte aspak tonin miqësor të vizitave të mëparshme.¹⁷

Takimi nxiste, në thelb, një marrëdhënie krejt të ndryshme të shtetit me qytetarët. Ndërsa deri në atë moment, qytetarëve shqiptarë u ishte kërkuar të sakrifikonin për të fuqizuar “shtetin socialist”, në takimin e Moskës u theksua se ishte shteti ai që duhej të kujdesej më shumë për mirëqenien e tyre. Shqetësimi i drejtuesve sovjetikë ishte qartazi stabiliteti i Bllokut Komunist, i cili sigurohej përmes forcimit të gjendjes së brendshme të çdo shteti të veçantë. Për ta, situata tejet e vështirë

¹⁴ Ana Lalaj, “Detanta e parë dhe Shqipëria,” në *Studime historike*, nr. 3-4 (2009): 337.

¹⁵ Enver Hoxha, *Hrushovianët. Kujtime* (Tiranë: 8 Nëntori, 1980), 16.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*.

ekonomike, sjellja e shtetit ndaj shoqërisë, si dhe marrëdhëniet me fqinjët e bënin situatën për pushtetin në Shqipëri shumë të paqëndrueshme.¹⁸

Për përmirësimin e gjendjes ekonomike të popullsisë, shefat e Kremlinit e nxitën Hoxhën të linte mënjatë planet për “modernizimin” e shpejtë të vendit, si edhe ëndrrën për pavarësinë ekonomike të Shqipërisë, e cila sigurohej, sipas modelit stalinist, përmes zhvillimit të industrisë së rëndë. Sovjetikët nuk ishin më të gatshëm të financonin disa nga projektet industrializuese, përfshirë edhe një hidrocentral mbi lumin Mat. Direktivat e Moskës nxisnin pushtetarët shqiptarë të “shtrinin këmbët në gjatësinë e jorganit” dhe të përqendroheshin në menaxhimin e pakënaqësisë së brendshme. Për këtë, drejtuesit shqiptarë duhej të përmirësonin gjendjen e fshatit, duke përsosur sistemin e tatimeve dhe duke ulur ritmin e kolektivizimit; duhej të zbusnin luftën e klasave, kur i kujtuan Hoxhës “se jo të gjithë lindin komunistë” dhe se duhej t’u jepej një mundësi edhe atyre që në të kaluarën mund të mos e kishin mbështetur regjimin, por në atë kohë punonin për të dhe nuk shfaqnin armiqësi. Nga ana tjetër, Hoxhës iu kujtua se duhej të krijonte stabilitet ndërkombëtar për Shqipërinë, duke vendosur qetësi në kufijtë e saj, pra duke përmirësuar marrëdhëniet me tre fqinjët: Jugosllavinë, Greqinë dhe Italinë.¹⁹ Lidhur ngushtë me këtë këshillë ishte edhe ulja e shpenzimeve ushtarake, duke bërë çmobilizimin e një pjese të ushtrisë.

Drejtuesit e lartë moskovitë, ashtu siç do të bënin edhe me vende të tjera të Lindjes Komuniste, kërkonin një ndarje të përgjegjësisë, veçanërisht midis organeve të partisë dhe atyre të shtetit, duke u dhënë rëndësi të parave. Në këtë proces, ata diktuan ndryshime edhe në

¹⁸ Për kupolën drejtuese moskovite, autoritetet politike në Shqipëri nuk e kishin aspak nën kontroll situatën politike dhe ekonomike në vend. Ata akuzonin drejtuesit shqiptarë për shfrytëzimin e shqiptarëve, veçanërisht të atyre që jetonin në zonat rurale. Ata tërhiqnin vëmendjen për pakënaqësinë në rritje të fshatarësisë për shkak të taksave të rënda “nga 200 tonë prodhim t’i marrësh (fshatarësisë) 50, kjo është grabitje”; për një aparat burokratik të cilin as “Rockfelleri dhe Morgan nuk do të guxojnë ta mbajnë”; për masat ndëshkimore ekstreme etj. Shih: AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 23, fl. 1. Nga raportimi i Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së mbi bisedimet e zhvilluara në Moskë.

¹⁹ Deri në atë moment, Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike me fqinjët tokësorë, Jugosllavinë dhe Greqinë. Marrëdhëniet me Italinë ishin vendosur më 1949, por ato ishin në një pikë të vdekur, pa asnjë zhvillim real. Shih: *Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit XX*, vëll. V, grup autorësh, redaktor përgjegjës akad. prof. dr. Beqir Meta, ASA/Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2023), 304-325.

“nomenklaturën” e lartë të PPSH-së, çka duket e frikësoi me të vërtetë Hoxhën dhe trazoi ekuilibrat e pushtetit brenda udhëheqjes së lartë shqiptare. Krahës uljes së burokracisë shtetërore deri në 50% dhe numrit të ministrive nga 18 në 6-9, shefat e Kremlinit kërkuan edhe rishikimin e përgjegjësive të dy drejtuesve të PPSH-së: Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut. Të dy duhej të linin disa nga postet që mbanin, për t’u fokusuar te punët më të rëndësishme. Veçanërisht Hoxha, sipas direktivave moskovite, duhej të linte postet e tij në qeveri për t’iu përkushtuar më shumë drejtimit të partisë. Enver Hoxha, ndryshe nga çfarë shkruan në kujtimet e tij, u shfaq tërësisht i nënshtuar dhe pranoi menjëherë të bënte ndryshime si në qeveri, ashtu edhe në disa prej projekteve të planit të parë pesëvjeçar. Ai propozoi menjëherë të hiqte dorë nga posti i ministrit të Jashtëm, ministrit të Mbrojtjes, madje edhe nga detyra e Kryetarit të Frontit Demokratik.²⁰

Nuk është e qartë nëse Enver Hoxha e kuptoi se ajo që propozonin drejtuesit moskovitë ishte, në thelb, një rikthim te koncepti evolucionar leninist i ndërtimit të socializmit dhe në pushtetin personal të drejtuesit. Ata kërkonin që shtete si Shqipëria të riktheheshin në një sistem që e rimodelonte gradualisht dhe me kujdes realitetin, “duke u përpjekur të thyejnë sa më pak të munden” gjatë këtij procesi.²¹ Ajo çka dinte ai ishte se Shqipëria kishte nevojën për mbështetjen sovjetike. Spiralja e ndryshimeve ishte vënë në lëvizje dhe Enver Hoxha, së bashku me drejtuesit më të lartë të PPSH-së nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të ndryshonin ritmin e muzikës, pra të përshtateshin me erërat e reja që po frynin nga Moska.

²⁰ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 23, fl. 1. Nga raportimi i Enver Hoxhës në Byronë Politike të KQ të PPSH-së mbi bisedimet e zhvilluara në Moskë. Sovjetikët e këshilluan që pozicionet si Kryetar i Frontit dhe i Presidiumit të Kuvendit Popullor duhej t’i mbante.

²¹ Robert C. Tucker argumenton se Stalini në kohën e afirmimit të pushtetit të tij gjatë viteve ’30 ndërmori politika e reforma radikale, duke ndjekur një rrugë revolucionare në ndërtimin e socializmit dhe duke bërë pikërisht atë që Lenini kishte paralajmëruar të mos bëhej. Shih: Robert C. Tucker, “Stalinism as revolution from above,” në *Stalinism, essay in historical interpretation*, edited by Robert C. Tucker (New Brunswick, New Jersey: Transaction Publishers, 1999), 82.

“Uji del i pastër nga burimi, por turbullohet rrugës”: Enver Hoxha dhe shmangia e përgjegjësive personale

Menjëherë pas kthimit të tij nga Moska, Enver Hoxha mbledhi Byronë Politike për ta informuar mbi çka ishte biseduar me drejtuesit moskovitë. Ai u shfaq i shqetësuar, madje disi i pasigurt. Zhvillimet e reja i zunë në befasi edhe pjesën tjetër të anëtarëve të Byrosë Politike, të cilët zgjodhën të mos thoshin shumë. Mbledhja u dominua kryesisht nga një dialog mes Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut. Hoxha pranoi se Shqipëria ishte një vend i vogël dhe nuk mund të bënte një politikë të pavarur, duke nxitur edhe të tjerët të pranonin ndërmarrjen e ndryshimeve që kërkoheshin. Që direktivat që vinin nga Moska duhej të zbatoheshin, kjo nuk vihej në dyshim edhe nga anëtarët e tjerë të Byrosë Politike. Madje, Mehmet Shehu e shpreh fare qartë se: “Vijën e kemi dhe jemi të sigurtë se është e drejtë, do të punojmë për ta realizuar në jetë këtë vijë”.²² Në të vërtetë, bisedimet e Moskës për përmirësimin e standardit të jetesës u kthyen në vendime të Byrosë Politike, ku përfshiheshin: falja e detyrimeve të prapambetura të fshatarësisë për vitet 1949-1952; ulja e detyrimeve për zonat malore dhe kufitare; ndërmarrja e disa projekteve bonifikuese në bujqësi; ngadalësimi i ritmeve të kolektivizimit të bujqësisë, duke i dhënë rëndësi cilësisë dhe jo sasisë; si dhe studimi i pagave të punëtorëve dhe punonjësve të administratës.

Ajo çfarë lëvizte në ajër ishte ideja se “vija politike” në ekonomi, si investimet për industrializimin e shpejtë ashtu edhe politika bujqësore, konsiderohej e gabuar. Në Moskë ishte përmendur gjendja e mjerueshme e fshatit shqiptar dhe fakti se prodhimi bujqësor nuk ishte as 25% në nivelin e vitit 1938.²³ Por, ndërsa gjendja e fshatarësisë, e cila përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë, ishte shqetësuese, edhe punëtorët, “avangarda e shoqërisë”, nuk jetonin në kushte më të mira. Në një tjetër analizë të Byrosë Politike, Gogo Nushi, anëtar i saj dhe ndihmëskryeministër, si dhe Pilo Peristeri, drejtues i Bashkimeve Profesionale, ngritën shqetësimin për hendekun që ekzistonte midis ligjeve për të drejtat e punëtorëve dhe zbatimit të tyre në praktikë. “Ne

²² AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 23, fl. 43. Nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 20-22 qershor 1953.

²³ Po aty, fl. 1.

jemi kënaqur duke bërë ligje (për të drejtat e punëtorëve), – u shpreh Peristeri, – por nuk kemi kontrolluar zbatimin e tyre”.²⁴ Dy anëtarët e Byrosë Politike u ankuan se organet e partisë në bazë nuk i zgjidhnin hallet e punëtorëve për strehimin, për furnizimin, për të drejtat e tyre individuale dhe kolektive, ndërkohë që “përqindjet e paaftësive (në punë) dhe të vdekjeve të punëtorëve (për shkak të aksidenteve në punë) nuk po ulen”.²⁵ Qartazi, një pushtet që fliste në emër të popullit kishte dështuar të krijonte mirëqenie për të.

Kur flitej për “vijën”, përgjegjësia kryesore ishte e sekretarit të përgjithshëm të PPSH-së, pra e E. Hoxhës, i cili deri në atë kohë mbante edhe postin e Kryeministrit, ministrit të Jashtëm e të Mbrojtjes.* Sipas parimeve leniniste, aq të komentuara, do të ishte Enver Hoxha ai që duhej të bënte autokritikë para bashkëpunëtorëve të tij. Por Hoxha nuk kishte asnjë dëshirë të përjetonte sërish situatat e pasigurisë për autoritetin e vet, të cilat i kishte kaluar në periudhën 1944-1948. Shqetësimi i tij ishte që çështja të mos bëhej objekt diskutimi përtej mbledhjes së Byrosë Politike. “Analiza kryesore duhet të jetë kjo (pra mbledhja aktuale e Byrosë Politike), – shprehet ai, – dhe të mos futemi në hollësira dhe diskursione të kota. Ne njohim faktin se në lidhje me jetën e vendit dhe të popullit tonë kemi gabuar dhe na imponohet [nënvizimi im – S.B.] urgjentisht të marrim masa për të ndrequr situatën. Po të hymë dhe të bëjmë analiza dhe referate dhe të analizojmë situatën do të vemi larg”.²⁶ Njeriu që kishte propaganduar autokritikën si “armën e fuqishme të partisë”, e cila e detyronte “militantin të njohë më parë vetveten, të mos harrojë rrugën ... të jetë modest dhe jo atnor dhe pedant”,²⁷ tanimë kërkonte hapur t’i shmangej përgjegjësisë.

Në pamje të parë, dukej se edhe këtë herë dinamikat e pushtetit flisnin kundër Hoxhës. Njeriu i dytë më i fuqishëm brenda hierarkisë së lartë drejtuese të PPSH-së, Mehmet Shehu, e kundërshtoi propozimin e

²⁴ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 28, fl. 33-34. Nga diskutimi i Pilo Peristerit në mbledhjen e Byrosë Politike në KQ të PPSH-së, 28 gusht 1953.

²⁵ *Po aty*.

* Përveç këtyre posteve, Enver Hoxha vijonte të ishte edhe Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Popullore dhe Kryetar i Frontit Demokratik të Shqipërisë.

²⁶ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 23, fl. 43. Nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 20-22 qershor 1953.

²⁷ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 42, fl. 22. Nga mbledhja e Byrosë Politike e KQ të PPSH-së.

Hoxhës për të mos e vijuar diskutimin në forumet e tjera të Komitetit Qendror. Sipas Shehut, ishte i nevojshëm “një rishikim politik i çështjes së fshatarësisë dhe (jo) të bëhet një punë e tillë e përciptë në Komitetin Qendror pa analizuar mirë përgjegjësitë tona kolektive si byro politike, si sekretariat, si qeveri”. Ai ftoi për reflektim të plotë dhe diskutim të çështjes në forumet e tjera të KQ të PPSH-së, çka në të vërtetë u diskutua në një mbledhje të Plenumit të KQ të PPSH-së në dhjetor të atij viti.²⁸ Nuk mund të thuhet me siguri se kjo ishte një përpjekje e Shehut për të sfiduar pushtetin e Hoxhës. Ajo që do të dukej qartë në muajt në vijim ishin përpjekjet e Hoxhës për të mos cenuar aspak autoritetin e tij, si në shoqëri, ashtu edhe në strukturat më të larta drejtuese të PPSH-së. Në popull, ai ishte propaganduar si “udhëheqës i pagabueshëm” dhe bëri gjithçka që ky perceptim të mos ndryshonte.

Ndryshe nga periudha e mëparshme, Enver Hoxha tanimë kishte përvojën për t’iu imponuar si bashkëpunëtorëve të tij më të afërt, ashtu edhe shoqërisë në tërësi. Ajo që bëri Hoxha në këtë situatë ishte shkarkimi i barrës së përgjegjësisë nga vendimmarrësit të zbatuesit, duke i dhënë zë shprehjes që raportohej se qarkullonte shumë në popull se “uji del i pastër nga burimi, por qelbet rrugës”.²⁹ Interesant për të mbështetur këtë tezë është një takim i Enver Hoxhës me sekretarin e organizatës bazë të partisë të fshatit Mazrek, në lokalitetin e Vorës, një fshat 16 km lart kryeqytetit. Takimi ishte organizuar për të kërkuar llogari se përse organizata e partisë e fshatit kishte lejuar nëpunësit e grumbullimit të sekuestronin të gjithë pasurinë e një fshatari, i cili nuk kishte shlyer detyrimet ndaj shtetit. Në të vërtetë, takimi kishte për qëllim të kërkonte informacion më të besueshëm mbi gjendjen e fshatit dhe perceptimin e politikës fiskale nga fshatarët e varfër. Nga ana tjetër, problemet që vëreheshin në fshat, sidomos për sistemin e ri të grumbullimeve, duhej t’i paraqiteshin popullsisë jo si gabime në vendimmarrje, por si shtrembërime në zbatimin e tyre nga individë të papërgjegjshëm. Hoxha i kërkoi llogari sekretarit të partisë, i cili nuk kishte ndërhyrë për të ndaluar sjelljen e nëpunësve të grumbullimit “të cilët janë sjellë si tagrambledhësit e Zogut”. Ai njoftoi se për nëpunësit kishte dhënë urdhër

²⁸ “Vendim i Plenumit të KQ të PPSH-së ‘Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve’, 24-25 dhjetor 1953,” *Dokumenta kryesore të PPSH-së, 1949-1956*, vëll. II, bot. II, (Tiranë: 8 Nëntori, 1972), 445-448.

²⁹ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 28, fl. 34. Nga fjala e Pilo Peristerit në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 27 gusht 1953.

të arrestoheshin, ndërsa fshatarit do t'i riblihej bagëtia.³⁰ Qartazi, Enver Hoxha donte të jepte mesazhin se në momentin që mësonte për një padrejtësi ishte ndërhyrja e tij e drejtpërdrejtë ajo që e vinte në vend atë.

Takimi na jep shumë të dhëna interesante për dinamikat e autoritetit. Ai zhvillohet në një kontekst të qartë asimetrie autoriteti ndërmjet palëve: sunduesit dhe të nënshtruarit. Sekretari i organizatës paraqitet i rezervuar, flet i përmbajtur, jep përgjigje lakonike dhe përpiqet të ruajë një qëndrim politikisht korrekt. Bisedën e dominon tërësisht Enver Hoxha. Pyetjes së Enver Hoxhës mbi politikën e grumbullimeve dhe vështirësitë e fshatarëve për të paguar detyrimet, sekretari i përgjigjet sipas linjës zyrtare të deriatëhershme, pra rendiment i ulët për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike. Kur Enver Hoxha insiston dhe kërkon ta konkretizojë me situatën ekonomike të familjes së tij, sekretari deklaroj se mund të siguronte bukë vetëm për nëntë muaj, ndërsa për pjesën e mbetur të vitit detyrohej të shiste prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Si rrjedhojë, ushqimi i përditshëm për familjen e një fshatari të varfër reduktohej në produkte me vlerë të ulët kalorike.³¹ Për më tepër, ai shpjegon se ndryshimi midis një fshatari të varfër dhe një fshatari të mesëm ishte se ky i fundit siguronte bukë për të gjithë vitin.

Enver Hoxha e përdori këtë takim edhe për të paralajmëruar ndryshimet që priteshin të miratoheshin, si: falja e detyrimeve të prapambetura të fshatarëve midis viteve 1949-1952, lejimi i tregut të lirë për prodhimet bujqësore dhe përmirësimi i kushteve të jetesës etj. Për këtë të fundit, Hoxha i kërkoj sekretarit ta konsideronte kujdesin për mirëqenien e familjes së tij si një detyrim politik dhe moral, në funksion të modelit që duhej të jepte për komunitetin. “T”i mbash mirë fëmijët ti si komunist, – porositi Enver Hoxha, – kjo është detyra kryesore e anëtarit të partisë në fshat, të ngrihet niveli ekonomik i fshatarësisë ... dhe jo si tani ... mos të kesh të hash asgjë në drekë dhe pastaj rroftë pushteti, rroftë partia”.³²

³⁰ *Po aty*, F. 10/AP/III/III, V. 1953, D. 20, fl. 4. Protokoll i takimit të zhvilluar në zyrën e sekretarit të përgjithshëm të KQ të PPSH-së, shokut Enver Hoxha, me sekretarin e organizatës bazë të partisë të katundit Mazrek, të lokalitetit të Vorës, lidhur me një padrejtësi që i ishte bërë një fshatari nga katundi Kuç i lokalitetit të Vorës, 23 qershor 1953.

³¹ *Po aty*, fl. 4.

³² *Po aty*, fl. 8.

Nga analizat e bëra në qarqet e larta drejtuese gjatë viteve 1953-1954, shprehej në përgjithësi shqetësimi për stabilitetin politik të vendit. Punëtorë që flinin jashtë, pasi nuk kishin banesa, radhë të gjata për furnizime me ushqime (edhe për ushqimet me triska, njerëzit duhej të shkonin disa herë në dyqan për t'i siguruar), si dhe intelektualë të lënë pas dore. Propaganda, për shkak të nivelit të ulët të agjitorëve partiakë, nuk kishte dhënë rezultatet e duhura për “edukimin ideologjik” të popullsisë. Nëse situata mbahej nën kontroll, kjo ishte rezultat i “politikës së goditjes” dhe “luftës së klasës”, pra dhunës. Kjo situatë kishte prodhuar frikë, pasiguri, por edhe kishte rritur pakënaqësinë e një pjese të mirë të popullsisë. Në mbledhjen e Byrosë Politike të 16 nëntorit 1953, Mehmet Shehu paralajmëroi se pakënaqësia nuk qëndronte vetëm te gjendja ekonomike, por edhe te masat ndëshkimore që ishin marrë ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë. Ai theksoi se, midis masave ndëshkuese dhe atyre edukative, ekuilibri anonte nga të parat. Sipas Shehut, “janë 9 000 veta të përjashtuar nga partia, 10 000 e ca veta pa triska Fronti, mbi 4 000 veta (të shpallur) kulakë, mbi 20 000 të dënuar dhe 10 000 veta të prekur.” Kjo, sipas tij, do të thoshte se “gati 1/20 e popullsisë është e gatshme të vejë te armiku”, duke paralajmëruar se zbutja e kontrollit mund të kishte pasoja për pushtetin e tyre. Ai propozoi të bëhej një “luftë e madhe për të fituar njerëzit, në radhë të parë komunistat”.³³

“Partia e para, pastaj unë”: Kulti i individit dhe dinamikat e pushtetit në udhëheqjen e lartë të PPSH-së

Në verën e vitit 1953, Byroja Politike e KQ të PPSH-së u vu në dijeni për rezolucionin e KQ të PKBS-së, ku goditej “tradhtia” e Berias, personalizimi i pushtetit dhe mungesa e udhëheqjes kolektive në BRSS. Fillimisht, hierarkia e lartë drejtuese e PPSH-së u solidarizua menjëherë me rezolucionin. Sa i takonte kolegjalitetit në udhëheqje, situata u relativizua duke pranuar se jo gjithmonë kishte funksionuar kolegjaliteti në vendimmarrje, veçanërisht në plenumet e KQ të PPSH-së. Ndërsa kulti i individit u konsiderua si një devijim antiparti, që dobësonte rolin e udhëheqjes kolektive dhe dëmtonte marrëdhënien midis partisë dhe

³³ Po aty, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 41, fl. 38. Nga diskutimi i Mehmet Shehut në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 6 nëntor 1953.

masave. Enver Hoxha, në mënyrën e tij të zakonshme, diti ta largonte përgjegjësinë nga vetja. Ai pranoi se rreth tij ishte ngritur një kult individ, por kjo nuk ishte diçka e nxitur prej tij. Madje, ai i konsideroi si “të padurueshme” dhe “të dëmshme” ekzagjerimet e “shokëve” kur flisnin për të. Kjo nuk do të thoshte që të veprohej siç kishte thënë dikush, “se gjer tani kemi folur shumë për Komandantin dhe nuk duhet të flasim më”.

Ajo që Enver Hoxha propozonte ishte një ndryshim në retorikë, pra të flitej më përpara për partinë, pastaj për Komitetin Qendror dhe në fund për të dhe “kështu edhe populli do ta shohë më mirë udhëheqjen kolegjiale të partisë”.³⁴ Kjo qasje u mbështet edhe nga të gjithë anëtarët e Byrosë Politike. Madje, Mehmet Shehu theksoi se kulti nuk duhej të shihej vetëm tek Enver Hoxha, por tek të gjithë anëtarët e Byrosë Politike.³⁵ Në të vërtetë, të gjithë propozonin një ndryshim të retorikës, që nuk prekte asgjë nga autoriteti i Enver Hoxhës në shoqëri. Kulti nuk luftohej në raport me personalizimin e pushtetit dhe të vendimmarrjes politike; kërkohej më shumë kujdes me elementet e tij performative, por edhe këto në mënyrë të pjesshme, pasi fotografia e Enver Hoxhës dhe citatet e tij vijonin të dominonin ambientet publike. Më 1954, Enver Hoxha kundërshtoi vendosjen e një busti të tij në uzinën “Enver”, por emri i tij vijoi të pagëzonte një sërë qendrash prodhimi, përfshirë edhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë.

Ndryshimet në retorikën e portretizimit publik të Enver Hoxhës filluan përpara se çështja e kultit të individit të diskutohej në forumet e tjera partiake dhe në bazën e PPSH-së.^{**} Kjo bëri që disa nga anëtarët e strukturave partiake të reagonin ndaj retorikës së re. Më 1953, Mehmet Shehu shkroi në gazetën “Zëri i Popullit”, artikullin tradicional me rastin e ditëlindjes së Hoxhës, ku vinte në dukje rolin e partisë si organ kolegjial në sukseset e arritura gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe “në ndërtimin e socializmit”. Enver Hoxhës i njihej merita jo si themelues dhe ideator i PKSH-së, siç ishte portretizuar më herët, por thjesht si

³⁴ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 28, fl. 25. Nga diskutimi i Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike në KQ të PPSH-së, 28 gusht 1953.

³⁵ Mehmet Shehu u shpreh se në kohën e luftës ajo ka qenë më e theksuar. “Mehmeti dhe Hysniu diheshin atëherë dhe populli i krahinave tona thoshin se këta e bëjnë luftën”, *po aty*, fl. 29. Nga diskutimi i Mehmet Shehut në mbledhjen e Byrosë Politike në KQ të PPSH-së, 28 gusht 1953.

^{**} Në Plenumin e KQ të PPSH-së çështja e kultit të individit u diskutua në korrik 1954.

drejtues i saj.³⁶ Sokrat Bufi, sekretari i parë i Fierit, asokohe me studime në Moskë, i pakënaqur nga portretizimi i Enver Hoxhës në artikull, shkroi një letër shumë të ashpër kundër Mehmet Shehut. Ai e akuzonte atë për karrierizëm, sepse, sipas tij, synonte të zinte vendin e sekretarit të përgjithshëm të PPSH-së; për antisovjetizëm i cili përlligjej me “hezitimin” për të vënë në zbatim metodat sovjetike; si edhe për arrogancë dhe mungesë të lidhjeve me masat.³⁷

Letra e S. Bufit vinte në një moment delikat për Mehmet Shehun. Në korrik, në një mbledhje të Byrosë Politike ishte marrë vendimi për ta larguar nga posti i sekretarit të KQ të PPSH-së, me arsyetimin se duhej të përqendrohej në punët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.³⁸ Në regjimet staliniste, goditja e shefit të policisë sekrete shënonte zakonisht mbylljen e një cikli.³⁹ Në të vërtetë, për herë të parë pas vitit 1948, Byroja Politike kishte planifikuar të analizonte zbatimin e ligjshmërisë nga organet e Ministrisë së Brendshme dhe Sigurimi i Shtetit. Mehmet Shehu ishte qartazi i shqetësuar për të ardhmen e tij, aq më tepër kur situata në Sigurimin e Shtetit paraqitej mjaft problematike⁴⁰ dhe ndryshimet në politikat ekonomike kishin shkaktuar edhe disa fërkime midis tij e Hoxhës.

Letra u shfrytëzua me kujdes nga Enver Hoxha për t’i treguar Mehmet Shehut se kush urdhëronte. Me ambiguitetin që shoqëronte fjalimet e tij sa herë përgatitej për ndonjë goditje, Hoxha deklaroi se nuk u besonte akuzave të ngritura në letër dhe mbështeti punën e Shehut. Por fakti që e solli letrën në Byronë Politike ishte një kampanë alarmi për ministrin e Brendshëm. Shehu e konsideroi Bufin provokator dhe përçues

³⁶ Mehmet Shehu, “Shoku Enver Hoxha, udhëheqës i partisë dhe i popullit,” *Zëri i Popullit*, e premte, 16 tetor 1953.

³⁷ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 64, fl. 186-208. Nga procesverbali i mbledhjes së sekretariatit të KQ të PPSH-së, mbi takimin e Enver Hoxhës me Sokrat Bufin, 31 gusht 1953.

³⁸ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 32, fl. 33. Nga fjala e Spiro Kolekës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 28-29 shtator 1953.

³⁹ Bashkim Shehu, *Liri Belishova dhe koha e saj: Idealizmi, humnerat e pushtetit, katarsis* (Tiranë: UETPress, 2020), 93.

⁴⁰ Për më tepër, shih: Gjon Boriçi, “Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe të internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953,” në *Të mohuar nga regjimi: Burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990*, redaktimi shkencor Sonila Boçi (Tiranë: AIDSSH, 2019), 194-216.

të thashethemeve të medieeve të huaja mbi një konflikt të brendshëm midis tij dhe Hoxhës. Qëndrimin e moderuar të Hoxhës ndaj Bufit e konsideroi si shenjë mosbesimi ndaj tij.⁴¹

Kaq mjaftoi që Hoxha të aktivizonte mekanizmin e autoritetit. Mbledhja e Byrosë Politike, ku u kritikua Shehu, erdhi pas disa takimeve paraprake të tij me këtë të fundit. Në fjalën hapëse të mbledhjes, e cila, si rregull, u jepte tonin masave ndëshkuese, ndihej qartë se qëllimi nuk ishte ndëshkimi i Shehut, por disiplinimi i tij. Si mekanizëm legjitimiteti të autoritetit të tij, Hoxha tregoi me detaje takimet personale që kishte zhvilluar me ambasadorin sovjetik në Tiranë. Përfaqësuesi në fjalë, sipas Hoxhës, pas konsultimeve me Moskën, i kishte dhënë “dritën jeshile” për ta diskutuar çështjen e Mehmet Shehut në Byronë Politike.⁴² Pra, Moska ishte rreshtuar në krahun e Hoxhës, gjë që i jepte edhe më shumë peshë autoritetit të tij.

E. Hoxha e zhvendosi diskursin e kultit të individit nga ai vetë te Shehu,^{***} të cilin e akuzoi për mbeturina “mikroborgjeze”. Shehu, sipas Hoxhës, po krijonte rreth vetes kultin e njeriut të pagabueshëm, pasi ai ishte lavdëruar gjithmonë për punën e tij, ndërsa anëtarët e tjerë të Byrosë Politike ishin vazhdimisht në tëh të kritikave.⁴³ Hoxha nxiti edhe anëtarët

⁴¹ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 29, fl. 145-148. Nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 1 shtator 1953.

⁴² *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 32, fl. 16. Nga fjala e Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 28-29 shtator 1953.

^{***} Mehmet Shehu kishte krijuar një reputacion për veten të bazuar mbi veprimtarinë e tij revolucionare dhe aftësitë personale. Ndonëse nuk posedonte karizmin e Hoxhës, përkundrazi, shumica i frikësoheshin për arrogancën dhe prepotencën që tregonte vazhdimisht ndaj bashkëpunëtorëve dhe vartësve, Shehu megjithatë shfaqte aftësi të cilat Hoxhës i mungonin. Ai kishte kryer “shkollën revolucionare” në Spanjë dhe ishte organizator shumë i mirë, si politik, ashtu edhe ushtarak dhe administrativ. Shehu njihej si njeri “i dorës së fortë”. Ishte ai që kishte vendosur kontrollin qeveritar në veri, duke pushkatuar pa gjyq, arrestuar dhe keqtrajtuar popullsinë e atyre zonave. Po ashtu, ishte ai që ishte përgjigjur “terrorit me terror” ndaj popullsisë së Mirditës më 1949 dhe në Tiranë, pas vendosjes së një bombe në oborrin e ambasadës sovjetike në Tiranë. Ai kishte fituar reputacionin e njeriut që kishte drejtuar me sukses Ministrinë e Brendshme gjatë luftës “kundër bandave të diversantëve”. Shehu ishte i vetmi në Byronë Politike që guxonte ta kundërshtonte hapur Hoxhën; ai i kritikonte ashpër të gjithë, ndërkohë që vetë nuk kishte qenë asnjëherë në qendër të kritikave. Studimet në Moskë dhe njohja e gjuhës ruse e bënë, në sytë e Hoxhës, një rival të rrezikshëm për postin e tij.

⁴³ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 32, fl. 2-13. Nga autokritika e Mehmet Shehut në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 28-29 shtator 1953.

e tjerë të Byrosë Politike t'i bashkoheshin në sulmin kundër Shehut. Të gjithë përsëritën shembuj për sjelljet prepotente të Shehut, mungesën e kujdesit ndaj bashkëpunëtorëve, mendjemadhësinë e shfaqur në faktin se ai i kishte atribuar vetes sukseset e arritura, ndërkohë që nuk kishte bërë tjetër veçse “detyrën që i kishte caktuar partia”. Në fund të mbledhjes, Mehmet Shehu jo vetëm bëri autokritikë, por, duke e konsideruar Hoxhën pothuajse si figurë atërore, sipas traditës paternaliste shqiptare, pranoi edhe autoritetin e tij absolut.⁴⁴

Ardhja në krye të PKBS-së e Nikita Hrushovit ndryshoi sërish dinamikat e pushtetit në udhëheqjen e lartë të PPSH-së. Për shkak të ndarjes së përgjegjësisë midis autoriteteve partiake dhe atyre shtetërore, në korrik 1954 Enver Hoxha u detyrua të linte të gjitha postet shtetërore, përfshirë edhe atë të Komandantit të Përgjithshëm të ushtrisë. Mehmet Shehu mori drejtimin e qeverisë. Ndërsa dukej sikur do të krijohej një dualizëm pushteti, presioni i Hrushovit për të përmirësuar marrëdhëniet me Jugosllavinë ndihmoi *de facto* autoritetin e Hoxhës. Për Shqipërinë, revizionimi i marrëdhënieve me Beogradin do të thoshte, përveç të tjerave, rishikim i krejt historisë së themelimit të saj.⁴⁵ Legjitimiteti i Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut në krye të PPSH-së i dedikohej, në një masë të konsiderueshme, edhe propagandimit të tyre si persona që kishin qenë në ballë të luftës kundër jugosllavëve dhe kishin kontribuar për shpëtimin e pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë ndryshim të ri të historisë, ishte plotësisht e mundshme që ata të ishin viktimat e para të një procesi të kundërt, çka kontribuoi në forcimin e aleancës midis tyre.

Në vitet në vijim, vëmendja e drejtuesve më të lartë të PPSH-së u përqendrua të tregonte përkushtimin ndaj luftës kundër kultit të individit dhe tek të gjitha ndryshimet që diktoheshin nga Moska. Nga ana tjetër, ata vepronin me kujdes për të mos humbur autoritetin e tyre real në popullsi. Në prill 1955 u zhvillua një mbledhje e zgjeruar e Plenumit të KQ të PPSH-së, në të cilën morën pjesë edhe sekretarët e komiteteve të partisë në qarqe, drejtuesit e propagandës në rrethe, si dhe përfaqësues të strukturave të ushtrisë dhe të Ministrisë së Brendshme. Raporti, tejet i gjatë, prej 47 faqesh, u mbajt nga Liri Belishova, e cila ishte emëruar si sekretare e Komitetit Qendror për agjitacionin e propagandën që nga korriku i vitit 1954. Raporti mernte në shqyrtim të gjithë punën e bërë për

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ Mehilli, “Defying De-Stalinization”, 37.

ideologjizimin dhe efektivitetin e agjitacionit dhe propagandës në shoqëri. Në kuadër të kësaj trajtese, disa problematika tërheqin veçanërisht vëmendjen. Në mënyrë paradoksale, raporti pranon se ideologjizimi kishte pasur më shumë efekt te popullsia sesa tek elita politike. Liri Belishova vë në dukje se “kuadrot e larta” i kushtonin më pak vëmendje studimit të literaturës marksiste-leniniste sesa komunistët e bazës apo popullsia në përgjithësi. Lenini dhe Stalini vijonin të ishin “ideologët” që më së shumti përmendeshin, jo aq në raport, sa në diskutimet e pjesëmarrësve.

Raporti i kushton vëmendje të veçantë luftës kundër kultit të individit. Ndryshe nga Plenumi i korrikut 1954, këtë herë kjo luftë zbriste nga qendra në bazë. Belishova thekson se parimi leninist i kritikës dhe autokritikës nuk zbatohet në bazë. Fjala e sekretarit të një organizate bazë konsiderohet si ligj dhe rrallë ndodhte që në mbledhjet e saj të zhvilloheshin diskutime apo pyetje. Organizatave bazë u mungonte iniciativa, aq sa sekretarët e tyre nuk pranonin t’i zhvillonin mbledhjet pa praninë e një të deleguari nga një instancë më e lartë. Sipas raportit, kjo situatë, shpjegohej me nivelin e ulët kulturor të organizatave bazë dhe jo me masat represive të ndërmarra në vijimësi ndaj individëve që kishin shprehur mendim kundër.

Ndërsa fliste për luftën kundër kultit të individit, raporti vinte në dukje se ky proces nuk nënkuptonte që popullsia të mos edukohej për të shtuar dashurinë ndaj udhëheqjes. Një mënyrë e tillë dëshmon se bëhej fjalë vetëm për një ndryshim semantik të retorikës, jo për një luftë reale kundër personalizimit të autoritetit. Raporti kritikon tekstet shkollore, letërsinë dhe artet, ku lufta kundër kultit të individit nuk ishte pasqyruar mjaftueshëm. Direktiva e dhënë nga Belishova ishte vënia në pah e rolit të masave në histori. Si shembull ilustrues, ajo i referohej historisë së Mesjetës, duke kritikuar tekstet historike që vijonin të trajtonin kryesisht rolin e fisnikërisë arbërore, si Balshajt etj.⁴⁶

Në ndryshim nga fryma liberalizuese që vinte nga Bashkimi Sovjetik, raporti tërhiqte vëmendjen për forcimin e luftës së klasave, duke vënë në dukje “oportunizmin” që kishte filluar të shfaqej në disa raste. Raste oportunizmi në zhvillimin e luftës së klasave u përmendën

⁴⁶ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1955, D. 1, fl. Raporti i KQ të PPSH-së mbi punën ideologjike, mbajtur nga Liri Belishova në Plenumin e KQ të PPSH-së, 25-27 prill 1955.

nga pothuajse të gjithë sekretarët e komiteteve të qarqeve. Në formën e një autokritike për punën politike të munguar, Sami Baholli, sekretari i parë i Komitetit të PPSH-së për Elbasanin, vë në dukje disa shfaqje oportuniste. Sipas tij, heqja e emërimit “kulak” për disa persona kishte ndikuar në ndryshimin e sjelljes si te komunistët, të cilët “s’kanë dashë të prishin qejf me ata e kanë dobësuar kështu luftën e klasave”, ashtu edhe te fshatarët, të cilët “mbajnë qëndrim afrimi me elementin kulak”.⁴⁷

Hezitimi ndaj autoritetit u vu re edhe në fillimet e këtij plenumi, kur Enver Hoxha kërkoi nga pjesëmarrësit të bënin pyetje rreth raportit. Përveç Tuk Jakovës, për disa minuta askush nuk guxoi të bënte pyetje. U desh nxitja e Hoxhës që drejtuesit më të lartë lokalë të PPSH-së të artikulonin disa pyetje, shumica e të cilave ishin me karakter teknik. Pjesa më e madhe e diskutimeve iu përmbajt linjave të zakonshme politike: mobilizimit të popullsisë jo vetëm për çështje politike, por edhe ekonomike, thellimit të luftës së klasave, efektivitetit të punës ideologjike etj. I vetmi që artikuloi qëndrime disi ndryshe nga vija politike ishte Tuk Jakova, zëvendëskryeministër dhe anëtar i Plenumit të KQ të PPSH-së. Ai diskutoi mbi dy çështje: kultin e individit dhe luftën e klasave. Duke marrë shkas nga kritika e Belishovës mbi theksimin e rolit të masave në histori, Tuk Jakova kërkoi pikërisht këtë. Ai theksoi se në historinë e PPSH-së, Enver Hoxha përmendej si themeluesi dhe drejtuesi i saj, çka sipas tij nuk ishte e vërtetë, pasi Hoxha ishte zgjedhur në krye të partisë në Konferencën e parë të mbajtur në Labinot.⁴⁸ Ai kërkoi të kuptonte arsyet pse nuk shpjegohet roli i Miladin Popoviçit si ndërmjetës për bashkimin e grupeve komuniste. Nëse duhej të evidentohej roli i masave në histori, atëherë Jakova kritikoi mënyrën se si muzeu i themelimit të PPSH-së dhe ai i Luftës e paraqisnin këtë periudhë, duke evidentuar Enver Hoxhën dhe Byronë Politike, jo ata që kishin drejtuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ). I ndërgjegjshëm për rëndësinë që kishte LNÇ-ja për legjitimitetin e pushtetit, Jakova nxiti të paraqitej “roli i masave”, pra karakteri gjithëpërfshirës i saj. “Unë pashë në Budapest, – u shpreh Jakova, – që ata kishin pasur tre partizanë dhe u kishin bërë atyre kushedi

⁴⁷ Po aty, fl. 278. Nga fjala e Sami Bahollit në Plenumin e KQ të PPSH-së, 25-27 prill 1955.

⁴⁸ Nikolin Loka, *Tuk Jakova, jeta dhe vepra* (Tiranë: Grand Prind, 2017), 293-296; Demir Dyrmishi, *Lufta politike në udhëheqjen e PKSH (PPSH) 1944-1960* (Tiranë: Toena, 2011), 185-187.

sa gjëra, kurse ne kemi pasur plot partizanë dhe kemi ç'të vëmë në dukje".⁴⁹

Fjala e Tuk Jakovës mund të ishte në sinkroni me "shkrirjen e akujve", pra me liberalizimin e regjimit dhe politikën e afimit me Jugosllavinë, që po nxitej nga Bashkimi Sovjetik, por jo me qëllimet e hierarkisë së PPSH-së. Ndërsa linja politike e PPSH-së vijonte të fliste për luftën kundër oportunizmit në zbatimin e luftës së klasave, Jakova tërhiqte vëmendjen ndaj shfaqjeve të sektarizmit. Ai theksonte nevojën për të qenë më njerëzorë dhe për t'u dhënë individëve që nuk ishin kundërshtarë të regjimit mundësinë të siguronin jetesën,⁵⁰ prekte drejtpërdrejt kultin e Enver Hoxhës, i cili kishte përdorur një histori të deformuar për të legjitimuar pushtetin e vet. Për më tepër, ai e bëri këtë në një mbledhje të zgjeruar të plenumit, ku merrnin pjesë 60 individë, të cilët ishin drejtues të niveleve të dyta apo të treta lokale. Kjo e bënte ndërhyrjen e tij edhe më shqetësuese për Hoxhën.

Ajo që të bën përshtypje, duke shfletuar procesverbalin e plenumit, është se narrativa zyrtare mbi themelimin e PPSH-së ishte brendësuar nga shumica e pjesëmarrësve. Sadik Bocaj, sekretar i parë i Komitetit të PPSH-së për Shkodrën, ishte ndër të parët që kundërshtoi argumentet e ngritura nga Jakova, duke i dhënë tonin kritikave të mëvonshme ndaj tij. Ai shtrembëroi disi atë çka kishte thënë Jakova, kur u shpreh se Miladin Popoviçi nuk mund të konsiderohej si krijues i PKSH-së "mbasi partia u krijua si rezultat i përpjekjeve të grupeve, influencës së Revolucionit të Tetorit dhe krijimit të konditave në luftë kundër okupatorëve fashistë".⁵¹

Në të vërtetë, Jakova, duke kërkuar të rishikohej historia e grupeve komuniste, pasi "ato janë baza nga duallën elementët nga të cilët u udhëhoq partia", pohonte realitetin për të cilin fliste Bocaj. Miladin Popoviçi, Jakova i njihte meritën "se ndërmjetësoi përmes grupeve", gjë që nuk kishin mundur ta realizonin të dërguarit shqiptarë të

⁴⁹ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1955, D. 1, fl. 271. Nga fjala e Tuk Jakovës në Plenumin e KQ të PPSH-së, 25-27 prill 1955.

⁵⁰ *Po aty*. T. Jakova solli rastin e dy individëve nga Shkodra, qyteti i tij i lindjes, përfaqësues i të cilit ishte në Kuvendin Popullor. Jakova tregon për vetëvrasjen e një vajze, mbesës së tatër Anton Harapit, një prej ish-regjentëve të dënuar me vdekje nga regjimi, pasi kishte mbetur pa asnjë mjet jetese dhe pa kujdes minimal. Rasti i dytë, i ngjashëm me të parin, ishte shtyrë drejt vetëvrasjes për të njëjtat arsye, por në momentin e fundit tragjedia u evitua.

⁵¹ *Po aty*, fl. 304. Nga fjala e Sadik Bocajt në Plenumin e KQ të PPSH-së, 25-27 prill 1955.

Kominternit.⁵² Jakova nuk gaboi në raport me faktin historik, madje as me parimin marksist të “rolit të masave” në histori. Gabimi i tij qëndronte në raport me qëllimet politike të hierarkisë së lartë partiake. Ai përmendi se roli i Enver Hoxhës në themelimin e partisë nuk ishte ai që i atribuonte propaganda. Për më tepër, duke kërkuar që t’u njiheshin meritat për rezistencën edhe individëve që historia e politizuar nuk i përmendte, ai kërkonte depersonalizimin e kujtesës, çka do të thoshte të prekte themelet e legjitimiteti të regjimit dhe të pushtetit personal të Enver Hoxhës.

Shumë nga diskutantët, përfshirë edhe Enver Hoxhën, e dënuan fjalën e Tuk Jakovës, duke e konsideruar atë në kundërshtim me “teorinë marksiste-leniniste” dhe “vijën politike të përcaktuar nga Kongresi I. Kadri Hazbiu, ministri i Brendshëm, duke kritikuar fjalimin e Jakovës, u tërhoqi vëmendjen pjesëmarrësve,⁵³ të cilët, sipas tij, nuk mbajtën qëndrim ndaj fjalimit të këtij të fundit. Të gjitha këto ishin dëshmi se regjimi nuk kishte asnjë qëllim të luftonte realisht kultin e individit. Përkundrazi, kërkonte pjesëmarrje të gjerë për të dënuar ata që guxonin dhe ngriheshin jo kundër autoritetit të “njëshit”, pasi qëllimi i Jakovës nuk ishte të prekte pozitat aktuale të Enver Hoxhës, por kundër narrativës që legjitimonte këtë pushtet.

Përgjatë tre muajve që ndoqën Plenumin e prillit, Enver Hoxha dhe anëtarë të tjerë të Byrosë Politike përgatitën terrenin për dënimin e Tuk Jakovës. Vetë Enver Hoxha, së bashku me Rita Markon, takoi të gjithë ata me të cilët Jakova kishte miqësi ose kishte biseduar rreth çështjeve që kishte ngritur në plenum.⁵⁴ Në këtë proces u ndërtuan të gjitha akuzat kundër Jakovës. Ai u akuzua se nuk donte të luftonte kultin e individit, por të ngrinte kultin e tij; se kishte tendenca lokaliste dhe se po luftonte për të rrëzuar “udhëheqjen e partisë” etj. I vetmi që rezistoi të bëhej pjesë e skenarit ishte Bedri Spahiu, i cili, ndonëse kishte biseduar me Jakovën, nuk e kishte vënë në dijeni Komitetin Qendror. Në gjuhën e regjimit, kjo konsiderohej si “miqësi e sëmurë”, e cila mund të çonte në prishje të unitetit, pra në lindjen e fraksioneve.

⁵² *Po aty*, fl. 269. Nga fjala e Tuk Jakovës në Plenumin e KQ të PPSH-së, 25-27 prill 1955.

⁵³ Kastriot Dervishi, *Historia e vërtetë e Partisë së Punës së Shqipërisë, 1944-1991* (Tiranë: 55, 2022), 115.

⁵⁴ Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56*, 135-156; Loka, *Tuk Jakova*, 314-317.

Në Plenumin e qershorit 1955, situata ishte përgatitur dhe ngjante me një hetuesi të mirëfilltë. Tonin plenumit ia dha Enver Hoxha me leximin e raportit të Byrosë Politike. Siç vë në dukje studiuesi William J. Chase, duke folur për politikat represive të Stalinit, ai nuk mund të vepronte vetëm. Enveri, ashtu si Stalini, kishte nevojë për anëtarët e Byrosë Politike, të plenumit, apo të tjerë njerëz që kishin pasur lidhje me Jakovën, “për të mbështetur idetë e tij, për të dhënë fakte të reja, të cilat jo vetëm do të legjitimonin (akuzat), por edhe do t’i shtynin ato përtej limiteve të arsyeshme”.⁵⁵ Pas një mbledhjeje që më së shumti i ngjante një hetuesie, pjesëmarrësit ofruan “prova” për të vërtetuar akuzat që Hoxha kishte ngritur për të. Fjalët e Jakovës se përcaktimi i rolit të Miladin Popoviçit në Kongresin I ishte kushtëzuar nga situata politike, pra nga marrëdhëniet me Jugosllavinë, ranë në vesh të shurdhët. Tuk Jakova u përjashtua nga Komiteti Qendror dhe më pas edhe nga partia. Së bashku me të u dënua edhe Bedri Spahiu, asokohe ministër i Arsimit. Madje ky i fundit u arrestua menjëherë, me pretekstin se kishte shfaqur tendenca për të vrarë veten.⁵⁶ Sipas disa dëshmive të tërthorta, duket se arrestimi i Bedri Spahiut erdhi për shkak se kishte fyer Enver Hoxhën.⁵⁷

Studiuesja Ana Lalaj hedh hipotezën se dënimi i Tuk Jakovës dhe i Bedri Spahiut mund të jetë bërë me miratimin e Hrushovit, në kuadër të përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe të proceseve të ngjashme në vendet e tjera të Bllokut, ku u dënuan personat e përfshirë në proceset e montuara për dënimin e “agjentëve jugosllavë”.⁵⁸ Në të vërtetë, Tuk Jakova kishte zëvendësuar Koçi Xoxen si sekretar organizativ, ndërsa Bedri Spahiu kishte qenë prokuror i Gjykatës Speciale, e cila më pas e dënoi atë. Nëse kjo hipotezë qëndron, ajo dëshmon vetëm lojën me dy standarde të Hoxhës dhe të udhëheqjes së lartë të PPSH-së. Në planin e brendshëm, dënimi i tyre ishte një sinjal për

⁵⁵ William J. Chase, *Enemies within gates? The Comintern and Stalinist repression 1934-1939* (New Haven and London: Yale University Press, 2001), 405.

⁵⁶ “Bedriun e arrestuam nga frika se mos vriste veten”, marrë me shkurtime nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, 20 qershor 1955, në Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56-ës*, 156. Bedri Spahiu u lirua për mungesë provash, por në Elbasan, ku ishte dërguar të punonte si kontabilist, ai ishte në vëzhgim nga Sigurimi i Shtetit.

⁵⁷ Dervishi, *Historia e vërtetë e Partisë së Punës*, 116.

⁵⁸ Lalaj, “Detanta e parë dhe Shqipëria,” 342.

të gjithë mbi kufirin e kritikës dhe se pushteti i Enver Hoxhës ishte i paprekshëm.

Përfundime

Titulli “Reforma pa transformim” nuk synon të mohojë ndryshimet që ndërmori regjimi në Shqipërinë e viteve 1953-1956. Në këtë periudhë u morën një sërë vendimesh që synonin përmirësimin e jetesës së punëtorëve dhe fshatarëve, përfshirë heqjen e pjesshme të triskave më 1955 dhe lejimin e tregut privat fshatar. U morën disa masa edhe për lehtësimin e presionit mbi popullsinë, si heqja e emërimit “kulak” për një pjesë të saj apo iniciativa e një amnistie për emigrantët politikë, për t’i nxitur të ktheheshin në Shqipëri. Megjithatë, këto reforma nuk prodhuan transformimin që pritej nga iniciatori i tyre, Bashkimi Sovjetik.

Udhëheqja shqiptare nuk e përqafoi kurrë plotësisht “Kursin e Ri” të Nikita Hrushovit, gjë që u reflektua qartazi në mënyrën se si u trajtua çështja e kultit të individit. *Së pari*, Enver Hoxha nuk pranoi asnjëherë përgjegjësi personale për situatën e krijuar. Ndryshimet u bënë si reflektim i direktivave të Moskës, pa një analizë të përgjegjësive, duke ruajtur kështu imazhin e drejtuesit të pagabueshëm. *Së dyti*, rikthimi formal te udhëheqja kolegjiale nuk e preku autoritetin real të Hoxhës. Përkundrazi, ai, si mjeshtër i shfrytëzimit të rrethanave, arriti ta riafirmonte atë, si përmes nënshtrimit politik të Mehmet Shehut, ashtu edhe duke ndëshkuar figura si Tuk Jakova, i cili, ndonëse vepronte brenda diskursit zyrtar kundër kultit, preku drejtpërdrejt themelet e legjitimitetit personal të udhëheqësit. *Së fundi*, në Shqipëri, ndoshta edhe për shkak të paternalizmit tradicional, ekzistonte një vertikalitet i pushtetit, në të cilin të gjithë silleshin me vartësit e tyre si “Enverë më të vegjël”.

Ajo që bie veçanërisht në sy nga analiza e kujdesshme e kësaj periudhe është se edhe këto ndryshime të kujdesshme rrezikonin ta bënin të vështirë kontrollin e situatës. Raporti i Liri Belishovës, i cili evidenton se, me shenjat më të vogla të zbutjes, komunistët e bazës nuk tregonin konsekuencë në zbatimin e luftës së klasave, dëshmon se, në mungesë të një shoqërie plotësisht të ideologjizuar, metodat staliniste të dhunës dhe represionit mbeteshin instrumenti i vetëm efektiv i kontrollit. Në këtë kuptim, reformat e viteve 1953-1956 nuk u shndërruan në mekanizëm

transformimi, por konfirmuan kufijtë e një regjimi të ndërtuar mbi autoritetin personal dhe frikën.

Burime e bibliografi:

I. Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondet:

F. 10/AP/III/III. V. 1953, D. 20.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 42.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 1/9.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 23.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 28.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 29.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 32.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 41.» a.d.

F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 64.» a.d.

II. Literaturë:

ALIA, Ramiz. *Jeta ime: kujtime*. Tiranë: Toena, 2010.

BOÇI, Sonila. “Trajektorja e një kulti: Enver Hoxha dhe sendërtimi i udhëheqësit stalinist (1944-1948).” *Studime historike*, nr. 2 (February 2025): 115-144.

CHASE, William J. *Enemies within gates? The Comintern and Stalinist repression 1934-1939*. New Haven&London: Yale University Press, 2001.

DERVISHI, Kastriot. *Historia e vërtetë e Partisë së Punës së Shqipërisë 1944-1991*. Tiranë: 55, 2022.

DYRMISHI, Demir. *Lufta politike në udhëheqjen e PKSH (PPSH) 1944-1960*. Tiranë: Toena, 2011.

FISCHER, Bernd J. & Oliver Jens Schmitt. *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*. Përkthyer nga Col Mehmeti. Prishtinë: Artini, 2022.

HOXHA, Enver. *Hrushovianët, kujtime*. Tiranë: 8 Nëntori, 1980.

KABA, Hamit. *Shqipëria dhe të mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*. Tiranë: KLEAN, 2015.

KABA, Hamit & Ethem Çeku. *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*. Prishtinë: Brezi 81 & QSA, 2011.

- KLIMÓ, Árpád von. *Hungary since 1945*. Përkthyer nga Kevin McAleer. New York&London : Routledge, 2018.
- KRAMER, Mark. "The Changing Pattern of Soviet-East European Relation 1953-1968". Vol. II: *The Cambridge History of Communism: The Socialist Camp and World Power, 1941-1960*, eds. Silvio Pons, Sophie Quinn-Judge Norman M. Naimark, 139-169. Cambridge: Cambridge University Press, 2017.
- LALAJ, Ana. "Dentanta e parë dhe Shqipëria." *Studime historike*, nr. 3-4 (2009): 337-343.
- LALAJ, Ana. *Pranvera e rrejtshme e '56*. Tiranë: Infbotues, 2015.
- LOKA, Nikollë. *Tuk Jakova: jeta dhe vepra*. Tiranë: Grand Prind, 2017.
- MARKU, Ylber. "Shifting Alliances: Albania in the early Cold War." *Journal of Cold War Studies* 24, nr. 3 (Summer 2022): pp. 80-115.
- MËHILLI, Elidor. "Defying de-Stalinization: Albania's 1956." *Journal of Cold War Studies* 13, nr. 4 (Fall 2011): pp. 4-56.
- MËHILLI, Elidor. *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*. Ithaca : Cornell University Press, 2017.
- Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*. Vëll. V. Grup autorësh. Redaktor përgjegjës akad. prof. dr. Beqir Meta. ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2023.
- Dokumenta kryesore të PPSH-së 1949-1956*. Vëll. II, bot. II. Instituti i Studimeve marksiste-leniniste pranë KQ të PPSH-së. Tiranë: Shtëpia botuese e librit politik, 1972.
- SHEHU, Bashkim. *Liri Belishova dhe koha e saj: Idealizmi, humnerat e pushtetit, katarsis*. Tiranë: UETPress, 2020.
- TUCKER, Robert C. "Stalinism as revolution from above." Në *Stalinism, essay in historical interpretation*, redaktuar nga Robert C. Tucker, 77-111. New Brunswick, New Jersey: Transaction Publishers, 1999.

ASSOC. PROF. DR. SONILA BOÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
sonilaboci23@gmail.com

S u m m a r y

REFORM WITHOUT TRANSFORMATION: POLITICAL POWER
DYNAMICS IN ALBANIA
1953-1956

This article examines the dynamics of power in Albania during the years 1953–1956, a period marked by profound changes in the Soviet Union that reverberated throughout the Eastern Bloc. In Albania, the years following Stalin’s death were characterized by efforts to preserve internal control, while the leadership simultaneously sought to keep pace with the reforms of Nikita Khrushchev’s “New Course,” imposed from Moscow. Drawing on a re-reading of archival documents and newly uncovered sources, the study explores the gap between the formal acceptance of Soviet reform directives and their selective implementation in practice. The article argues that the reform process initiated by Moscow did not lead to a transformation of Albania’s power structure. The campaign against the cult of the individual did not challenge the core of personal authority or the personalization of decision-making, but was instead confined to a reconfiguration of public discourse, in which the Party was rhetorically placed before the individual. The article analyzes Enver Hoxha’s maneuvers to consolidate his authority both within the upper echelons of the party hierarchy and within society at large. Cases such as that of Tuk Jakova demonstrate that any attempt to depersonalize history and relativize the leader’s role constituted the insurmountable boundary of reform. In this sense, the period 1953–1956 can be defined as one of reform without transformation, insofar as it left untouched the ideological foundations of a regime oriented toward Stalinism.

Keywords: De-Stalinization, New Course, Enver Hoxha, cult of personality, power dynamics.

NEKROLOGJI

DY FJALË PËR PROF. DR. RAMIZ ABDYLIN (10 nëntor 1944 – 22 shkurt 2026)



Më 22 shkurt të këtij viti, në moshën 81-vjeçare, ndërroi jetë profesori i shquar i historisë, Ramiz Abdyli.

Ai lindi më 10 nëntor 1944 në Llojan të Kumanovës, ku edhe filloi shkollimin. Shkollën fillore e vijoi në Miratoc të Preshevës, ndërsa arsimin e mesëm e kreu në Shkollën Normale “Zef Lush Marku” në Shkup. Pas përfundimit të saj, më 1963, në vitet 1964-1968 ndoqi studimet e larta për histori në Universitetin e Shkupit. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Prishtinës, ku u magjistrua më 1976 dhe u doktorua më 1982.

Ende gjatë procesit të arsimimit, R. Abdyli publikoi në gazetën “Flaka e Vëllazërimit” shkrime me tematikë nga historia e shqiptarëve gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Që në fillimet e veprimtarisë së tij hulumtuese e botuese, i riu R. Abdyli dëshmoi saktësi në trajtimin e temave dhe seriozitet në qasjen ndaj burimeve e literaturës. Nuk u demoralizua kur redaktorët ndërhyjnë dhe bënin ndryshime në tekstin e paraqitur, për të qëndruar brenda kornizës ideore dhe politikës nacionale të regjimit. Tema e tij e diplomës, “Pavarësia e Shqipërisë”, ishte hapi i radhës. Më pas, ai vijoi me trajtimin e historisë së trevave shqiptare lindore, duke finalizuar, ndër botimet e para, një libër kushtuar heroit kumanovas Bajram Shabani.

Përsëri iu desh të përballej me vështirësi, sepse prirja e autoriteteve në Republikën e Maqedonisë ishte denigrimi dhe tendenca për përjashtimin e shqiptarëve, sa herë që ishte e mundur, nga radhët e kombësive që kishin dhënë kontribut në luftën antifashiste. Prapavija ishte kategorizimi i tyre si elementë jo të besueshëm në Maqedoni dhe në

gjithë Jugosllavinë. Megjithatë, ai punoi me përkushtim dhe ngjiti shkallët e karrierës shkencore. Vështirësitë nuk iu ndanë as gjatë përgatitjes së temës “Presheva gjatë Luftës së Dytë Botërore, 1941-1945”, e cila mbeti dorëshkrim në Bibliotekën e Preshevës.

Është autor i disa monografive: “Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore, 1918-1941” (1986), “Zef Lush Marku” (1988), “Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910, I” (2004) dhe “Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912, II” (2004), të përkthyer edhe në maqedonisht, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze, I-II” (2004), “Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912” – bashkautor (2006), “Trojet lindore shqiptare në Kryengritjen e Përgjithshme 1912” (2012), “Hasan Jakup Ferri – një jetë për atdhe” (2019), “Shkupi në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881” (2021), “Klubi ‘Bashkimi’ i Shkupit, 1908-1912” (2021) etj.

Ndërkohë, në vitet ’90, R. Abdyli ishte kryeredaktor i revistës historiko-politike “Kosova”, e cila botohej në Tiranë në gjuhën shqipe dhe angleze, si organ i Institutit të Historisë në Prishtinë dhe i Institutit të Historisë në Tiranë (1994-2001), si dhe i revistës shkencore “Studime albanologjike” të Institutit për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh), (2009-2010).

Është autor i dhjetëra zërave në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, I-III (2008) dhe në *Fjalorin enciklopedik të Kosovës*, I-II (2018), i dhjetëra studimeve, artikujve dhe trajtesave në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe i disa artikujve nga metodika e historisë. Po ashtu, mori pjesë me kumtesa në simpoziume dhe konferenca shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar.

Karrierën e tij akademike e nisi që në vitin 1975. Pasi kishte punuar fillimisht si mësues në shkollat e Llojanit, Bukovikut dhe në gjimnazin e Kumanovës – ku, në fillim të viteve ’70, dha një kontribut të rëndësishëm për hapjen e paraleleve të para në gjuhën shqipe – më 1978 u pranua si punonjës shkencor në Institutin e Historisë në Prishtinë. Punoi gjithashtu si studiues në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup.

Ai ishte ndër profesorët themelues të Universitetit të Tetovës (1994), ku rreth vitit 2003 ushtroi detyrat e prodekanit të fakultetit dhe të rektorit, duke kontribuar në zhvillimin dhe konsolidimin e këtij universiteti. Po ashtu, gjatë viteve 2008-2009 drejtoi edhe ITShKSh-në.

Gjatë punës së tij si studiues e pedagog shqiptar, prof. R. Abdyli u përball me pengesa, jo vetëm në periudhën para viteve ’90, por edhe më

pas. Madje, gjatë hulumtimeve në arkivat e Serbisë, siç ka pohuar edhe vetë, hasi në pengesa që nuk i kishte pasur më parë.

Kur u nda nga jeta, profesori ishte në procesin e përfundimit të një studimi kritik në përgjigje të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve në Shkup, lidhur me trajtimet për historinë e shqiptarëve në *Enciklopedinë e Maqedonisë së Veriut*. Dorëshkrimi voluminoz ndodhet ende në tryezën e tij të punës.

Në rrugën shumëvjeçare si intelektual dhe shkencëtar, Ramiz Abdyli dha një kontribut të shquar në dy plane: në atë të zgjerimit të hapësirës emancipuese dhe të arsimimit të shqiptarëve në trevat e tyre verilindore e lindore, si edhe në ngritjen dhe avancimin e standardeve akademike e shkencore në universitetet dhe institucionet ku shërbeu, veçanërisht aty ku pati edhe poste drejtuese, përkatësisht në Universitetin e Tetovës dhe në ITShKSh. Kontribut personal në këtë plan të dytë vlerësohet edhe zgjerimi i hulumtimeve dhe i studimeve mbi periudha të caktuara me rëndësi për historinë e shqiptarëve, të cilat kishin të bënin me zhvillimin e vetëdijes politike dhe me hapat për shtetndërtim në dekadat e fundit të shek. XIX dhe në vitet e para të shek. XX.

Thënë thjesht, prof. dr. Ramiz Abdyli pati rol e kontribut të shquar në historiografinë shqiptare e më gjerë për ndriçimin shkencor të historisë kombëtare, për edukimin e brezit të ri dhe për zhvillimin e institucioneve të larta arsimore e studimore shqiptare.

Vepra e prof. dr. Ramiz Abdylit është dhe do të mbetet një pikë reference e rëndësishme për studimin e historisë së kombit shqiptar. Ai do të kujtohet gjithashtu si veprimtar e mësimdhënës i respektuar, si njeri i urtë, i qetë, komunikues, human dhe dashamirës, për çka do t'i jemi mirënjohës përgjithmonë.

AKADEMIK. PROF. DR. MARENGLEN VERLI
PROF. DR. MUHAMET SHATRI